



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



RAPORT VJETOR

2007

Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit
1 Janar – 31 Dhjetor

Viti 2007

Tiranë, Prill 2008

Fjala e Avokatit te Popullit

E nderuar Zj. Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Të nderuar deputetë,

Ky është Raporti i tetë Vjetor, me të cilin Avokati i Popullit paraqitet para ketij Kuvendi te nderuar.

Avokati i Popullit vjen sot para jush me një fizionomi shumë më të plotë dhe të qartë, jo vetëm për të rishpalosur vizionin e tij, por edhe për të rishprehur angazhimin dhe motivimin e tij për të kryer edhe detyra të tjera që ky Kuvend pritet t'i ngarkojë.

Ashtu si çdo vit tjetër, ky Raport paraqet një pasqyrë përmbledhëse të punës sonë njëvjeçare. Pavarësisht formës dhe përfundimeve të tij, në përgjithësi përmbajtja e këtij Raporti ka qenë pjesë e pasqyrimit të përditshëm mediatik të rasteve të shqyrtuara nga Avokati i Popullit nga të gjitha mjetet e informimit publik në Shqipëri.

Praktika e përditshme e raporteve individ-shtet dëshmon se niveli i mirëqeverisjes, si një e drejtë e njeriut, akoma lë shumë për të dëshiruar në Shqipëri. Avokati i Popullit, gjatë vitit 2007, e ka ngritur zërin në çdo rast që ka konstatuar shkelje të të drejtës së informimit, të të drejtave që rrjedhin nga marrëdhëniet e punes, për shkeljet e ambientit, për zvarritjet në procedurat gjyqësore etj. Reagimet tona të forta ndjehen në të gjitha rekomandimet tona që kanë pasuar inspektimet dhe kontrollet periodike nëpër burgje, në dhomat e paraburgimit, në spitalet psikiatrike apo ambiente të tjera të mbyllura. Në të gjitha këto raste kemi qenë tepër kërkuar ndaj punonjësve të shtetit, për të zbatuar dhe eliminuar dhunën, torturën dhe çdo formë tjetër keqtrajtimi të lidhur me to. Këtij qëllimi besoj se do t'i shërbejmë akoma më mirë tani e tutje, kur, në plotësim të detyrimeve ndërkombëtare që vendi ynë ka marrë përsipër pas ratifikimit të konventave ndërkombëtare, pritet të fillojë nga funksionimi struktura e re pranë Avokatit të Popullit, që quhet Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Avokati i Popullit ka ngritur me kohë edhe nevojën e zbatimit të së drejtës pozitive, që parashikon kuotën jo më pak se 30 përqind për përfshirjen e grave në formacionet vendimmarrëse në të gjitha nivelet apo funksionimin e gjithë strukturave të shtetit ndaj plagës së gjakmarjes.

Ndërkohë kemi qenë të angazhuar edhe në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, përmes një projekti trevjeçar, në përfundim të të cilit do të paraqesim rekomandime konkrete, nëse një strukturë e tillë e posaçme do të funksionojë pranë Avokatit të Popullit apo do të krijohet një Zyrë e veçantë Ombudsmani për Fëmijet.

E kemi thënë dhe e themi, se qëndrimi ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit tregon ndjeshmërinë ndaj të drejtave të njeriut dhe shkallën e kulturës së mirëqeverisjes që ka administrata publike. Përtej problematikës individuale, natyrisht që Avokati i Popullit përgjithëson praktika, të cilat materializohen në rekomandimet e tij specifike.

Synimi ynë vazhdon të jetë të ushtruarit e presionit të nevojshëm pozitiv ndaj administratës publike shqiptare, gjithmonë me synimin për të ndikuar sa më shumë në realizimin e standarteve të kërkuara të mirëqeverisjes. Arritja e këtyre standarteve, në funksion të zbatimit të ligjit, vetvetiu parakupton një luftë më efikase ndaj

fenomeneve frenuese të shoqërisë dhe shtetit tonë, sikundër janë korrupsioni, trafiket apo edhe mosfunksionimi i strukturave që kontrollojnë zbatimin e ligjit.

Në mungesë të ndarjeve të dikurshme ideologjike, Kalë Beteje për politikanët dhe qeveritë e sotme moderne janë bërë të drejtat e njeriut dhe cilësia e jetesës së të qeverisurve, kudo dhe në çfarëdolloj pozite ekonomike, shoqërore dhe politike që ata ndodhen për një moment të dhënë. Prandaj ka patur dhe do të ketë gjithmonë opinione, gjykime dhe vlerësime të ndryshme rreth nivelit të zbatimit të tyre. Themelore dhe pozitive është se të gjithë bashkë synojnë standarte më të larta.

Të nderuar deputetë,

Natyrisht që është e drejta e këtij Kuvendi të shprehet për veprimtarinë e paraqitur në Raportin e Avokatit të Popullit, gjë që ne e mirëpresim me shumë konstruktivitet. Por, më shumë se kaq, ne presim të ndihemi gjithmonë të mbështetur nga ky Kuvend, i cili, edhe përmes Avokatit të Popullit, realizon njëkohësisht atributin e tij, si kontrollues i administratës në kushtet e demokracisë parlamentare. Jemi para ngjarjeve të rëndësishme historike për shtetin shqiptar, siç është pritja e ftesës për në NATO dhe për thellimin e marrëdhënieve me Bashkimin Europian, ngritjen e Statusit të Shqipërisë si vend kandidat, edhe institucioni i Avokatit të Popullit ndjehet krenar për kontributin që ka dhënë në fushën e promovimit, ruajtjes, përmirësimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri. Pa respektuar këto të drejta as që mund të bëhej fjalë për anëtarësim në këto organizma të botës së qytetëruar, të botës së lirë dhe thellësisht demokratike.

Ju faleminderit.

**Avokati i Popullit
Ermir Dobjani**

Tiranë, më 15 mars 2008

PERMBAJTJA

	Faqe
Fjala e Avokatit të Popullit	1
Përmbajtja	3
Hyrje. Avokati i Popullit dhe parimet mbi te cilat ai funksionon.	6
Prezantim i shkurtër i Raportit	9

KREU I PARE

1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit.	11
2. Bashkepunimi dhe mbështetja ndërkombëtare për Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2007.	15
3. Buxheti i institucionit për vitin 2007.	18
4. Sfidat dhe objektivat e institucionit për vitin 2008 e në vazhdim	19

KREU I DYTE

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2007.	21
2. Opinione të përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri.	23
3. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë.	30
4. Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese.	36
5. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me publikun dhe median.	49
a. Sektori i Pritjes së Popullit	51
b. Ditët e hapura – përvojë për t'u vazhduar.	54
6. Konferenca Kombëtare “ Per nje Shqiperi pa torture”.	55
7. Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2007.	58

KREU I TRETE

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet, të grupuara sipas institucioneve qeveritare

1.	Këshilli i Ministrave (Qeveria).	61
2.	Ministria e Drejtësisë	66
	a. Sistemi i burgjeve dhe paraburgimeve.	66
	b. Zyrat e Përmbartimit	79
	c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.	83
	ç. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish Pronarëve	86
3.	Ankesat për pushtetin gjyqësor dhe administratën gjyqësore.	88
4.	Ankesat për Prokurorinë.	102
5.	Ministria e Brendshme.	117
6.	Ministria e Mbrojtjes.	161
7.	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.	167
8.	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.	174
9.	Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës.	196
10.	Ministria e Financave.	210
11.	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës	216
12.	Ministria e Shëndetësisë.	224
13.	Ministria e Punëve të Jashtme.	236
14.	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	239
15.	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.	242
16.	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.	246
17.	Ankesat për Administratën e Shërbimit Informativ Shtetëror	247
18.	Veprimtaria e Nën Seksionit të të Drejtave të Fëmijëve	248

KREU I KATERT

- | | |
|---|-----|
| 1. E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legislative. | 257 |
| Pasqyra Nr.1. Evidenca e rekomandimeve për plotësime apo ndryshime të ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 2000-2007. | 259 |
| Pasqyra Nr.2. Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime në aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave për periudhën 2000-2007. | 271 |
| Pasqyra Nr.3. Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime për aktet nënligjore të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore për periudhën 2000-2007. | 281 |
| 2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit (“ex officio”) | 291 |

ANEKSE

- | | |
|--|-----|
| 1. Letra falenderimi nga qytetarët dhe vlerësime të institucioneve | 292 |
| 2. Tabela dhe grafikët | 295 |

HYRJE

Avokati i Popullit dhe Parimet mbi te cilat ai Funkcionon

Në përmbushje të misionit të tij, Avokati i Popullit funksionon si një mjet ligjor, ekstrajgyqësor për hetimin e pavarur të ankesave apo kërkesave të qytetarëve ndaj sjelljes, vendimeve, veprimeve apo mosveprimeve të parregullta e të paligjshme të administratës publike. Parimet dhe tiparet thelbësore të Zyrës janë pavarësia, fleksibiliteti, paanësia, besueshmëria dhe transparenca ndaj publikut.

Synimi i Avokatit të Popullit dhe arsyeja përse ai ekziston është të shqyrtojë çështjet që dalin nga keqadministrimi në administratën publike dhe nëpërmjet rekomandimeve të sjellë përmirësime në standartet dhe cilësinë e shërbimeve. Keqadministrimi shprehet në sjelljen e zyrtarit në kundërshtim me Kushtetutën, me ligjet dhe normat e gjithëpranuara morale në shtetin tonë. Duke atakuar këtë dukuri, Avokati i Popullit promovon mirëqeverisjen dhe ndershmërinë në administratën publike.

Tipar i Raportit të Avokatit të Popullit, ashtu si i çdo Raporti tjetër pergjithesues dhe pasqyrues i punës së tij, është se ai nuk është surprizë. Pavaresisht formës së përmbledhur dhe përfundimeve të arritura në të, në pergjithësi përmbajtja e tij, pra rastet e ndjekura nga Avokati i Popullit, kanë qenë pjesë e pasqyrimit të përditshëm në faqet e shtypit. Është ky pasqyrim mediatik që ka krijuar atë enë komunikimi të përditshëm, të cilën Avokati i Popullit edhe e ka ushqyer, por edhe është ushqyer prej saj. Edhe këtu, teksa perpiqemi që të paraqesim para Kuvendit një reagim analitik ndaj zhvillimeve të brendshme në vend, me synimin për të ushtruar presionin e nevojshëm alternativ dhe pozitiv të administratës publike, gjithmone synimi ynë është ndikimi për realizimin e standarteve të kerkuara të mirëqeverisjes. Fokusi i punës së Avokatit të Popullit është praktika e përditshme shqiptare në korrelacionin individ-shtet dhe niveli i mirëqeverisjes si e drejte e njeriut. Në këto bindjen se sot do të ishte pretendim minimalist të flitej vetëm për të drejtën e jetesës. Mbi të gjitha sot flitet për të drejtën e jetesës, çka parakupton shumë më tepër.

Në rastet e paraqitura në këtë raport jemi munduar jo thjesht të pasqyrojmë punën tonë, por mbi të gjitha të vëmë gishtin mbi dukuritë abuzive që shfaqin ata përfaqësues të administratës publike, në nivel qendror dhe vendor, dhe shumë se kaq, të bëjmë të qartë për ta rruget që duhen ndjekur për të krijuar dhe ruajtur standardet e mirëqeverisjes, që tashmë konsiderohet si një e drejte e njeriut.

Kjo është arsyeja përse Avokati i Popullit ka terhequr në mënyrë specifike vëmendjen se, nëse ka dy ligje që duhet të jenë busulla e përditshme e zyrtarit shqiptar, ato duhet të jenë Ligji për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Zyrtare dhe Kodi i Procedurave Administrative. Këto dy ligje shprehin konkretisht kontratën sociale që qytetarët shqiptarë kanë nënshkruar dhe nënshkruajnë rregullisht me shtetin e tyre. Për zbatimin e këtyre dy ligjeve, Avokati i Popullit nuk është mjaftuar me terheqjen e vëmendjes dhe keshillimet e rastit, gjë që e ka bërë që prej fillimit të veprimtarisë së tij. Përkundrazi, në Korrik 2007, ai ju ka derguar të gjitha organet e administratës publike, në nivel qendror dhe vendor, dy rekomandime, respektivisht

“Per miratimin e Rregullores tip per te Drejten e informimit”, si dhe “Per miratimin e Rregullores tip per shqyrtimin e ankimeve administrative”, duke bashkengjitur me kete rast edhe formularet perkates, si e si per t’ua bere me te lehte edhe qytetareve, edhe zyrtareve zbatimin e ketyre dy ligjeve.

Funksionimi i Institucionit te Avokatit te Popullit e fuqizon akoma me shume edhe funksionimin e skemes sipas ndarjes se tre pushteteve. Ai eshte nje mekanizem ndihmës i kontrollit dhe balances se pushteteve, synimi i te cilit nuk eshte ndeshkimi i shkelesve te ketyre te drejtave, por korrigjimi, rivendosja, e per pasoje rikthimi i ketyre te drejtave te vete qytetaret ose taksapaguesit.

Normat dhe parimet e veprimtarise se Avokatit të Popullit e kanë burimin në Kushtetutën e Shqipërisë, ligjet, konventat dhe protokollat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe në traditën me te mire administrative te krijuara nga institucionet shqiptare nder vite. Kontrata më angazhuese, e shpallur nga Titullari i Institucionit është ajo me qytetaret shqiptare.

Duke vepruar ne permbushje te kesaj “kontrate”, Avokati i Popullit perpiqet te jete njohes dhe sherues praktik i patologjise shoqerore qe historikisht dhe ne çdo vend, shoqeron marredheniet individ administrate. Veprimtaria efikase e nje institucioni te tille ushqen çdo dite besimin e individit tek administrata, dhe për pasoje siguron kohezionin social, aq te domosdoshem per funksionimin e nje demokracie normale. Per kete arsye, Avokati i Popullit ose Ombudsmani ben pjese ne ato institucione, që sipas Kartës së Kopenhagenit jane “garante te demokracise, te shtetit ligjor dhe te te drejtave te njeriut”.

Pavarësia institucionale dhe kompetencat e Avokatit të Popullit nuk janë privilegje që i jepen Kreut të Zyrës dhe punonjësve të saj, por garanci për të vepruar me profesionalizëm dhe përkushtim gjatë ndërmjetësimit midis qytetarit dhe autoritetit publik, kur ky i fundit me veprime apo mosveprime lejon të shkelen të drejtat dhe liritë e individit, të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet.

Tipar themelor i institucionit të Avokatit të Popullit eshte pavarësia nga Qeveria dhe nga çdo ndikim politik. Pasi ka siguruar kete, ai mundeson lehtësi kontaktimi, shpejtësi procedimi, fleksibilitet qendrimesh, efektivitet nderhyrjesh. Rekomandimet e tij formalisht nuk janë detyruese, por pikerisht mungesa e forcës detyruese kushtëzon edhe forcën më të madhe morale dhe argumentuese, per pasoje edhe detyrimin moral dhe ligjor te administrates dhe autoriteteve publike per te zbatuar kete rekomandim.

Si në vende të tjera me demokraci në tranzicion, edhe administrata shqiptare nuk mund t’i shpëtojë lehtë tendencës për të diktuar dhe qenë e mbyllur, më tepër se sa për të dëgjuar dhe sqaruar. Avokati i Popullit vazhdon të përpiqet për ta bërë publikun të kuptojë se të drejtat e tij përbëjnë detyrim për administratën publike.

Avokati i Popullit nuk është dhe nuk mund të jetë një institucion i specializuar akuze dhe gjurmimi ndaj administratës publike në Shqipëri. Ne nuk jemi për të punuar kundër institucioneve publike, as për të marrë meritat e punës së tjerëve. Kritikata apo kërkesat tona për masa ndëshkuese ndaj punës së administratës apo zyrtarëve të veçantë, janë pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të administratës në përmbushje të detyrimeve të saj ligjore,

Në vendet ku ky institucion ka qindra apo dhjetra vite që ekziston është vënë re se Ombudsmani ndihmon që të ndryshojë pozitivisht imazhin e administratës në publik. Edhe tek ne, kjo ka ndikuar për ta bërë administratën shqiptare më të përgjegjshme për cilësitë e veprimtarisë së saj dhe për përgjegjësitë ndaj publikut.

Çdo zyrë ombudsmani në botë, sikundër edhe në Shqipëri, faktikisht ndeshet çdo ditë edhe me forma të rezistencës të organeve të administratës apo të autoriteteve

publike. Në kushtet tona, kur institucionet ende rezultojnë jo të mësuara e të konsoliduara me ndërgjegjen e shtetit të së drejtës, kjo është edhe më e dukshme. Por, nëse secili do të udhëhiqet nga parimi demokratik i pushteteve të kufizuara, mendojmë se ekzistojnë hapësira të mjaftueshme për njëri-tjetrin, ku bashkëpunimi të jetë sa më efikas. Në kushtet kur ndërhyrja e Avokatit të Popullit bëhet me të vetmin qëllim, për të rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit në raport me administratën, rezultati merr edhe më shumë vlerë, sepse gjithkush, para se të jetë autoritet publik, i zgjedhur apo i emëruar, polic, prokuror apo qoftë edhe zyrtar i thjeshtë, është qytetar i këtij vendi ndaj të cilit kemi të drejta, por edhe shumë detyrime.

Kemi thënë vazhdimisht se qëndrimi që administrata mban ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit është tregues i përgjegjshmërisë së saj ndaj shkeljeve që kryen si edhe i faktit se sa e gatshme është ajo për t'i riparuar ato.

Në tetë vjet aktivitet Avokati i Popullit ka punuar me administrata qendrore dhe vendore të ndryshme për nga orientimi politik. Ne jo vetëm rideklorojmë, por jemi perpjekur në çdo rast edhe të deshmojmë pas çdo vendimi apo qëndrimi se Avokati i Popullit në Shqipëri, duke ofruar oponente për mireqeverisje, nuk punon të bëjë Opozitën ndaj Qeverisë, veçse punon që ajo të realizojë detyrat dhe angazhimet e saj para popullit shqiptar.

Kjo ka qënë, është dhe do të jetë filozofia e funksionimit të këtij institucioni të zhveshur nga çdo anësi politike në funksionimin e tij. Nëse do të ishim orientuar drejt konfliktualitetit ose, në të kundërt, drejt kompromisit politik me pushtetmbajtësit e radhes, do të komprometoheshin rëndë parimet themelore, mbi të cilat në mbështetemi dhe institucioni do të dështonte, në sytë e opinionit publik shqiptar dhe organizmave ndërkombëtare që na monitorojnë nga afër.

Analizat që behen në këto raporte, pas çdo rasti apo ankese, synojnë të hedhin dritë mbi problematikën e përgjithshme të situatës në vend, me prirjen për t'u orientuar drejt praktikave me të mira që ofron legjislativi ndërkombëtar, jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Strasburgut dhe veprimtaria e zyrave homologe në botë. Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se sfidat e integritetit edhe për institucionin që drejton vijjnë gjithmonë e në rritje dhe janë gurë kilometrike të pafundëm në rrugën e zhvillimit.

PREZANTIM I SHKURTER I RAPORTIT

Në fillim të çdo viti Institucioni i Avokatit të Popullit finalizon tekstin e publikimit më të rëndësishëm të tij, Raportit Vjetor, i cili përmban punën e Institucionit të bërë gjatë 12 muajve, refleksionet për çështjet më të rëndësishme të prezantuara gjatë vitit si dhe identifikon problemet të cilat kanë nevojë për përmirësime në të ardhmen. Numri i ankesave të shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2007, është pak më i madh, por i afërt me ato të shqyrtuara gjatë vitit 2006 dhe 2005, gjë që do të thotë se tashmë kemi krijuar një stabilitet lidhur me ankesat apo kërkesat që shqyrtojmë.

Raporti i tetë vjetor i Avokatit të Popullit, paraqet veprimtarinë e tij gjatë vitit 2007. Ai është i ndarë në katër krerë dhe dy anekse dhe fillon me fjalën e veçantë të Avokatit të Popullit, në të cilën ai paraqet shkurtimisht arritjet kryesore të punës së tij gjatë vitit 2007, si dhe nënvizon idetë e tij për punën e vitit në vazhdim.

Kreu i parë është prezantimi i cili ndër të tjera shpjegon shkurtimisht arritjet e Institucionit dhe në veçanti objektivat e tij për të ardhmen. Gjithashtu i kushton vëmendje bashkëpunimit të Institucionit tonë me zyrat homologe dhe detajon pjesëmarrjen aktive të Institucionit të Avokatit të Popullit në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare..

Kreu i dytë ka të bëjë me aktivitete të informimit dhe komunikimit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Ky kre është ndarë në 7 seksione ku një vënd të veçantë zënë opinionet për situatën e të drejtave të njeriut si dhe për mirëqeverisjen në Shqipëri. Një seksion i veçantë i është kushtuar organizimit të “ditëve të hapura” dhe bashkëpunimit me mediat, nëpërmjet të cilave kemi siguruar aksesin e nevojshëm në publik.

Kreu i tretë, i cili zë dhe pjesën më të madhe në raport, ka të bëjë me ankesat, kërkesat dhe njoftimet e trajtuara nga Avokati i Popullit, të ndara sipas ministrive përkatëse dhe organeve të tjera të administratës publike, dhe hetimet e kryera për disa raste si dhe rezultatet. Këtu kemi prezantuar dhe mjetet për zgjidhjen e rasteve tipike dhe të përsëritura, të cilat mendojmë se duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për veprimet e organeve përgjegjëse të administratës në situata të ngjashme. Ky kre gjithashtu përmban rekomandime dhe propozime për eliminimin e shkeljeve dhe padrejtësive, të cilat janë identifikuar gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura tek Avokati i Popullit. Në një seksion të veçantë kemi prezantuar dhe veprimtarinë e nënseksionit për fëmijët për vitin 2007. Ky kre i raportit përmban gjithashtu dhe shumë analiza të detajuara për raste të veçanta, të cilat sipas këndvështrimit tonë, janë konsideruar të rëndësishme dhe që do të vazhdojnë të jenë në vëmendjen tonë në të ardhmen.

Kreu i katërt paraqet veprimtarinë shumë të rëndësishme të Avokatit të Popullit, të realizuar nëpërmjet rekomandimeve për nxjerrjen, ndryshimin apo plotësimin e ligjeve apo akteve nënligjore, në rastet kur është përmbajtja e këtyre dhe jo zbatimi ose moszbatimi i tyre shkak që krijon premisa apo kushte për shkelje të të drejtave të njeriut apo keq qeverisje. Për shkak të kësaj rëndësie, në tre tabelat përkatëse kjo veprimtari paraqitet për 8 vitet e ekzistencës së Avokatit të Popullit në

Shqipëri. Gjithashtu në këtë kre prezantohen edhe çështjet e filluara me iniciativë nga Avokati i Popullit.

Në aneksin 1 kemi paraqitur disa nga letrat e falenderimit të qytetarëve drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit dhe vlerësime të institucioneve.

Aneksi 2 paraqet në mënyrë grafike statistikën kryesore të punës së Institucionit.

K R E U I

1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit

Ligji nr. 8600, dt.10.04.2000, “Për disa ndryshime në ligjin 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit””, i jep Avokatit të Popullit të drejtën e përcaktimit të strukturës dhe organikës (numrit të personelit) të tij. Kurse pagat janë caktuar me vendim të veçantë të Qeverisë Nr.500, dt.18.07.2003 “Për miratimin e strukturës dhe pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit”.

Zotërinjtë Gëzim Lleshi, Riza Poda dhe Jorgo Dhrami kanë qënë për 3 vjet në detyrën e Komisionerit deri më datën 22.01.2007.

Nga data 23.01.2007 deri më 7 nëntor 2007 këta persona kanë kryer detyrën e këshilltarit të Avokatit të Popullit. Zoti Jorgo Dhrami më datën 30 shtator 2007 doli në pension.

Me vendimin nr.142 datë 05.11.2007 të Kuvendit të Shqipërisë zgjidhen në detyrën e Komisionerit Florina Nuni, Riza Poda dhe Skënder Haluci. Zoti Gëzim Lleshi emërohet Sekretar i Përgjithshëm pas kësaj date.

Zyra e Avokatit të Popullit funksionon me tre seksione të specializuara, siç i ka përcaktuar neni 31 i ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Seksioni i parë merret me ankesat dhe kërkesat për organet e administratës qëndrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre dhe drejtohet nga zj. Florina Nuni.

Seksioni i dytë merret me ankesat dhe kërkesat për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura, prokurorinë e pushtetit gjyqësor dhe drejtohet nga z. Skënder Haluci.

Seksioni i tretë ose seksioni i përgjithshëm, drejtohet nga z. Riza Poda dhe trajton çështjet jashtë fushave të mësipërme, ndjek bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe kryen studime në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Këtu funksionon edhe nënseksioni për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Nga 1 Janar 2007 deri më 31 dhjetor 2007 kanë funksionuar dy zyra Rajonale në qytetet Shkodër dhe Korçë me nga dy specialistë (juristë). Këto dy zyra kanë funksionuar në përbërje të nënseksionit në bazë të një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatës Save the Children. Ky bashkëpunim ka përfunduar në dhjetor 2007.

Hallkë e rëndësishme e strukturës së institucionit është edhe Kabineti, në përbërje të të cilit janë Drejtori i i Kabinetit dhe këshilltarët, të cilët janë në vartësi direkte nga Avokati i Popullit.

Sektorët mbështetës që ndihmojnë në realizimin e detyrave kryesore të Institucionit janë Drejtoria e Informacionit, Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë si dhe Drejtoria e Personelit dhe Administratës, të cilat janë në varësi direkte të

Sekretarit të Përgjithshëm. Pjesë të rëndësishme të këtyre drejtorive, janë Sektori i Informacionit e Pritjes së Popullit dhe Sektori i Financës. Kjo strukture, e cila është përcaktuar nga Avokati i Popullit, ka rezultuar e efektshme, në përputhje me prioritetet e vendosura për vitin 2007.


Kuvendi në ligjin “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2007” ka miratuar 45 punonjës dhe po kaq kanë qenë të punësuar. Nga këta janë 16 juristë që quhen ndihmëskomisionerë, të cilët merren direkt me zgjidhjen e ankesave. Juristë janë edhe Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Kabinetit, 2 këshilltarë, 3 komisionerët dhe vetë Avokati i Popullit.

Një element i rëndësishëm i cili është lidhur me strategjinë e Avokatit të Popullit është dhe rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të institucionit. Pjesëmarrja në trajnimet e ndryshme e ndihmëskomisionerëve dhe e punonjësve të tjerë të Administratës, ka ndihmuar në ngritjen e tyre profesionale, gjë kjo që vërtetohet edhe me pajisjen e tyre me certifikatat e marra nga Instituti i Trajnimit të Departamentit të Administratës Publike.

Titullin Master e kanë fituar 5 anëtarë të stafit, kurse 2 të tjerë janë në proces të fitimit të këtij titulli. Kurse 5 juristë të tjerë aktivizohen për mësimdhënie si pedagogë të jashtëm në Fakultetet e Drejtësisë dhe në Shkollën e Magjistraturës.

Pjesa më e madhe e specialistëve të Zyrës së Avokatit të Popullit zotërojnë dhe përdorin mirë një ose më shumë gjuhë të huaja, kryesisht anglisht, frëngjisht, italisht, rusisht, gjermanisht etj.

**STRUKTURA E INSTITUCIONIT TE AVOKATIT TE POPULLIT
PER VITIN 2007**



**ORGANIKA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT
PER VITIN 2007**

Nr.	EMËRTIMI	NËPUNËS
I.	AVOKATI I POPULLIT	(1)
II.	KABINETI Drejtor i Kabinetit + Zëdhënës i Avokatit të Popullit Këshilltarë të Avokatit të Popullit Sekretare e Avokatit të Popullit	(5) 1 3 1
III.	SEKSIONI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS QENDRORE DHE VENDORE Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + Rregjistruese	(7) 1 5 1
IV.	SEKSIONI I SHËRBIMEVE TË VEÇANTA Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	(8) 1 6 1
V.	SEKSIONI I PËRGJITHSHËM Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Nënseksioni për Fëmijët (Ndihmëskomisioner) Sekretare + rregjistruese	(7) 1 4 1 1
VI.	SEKRETARI I PËRGJITHSHËM	(1)
VII.	DREJTORIA E INFORMACIONIT, MARREDHENIEVE ME PUBLIKUN DHE ME JASHTË Drejtor Shef Sektori Specialist Arkivist+Sekretare e Sekretarit të Përgjithshëm	(5) 1 2 1 1
VIII.	DREJTORIA E PERSONELIT, ADMINISTRATËS DHE FINANCES Drejtor Shef Sektori Specialist Shofer Pastrues	(11) 1 2 1 5 2

Punonjës gjithsej të Institucionit të Avokatit të Popullit janë 45 veta.

2. Bashkëpunimi dhe mbështetja ndërkombëtare për Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2007

Marrëdhëniet me Jashtë të Avokatit të Popullit janë realizuar kryesisht në tre drejtime. Së pari, në shkëmbimin on-line të informacioneve mbi zhvillimet e forumeve ndërkombëtare të familjes së Ombudsmanit dhe të Institucioneve Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (marrëdhënie shumëpalëshe). Së dyti, në shkëmbimin e vizitave njohëse dhe trajnimeve me zyrat homologe (marrëdhënie dypalëshe). Së treti, në pjesëmarrjen në konferenca, seminare, tavolina të rrumbullakta etj. ku diskutohet për të drejtat e njeriut dhe veprimtarinë e Ombudsmanëve apo institucioneve të tjera të kësaj natyre.

Veprimtaritë e Avokatit të Popullit në këto drejtime kanë konsistuar në prezantimin e arritjeve të institucionit tonë, sikurse dhe të përpjekjeve që bën shteti shqiptar për të përmbushur standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut një nga të cilat është ngritja dhe konsolidimi i institucionit të Avokatit të Popullit apo si quhet kryesisht në gjuhën ndërkombëtare Ombudsmanit parlamentar.

Një drejtim tjetër i marrëdhënieve me faktorin ndërkombëtar është edhe bashkëpunimi me organizmat vepruese në Shqipëri, interesimi i të cilave për shtetin e të drejtës dhe të drejtat e njeriut është mjaft i madh. Kështu mund të përmendim bashkëpunimin e vazhdueshëm me Departamentin Amerikan të Shtetit, përmes Ambasadës Amerikane në Tiranë, për hartimin e pjesës së Raportit Vjetor të këtij Departamenti për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri. Falë besueshmërisë së shfaqur në veprimtarinë e Avokatit të Popullit, Ambasada Amerikane në Tiranë vazhdon ta konsiderojë Avokatin e Popullit si një ndër filtrat informativ, të vlefshëm për referim në rastet e shumë trajnimeve që kjo ambasadë ofron për nëpunësit dhe autoritetet publike shqiptare, duke afishuar me këtë rast si standart sjelljen dhe figuren e tyre përse i përket rekordit të shkeljeve të mundshme të të drejtave të njeriut. I tillë është edhe bashkëpunimi me Zyren e OSBE-së në Tiranë për probleme të ndryshme që lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut dhe standartet e shtetit ligjor.

Forcimit dhe zhvillimit të institucionit të Avokatit të Popullit i shërben edhe bashkëpunimi me zyrat homologe si dhe pjesëmarrja aktive në forumet ndërkombëtare, të cilësuar joformalisht si aktivitete të Familjes Ndërkombëtare të Ombudsmanit.

Avokati i Popullit vazhdon të jetë anëtar me të drejta të plota i Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI), i Ombudsmanit European (EOI), Shoqatës së Ombudsmanit dhe Mediatorit Frankofon (AOMF), Shoqatës së Ombudsmanit të Shteteve të Bashkuara (USOA), Shoqatës Ndërkombëtare të Ombudsmanit (IOA). Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia, Avokati i Popullit i realizon përmes pjesëmarrjes në aktivitete si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

I. Aktivitete të organizuara nga Këshilli i Europës:

1. Avokati i Popullit mori pjesë në seminarin me temë: “Ndërhyrja e Ombudsmanit midis Parimeve të Ligjshmërisë dhe Mirë-Qeverisjes” që u zhvillua në Sofie, Bullgari, më 17-18 shtator 2007. Seminari u organizua nga programi Eonomia i Ombudsmanit të Greqisë, me mbështetjen e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Europës dhe që u mikprit nga Ombudsmani i Bullgarisë.

2. Një përfaqësues i Avokatit të Popullit, mori pjesë në Forumin e Lisbonës me temë “ Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut- gur themeli për

promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut” organizuar nga North-South Centër në bashkëpunim me Komisionin e Venecias dhe Komisionerin për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Europës, më 16-17 nëntor 2007, në Lisbonë.

3. Një përfaqësues i Avokatit të Popullit, mori pjesë në seminarin me temë: “Heqja e Barrierave për Pjesëmarrje Sociale: Popullsia Rome përpara Ombudsmanit”, organizuar më 7-8 dhjetor 2007 në Naflpion, Greqi, nga Ombudsmeni Grek me mbështetje të Këshillit të Europës. Qëllimi i këtij seminari ishte shkëmbimi i eksperiencave të institucioneve të Ombudsmanit European në trajtimin e rasteve të romeve dhe formulimi i nje politike të qëndrueshme për bashkëpunimin me administratën publike mbi çështjet e romëve.

II. Aktivitete të organizuara në bashkëpunimi me OSBE-në

1. Avokati i Popullit mori pjesë në Konferencën e Ombudsmanëve rajonal mbi mbështetjen dhe pengesat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që u zhvillua në Prishtinë, më 8-9 qershor 2007, organizuar nga Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës, me mbështetje të zyrës amerikane në Prishtinë dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë.

2. Me ftesë të zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODHIR), një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në mbledhjen e posaçme me temë kryesore njohjen dhe shqyrtimin e situatës ndërkombëtare lidhur me të drejtën e lirisë së organizimit, të grumbullimit dhe të shprehjes së lirë, nxitjes së të drejtës për pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë në vendet dhe shoqëritë pluraliste që aderojnë në OSBE. Kjo mbledhje u zhvillua në Vienë, Austri, me 29-30 mars 2007.

III. Konferenca të tjera ndërkombëtare:

1. Avokati i Popullit mori pjesë në Konferencën e dytë të Shoqatës ndërkombëtare të vendeve frankofone të Komisioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, me temë: “Respektimi i diversitetit kulturor dhe gëzimi i plotë e të Drejtave”, organizuar në bashkëpunim me Komisionin për të Drejtat e Njeriut të Francës që mban pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj Shoqate. Konferenca u zhvillua në Rabat, Marok, me 4-8 shkurt 2007.

2. Më 1-2 mars 2007, Avokati i Popullit mori pjesë në konferencën me temë: “Të Drejtat e Njeriut dhe Ombudsmeni” që u zhvillua në Matera, Rajoni i Basilicatës, Itali, me ftesë të Mrojtësit Qytetar të këtij Rajoni. Avokati i Popullit pati rastin gjithashtu të takohet një ditë pas Konferencës me komunitetin arbëresh dhe autoritetet në San Constantino Albanese.

3. Një delegacion i kryesuar nga Avokati i Popullit, mori pjesë në Konferencën e Dytë Vjetore të Shoqatës së Ombudsmanit Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (IOA), që u zhvillua në St.Louis, më 11-14 prill 2007, me temë: “Të forcojmë themelet tona”.

4. Me ftesë të Qendrës Rajonale për Minoritetet dhe Zyrës së Ombudsanit të Provincës së Vojvodinës, një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në seminarin me temë “Situata e grave në rajonin e Ballkanit Perëndimor” që u zhvillua në Beograd, më 14-15 maj 2007.

5. Dy përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në Konferencën Vjetore të ENOC (Rrjeti European i Ombudsmanëve të Fëmijëve) që u zhvillua në Barcelonë më 19-21 shtator 2007.

6. Avokati i Popullit mori pjesë në konferencën me temë: “Roli i Gjykatës Kushtetuese dhe Ombudsmanit në mbrojtje të çështjeve për të drejtat e njeriut” që u zhvillua në Yerevan, Armeni me 5-6 tetor 2007, organizuar nga Gjykata Kushtetuese dhe Institucioni i Mbrojtësit të të Drejtave të Njeriut të Republikës së Armenisë.

7. Me ftesë të Qendrës Ndërkombëtare për Fëmijët e Humbur dhe të Shfrytëzuar, një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në Forumin US/Balkan për Fëmijët e Humbur dhe të Shfrytëzuar që u zhvillua në Athinë, Greqi, më 10 tetor 2007.

8. Në kuadrin e një projekti për mbrojtjen e konsumatorit të financuar nga GTZ-ORF (Fondi i hapur Rajonal për reformën Ligjore) në vendet e Europës Juglindore, dy përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në takimin rajonal të Grupit të Punës për Planifikimin Strategjik, që u zhvillua në Beograd, më 4-7 nëntor 2007. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe OJF që vepron në këtë fushë të cilët diskutuan dhe shkëmbyen eksperiencat e tyre në aspekte të ndryshme të mbrojtjes së konsumatorit.

9. Një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në Konferencën e parë themeluese Ndërkombëtare të Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të vendeve Mesdhetare që u zhvillua në Rabat, Marok, me 8-10 nëntor 2007, organizuar nga Institucioni i Mediatorit të Marokut, në bashkëpunim me Institucionet e Mediatorit Francez dhe atij Spanjoll. Qëllimi i kësaj konference ishte forcimi i bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të partneritetit që egzistojnë midis institucioneve kombëtare të mediacionit brenda hapësirës Mesdhetare si dhe forcimi i rolit të mediatorëve brenda procesit të promovimit të kulturës së qytetarisë, demokracisë dhe të të drejtave të njeriut.

10. Avokati i Popullit mori pjesë në Kongresin e 5-të të shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve Frankofonë (AOMF) që u zhvillua në Bamako, Mali, më 10-13 dhjetor 2007, me temë: “Mediatori, garant i ekuilibrit midis të drejtave kolektive dhe të drejtave individuale”. Ombudsmanët dhe Mediatorët Frankofonë, rikonfirmuan me unanimitet vullnetin e tyre për të vendosur mediacionin institucional në qendër të mirëqeverisjes dhe të shtetit të së drejtës, që lejon garantimin e ekulibrit ndërmjet të drejtave kolektive dhe të drejtave individuale.

IV. Vizita të Autoriteteve Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri

Më 28 tetor-2 nëntor 2007, erdhi në Shqipëri Komisioneri për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Europës, Z. Thomas Hammarberg, me ftesë të Ministrisë të Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Në axhendën e përpiluar, ishte parashikuar një takim me Avokatin e Popullit që u realizua më 29 tetor 2007.

Gjatë këtij takimi Z. Hammarberg u njoh nga afër me punën e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore demokratike të qytetarëve. Në këtë takim u theksua edhe njëherë domosdoshmëria e bashkëpunimit të mëtejshëm të Zyrës së Avokatit të Popullit me Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Europës.

V. Vizitat e Avokatit të Popullit në zyrat e Ombudsmanëve të vendeve të tjera

1. Më 20-21 nëntor 2007, Avokati i Popullit shkoi për një vizitë të shkurtër pune pranë Zyrës së Avokatit të Popullit të Maqedonisë. Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i eksperiencave lidhur me veprimtarinë e Ombudsmanit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave të dënuar. Avokati i Popullit pati rastin të shihte

kutitë postare të vendosura brenda në burg nga Avokati i Popullit të Maqedonisë, posaçërisht për të mbrojtur të drejtën e konfidencialitetit të të burgosurve që dëshirojnë të ankohen drejt për drejt tek Avokati i Popullit.

VI. Vizita studimore të stafit të zyrës së Avokatit të Popullit

1. Me mbështetje të Agjencisë Austriake për Zhvillim (AAZH), tre anëtarë të stafit të Avokatit të Popullit morën pjesë në trajnimin tre ditor organizuar pranë Zyrës së Ombudsmanit Austriak, në Vienë, më 14-16 mars 2007.

2. Tre anëtarë të stafit të Avokatit të Popullit morën pjesë në trajnimin 5 ditor lidhur me Lirinë e Informimit, sponsorizuar nga USAID dhe organizuar nga projekti FORECAST në Shtetet e Bashkuara të Amerikës., më 28 prill-5 maj 2007.

3. Më 14-18 maj 2007, dy anëtarë të Nënseksionit të Fëmijëve të Institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në programin e trajnimit organizuar posaçërisht pranë Zyrës së Ombudsmanit të Fëmijëve të Greqisë, Athinë.

4. Me ftesë të Ombudsmanit të Fëmijëve të Suedisë, një anëtar i Nënseksionit të Fëmijëve të Institucionit të Avokatit të Popullit mori pjesë në programin e trajnimit mbi të Drejtat e Fëmijëve që u zhvillua në Stockolm, Suedi më 1-19 tetor 2007.

3. Buxheti i Institucionit për vitin 2007

Për të funksionuar me efikasitet një institucion për të drejtat e njeriut siç është Avokati i Popullit që ka për detyrë të promovojë mirëadministrimin, kërkohet jo vetëm mbështetje politike, institucionale e morale, por dhe mbështetje financiare. Prandaj në këtë vështrim ne mendojmë se ka patur një konceptim të drejtë nga Kuvendi dhe Qeveria Shqiptare. Për vitin 2007 buxheti i institucionit ka qenë në shumën 113.972.500 lekë. Ky buxhet ka qenë më i madhi në të gjithë vitet e ekzistencës së institucionit tonë, nga viti 2000. Kjo rritje ka qenë për shkak të investimit të kryer për rikonstruksionin e kryer në zyrat aktuale të institucionit, ku jemi vendosur që në gusht 2006. Për periudhën objekt raportimi buxheti është konsumuar në masën 97% e konkretisht:

Nr.Llog.	Emertimi	Plan leke	Realizim leke	Realiz. %
600	Pagat	48.358.300	45.987.423	95%
601	Sigurim shoqëror	7.049.500	6.012.064	85%
602	Shp operative	17.805.600	17.762.816	100%
605	Kuote anetaresie	300.000	228.825	76%
604	Transferte	459.100	459.100	100%
231	Investime (Rikonstruksion)	39.330.000	39.326.179	100%
231	Supervizor punimesh	395.000	395.000	100%
231	Pajisje zyre	275.000	252.900	92%
	Totali	113.972.500	110.424.307	97%

Fondi për pagat dhe sigurimet shoqërore nuk është realizuar plotësisht për shkak se disa punonjës (gra) të institucionit tonë kanë qenë me leje për barrë lindje.

Përsa i përket shpenzimeve të buxhetit ato janë përdorur kryesisht për rikonstruksionin e godinës ku ndodhet institucioni, i cili për të përfunduar plotësisht

do të kërkojë edhe disa financime në buxhetin e vitit 2008. Ambientet e rinovuara do të paraqesin një institucion modern, mjaft të përshtatshëm për punë për nëpunësit dhe mikpritës për çdo qytetar që do paraqitet për të kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit. Pjesa tjetër e buxhetit është shpenzuar për paga punonjësish, blerje kancelerie, riparime automjesh, blerje karburanti, parkim automjesh, shpenzime për energji elektrike, shpenzime telefoni, shpenzime poste, shërbim telegrafik, abonime gazetash, siguracione automjesh, shërbim interneti etj.

Në lidhje me kuotat e anëtarësisë ne bëjmë pagesën në Institutin Europian të Ombudsmanëve, Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve, Shoqata Ombudsmanëve Frankofonë, Shoqata e Ombudsmanëve në Amerikë (TOA), Shoqata Ombudsmanëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (USOA).

4. Sfidat dhe objektivat e Institucionit për vitin 2008 e në vazhdim

Sfidat dhe objektivat e Avokatit të Popullit janë gjithmonë në përplotësim të sfidave dhe objektive të qeverisjes në vend. Nenshkrimi i Marreveshjes së Stabilizimit Asociimit, ftesa e dëshiruar për t'u futur në NATO, e për me teper anëtarësia e endëruar në Bashkimin Evropian, para se të jete arritje të një apo disa qeverive shqiptare, janë pikësëpari sfida për të gjithë ne si shoqëri dhe si shtet. Kjo do të thote se qytetari shqiptar gjithnjë e më shumë do që të ndihet qytetar evropian, jo vetëm për nga të drejtat, por edhe nga detyrimet. Akoma me shumë qëndron ky problem për strukturat e shtetit. Mjaft të kujtojmë faktin se gjithmone e më shumë qytetarët shqiptarë janë ndërgjegjësuar për të drejtën e tyre për të paditur shtetin e tyre edhe në Gjykatën e Strasburgut. E gjithë kjo do të thote se edhe për Zyren e Avokatit të Popullit objektivat do të duhet të vijne në rritje.

Për të ardhmen, ne do të vazhdojmë t'u kushtojmë vëmendje të veçantë këtyre objektive:

1. Informimi i Parlamentit për problematika specifike edhe nëpërmjet raporteve të veçanta, sikunder janë ato që do të bëjmë për situatën në sistemin penitenciar, njohjen me aktet ndërkombëtare apo për shërbimet publike.
2. Rritja e efikasitetit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, jo thjesht për të zgjidhur ankesat individuale, por për të shënuar përmirësime sistematike në funksionimin e administratës publike.
3. Rritja cilësore e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, duke synuar unifikimin e praktikave me të mira administrative, pjesë e jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut.
4. Angazhimi i stafit të Avokatit të Popullit për të dhënë kontributin e tij në funksion të përgatitjes së ndryshimeve legjislativë, qoftë edhe duke bërë opionencën e ligjeve që trajtojnë në mënyrë specifike të drejtat e njeriut sipas standardeve të *Accui Communautaire*.
5. Përdorimi i mediacionit për zgjidhjet alternative të mosmarreveshjeve, për përfitim të drejtëpërdrejtë të së drejtës së individit, mundësisht për të parandaluar që individit të shkojë në dyert e gjykatës.
6. Angazhimi i Avokatit të Popullit, jo vetëm për zbatimin e vendimeve të formës së prera të Gjykatave shqiptare, por mbi të gjitha funksionimi i tij si mekanizëm nxitës për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut apo të ndihmës së qytetarëve për t'ju drejtuar asaj Gjykate.
7. Ngritja dhe mirëfunksionimi i Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e Torturës, i cili pritet të realizojë një kontroll të përhershëm periodik në mjediset e mbyllura,

- si burgje, dhoma paraburgimi, spitale psikiatrike, porte, aeroporte etj, ku mund të mbahen njerëz që kanë probleme me ligjin.
8. Vemendje e vazhdueshme për ndjekjen e rasteve me vetiniciativë, fokusuar në mbrojtjen e të drejtave që prekin grupe të mëdha njerëzish apo grupet më në nevojë e më të prekshëm, pa perjashtuar rastet individuale te bera publike nga media.
 9. Bashkepunimi me efikas me OJF te linjes, si per mbrojtjen e te drejtave te femijeve, ashtu edhe per Mekanizmin Kombetar Kunder Tortures.
 10. Ndjekja e zbatimit te Rekomandimeve tona lidhur me, perkatesisht, Rregulloren Tip për të drejtën e informimit të publikut me dokumentet zyrtare, si dhe Rregulloren Tip per te drejten e shqyrtimit te ankimeve administrative. Kjo vlen per te gjitha administraten shqiptare, ne te gjitha nivelet.
 11. Vazhdimi i bashkëpunimit me median per rritjen e presionit pozitiv mbi administratën, si kusht i domosdoshem dhe jetik per ekzistencen dhe integritetin e Avokatit te Popullit, me synim ngulitjen e praktikave të mira administrative. Pasurimi i përditshëm i faqes tonë në Internet do të jetë një përparësi, në favor të qytetarëve dhe Mediave.
 12. Zbatimi i Rezolutes se Kuvendit per vazhdimesine e praktikës së ditëve të hapura në mënyrë periodike në zona të ndryshme të vendit, si forme alternative për t'ju afruar sa më shumë shqetësimeve te publikut, sidomos në zonat rurale, ku nuk njihet sa duhet Avokati i Popullit.
 13. Saktësimi nje here e mire i statusit te nënseksionit për mbrojtjen e të drejtave të femijëve, me synimin ose per ta konturuar si Institucion me vete, ose per ta bere me te prekshe dhe me te ndjeshem, nese do te vazhdoje te funksionoj prane Avokatit te Popullit, kundreejt qëndrimit që do mbajë Kuvendi ndaj propozimeve tona.
 14. Vazhdimesia e funksionimit te te dy zyrave rajonale ne Shkoder dhe Korçe, për të realizuar keshtu nje shtrirje organizative gjeografike te Institucionit, në vartësi të faktit nëse Kuvendi do na mbështesë me buxhet shtesë për 6-mujorin e dytë të vitit 2008.
 15. Vazhdimi i bashkepunimit me strukturat qeverisese te shtetit tone per rritjen cilësore të raportimeve pranë organizmave ndërkombëtare, si përmes përditësimit te raporteve të paraqitura nga pala shtetërore, ashtu edhe të njohjes me raportet alternative, të përgatitura nga organizma të shoqërisë civile.
 16. Ruajtja e qëndrueshmërisë teknike permes mirembajtjes se vazhdueshme te sistemit intranet dhe internet, qe funksionojne prane zyres per menaxhimin e rasteve dhe shkembimin e pervojave me zyrat homologe. Eshtë fakt që pajisjet e dhuruara nga qeveria Daneze, pas 8 vjet pune, janë vjetëruar dhe duhen zëvendësuar me të reja.
 17. Sigurimi i financimeve nga partnere nderkombetare, per projekte te veçanta, duke synuar jo vetem nje performance aktive, por edhe specializime specifike per stafin, apo pajisje për strukturat e reja siç është Mekanizmi për parandalimin e Torturës.

Sa më sipër janë njëkohësisht objektiva dhe detyra të përditshme të stafit të Avokatit të Popullit, përvoja e të cilit është investimi dhe garancia më e mirë për përballjen me sfidat dhe mbarëvajtjen e punëve në Institucion. Duke qenë të tilla, këto objektiva janë objekt i verifikimit të përditshëm në punë e sipër, si dhe i pasqyrimit të përditshëm përmes rasteve në media.

K R E U II

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2007

(Rastet sipas fushave përkatëse dhe mënyra e përfundimit të tyre)

Avokati i Popullit, ka synuar të promovojë kulturën e mirëqeverisjes nga organet e administratës publike të të dyja niveleve dhe nga agjensitë e ndryshme që ofrojnë shërbime për qytetarët. Kuptohet që nëpërmjet shqyrtimit të ankesave që i adresohen Institucionit tonë, ofrohet mundësia e rivendosjes së atyre të drejtave që individëve i janë mohuar nga organet e ndryshme të administratës dhe krijohet mundësia që këto të fundit të demostrojnë seriozitetin e tyre në respektimin e të drejtave themelore të njeriut. Shumë nisma janë marrë nga Qeveria për të përmirësuar shërbimin ndaj qytetarëve dhe për të rritur transparencën ndaj tyre. Por, siç do të shihet dhe në raportimet në vijim, Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të ankesave të prezantuara nga ankues të ndryshëm, ka rekomanduar që nismat e marra për mirëqeverisje të bëhen realitet dhe shërbimi ndaj qytetarëve të përmirësohet.

Gjatë vitit 2007, nëpërmjet organizimit të ditëve të hapura, kemi realizuar njohjen e problemeve të individëve të ndryshëm jo vetëm në Tiranë, por në të gjithë vendin. Kemi ndërmarrë më shumë iniciativa për të ndërgjegjësuar administratën lidhur me detyrimet që ajo ka në ushtrim të funksioneve të saj.

Ne kemi nënvizuar dhe ne raportet e mëparshme se, qellimi i Institucionit të Avokatit të Popullit është të luftojë që t'i sigurojë gjithë individëve apo grupeve të individëve që i drejtohen atij, të marrin ndihmën ose këshillat e nevojshme në kohën dhe mënyrën e duhur. Tashmë jemi të bindur se qytetarët nuk do të adresonin përsëri tek ne problemet e tyre, nëse nuk do të kishin besim në zgjidhjen e tyre. Gjatë vitit 2007, ne vazhduam të provojmë se ky besim ekziston. Këtë e provon dhe fluksi i ankesave që ka shqyrtuar Institucioni gjatë vitit të këtij raportimi.

Gjatë periudhës 1 Janar - 31 Dhjetor 2007 janë trajtuar nga Zyra e Avokatit të Popullit **4233** ankesa, kërkesa dhe njoftime (duke përfshirë dhe ato të Zyrës së Pritjes së Popullit, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë). Nga **4233** ankesa, **226** kanë qenë të mbartura nga viti 2006, **2792** janë raste të regjistruara në vitin 2007 dhe **1215** janë raste të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë në Zyrën e Pritjes së Popullit. Ankesa, kërkesa dhe njoftime të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit nga ana e Zyrës sonë kanë qenë **3018** ose 183 më shumë se në vitin 2006. Nga këto, **425** ankesa ose rreth 14 % e tyre kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2008. Gjatë vitit 2007 janë përfunduar së shqyrtuari gjithsej **2567** ankesa, nga të cilat ka rezultuar se **1155** ankesa, ose 45 % e tyre, kanë qënë jashtë juridiksionit dhe kompetencës. Por për këto ankesa është bërë punë efektive, sepse qytetarët janë sqaruar për rrugën që ata duhej të ndiqnin për zgjidhjen e problemit të prezantuar tek ne. **692** ose 27 % e ankesave kanë rezultuar të padrejta, kurse **616** ose 24 % e tyre janë zgjidhur në favor. Në vitin 2006 janë zgjidhur në favor 554 ankesa apo kërkesa, të cilat përbënin 22%. Për 27 ankesa, ose 1 % e ankesave të përfunduara, rekomandimet me shkrim drejtuar organeve përkatëse të administratës për shkelje të konstatuara prej tyre, nga zyra jonë, janë refuzuar. Për **77** raste, ose 3 % të tyre, të paraqitura për shqyrtim pranë nesh, ankuesit kanë hequr dorë gjatë procesit të shqyrtimit. Për ankesat e gjetura të bazuara, për 114

prej tyre janë bërë rekomandime apo propozime përkatëse me shkrim, drejtuar autoriteteve publike me qëllim që të rritet cilësia e administrimit publik dhe të sigurohen standarte mirëqeverisje. Për pjesën tjetër zgjidhjet pozitive janë arritur që në fazën e marrjes së shpjegimeve apo ndërmjetësimit tonë verbal me organet e Administratës Publike, të cilat pas komunikimit me ne, kanë rregulluar gabimin e bërë ose kanë hequr dorë nga qëndrimet refuzuese apo negative që kanë mbajtur me ankuesit. Rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit dhe të pranuar nga organet të cilave ato u janë drejtuar tregojnë për ndërhyrje të argumentuara nga institucioni ynë për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura qytetarëve.

Në këtë Raport Vjetor do të prezantojmë, ashtu si dhe vitet e kaluara, rastet e trajtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit, të ndara sipas Ministrive përkatëse dhe organeve apo enteve të tjera të Administratës Publike Shqiptare në vartësi të tyre, ndaj të cilave janë drejtuar ankesat apo kërkesat, duke shprehur shpesh dhe opinionet tona për fushat përkatëse.

Më poshtë po paraqesim numrin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve të trajtuara në vitin 2007, të ndara për Këshillin e Ministrave dhe sipas Ministrive përkatëse, organeve apo enteve të tjera të administratës publike.

1. Këshilli i Ministrave	37 , nga të cilat
për vetë Qeverinë	25
a. Grupin Mbikqyrës të Firmave Piramidale	2
b. Instituti i Integritimit të ish të Përndjekurve politikë	8
2. Ministria e Drejtësisë	540 , nga të cilat:
për vetë ministrinë	16
a. Për burgjet dhe paraburgimet	98
b. Zyrat e Përmbarimit	154
c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	147
d. Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	125
3. Organet e pushtetit gjyqësor	282
4. Prokuroria	169
5. Ministria e Brendshme	758 nga te cilat:
Organet e policisë	274
Organet e pushtetit vendor	484
a. Komunat	98
b. Bashkite	342
c. Prefekturat	10
d. Qarqet	4
dh. Gjëndja Civile	30
6. Ministria e Mbrojtjes	141
7. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	253 , nga të cilat
Për vetë ministrinë	31
a. Institutin e Sigurimeve Shoqërore	207
b. Shërbimi Social Shtetëror	15

8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	191 , nga të cilat:
Për vetë ministrinë	43
a. Policia ndërtimore	106
b. Ujësjiellës kanalizime	20
c. Albtelekom dhe telefonja mobile	5
ç. Posta Shqiptare	4
d. Enti Kombëtar i Banesave	13
9. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës	98 , nga të cilat:
Për vetë ministrinë	28
KESH	70
10. Ministria e Financave	29
11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës	96
12. Ministria e Shëndetësisë	37
13. Ministria e Punëve të Jashtme	28
14. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	15
15. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	12
16. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	7
17. Ankesa ndaj administratës së Shërbimit Informativ Shtetëror	5
Të tjera	94
TOTALI	2792 ankesa

Siç do të shihet dhe nga pjesët e veçanta të këtij raporti, përveç trajtimit të ankesave të ardhura nga qytetarë të ndryshëm, shoqëri apo shoqata, Avokati i Popullit ka punuar aktivisht duke kryer hetime për probleme të ndryshme me iniciativë “ex officio”, duke takuar përfaqësues të ndryshëm të administratës qendrore dhe vendore dhe duke i bërë të ditur qytetarve të drejtat e tyre. Po kështu gjatë vitit 2007, ka vazhduar zgjidhja në favor të ankuesve të një numri të konsiderueshëm të ankesave, (616 ankesa), nëpërmjet ndërhyrjes së Avokatit të Popullit tek organet e administratës publike të të dyja niveleve.

2. Opinione të përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri

Të drejtat e njeriut kanë të bëjnë kryesisht me marrëdhëniet midis individëve dhe shtetit. Ato rregullojnë ushtrimin e fuqisë së shtetit mbi individin, garantojnë liri për individët në marrëdhënie me shtetin dhe i kërkojnë këtij të fundit të plotësojë nevojat bazë të njerzve, brenda juridiksionit të tij. Këto janë të kuptueshme më së miri dhe të shprehura në tekste ndërkombëtare (instrumentat), për të cilat shtetet kanë rënë

dakort dhe mbi të cilat janë shtrirë standartet e të drejtave të njeriut. Mbi këto principe është shkruar dhe Kushtetuta Shqiptare e vitit 1998, e cila përforcoi garancitë kushtetuese në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Kapitulli kushtetues mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut përfshin gjithë të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat bazohen në standartet më të larta ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Në vendin tonë nocioni i mbrojtjes me transparencë të të drejtave të individëve nga fuqia e abuzimit të shtetit është relativisht i ri. Përmirësimi i mëtejshëm i gjëndjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, varet gjerësisht nga njohja dhe respektimi i shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut.

Duhet thenë se legjislacioni i të drejtave të njeriut në Shqipëri, është modern, si rezultat i bashkimit (shkrirjes) të të gjitha standarteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në Kushtetutë është parashikuar edhe se normat dhe parimet e njohura nga e drejta ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare të njohura prej Shqipërisë janë pjesë përbërse e sistemit ligjor të vendit si dhe këto norma kanë prioritet në krahasim me legjislacionin e vendit. Megjithatë për aplikimin direkt nga gjyqësori dhe administrata publike të standarteve ndërkombëtare për mbrojtjen reale të të drejtave të njeriut në Shqipëri, ka akoma shumë për të bërë.

Duke patur si bazë rekomandimin Nr. (85)13 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës mbi institucionin e Ombudsmanit, ne përfitojmë nga rasti për të dhënë konsiderata të veçanta për çështje të të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit është i vetmi institucion kombëtar me status kushtetues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Por në lidhje me gjendjen e të drejtave dhe lirive të individëve në Shqipëri ne shprehemi jo vetëm në Raportet tona, por edhe në analizat, diskutimet apo rekomandimet, kur kemi shqyrtuar ankesa apo kërkesa të caktuara. Për opinionet që do të prezantojmë më poshtë, nuk jemi bazuar vetëm në ankesat e paraqitura tek Institucioni ynë, por dhe në informacionet e marra nga organizatat jofitimprurëse për fusha të veçanta të së drejtës, nga sondazhet dhe informacionet e publikuara në Mediat shqiptare, si dhe në raportet e organizmave dhe institucioneve prestigjioze që analizojnë gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, siç janë Raportet e Komisionit European, Këshillit të Europës, Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Human Rights, Amnesty International, Freedom House, Komitetet e të drejtave të njeriut pranë organizmave të Kombeve të Bashkuara, Komiteti Shqiptar i Helsinkit etj.

Kështu mund të citoj disa konkluzione nga Raporti vjetor për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri i Departamentit Amerikan të Shtetit për vitin 2007, publikuar më 11 mars 2008 “Qeveria përgjithësisht i respektoi të drejtat e njeriut të qytetarëve të saj. Megjithatë pati probleme në disa fusha, përfshi vrasjet prej gjakmarrjes, abuzim nga forcat e sigurisë ndaj të burgosurve dhe të ndaluarve, kushte të këqia në burgje dhe paraburgim, korrupsion dhe mosndëshkim të policisë, diskriminim kundër grave, fëmijëve dhe pakicave si dhe trafikim të qenieve njerëzore”.

Ne të gjithë e dijmë, por edhe të gjitha Raportet e institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare që na monitorojnë theksojnë se në Republikën e Shqipërisë janë miratuar pothuajse të gjitha ligjet specifike që kanë si objekt respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Por dihet gjithashtu se hartimi i ligjeve të reja nuk është i mjaftueshëm. Aftësia për t'i zbatuar ato mirë është një element po aq thelbësor i garantimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Dihet gjithashtu prej vitesh se në Shqipëri në drejtim të zbatimit me efikasitet të kuadrit ligjor pozitiv vazhdojnë të hasen një sërë problemesh serioze që kërkojnë zgjidhje. Në

këto kushte në jetën e përditshme të përballjes së ankesave të qytetarëve me administratën publike shqiptare ndeshim mjaft fenomene negative, që në thelb janë shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Dihet se e drejta e jetës, si e drejtë themelore e njeriut ka qenë në qendër të Konferencës së pare Kombëtare që Avokati i Popullit organizoi në Dhjetorin e vitit 2001. Synimi i saj ishte inicimi i një strategjie kombëtare të përbashkët nga të gjithë organet shtetërore dhe OJF-të, për masat parandaluese të ngutshme dhe të qëndrueshme, në mbrojtje të së drejtës së jetës dhe në veçanti, ndaj fenomenit të gjakmarrjes. Është pozitive se pas vitit 2004 ka patur një angazhim më serioz ndaj gjakmarrjes dhe faktikisht nga organet e policisë raportohet se fenomeni ka rënie. Pozitive është se Kuvendi ka miratuar Ligjin nr.9389 date 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër Gjakmarrjes”. Gjithashtu në shkurt 2007 u miratuan ndryshime në Kodin Penal për të ndëshkuar penalisht nxitësit e gjakmarrjes. Është punuar për t’u siguruar “arsimin në shtëpitë e tyre” të fëmijëve të ngjuar. Por për fat të keq deri tani, pas rreth 30 muajsh, Këshilli Koordinues nuk është mbledhur asnjë here. Gjithashtu edhe Këshilli i Ministrave nuk ka nxjerrë aktet nënligjore përkatëse në zbatim të këtij ligji. Nga ana jonë këto çështje i janë ringritur Presidentit të Republikës, Kryeministrit si dhe gjithë anëtarëve të Këshillit Koordinues. Veç të tjerave, kjo mangësi bën që të mos dihet me saktësi numri i familjeve në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti të cilësuar “në gjakmarrje”. Në këtë kuadër lind edhe mundësia e manipulimit me shifrat për interesa të caktuara të organizatave jofitimprurëse. Megjithëse që të gjitha institucionet qeveritare e kanë kuptuar se duhet të angazhohen më seriozisht për këtë “plagë” që e bën të papranueshme Shqipërinë në familjen e madhe të Bashkimit Europian, por gjatë vitit 2007 nuk kemi konstatuar ndonjë zhvillim apo iniciativë të rëndësishme qeveritare, veç atyre të organizatave joqeveritare.

E drejta e jetës në Shqipëri, si e drejtë themelore e njeriut, vazhdon të jetë e rrezikuar për sa kohë që armët vazhdojnë të jenë pa kontrollin e duhur në duart e popullsisë civile. Këto armë përditë marrin jetë njerëzish nëpërmjet krimeve brenda familjes, vetvrasjeve, krimeve me dashje apo pakujdesive në administrimin e tyre. Stoqet e mëdha të municioneve dhe ngjarja në fshatin Gërdec më datën 15 mars 2008 ku humbën jetën dhe u plagosën qindra njerëz, tregojnë për një kthim tjetër rreziku për jetën e shtetasve shqiptarë. Ndonëse nga policia ka patur disa rezultate për trafikun e armëve dhe zbatimin e ligjit për armëmbajtësit pa leje është forcuar, numri i armëve pa leje në duart e popullsisë vazhdon të jetë ende i madh. Për t’i dhënë fund kësaj gjendje mendojmë se çarmatimin nuk mund ta presim që ta bëjnë vetëm strukturat e Policisë së Shtetit. Ne vazhdojmë të insistojmë se duhen gjetur zgjidhje të reja që mund të jenë që nga kombinimi i pagesës për çdo armë të dorëzuar deri tek ligjësimi i mbajtjes së armës nga çdo individ i rritur, i përgjegjshëm dhe pa precedentë penale.

Liritë dhe të Drejtat Vetjake si liria e shprehjes, e shtypit, medias e televizionit, liria individuale, paprekshmëria e banesës, liria e fshehtësia e korrespondencës janë të garantuara me ligj. Për to ka patur dhe do të ketë ankesa apo dhe mbrojtje të tyre si nga ana e Avokatit të Popullit ose me anë të proceseve gjyqësore. Por mendimi ynë, ashtu sikundër është thënë dhe më parë, është se këto të drejta dhe liri përgjithësisht respektohen. Janë ndëshkuar shkaktarët, kur pas proceseve ligjore të rregullta janë vërtetuar shkelje të tyre të kryera nga autoritete publike, apo nga individë të veçantë që ju kanë cënuar këto të drejta, në rastet që janë ankuar tek Avokati i Popullit apo në organet gjyqësore.

Për lirinë e shtypit, medias e televizionit, duhet thënë se vazhdon të ketë raste kur kjo liri është shkelur. Por mediat tona duket se po ndërgjegjësohen, sepse më pare

nuk e konsideronin shkelje të jepnin me hollësi të dhënat personale që shkelin të drejtën e privacisë, të rregulluar nga dispozitat e Ligjit nr. 8517, datë 22.07.1999, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Është fakt se për shkak të mungesës së nivelit të duhur arsimor, kulturor e juridik, shpesh herë personat e cënuar nuk kanë ngritur padi apo bërë ankesa, por kjo nuk do të thotë se këto shkelje nuk ekzistojnë. Shumë gazetarë në kushtet e anonimitetit ankohen se mungesa e kontratave të punës shpesh pengon aftësinë e tyre për të raportuar në mënyrë objektive dhe kjo konsiderohet autocensurë. Si rrjedhojë edhe gazetaria investigative nuk është shumë e përdorur, me përjashtim të emisionit Fiks Fare të Tv. Top Channel. Rol të madh parandalues duhet të lozin shoqatat e gazetarëve, nëpërmjet bashkimit në sindikata dhe aftësimin profesional të tyre. Por edhe institucioni ynë duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim, duke vepruar me inisiativë për të ngritur opinionin publik kundër këtyre shkeljeve, në fushën e të drejtës së informimit, mbrojtjes në punë apo shkeljen e të drejtës së privacisë.

Liria e ndërgjegjes dhe e fesë njihen dhe respektohen nga shteti.

Avokati i Popullit nuk ka munguar të trajtojë ankesa që lidhen me respektimin e lirise se shprehjes dhe të besimit privatisht dhe publikisht. Në disa raste ka mundur të arrijë zgjidhje me mirekuptim të këtyre rasteve, të bera keto publike jo si qellim në vetvete, por për të krijuar shembullin pozitiv të trajtimit të tyre konform ligjit dhe në frymën e kartave nderkombetare.

Por shteti shqiptar dhe Administrata Publike etj, nuk duhet të qendrojnë indiferente, por duhet të marrin përgjegjësi dhe të rregullojnë sa më shpejt me ligje fenomene dhe aktivitete fetare që rrezikojnë laicitetin shtetëror dhe harmoninë fetare në Shqipëri. Është pozitive se në fund të viti 2007 Komiteti Shtetëror i Kulteve ka përfunduar projektligjin “Për lirinë e fesë dhe marrëdhëniet e ndërsjellta me shtetin” si dhe tre projekt marrëveshjet “Për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe tre komuniteteve fetare (ortodoks, musliman dhe muslimanëve bektashinj). Ky rregullim ligjor është detyrim që rrjedh nga nenet 10 dhe 24 të Kushtetutës Shqiptare, mangësia e të cilit ka 8 vjet që ngrihet në Raportet vjetore të institucionit të Avokatit të Popullit.

Liritë dhe të Drejtat Politike, si e drejta e zgjedhjeve, e organizimit, e tubimeve dhe manifestimeve paqësore, janë të garantuara me ligj. Të gjitha institucionet publike punojnë që ato të respektohen. Për fat të keq për zgjedhjet vazhdojnë diskutimet dhe dyshimet, mungesa e besimit reciprok, rrjedhur nga proceset elektorale të shkuara. Natyrisht ka dhe do të ketë opinione të ndryshme në këto drejtime, sidomos nga partitë politike. Avokati i Popullit ka zbatuar dhe është mbështetur fort në parimin e paanësisë, për të mos u kompromentuar në pakënaqësitë e natyrshme të partive politike, që gjithmonë shoqërojnë garat elektorale për pushtetin qëndror apo atë vendor. Ashtu siç kanë përmendur Raportet ndërkombëtare për zgjedhjet vendore të 18 shkurtit 2007 konfliktet ndërmjet subjekteve politike çuan në zgjedhje të shtyra, si asnjëherë tjetër më parë. Vonesat në zgjedhjet politike shkaktuan që zgjedhjet të organizohen me dobësi dhe të caktohen rregulla shtesë, sepse mungojnë kartat e identitetit dhe Rregjistri Kombëtar i zgjedhësve. Prandaj vëzhguesit ndërkombëtarë deklaruan se u përmbushën vetëm pjesërisht standartet ndërkombëtare.

Avokati i Popullit është shprehur pozitivisht për masat legislative dhe ato administrative për të zbatuar Rekomandimet e ODIHR-it. Veç krijimit të Regjistrimit të saktë të zgjedhësve dhe pajisjes së shtetasve me karta identiteti për zgjedhjet e ardhshme do të rekomandim që në vend të skuadrave të numërimit të përdoren skanerët elektronikë për të numëruar votat, ashtu siç Universitetet bënë procesin e vlerësimit të studentëve. Kjo zgjidhje veçse zhduk subjektivizmin njerëzor, është edhe

me mjaft përfitim ekonomik për buxhetin e shtetit. Do vazhdojmë të insistojmë që në Kodin Zgjedhor të bëhen amendime për të ndaluar me ligj përfshirjen e fëmijëve në fushatat zgjedhore.

Në lidhje me trafikun e qënieve njerësore nuk duhen mohuar rezultatet pozitive të viteve të fundit që kanë patur të bëjnë sidomos me rritjen e kontrollit të kufijve. Trafikimet e femrave për prostitucion dhe ato të fëmijëve në çdo formë ekzistojnë, por rastet janë pakësuar. Çdo ditë e më tepër njoftohet për vënie para ligjit të cilitdo që ka kryer vepra të tilla, sidomos në vitet e shkuara. Por duhet punuar më mirë nga organet shtetërore për realizimin e detyrimeve të tyre, p.sh. ka rreth dy vjet që Ministria e Brendshme nuk ka përgatitur ndryshimet e ligjit “Për gjendjen civile”. Si rrjedhojë vazhdojnë të mbeten shumë fëmijë në zonat rurale pa rregjistruar. Këta fëmijë dhe ata të komunitetit rom janë kontigjentet më të preferuara nga trafikantët.

Avokati i Popullit gjatë shqyrtimit të ankesave konkrete, sidomos për abuzime me fëmijët ka shqyrtuar nëse janë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga nenshkrimi i konventave nderkombetare apo nga legjislacioni vendas. Në këto raste ndërhyrjet e Avokatit të Popullit kanë qenë frutdhënëse, jo vetëm sepse janë vënë në levizje strukturat e përmbarimit, të policisë ato të shkollës apo të ndihmës sociale, por se duke ju bërë këtyre rasteve edhe publiciteti i nevojshëm, është krijuar precedenti pozitiv, janë hartuar Rekomandime për shumë struktura shtetërore, për t’i sensibilizuar që të kontrollojnë e t’u kërkojnë llogari organeve të tyre vartëse, për të vlerësuar në radhë të parë interesin e fëmijëve.

Në bashkëpunim me “Save the Children”, qysh në vitin 2004 në zyrën tonë ka filluar funksionimi i një nënseksioni që merret në mënyrë specifike me problemet e fëmijëve në Shqipëri. Projekti tashmë është në përfundim. Synimi ka qenë dhe është që edhe në Shqipëri të krijohet një autoritet i fortë shtetëror, i cili jo vetëm që do të nxitë autoritetet dhe organet shtetërore më tepër kujdes për zhvillimin e fëmijëve, por do të jetë edhe një organ specifik si mbrojtës i të drejtave të fëmijëve. Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2008 do të paraqesim një Raport të veçantë në Kuvendin e Shqipërisë, ku do të dalim me rekomandime konkrete për këtë çështje. Por për këtë kuptohet që duhet vullnet politik, angazhim financiar si dhe ndryshimet e duhura në legjislacion, kushte të cilat kërkojnë disa kohë që të plotësohen.

Është pozitive se po miratohen ligjet e posaçme për të drejtat e fëmijëve, si krijimi i një sistemi gjyqësor të veçantë. Por për minorenët, duhet të bëhet sa më parë krijimi i qendrës për edukimin e atyre minorenëve që nuk kanë arritur moshën për përgjegjësi penale, por mundësisht edhe një burg të veçantë për ta.

Në lidhje me të drejtat e grave, konstatohet që vitet e fundit ka rënie të trafikut të femrave në mënyrë të ndjeshme. Kjo ka ardhur edhe si rrjedhojë e fushatave ndërgjegjësuese të ndërmarra nga OJF-të e ndryshme në media, shkolla, universitete etj. Por kryesore ka qenë ndjekja dhe zbatimi me rreptësi i ligjit ndaj trafikantëve, miratimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve të posaçme për mbrojtjen e viktimave të trafikut, si dhe monitorimin e këtij procesi nga organizmat që janë krijuar enkas nga strukturat qeveritare. Por çështjet që kanë të bëjnë me keqtrajtimin bashkëshortor apo dhunën në familje ndaj grave, fëmijëve apo vajzave janë të shumta dhe problemi vazhdon të mbetet serioz. Situata duket që përmirësohet ngadalë. Puna parandaluese që bëhet nga organizatat joqeveritare po shoqërohet edhe me miratimin e ligjeve përkatëse për dhunën në familje, por edhe me kujdesin për të hetuar dhe gjykuar me rreptësi çdo shfaqje dhune që ka përbërë vepër penale.

Organizmat nderkombëtare rekomandojnë në vazhdimësi që shteti shqiptar duhet të ndërmarrë hapa të shpejta për ndryshimin e sjelljes së publikut ndaj pjesëmarrjes së gruas në çështjet publike, si dhe të marrë në konsideratë miratimin e

një politike pozitive veprimi në këtë drejtim. Vlen për t'u përshëndetur angazhimi politik për të përfshirë jo më pak se 30% të grave në legjislativin shqiptar, i cili ka qenë edhe një rekomandim i institucionit të Avokatit të Popullit. Ndryshimi i pritshëm i sistemit elektoral besojmë se do t'i japë më tepër hapësirë pjesëmarrjes së grave në jetën publike dhe do rriste nivelin e tyre të përfaqësimit në organet e zgjedhura të pushtetit qendror dhe vendor. Duhet të ketë më shumë mjete efektive për të ndikuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave, për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Shteti duhet të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar pjesëmarrjen efikase të gruas në jetën politike, publike si dhe në sektorë të tjerë të shtetit. Prandaj vlerësohet mjaft pozitivisht ngritja e një institucioni të veçantë të quajtur Komisionari për Barazinë Gjinore, sipas projektligjit përkatës që ndodhet për miratim në Parlament.

Në Shqipëri vazhdon të jetë problematike situata në lidhje me zbatimin e rregullave për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit në punë, sidomos në sektorët e ndërtimit, metalurgji dhe miniera. Mungojnë shpesh pagesat e siguracioneve për paaftësi të përkohshme për aksidente apo sëmundje ose për pensione, edhe sepse punëtorët punojnë në të zezë. Kushtet në vendet e punës, sidomos kur ato janë të punëdhënësve privatë janë të këqia dhe në disa raste të rrezikshme për jetën. Me të drejtë autoritetet publike dhe Mediat shqiptare herë pas here ngrenë alarmin se “në Shqipëri humbjet njerëzore nga mungesat në kushtet e punës dhe siguria në qarkullimin rrugor janë më të mëdha se ato në raste luftrash apo fatkeqësish natyrore”. Edhe shpërthimi i municioneve në fshatin Gërdec më datën 15 mars 2008 vërteton plotësisht këtë konstatim. Duhet të ndryshojnë metodat e punës së inspektoriateve që shteti ka krijuar për këto fusha sepse jeta e çdo shtetasi shqiptar duhet vlerësuar njëllëj si jeta e çdo qytetari tjetër evropian. Justifikimi i kreut të Inspektoriatit të Punës se “deri tani kemi toleruar shkeljet e rregullave të sigurisë në punë pasi Qeveria ka dashur të mbështesë biznesin”, janë të dëmshme dhe të dënueshme.

Trajtimi i të ndaluarve dhe të paraburgosurve në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, apo të të dënuarve në burgje, megjithë përmirësimet nga viti në vit, vazhdon të ketë probleme dhe ankesa. Edhe trajtimi i të sëmurëve mendorë në spitalet tona psikiatrike vazhdon të jetë problem shqetësues. Inspektimet e kryera nga Avokati i Popullit gjatë vitit 2006 e 2007 në të gjitha institucionet e shëndetit mendor kanë konstatuar se spitalet kishin mungesa stafi, barnash dhe pajisjesh mjekësore, kushte të papranueshme higjieno sanitare dhe mungesa në pajisje për jetesë normale. Për të bërë rregullimin e gjendjes në standarte të pranueshme ne kemi rekomanduar ndryshime dhe përmirësime të legjislativimit si dhe të infrastrukturës së sistemit të kujdesit për shëndetin mendor në Shqipëri.

Qeveria Shqiptare duhet t'i kërkojë më tepër llogari institucioneve vartëse të drejtësisë, policisë e mjekësisë që të punojnë më seriozisht për zbatimin e vendimeve të saj, për t'i ndarë përgjegjësitë për këta persona. Mund të themi se Qeveria e ka bërë më mire këtë detyrë dhe angazhim të saj, sepse pas disa vitesh zvarritje, në korrik 2007 përfundoi kalimi i dhomave të paraburgimit në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë. Avokati i Popullit ka theksuar vazhdimisht se problemi i mbipopullimit të burgjeve në vendin tone nuk mund të zgjidhet vetëm duke ndërtuar burgje të reja. Mënyra më efikase për të ulur nivelin e lartë të mbipopullimit në burgje është aplikimi i dënimeve të tjera alternative, veç llojit të burgimit apo arrestit me burgim. Prokurorët dhe gjyqtarët ngurojnë t'i zbatojnë dënimet alternative nga frika se mos i akuzojnë se “tregohen të butë ndaj kriminalitetit” apo se “mos i akuzojnë për korrupsion”.

Institucioni i Avokatit të Popullit është i ndërgjegjshëm se ndonëse ka përmirësime në trajtimin e të ndaluarve dhe të të paraburgosurve në dhomat e izolimit

pranë komisariateve të policisë, apo nëpër burgje ka patur mjaft ankesa dhe kërkesa për të cilat kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Brendshme.

Ne kemi bërë hetimet përkatëse për rastet arbitrare të arrestimit dhe ndalimit, përdorimin e dhunës nga oficerët e policisë, keqtrajtimin e të ndaluarve në dhomat e paraburgimit si dhe përdorimin e dhunës për të detyruar të ndaluarit të pranojnë fajin. Gjithashtu ne kemi rekomanduar gjithmonë masa të rrepta për eliminimin e të gjitha rasteve të keqtrajtimeve nga punonjësit e policisë, ashtu siç kemi parashtruar në pjesët përkatëse të këtij Raporti.

Edhe për prokurorinë dhe gjykatat vazhdohet të ketë një numër të madh ankesash tek Avokati i Popullit, sidomos të vonesës së paarsyeshme (zvarritjeve) të çështjeve gjyqësore, duke kërkuar që të paraburgosurit e padënuar të dalin para gjyqit sa më shpejt që të jetë e mundur. Duke patur këtë situatë edhe ne kemi rekomanduar vazhdimisht se duhet vazhduar puna për përmirësimin dhe hartimin e ligjeve të reja për luftën kundër korrupsionit brenda sistemit gjyqësor; zbatimin pa kushte të vendimeve gjyqësore; për përjasjen e legjislacionit vendas me marrëveshjet ndërkombëtare, përmirësimin e marrëdhënieve konkrete të punës së përditshme midis prokurorisë, policisë gjyqësore dhe gjykatave kundër krimit të organizuar etj.

Për të siguruar më mire të drejtën e jetës dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, edhe në kuadrin e Reformës në Drejtësi përsëritim propozimin që të bëhet edhe përgatitja e një ligji për Investigatorin privat dhe për pjesëmarrjen e Avokatit të personit të dëmtuar (viktimit) qysh në fazën e hetimit, siç e kanë edhe shumë vende të tjera të botës së qytetëruar. Njohja e këtyre dy funksioneve me të drejta dhe detyrime procedurale në procesin penal do të rritë forcën zbuluese ndaj krimeve, do parandalonin vonesat në hetime dhe gjykime, sidomos do të parandalonin korrupsionin në prokuroritë dhe gjykatat tona. Procesi i trajnimit dhe testimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet vazhduar, por me kritere e kontroll të rreptë për aftësitë e tyre profesionale. Gjithashtu atyre u duhen siguruar kushte më të mira jetese dhe për sigurinë e jetës së tyre. Prandaj vlerësojmë se ligji i ri i miratuar kohët e fundit, në kuadër të Reformës në Drejtësi është një përpjekje serioze në këtë fushë që besojmë se do ta rritë efektivitetin e drejtësisë shqiptare.

Vazhdon të jetë problem mospërkthimi dhe mosbotimi në Fletoren Zyrtare i Konventave dhe akteve ndërkombëtare të ratifikuara. Rreth 75 prej tyre janë të papërkthyer e të pabotuara zyrtarisht për shkak se Ministria e Drejtësisë nuk po arrin të kryejë këtë detyrë të saj funksionale, megjithë rekomandimet e herëpashershme të Avokatit të Popullit. Kjo situatë sjell dëme të mëdha, sepse këto tekste akoma nuk janë në përdorim të të gjitha institucioneve zyrtare të interesuara dhe në veçanti të gjykatave shqiptare, duke dëmtuar si shtetin, ashtu edhe qytetarët.

Pra, si mund të zbatohen këto tekste, në qoftë se ato fizikisht nuk ndodhen në dispozicion të organeve që duhet t'i zbatojnë ato? Edhe Rekomandimi REC (2002) 13 i Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare të Këshillit të Europës, miratuar më 18 dhjetor 2002 u kërkon shteteve anëtare që “të garantojnë që teksti i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut është përkthyer dhe i është shpërndarë autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave, dhe se për zhvillimet në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut ka akses të mjaftueshëm në gjuhën e vendit”.

Në përfundim të kësaj paraqitje theksojmë se është e qartë për të gjithë, që përgjegjëse për gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në çdo vend janë Parlamenti dhe Qeveritë që dalin prej tij. Në këtë kuadër secili duhet të bëjë punën e tij. Institucioni i Avokatit të Popullit e ka të qartë rolin dhe ka bërë dhe do të vazhdojë të bëjë me rigorozitet vetëm detyrën e tij për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive

themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Për këtë ne kemi vlerësuar dhe vlerësojmë mbështetjen që na ka dhënë dhe vazhdon të na japë Kuvendi i Shqipërisë.

3. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë

Gjatë gjithë periudhës 8-vjeçare të ngritjes dhe funksionimit të institucionit të Avokatit të Popullit (2000-2007) nuk ka asnjë dyshim se roli i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ka qënë mjaft pozitiv në vazhdimësi. Edhe gjatë vitit 2007, ashtu si në shtatë vitet e mëparshme, Avokati i Popullit ka vazhduar të informojë here pas here me shkrim si Kryesinë e Kuvendit, ashtu edhe komisionet e përhershme parlamentare. Gjithashtu kemi bashkëpunuar edhe me grupe deputetësh për çështje të veçanta, si dhe kemi dhënë mendime për projektligje të veçanta, kur na është kërkuar mendimi. Një vend të veçantë kanë zënë sidomos rekomandimet tona, me synim që deputetët të informohen për shkallën e respektimit të të drejtave të njeriut nga organet, autoritetet dhe institucionet e ndryshme politike, por edhe për nxitjen e nismave legjislative direkt nga vetë deputetët.

Sipas Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë të datës 19 mars 2007 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2006”, Kuvendi kërkoi që për vitin 2007 t’u kushtohet vëmendje e veçantë këtyre objektivave:

- rikonfirmimit të bashkëpunimit me Kuvendin për informimin për shkallën e respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe për nxitjen e nismave ligjvënëse;
- mbrojtjes së të drejtave të njeriut, nëpërmjet ndjekjes së rasteve me vetiniciativë për grupe të mëdha njerëzish, shtresa në nevojë, pa përjashtuar raste individuale tipike;
- forcimit e bashkëpunimit me shoqërinë civile, OJF-të dhe median, për të ushtruar një presion pozitiv mbi administratën, me synim rrënjosjen e praktikave të mira administrative;
- vazhdimin të organizimit të praktikës frytdhënëse të “ditëve të hapura” për t’iu afruar sa më shumë publikut dhe për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit të tij;
- ruajtjes së marrëdhënieve të mira të bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë;
- denoncimit në vijimësi të shkeljeve të të drejtave të shtetasve nga zyrtarët përgjegjës të administratës shtetërore.

Nga Raporti që paraqesim dhe nga shifrat përkatëse për veprimtarinë konkrete mund të nxjerrim konkluzionin paraprak se në tërësi është punuar mire për realizimin e objektivave që ka caktuar Kuvendi i Shqipërisë.

A. Në të gjitha Raportet tona vjetore, të paraqitura në Kuvendin e Shqipërisë që nga viti 2001 e në vazhdim ne kemi rekomanduar Qeverinë shqiptare që të marrin masa për të zbatuar disa detyrime që kanë rrjedhur nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Një nga këto detyrime kushtetuese që akoma ka mbetur pa u plotësuar është ai që përcakton neni 10 i Kushtetutës për lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare dhe që më pas këto marrëveshje të ratifikohen nga Kuvendi. Edhe në këtë Raport, institucioni i Avokatit të Popullit informon dhe rekomandon që këto marrëveshje, të cilat në formë projekti janë depozituar në Këshillin e Ministrave, të firmosen sa më shpejt. Zvarritja e mëtejshme e plotësimit të këtij detyrimi që rrjedh nga Kushtetuta jo vetëm përbën një mosplotësim të angazhimeve që kanë patur të gjitha Qeveritë Shqiptare pas vitit 1998, por është edhe një premise më tepër për të justifikuar apo legalizuar çdo shfaqje të praktikave të ekzagjeruara në disa raste, ose të

mungesës së tolerances fetare, gjë që përbën një nga themelet e shoqërisë dhe shtetit shqitar.

B. Gjatë vitit 2007 i kemi nisur direkt Kuvendit të Shqipërisë (Komisioneve të Përhershme Parlamentare) dy Rekomandime për përmirësimin e ligjeve me qëllim që deputetët të marrin nisma legislative:

1. Rekomandimi për përgatitjen, diskutimin dhe propozimin e një projektligji për ndryshimin e ligjit Nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjëndjen civile”.

Në këtë Rekomandim thuhet se: “nga komunikimi me punonjësit e Zyrave të Gjëndjes Civile dhe me drejtuesit e pushtetit vendor në njësitë administrative të vendit jemi informuar se mosregjistrimi i fëmijëve në regjistrat e Gjëndjes Civile është kthyer një problem shqetësues. Gjithashtu, prej tyre jemi informuar se në shume raste, regjistrimi i lindjeve nuk bëhet brenda afatit të përcaktuar ligjor (*45 ditë nga data e lindjes*). Sipas pikës 5 të nenit 34 ligjit Nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjëndjen civile”, të ndryshuar, me kalimin e këtij afati kohor, kërkohet realizimi i një procesi gjyqësor për konfirmimin e lindjes si dhe pagesa e një gjobe prej 2.000 lekësh (të reja). Pra këto familje, përveç gjobës jo të vogël, duhet të përballojnë edhe shpenzimet e avokatit, që në rastin më të mirë, janë rreth 30.000 lekë (të reja) për këtë shërbim. Një praktikë e tillë, e cila kërkon kohë dhe shpenzime financiare frenon regjistrimin e fëmijëve. Kjo ka bërë që edhe numri i fëmijëve të peregjistruar, sidomos nga shtresat e varfëra të popullsisë, të njohë ndër vite vetëm rritje. Dukuria e mosregjistrimit shfaqet në të njëjtën mënyrë edhe në rastin e vdekjeve.

Dukuritë e sipërpërmëndura të mosregjistrimit të lindjeve të fëmijëve dhe të vdekjeve janë të përhapura në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë, por më shumë ato dominojnë në minoritetin Rom dhe në familjet e shpërngulura në Tiranë gjatë 15 viteve të fundit. Në rastin e të shpërngulurve, si shkak kryesor i mosregjistrimit në afat është fakti se, duke qënë se këto familje vazhdojnë të jenë të regjistruara në zyrat e gjëndjes civile të vëndbanimeve të mëparshme, prindërve të të lindurve apo familjareve të të vdekurve u duhet të shkojnë pikërisht në ato zyra për të bërë raportimin e lindjeve apo të vdekjeve. Kjo gjë kërkon shpenzime udhëtimi dhe harxhim kohe. Pra, në shumicën e rasteve, mosregjistrimi në këtë pjesë të popullsisë, ka ardhur si rezultat i mostransferimit të dokumentave të gjëndjes civile në zyrat e gjëndjes civile të vëndbanimit të ri.

Avokati i Popullit ka konstatuar se kërkesat e ligjit ekzistues të gjëndjes civile përbëjnë një pengesë të pakapërcyeshme për familjet e shtresave të varfëra dhe të paarsimuara, për regjistrimin e fëmijëve të tyre.

Theksojmë se shteti ka detyrime ligjore për regjistrimin e tyre. Në bazë të Nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, ku shteti ynë është palë që në vitin 1992 thuhet:

“Fëmijët duhet të regjistrohen menjëherë paslindjes

Shtetet Palë duhet të sigurojnë zbatimin e kësaj të drejte në përputhje me legjislacionin e tyre dhe detyrimet ligjore ndërkombëtare përkatëse...”

Mosregjistrimi i këtyre fëmijëve është me pasoja shumë të rënda për të tashmen dhe të ardhmen e tyre, duke ju mohuar çdo mundësi për akses në jetën normale, për shkak të mungesës së një dokumenti identifikimi (çertifikate apo pasaporte). Si rrjedhojë, ata nuk mund të përfitojnë nga shërbimet shtetërore që ju ofrohen, nuk mund të pajisen me pasaporte për të lëvizur lirisht jashtë shtetit, nuk mund të regjistrohen në shkollë, nuk mund të futen në punë, nuk mund të votojnë kur bëhen madhorë, pra atyre ju cënohen shumë të drejta njerëzore. Duke qënë të

paregjistruar, ata janë kontigjenti i parë për trafikim të qënieve njerëzore, i cili është një problem social i shoqërisë. Nevoja për t'u pajisur me dokumenta nga kjo kategori qytetarësh, nxit falsifikimet dhe krimin e trafikut njerëzor.

Nga ana tjetër, krijimi i mundësisë së raportimit të lindjes apo të vdekjes, jo vetëm në zyrën e gjëndjes civile ku është regjistruar familja, por edhe në zyrën e gjëndjes civile në teritorin e të cilës ka ndodhur lindja apo vdekja, lehtëson procesin e regjistrimit të lindjeve dhe të vdekjeve, duke krijuar lehtësira për familjet që nuk e kanë realizuar ende transferimin e dokumentave të gjëndjes civile, në momentin kur ju lind një fëmijë apo kur ju vdes nje familjar.

Përderisa ligji lejon regjistrimin e martesave në çdo zyrë të gjëndjes civile, atëhere duhet të shtohen mundësitë edhe për raportimin e lindjeve dhe vdekjeve në çdo zyrë të gjëndjes civile, sepse mosregjistrimi i tyre është me pasoja jo vetëm për qytetarët, por edhe për vetë shtetin.

Theksojmë se duhet marrë në konsideratë edhe rekomandimi i Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve pranë Kombeve të Bashkuara, i cili në Konkluzionet përfundimtare rekomandon Shtetin Shqiptar që të marrë masa për promovimin e regjistrimit të fëmijëve, duke përfshirë edhe lehtësimin e procedurave për regjistrimet e vonuara kur është e nevojshme dhe duhet t'i kushtojë vëmendje në veçanti grupeve më të prekura.

Për të eliminuar këtë dukuri anormale dhe për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare këtij shqetësimi, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Brendshme qysh më datën 12.07.2006:

1. Përgatitjen e projektligjit për të ndryshuar e përmirësuar ligjin Nr. 8950, datë 10.10.2002 "Për gjëndjen civile", të ndryshuar. Më konkretisht:

a) Duke hequr procedurën gjyqësore të konfirmimit të lindjes dhe të vdekjes dhe zëvendësimin e saj me verifikimin administrativ.

b) Krijimin e mundësive të regjistrimit të lindjeve dhe vdekjeve jo vetëm në zyrën e gjëndjes civile ku është regjistruar familja, por edhe në zyrën e gjëndjes civile në teritorin e të cilës ka ndodhur lindja apo vdekja.

c) Uljen e masës së gjobës nga 2000 lekë në 1000 lekë, për mosregjistrimin në kohë të lindjeve.

Deri tani kemi marrë një informacion nga Ministria e Brendshme se po përgatiten disa ndryshime të këtij ligji, ku do parashikohet zgjidhja edhe e këtij problemi. Gjithashtu ja kemi propozuar këtë projektligj edhe komisioneve të përhershme parlamentare, por nga ndonjë grup deputetësh nuk është ndërmarrë nisma legjislative.

2. Rekomandimi për një ndryshim dhe shtesë në Ligjin Nr.8661, datë 18.9.2000 "Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit".

Në këtë Rekomandim thuhet se "në Institucionin tonë janë bërë disa ankesa nga ish punonjës të Policisë së Shtetit të përjashtuar me motivacionin "për braktisje të detyrës" ose "që janë dënuar me burg nga gjykata". Ata ankohen për mospërfitim nga Ligji Nr. 8661, datë 18.9.2000 "Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit".

Ankuesit pretendojnë se megjithëse i plotësojnë kriteret e përcaktuara si *vjetërsinë e shërbimit dhe moshën*, nuk e përfitojnë të drejtën si të ardhur suplementare. Shkak për mospërfitim e saj është bërë një dispozitë e këtij ligji dhe konkretisht neni 21, paragrafi i parë, i cili parashikon se: "Të ardhurat suplementare, të përcaktuara në këtë ligj, nuk i përfitojnë punonjësit që janë përjashtuar nga policia për braktisje të detyrës ose që janë dënuar me burg nga gjykata, me vendim të formës së prerë".

Nga ballafaqimi i kësaj dispozite me Kushtetutën tonë dhe me aktet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të ratifikuara nga shteti ynë, konstatojmë se paragrafi i parë i nenit 21 të Ligjit Nr. 8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, nuk është në përputhje me to dhe konkretisht:

1. Ai vjen në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin përcaktohet se: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit”*. Rezulton që kolegët e policëve të liruar apo të përjashtuar nga Policia e Shtetit për motivacione të ndryshme, si thyerje të rëndë të disiplinës, shkelje të betimit etj e përfitojnë këtë të drejtë përveç ankuesve të liruar me motivacionit për braktisje të detyrës ose që janë dënuar me burg nga gjykata me vendim të formës së prerë, ndonëse kanë paguar kontribut shtesë njëloj sikurse ata. Sqarojmë se përfitimi nga ky ligj është rrjedhojë edhe e pagesës së kontributit shtesë të punonjësve të policisë gjatë kohës që kanë qënë në detyrë. Kjo përcaktohet në nenin 3 të tij, ku thuhet se: *“Punonjësit e Policisë së Shtetit paguajnë kontribut shtesë, mbi atë të përcaktuar në ligjin Nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" në masën 1 për qind të pagës referuese. Për funksionet në rolin madhor, masa e këtij kontributi është 2 për qind..”*.

Pra, përderisa ankuesit kanë punuar në të njëjtat kushte dhe kanë paguar nga paga e tyre të njëjtën masë kontributi sikurse kolegët e tyre, për rrjedhojë edhe këta duhet të përfitojnë të ardhurat suplementare që rrjedhin nga ky ligj, pavarësisht nga motivacioni i përjashtimit të tyre nga Policia. Vetëm kështu mund të zbatohet drejt dhe pa dallim parimi kushtetues i barazisë së të gjithëve para ligjit.

2. Ai vjen në kundërshtim me nenin 7, gërma “a”, të “Paktit ndërkombëtar lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore”, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën e saj 2200 A të 16 dhjetorit 1966, në të cilën përcaktohet se: *“Shtetet palë në këtë Pakt njohin të drejtën që ka çdo person për të gëzuar kushte pune të drejta e të favorshme, të cilat të sigurojnë në mënyrë të veçantë: ... Një pagë të drejtë dhe një shpërblim të barabartë për një punë të barabartë, pa kurrfarë dallimi,..”*.

Në fakt të ardhurat suplementare të përcaktuara në këtë ligj, ku përfshihet edhe pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi, janë një lloj shpërblimi për punonjësit e policisë për shkak të natyrës së punës së tyre dhe vështirësive të detyrave që ata kryejnë. Mirëpo, duke ia mohuar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi një pjesë të punonjësve të policisë për shkak të motivacionit të përjashtimit të tyre, shkelet hapur e drejta e garantuar nga Pakti i cituar më sipër, *shpërblim të barabartë për një punë të barabartë*.

3. Ai vjen në kundërshtim edhe me nenin 1 të “Deklaratës universale të të drejtave të njeriut”, miratuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 217 A, të 10 dhjetorit 1948, në të cilën përcaktohet se: *“Të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikpamja e dinjitetit dhe e të drejtave”*.

4. Kjo pengesë për të mospërfituar nga ligji, në fakt përbën një dënim penal plus për personat që janë dënuar me vendim penal nga gjykata. Kujtojmë se dënimet penale plotësuese janë përcaktuar nga neni 30 i Kodit Penal. Në këtë dispozitë penale nuk parashikohet si lloj dënimi “mospërfitimi i pensionit ose të të ardhurave suplementare si pension”. Këtë e ndalon edhe neni 2 i Kodit tonë Penal që përcakton: *“Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj”*.

5. Gjithashtu, është me rëndësi t’ju bëjmë me dije se një mohim të të njëjtës natyrë të kësaj të drejte ka patur edhe Ligji ne fuqi Nr. 8087, dt. 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ

Shtetëror”, ndryshuar me Ligjin Nr. 8521, dt. 30.07.1999. Mirëpo me rekomandimin e Avokatit të Popullit, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me Ligjin Nr. 8948, dt. 03.10.2002, bëri ndryshimin në nenin 19/1 të ligjit të cituar më sipër, duke hequr shprehjen “për braktisje detyre” dhe shtuar një paragraf i cili i jep fuqi prapavepruese kësaj dispozite. Ky ndryshim ligjor i krijoi mundësinë e përfitimit suplementar të pensionit të parakohshëm edhe kategorisë së ushtarakëve të larguar nga detyra me motivacionin “për braktisje detyre”. Përderisa këtë të drejtë që ne po propozojmë e fitojnë ushtarakët e Forcave të Armatosura, të SHISH-it dhe të ish MRPublik, pjesë përbërëse e të cilës kanë qënë edhe punonjësit e Policisë së Shtetit deri në momentin e zbatimit të Ligjit Nr. 8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, për rrjedhojë atë duhet ta përfitojnë policët edhe me ligjin aktual. Sqarojmë se Ligji Nr. 8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, megjithëse “de jure” ka hyrë në fuqi në vitin 2000, “de facto” ai ka hyrë në fuqi dhe është zbatuar në gjysmën e dytë të vitit 2005, pas kompletimit të tij me disa akte nënligjore. Qëndrimi i kundërt përbën një pabarazi të dukshme, një mohim të padrejtë të një të drejte të fituar më parë dhe një diskriminim të hapur të punonjësve të Policisë së Shtetit në krahasim me kategoritë e tjera punonjësve të cituar më sipër.

Për të bërë të mundur zgjidhjen e këtij problemi, Avokati i Popullit rekomandoi që nëpërmjet një grupi deputetësh të meret inisiativa legjislative për një ndryshim dhe shtesë në Ligjin Nr. 8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit” dhe konkretisht:

1. Të shfuqizohet neni 21 i tij.

2. Në nenin 12 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Punonjësit e Policisë që nuk kanë përfituar nga ky ligj për shkak të nenit 21 të Ligjit Nr. 8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, t’i përfitojnë të ardhurat suplementare nga çasti i lindjes së të drejtës për përfitim”.

Gjithashtu më vonë kemi shtuar që fusha e zbatimit të këtij ligji të përfshijë edhe punonjësit e policisë së burgjeve dhe ata të mbrojtjes nga zjarri.

Më datën 28.01.2008 një grup prej 12 deputetësh e ka mbështetur këtë Rekomandim dhe kanë kërkuar futjen e tij në procedurën parlamentare, duke firmosur kërkesën përkatëse drejtuar Kryetares së Kuvendit, të shoqëruar me relacionin dhe projektligjin përkatës.

C. Gjatë vitit 2007 Kryesia e Kuvendit apo Komisionet e Përhershme Parlamentare janë informuar me shkrim për:

1. Rekomandimin për marrjen e masave për zbatimin e konventave ndërkombëtare, ligjeve dhe akteve nënligjore të njohura nga shteti shqiptar për trajtimin e të burgosurve, për të parandaluar rastet e dhunës ndaj tyre, më datën 25.01.2007.

2. Rekomandimet e Konferencës Kombëtare “Të Drejta dhe Dinjitet të barabartë për Personat me Aftësi të Kufizuara” më datën 29.01.2007.

3. Rekomandimin për zbatimin direkt të nenit 45, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për lejimin e të burgosurve për të votuar në zgjedhjet lokale më 18 shkurt 2007, dërguar më datën 15.02.2007.

4. Informacionin për Rekomandimin për shfuqizimin e dispozitave të Kodit Penal Ushtarak që përmbajnë dënimin me vdekje në zbatim të Protokollit 13 të Konventës Europiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe lirive Themelore dërguar më datën 19.02.2007.

5. Informacionin për Rekomandimin për marrjen e masave të menjëhershme për shkarkimin dhe zhvendosjen e depozitave të amoniakut nga Tekstile sha Berat dhe nxjerrjen e përgjegjësive administrative për neglizhencën e treguar nga nëpunësit përgjegjës, drejtuar Ministrit të Ekonomisë, tregëtisë dhe Energjistikës dhe Ministrit të Mjedisit më datën 06.04.2007.

6. Informacionin për Rekomandimin për zbatimin e ligjit gjatë kryerjes së reformës në strukturat e Policisë së Shtetit në rastet e largimit nga puna të punonjësve të policisë, dërguar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Ministrit të Brendshëm në datën 25.04.2007.

7. Propozimin për emërimin (ngarkimin me detyrë) të institucionit të Avokatit të Popullit si mekanizmi kombëtar për parandalimin e tortures, më datën 06.09.2007.

8. Informacionin për Rekomandimin për përmirësimin e shërbimit të sinjalit televiziv të TVSH-së në disa zona të largëta të vendit dhe eliminimi i dukurive negative që kanë krijuar anomali në terren, dërguar në datën 02.11.2007.

9. Informacionin për rekomandimin për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Këshillit të Komunës Gosë, Kavajë nr.8 dt.18.05.2007, lidhur me zgjedhjen e kryesive dhe kryetarëve të fshatrave të kësaj komune dhe marrja e vendimit dhe të masave të nevojshme për zhvillimin e procesit zgjedhor në përputhje me ligjin, më datën 12.11.2007.

10. Informacionin për Rekomandimin për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të të dënuarve të sëmurë mendorë në Spitalin e Burgut në Tiranë, më datën 05.12.2007.

11. Informacionin për Rekomandimin për përfshirjen e rreth 400 familjeve të zones së Berdeneshit në Sarandë brenda territorit administrativ të një njësie vendore, më datën 06.12.2007.

12. Informacionin për lidhjen në një kohë sa më të shpejtë të marrëveshjeve me bashkësitë fetare në zbatim, të nenit 10 të Kushtetutës, më datën 05.12.2007.

Ç. Gjithashtu Kuvendit të Shqipërisë i janë dërguar mendimet dhe propozimet e institucionit të Avokatit të Popullit për projektligjet e mëposhtëme, për të cilat na është kërkuar mendimi:

1. Për projektligjin “Për Policinë e Shtetit”, më datën 17.01.2007.

2. Për projektligjin “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.7843 datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar”, më datën 21.03.2007.

3. Për projektligjin “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, më datën 19.04.2007.

4. Për projektligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, më datën 04.05.2007.

5. Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8328 datë 02.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, më datën 07.06.2007.

6. Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.7895, date 27.01.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”, më datën 04.06.2007.

Gjithë veprimtaria e mësipërme që tregon për bashkëpunimin e institucionit të Avokatit të Popullit me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë nuk na vetëkënaq. Ne vazhdojmë të kemi përparësi absolute detyrimin që të informojmë gjithnjë e më shumë e më shpesh Kuvendin për gjendjen e ligjshmërisë dhe zbatimit të të drejtave të

njeriut në Shqipëri nga Administrata publike, organet e gjyqësorit dhe prokuroria shqiptare. Gjithashtu, në rastet që nuk do merren parasysh rekomandimet tona nga institucionet e administrates, ne duhet të shfrytëzojmë më tepër mundësinë për të nxitur deputetët që të ndërmarrin ata personalisht inisiativa ligjvënëse, në interes të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve, të cilët si zgjedhës janë ata që u delegojnë pushtetin deputetëve tanë.

4. Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese

I. Siç kemi paraqitur në Raportin për veprimtarinë tone gjatë vitit 2006, më datën 3 tetor 2006, bashkë me Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit paraqitëm një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me objekt:

- Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 1 pika 1; të nenit 4; të nenit 7 pika 2; të nenit 9; të nenit 10 pikat 1, 2 përsa përfshijnë edhe institucionet e pavarura kushtetuese, si dhe të nenit 20 të ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”. Kjo çështje u shqyrtua në datën 20 nëntor 2006.

Me Vendimin nr.19 datë 03.05.2007 Gjykata Kushtetuese e pranoi këtë kërkesë me këtë arsyetim:

“Subjekti i interesuar, Kuvendi, vuri në dyshim, që në fillim, legjitimitimin e Avokatit të Popullit si kërkues në këtë gjykim kushtetues. Sipas tij, legjitimitimi i këtij subjekti mund të bëhet vetëm për çështje që lidhen me interesat që ai përfaqëson, interesa që përcaktohen nga objekti i veprimtarisë së këtij institucioni, të cilat në mënyrë të shprehur përmenden në Kreun e VI të Kushtetutës dhe në ligjin organik që rregullon organizimin dhe funksionimin e Avokatit të Popullit.

Gjykata Kushtetuese çmon se është i pathemeltë pretendimi i mësipërm i subjektit të interesuar, sipas të cilit edhe Avokati i Popullit nuk legjitimohet si kërkues në këtë gjykim kushtetues. Ndryshe nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili, në përputhje me shkronjën “ç” të nenit 134 të Kushtetutës, paraqitet në këtë rast, si kërkues në mbrojtje të interesave të të gjithë organeve kushtetuese, Avokati i Popullit paraqitet si kërkues vetëm për mbrojtjen e interesave të tij në bazë të shkronjës “dh” të pikave 1 dhe 2 të nenit 134. Si interesa të tij janë përcaktuar edhe normat apo rregullat që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni kushtetues, pavarësisht nëse janë vërtetuar ose jo pasojat.

Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kundërshtuan të gjitha pretendimet e kërkuesve dhe të subjekteve të tjera të interesuara, duke theksuar, ndër të tjera, se dispozitat objekt i këtij gjykimi kushtetues, në këndvështrimin juridik-formal, nuk kanë lidhje dhe, për rrjedhojë, ato nuk prekin ligjet organike të organeve kushtetuese. Sipas tyre, përmbajtja e këtyre dispozitave nuk cenon as pavarësinë e këtyre organeve të garantuara nga Kushtetuta dhe ligjet organike përkatëse.

Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e paraqitur duhet të pranohet. Në nenin 7 të Kushtetutës, deklarohet shprehimisht se “*Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor*”. Në këtë dispozitë është sanksionuar një prej elementëve më të qenësishëm të parimit të shtetit të së drejtës, për të cilin bëhet fjalë që në preambulën e Kushtetutës.

Në demokracinë si formë e qeverisjes, parimi i rëndësishëm i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të

pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbar me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Për këtë qëllim, pavarësisht se pushteti shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë, brenda tij ka një sërë ndërthurjesh dhe raportesh të ndërsjella që Kushtetuta krijon ndërmjet segmenteve të caktuara të tij. Pra, në thelb, në bazë të këtij parimi, tri pushtetet qendrore duhet të ushtrohen jo vetëm në mënyrë të pavarur por edhe në mënyrë të balancuar. Kjo gjë arrihet nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që garantojnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm midis pushteteve, pa cenuar dhe pa ndërhyrë në kompetencat e njeri-tjetrit. Pushteti gjyqësor zë një pozicion të veçantë. Ai është i pavarur në dhënien e drejtësisë. Në këtë funksion, gjyqtarët u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Ata duhet të jenë të paanshëm dhe objektivë në gjykimin e çështjeve. Mbi këtë bazë, krijohen raporte të caktuara ndërmjet organeve dhe institucioneve qendrore kushtetuese që përfaqësojnë një nga tre pushtetet kryesore, por duke bërë kujdes që në çdo rast të respektohet pavarësia kushtetuese e secilit prej tyre.

Përveç kësaj, Kushtetuta parashikon edhe krijimin e organeve të tjera qendrore me pozicion neutral ose të ndërmjetëm, vendi dhe roli i të cilëve është mjaft i rëndësishëm në funksionimin e shtetit demokratik si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve. Edhe këto organe të rëndësishme, në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese, gëzojnë pavarësi që garantohet me dispozita të veçanta të Kushtetutës. Ide qendrore mbetet shpërndarja e pushtetit shtetëror në disa organe apo mekanizma qendrore kushtetues, të cilët e ushtrojnë atë në mënyrë të pavarur, por duke krijuar gjithnjë mundësinë që secili prej tyre të kontrollohet në mënyrë reciproke. Një zgjidhje e këtillë është veçanërisht e rëndësishme dhe e domosdoshme në regjimin parlamentar të qeverisjes.

Fryma demokratike e shtjelluar më lart përshkon të gjithë Kushtetutën. Në dispozita të veçanta të saj bëhet fjalë shprehimisht për krijimin e organeve apo institucioneve të veçanta kushtetuese, të cilat kanë kompetenca të gjera dhe të rëndësishme në ushtrimin e pushtetit. Mes tyre përmenden qartësisht edhe kërkuesit dhe subjektet e tjera të interesuara në këtë gjykim kushtetues, të tillë si Kontrolli i Lartë i Shtetit (nenet 162-165), Avokati i Popullit (nenet 60-63), Këshilli i Lartë i Drejtësisë (neni 147), Gjykata e Lartë (nenet 135-137, 139-142 ose 135-146), Prokurori i Përgjithshëm (neni 149) dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (nenet 153-154). Përmes këtyre dispozitave sanksionohet kujdesi për të mbrojtur dhe siguruar sa më mirë pavarësinë e organeve dhe institucioneve kushtetuese, veçanërisht nga ndikimet apo ndërhyrjet e mundshme të politikës ose të ekzekutivit, të cilat mund të cenojnë veprimtarinë e tyre në ushtrimin e funksioneve kushtetuese përkatëse. Duke theksuar pavarësinë e këtyre organeve, është bërë kujdes që Kushtetuta të mos i lejë ata jashtë çdo lloj kontrolli. Ajo vendos raporte të caktuara mes vetë atyre si dhe mes tyre dhe organeve të tjera qendrore të pushtetit shtetëror, veçanërisht me Kuvendin. Këto raporte krijojnë mundësi për ushtrim kontrolli reciprok dhe për balancim të mjaftueshëm të pushtetit, duke u bazuar në kompetencat dhe funksionin kushtetues të secilit prej tyre.

Një nga mjetet më të rëndësishme për mbrojtjen e pavarësisë së organeve apo institucioneve kushtetuese është veçanërisht përcaktimi i saktë i mekanizmave dhe procedurave për zgjedhjen, emërimin dhe sidomos shkarkimin e drejtuesve apo anëtarëve të tyre. Parashikimi, për këtë qëllim, i mekanizmave të tillë si shumica e cilësuar në Kuvend, vendimmarrja e Presidentit të Republikës ose e Gjykatës Kushtetuese, vlerësohet si masë e rëndësishme dhe efektive në funksion të ruajtjes dhe forcimit të kësaj pavarësie.

Përveç argumenteve të mësipërme, në funksion të garantimit të pavarësisë së organeve dhe institucioneve kushtetuese shprehen edhe deklaratimet e neneve 6 dhe 81, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës. Sipas nenit 6, *“Organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse...”*, ndërsa në nenin 81, pika 2, shkronja “a” theksohet, ndër të tjera, se ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta duhet të miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Pra, qëllimisht Kushtetuta urdhëron që në bazë e për zbatim të saj, i gjithë ndërtimi, organizimi dhe funksionimi i secilit organ kushtetues të bëhet me ligj organik të veçantë, i cili duhet të miratohet jo me shumicë të thjeshtë, ashtu siç miratohet çdo ligj i zakonshëm, por me shumicën e cilësuar prej tri të pestave të deputetëve, gjë që kërkon një konsensus më të gjerë politik. Në këtë kuadër, ligjit organik i është dhënë rëndësi e posaçme në fushën e organizmit dhe të funksionimit të hallkave të ndryshme të organizmit shtetëror, sepse ai rregullon marrëdhëniet në një fushë të caktuar, që ligjvënësi nuk mund ta rregullojë me ligj të zakonshëm. Vullneti i kushtetutëbërësit është shprehur mjaft qartë për këtë çështje.

Referimi i drejtpërdrejtë nga Kushtetuta i mënyrës së miratimit të ligjeve organike të institucioneve të sipërpërmendura u jep atyre fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ata renditen pas Kushtetutës dhe para ligjeve të zakonshme të Kuvendit. Mbështetur në këto konsiderime, Gjykata Kushtetuese rithekson se ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ata të mos prekin rregullimet që përfshihen natyrshëm në sferën ekskluzive të ligjeve organike, përndryshe ato do të binin në kundërshtim me nenet 6 dhe 81, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës.

Nga ana tjetër, kjo do të thotë se edhe ndryshimet që mund t’u bëhen këtyre ligjeve ose dispozitave të veçanta të tyre nuk mund të arrihen nëpërmjet një ligji të thjeshtë, por nëpërmjet një ligji që do të kërkonte sërish të paktën tri të pestat e deputetëve. Kjo gjë arsyetohet me faktin e thjeshtë se rendi juridik nuk përbëhet nga norma juridike të barasvlershme apo me të njëjtën fuqi juridike, përkundrazi ai është një sistem i shkallëzuar, ku normat e së drejtës renditen në bazë të fuqisë juridike që kanë. Uniteti i këtij sistemi qëndron në varësinë që ekziston ndërmjet normës “krijuese” dhe normës së “krijuar”.

Gjykata Kushtetuese konsideron të rëndësishme të ritheksojë se ligjet organike zërthejnë më tej dhe konkretizojnë më qartë dhe më mirë pavarësinë e organeve dhe institucioneve kushtetuese që garantojnë sipas rastit dispozita të veçanta të Kushtetutës. Kjo pavarësi nuk është thjesht një privilegj i tyre, por një prerogativë e vërtetë dhe e domosdoshme, e cila u jep më shumë siguri, qëndrueshmëri dhe efikasitet organeve dhe institucioneve kushtetuese në ushtrimin e detyrave të tyre. Nocioni i pavarësisë nuk ka dhe nuk mund të ketë të njëjtën përmbajtje apo kuptim referuar në tërësi të gjithë organeve apo institucioneve kushtetuese. Ai ndryshon në varësi të natyrës së organit, detyrave dhe funksioneve e tij kushtetuese. Megjithatë, marrë në tërësi, duhet vënë në dukje se pavarësia e tyre e garantuar me Kushtetutë dhe me ligjet organike përkatëse, ka si përbërës apo elementë të qenësishëm të saj pavarësinë organizative, pavarësinë funksionale dhe pavarësinë financiare.

Përveç çështjeve që kanë të bëjnë me zgjedhjen, emërimin apo shkarkimin e drejtuesve apo funksionarëve të tjerë të lartë të organeve dhe institucioneve kushtetuese, ndër të tjera, pavarësia organizative gjen shprehje edhe në të drejtën e tyre që të hartojnë e caktojnë vetë, në përputhje me kritere të caktuara, strukturën dhe organikën e tyre, përfshirë këtu edhe të drejtën e caktimit të drejtorëve dhe

këshilltarëve, numrin dhe përbërjen e funksionarëve të kabineteve ndihmëse, emërimin e funksionarëve të niveleve më të ulëta, rekrutimin e personelit në nivele të ndryshme, etj.

Pavarësia funksionale e organeve dhe institucioneve kushtetuese është e lidhur ngushtësisht me përmbajtjen e veprimtarisë që këto realizojnë, e cila rregullohet drejtpërsëdrejti dhe e ka themelin e vet në dispozitat përkatëse kushtetuese. Në përputhje me detyrat që i ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm që i jep atij mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve qendrore, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese.

Pavarësia financiare e organeve ose institucioneve kushtetuese nuk ka dhe nuk mund të ketë të njëjtën natyrë me pavarësinë organizative ose me atë funksionale të tyre. Ky aspekt i pavarësisë varet kryesisht nga mundësitë financiare të vet shtetit, të cilat reflektohen periodikisht në buxhetin vjetor të tij, buxhet që miratohet me ligj të veçantë nga Kuvendi, në bazë të projektit të hartuar nga Këshilli i Ministrave. Në këtë proces mbahen mirë parasysh veçanërisht parimet e unitetit dhe universalitetit të buxhetit si dhe ai i ekonomizmit dhe i kursimit të tij. Po kështu, rol mjaft të rëndësishëm në këtë drejtim luajnë edhe planet për investime publike, politikat ekonomike e sociale, objektivat apo prioritetet e qeverisjes së vendit në periudha të ndryshme të saj, etj.

Mbështetur në sa u trajtua më sipër dhe duke u shprehur në terma të përgjithshëm, pavarësia financiare duhet kuptuar si një financim i tillë i organeve dhe institucioneve kushtetuese, i cili duhet t'u mundësojë atyre të ushtrojnë normalisht veprimtarinë për përmbushjen e funksioneve që Kushtetuta u ka ngarkuar, pa ndërhyrjen ose ndikimin e qeverisë, e politikës apo faktorëve të tjerë të jashtëm me këtë veprimtari, gjë që do të mund të cenonte rëndë ushtrimin e kompetencave tyre. Me fjalë të tjera, pavarësia financiare e këtyre organeve konsiston në të drejtën për të propozuar në Kuvend buxhetin e tyre vjetor, veçanërisht në të drejtën e menaxhimit të pavarur të këtij buxheti në përputhje me ligjin. Megjithëse Buxheti i Shtetit përbën akt politik që merr jetë përmes bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të Këshillit të Ministrave me Kuvendin, përsa u përket shqyrtimit dhe miratimit të zërave buxhetorë të organeve dhe institucioneve kushtetuese, sipas rastit dhe përmes konsultimeve, është e domosdoshme të merren parasysh edhe kërkesat dhe nevojat e tyre për ushtrimin normal të funksioneve kushtetuese për të cilat ata janë krijuar. Nga ana tjetër, dispozitat kushtetuese dhe ligjet organike përkatëse përcaktojnë qartazi se menaxhimi i këtij buxheti në përputhje me ligjin duhet t'u lihet në dorë vetë këtyre organeve. Sigurisht, ato i dinë dhe i vlerësojnë më mirë se kushdo tjetër kërkesat dhe problemet e tyre, nevojat për investime, objektivat që synojnë të arrijnë, etj.

Gjykata Kushtetuese tërheq vëmendjen se të tri elementëve të pavarësisë së organeve dhe institucioneve kushtetuese duhet t'u kushtohet, sipas rastit, vëmendje e posaçme, gjë që diktohet jo vetëm nga dispozitat e Kushtetutës por edhe nga ligjet organike që rregullojnë veprimtarinë e secilit prej tyre.

Kërkuesit dhe disa nga subjektet e interesuara në këtë gjykim kushtetues pretendojnë se dispozitat që kundërshtohen jo vetëm e cenojnë këtë pavarësi, por ato duhen shfuqizuar si jokushtetuese në këndvështrimin formal, sepse janë pjesë e një ligji të zakonshëm, cili ndërhyr dhe ndryshon dispozita të rëndësishme të ligjeve organike që e garantojnë këtë pavarësi.

Gjykata Kushtetuese çmon se Kuvendi, si organi më i lartë përfaqësues dhe mbartës i sovranitetit të popullit është padyshim organi qendror dhe më i rëndësishëm i pushtetit shtetëror. Si i tillë, Kuvendi shfaqet para së gjithash si organ ligjvënës dhe në ushtrimin e këtij funksioni kryesor, ai mbështetet së pari te dispozitat kushtetuese, sepse ligjet që miraton duhet të nxirren në bazë dhe për zbatim të tyre. Në këtë kuptim, ai shfaqet edhe si interpretues i parë i normës kushtetuese. Hapësira e këtij interpretimi varet nga karakteri dhe natyra e dispozitave kushtetuese që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me ligjin që do të miratohet ose me dispozita të veçanta të tij. E rëndësishme është të ruhen, në çdo rast, vlerat dhe parimet themelore të deklarimeve kushtetuese. Brenda kësaj hapësire, Kuvendi ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, të cilat janë përcaktuar si prioritet në programin zgjedhor të shumicës parlamentare. Përveç kësaj, Kuvendi, përmes procesit ligjvënës, ka detyrën dhe përgjegjësinë t'u përgjigjet në mënyrë të vazhdueshme, me realizëm, sa më shpejt dhe sa më drejt edhe prioritetëve apo problemeve të ndryshme të vendit. Në të gjitha rastet, është e rëndësishme të ritheksohet se ligji i ri apo dispozita të veçanta të tij të mos bien ndesh me dispozitat kushtetuese, pasi Kushtetuta qëndron në majë të piramidës së akteve normative që kanë fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ligji që kundërshtohet ka pasur si qëllim kryesor rregullimin e mënyrës së përcaktimit të pagave, shpërblimeve dhe strukturave organike të institucioneve kushtetuese e të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, gjë që deklarohet shprehimisht që në pikën 1 të nenit 1. Përmes vendosjes së një ekuilibri hierarkik mes organeve kushtetuese është synuar të ndërtohet një piramidë e qëndrueshme e pagave buxhetore. Kështu, ndër të tjera, ligji vendos, përmes koeficientëve, raporte të caktuara ndërmjet pagave të titullarëve të organeve dhe institucioneve kushtetuese me pagën e Presidentit të Republikës, e cila qëndron në majën e piramidës së pagave dhe përcaktohet çdo vit në ligjin për Buxhetin e Shtetit, sipas propozimit që bën Këshilli i Ministrave.

Pa hyrë në vlerësimin e hollësishëm të qëllimit të ligjit, Gjykata Kushtetuese çmon se mjetet e përdorura për arritjen e këtij qëllimi nuk janë kushtetuese. Dispozitat që kundërshtohen prekin mjaft dispozita kushtetuese dhe dispozita të tjera të ligjeve organike, që garantojnë pavarësinë e organeve dhe institucioneve kushtetuese të lartpërmendura. Konkretisht, në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, theksohet, ndër të tjera, se përveç mënyrës së përcaktimit të pagave, ligji rregullon edhe “çështjen e shpërblimeve dhe strukturave organike të institucioneve kushtetuese” (pika 1 e nenit 1), se “kategorizimi i pozicioneve të punës përgjegjës/shef sektori dhe specialist në këto institucione bëhet me vendim të Kuvendit, në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së çdo institucioni, me mbështetjen e Ministrisë së Financës dhe Departamentit të Administratës Publike” (pika 2 e nenit 9), se “struktura dhe organika e institucioneve kushtetuese ... miratohen me vendim të Kuvendit” (pika 1 e nenit 10), dhe se “kabinetet ndihmëse nuk mund të kenë më shumë se dy funksionarë të brendshëm dhe një sekretar ...”. Të gjitha këto çështje përfshihen shprehimisht në objektin e rregullimit të ligjeve organike përkatëse. Siç u theksua më sipër, çështjet e strukturës dhe organikës përbëjnë çështje ekskluzive të organeve dhe institucioneve kushtetuese si shprehje e pavarësisë organizative dhe funksionale të tyre në ushtrimin e detyrave kushtetuese (nenet 10 e 12 të ligjit organik të Kontrollit të Lartë të Shtetit; nenet 31, 32 e 35 të ligjit organik të Avokatit të Popullit; nenet 7, 9, 26 dhe 28 të ligjit organik të Gjykatës së Lartë; nenet 11-17 i ligjit organik të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; nenet 8/c dhe 9/2 të ligjit organik për Prokurorinë, etj).

Në ligj theksohet gjithashtu se “pagat e funksionarëve të lartë shtetërorë të këtyre institucioneve, përcaktohen në raport me pagën e Presidentit të Republikës” (neni 4), se “pagat e funksionarëve të kabineteve ndihmëse ... janë të njëjta me pagat e funksionarëve të kabineteve ndihmëse të ministrave dhe përcaktohen nga Këshilli i Ministrave” (pikat 1 dhe 2 të nenit 7) dhe se “pagat dhe shpërblimet e nëpunësve civilë/nëpunësve të institucioneve kushtetuese ... nga niveli sekretar i përgjithshëm deri në specialist, janë të njëjta me pagat dhe shpërblimet e nëpunësve civilë në ministritë e linjës” (pika 1 e nenit 9). Për këto çështje ka rregullime të posaçme në ligjet organike, të cilat respektojnë, brenda hapësirës kushtetuese, pavarësinë financiare të tyre për këtë qëllim. Në nene të posaçme të ligjeve organike të sipërcituara është përcaktuar si kompetencë e vetë organeve vendosja e strukturave organizative. Struktura administrative përmban në vetvete klasifikimin e nëpunësve civilë sipas punës që ata kryejnë. Ky klasifikim i pozicioneve të punës, që vlen për të gjithë administratën publike, përcaktohet në nenin 11 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për Statusin e Nëpunësit Civil”. Mbi bazën e këtij klasifikimi është ndërtuar në përgjithësi struktura administrative e institucioneve qendrore dhe atyre të pavarura. Ky ligj, në pikën 6 të nenit 11, bën një dallim për institucionet e pavarura, duke parashikuar mundësinë që këto institucione të “bëjnë klasifikime ose të caktojnë nivele të ndryshme brenda secilës klasë në institucionet e pavarura përkatëse”.

Klasifikimi i nëpunësve, përveçse lidhet ngushtësisht me detyrat që do t'i ngarkohen secilit prej nëpunësve të emëruar në pozicionin përkatës, pasi ky është edhe qëllimi i këtij klasifikimi, përmban në vetvete edhe masën e shpërblimit që do të përfitojnë këta nëpunës për detyrën që kryejnë. Është vështirë të ndahet koncepti i shpërblimit nga ai i pozicionit të vendit të punës ose strukturës në administratën publike, pasi një nga parimet në të cilat mbështetet administrata publike është se shërbimi civil përbën një shërbim ose punë që kryhet kundrejt pagës. Për këtë qëllim, ligji “Për statusin e nëpunësit civil” parashikon edhe elementet përbërës të pagës si dhe shtesat përkatëse sipas pozicionit të punës (neni 18 – Struktura e pagës dhe shpërblimit). Siç shihet, struktura ose organika e administratës duhet të kuptohen të lidhura ngushtësisht me elementin “pagë” ose “shpërblim”.

Përsa më sipër, Gjykata Kushtetuese, mbështetur në kuptimin e dispozitave të neneve 6 dhe 81, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës, nxjerr përfundimin se dispozitat që kundërshtohen nga kërkuesit nuk duheshin miratuar me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Kuvendit, por me tri të pestat e tyre, pasi problemet që ato trajtojnë përbëjnë në mënyrë të dukshme objekt rregullimi të ligjeve organike përkatëse të organeve dhe institucioneve kushtetuese...

... Gjykata Kushtetuese vlerëson se në vijim të arsyetimit të mësipërm duhet pranuar kërkesa për shfuqizimin edhe të nenit 20 të ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006. Përmbajtja e këtij neni nuk mund të gjejë më veprim mbi dispozitat që Gjykata Kushtetuese i gjen në kundërshtim me Kushtetutën...”

Megjithëse ky Vendim i Gjykatës Kushtetuese është shprehur qartë se institucionet e pavarura kushtetuese duhet të ruajnë të drejtën e përcaktimit të strukturës së tyre, etj ka qenë dhe vazhdon që të jetë në axhendën e Kuvendit edhe për periudhën 21 janar – 24 mars 2008 si propozim i Qeverisë projekt ligji i dërguar që nga data 20.06.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në disa ligje organike”. Ky projektligj synon të bëjë ndryshime në ligjet organike të institucionit të Avokatit të Popullit, të Kontrollit të Lartë të Shtetit etj, pikërisht në ato drejtime që është shprehur qartë Vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Mendojmë se kjo nuk është rrjedhojë e një gabimi apo “lajthitje teknike”, por tregon ekzistencën e një mentaliteti dhe praktike

nënvleftësuese ndaj vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe tentative për të thyer qëndrimet parimore të ruajtjes së pavarësisë nga institucionet e pavarura kushtetuese.

II. Siç del edhe nga Vendimi i mësipërm, por edhe në çështje të tjera të mëparshme të shqyrtuara nga Gjykata, shpesh është ngritur çështja nëse ka legjitimitet institucioni i Avokatit të Popullit për të kërkuar nga Gjykata Kushtetuese shfuqizimin e ligjeve antikushtetuese? Ky diskutim ka filluar qysh në fillim të veprimtarisë së institucionit tone në vitin 2000 dhe pati marrë një zgjidhje jo të plotë me vendimin nr.49 datë 31.07.2000 të Gjykatës Kushtetuese si dhe me disa vendime të mëvonshme. Për këto zgjidhje të pjesshme është folur edhe në Raportet tona të mëparshme drejtuar Kuvendit. Por tashmë, pas vendimit nr.40 datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese mund të deklarojmë se ky diskutim është mbyllur përfundimisht në favor të legjitimitetit të plotë të institucionit të Avokatit të Popullit.

Vendimi nr.40 datë 16.11.2007 ka dale pas kërkesës sonë të dates 23 shkurt 2007 drejtuar Gjykatës Kushtetuese me objekt: “Shfuqizimi si të papajtueshëm me kushtetutën të fjalës “vendbanim” në pikën 3 të nenit 63 të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 ndryshuar me Ligjin nr. 9297, datë 21.10.2004, dhe ligjet nr.9341, datë 10.01.2005, nr. 9371, datë 14.04.2005 si dhe ligjin nr. 9676 datë 13.01.2007 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Në këtë kërkesë Avokati i Popullit parashtrroi se:

“Në pikën 1 dhe 3 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se:

1. “Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtë të zgjedhë ose të zgjidhet”

3“Të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë, kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur”.

Në pikën 3 të nenit 63 të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 ndryshuar me Ligjin nr. 9297, datë 21.10.2004, dhe ligjet nr.9341, datë 10.01.2005, nr. 9371, datë 14.04.2005 si dhe ligjin nr. 9676 datë 13.01.2007 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” është përcaktuar se:

“Në burgjet dhe në vëndet e paraburgimit, për zgjedhjet dhe referendumet vendore, 40 ditë para datës së votimit, drejtuesi i Institucionit, përgatit listën e zgjedhësve me vendbanim në njësinë zgjedhore, ku ndodhet institucioni dhe ia dorëzon atë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse”.

Nga praktika në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, sipas përcaktimit të bërë në dispozitën e mësipërme, rezulton se pjesa më e madhe e të dënuarve në burgje privohen nga e drejta për të zgjedhur. Kjo për arsyen se Kodi Zgjedhor në listën e zgjedhësve për organet e qeverisjes vendore përfshin vetëm ata të dënuar që kanë vendbanimin në vëndin e institucionit ku vuajnë dënimin (paraburgim/burg).

Gjatë zbatimit të kësaj dispozite të Kodit Zgjedhor, Avokati i Popullit ka konstatuar se në burgje ka me mijra të dënuar që kanë vendbanimin e tyre në qytete të tjera. Sipas ligjit ekzistues, ata nuk mund të regjistrohen në listat e zgjedhësve dhe për rrjedhojë nuk votojnë.

Sipas të dhënave zyrtare të dërguara pranë Avokatit të Popullit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve më datë.15.02.2007, nga rreth 4000 persona që ndodheshin të dënuar ose të paraburgosur në rang Republike, vetëm 274 prej tyre ishin regjistruar në komisionet e njësisive zgjedhore. Këto në rastet kur vendbanimi i tyre përputhej me vëndin e institucionit ku ata mbahen si të privuar nga liria.

Ky interesim i Avokatit të Popullit ka ardhur si rezultat i disa ankesave të paraqitura pranë zyres së tij nga persona të dënuar, por dhe në zbatim të nenit 14, paragrafi i tretë i Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar,

në të cilin kjo e drejtë i jepet këtij organi edhe kryesisht, në rastet kur duhet të mbrohen interesat e një komuniteti të gjerë.

Nisur nga sa më lart, Avokati i Popullit me cilësinë e kërkuesit, konstatoi se përmbajtja e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, konkretisht fjala “Vendbanim” parashikuar në nenin 63, pika 3 të tij, është bërë pengesë që të dënuarit të ushtrojnë lirisht të drejtën për të zgjedhur që ju njeh Kushtetuta sipas nenit 45 pika 3 e tij.

Në këto kushte, që nga vitit 2003, kërkuesi ka paraqitur rekomandimet e tij për ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, pranë Kuvendit, Këshillit të Ministrave, Komisionit “bipartizan” për procesin elektoral etj, kërkesë e cila nuk është marrë në konsideratë megjithë premtimet e bëra.

Gjithsesi numri i madh i te burgosurve që ju mohua e drejta e votës gjatë zgjedhjeve të fundit Shkurt 2007 për organet e qeverisjes vendore, si dhe qëndimi i Qeverisë me anë të pergjigjes së Ministrisë së Drejtësisë me shkresën Nr.1232/1 Prot dt.16.02.2007 në të cilën zgjidhja e kësaj çështje në kontekstin kushtetues, sipas tyre, i takonte vetëm Gjykatës Kushtetuese, kanë nxitur Avokatin e Popullit që këtë antikushtetueshmëri flagrante ta bëjë objekt shqyrtimi për zgjidhje përfundimtare pranë Gjykatës Kushtetuese.

Në këtë kerkese, Avokati i Popullit ka patur parasysh të evidentojë hapur vlerën e vërtetë që duhet të manifestojë e drejta kushtetuese për të zgjedhur, si një e drejtë që buron edhe nga Protokollu 3 i Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe që duhet të zbatohet si e pamohueshme dhe e pandashme, ashtu siç përcakton edhe neni 15 pika 1 e Kushtetutes së Shqipërisë.

Në kushtet kur transporti i të gjithë të burgosurve pranë vendbanimit të tyre, për të realizuar të drejtën e votes, konsiderohet i pazbatueshëm dhe i rrezikshëm për sigurinë publike, mohimi i kësaj të drejte nuk mund të gjeje perligjje nga organet e ngarkuara nga ligji për këtë proces, por duhet të rregullohet konform frymës së Kushtetutës.

Kërkuesi (Avokati i Popullit) ka në konsideratë në këtë rast jo vetëm shfuqizimin e dispozitës së Kodit Zgjedhor si antikushtetuese, por dhe detyrimin që Kuvendi i Shqipërisë duhet të përmbushë më tej për të rregulluar vakumin ligjor që do të krijohet, duke zëvendësuar fjalën “Vendbanim” me Vendqëndrim”.

Në kuader të sqarimit të rrethanave kushtetuese dhe ligjore të legjitimitit të Avokatit të Popullit në cilësinë e kërkuesit pranë Gjykatës Kushtetuese për çështjen konkrete, referojmë në argumentat si më poshtë vijon:

1. Kërkuesi mban në konsideratë gjatë parashtrimit të kësaj ankese rolin dhe kompetencat e tij që burojnë nga neni 60 i Kushtetutës dhe Ligji Nr.8454 dt.4.02.1999 “*Per Avokatin e Popullit*”. (i ndryshuar). Këto kompetenca konstatojmë se janë gjithashtu në përputhje me nenin 49 pika 2 e ligjit nr. 8577 datë 10.02.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”.

2. Me ndryshimet e reja në Ligjin Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” me ane të Ligjit Nr.9398 dt.12.05.2005, Kërkuesit ju njoh e drejta për të marrë në shqyrtim raste të tilla, duke shfuqizuar paragrafin e dytë të nenit 25 ku ligji dhe aktet e tjera normative parashikoheshin jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit.

Në çështjen konkrete janë tejkualuar mangësitë e konstatuara në Vendimet e Gjykatës Kushtetuese Nr.178 dt.08.11.2001 dhe Nr.2 dt.12.02.2004 për poziten kushtetuese të Avokatit të Popullit, për shkak të ndryshimeve në ligjin e tij organik. Për rrjedhojë, Kërkuesi ka bindjen se tashme nuk ekzistojnë pengesa kushtetuese apo ligjore në kuptim të legjitimitit të tij për të parashtruar kërkesa pranë gjykatës Tuaj të nderuar.

3. Kërkuesi ka ardhur në dijeni për çështjen e mesiperme, nisur nga ankesat dhe njoftimet që janë drejtuar prane tij, kundër veprimtarisë së organeve të administratës publike dhe konkretisht Drejtorise së Pergjithshme të Burgjeve, e cila sipas ankuesve ju kishte mohuar atyre të drejtën e votës.

4. Në çështjen në shqyrtim, Avokati i Popullit vëren se interesi i tij për të ndërhyrë me mjetet e njohura nga ligji, ka qenë korrigjimi i përmbajtjes antikushtetuese të dispozitave të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, të cilat përbëjnë shkak për shkelje të të drejtave të njeriut nga organet e administratës publike. Ky interes i kërkuesit në kontekstin kushtetues, gjen gjithashtu përputhje të plotë me Vendimin interpretues të Gjykatës Kushtetuese Nr.49 dt.31.07.2000”.

Për të gjitha argumentat dhe faktet e lartpërmendura kërkuesi shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të fjalës “vendbanim” në pikën 3 të nenit 63 të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 ndryshuar me Ligjin nr. 9297, datë 21.10.2004, dhe ligjet nr.9341, datë 10.01.2005, nr. 9371, datë 14.04.2005 si dhe ligjin nr. 9676 datë 13.01.2007 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” si pjesë dispozite që bie në kundërshtim me pikën 3 të Nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Gjatë shqyrtimit të çështjes më datën 19.06.2007 përfaqësuesi i subjektit të interesuar, **Kuvendi të Shqipërisë**, është shprehur se pretendimet e Avokatit të Popullit janë të pabazuara, duke parashtruar se:

“- Kërkesa është paraqitur tej afateve ligjore të parashikuara nga neni 50 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”;

- Të burgosurit nuk privohen nga e drejta e tyre për të votuar pasi ata janë të regjistruar në listat e zgjedhësve të vendbanimeve të tyre. Çështja e realizimit konkret të kësaj të drejte nga të burgosurit nuk të çon detyrimisht në përfundimin se dispozita e Kodit Zgjedhor është antikushtetuese;

- Të burgosurit ndodhen në të njëjtën pozitë si edhe personat me shtetësi shqiptare dhe vendbanim jashtë Shqipërisë, studentët, ushtarakët, etj., të cilët vetëm për zgjedhjet parlamentare kanë të drejtë të votojnë në vendqëndrimet e tyre, kurse për zgjedhjet vendore duhet të votojnë pranë vendbanimit të tyre. Kjo dispozitë është formuluar në këtë mënyrë për shkak të lidhjes së drejtpërdrejt që ka zgjedhësi me drejtuesit e njësive vendore.

Kurse përfaqësuesi i **Këshillit të Ministrave** kundërshtoi pretendimet e Avokatit të Popullit me këto argumente:

- Kërkuesi nuk legjitimohet të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk ndodhemi para rastit kur janë cënuar të drejtat liritë apo interesat e ligjshme të individëve nga veprime apo mosveprime të organeve të administratës publike. Sipas subjektit të interesuar, ligji nuk është akt i administratës publike dhe për këtë arsye kërkuesi nuk mund të kërkojë papajtueshmërinë e tij me Kushtetutën para kësaj Gjykate për mungesë legjitimitimi;

- Kërkuesi nuk duhet ta mbështesë pretendimin e tij mbi nenin 3 të Protokollit Shtesë nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi kjo dispozitë e shtrin efektin vetëm për zgjedhjet e përgjithshme dhe jo për ato vendore;

- Të burgosurve nuk u është mohuar e drejta e votës, ajo thjesht është lidhur me konceptin e vendbanimit, pasi vetë karakteri i zgjedhjeve vendore e kushtëzon këtë lidhje midis zgjedhësve dhe të zgjedhurve. Mungesa e parashikimeve ligjore përkatëse për ta bërë efektiv ushtrimin e të drejtës së votës për të burgosurit që nuk kanë vendbanimin në vendin e vuajtjes së dënimit, nuk do të thotë se dispozita e nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor është antikushtetuese”.

Gjykata Kushtetuese, me Vendimin e saj nr.40, datë 16.11.2007 konstatoi se:

“Me ligjin nr.9341, datë 01.10.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë””, është ndryshuar, midis të tjerave, edhe dispozita e nenit 63 e këtij Kodi, e cila thotë: “Në burgjet dhe në vendet e paraburgimit, për zgjedhjet dhe referendimet vendore, 40 ditë para datës së votimit, drejtuesi i institucionit përgatit listën e zgjedhësve me vendbanim në njësinë zgjedhore, ku ndodhet institucioni dhe ia dorëzon atë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse”.

Ndryshimet që iu bënë kësaj dispozite kishin për qëllim realizimin e të drejtës së votës të personave të ndodhur në institucione të posaçme, pra të burgosurve dhe të paraburgosurve. Duke iu referuar nenit 50 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se kërkesat para Gjykatës Kushtetuese për papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre, rezultoi se kërkesa e paraqitur nga Avokati i Popullit është brenda afatit ligjor të parashikuar për këtë qëllim.

Gjykata Kushtetuese vlerëson si të nevojshme që së pari të shprehet mbi legjitimitimin e kërkuarit. Lidhur me këtë Gjykata çmon se Avokati i Popullit legjitimohet në paraqitjen e kërkesës së tij para kësaj Gjykate. Siç është theksuar edhe në praktikën e mëparshme të kësaj Gjykate, Avokati i Popullit, si një nga subjektet që mund ta vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet të justifikojë interesin e tij në çështjen konkrete. Interesi i tij duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike, janë çenuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve. Këto shkelje duhet të evidentohen në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij.

Gjykata Kushtetuese e sheh me vend të ndalet edhe një herë në përcaktimin e konceptit “interes” në çështjen me kërkuar Avokatin e Popullit, sipas nenit 134/2 të Kushtetutës, ku parashikohet se ky organ mund të bëjë kërkesë para kësaj Gjykate vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tij.

Sipas nenit 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit është organ kushtetues i krijuar për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të administratës publike. Një nga mënyrat me të cilat ky organ realizon funksionin e tij është edhe vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e akteve normative të nxjerra nga administrata publike dhe që nga evidentimi i Avokatit të Popullit rezultojnë të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën. Avokati i Popullit mund të arrijë në këtë përfundim përmes hetimeve, vëzhgimeve apo informacioneve që ai mbledh, kur individët i drejtohen atij me anë të ankesës ose kërkesës. Nëse ky organ vlerëson se si rrjedhim i veprimtarisë së administratës publike janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të individit, atëherë ai ndërmerr hapa konkrete për verifikimin e mëtejshëm të shkaqeve që kanë çuar në këtë shkelje dhe rast pas rasti rekomandon marrjen e masave të karakterit normativ, nëse është e nevojshme.

Gjykata Kushtetuese konstaton se kompetenca e Avokatit të Popullit për t’iu drejtuar kësaj Gjykate konsiderohet si një garanci shtesë që i është dhënë në mënyrë indirekte individit për të vënë në vend të drejtën e çenuar nga aktet e administratës publike. Nuk është detyra kryesore e Avokatit të Popullit t’i drejtohet gjykatave në tërësi dhe Gjykatës Kushtetuese në veçanti. Megjithatë në legjislationet e vendeve ku nuk është parashikuar ekzistenca e mjeteve të tilla si kundërshtimi i drejtpërdrejt i akteve normative para Gjykatës Kushtetuese, Avokati i Popullit mund të luajë një rol

të rendësishëm në verifikimin e shkeljeve të të drejtave themelore të individit deri në investimin e Gjykatës Kushtetuese. Në raste të tilla, Avokati i Popullit duhet të argumentojë shkeljen konkrete dhe interesin në çështjen që kërkon të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

Kur Avokati i Popullit krijon bindjen se shkelja ka ardhur si pasojë e përmbajtjes së një ligji ose akti tjetër normativ, pra nga vetë formulimi i vullnetit të organit që e ka nxjerrë atë, atëherë ai mund të investojë Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e aktit si antikushtetues. Në një rast të tillë mund të thuhet së çështja konkrete lidhet me interesin e këtij organi kushtetues për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e individit. Në këtë këndvështrim, interesi i Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese më qellim shfuqizimin si antikushtetues të aktit të ligjvënësit duhet të shqyrtohet rast pas rasti, pasi ky është edhe kuptimi i nenit 134/2 të Kushtetutës, i cili e ka renditur këtë organ në grupin e subjekteve që i drejtohen Gjykatës Kushtetuese vetëm nëse justifikojnë interesin e tyre në çështjen konkrete.

Ashtu siç është shprehur edhe në praktikën e mëparshme të kësaj Gjykate, interesi i një subjekti në një çështje në kuptim të shkronja "dh", "e" "e", "f" të nenit 134 të Kushtetutës do të quhet i justifikuar nëse ai arrin të provohet nga vetë kërkuuesi se pasoja është e drejtpërdrejt pra rrjedh direkt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale dhe sipas rastit, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit ose organizatës respektive. Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkuuesi i plotëson të tre këto kritere, pasi kërkesa lidhet me përmbajtjen e aktit normativ, i cili, sipas tij, sjell pasoja direkte në një të drejtë kushtetuese themelore siç është e drejta e votës. Gjithashtu, çënimi është aktual dhe jo potencial, pasi, sipas kërkuuesit, të burgosurit janë penguar realisht të ushtrojnë të drejtën e votës si rrjedhim i përmbajtjes së dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor. Edhe elementi i tretë, pra lidhja e drejtpërdrejt me subjektin, ekziston, pasi, siç u shpreh më lart, është në funksionin e Avokatit të Popullit të mbrojtë interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike.

Në kërkesën para kësaj Gjykate kërkuuesi ka parashtruar se ai është vënë në lëvizje për këtë shkelje nga vetë të burgosurit, të cilët nuk kanë pasur mundësi të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës. Avokati i Popullit, në ushtrim të kompetencave të veta, ka krijuar mendimin se shkak për mosushtrimin e kësaj të drejte është përmbajtja e dispozitës së Kodit Zgjedhor, eliminimi i së cilës mund të sjellë si pasojë vendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Gjykata Kushtetuese çmon se vënia në lëvizje nga Avokati i Popullit është në përputhje me funksionin e tij kushtetues dhe me filozofinë e krijimit të këtij institucioni, si një mekanizëm efektiv në mbrojtje të të drejtave kushtetuese të shtetasve, të drejta të cilat përbëjnë bazën e rendit tonë juridik.

Lidhur me thelbin e kërkesës, pra për të arritur në përfundimin nëse termi "vendbanim" që përmban dispozita e nenit 63/3 e Kodit Zgjedhor është apo jo në përputhje me Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese vlerëson se duhet të ndalet në konceptin e zgjedhjeve në përgjithësi e sidomos tek zgjedhjet vendore në veçanti.

E drejta e votës është një nga të drejtat themelore politike që gëzon individi. Kjo e drejtë ushtrohet nëpërmjet ngritjes së një sistemi zgjedhor që garanton fshehtësinë, lirinë dhe barazinë e votës duke i siguruar shtetasve qënien e tyre politikisht aktiv duke formuar në këtë mënyrë thelbin e rolit që duhet të kenë ata në një sistem demokratik. E drejta e votës është një element qëndror i demokracisë dhe i shtetit të së drejtës. Kontributi kryesor i saj është garantimi i mundësisë për të gjithë zgjedhësit, pa bërë dallime mbi baza shtresash apo përkatësie në grupe të caktuara shoqërore ose mbi baza të tjera, që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një

shoqëri demokratike. Nga ushtrimi i të drejtës së votës nuk duhet përjashtuar asnjë pjesë sado e vogël e popullsisë, përveç rasteve të përcaktuara në ligjin themeltar të shtetit.

Megjithatë e drejta e votës nuk është absolute, ajo mund të behet objekt i kufizimeve. Ne kete kendveshtrim, per vete rendesine qe merr kjo e drejte ne nje shoqëri demokratike, kufizimet që i duhen bërë kësaj të drejte jo vetëm duhet të jenë të pakta, por ato duhen zbatuar brenda kufijve kushtetues. E rendësishme është që kufizimet të mos jenë të tilla që ta bëjnë jo efektiv ushtrimin e kësaj të drejte ose ta çenojë atë në thelbin e saj, pasi e drejta e votës nuk është një privilegj që pushteti shtetëror ua njeht shtetasve, por një instrument për të zgjedhur mënyrën dhe personat që do të qeverisin vetë ata. Duke ushtruar të drejtën e votës zgjedhësit i krijohet mundësia të ndikojë në mënyrën dhe cilësinë e funksionimit të rendit juridik duke e bërë shtetasin më të përgjegjshëm për rolin që ai ka në drejtimin e jetës së vendit. Ky është në fakt edhe thelbi i demokracisë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 45 të saj, parashikon të drejtën e çdo individi mbi 18 vjeç të zgjedhë e të zgjidhet. Përjashtim bëjnë personat të cilëve u është hequr kjo e drejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë për paaftësi mendore. Gjithashtu, paragrafi 3 i këtij neni parashikon se të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur. Ky parashikim kushtetues është brenda standardeve demokratike dhe bashkëkohore.

Gjykata Kushtetuese thekson se teoria e së drejtës kushtetuese si dhe praktika gjyqësore evropiane e quan të pranueshme dhe të justifikuar vendosjen e kriterëve të tilla si, mosha minimum ose vendbanimi në një zonë të caktuar, përfshirja në lista zgjedhësish apo pasja e shtetësisë së vendit ku zhvillohen zgjedhjet si dhe aftësia mendore për të shprehur vullnetin politik. Duke iu referuar edhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dispozita e nenit 1 Protokollit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vendet anëtare kanë një hapësirë të gjerë në hartimin e legjislacioneve të tyre për zgjedhjet natyrisht duke respektuar thelbin e së drejtës. Kufizimet që mund t'i vendosen kësaj të drejte duhet t'i përgjigjen një qëllimi legjitim dhe të mos jenë arbitrare apo joproporcionale.

Neni 45/3 i Kushtetutës sonë ka shkuar tej parashikimeve minimale si detyrime që rrjedhin dhe nga aktet ndërkombëtare. Këto akte, që synojnë garantimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike, u lënë shteteve anëtare një hapësirë të gjerë vlerësimi të mekanizmave që kanë në dispozicion për ta bërë ushtrimin e të drejtës së votës efektive edhe për grupe të posaçme. Në këtë aspekt i është lënë vetë shteteve anëtare të vlerësojnë, midis të tjerave, edhe grupet e individëve që mund të përjashtohen nga e drejta e votës, psh., vendosja e një moshe më të lartë për të ushtruar të drejtën e votës ose vendosja e kriterëve të tilla si shtetësia.

Në rastin konkret, ligjvënësi ynë ka vendosur minimumin e kriterëve kufizuese duke iu njohur të burgosurve të drejtën aktive të zgjedhjes. Pra, nga pikëpamja e garancisë kushtetuese formale e drejta e votës së të burgosurve është arritur nga dispozita e nenit 45/3 të Kushtetutës. Parashikimi i të drejtës së votës në përgjithësi dhe i grupeve të posaçme, siç konsiderohen të burgosurit, në veçanti, është shprehje e një demokracie politike dhe paraqet rendësi për pjesëmarrjen e gjerë të votuesve në një proces të rendësishëm.

Gjykata Kushtetuese konstaton se neni 63 i Kodit Zgjedhor vendos rregullat e ushtrimit të drejtës së votës për të burgosurit në zbatim të detyrimit që rrjedh nga dispozita e nenit 45/3 të Kushtetutës. Konkretisht, paragrafi 2 i nenit 63 parashikon votimin për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, kurse paragrafi 3 i këtij neni i referohet votimit në zgjedhjet për pushtetin vendor. Një nga dallimet midis këtyre dy

dispozitave është se për zgjedhjet vendore ligjvënësi e ka lidhur ushtrimin e të drejtës së votës me vendbanimin, ndërsa për zgjedhjet e përgjithshme jo. Arsyeja e këtij dallimi duhet kërkuar tek fakti se në zgjedhjet e përgjithshme votohet për anëtarët e organit ligjvënës, të cilët i përkasin të gjithë popullit. Një nga parimet kryesore të përfaqësimit popullor është edhe mungesa e mandatit detyrues të deputetit, pra deputeti përfaqëson jo zonën zgjedhore ku ai votohet por të gjithë zgjedhësit. Ndryshe ndodh në rastin e zgjedhjeve vendore. Këtu synohet një lidhje më e ngushtë midis zgjedhësit dhe të zgjedhurit për vetë natyrën e organizimit dhe kompetencave të pushtetit lokal. Është pushteti vendor që kujdeset për zgjidhjen e problemeve aktuale të qytetarëve që lidhen me çështje të tilla si punësimi, kujdesi shëndetësor, arsimi parashkollor, pastrimi dhe gjelbërimi i mjediseve të njësisë vendore, etj. Për këtë arsye, votimi në zgjedhjet vendore trajtohet si pjesë e strukturës së demokracisë nga posht lart duke u mundësuar zgjedhësve pjesëmarrjen në qeverisje edhe në forumet më të vogla, përveç parlamentit kombëtar. Në këtë këndvështrim, pranohet se pushteti lokal është më afër qytetarëve dhe këta të fundit janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në drejtimin e njësisë vendore ku ata kanë vendbanimin.

Sipas nenit 12 të Kodit Civil, banimi është “...vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës”. Në këtë kuptim, vendbanimi është pika qendrore e marrëdhënieve jetësore të një njeriu. Është kërkesë ligjore që një person të ketë një vendbanim kryesor, brenda një juridiksioni të caktuar, me qëllim që të votojë, të punësohet ose të presë përfitime të tjera brenda këtij juridiksioni. Kushti për të pasur vendbanimin në zonën zgjedhore është një nga kufizimet e të drejtës së votës, e cila bashkë me kriterin e shtetësisë synojnë të vendosin një lidhje direkte qoftë edhe minimale, midis votuesit dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në këtë mënyrë sigurohet legjitimiteti i votës në një zonë të caktuar.

Në këtë këndvështrim, duket me vend që neni 63/3 i Kodit Zgjedhor e lidh ushtrimin e të drejtës së votës për të burgosurit me konceptin e vendbanimit dhe jo me vendin e vuajtjes së dënimit ose vendqëndrimin. Gjykata Kushtetuese çmon se kushtëzimi i të drejtës së votës me konceptin e “vendbanimit” në përmbajtjen e dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor nuk e bën atë antikushtetuese, përkundrazi ai garanton shprehjen direkte të vullnetit të zgjedhësit për drejtuesit e njësisë vendore ku ai banon.

Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se mosushtrimi i të drejtës së votës nga të burgosurit dhe të paraburgosurit nuk është rrjedhojë e antikushtetutshmërisë së dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor”.

Për arsyet e paraqitura më lart, Gjykata Kushtetuese çmoi se dispozita e paragrafit 3 të nenit 63 të Kodit Zgjedhor është në përputhje me nenin 45/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe si rrjedhim vendosi rrëzimin e kërkesës së Avokatit të Popullit.

Megjithatë, pavarësisht rrëzimit të kërkesës, siç thamë Vendimi i mësipërm ka rendësi sepse sqaroi dhe sanksionoi më qartë legjitimitetin e Avokatit të Popullit për të kërkuar më Gjykatën Kushtetuese shfuqizimin e ligjeve që ai i konsideron antikushtetuese.

5. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me Publikun dhe Median

Marredheniet e Avokatit të Popullit me median kushtevojne nje bashkepunim te ngushte, bazuar ne logjiken e perfitimit per te dyja palet. Avokati i Popullit i ka cilesuar gazetaret si “rojtare publikë”. I tillë është edhe vete Avokati i Popullit. Kjo përse i perket misionit. Natyrisht qe bashkepunimi i perditshem paraqitet ne nje plan me specifik. Ky bashkepunim realizohet ne nje plan me te zakonshem, qe parakupton kontaktet e perditshme te zyres me perfaqesuesit e organeve te shtypit, te cilet vijne ne Zyren e Avokatit te Popullit, njelloj sikurse shkojne ne çdo zyre tjeter te administrates publike.

Ne marredheniet me gazetaret, Avokati i Popullit bazohet jo thjesht ne nevojën e tij institucionale per te nxjerre ne pah punen e kryer, por edhe ne nje Ligj shume te rendesishem, qe nuk ben dallim nese kemi te bejme me gazetare apo me qytetare te interesuar per te patur akses ne dokumentet zyrtare. Eshte specifika e shtypit per te patur informacion te dores se pare dhe te shpejte, ajo qe e rrit edhe gadishmerine e punonjesve te Zyres se Avokatit te Popullit per t’iu pergjigjur ne kohe gazetareve te interesuar.

Avokati i Popullit e njeh mire prirjen e shtypit ne pergjithesi, dhe atij shqiptar ne veçanti, per te pasqyruar ne faqet e veta lajmin sensacional dhe, per fat te keq, edhe virulencen e konfliktualitetit politik. Avokati i Popullit ndan mendimin se shtypi duhet ushqyer më shumë me materjal qe hedh drite mbi debatin demokratik ne vend. Nga kendveshtrimi yne kjo do te thote se ndjeshmeria e publikut dhe e politikaneve duhet te rritet me shume me problemet e funksionimit te sherbimeve publike, me perpjekjet ne luften kunder korrupsionit, me hartimin e politikave per te luftuar trafiqet, me kryerjen e reformave ne fushen e drejtesise, me pergjegjesite e shtetit dhe te zyrtarve te tij ne permbushje te detyres, me respektimin e dinjitetit njerezor, te se drejtes se besimit, te mosdiskriminimit e te mostortures e keshtu me radhe, pra me funksionimin e atyre antikorpeve demokratike qe e bejne sistemin tone sa perfekt, aq edhe te brishte e te veshtire ne rrugen e tij te rritjes dhe maturimit.

Nese ne fillimet e funksionimit te Avokatit te Popullit, sfida kryesore ka qene njohja dhe krijimi i integritetit dhe autoritetit publik te Institucionit, per kohen qe flasim perben sfide rritja e pergjegjshmerise, krenaria per çka arrijme dhe, me shume se kaq, realizmi, mundesite tona si dhe vetekontrolli ne dhenien e informacionit, i cili duhet te jete sa me faktik dhe i ftohte. Themi keshtu, sepse synojme te ruajme nje imazh sa me te drejte dhe real per rolin qe kryejme, me synimin per te mos krijuar iluzione tek publiku, edhe per probleme qe ne nuk kemi mundesi ligjore per zgjidhur.

Avokati i Popullit i ka konceptuar marredheniet me publikun si nje teresi raportesh qe krijohen sa nga administrimi i puneve ne zyre, aq edhe nga performanca e çdo punonjesi te zyres tone. Idealja do te ishte qe administrimi i brendshem i puneve te shkonte paralel edhe me performancen e jashtme, qe natyrisht nuk jane e njejta gje. Per t’i perafuar sa me shume keto, le t’i referohemi praktikës tone per ngritjen e infrastruktures se nevojshme qe mundeson informimin e publikut. Dy drejtimet themelore jane informimi i qytetareve per sherbimet e zyres, pritja dhe sqarimi i tyre korrekt per t’u ardhur ne ndihme halleve dhe shqetesimeve qe ata ngrejne prane nesh, dhe e dyta, informimi i publikut permes medias rreth nderhyrjeve tona mbi bazen e çeshtjeve te ndryshme, ne varesi te rendesise se tyre.

Prane Avokatit te Popullit funksionon nje zyre e veçante dhe person i veçante qe merret me pritjen e ankuesve dhe qe ofron sherbimin e pare nga zyra e Avokatit te Popullit. Ky element perben ate qe quhet *front office* ose zyra e parme. Veç sqarimit

paraparak te qytetareve, personi i posaçem qe punon ne kete zyre realizon edhe regjistrimin e rasteve konkrete, per t'ia percjelle me pas keto nje elementi tjetër qe quhet *back office* ose zyra e pasme, qe perfshin strukturalisht protokollin dhe arkiven. Nga ana funksionale kjo nenkupton angazhimin e te gjithë stafit te institucionit per te adresuar sipas rastit lenden e filtruar nga zyra e parme. Keto elemente, te cilat ne i kemi zbatuar ne Institucionin tone, ne i kemi sugjeruar edhe ne rregulloren tip qe i kemi derguar Qeverise per ta miratuar si Rekomandim te Avokatit te Popullit, ne menyre qe nje praktike e tille te unifikohet ne shkalle vendi ne tere piramiden administrative te shtetit.

Konceptin e marrëdhënieve me publikun, sikunder e shpjeguar me lart, Avokati i Popullit nuk e ka ngaterruar me konceptin dhe funksionin e zedhenesit te institucionit. Ky i fundit perben ne vetvete nje institucion qe ka te beje me shume me promovimin e veprimtarise se institucionit, me berjen publike te politikave te institucionit, pra me profilizimin gjithnje e me pozitiv te imazhit te institucionit. Ne funksion te ketij qellimi, ne kemi hartuar nje strategji te shkruar, e cila perfshin ne teresine e saj te gjithë elementet e mundshem qe duhet te funksionalizojë nje institucion i ri ose tradicional qofte, per te krijuar e rritur imazhin e tij dhe mbi te gjitha besimin te publiku dhe autoritetet, pra ate qe perben reputacionin dhe integritetin e tij. Kete strategji ne e kemi bere te ditur dhe botuar thuajse ne te gjitha raportet e meparshme vjetore. Komponentet e saj vazhdojne te mbeten fusha gjithnje per te elaboruar dhe prodhuar here pas here profile te te ndryshme funksionale, ne varesi te problematikave qe ndjek institucioni. Keshtu, krahas pasqyrimin te rasteve ne shtypin e perditshem, gjate vitit 2007, Avokati i Popullit realizoi ne kuadrin e bashkepunimit me projektin e qeverise suedeze SIDA dhe Save the Children, dy spote sensibilizuese per dhune ndaj femijeve.

Marrëdhëniet me median gjithmonë i kemi parë me përparësi, sepse kemi patur dhe kemi si objektiv të rrisim besueshmërinë e publikut ndaj institucionit tonë në praktikë. Jemi të bindur se sukcesi arrihet duke u bazuar në dy shtylla, të cilat janë profesionalizmi dhe besueshmeria.

Modeli tashmë i konsoliduar në marrëdhëniet me median është përqendruar në tre nivele komunikimi. E para, mediave u kemi dhënë materiale, kryesisht mbi bazën e rasteve konkrete. E dyta, jemi munduar të bëjmë përgjithësime, duke shpjeguar rolin, kompetencat dhe juridiksionin tonë pas çdo rasti konkret, të trajtuar gjithmonë me mjaft transparencë nga ekspertët tanë. E treta, njoftimet për shtypin, të shpërndara për median sipas rasteve dhe aktivitetit te Zyres, pasqyrohen brenda ditës edhe ne faqen tonë elektronike.

Përmes medias ne jemi njohur edhe me ankimet e mjaft njerëzve, por dhe me prioritetet e Qeverisë shqiptare. Në këtë mënyrë, fokusin e punës tonë e kemi drejtuar për të krijuar precedentë në ato sektorë të qeverisjes, tek të cilët kërkohet krijimi dhe rritja e standarteve për shërbimet publike, presioni për uljen e kostos së këtyre shërbimeve, domosdoshmëria e zbatimit të vendimeve gjyqesore, të drejtat e fëmijëve, zbatimi i të drejtës së informimit, përmirësimi i legjislacionit për pronësinë, lufta kundër korrupsionit, kundër abuzimeve të zyrtarëve, per te drejtat e te burgosurve dhe paraburgosurve si dhe fusha të tjera që janë pasqyruar në kreun përkatës sipas rasteve. Tek media kemi patur aleatin më të sigurtë për t'u bërë pjesë e opinionit publik, në rastet kur na është dashur të ndeshemi me rezistencën e atyre zyrtarëve publikë, të cilët mund ta konsiderojnë rekomandimin e Avokatit të Popullit si diçka bezdisëse.

Informacionet nga shtypi përbëjnë bazën e një drejtimi të rëndësishëm të punës tonë, sikundër është vënia në lëvizje me vetiniciativë, parashikuar nga neni 13-

te i Ligjit “Për Avokatin e Popullit”. I gjithë spektri i shtypit të përditshëm filtrohet posaçërisht çdo ditë në zyrën tonë.

Produktet e Zyres së Avokatit të Popullit si broshura “Avokati i Popullit në Shqipëri – Ombudsmani Parlamentar” (në shqip, anglisht dhe frëngjisht), posterat tematikë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përmbledhjet me tituj “Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit”, “E drejta e informimit – e drejtë themelore e njeriut”, apo pesë fletëpalosje për grupe të ndryshme interesi, përmes të cilave shpjegojmë rolin, kompetencat dhe rrugët si mund t’i drejtohen Avokatit të Popullit, kanë qenë në qarkullim përgjatë gjithë vitit. Për një kohë filluam edhe botimin e gazetës “Avokati i Popullit”, në dy gjuhë, shqip dhe frëngjisht, botim i cili u ndërpre për shkak të pamundësive financiare për botimin e saj, nga ana e Agjencisë Nderkombetare të Frankofonisë. Në bashkëpunim me OSBE-në kemi realizuar afishimin thuajse në të gjitha institucionet publike, komisarjate dhe vende të vuajtjes së denimit, të tre posterave të medhenj, ku qytetarët informohen për të drejtat e tyre për informim, për problemet e mjedisit dhe për të drejtat e tyre në momentin e ndalimit ose paraburgimit. Këtë vit, po në bashkëpunim me OSBE-në, ne botuam “Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve në sistemin shqiptar të burgjeve”. Dokumentari njohës dhe promovues për Institucionin e Avokatit të Popullit tashmë është vënë në dispozicion dhe transmetuar në shumicën e televizioneve lokale dhe kombëtare. Të disponueshme kanë qenë edhe pesë spotet televizive që informojnë publikun për shërbimet që ne ofrojmë dhe rrugët e përfitimit të këtyre shërbimeve. Instalimi i teknologjisë informative na ka mundësuar që tashmë të kemi edhe faqen tonë në Internet, ku të interesuarit mund të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me zyrën tonë dhe aktivitetin që kryen ajo.

Mbulimi mediatik ka qenë gjithmonë në përshtatje me problematikën dhe intensitetin e punës që institucioni ka kryer. Larmia e problematikës, që është pasqyruar në Media është pa komente në tabelat përkatëse me statistikat e mbulimit mediatik. Duke u nisur qoftë edhe nga titujt e informacioneve, bëhet e qartë edhe veprimtaria që kemi kryer dhe sa kemi mundur ta bëjmë të njohur atë për publikun. Strategjia në fjalë është një material që gjen materializim çdo ditë në varesi të mundësive financiare për të realizuar zërat e saj. Gjithsesi, mund të themi se Avokati i Popullit tashmë ka krijuar zërin e tij, imazhin e tij, pra vendin e tij si një organizëm i natyrshëm që realizon komunikimin e përditshëm të qytetarëve me administratën, duke e pozicionuar këtë të fundit jo si pronar, as edhe si të pandehur, por si shërbetore të taksapaguesve përmes mirëadministrimit.

a) Sektori i pritjes së popullit

1. Organizimi i punës

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, që prej vitit 2001 funksionon sukseshëm Sektori i Pritjes së Popullit. Kjo zyre u krijua për perballimin në vazhdimësi të fluksit në rritje të individëve, të cilët paraqiten pranë nesh për të parashtruar ankesa, kërkesa, apo njoftime në lidhje me shkelje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre. Ky shërbim ndaj qytetarëve vazhdon me ritme të larta dhe ka krijuar një fizionomi pozitive për institucionin e Avokatit të Popullit, duke u shfaqur me afër ankuesve dhe duke i orientuar drejtë ata për zgjidhjen e problemit të tyre.

Për këtë një nga juristet e institucionit tonë, në një zyre të posaçme, lehtësisht të arritshme për qytetarët, pret në çdo kohë gjatë orarit zyrtar, pa pengesa, me kulturë e profesionalizëm, ankesat e individëve të ndryshëm. Duke u udhëhequr nga motoja e Institucionit tonë “Avokati i Popullit- një dërrë e hapur për ju”, kjo zyre u mundëson

qytetareve qe paraqiten per ankesa apo kerkesa, te ndjehen te mirepritur dhe te perfitojne ne kohe te shkurter, sherbimet qe mund t'u ofroje institucioni yne.

Duke koordinuar punen edhe me pjesetare te tjere te stafit, eshte arritur qe ky sherbim te vije gjithnje ne rritje per nga cilesia dhe profesionalizmi. Ai ka rritur besimin tek qytetaret dhe per rrjedhoje numri i ankesave dhe kerkesave shtohet nga viti ne vit.

Sektori i Pritjes se Popullit, si pike takimi e pare e Marredhenieve me Publikun, ka ofruar sherbimin e tij, si nepermjet perpilimit te ankeses apo kerkeses qe individe te ndryshem parashtrojne, ashtu dhe nepermjet keshillimeve ose orientimeve ligjore profesionale qe ata kerkojne, kur ceshtja qe parashtrohet prej tyre nuk eshte objekt i veprimtarise se Avokatit te Popullit. Pervec materialeve te gatshme, te prodhuara nga Zyra e Avokatit te Popullit, qe ndodhen ne dispozicion te qytetareve, ketyre te fundit u ofrohet informacioni i kerkuar dhe njohja me legjislacionin ne fuqi, si dhe u jepen sqarime te metejshme per rrugen qe ndiqet pas ankeses se bere.

Nepermjet sqarimeve me goje dhe pergjigjeve me shkrim ne kemi mundur t'u vijme ne ndihme qytetareve, me synimin per te eleminuar sa me shume sorollatjet e tyre ne dyert e Administrates Publike, ku shpesh hasin mjaft pengesa burokratike. E gjithë kjo procedure, direkt ne kontrollin dhe kujdesin e Avokatit te Popullit, rrit besimin te qytetaret dhe ben te mundur shtimin e ankesave apo keshillimeve nga viti ne vit. Ngarkesa e punes e kesaj njesie paraqitet si me poshte:

2. Statistikat permbledhese

Gjate vitit 2007, numri i pergjithshem i ankesave te paraqitura prane Zyres se Pritjes se Popullit, eshte **2037 ankesa apo kerkesa**. Ne tabelen e meposhtme pasqyrohen ankesat e paraqitura çdo muaj dhe numri i pranimit te atyre qe kane qene brenda juridiksionit dhe kompetencave te Avokatit te Popullit.

Muaji	Ankesa gjithsej		Ankesa te pranuar	
Janar	207	ankesa	101	ankesa
Shkurt	181	-“-	91	-“-
Mars	195	-“-	78	-“-
Prill	150	-“-	69	-“-
Maj	180	-“-	76	-“-
Qershor	196	-“-	83	-“-
Korrik	208	-“-	77	-“-
Gusht	51	-“-	20	-“-
Shtator	199	-“-	52	-“-
Tetor	167	-“-	57	-“-
Nentor	195	-“-	81	-“-
Dhjetor	108	-“-	37	-“-
Totali	2037	-“-	822	-“-

Siç mund te shikohet nga numri i pergjithshem i ankesave ose kerkesave verbale qe jane paraqitur prane Zyres se Pritjes se Popullit, jane pranuar per shqyrtim 822 ankesa apo kerkesa të cilat u janë bashkuar ankesave, kërkesave apo njoftimeve të tjera që i janë dërguar Avokatit të Popullit me letra, fax, telegram etj. Keto gjejne pasqyrim ne pjese te tjera te raportit sipas fushave dhe organeve te administrates publike.

Zyra e Pritjes se Popullit ne permbushje te detyrave te saj funksionale gjate vitit 2007, ka pritur, keshilluar, orientuar dhe kthyer pergjigje te menjehershme 1215

kerkesave dhe ankesave te paraqitura verbalisht. Eshte konstatuar se keto ankesa apo kerkesa kane qene jashte juridiksionit dhe kompetencave te Avokatit te Popullit. Megjithate te gjithë ketyre individeve ju eshte dhene nje keshillim profesional, mbi rrugen ligjore dhe institucionale qe duhet te ndjekin dhe afatet qe duhen te respektojne per zgjidhjen e ankeses se tyre.

3. Problematikat e shfaqura

Ne ndryshim nga vitet e tjera Sektori i Pritjes se Popullit, ka evidentuar e monitoruar me kujdes, problematikat e ankesave qe individe te ndryshem kane paraqitur, por qe nuk jane pranuar për shqyrtim pasi jane jashte juridiksionit te Avokatit te Popullit. Ankuesve u eshte dhene konsulenca e nevojshme juridike, si dhe adresa e institucioneve ne te cilat duhet te paraqiten per zgjidhjen e ankesave te tyre.

Nga ky evidentim del se ankesat jashte juridiksionit te Avokatit te Popullit kanë qenë si me poshte:

Ankesa ndaj vendimeve te Gjykatave Shqiptare	210
Kerkesa per perfaqesim ne gjykate	115
Konflikte midis individeve	161
Ankesa ndaj subjekteve private	96
Konflikte ne familje	98
Kerkesa per punesim	109
Ankesa ndaj kompanive te huaja private	87
Ankesa ndaj gjykatave te shteteve te huaja	81
Ankesa ndaj perfaqesive te huaja në Shqipëri	120
Ankesa ndaj shteteve te huaja	70
Ankesa ndaj organeve te policise se shteteve te huaja	41
<u>Te tjera</u>	<u>27</u>
	1215

Siç mund te shikohet ne tabelen e mesiperme numri me i madh i këtyre ankesave, drejtohet ndaj gjykatave shqiptare te te gjitha niveleve. Keto ankesa zene rreth 17.5% te te gjitha ankesave jashte juridiksionit te Avokatit te Popullit. Sipas ankesave të individeve te paraqitur vendimet e gjykatave shqiptare mbartin padrejtesi, paragjykim, pavartetesi dhe njeanshmeri. Ata nuk jane dakort me vendimet e gjykatave, kane pretendime per trupin gjykues, ankohen per korrupsion si dhe marrje rryshfeti. Gjithashtu, ankohen per punen pa nivel te avokateve mbrojtës, te cilet ne disa raste, sipas ankuesve, bejne lojë (mbrojtje) te dyfishte kundrejt rryshfetit.

Edhe gjate ketij viti, mjaft qytetare jane ankuar se nuk mund te kundershtojne vendimet e gjykatave për çeshtje penale mbasi kete te drejte ligji ia njej vetem Prokurorise, e cila ne mjaft ne raste, kerkon mase ndeshkimi te ulet ne krahasim me pretendimet e te demtuarve. Ky problem eshte ngritur shpesh nga Avokati i Popullit, për të ndryshuar Kodin e Procedurës Penale në menyre qe familjet e demtuara te kene te drejte ankimimi. Kjo per faktin se ne te shumten e rasteve jane familjaret e viktimave qe mendojne se vendimi nuk ka qene i drejte, por prokurorët nuk bëjnë ankime të vendimeve.

Nje problem tjetër qe eshte evidentuar gjate pritjes se individeve ne Zyren e Pritjes se Avokatit te Popullit, jane konfliktet ne familje si dhe konfliktet midis individeve. Keto ankesa zene rreth 21.3 % te ankesave jashte juridiksionit te Avokatit te Popullit. Ne me te shumten e rasteve, problematika e ketyre ankesave kane te bejne me probleme ne familje, burre e grua, kane te bejne me femijet, probleme trashegimie,

te pronës etj. Nga ana jone, është bere kujdes ne dhenien e konsulences per menyren e zgjidhjes se ankesave, duke keshilluar per rrugen e sakte ligjore qe duhet te ndiqet, me qellim eleminimin e konflikteve te mundeshme. Per kete, veç konsultave tona, është bashkepunuar me organizata jo qeveritare si dhe me organizata per mbrojtjen e te drejtave te grave e femijeve, gjithmone ne funksion te parandalimit te konflikteve te mundeshme.

Per sa i perket kerkesave per punesim, vihet re nje rritje e numrit te tyre, krahasuar me vitin e kaluar. Ato zene rreth 9% te ankesave te papranuara si jashte juridiksionit te Avokatit te Popullit. Ne keto raste, qytetaret jane keshilluar te paraqiten ne zyrat e punes. Ne kete menyre, mendojme se kemi kontribuar sado pak ne uljen e informalitetit ne kete sektor si dhe per edukimin e qytetareve per ndjekjen e rruges ligjore ne permbushjen e qellimeve te tyre. Kjo statistike mund t'i sherbeje organeve kompetente shtetore ne hartimin e strategjive efikase per punesim.

Rreth 8% e ankesave kane qene kunder subjekte private. Problemet jane te ndryshme, mosrespektim dhe prishje e njeanshme e kontratave, sidomos nga ndertues qe nuk zbatojne kontratat e sipërmarrjes dhe të shitjes, afatet e percaktuara, mos dhenie e pages nga punemarresit, pune ne te zeze, largime nga puna, mos pagim i Sigurimeve Shoqerore e te tjera probleme qe rendojne mbi qytetarët edhe për shkak se strukturat e tjera të shtetit nuk veprojnë.

Si dhe vitet e kaluara, nje numer i madh ankesash drejtohet ndaj perfaqesive te huaja, te cilat ndaj kerkesave te shtetasve per paisje me vize, reagojne me sjellje aspak dinjitoze dhe diskriminuese. Ky diskriminim, i verejtur pothuajse ne pjesen me te madhe te perfaqesive te huaja ne vend, shprehet shpeshhere, me mos dhenie te arsyes per mospaisjen me vize ndaj individeve, te cilet kane bere nje kerkese te tille. Gjithashtu, nje numer i madh ankesash drejtohet ndaj institucioneve te shteteve te huaja, qe kane te bejne me padrejtesi te ndryshme ndaj shtetasve shqiptare qe jetojne ne shtete të tjera.

Per sa i perket ankesave drejtuar shteteve apo perfaqesive te huaja, Avokati i Popullit, ka bashkerenduar punen me Ministrine e Jashtme dhe perfaqesite tona jashte vendit. Por e shikojme me vend te theksojme se puna e perfaqesive tona jashte vendit, duhet te jete me afer problemeve dhe shqetesimeve te shtetasve Shqiptare, sepse ka shume ankesa per pa aftesi dhe zvarritje ne punen e tyre.

Ne te gjitha rastet, ankuesve iu është bere e qarte se Avokati i Popullit është i gatshem te nderhyje me kompetencat qe i jep ligji, vetem kur organet apo autoritetet per te cilat ka ankesa apo kerkesa, jane pjese e Administrates Publike, dhe kur prej tyre nuk konstatohet angazhimi i duhur institucional. Ne rastet e tjera, qytetareve i është ofruar keshillim ligjor, ose orientim dhe sugjerim per zgjidhjen e problemeve te prezantuara.

Nga konkluzionet e arritura, si rrjedhim i nje eksperience prej me shume se 7 vjetesh te Zyres se Pritjes se Popullit dhe te marredhenieve me individe ne pergjithesi, mendojme se angazhimi yne ne te ardhmen është i domosdoshem per t'i ardhur sa me teper ne ndihme qytetareve qe kerkojne ndihmen e Avokatit te Popullit.

b. “Ditët e Hapura” – Përvojë për t’u vazhduar

Në zbatim të një prej pikave te Rezolutes se Kuvendit te Shqiperise, të datës 12 Mars 2007, gjate vitit 2007 ne vazhduam praktiken tashme te konsoliduar të komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, që e kemi quajtur “Ditë të hapura”. Kjo ka rezultuar te jete një praktikë shumë e frutshme që jo vetëm shkurton procedurat burokratike, rrugët e gjata drejt Tiranës, shpenzimet ekonomike, por edhe

manipulimet e mundshme me të drejtat e qytetarëve, pa folur ketu edhe për vlerën njohëse që ka kjo praktike edhe për vetë stafin e Avokatit të Popullit, duke u mundësuar atyre prekjen nga afer të halleve dhe shqetësimeve të qytetarëve. Parimi është se, nëse procedurat zbatohen me korrektesë, qytetari nis të rrisë besimin tek shteti i vet, tek institucionet dhe ligji, dhe kjo fillon qysh nga njësia me e vogël administrative.

Orientimi i qeverisë shqiptare drejt atij që quhet “shtet i vogël”, si një filozofi e caktuar e demokracisë liberale, ka sjelle vetvetiu edhe leshimin e mjaft kompetencave nga pushteti qendror në drejtim të pushtetit vendor. Problemet që kanë të bëjnë me shërbime të tilla publike si energjia elektrike, ujësjellës kanalizime, probleme të pronësive, zyrat e regjistrimit të pasurive neper rrethe, marrëdhëniet e punës, sigurimet shoqërore e kështu me radhë, natyrshëm çojnë në orientimin se më e mira është që problemet të zgjidhen atje ku lindin dhe me ata persona që i kanë krijuar këto probleme.

Gjate vitit 2007, ekspertet e Avokatit të Popullit kanë organizuar “Ditë të Hapura”, në 53 bashki dhe 43 komuna të vendit. Jane pritur gjithsej 1383 ankes, nga të cilat janë pranuar 1038 ankesa. Në vend janë sqaruar e keshilluar edhe 345 ankes. Për herë të parë kemi shkuar në kaq shumë komuna.

Takimeve tona nëpër rrethe në “ditët e hapura” u kanë paraprirë eventualisht bisedat në televizione lokale nga ekspertët e Zyrës së Avokatit të Popullit, si dhe njoftimet e bera nga zyrtaret e bashkive perkatese. Veçori e vitit që shkoi ishte zgjerimi gjeografik i organizimit të këtyre ditëve. Ka rezultuar se në shumicën e rasteve, objekti i ankesave të tyre ka patur të bëjë me politikën sociale të shtetit (punësimi, strehimi, ndihma sociale etj), me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, me procedurat e ndjekura nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, konflikte të lindura në marrëdhëniet e punës, ankesa në lidhje me shtesat e pensioneve apo dhe probleme të tjera.

Përvoja e fituar në “Ditët e Hapura”, por dhe në disa inspektime me grupe pune, me objekt të caktuar, siç janë inspektimet në burgje, takimet me efektiva të repartëve ushtarake etj, për t’u njohur nga afër se sa zbatohen të drejtat që janë të sanksionuara me ligj, na ka nxjerrë si domosdoshmëri që kjo punë të thellohet në të ardhmen, me synim rritjen e efikasitetit dhe shpejtesinë e zgjidhjes së ankesave atje ku lindin.

6. Konferenca Kombëtare për parandalimin e Torturës

Më datën 26.07.2007 Avokati i Popullit në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës, organizuan Konferencën e parë Kombëtare me temë “Drejt një Shqipërie pa torturë”. Në këtë Konferencë morën pjesë deputetë, drejtues të Policisë së Shtetit, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, përfaqësues të trupit diplomatik në vendin tonë, të organizatave jo fitimprurëse që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe të të përndjekurve politikë. Në Konferencë, krahas të tjerave, u evidentua progresi i arritur pas zhvillimeve demokratike të vitit 1990 në Shqipëri për parandalimin e torturës, si një nga shfaqjet më të ashpra të shkeljes së të drejtave të njeriut. Në mënyrë të veçantë Konferenca u ndal në punën e bërë nga shteti shqiptar për realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga Protokollin opsional i Konventës kundër Torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar. Ky Protokoll është ratifikuar nga Kuvendi i

Shqipërisë me ligjin nr.9094, datë 03.07.2003 dhe ky ligj ka hyrë në fuqi që para 4 vitesh.

Në këtë konferencë Avokati i Popullit theksoi se institucioni që ai drejton ju përgjigj pozitivisht menjëherë ftesës së Qendrës Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës, jo thjesht për të shënuar një aktivitet më shumë në axhendën e bashkëpunimit të tij me organizma të shoqërisë civile. Ky aktivitet ishte një Homazh edhe për ato qindra e mijra viktima të torturës gjatë regjimit komunist në vitet 1944-1990. Gjithashtu, ky aktivitet u zhvillua së pari, për të ftuar autoritetet publike të informoheshin dhe orientoheshin drejt detyrimeve, për ta parë situatën nën dritën e hyrjes në fuqi të Protokollit Opsional të Konventës Kundër Torturës. Së dyti, për të informuar dhe inkurajuar qytetarët, se janë disa të drejta të patjetërsueshme të njeriut, sikurse është ajo e mostorturimit, që as nuk blihet dhe as nuk dhurohet, por thjesht gëzohet absolutisht në çdo rrethanë. Nuk mund të ketë asnjë situatë të jashtëzakonshme që të mund të pezullojë ose kufizojë, qoftë edhe përkohësisht të drejtën e mostorturës dhe detyrimin e shtetit për të mos e zbatuar atë.

Në Konferencë u theksua se edhe futja e kësaj të drejte, pra e mostorturës, në ligjet e vendit, nuk është e mjaftueshme për të parandaluar shkeljen e saj dhe të të drejtave të ngjashme me të, sikundër është trajtimi mizor, jo-njerëzor dhe poshtëruar. Të gjithë mund të pohojnë se “në asnjë mënyrë nuk mund të detyrohet një person për të bërë një rrëfim”, por jo të gjithë e dinë se si duhet krijuar sistemi që ta sigurojë zbatimin e këtij pohimi. Të gjithë ne pohojmë se një personi, në asnjë rrethanë, nuk mund t’i heqësh me dhunë aftësinë e shikimit, apo të dëgjimit, pasi ky veprim cilësohet mizor. Por sakaq, në mos të gjithë, disa nga ne, janë dëshmitarë se gjëra të tilla kanë ndodhur dhe ndodhin. Edhe vuajtjet psikologjike dhe stresi fizik dhe mendor, që u shkaktohet personave në rrethana të ndryshme, janë trajtime jo njerëzore. Është torturë si për atë që e pëson, ashtu edhe për atë që e shikon, rrahja me shkop gome apo çdo mjet tjetër, në tejkallim të forcës së ushtruar në kryerje të detyrës. Edhe sipas parimit të prezumimit të pafajësisë, një i pafajshëm nuk mund të torturohet. Por dhe përtej kësaj, edhe kur personi është fajtor, përsëri nuk mund të torturohet. Dhe kjo, për arsye se e drejta e mostorturës i përket njeriut, për asnjë arsye tjetër, përveç faktit se ai është thjesht një qenie njerëzore.

Legjislacioni Ndërkombëtar dhe ai Kombëtar e kanë klasifikuar në këtë mënyrë të drejtën e mostorturës, duke u nisur edhe nga detyrimi që del para shteteve për të operuar në të drejtën pozitive, dhe konkretisht për të krijuar garancitë e mbrojtjes efektive të kësaj të drejte. E thënë më thjesht, kjo do të thotë se minimalisht dhe i pari hap, që pritej të ndërmerrej, ishte krijimi i një Mekanizmi Kombëtar Parandalues. Veprimtaria e këtij mekanizmi do të konsistojë në vizitat dhe inspektimet e herëpashershme dhe të papritura në të gjitha ato institucione, le të themi te mbyllura, ku mundësia e ekspozimit të njerëzve ndaj keqtrajtimeve dhe torturës është më e madhe. Të gjithë e kemi të qartë, se nuk bëhet fjalë për banesat private apo shtëpitë e pushimit, por për stacionet e policisë, dhomat e ndalimit, burgjet, qendrat e pritjes së azilkërkuesve, spitalet psikiatrike e të tjera të ngjashme me këto.

Avokati i Popullit vuri në dukje në Konferencë se një ndër rastet e para, të trajtuara nga Avokati i Popullit qysh në Korrik të vitit 2000, kur sapo kishte filluar veprimtarinë, ka qenë pikërisht tortura ndaj një të mituri nga policia në Sarandë. Duke qenë mjaft të ndjeshëm në këtë drejtim, mund të themi se në asnjë rast keqtrajtimi apo torture, kur Avokati i Popullit është vënë në dijeni, nuk ka hezituuar të fillojë hetimin me inisiativë (ex officio), duke bashkëpunuar me policinë dhe prokurorinë. Avokati i Popullit ka këmbëngulur që drejtësia të bëhet deri në fund, qoftë për autorët e veprave penale, qoftë për viktimat e tyre, deri edhe duke i zhvarrosur, kur ka qenë nevoja.

Një ndër rastet e fundit ka qenë edhe vetëvarja e të riut Përfundi në vitin 2006, ku veç investigimit në vend, si instrument kryesor për të nxjerrë përfundimin, u përdor pikërisht përkufizimi që i bëhet veprës penale të torturës nga Konventa Evropiane Kundër Torturës, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar qysh në vitin 2003. Pas rekomandimeve të përsëritura të Avokatit të Popullit që nga viti 2005, Parlamenti Shqiptar realizoi në mars të vitit 2007, ndryshimin përkatës në Nenin 86 të Kodit Penal, duke i bërë torturës përkufizimin adekuat, në përputhje me konventat ndërkombetare. Por duhen bërë edhe rregullime të tjera në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, sepse padrejtësisht policët që kryejnë vepra torture përgjigjen sipas Kodit Penal Ushtarak, duke u lehtësuar padrejtësisht pozita e tyre. Si rrjedhojë bie edhe vlera e ndryshimit të nenit 86 të Kodit Penal.

Avokati i Popullit vuri në dukje se ka kritikuar, në rekomandimet dhe në raportet e tij vjetore, Prokurorinë dhe Gjykatat, për rastet, kur nga policia janë dërguar para tyre persona të ndaluar, me shenja të dukshme dhune, dhe në shumë pak raste janë vënë para përgjegjësisë personat përgjegjës. Ne kemi kërkuar në Raportet tona vjetore në Kuvend që të bëhen prononcime kundër torturës nga autoritetet më të larta të Shtetit Shqiptar. Prandaj kemi vlerësuar thirrjet e Kryeministrit Berisha, kundër torturës të bëra në mbledhjet e Qeverisë, apo në konferencat e Policisë së Shtetit. Në vijim të rekomandimit të Komitetit të Këshillit të Europës kundër Torturës (CPT) ne do vazhdojmë të sugjerojmë që të gjitha autoritetet më të larta të Shtetit, Presidenti, Kryeministri, Ministrat e Drejtësisë e të Brendshëm, Prokurori i Përgjithshëm etj, të japin herë pas here mesazhe kundër akteve të torturës dhe për vënien para përgjegjësisë të zyrtarëve që zbatojnë atë. Në vijim të këtij angazhimi, ne kemi kërkuar dhe kërkojmë që të vendoset linja e komunikimit të drejtpërdrejtë nga komisaritet e policisë, në dispozicion të të shoqëruarve dhe të paraburgosurve, jo vetëm me Ministrinë e Brendshme dhe atë të Drejtësisë, por të vendoset edhe me Institucionin e Avokatit të Popullit. Ne gjykojmë se vendosja e kësaj linje do të ndikojë shumë në parandalimin e shkeljeve, sepse do të rriste më shumë edhe mundësinë tonë për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Avokati i Popullit u ka bërë thirrje të gjitha instancave shtetërore të policisë, të burgjeve, të prokurorisë, të gjykatave, shoqërisë civile dhe OJF-ve që të kontribuojnë së bashku për ndërgjegjësimin e publikut shqiptar dhe të administratës publike që punon në këto institucione, për domosdoshmërinë e parandalimit të çdo veprimi apo mosveprimi që cilësohet torturë, me qëllim që Shqipëria të mos përmendet më, në asnjë Raport Ndërkombëtar apo Kombëtar, si vend, ku mund të konstatohet njerëz të torturuar.

Kërkesat kryesore të Protokollit opsional, të detyrueshme për zbatim parashikohen në nenet 17 deri 23 të tij. Kështu sipas nenit 17 të Protokollit “Çdo Shtet Palë mban, emëron ose krijon, jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të këtij protokollit ose të ratifikimit apo të aderimit, një ose disa mekanizma të pavarur, kombëtar parandalues për parandalimin e torturës në nivel kombëtar. Mekanizmat e krijuar si njësi të decentralizuara mund të emërohen si mekanizma kombëtare parandalues për qëllimet e këtij protokollit, nëse ato janë në pajtim me dispozitat e tij”.

Në dispozitat vijuese kërkohet nga shtetet palë që të garantohet pavarësia funksionale dhe e personelit për këtë (këto) mekanizma, vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme (njerëzore dhe financiare) për funksionimin e tyre, dhënien e kompetencave të nevojshme për të realizuar këtë detyrë etj.

Pas Konferencës, më datën 06.09.2007, duke shqyrtuar këto kërkesa të Protokollit, veprimtarinë konkrete 7-vjeçare të institucionit të Avokatit të Popullit për parandalimin, hetimin dhe vënien para përgjegjësisë të personave zyrtarë që kanë

kryer vepra torture, si dhe krahasuar kompetencat e ligjit nr.9094 datë 03.07.2003 me ato të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, të ndryshuar “Për Avokatin e Popullit”, që janë të njëjta, Avokati i Popullit ju drejtua Qeverisë dhe Kuvendit me propozimin për emërimin (ngarkimin me detyrë) të institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e Torturës. Pasi informuam për Konferencën e zhvilluar, në propozim u theksua se:

1. Ngritja e Mekanizmit Kombëtar është detyrim ndërkombëtar dhe kërkesa e ligjit përkatës shqiptar.

2. Në qoftë se do të pajtoheshin me mendimin për të ngarkuar Avokatin e Popullit me këtë detyrë, nuk do të ketë nevojë për të nxjerrë ndonjë ligj të veçantë apo akt të Qeverisë për këtë qëllim. Do të mjaftojë që Kuvendi i Shqipërisë, në Rezolutën që do të përpilojë pasi të shqyrtojë Raportin për veprimtarinë tone gjatë vitit 2007, të na ngarkojë detyrën e Mekanizmit kombëtar për parandalimin e Torturës. Theksuam se aktualisht Avokati i Popullit nuk është penguar dhe faktikisht i ka hetuar rastet e torturës dhe dhunës për të cilat ka patur ankesa, bazuar në ligjin “Për Avokatin e Popullit”. Pra nuk bëhet fjalë për ndonjë “fuqizim me kompetenca” të Avokatit të Popullit, veçse për specifikim të tyre në një fushë tepër të ndjeshme, siç është tortura dhe trajtimi çnjerëzor. Pas kësaj kur bëhet përmirësimi i ligjeve të ndryshme, mund të futet në to edhe Mekanizmi Kombëtar.

3. Për të mos krijuar organizma të reja që rrjedhimisht do të kenë kosto financiare të konsiderueshme për buxhetin e shtetit për paga për personelin, përgatitje dhe kualifikim të tyre, godinë (zyra), mjete pune, etj; detyrat e Mekanizmit t’i ngarkohet Avokatit të Popullit.

4. Për këtë Avokati i Popullit kërkoi vetëm një shtesë personeli prej 5 personash dhe fondin përkatës të pagave nga buxheti i shtetit për vitin 2008 e në vazhdim. Për vitin 2007 institucioni kishte 45 punonjës dhe nuk është i mbingarkuar si organikë. Shtesa prej 5 specialistësh do të quhet Mekanizëm apo “nënseksion” dhe do të shërbejë për të hetuar pa përjashtim gjithë rastet e torturës, për të inspektuar më në gjerësi dhe thellësi gjithë burgjet, dhomat e paraburgimit etj, dhe sidomos për të organizuar dhe zhvilluar më tepër veprimtarinë parandaluese. Për t’i dalë para këtij propozimi, në projekt buxhetin e institucionit tonë për vitin 2008, e kemi nënvizuar këtë kërkesë.

Duke e vlerësuar si realist, Qeveria dhe Kuvendi e kanë miratuar këtë propozim dhe na është miratuar shtesa e personelit prej 5 personash për vitin 2008. Nga buxheti i shtetit për vitin 2008 na është miratuar pjesërisht fondi i pagave. Pas procesit të konkurimit sipas ligjit “Statusi i Nëpunësit Civil”, ky Mekanizëm brenda vitit 2008 do të fillojë veprimtarinë e tij si strukture e posaçme brenda institucionit të Avokatit të Popullit.

7. Bashkepunimi me Organizatat joqeveritare dhe aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2007

Në bazë të nenit 30 dhe 31 të Ligjit nr. 8454 “Për Avokatin e Popullit”, njeri nga tre seksionet e Zyres së Avokatit të Popullit merret edhe me bashkepunimin me Shoqerine Civile, dhe konkretisht me OJF-te që veprojnë në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në kryerjen e funksioneve të veta, Avokati i Popullit bashkëpunon ngushtë me këto organizma joqeveritare, duke marrë në mënyrë periodike mendimet e tyre për gjendjen e të drejtave të njeriut, si dhe organizimin një herë në vit të një veprimtarie kombëtare për një problematike të caktuar që paraqet gjendja e të drejtave

te njeriut ne vend. Per vitin 2007, ky aktivitet, i cilesuar tashme Konference Kombetare, iu kushtua çështjes së tortures duke u ndalur veçanërisht në domosdoshmërinë e parandalimit të çdo veprimi apo mosveprimi që cilesohet torturë, me qellim qe Shqiperia te mos permendet më, në asnje Raport Nderkombetar apo Kombetar, si vend, ku mund te konstatosh njerez te torturuar. Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare te Rehabilitimit te Traumes dhe Tortures.

Krahas ndjekjes së problematikës së përditshme për të shqyrtuar ankesat e qytetarëve, Avokati i Popullit ose përfaqësues të tij, kanë marrë pjesë duke dhënë kontributin e tyre në aktivitete të ndryshme, organizuar nga organizma qeveritare dhe të shoqërisë civile. Ashtu siç kemi theksuar dhe në Raportet Vjetore të mëparshme një gjë e tillë ka qenë dhe mbetet një angazhim sa institucional, aq edhe qytetar i Institucionit të Avokatit të Popullit, për tu investuar dhe thënë fjalën e tij për një problematikë edhe më të gjerë se ajo që paraqitet në statistikat e punës së tij normale.

Më poshtë po ju njohim thjesht me tematikën e këtyre aktiviteteve, që janë organizuar nga partnerë të tjerë dhe ku Institucioni i Avokatit të Popullit ka kontribuar bashkë me grupet e interesit.

1. Tryeza me “Aleancën për fëmijët” për promovimin e raportit të monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët, Mars 2007.
2. Takime të përmuajshme tek UNICEF për analizën e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, Mars-Shtator 2007.
3. Tryezë e Rrumbullakët mbi hartimin e raporteve të projektit, në kuadër të projektit me “Save the Children”, Maj 2007.
4. Pjesëmarrje në tre tryeza periodike pune pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme për përgatitjen e raportit vjetor mbi punën për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI). Në këtë raport janë pasqyruar rastet që ka trajtuar NDF në kuadër të ECRI-it në drejtim të diskriminimit të fëmijëve të komunitetit rom dhe pakicave të tjera kombëtare.
5. Pjesëmarrje në konsorciumin Ndërkombëtar për reformën në sistemin penitenciar, organizuar nga Avokati i Popullit dhe Qendra Shqiptare per Rehabilitimin e Traumas dhe Tortures, Maj 2007.
6. Takim mbi vlerësimin e ecurisë së projektit “Fuqizimi institucional i NDF-së”, me pjesëmarrje të SIDA-s, Avokatit të Popullit Tiranë, Korçe dhe Shkodër, Save the Children, partnere nga shoqëria civile: Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, Instituti i Medias Shqiptare dhe Terres des Hommes, Qershor 2007.
7. Seminar për rregullat themelore urbanistike dhe arkitektonike për Personat me Aftësi të Kufizuara, Qershor 2007.
8. Pjesëmarrje në Seminarin Trajnues për rritjen e kapaciteteve të NDF-se, organizuar në bashkëpunim me NGO Resource Center (Qendra e Kerkimit Burimor) në kuadrin e projektit mbi fuqizimin e NDF-se, Korrik 2007.
9. Pjesëmarrje në Workshopin për rishkrimin në mënyrë feminare të objektivave të NDF-së dhe axhendës për trajnimin e fëmijëve, organizuar nga Save the Children në kuadër të projektit të përbashkët për NDF-ne, Korrik 2007 .
10. Seminar lidhur me të drejtat e fëmijëve, organizuar nga Avokati i Popullit dhe OJF-te per te drejtat e femijeve, Korrik 2007.
11. Konferenca me temë “Forcimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, të rinjve, dhe familjes në Shqipëri”, organizuar nga UNICEF dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Shtator 2007.

12. Tryezë për përfundimin e Studimit “Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijëve”, organizuar nga Save the Children dhe Qendra e Shëbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, Tetor 2007.
13. Pjesëmarrje aktive në Konferencën mbi “Fëmijët e Humbur dhe të Shfrytëzuar”, Tetor 2007.
14. Pjesëmarrje në aktivitetet e zhvilluara me rastin e Ditës së Personave me Aftësi të Kufizuara, Dhjetor 2007.
15. Seancë dëgjimore në Entin Rregullator të Energjisë për të diskutuar për propozimin e KESH sha për rritjen e çmimit të energjisë elektrike, Nëntor 2007.
16. Trajnim me temë “Drejtësia, liria dhe siguria, çështje dhe perspektiva” nga Instituti European i Administratës Publike në bashkëpunim me Ministrinë e Integritit, Dhjetor 2007.

Në të gjitha këto aktivitete dhe të tjera, Institucioni i Avokatit të Popullit ka promovuar rolin, kompetencat dhe juridiksionin e tij në ndërveprimin me institucionet e tjera shtetërore dhe ato të shoqërisë civile. Problematika e diskutuar në to na ka ndihmuar në sqarimin e pozicioneve të ndryshme, në të cilat ndodhemi, në raport me instancat të cilave u drejtohem, nisur nga ankesat konkrete që vijnë pranë zyrës tonë. Kjo pjesëmarrje aktive do të vazhdojë edhe në të ardhmen, pasi bashkëpunimin me organet e administratës publike si dhe me organizmat e shoqërisë civile e shohim si domosdoshmëri për perfeksionimin e mëtejshëm të punës tonë.

K R E U III

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet, të grupuara sipas institucioneve qeveritare

1. Këshilli i Ministrave (Qeveria)

Në zbatim të detyrës së tij kryesore, mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, ne kemi patur ankesa, kërkesa apo njoftime për të cilat është dashur vënia në lëvizje e Qeverisë. Prandaj Avokati i Popullit ka informuar, rekomanduar apo i ka bërë propozime Kryeministrit dhe ministrave për të gjitha çështjet kryesore që kanë dalë gjatë punës së tij dhe që është dashur angazhimi i tyre. Pavarësisht nga forma në të cilën janë paraqitur çështjet e ngritura mendojmë se, në një tërësi ose pjesë të mënyrës, ato kanë ndikuar në rritjen e standarteve në favor të mirëqeverisjes, dhe të performancës së ekzekutivit shqiptar.

Nga janari deri në dhjetor 2007, Qeverisë, të kryesuar nga kryeministri, zoti Sali Berisha, i kemi dërguar zyrtarisht këto rekomandime, propozime apo informacione:

1. Informacion drejtuar Kryeministrit për marrjen e masave për zbatimin e konventave ndërkombëtare, ligjeve dhe akteve nënligjore të njohura nga shteti shqiptar për trajtimin e të burgosurve, për të parandaluar rastet e dhunës ndaj tyre, dërguar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Ministrit të Drejtësisë më datën 25.01.2007.

2. Informacion për përsëritjen e rekomandimit për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.1820 datë 21.04.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë në favor të qytetarit Rexhep Rama, drejtuar më 18.01.2007 Ministrit të Financave, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave dhe Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Ky vendim gjyqësor u ekzekutua pas investimit të vetë kryeministrit, zotit Berisha për këtë çështje.

3. Rekomandimet për detyrat që dalin për të gjitha organet shtetërore në zbatim të Konferencës Kombëtare të organizuar nga Avokati i Popullit me temë: “Të drejta dhe dinjitet të barabartë për Personat me Aftësi të Kufizuar” dërguar më datën 29.01.2007.

4. Informacion më datën 01.02.2007 për Rekomandimin drejtuar Kryetarit të Komunës Paskuqan për marrjen e menjëhershme të masave të nevojshme për rishikimin dhe plotësimin e listave paraprake të zgjedhësve, për zgjedhjet e 18 shkurtit 2007. Më datën 09.02.2007 është dërguar edhe informacioni për situatën më të fundit të listave të zgjedhësve në Komunën e Paskuqanit.

5. Informacion më datën 15.02.2007 për Rekomandimin për zbatimin direct të nenit 45, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për lejimin e të burgosurve për të votuar në zgjedhjet lokale të 18 shkurtit 2007 drejtuar Ministrit të Drejtësisë, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

6. Informacion më datën 19.02.2007 për Rekomandimin që të ndërmerret iniciativa për shfuqizimin e dispozitave të Kodit Penal ushtarak që përmbajnë dënimin me vdekje në gjendje lufte apo situatë të jashtëzakonshme, në zbatim të Protokollit 13 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, dërguar Ministrin të Drejtësisë.

7. Informacion për Rekomandimin e datës 07.03.2007, drejtuar Ministrin të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, për miratimin e shpejtë dhe vënien në zbatim të projektit konçensionar të Shoqërisë “Remi sh.p.k., duke rivendosur në vend të drejtat e ligjshme të këtij subjekti.

8. Informacion më datën 13.03.2007 për Rekomandimin që të hartohet dhe paraqitet për miratim pranë Këshillit të Ministrave projekt-vendimi mbi kriteret liçensuese të ekspertëve të dëmeve, si detyrim që buron nga Neni 89 i Ligjit nr.9267, dt.29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, dërguar Kryetares së Agjencisë së Mbikqyrjes Financiare.

9. Rekomandim më datën 03.04.2007 drejtuar Kryeministrit dhe Ministrin të Drejtësisë për përgatitjen e ligjit për ngritjen e një autoriteti mbikqyrës të pavarur, përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri.

10. Rekomandim më datën 23.04.2007 për një ndryshim në përcaktimin e grupimit të personave që përfitojnë statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, më VKM-në nr.619 datë 07.09.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.31 datë 20.01.2001, “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, dërguar Kryeministrit dhe ministrin të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

11. Informacion i datën 25.04.2007 drejtuar Kryeministrit për marrjen e masave për të vendosur në pozita të ligjshme veprimtarinë e Kesh sha, në kuadër të përmirësimit të mënyrës së matjes së konsumit të energjisë elektrike, drejtuar Kryetarit të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, dhe Drejtorit të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare Kesh sha.

12. Informacion më datën 04.05.2007 për angazhimin e Qeverisë për respektimin e të drejtave të të dënuarve dhe përmirësimin e kushteve në burgje dhe në vendet e paraburgimit.

13. Informacion drejtuar Kryeministrit më datën 25.05.2007 për Rekomandimin për marrjen e masave të menjëhershme për shpronësimin për interes publik të pronarëve që janë prekur nga ndërtimi i linjës 110 kv Zemblak-Korçë, drejtuar Ministrin të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, dhe Drejtorit të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare Kesh sha.

14. Rekomandim më datën 29.06.2007 drejtuar Kryeministrit dhe Ministrin të Financave për marrjen e masave për lejimin e transportit të mallrave nëpërmjet doganës në Pikën Kufitare të Qafë Morinës, Tropojë, si veprim që nxit zhvillimin ekonomik dhe lehtëson shkëmbimet tregtare të banorëve të zones.

15. Rekomandim më datën 04.07.2007 për fillimin e ushtrimit të detyrës nga Njësia Ad-hoc, “Për shqyrtimin e dosjeve të prapambetura të Komisionit Qëndror të Dëshmorëve të Atdheut”, sipas Vendimit nr.54 datë 31.01.2007 të Këshillit të Ministrave, drejtuar zv.kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Më datën 18.12.2007 është kërkuar që Komisioni të shqyrtojë edhe dosjet e prapambetura.

16. Informacion më datën 13.07.2007 për trajtimin në vazhdim të çështjes së dëmshpërblimit të kërkuar nga ish punonjësit e Ambasadës Shqiptare në Beograd drejtuar Ministrin të Punëve të Jashtme.

17. Dërgohet më datë 16.07.2007 Rekomandimi i Avokatit të Popullit Nr.177 datë 13.06.2006 “Për Miratimin e Rregullores Tip për të Drejtën e Informimit” drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

18. Dërgohet më date 16.07.2007 Rekomandimi i Avokatit të Popullit Nr.160 datë 05.06.2007 “Për Miratimin e Rregullores Tip “Për shqyrtimin e ankimeve administrative (RTAA)”, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, si dhe gjithë organeve të Administratës Publike shqiptare.

19. Rekomandim më datën 17.07.2007 për marrjen e masave të menjëhershme për botimin në Fletoren Zyrtare të Vendimit të Këshillit të ministrave Nr.565, dt.09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Ministrit të Financave, Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

20. Informacion më datën 26.07.2007 për marrjen e masave për përmirësimin e shërbimit shëndetësor psikiatrik në shkallë vendi, për ta standartizuar atë me kushte të pranueshme dhe ligjore, drejtuar Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta.

21. Rekomandim më datën 31.07.2007 për domosdoshmërinë e dublimit të rrugës së Plazhit, Plepa – Mali i Robit, Kavajë drejtuar Kryeministrit dhe Ministrit të Transportit dhe Punëve Publike.

22. Informacion më datën 31.07.2007 për Rekomandimin për plotësimin e kërkesave të Nenit 401 të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë për hartimin dhe kalimin për miratim në Këshillin e Ministrave të disa vendimeve të veçanta me karakter ndërministerial, drejtuar Ministrit të Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacioneve, Ministrit të Financave, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Mbrojtjes, Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

23. Informacion më datën 31.07.2007 për Rekomandimin për fillimin e inspektimit për shërbimin e transportit detar të udhëtarëve që ofrohet nga tragetet e huaja, drejtuar Ministrit të Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacioneve.

24. Më datën 04.09.2007 përsëritet rekomandimi drejtuar Kryeministrit për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.9389 datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në Luftën Kundër Gjakmarrjes”.

25. Propozimi më datën 06.09.2007 për emërimin (ngarkimin me detyrë) të institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

26. Informacion më datën 20.09.2007 drejtuar kryeministrit për Rekomandimin drejtuar Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta për të ndërmarrë iniciativën për miratimin e projektligjit “Për statusin e personave në aftësi të kufizuar”.

27. Informacion më date 02.11.2007 për Rekomandimin për përmirësimin e shërbimit të sinjalit televiziv të TVSH-së në disa zona të largëta të vendit dhe eliminimi i dukurive negative që kanë krijuar anomaly në terren, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH dhe Ministrit të Brendshëm.

28. Informacion i dates 09.11.2007 për Rekomandimin për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Këshillit të Komunës Gosë, Kavajë nr.8, date 18.05.2007, lidhur me zgjidhjen e kryesive dhe kryetarëve të fshatrave të kësaj komune dhe marrja e vendimit dhe të masave të nevojshme për zhvillimin e procesit zgjedhor në përputhje me ligjin, drejtuar Këshillit të Komunës Gosë – Kavajë.

29. Informacion i dates 20.11.2007 drejtuar Kryeministrit me anë të të cilit rekomandohet nisma ligjore për përfshirjen e rreth 400 familjeve të zones së Berdeneshit Sarandë brenda territorit administrativ të një njësie vendore, drejtuar Ministrit të Brendshëm.

30. Përsëritje e Rekomandimit më datën 05.12.2007 për lidhjen në një kohë sa më të shpejtë të marrëveshjeve me bashkësitë fetare, në zbatim të nenit 10 të Kushtetutës.

31. Rekomandimi më date 05.12.2007 për të përgatitur një projektligj për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, drejtuar Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm.

Nga të dhënat e mësipërme del se Qeveria shqiptare është informuar për mjaft probleme që ka hasur gjatë veprimtarisë së tij institucioni i Avokatit të Popullit, por që lidhen në mënyrë të pazgjidhshme edhe me objektivat e saj që janë mirëqeverisja dhe lufta kundër korrupsionit. Në përgjithësi rekomandimet tona janë mirëpritur dhe nga Qeveria ka patur mirëkuptim për t’u marrë me problemet dhe impenjim për t’i zgjidhur ato. Kjo shihet edhe në rezultatet e pasqyruara për rekomandimet legislative që ka paraqitur Avokati i Popullit dhe që ndodhen në Kreun e katërt të këtij Raporti.

*
* *
*

Gjatë vitit 2007 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur **25** ankesa për Qeverinë. Objekt kryesor i ankesave për Qeverinë ka qenë përfitimi i pensioneve të posaçme, trajtimi i veçantë i familjeve të punonjësve të policisë të rënë në krye të detyrës para vitit 1997, kërkesa të sindikatave për trajtim më të mirë financiar, kërkesa të shoqatës së pensionistëve për rritje pensioni, apo të individëve që kërkojnë pensione të posaçme etj.

Avokati i Popullit është përpjekur në çdo rast që ankesat e ardhura në adresë të tij, megjithëse në shumë raste jashtë juridiksionit dhe kompetencave, të gjejnë një përgjigje dhe sqarim të shpejtë. Kjo pasi shpesh kërkesat e individëve ndaj Qeverisë janë në diskrecion për zgjidhje nga vetë Qeveria dhe nuk mund të kërkohet nga Qeveria plotësim i tyre, pa qënë detyrimi në ligje të posaçme.

Gjithsesi ne kemi patur gjithmonë në konsideratë për të trajtuar me seriozitet ato raste, kur gjatë këtyre procedurave nuk janë respektuar afatet apo detyrimet e tjera për transparence ndaj te drejtave të individëve. Ky ka qenë edhe thelbi i ndërhyrjeve tona, sepse për raste të tjera, nuk mund të ndërhyhej duke shprehur thjesht opinione të qytetarëve për politika të caktuara qeveritare. Megjithatë siç kemi thenë edhe në Raportet e shkuara, konstatohet se administrata e Këshillit të Ministrave nuk u jep përgjigje shtetasve brenda afateve ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative apo në Ligjin “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentat Zyrtarë”. Ky ka qenë në disa raste shkak për ankesa dhe ka pasqyruar mungesë transparence nga aparati i Këshillit të Ministrave.

Vlerësohet pozitivisht se Qeveria ka një faqe interneti tepër informative dhe të përditësuar për veprimtarinë e saj, por kujdes duhet të tregohet edhe për përgjigjet ndaj kërkesave apo ankesave të individëve.

Si përfundim mund të themi se pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Asociim-Stabilizimit në qershor 2006 është shënuar përparim në një numër çështjesh që kanë të bëjnë me sistemin politik, funksionimin e demokracisë dhe të ekonomisë së tregut. Por përmbushja e angazhimeve të Shqipërisë nuk ka ecur me të njëjtin ritëm. Përmbushja e kriterëve të tilla si përfundimi i reformës zgjedhore dhe asaj

infrastrukturore e administrative në mbështetje të sistemit zgjedhor, reformimi i sistemit të gjendjes civile, reformimi i sistemit të adresave, pajisja e qytetarëve shqiptarë me dokumente identiteti me nivel të lartë sigurie, reformimi i sistemit të drejtësisë, decentralizimi, reforma në administratën publike, politikat bujqësore dhe mjedisore janë disa nga sektoret ku vihet re se nuk është shënuar përparimi i kërkuar.

Aktorë të shoqërisë civile dhe përfaqësues të medias dhe grupeve të interesit kanë dhënë ndihmën e vet me parashtrimin e opinioneve dhe mendimeve juridike për projektligje të ndryshme, nëpërmjet organizimit të tryezave, konferencave të shtypit, deklaratave publike, letrave të hapura, seancave dëgjimore në komisionet parlamentare etj. Në disa raste shoqëria civile si dhe Avokati i Popullit ia ka dale të ndikojë në cilësinë e ligjeve dhe të nismave. Megjithatë duhet theksuar se detyrimi kushtetues për t'u konsultuar me grupet e interesit përpara ndërmarrjes së një nisme, mbetet një praktikë që duhet zbatuar më shumë në jetën publike shqiptare.

Qeveria, ashtu si dhe Kuvendi i Shqipërisë duhet të ketë më mire parasysh Rekomandimin REC (2004) 5 të Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtarë për kontrollin e pajtueshmërisë së projektligjeve, akteve ligjore ekzistuese dhe praktikës administrative me standartet e përcaktuara në Konventën Europiane për të drejtat e Njeriut, miratuar më 12 maj 2004. Ky Rekomandim është botuar në Fletoren tone Zyrtare nr. ekstra, në korrik 2007 dhe ka mjaft detyra për legjislativin, ekzekutivin, institucionet gjyqësore dhe ato të pavarura, përfshirë edhe Avokatin e Popullit.

a. Instituti i Integritit të të Përndjekurve Politikë (IIPP)

Gjatë vitit 2007, nga ish të burgosurit politikë ka patur ankesa si ndaj Institutit të Integritit të të Përndjekurve Politikë (IIPP) dhe Qeverisë Në këto ankesa ish të burgosurit politikë pretendojnë vazhdimisht se Instituti i Integritit të të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë në bashkëpunim me disa shoqata kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë shumë abuzime me fondet e dhëna nga shteti shqiptar për ish të burgosurit dhe të përndjekurit politikë.

Një problem shqetësues, i paraqitur nga ish të përndjekurit politikë është ai i mospërfitimit të statusit të të përndjekurit politik. Ky problem prek rreth 500 persona që presin të fitojnë statusin e ish të përndjekurit politik, dhe që nëpërmjet statusit, pretendojnë të përfitojnë të gjitha benefitet që mund të përfitohen prej zotërimit të tij. Kjo si pasojë e mosfunksionimit të Komisionit Shtetëror Trepalësh si organi kompetent për dhënien e së drejtës së Statusit të ish të Përndjekurit Politik. Ky komision ka funksionuar gjatë periudhës Nëntor 1993-Korrik 1997. Më pas edhe pse ka qenë detyrim ligjor ekzistenca e tij, ky funksionim është ndërprerë. Ndaj në kuadër të një prej detyrave të tij, asaj të mirëfunksionimit të administratës publike, Institucioni i Avokatit të Popullit që në mars 2005 i ka rekomanduar ish Zv.Kryeministrit përsheptimin e procedurave për ngritjen e Komisionit Tre Palësh si organ kompetent për dhënien e së drejtës së Statusit të ish të Përndjekurit Politik dhe nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 1 dhe 2 të Ligjit. Nr.9260, datë 15.07.2004 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” i ndryshuar. Këtë rekomandim ia kemi dërguar dhe Qeverisë të drejtuar nga Kryeministri Z.Sali Berisha. Por zgjidhja përfundimtare e kësaj çështje nuk është arritur akoma.

2. Ministria e Drejtësisë

Gjatë vitit 2007 janë trajtuar gjithsej 510 ankesa e kërkesa që kanë të bëjnë me autoritete në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, e konkretisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Zyrat e Përmbarrimit, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, Agjensinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish Pronarëve etj.

A. Ankesat për burgjet, paraburgimet dhe administratën e burgjeve

Në lidhje me burgjet dhe personelin e burgjeve kemi patur 98 ankesa. Burgjet janë institucione të mbyllura dhe liria në të gjitha shprehjet e saj është e kufizuar dhe të drejtat e të burgosurve mund të shkelen më lehtë. Ne kemi mbajtur gjithmonë parasysh thënien e ish të burgosurit të famshëm dhe ish Presidentit të Afrikës së Jugut Nelson Mandela që ka thënë: “Thuhet se askush nuk e njeh me të vërtetë një komb, pa u futur njëherë brenda burgjeve të tija. Një komb nuk duhet të gjykohet nga mënyra si i trajton qytetarët e tij shembullorë, por ata më të këqijtë”. Prandaj, ankesave nga këta persona ju është kushtuar dhe do t’u kushtohet vëmendje e veçantë nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Gjatë vitit 2007, punonjës të stafit të Avokatit të Popullit kanë vizituar të gjitha burgjet dhe paraburgimet që tashmë janë të gjitha në vartësinë e Ministrisë së Drejtësisë, ashtu si dhe dhomat e shoqërimit dhe të ndalimit të komisariateve të policisë në rrethe. Në fund të vitit 2007 ka patur 4554 të burgosur dhe të paraburgosur në burgjet dhe paraburgimet e sistemit shqiptar të burgjeve, ndërkohë që kapaciteti i tyre është për 3616 të burgosur, pra kanë qenë 938 të burgosur mbi kapacitetin. Duke qenë se në fund të vitit 2006 ishin 4566 persona në burgje, për vitin 2007 janë 12 persona më pak se viti 2006.

Gjatë vizitave në këto institucione janë takuar personalisht 327 të dënuar apo të paraburgosur. Në 98 raste ankesat e të dënuarve janë bërë me shkrim.

Kalimi i plotë i të gjitha paraburgimeve në vartësinë e Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, megjithë problemet që e shoqëruan, është një hap pozitiv i Qeverisë, i cili ka ndikuar dhe do të ndikojë mjaft në parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në vendin tonë. Ky hap pozitiv solli edhe një problem shumë delikat siç është mbipopullimi i burgjeve dhe paraburgimeve.

Gjatë vitit 2007 gjithsej janë ankuar 146 persona, ku përfshihen të burgosur, familjarë të tyre apo personel i administratës së burgjeve për çështje që lidhen me administratën gjyqësore, të prokurorisë dhe burgjeve.

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2007 ka bërë inspektime të vazhdueshme në të gjitha paraburgimet dhe burgjet e sistemit shqiptar të burgjeve, në dhomat e shoqërimit dhe të ndalimit në komisariatet e policisë si dhe në Qendrën Spitalore të Burgjeve, për të parë nga afër zbatueshmërinë e Ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, të “Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, dhe “Rregulloreve të Brendshme të Burgjeve” etj.

Në Shqipëri, nga njëri vit në tjetrin vjen duke u rritur dhe konsoliduar interesi i publikut në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të burgosurve dhe të paraburgosurve. Edhe në vitin 2007 të burgosurve ju është ardhur në ndihmë nëpërmjet linjës telefonike Nr.08001111 që funksionon falas për ankesat e tyre. Është verifikuar disa herë dhe ka rezultuar se ajo ka funksionuar rregullisht. Në disa raste (që janë përfshirë në numrin përgjithshëm të ankesave) të burgosurit i kanë paraqitur ankesat nëpërmjet telefonit që është vendosur në dispozicion të tyre. Edhe gjatë vitit 2007 ka patur shumë ankesa nga të burgosurit se nuk janë lejuar nga administrata e

burgjeve të marrin në telefon Avokatin e Popullit dhe se ju është penguar korrespondenca me Avokatin e Popullit. Shpeshherë letrat e nisura nga të burgosurit nuk kanë arritur pranë Institucionit të Avokatit të Popullit.

Të ndarë sipas burgjeve, gjëndja e ankesave paraqitet si më poshtë:

1. Paraburgimi “Jordan Misja”	Tiranë	ankuar	6 persona
2. Paraburgimi “Mine Peza”	Tiranë	ankuar	3 persona
3. Burgu “Ali Demi”	Tiranë	ankuar	9 persona
4. Burgu i Lushnjës		ankuar	3 persona
5. Burgu i Tepelenës		ankuar	4 persona
6. Burgu i Burrelit		ankuar	8 persona
7. Burgu i Vaqarrit		ankuar	14 persona
8. Spitali burgjeve		ankuar	3 persona
9. Burgu i Rrogozhinës		ankuar	11 persona
10. Burgu i Lezhës		ankuar	9 persona
11. Burgu i Krujës		ankuar	3 persona
12. Burgu i Peqinit		ankuar	2 persona
14. Paraburgimi Durrës		ankuar	0 persona
15. Paraburgimi Kukës		ankuar	2 persona
16. Paraburgimi Sarandë		ankuar	0 persona
17. Paraburgimi Korçë		ankuar	0 persona
18. Parburgimi Tropojë		ankuar	2 persona
19. Paraburgimi Berat		ankuar	0 persona
20. Nga burgjet jashtë vëndit		ankuar	2 persona

Në këtë numër nuk janë përfshirë ankesat apo kërkesat me shkrim të familjarëve të burgosurve si dhe kërkesa apo njoftime të tjera që janë paraqitur nga drejtoritë e burgjeve, komisariatet e policisë në rrethe, punonjës të administratës së burgjeve dhe të policisë së burgjeve.

Të ndarë sipas gjinisë, në 98 raste kanë bërë ankesë burrat, në 9 raste gratë dhe në rastet e tjera ankesat apo kërkesat janë dërguar nga drejtoritë e burgjeve, komisariatet e policisë në rrethe apo familjarët e të burgosurve dhe të paraburgosurve.

Sipas mënyrës së përfundimit ankesat paraqiten si vijon:

Për vitin 2007 janë përfunduar 137 ankesa apo kërkesa të ardhura me shkrim, nga 146 të ardhura gjithësej, ndërsa janë në shqyrtim 9 çështje.

Nga këto 31 ose 24. % prej tyre janë zgjidhur në favor, 74 kanë qenë jashtë juridiksioni dhe kompetencës, 32 janë konsideruar si të padrejta apo të pabazuara në ligj.

**GJENDJA NË BURGJE DHE PARABURGIME
MË DATË 31.12.2007**

Nr.	Institucioni	TE DENUAR											
		Burra				Gra		Te mitur		Te semure mendore	shuma	Kapaciteti	Mbipopullimi
		Siguri e larte	Siguri e zakonshme	Organizim pashprehur	Te paraburgosur	Te denuara	Te paraburgosura	Te denuar	Te paraburgosur				
1	P/burg "Jordan Misja"				388		53		23		464	395	69
2	P/burg Vlore		10		75				8		83	46	37
3	P/burg "M.Peza"		3		218						221	182	39
4	I.E.D.P. Lezhe		455		152				29		636	528	108
5	I.E.D.P. Burrel	179	37	14	41				2		273	195	78
6	I.E.D.P. Tepelene	57	3	2	61						123	105	18
7	I.E.D.P. Peqin	376	387	26	97						886	700	186
8	I.E.D.P. Lushnje		307	6							313	240	73
9	I.E.D.P. Vaqarr		186					9			195	150	45
10	I.E.D.P. Rrogozhine	2	274	6	195				15		490	380	110
11	I.E.D.P. Ali Demi		119			83					202	140	62
12	I.V. Kruje		167		21						188	200	-12
13	Spitali i Burgjeve		8		45	1	2		1	73	129	80	49
14	P/burg Durres		7		128				12		147	80	67
15	P/burg Kukes				7				1		8	44	36
16	P/burg Sarande				25				2		27	30	-3
17	P/burg Korçe		4		88				4		96	45	51
18	P/burg Tropoje				33						33	26	7
19	P/burg Berat				39				1		40	50	-10
	SHUMA	612	1957	54	1613	84	55	9	97	73	4554	3616	938

Duke bërë grupimin sipas natyrës së ankesave rezulton:

1. Ankesa për mbipopullimin e burgjeve.

Mjaft të burgosur janë ankuar se mbahen padrejtësisht në dhomat e izolimit të komisariateve të policisë, megjithëse gjykatat kanë vendosur si masë sigurimi ndaj tyre "arrestin në burg". Ata kanë pretenduar se ju është shkelur e drejta e njohur nga neni 462 i K.Pr.Penale që urdhëron ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit të gjykatës.

Numri i ankesave të kësaj natyre për vitin që raportojmë në krahasim me vitin 2006 është më i vogël. Për rastet konkrete të të dënuarve që kanë bërë ankesat me shkrim pranë zyrës së Avokatit të Popullit, ne kemi ndërhyrë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që ata të dërgohen sa më parë në paraburgimet në vartësinë e Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve. Si rrjedhojë ata janë transferuar nga dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë për në sistemin e burgjeve dhe të paraburgimeve.

Siç u theksua edhe më lart një nga problemet kryesore në sistemin tonë të burgjeve mbetet niveli i mbipopullimit. Kjo gjendje rëndon më shumë të paraburgosurit dhe personat që presin gjykimin. Mbiipopullimi mund të konsiderohet si trajtim çnjerëzor në shumë burgje dhe paraburgime.

Më i mbingarkuar është Burgu i Peqinit me 186 të burgosur. Burgu i Rrogozhinës me 110 të burgosur. Burgu i Lezhës me 108 të burgosur. Burgu i Burrelit me 78 të burgosur. Paraburgimi “Jordan Misja” në Tiranë me 69 të paraburgosur. Paraburgimi i Durrësit me 67 të paraburgosur. Qendra Spitalore e Burgjeve me 49 të burgosur. Paraburgimi “Mine Peza” me 39 të paraburgosur dhe Paraburgimi i Vlorës me 37 të paraburgosur mbi kapacitetin.

Problemi i mbipopullimit të burgjeve nuk mund të zgjidhet vetëm duke ndërtuar burgje të reja. Më shumë rëndësi duhet t’i jepet në radhë të parë punës parandaluese që duhet të bëjë gjithë shoqëria dhe shteti Shqiptar, dhe së dyti prokuroritë dhe gjykatat duhet të bëjnë një politikë më të drejtë në zbatimin e masave alternative të sigurimit dhe dënimit. Prokurorët duhet të jenë më racionalë, jo çdo gjë duhet të zgjidhet me burgim. Kufizimi i lirisë është një masë ekstreme, e cila duhet të jepet dhe të përdoret vetëm nëse masa të tjera alternative do të ishin pa vënd për shkak të rrezikshmërisë së krimit të kryer dhe autorit. Këto janë rekomandime të përsëritura jo vetëm të Avokatit të Popullit, por edhe të organizmave ndërkombëtare që merren me këto probleme.

**INFORMACION MBI GJENDJEN DHE PËRBËRJEN E TË
DENUARVE PËR MUAJIN DHJETOR 2007**

Emërtimi	MOSHA								LLOJI I VEPRËS PENALE														
	Nën 18 vjeç	18<21 vjeç	21<30 vjeç	30<40 vjeç	40<50 vjeç	50<60 vjeç	Mbi 60 vjeç	Shuma.	Vjedhje me dhunë	Vjedhje	Vrasje	Plagosje	Marr Seks	K/vajtje	Droga	Të tjera	0<1 vjet	1<2 vjet	2<5 vjet	5<15 vjet	15<20 vjet	20<25 vjet	Per jete
Burgu 313		1		2		2		5		2			1					1	3	1			
I.R.325 (B)		10	35	37	31	3	2	118	16	30	7	4	5	1	33	22	21	24	46	25	1	1	
I.R.325(G)		4	20	23	29	5	3	84		8	51		2		5	18	6	5	10	39	19	5	
I.R.Lushnj		10	97	130	49	36	9	331	24	28	111	7	8	2	97	54	2	19	65	161	45	38	
B. Burrel		5	91	77	42	14	16	245	64	2	157	4	3		4	11	2		11	94	62	39	38
B.Tepelen			21	36	11	2		70		17	38		4		3	8	3	1	2	14	13	20	16
B. Vaqarr	11	9	51	82	24	8	1	186	31	11	74	2	9		51	8	10	2	23	94	42	15	
B. 302			4	2	6			12	2	1	8	1						3		3	3	3	
B. Rrogzhinë		20	134	79	49	19	4	305	45	12	87	6	9		58	88	1	8	47	208	32	9	
B. Kruje		4	37	52	23	20	47	183	21	5	126	2	10	1	10	8		6	13	102	40	21	1
B. Peqin		33	321	263	113	48	13	791	71	80	407	13	25		92	103	7	11	69	343	164	130	67
B. Lezhe		28	155	163	23	65	26	460	134	93	72	39	33	30	43	16	68	77	142	153	21		
Shuma	11	124	966	946	400	222	121	2790	408	289	1138	78	109	34	398	336	120	157	431	1237	442	281	122

2. Të sëmurë mendorë që mbahen ende padrejtësisht në Spitalin e Burgjeve

Të burgosurit dhe të paraburgosurit gëzojnë të drejtën themelore për të gëzuar shëndet të mirë, si mendor ashtu edhe fizik, si dhe vazhdojnë të gëzojnë të drejtën për të gëzuar kujdes shëndetësor në një standart që është të paktën në nivelin e standartit që i sigurohet komunitetit të gjërë. Pakti ndërkombëtar “Për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore” (neni 12) përcakton:

“Kushdo ka të drejtë për të gëzuar në standartet maksimale të mundshme shëndet mendor dhe fizik”.

Përveç të drejtave themelore që gëzojnë të gjithë personat, të burgosurit gëzojnë edhe disa të tjera për shkak të statusit të tyre. Kur shteti u heq njerëzve lirinë, merr përsipër përgjegjësinë të kujdeset për shëndetin e tyre si në lidhje me kushtet në të cilat i mban ata, ashtu edhe në lidhje me trajtimin individual që mund të jetë i nevojshëm si rezultat i këtyre kushteve.

Shëndeti i mirë është shumë i rëndësishëm për këdo. Ai ka një rëndësi jashtëzakonisht të veçantë në komunitetet e mbyllura të burgjeve dhe paraburgimeve. Për nga natyra, kushtet në burg mund të kenë ndikim dëmtes, si në mirëqenien mendore, ashtu edhe atë fizike të të burgosurve. Për këtë administrata e burgjeve ka përgjegjësi jo thjesht të sigurojë kujdes mjekësor, por edhe të krijojë kushte që promovojnë mirëqenien si të të burgosurve, ashtu edhe të personelit të burgjeve. Të burgosurit nuk duhet të largohen nga burgu në gjëndje më të keqe se ajo që kishin kur u futën në burg. Kjo duhet të zbatohet për të gjitha aspektet e jetës në burg e veçanërisht për shëndetin. Në vendin tonë përdorimi në rritje i dënimeve me kohë të gjatë apo të përjetshme po çon në një shtim të problemeve shëndetësore që lidhen me moshën në popullsinë e burgjeve. Kjo kërkon nga administrata e burgjeve që të bëjë planifikimet e duhura për problemet shëndetësore, aq më tepër që vendi ynë ka vështirësi të mëdha për të siguruar kujdes shëndetësor të standarteve të larta për popullsinë në përgjithësi. Edhe në këto rrethana të burgosurit kanë të drejtë dhe duhet të gëzojnë kujdesin më të madh të mundshëm shëndetësor dhe pa pagesë. Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës (CPT) ka deklaruar që edhe në periudha të vështirësive të mëdha ekonomike, asgjë nuk mund ta justifikojë shtetin të mos përmbushë përgjegjësinë për t’u siguruar kushtet bazë të jetës atyre të cilëve ai u ka hequr lirinë. KEPT-ja, gjithashtu, e ka bërë të qartë që kushtet bazë të jetesës përfshijnë edhe paisjet dhe medikamentet e përshtatshme dhe të mjaftueshme shëndetësore. Në zbatim të këtyre rekomandimeve, administrata e burgjeve duhet të plotesojë parasëgjithash të gjitha burgjet e vendit me personelin e nevojshëm dhe sipas profilit të shërbimit shëndetësor. Sidomos kjo në Burgun e Krujës, ku vuajnë denimin të denuar me probleme të rënda të shëndetit mendor dhe të denuar të moshave të vjetra.

Edhe në vitin 2007, problemi i personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjeksore të “mjekimit të detyruar” nuk ka marrë ende zgjidhje. Në Dhjetor të vitit 2007 specialistë të zyrës së Avokatit të Popullit kanë bërë inspektim në Spitalin e Burgjeve për të parë gjëndjen e të sëmurëve mendorë për të cilët gjykatat kanë marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar dhe padrejtësisht mbahen në kushte burgimi.

Gjatë këtij inspektimi, me gjithë përparimet e bëra në drejtim të zbatimit të një sërë dokumentesh kombëtare dhe ndërkombëtare që trajtojnë në mënyrë

specifike problemet e të burgosurve dhe të paraburgosurve, u konstatuan edhe mangësi serioze.

Në nenin 42 të Ligjit Nr.8092, dt. 03.02.1996 “Për Shëndetin Mendor” përcaktohet se: “Masat e sigurimit për personat e përmendur në nenin 41 merren nga organet e ngarkuara për ruajtjen e tyre sipas Rregullores së miratuar nga Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shëndetësisë”. Me këtë dispozitë ligji ka përcaktuar detyrimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Shëndetësisë për të miratuar rregulloren e masave të sigurimit për personat që kanë kryer vepra penale dhe gjykata ka vendosur ndaj tyre masën mjekësore “mjekim të detyruar” në një institucion psikiatrik.

Por megjithëse kanë kaluar rreth 12 vjet nga dita kur ka hyrë në fuqi Ligji Nr.8092, dt. 21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor”, një rregullore e tillë akoma nuk është miratuar, ndonëse Avokati i Popullit ka 8 vjet që çdo vit bën këtë rekomandim.

Në dhjetor 2007, në Qendrën Spitalore të Burgjeve, ndër të tjera, u konstatua se atje ndodheshin 76 persona, të cilët kanë kryer vepra të ndryshme penale dhe gjykata ka vendosur ndaj tyre masën mjekësore “mjekim të detyruar” në një institucion psikiatrik. Por këta persona mbahen atje në kundërshtim të hapur me nenin 45 (ekzekutimi i masës mjekësore) të Ligjit Nr.8331, dt. 21.04.1998 “Për ekzekutimin e Vendimeve Penale” ku përcaktohet se: “Masa mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet në institucionin mjekësor të specializuar sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë mbi kërkesën e Prokurorit”. Kjo, sepse Qendra Spitalore e Burgjeve është burg dhe jo institucion mjekësor i specializuar.

Ky trajtim është në kundërshtim edhe me nenin 28 paragrafi i 5-të të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton se: “Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij”, si dhe ka lënë shteg për të abuzuar në drejtim të kërkesave ligjore për të drejtat e liritë e këtyre personave. Duke i mbajtur në kushte burgu ata dëmtohen edhe më tepër nga ana mendore. Ky është një problem që ka rreth 8 vite që ngrihet vazhdimisht nga Institucioni i Avokatit të Popullit, por që nuk ka gjetur zgjidhje.

Gjatë inspektimit në Qendrën Spitalore të Burgjeve u konstatua edhe një shkelje e rëndë e nenit 46 të Kodit Penal ku ndër të tjera thuhet: “Vendimi gjyqësor për masat mjekësore dhe edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë, por në çdo rast, gjykata, kryesisht, është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj”.

Por nga 76 persona, për të cilët gjykatat tona kanë vendosur masën mjekësore “mjekim të detyruar” dhe që ishin në Qendrën Spitalore me afate që shkojnë nga 1 vit deri në 9 vjet, vetëm për një rast, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë ka zbatuar nenin 45 të Kodit Penal, duke rimarrë në shqyrtim vendimin e dhënë prej saj ndaj shtetasit Marjan Gjetë Hasani. Duke mos rishqyrtuar çdo vit masat e dhëna, nuk u krijohet mundësia personave që mund të jenë përmirësuar që të mjekohen në kushte të tjera.

Për këto arsye i kemi rekomanduar Ministrinë të Drejtësisë marrjen e masave që:

a) Të hartohet dhe të miratohet me procedurë të përsheptuar Rregullorja “Për masat e sigurimit të personave për të cilët gjykata ka vendosur masën mjekësore “të mjekimit të detyruar””.

b) Procedimin disiplinor për të gjithë ata gjyqtarë që kanë vendosur masën mjekësore “mjekim të detyruar” dhe që pas kalimit të afatit prej një viti nuk kanë marrë në shqyrtim vendimin e dhënë prej tyre, në zbatim të nenit 46 të Kodit Penal.

Edhe gjate vitit 2007 zyra jonë ka insistuar pranë të dy ministrive për nxjerrjen e rregullores dhe përcaktimin e vendit ku do të shkojnë këta persona, por ende nuk është miratuar as rregullorja dhe as vendi i trajtimit tyre.

Ne mendojmë se ka munguar vullneti i të gjitha Qeverive për zgjidhjen e këtij problemi. Këtë konkluzion e nxjerrim duke parë kohën tepër të gjatë prej 12 vjetësh që ka kaluar që nga hyrja në fuqi e Ligjit “Për shëndetin mendor”.

Edhe për të ardhmen sistemimi i këtyre personave në vende të përshtatshme, ashtu siç është përcaktuar në ligj, do të jetë një nga përparësitë e punës sonë.

3. Ushtrim dhune dhe shkelje të tjera nga Policia e Burgjeve

Ata që menaxhojnë burgjet duhet të kuptojnë se nuk janë thjeshtë roje, me të vetmen detyrë heqjen e lirisë së njerëzve, dhe se shteti ligjor nuk vepron prapa dyerve të hekurta të burgjeve. Përkundrazi, ata duhet të ndërthurin rolin e tyre të mbikëqyrjes së të burgosurve me një rol edukativ dhe reformues. Personeli i burgut duhet të ketë cilësi personale që i lejon të komunikojnë si të barabartë dhe njerëzisht me të gjithë të burgosurit, përfshirë këtu edhe ata më të vështirët dhe më të rrezikshmit.

Në vendin tonë, publiku ka shumë pak njohuri për burgjet, personelin e burgjeve apo punën e tyre. Ndërsa shoqëria jonë, përgjithësisht, e njeh vlerën thelbësore të punonjësve p.sh., në sektorin e shëndetësisë dhe të arsimit, personeli i burgjeve nuk e merr një vlersim të tillë publik. Në këto kushte, Ministria e Drejtësisë dhe administratorët e lartë të burgjeve duhet të konsiderojnë si përparësi krijimin e një programi të edukimit publik dhe të nxisin interesin e medias për të edukuar shoqërinë për rolin e rëndësishëm që ka personeli i burgjeve në mbrojtjen e shoqërisë.

Në zbatim të ligjit “Për Avokatin e Popullit” ekspertët e Zyrës së Avokatit të Popullit kanë organizuar inspektime të hollësishme në të gjitha burgjet. Këto inspektime u organizuan me iniciativën e Avokatit të Popullit për shkak të të dhënave që erdhën se në burgje përdorej dhunë nga ana e policisë së burgjeve. Pas këtyre inspektimeve të hollësishme rezultoi se ka patur raste për përdorim të dhunës nga ana e policisë së burgjeve, sidomos nga forcat e policisë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve gjatë kontrolleve që organizoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për gjetjen dhe eliminimin e sendeve të ndaluara.

Gjatë këtyre kontrolleve janë shkelur rëndë nga ana e policisë neni 47 i Ligjit Nr.8328, dt.16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim”, si dhe neni 40 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. Në paragrafët 5 e 6 të nenit 40 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve thuhet: “*Kontrollet e të denuarve dhe të dhomave të tyre duhet të bëhen duke treguar respektin më të madh për personalitetin e të kontrolluarit dhe pa dëmtuar sendet që posedojnë ata.*

Ushtrimi i kontrollit personal të anësive lejohet të bëhet vetëm kur ekziston një dyshim i arsyeshëm se i denuari mban sende të ndaluara sipas rregullave në fuqi”.

Gjatë verifikimeve të bëra nga ana jonë nëse janë zbatuar apo jo këto dispozita ka rezultuar se jo vetëm që nuk janë zbatuar, por gjatë kontrolleve nga ana e policisë janë kryer shkelje të rënda të këtyre dispozitave duke kryer veprime

çnjerezore dhe poshtëruese ndaj të burgosurve, deri në përdorim të paligjshëm të dhunës fizike dhe psikologjike.

Gjatë inspektimit të kryer më dt.23.11.2007, në Paraburgimin e Vlorës u konstatua se ky paraburgim kishte 17 dhoma me kapacitet prej 46 personash, ndërsa në fakt në këto dhoma ndodheshin 91 të paraburgosur. Sipërfaqja e banimit dhe kubatura e dhomave ku banonin të paraburgosurit nuk ishin sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 21 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve që bën fjalë për strehimin e të burgosurve.

Pra kushtet e akomodimit të të paraburgosurve në këtë paraburgim ishin tejte të vështira dhe shumë larg standarteve të kërkuara. Kjo gjëndje jo normale njihej nga drejtuesit e paraburgimit dhe ata të Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, por nuk merreshin masa për përmirësimin e saj me arsyetimin se së shpejti do të transferoheshin në një paraburgim të ri. Por me sjelljet dhe veprimet e paligjshme (dhunë) e punonjësve të policisë janë tejkuluar kompetencat e përcaktuara në Ligjin Nr.8321 datë 02.04.1998 “Për Policinë e Burgjeve” si dhe në akte te tjera nënligjore që normojnë veprimtarinë e punës së tyre.

Duke parë nga afër gjëndjen reale dhe kushtet që ndodheshin të paraburgosurit në Paraburgimin e Vlorës kemi arritur në përfundimin se autoritetet e burgjeve jo vetëm që nuk merrnin asnjë masë për kushtet objektivisht të papranueshme të burgimit, por me veprimet e tyre çnjerezore e poshtëruese kanë konsumuar veprën penale të torturës të parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal ku shprehimisht përcaktohet se; “Kryerja me dashje e veprave, nëpërmjet te cilave një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda, fizike apo mendore, nga një person, që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur”.

Prandaj, i kemi rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë fillimin e hetimit për veprën penale të “Torturës” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nenet 86 e 25 të Kodit Penal në ngarkim të 4 shtetasve me detyrë punonjës policie në Paraburgimin e Vlorës.

Kjo çështje ka filluar dhe është duke u hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Edhe gjatë vitit 2007 është ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike nga policia e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në kontrollet e kryera nëpër burgje dhe paraburgime me arsyetimin për pastrimin e burgjeve dhe paraburgimeve nga sendet e ndaluara dhe për rritjen e sigurisë në burgje.

Për problemet që i përkasin kontrolleve në burgje dhe paraburgimeve, kemi bërë dy rekomandime për marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin me përpikmëri të konventave ndërkombëtare, ligjeve dhe akteve nënligjore të njohura nga shteti shqiptar për burgjet, me qëllim që të respektohen në maksimumin e mundshëm liritë dhe të drejtat e të burgosurve si dhe mos të përsëriten në të ardhmen shkelje të tilla. Nga ana e ish drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve z.Sajmir Shehri, jo vetëm që nuk është marrë asnjë masë për këtë qëllim, por nuk ka marrë as mundimin për të përmbushur detyrimin ligjor për të kthyer përgjigjen e këtyre rekomandimeve.

Gjithmonë, konstatimet tona i janë bërë prezent veç Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, edhe Ministrit të Drejtësisë apo edhe Kryeministrit dhe Komisioneve Parlamentare. Vlen për t’u theksuar fakti se gjatë vitit 2007 në krahasim me vitin 2006 ka patur më pak ankesa për keqtrajtime nga policia e burgjeve si dhe nga policia e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Disa drejtorë burgjesh kanë theksuar se ushtrimi i dhunës nga forcat e policisë të Drejtorisë së Përgjithshme të

Burgjeve rrit artificialisht konfliktin midis të burgosurve dhe punonjësve të burgjeve. Miratimi i së drejtës së Avokatit të Popullit për të bërë vizita në burgje pa autorizim, si dhe për të organizuar inspektime në burgje është një mundësi shumë efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të denuarve. Praktika e inspektimeve do të bëhet më e shpeshtë në të ardhmen.

4. Ankesa të të burgosurve kundër vendimeve të gjykatave

Edhe gjatë vitit 2007 në zyrën tonë kanë vazhduar të vijnë ankesa të të denuarve kundër vendimeve të gjykatave të cilat i kanë deklaruar ata fajtorë. Në disa nga ankesat e tyre ata pretendojnë se nuk janë fajtorë për veprat për të cilat janë dënuar, duke pretenduar se gjykatat nuk kanë vlerësuar drejt provat në ngarkim të tyre. Numri i këtyre ankesave për vitin 2007 është 46. Pavarësisht se Avokati i Popullit në bazë të ligjit nuk ka në juridiksion shqyrtimin e vendimeve të gjykatës, në të gjitha këto raste nga ana jonë ankuesve ju është treguar rruga që ata duhet të ndjekin për të realizuar të drejtën e pretenduar prej tyre, me kërkesë për rishikimin e vendimit pranë Gjykatës së Lartë.

Kjo sepse pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.9398 datë 12.05.2005 Avokatit të Popullit i është dhënë e drejta të presë ankesa ndaj vendimeve të gjykatave, por nuk janë bërë ndryshimet në Kodet e Procedurës Penale dhe Civile për të realizuar këtë të drejtë.

5. Grevat e urisë

Avokati i Popullit në të gjitha rastet që është vënë në dijeni nga media apo nga administrata e burgjeve për hyrjen në greva urie të të denuarve, ka qenë ndermjetës midis administratës dhe të burgosurve. Në disa raste, ndërhyrja e Avokatit të Popullit ka qënë e suksesshme sepse të dënuarit kanë ndërprerë grevën e urisë, pasi ju janë plotësuar më parë ato kërkesa apo ankesa për të cilat kanë patur të drejtë. Ndërsa, në rastet kur ata kanë përdorur këtë mjet si presion për ndryshimin e vendimit të gjykatës, ju është bërë e qartë se ankesa nuk ishte në juridiksionin tonë dhe se çështja nuk zgjidhet me grevë urie, por duke apeluar në organet më të larta të gjyqësorit. Duke ndjekur në vazhdimësi fenomenin e grevave të urisë nëpër burgje, Zyra e Avokatit të Popullit ka konstatuar se grevat e urisë nëpër burgje nuk bëhen sipas udhëzimeve të Organizates Botërore të Shëndetësisë dhe Urdhërit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Pothuajse në të gjitha rastet e grevave të urisë, të burgosurit që pretendojnë se janë në greve urie nuk marrin ushqimin e burgut, ndërkohë që ushqimet nga familja mbahen në dhoma ku bëhet greva. Drejtuesit e burgut, duke mos dashur të konfliktohen me të burgosurit, bëjnë sikur ju besojnë atyre që janë në greve urie, ndërkohë edhe të burgosurit bëjnë sikur janë në grevë urie. Për këto arsye, grevat e shpallura të urisë nuk kanë qenë serioze.

6. Ankesa për transferime të padrejta nga një burg në tjetrin

Gjatë inspektimit të bërë në burgje dhe paraburgime është konstatuar një fenomen shumë negativ në lidhje me ligjshmërinë e transferimeve të të denuarve nga një burg në tjetrin.

Në të shumtën e raste transferimi i të denuarve nga një burg në tjetrin është përdorur si masë ndëshkimi, gjë që bie në kundërshtim me nenet 53 e 66 të Ligjit

Nr.8328, dt.16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim”, si dhe me nenet 42,43 e 64 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Në të gjitha këto raste është vepruar në kundërshtim me nenin 66 të Ligjit nr.8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim”. i cili ka përcaktuar se :

“Transferimet bëhen për arsye të rënda sigurie, kur rrezikohet jeta ose shëndeti i të dënuarit nga të tjerët, kur ka mbipopullim në institucion, për nevoja të hetimit dhe gjykimit, për shkaqe shëndetësore dhe familjare, si dhe për shkak të formimit profesional është i nevojshëm në një institucion tjetër.

Transferimet duhet të favorizojnë mundësinë që të dënuarit të kryejnë dënimin pranë vëndbanimeve të familjeve të tyre.

Të dënuarit duhet të transferohen së bashku me sendet vetjake”.

Transferimet e paligjshme të të denuarve nga një burg në tjetrin dhe sidomos kur nuk respektohet paragrafi i 5-te i nenit 31 te Ligjit Nr.8328, dt.16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim”, ku thuhet: “*Duhet të favorizohet kriteri i caktimit të të denuarve në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre*”, dëmton shumë rëndë përpjekjet e administratës së burgjeve dhe sidomos të edukatorëve për kujdesin e veçantë që duhet t’i kushtohet ruajtjes, përmirësimit ose rivendosjes së lidhjeve të të denuarve me familjen. Transferime të tilla të paligjshme dëmtojnë jo vetëm të dënuarit, por edhe familjarët e tyre.

Pas përfundimit të inspektimeve në burgje dhe paraburgime u konstatua një numër i madh transferimesh të bëra nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nga njëri burg në tjetrin e anasjelltas. Ky fenomen vërehet pothuajse në të gjitha burgjet. Transferime të tilla të paligjshme jo vetëm shkelin rëndë liritë dhe të drejtat e të denuarve dhe familjarëve të tyre por dhe i shkaktojnë një kosto financiare buxhetit të shtetit.

Në disa raste të dënuarit janë ankuar për transferime të padrejta ose kanë kërkuar të transferohen nga njëri burg në tjetrin në zbatim të nenit 31 të Ligjit Nr.8328 dt.16.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim” ku thuhet: “duhet të favorizohet kriteri i caktimit të të denuarve në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre. Në të gjitha rastet që të dënuarit janë ankuar se ndaj tyre nuk është respektuar kriteri i caktimit të tyre në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre, pas ndërhyrjes së zyrës tonë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është bërë i mundur transferimi i tyre sa më afër vendbanimit të familjeve të tyre. Por kemi patur edhe raste kur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është refuzuar pa u argumentuar rekomandimi i Avokatit të Popullit.

Gjatë viteve kemi konstatuar se transferimi i të denuarve nga një burg në një tjetër është përdoruar si masë disiplinore, veprim që bie në kundërshtim të hapur me Ligjin Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim”. Konstatojmë se si burg ku transferohen të dënuarit e vështirë dhe të rrezikshëm po përdoren Burgu i Burrelit dhe Burgu i Tepelenës. Ne i qëndrojmë propozimit që kemi bërë që për shkak të kushteve jo të mira, që janë shumë larg standarteve të kërkuara të shikohet mundësia që Burgu i Burrelit të mbyllet, pasi sipas mendimit tonë edhe pse janë bërë disa rikonstruksione akoma nuk i plotëson as standartet më minimale për trajtimin e të burgosurve.

7. Ankesa të të dënuarve të ekstraduar nga Greqia që vuajnë dënimin në burgjet shqiptare

Edhe gjatë vitit 2007 kemi patur disa ankesa nga të dënuarit e transferuar nga Greqia për të vuajtur dënimin në Shqipëri.

Nga ankesat e tyre dhe nga takimet e vazhdueshme që kemi patur me ta ka rezultuar se këta të burgosur ndonëse i kishin kaluar të gjitha shkallët e gjykimit në Greqi, pretendojnë se ishin dënuar padrejtësisht ose se janë dënuar me masa dënimi shumë të rënda për shkak se janë shqiptarë.

Ata janë sqaruar se vendimet e gjykatave greke janë jashtë juridiksionit të zyrës sonë dhe se shqyrtimi i këtyre vendimeve nga gjykatat tona nuk mund të bëhet. Disa vendime unifikuese të Gjykatës së Lartë i ndalojnë gjykatat tona që të marrin në shqyrtim vendimet e dhëna nga gjykatat greke.

Në këtë çështje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve nuk ka qënë i mirë. Sepse kjo Ministri nuk na ka siguruar kopje të plota të vendimeve të kërkuara nga ana jonë për të krijuar idenë se sa qëndrojnë pretendimet e këtyre të dënuarve.

8. Ankesa të familjareve të shtetasve shqiptarë që vuajnë dënimin në burgjet e shteteve të tjera

Për vitin 2007 ka patur disa ankesa nga të dënuar dhe familjarë të tyre, me anën e të cilave ata kanë pretenduar se ndaj të afërmeve të tyre në burgjet në Itali dhe Greqi përdoret dhunë, se ata nuk kanë asnjë dijeni për shkaqet e burgosjes së fëmijve të tyre etj. Ata në ankesat dhe kërkesat e tyre kërkojnë përshpejtimin e procedurave për transferimin e tyre nga burgjet e vendeve të huaja për të vuajtur dënimin në burgjet shqiptare. Këto ankesa ju janë dërguar Ombudsman-ve në këto vende ose i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë në Shqipëri për kompetencë.

* * *

Nga analiza e ankesave dhe kërkesave të të burgosurve që ndodhen në burgje dhe paraburgime, del se gjatë vitit 2008, veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit duhet të synojë në realizimin e rekomandimeve kryesore për Qeverinë, për Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrinë e Brëndshme dhe konkretisht:

1. Hapjen dhe sistemin në një institut mjekësor të personave për të cilët gjykata ka vendosur mjekimin e detyruar, ashtu siç kërkon ligji.

2. Mbi bazën e ankesave të të burgosurve, duke parë se në disa raste vetë ligji ishte bërë shkak për shkeljen e disa te drejtave të të burgosurve dhe të paraburgosurve kemi bërë edhe rekomandim për ndryshimin e akteve ligjore për të dënuarit që janë mbajtur në qelitë e paraburgimit, por nuk ju njihet dhe nuk ju llogaritet kjo kohë si paraburgim. Shkaku i shkeljes së të drejtës së të paraburgosurve është bërë neni 7 i ligjit nr.7941, datë 27.01.1995, "Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton se: "Me paraburgim do të kuptojmë ditët e qëndruara në ndalim dhe arrestim në burg. Kur arrestimi nuk është ndërprerë, periudha e paraburgimit do të konsiderohet nga dita e ndalimit, derisa vendimi i gjykatës ka marrë formën e prerë". Ky rekomandim u paraqit si projektligj nga një grup deputetësh, kaloi në Komisionin Parlamentar të Ligjeve, por nuk mori votat e duhura në seancën plenare të Kuvendit. Si rrjedhojë, projektligji u rrëzua.

3. Duke parë se një pjesë e madhe e të dënuarve nuk ju sigurohet e drejta për të votuar në zgjedhjet për pushtetin vendor i kërkuam Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e dispozitës përkatëse në Kodin Zgjedhor, por kërkesa nuk u pranua. Zyra jonë do të vazhdojë t'u kërkojë forcave politike parlamentare ndryshimin dhe reformimin e legjislacionit për zgjedhjet që të gjithë të paraburgosurve dhe të dënuarve t'ju sigurohet mundësia për të votuar në zgjedhjet vendore.

4. Gjithashtu i kemi ridërguar Ministrisë së Drejtësisë rekomandimet e mëposhtëme, për të cilat ndonëse kemi marrë përgjigje se janë pranuar si të drejta, në realitet nga ana e kësaj Ministrie nuk janë bërë hapa konkrete për vënien në zbatim të angazhimeve të marra:

a. Rekomandim për plotësimin e kërkesave të ligjit nr.8328 dt.16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim.”

Megjithëse kanë kaluar më se 9 vjet nga dita kur ka hyrë në fuqi ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, gjithë të burgosurit që punojnë në burgje, marrin një shpërblim simbolik 90 lekë në muaj. Për çdo një muaj pune deri tani përfitonin 3.9 ditë burgim. Por me Urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm me Nr.3223 Prot. të dt.08.10.2004, është urdhëruar që të gjithë të dënuarve që kanë përfituar ditë burgu nëpërmjet punës t'ju hiqen. Për këtë qëllim Avokati i Popullit i ka dërguar rekomandim Prokurorit të Përgjithshëm “Për rregullimin e çështjes së uljes së dënimit për të dënuarit që punojnë në burgje dhe marrjen e masave për korrigjimin e pasojave të aktit të nxjerrë nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën Nr.3223, datë 08.10.2004 dërguar Prokurorive në Rrethe”. Kjo çështje po ndiqet nga ana jonë. Aktualisht në sistemin shqiptar të burgjeve janë të punësuar 583 të dënuar. Por duhet pranuar se aktualisht mundësitë e punësimit janë të pakta. Mbase duhet një konceptim i ri për ngritjen e një sistemi, shtet – të burgosur që në kushtet e ekonomisë së tregut, të burgosurit të punojnë në vepra të mëdha publike, në përputhje me aftësitë, kualifikimin dhe pëlqimin e tyre, kundrejt një shpërblimi të drejtë.

b. Rekomandim për krijimin e kushteve të nevojshme për funksionimin e Komisionit Mbikqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve me Burgim, sipas kreut të tretë të ligjit nr.8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e Vendimeve Penale”

Nga shqyrtimi i çështjes prej zyrës sonë rezulton se ngritja e këtij komisioni nuk ka përfunduar. Është miratuar vendimi për shpërblimin e antarëve të këtij komisioni, por Komisioni nuk funksionon siç duhet.

5. Të hartohen dhe të miratohen me procedurë të përsheptuar një tërësi e qartë dhe e kuptueshme rregullash dhe procedurash që përshkruajnë në detaje rrethanat në të cilat duhet të zhvillohen kontrollet, metodat, mjetet që duhet të përdoren dhe shpeshtësinë e tyre. Këto rregulla dhe procedura duhet të jenë në përputhje të plotë me konventat ndërkombëtare, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të njohura nga shteti shqiptar për sistemin e burgjeve.

6. Të mos pengohen të burgosurit të telefonojnë me nr.08001111 direkt në çdo kohë me institucionin e Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit mbetet në pritje të zbatimit të rekomandimeve të sipërpërmendura, të cilat do të jenë pjesë e një pakete të re ligjore dhe nënligjore që po përgatitet të miratohet gjatë vitit 2008.

Gjatë vitit 2007 në sistemin shqiptar të burgjeve, me gjithë shkeljet e mësipërme, nga institucioni ynë janë konstatuar edhe disa përparime të dukshme. Mund të përmëndim si arritje të këtij viti miratimin e normës së re për ushqimin e të

dënuarve si dhe kalimi i plotë i të gjitha paraburgimeve në vartësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Ndërkohë gjatë viteve 2006-2007 është realizuar ndërtimi dhe rikonstruksioni i paraburgimit të Vlorës, burgjeve të reja në Fushë-Krujë dhe në Korçë, të cilat priten të hapen dhe të vihen në funksionim gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2008. Ndërtimi dhe rikonstruksioni i këtyre institucioneve penitenciare është realizuar në kuadër të Programit CARDS. Gjatë vitit 2007, është punuar për projektin e ndërtimit të Institutit të Riedukimit për të miturit në rrethin e Kavajës, por ende nuk është bërë asgjë për fillimin nga puna e tij. Përtej afateve të parashikuara, ende nuk ka përfunduar rikonstruksioni i godinës për të dënuarit e sëmurë në rrethin e Durrësit. Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2007 pas disa shtyrjeve u arrit të realizohej tenderimi i projektit për institucionin e Durrësit. Në kuadër të zbatimit të Masterplanit për paraburgimin me programin e ri të Bashkimit European, po punohet për hartimin e projekteve të reja për ndërtimin e paraburgimeve në Fier dhe Elbasan. Ministria e Drejtësisë vazhdon të jetë e angazhuar seriozisht në këtë drejtim.

Gjithashtu në Paraburgimin “Jordan Misja”, Burgun e Lushnjës, Burgun e Grave Burgun e Vaqarrit si dhe në Burgun e Peqinit janë organizuar disa aktivitete masive në drejtim të rehabilitimit të të dënuarve dhe parapregatitjes së tyre që, pas përfundimit të denimit penal, edhe ata të jenë qytetar të denjë të shoqërisë shqiptare.

Gjatë vitit 2007 bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me Ministrinë e Drejtësisë dhe me të gjitha burgjet ka qënë i mirë gjë që nuk mund të thuhet për bashkëpunimin e institucionit tonë me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Mjaft pozitive është botimi nga Institucioni i Avokatit të Popullit i librit “Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve në sistemin shqiptar të burgjeve” në 4000 kopje i cili është shpërndarë në të gjitha burgjet dhe institucionet e paraburgimit. Kemi falenderuar zyrën e OSBE-së në Shqipëri për financimin e këtij botimi. Gjithashtu për vitin 2008 do të vendosim kuti postare në çdo burg dhe institucion paraburgimi, por po kërkojmë burime financiare për këtë projekt.

b. Ankesat për Zyrat e Përmbarrimit

Edhe për vitin 2007 ankesat për Zyrat e Përmbarrimit në rrethe kanë zënë përqindje jo të vogël në ankesat e drejtuara institucionit tonë. Kështu për vitin 2007 janë regjistruar 154 ankesa. Pretendimet për të drejtat e shkelura, në shumicën dërmuese, kanë qënë për zvarritje nga Zyrat e Përmbarrimit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Por, nuk janë të pakta edhe ankesat ndaj veprimeve, mosveprimeve apo vendimeve të përmbarruesve gjyqësorë gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë.

Nga 154 ankesa, janë përfunduar 122 ankesa, nga të cilat 29 janë zgjidhur në favor të ankuesve. Për shkeljet nga shërbimi përmbarrimor kemi bërë 10 rekomandime, nga të cilat 9 janë pranuar, dhe 1 është pa përgjigje.

Nga ankesat e tjera, 48 kanë rezultuar të pabazuara, 4 kanë qënë jashtë juridiksionit, 28 jashtë kompetencës dhe 13 ankesa me heqje dorë.

Nga vitit 2006 kanë qënë të mbartura edhe 18 ankesa të të njëjtës natyrë, nga të cilat kanë përfunduar 14. Nga këto 5 janë zgjidhur në favor të qytetarëve, 5 të pabazuara, 1 jashtë kompetencës, 3 rekomandime të pranuar dhe 4 janë mbartur për vitin 2008.

Mjaft ankesa kanë rezultuar të pabazuara, mbasi ankuesit kanë kërkuar pezullim të ekzekutimit të titujve ekzekutivë nga Gjykata e Lartë, ose kundër

vendimit për kundërshtimin e vendimeve të pezullimit apo të pushimit të çështjes nga përmbauesit gjyqësor. Për këto vendime ju është sugjeruar ankuesve që të ankohen në gjykatën kompetente, në bazë të nenit 617 të Kodit të Proçedurës Civile.

Ankesat kanë qënë pothuajse për të gjitha Zyrat e Përmbaimit, por më të shumta për Zyrat e Përmbaimit Tiranë, Lezhe Korçë, Vlorë, Durrës, Lushnjë, Tropojë dhe Shkodër.

Rezulton se më shumë ankesa për përmbaimin pas ndërhyrjes tonë, janë përfunduar nga Zyra e Përmbaimit Tiranë. Statistikat tona tregojnë se kjo Zyrë ka edhe një pjesë tepër të madhe të praktikave të të gjithë sherbimit Përmbaimit në rang vendi.

Në marrëdhënie me Avokatin e Popullit, Zyra e Tiranës së bashku me atë të Korçës dhe Lezhës, kërkesave tona ju përgjigjen brënda afateve të kërkuara si dhe të shoqëruara edhe me kopjet e akteve dhe veprimeve proçeduriale përmbaimore të kryera. Më pas renditen për sa u takon çështjeve të ekzekutuara, Zyrat e Përmbaimit Shkodër, Mirdirë, Sarandë. Ndërsa me Zyrën e Përmbaimit Tropojë kemi probleme të mëdha komunikimi, pasi nuk respektojnë asnjë afat ligjor, gjë për të cilën kemi kërkuar marrjen e masave nga organi epror.

Një pjesë e konsiderueshme e ankimeve drejtuar Institucionit tonë, ka të bëjë me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga debitorët që janë institucione buxhetore dhe që janë detyruar për kthim shumash monetare të caktuara. Ky problem është i mbartur nga viti në vit, duke bërë kështu shqetësimin kryesor si për Shërbimin Përmbaimit, ashtu edhe për Institucionin e Avokatit të Popullit. Por, veçanërisht të dëmtuar janë protagonistët kryesorë, gjyqfituesit, të cilët nuk kanë mundur të realizojnë të drejtën e fituar në rrugë gjyqësore.

Ka edhe mjaft ankesa të tjera që kanë të bëjnë me mosrikthimin në punë të gjyqfituesve, mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore për trajtimin me tokë bujqësore nga komisionet e tokave të fshatrave dhe komunave që nuk janë ekzekutuar.

Në ndërhyrjet tona me mjetet ligjore që na ka vënë në dispozicion ligji, jemi përpjekur në rradhë të parë të tërheqim vëmendjen e Qeverisë dhe institucioneve buxhetore debitore, për ndryshimin e mentalitetit të tyre që konsiston në moskonceptimin e drejtë të fuqisë së vendimit gjyqësor të formës së prerë. Shpesh ka patur raste që ekzekutimin e vendimit gjyqësor organe apo autoritete shtetërore e konsiderojnë si jo të detyrueshëm për zbatim, si fakultativ, për të mos thënë që nuk janë të pakta rastet kur marrin guximin që të shprehin se: "...vendimet janë ekzekutuar 70% dhe si të tilla mund të konsiderohen si të ekzekutuara tërësisht".

Një problem tjetër që duhet prekur, është edhe niveli jo gjithmonë i kënaqshëm i cilësisë së veprimeve të përmbauesve gjyqësore, bazuar në kërkesat ligjore të Kodit të Proçedurës Civile. Në shumë raste, gjatë verifikimeve të ankesave me dosjet përmbaimore, rezulton se ka veprime ose mosveprime, që janë tregues të mangësive të formimit profesional, pavarësisht shkakut apo motivit konkret, si mungesë e njohjes së legjislacionit civil dhe atij proçedural civil, keq interpretim të dispozitivit të vendimit gjyqësor, nënvleftësim, harresë, ngutje, etj.

Ndër shkaqet kryesore që kanë penguar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë ka qënë edhe qëndrimi jo konsequent i përmbauesve për zbatimin e kërkesave të ligjit. Janë jo të pakta rastet kur përmbauesit gjyqësorë zbatojnë nenin 606 të K.Proçedurës Civile për dënim me gjobë të drejtuesve qëndror e lokal të cilët nuk zbatojnë vendimet gjyqësore. Por, thuajse nuk zbatohet fare proçedimi penal për t'i denoncuar për ndjekje penale në Prokurori sipas nenit 320 të Kodit Penal për moszbatim të vendimit të gjykatës.

Qëndrime të tilla kanë ulur besimin e shtetasve ndaj organeve dhe nëpunësve të administratës, duke cënuar reputacionin e shkallën e besueshmërisë të sistemit tonë të drejtësisë. Sot në Shqipëri ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është një handicap në sistemin e dhënies së drejtësisë, që në raste të veçanta vë në dyshim funksionimin e vetë sistemit.

Ndër rastet e paraqitura pranë Institucionit tonë mund të përmendim:

1. Ankesën e marrë nga shtetasi R.R që prej vitesh ankohej lidhur me mosnjohjen e detyrimit të përcaktuar në vendimin e gjykatës nga Ministria e Financave, përsa i përket dëmshpërblimit të tij për tokën që i është marrë për ndërtimin e ujësjetillës të Bovillës. Kjo ankesë ka qënë shumë e njohur për shkak edhe të publikimit të saj nga emisioni “Fiks Fare”.

Zyra e Përmbarrimit Tiranë na informoi se e vetmja pengesë ishte mosnjohja e detyrimit nga ana e Ministrisë së Financave. Në kushtet që Gjykata detyronte Ministrinë e Financave të dëmshpërblejë qytetarin ju drejtuam disa herë Ministrisë së Financave për të korrigjuar qëndrimin e saj dhe vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor. Ky vendim gjyqësor u ekzekutua pas investimit të vetë kryeministrit Zotit Sali Berisha për këtë çështje.

2. Ankesa e shtetases T.Ç për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku ishte vendosur detyrimi i shtetasis K.Ç të paguante detyrimin ushqimor në masën 5000 lekë në muaj. Nga ana e Zyrës së Shërbimit Përmbarrimor Tiranë, qytetarja zvarritej për më shumë se 3 vjet duke bërë shkelje të dukshme të nenit 515 të K. Pr.Civile.

Pas rekomandimit të bërë nga ana jonë u kryen të gjitha veprimet e nevojshme procedurale deri në ekzekutimin përfundimtar të vendimit gjyqësor.

3. Ankesa e shtetasis R.D nga Elbasani për zvarritjen prej 2 vjetësh nga ana e Zyrës së Përmbarrimit Elbasan lidhur me mosekzekutimin e një vendimi të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Durrës, ku ishte vendosur anulimi i vendimit të refuzimit të përmbarruesit gjyqësor që konsistonte në refuzimin e kryerjes së veprimeve për ekzekutimin e një vendimi të Vitit 2002 të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe të urdhëruar për ekzekutim me vendimin Nr.102 datë 26.02.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Mbasi shqyrtuam ankesën e qytetarit, ju drejtuam Zyrës Përmbarrimore Elbasan, për t’u informuar mbi shkaqet e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor. Nga ana e tyre u vumë në dijeni se ekzekutimi i këtij titulli ekzekutiv nuk është bërë i mundur pasi, prezenca e Policisë Ndërtimore së bashku me logjistikën që ajo disponon nuk ka qënë evidente. Mbas rekomandimit tonë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit u mbajt qëndrim i drejtë duke urdhëruar Zyrën e Përmbarrimit Elbasan, të kryejë veprimet procedurale konform ligjit, duke aplikuar dhe sanksionet e parashikuara në nenin 606 të Kodit të Proçedurës Civile, nëpërmjet gjobitjes së Kryetarit të Policisë Ndërtimore Elbasan.

4. Ankuesi F.D ankohej për moszbatimin e vendimit gjyqësor Nr.2855 datë 08.10.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku ishte vendosur detyrimi i K.K.K.Pronave pranë Këshillit të Rrethit Tiranë, të njohë trashëgimtarët e trashëgimlënësit S.M si dhe regjistrimi nga Agjensia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave i vendimit gjyqësor, me gjithë ndryshimet përkatëse.

Mbasi shqyrtuam me vëmendje ankesën e qytetarit si dhe dokumentacionin përkatës, i rekomanduam Zyrës së Përmbarrimit Tiranë, marrjen e masave të menjëhershme për vënien në vend të të drejtës së shkelur si dhe informuam edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit. Në përfundim u informuam për zbatimin e

rekomandimit tonë dhe për masat e marra për zgjidhjen e kësaj çështje konformë akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Nga shqyrtimi i të gjitha rasteve që kanë patur të bëjnë me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, duam të ritheksojmë dhe njëherë së është koha që institucionet që administrojnë financat shtetërore, të ballafaqohen me këtë realitet, të mbajnë përgjegjësitë që ju takojnë dhe të punojnë për zbutjen e problemit me mundësitë reale financiare të disponueshëm. Gjithashtu i duhet kushtuar vëmendje forcimit të ndjenjës së përgjegjësisë së administratorëve shtetërorë në raport me ligjin, që në veprimet e tyre të përditshme në marrëdhënie me individët, të jenë të kujdesshëm në raporte të tilla të ndjeshme, si dhe respektimin e pronës private, të marrëdhënieve të punës, të interesave të tjera të ligjshme të individëve, pasi çënim i tyre pa të drejtë, jo vetëm që çënon demokracinë, por rëndon buxhetin e shtetit.

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe në të ardhmen do t'i kushtojë vëmendjen e duhur ankuesve ndaj përmbarrimit gjyqësor që çënojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të palëve në procesin gjyqësor.

Reforma në fushën e përmbarrimit është në proces. Me kuadër të saj janë parashikuar një sërë nismash të rëndësishme ligjore të cilat nuk kanë përfunduar dhe vazhdojnë ende të jenë në proces diskutimi. Këto nisma ligjore kanë për qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe synojnë rritjen e numrit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, forcimin e imazhit publik të shërbimit përmbarrimor në Shqipëri, rritjen e efektivitetit, transparencës, profesionalizmit dhe të buxhetit financiar të këtij shërbimi. Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit kanë punuar për hartimin e projektligjit amendues të Kodit të Proçedurës Civile. Në të njëjtën kohë po punohet nga këto dy institucione për ndryshimet dhe shtesat në Ligjin Nr. 8730, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarrimor gjyqësor", proces i cili vazhdon dhe nuk ka përfunduar ende edhe pse afatet e përcaktuara ligjore janë tejkaluar.

Nga një raport i Komisionit European për vitin 2007, evidentohet si problem kryesor për mosfunksionimin në mënyrë eficiente të shërbimit përmbarrimor fakti se, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore pengohet për shkak të mungesës së fondeve, paqartësisë së vendimeve gjyqësore dhe refuzimit të shumë organizmave qeveritare për të përmbushur detyrimet e tyre. Numri i vendimeve gjyqësore të ekzekutuara vazhdon të jetë ende në nivele të ulëta për shkak të ndikimit të faktorëve të tillë si: situata ekonomike e debitorëve, pengesa në gjetjen e vendbanimeve të debitorëve, situata gjeografike e territorit të vendit, aftësia profesionale e përmbarruesve, kushtet e vështira të punës etj. Vërehet dukshëm rënia e interesit të ekzekutimit në këtë drejtim, krahasuar me vitin 2005, kur vetë kryeministri Z. Berisha bëri thirrje të vazhdueshme për ekzekutimin e të gjithë vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Pavarësisht se u përqendruam tek mangesitë e zyrave të përmbarrimit, theksojmë se sistemi i përmbarrimit gjyqësor, ka edhe shumë shëmbuj e praktikë të mirë, dukshëm shumë më të mirë se vitet paraardhëse.

Disa përmirësime janë shënuar në rritjen e kapaciteteve profesionale të administrates së shërbimit përmbarrimor. Me mbështetjen e Misionit EURALIUS janë kryer trajnime të përmbarruesve gjyqësorë në disa rrethe kryesore të vendit. Por pak është bërë për rritjen e efektivitetit të këtij shërbimi. Ende nuk është realizuar sistemi i informatizuar i kontrollit të vlerësimit të ecurisë dhe efektivitetit të zyrave lokale të shërbimit përmbarrimor dhe instalimi i një intraneti për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm. Ndonëse janë përgatitur programet specifike nuk janë instaluar. Është shumë i domosdoshëm trajnimi i administrates së shërbimit përmbarrimor mbi njohuritë bazë të programeve kompjuterike dhe internetin. Kohët e

fundit Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit pranë Ministrisë së Drejtësisë ka dhënë shenja të dëmshme mbyllje dhe hermetizimi, mungesë transparence si në raport me Mediat, ashtu edhe me Avokatin e Popullit.

c. Ankesa për Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) dhe disa probleme që kanë dale për aktet nënligjore për regjistrimin e pasurive të paluajtshme

Për vitin 2007 pranë Institucionit tonë janë paraqitur 147 ankesa, që si objekt të tyre kanë patur pretendime për zvarritje në regjistrimin e pasurisë të tyre të paluajtshme, veçanërisht të oborreve të banesave private dhe zvarritje në procesin e marrjes së certifikatës së pronësisë. 12 ankesa kanë qënë të mbartura nga viti 2006.

Nga viti 2006 ishin mbartur për shqyrtim të mëtejshëm nga institucioni ynë, katër rekomandime të cilat u ishin drejtuar respektivisht 2 rekomandime Z.V.R.P.P. Korçë për të cilët kemi marrë një përgjigje pozitive, një rekomandim Z.V.R.P.P. Tiranë lidhur me një ankesë e cila gjithashtu u zgjidh pozitivisht në favor të ankuesit.

Nga 159 ankesa gjithsej, janë shqyrtuar 135, nga të cilat 29 janë zgjidhur në favor të ankuesve, ndërsa 23 të tjera kanë kaluar për shqyrtim të mëtejshëm për vitin 2008.

Përveç ankesave të përfunduara në favor të shtetasve, 106 ankesa kanë rezultuar të pa bazuara, jashtë juridiksionit tonë ose jashtë kompetence, pasi kanë qënë në vetvete konflikte pronësie që kërkojnë zgjidhje gjyqësore. Janë konsideruar të pabazuara për faktin se thuhet të gjithë ankuesit konsiderojnë veprime korruptive dhe cënim të të drejtave të tyre, kur vihen në dijeni se pjesa e pronës që mendonin se ju takonte, në sajë të veprimeve të ndryshme juridike të kryera më përpara apo atyre që nuk janë kryer para noterit, nuk mund të regjistrohet tashmë nga ana e Z.V.R.P.P., pasi përbën shkelje të ligjit organik dhe Rregullores së brendshme përkatëse. Ndërsa pjesa që është vlerësuar jashtë kompetencave tona, nuk është gjë tjetër veçse bllokimi me të drejtë i pasurisë pasi janë krijuar mbivendosje pronash. Këto pasoja janë rrjedhim i veprimeve të nxituara të organeve të ngarkuara nga ligji për kalimin e pronësisë, të cilat pa bërë verifikimet e duhura japin, apo kthejnë në pronësi apo pjestojnë prona që pjesërisht apo tërësisht janë të regjistruara në emër të pronarëve të tjerë, duke krijuar në fakt një konflikt të ri pronësie.

Gjithashtu ka edhe raste kur qytetarët blejnë banesa të paregjistruara ose të regjistruara me vërtetim gjyqësor të faktit, dhe mos regjistrimin e tyre apo mos dhënien e certifikatës së pronësisë, kur janë ndërtime të paligjshme, e vlerësojnë si të qëllimshëm dhe me motive korruptive.

Siç e përmendëm edhe më lart, mos njohja e ligjit dhe mos përgatitja e dokumentave të duhura për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, janë shkaku kryesor që mosveprimet e Z.V.R.P.P.-ve në rrethe, një pjesë e madhe e individëve t'i konsiderojnë shkelje të të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme.

Kështu 50 ankesa kanë qënë të pabazuara, pasi regjistrimi nuk ju është bërë për shkak të mosplotësimin të dokumentacionit përkatës ligjor dhe të mos pasjes së aktit të pronësisë për oborret funksionale. Ankuesit janë orientuar rast pas rasti dhe ju është sugjeruar forma dhe mënyra e veprimeve që duhet të bëjnë, përfshirë edhe ndjekjen e rrugës gjyqësore për fitimin e pronësisë së oborreve të banesave private me parashkrimin fitues. Një mangësi që sjell zvarritje në shqyrtimin e këtyre ankesave dhe keq kuptime në marrëdhëniet tona me ankuesit, janë vonesat e pajustificuara në kthimin e përgjigjeve nga disa Z.V.R.P.P. në rrethe, që nuk

respektojnë afatet ligjore në kthimin e përgjigjeve apo të ecurisë së rekomandimeve konkrete, duke shkelur Kodin e Procedurave Administrative. Kjo është një e metë e madhe e këtyre zyrave.

Konstatojmë se për këtë periudhë kohore, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis ZVRPP në disa rrethe dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të funksioneve tona të njohura me Kushtetutë dhe me Ligj, nuk ka qenë aspak në nivelin e dëshiruar dhe në frymën e respektimit të dispozitave ligjore.

Problematike shfaqen veçanërisht Z.V.R.P.P. në rrethet Fier, Vlorë, Kavajë, Sarandë dhe Durrës, ku janë konstatuar vazhdimisht vonesa dhe zvarritje të pajustificueshme të qytetarëve për kërkesa të ndryshme që ato kanë bërë pranë këtyre Zyrave. Kjo situatë është krijuar për shkak të menaxhimit të dobët dhe keqadministrimit të veprimtarisë së këtyre zyrave nga drejtuesit e saj.

Gjatë vitit 2007 ka patur një bashkëpunim të mirë me ZVRPP Tiranë, ku pavarësisht faktit të fluksit të madh të punës për shkak të shtrirjes së madhe të zonës që mbulon kjo zyrë dhe numrit të lartë të ankesave të paraqitura nga qytetarët ndaj kësaj Zyre, drejtuesit e kësaj Zyre i kanë krijuar kushtet e duhura nëpunësve të Institucionit të Avokatit të Popullit për verifikimin e ankesave në vend, konsultimin dhe ballafaqimin e tyre me përgjegjësit e sektorëve përkatës, me qëllim që të arrihet përfundimi i shqyrtimit të ankesës brenda afateve ligjore.

Shkak i vonesave të dhënies së informacionit dhe shpjegimeve të kërkuara nga ana e Regjistruarëve të ZVRPP në rrethe, vazhdon të jetë neglizhenca dhe mosrespektimi i detyrimeve ligjore për t'i kthyer përgjigje brenda afateve ligjore si kërkesave të qytetarëve, ashtu edhe Institucionit tonë. Megjithëse ka patur edhe raste të shumta ku pengesë në shqyrtimin e rasteve dhe identifikimin e saktë të problemit të ngritur ka qenë edhe mosplotësimi i saktë i dokumentacionit për aplikim. Pas sugjerimit tonë për plotësimin e këtyre mangësive, kërkesat e ankuesve janë përmbushur nga ana e Z.V.R.P.P. Kështu mund të përmendim rastin e ankuesit A.K., i cili prej vitesh nuk po arrinte të bente regjistrimin fillestar dhe marrjen e çertifikatës së pronësisë në Z.V.R.P.P. të rrethit Durrës për banesën e tij pronë private. Pasi plotësoi aktet me dokumentat që i mungonin dhe u morrën kontakte direkte me nëpunës të Z.V.R.P.P.-së Durrës, me anë të një shkresë të ZVRPP Durrës, u vumë në dijeni të faktit se praktika e këtij shtetasi ishte përfunduar me datë 12.07.2007. Ankuesi ishte paraqitur pranë ZVRPP Durrës dhe ka tërhequr çertifikatën e pronësisë.

Të njëjtin problem ka ngritur edhe shtetasi F.D. banues në Tiranë, për mosdhënien e informacionit lidhur me një pasuri për të cilën ai kishte pretendimet e tij, megjithëse ai kishte ndjekur të gjitha procedurat ligjore, duke paraqitur kërkesat me shkrim pranë kësaj Zyre si dhe duke paguar tarifat për shërbimin e kërkuar nga ana e tij. Ankuesi pretendonte për shkelje të të drejtës së tij për informim, si një e drejtë e parashikuar dhe sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pas fillimit të shqyrtimit të kësaj ankese, nga nëpunës të ZVRPP Tiranë u pretendua fillimisht për humbje të kërkesave me shkrim që ankuesi kishte paraqitur, e për pasojë ai duhej t'i drejtohej edhe njëherë ZVRPP Tiranë me një kërkesë tjetër me shkrim, duke paguar përsëri edhe tarifën përkatëse. Megjithatë pas një rishikimi më të hollësishëm të dokumentacionit dhe kërkesave të paraqitura pranë ZVRPP Tiranë gjatë asaj periudhe kohore, u arrit në identifikimin e kërkesës dhe pronës për të cilën kërkohej informacion nga ankuesi, duke i mundësuar atij kështu përmbushjen e të drejtës së tij për informim, e drejtë e cila i ishte mohuar në vazhdimësi nga ZVRPP Tiranë.

Problematik është rasti i shtetasit L.T. me banim në Tiranë, i cili është ankuar ndaj Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tirane për mosekzekutim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Konkretisht në ankesën e paraqitur pranë institucionit të Avokatit të Popullit, ai shprehet se që prej nëntorit të vitit 2003 e deri me datë 31.03.2006 kishte punuar si Drejtor i Drejtorisë Ekonomiko-Administrative në Z.Q.R.P.P. Tiranë dhe ishte larguar nga detyra e tij. Ankuesi ka pretenduar shkelje të të drejtave të tij duke ju drejtuar më pas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. 5510 datë 17.10.2006 ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë duke vendosur që Z.Q.R.P.P. duhet të shpërblente ankuesin në një shumë të caktuar të hollash. Megjithëse nga ana jonë janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore, duke i rekomanduar Kryeregjistruesit ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, akoma nga ana e këtij institucioni nuk është bërë e mundur një gjë e tillë. Kjo çështje po ndiqet akoma nga ana e institucionit tonë deri në përmbushjen e të drejtës ligjore të ankuesit.

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme duhet të unifikojë sa më shpejt praktikën e Zyrave në vartësi të saj, për zbatimin e kërkesave të pikës 3 të nenit 142 të Kushtetutës që i detyron organet shtetërore të ekzekutojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë. Çdo kontestim ndaj këtyre vendimeve gjyqësore, duhet bërë vetëm në rrugë gjyqësore, me anë të rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, parashikuar në nenin 494 të Kodit të Proçedurës Civile. Në të kundërt, duhet të jenë koshientë në respektimin e pavarësisë të pushtetit gjyqësor dhe të veprojnë për ekzekutimin e tyre.

Rëndësi të veçantë për mirëfunksionimin dhe administrimin sa më të mirë të punës së këtyre Zyrave është ai i rritjes së shkallës së transparencës të Z.V.R.P.P. në marrëdhëniet dhe komunikimin e tyre me qytetarët. Forcimi i infrastrukturës së tyre, siç është rasti i përmirësimeve rrënjësore me ambientet e reja të funksionimit të Z.V.R.P.P. të rretheve Tiranë, Durrës, etj, ku përveç të tjerave, është rritur ndjeshëm numri i sporteleve dhe i juristëve që kontaktojnë direkt gjatë gjithë orarit zyrtar me aplikuesit, padyshim që, do t'u shërbejë më mirë nevojave të qytetarëve dhe do të çojë në fund të fundit në rritjen e besimit të tyre ndaj këtyre organeve mjaft të rëndësishme të administratës publike.

Gjithashtu Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut pranë Kuvendit të Shqipërisë i janë dërguar mendimet dhe propozimet e institucionit të Avokatit të Popullit për Projektligjin “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.7843 datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar”, më datën 21.03.2007, për të cilin na është kërkuar mendimi. Megjithatë këto mendime nuk u morën parasysh gjatë fazës së miratimit të Projektligjit në seancë parlamentare.

Një nga ndryshimet më të rëndësishme dhe më të kontestuara nga ana e Institucionit tonë ishte e drejta që i njihet Kryeregjistruesit për të vendosur për fshirjen e regjistrimit të një pasurie. Konkretisht në nenin 10 të Ligjit nr. 9701 datë 02.04.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 7843 datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht e drejta e Regjistruesit, në rastet kur për të njëjtën pasuri, janë bërë më shumë se disa regjistrime, të cilat nuk kanë rrjedhur nga njëri-tjetri, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, që t'i kërkojë Kryeregjistruesit të vendosë fshirjen e regjistrimeve të kryera pas regjistrimit të parë, kur ky i fundit është në përputhje me nenet 192-197 të Kodit Civil, duke bërë shënimin në kolonën përkatëse. Kryeregjistruesit i njihet e drejta që të marrin një vendim brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës. Në rast të

mosmarrjes së vendimit nga Kryeregjistruesi, zbatohet neni 328 i Kodit të Procedurës Civile.

Një ndryshim tjetër thelbësor është parashikuar në nenin 39/a të Ligjit të mësipërm ku Regjistruesit i njihet kompetenca që të mos pranojë asnjë regjistrim të ri të një prone, nëse për këtë pronë ka një regjistrim të mëparshëm të një titulli. Nëse Regjistruesi vihet në dijeni se një regjistrim i mëparshëm është kryer në një kohë kur për këtë pronë ekzistonte një regjistrim, atëhere ai procedon sipas nenit 10 të Ligjit nr. 9701 datë 02.04.2007.

Krahas kësaj, gjatë vitit 2007 janë miratuar edhe një sërë aktesh nënligjore me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së efikasitetit të punës së ZVRPP-ve. Kështu është miratuar V.K.M. nr. 24 datë 19.01.2007 “Për procedurën e lëshimit të dokumentave nga disa Zyra të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe ndryshimin e tarifave për to”, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 1 datë 31.01.2007, “Për procedurat e Regjistrimit në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, si dhe Udhëzimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre që krijojnë mbivendosje në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

Gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura pranë institucionit tonë, kemi arritur në konkluzionin se disa nga këto akte nuk kanë ndikuar në përmirësimin e veprimtarisë së këtyre Zyrave ndaj qytetarëve. Gjatë kontakteve që kemi marrë me disa drejtues të këtyre Zyrave, theksohet fakti se ato nuk disponojnë kapacitetet e duhura për të kryer një volum të tillë pune. Ajo që vlen të përmendet është fakti se janë miratuar disa akte nënligjore të cilat bien ndesh me parimet e së drejtës dhe dispozita të ligjeve organike. Në këtë kuadër mund të përmendim Udhëzimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre që krijojnë mbivendosje në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, i cili autorizon dhe i jep kompetencë një organi të administratës publike që të fshijë regjistrimin e një pasurie të paluajtshme nga regjistrat e ZVRPP. Akte të tilla i hapin rrugë abuzivizmit nga nëpunës të caktuar të ZVRPP, të cilët mund të vendosin padrejtësisht për fshirjen e pronave, të cilat qytetarët mund t’i kenë fituar me mënyra të ligjshme të parashikuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. Nga ana tjetër, akte të tilla krijojnë një pasiguri të theksuar tek qytetari i thjeshtë, i cili duhet të kontrollojë herë pas here gjendjen juridike të pronës së tij, të fituar dhe të regjistruar sipas kërkesave të Ligjit, por që një nëpunës i caktuar mund ta perceptojë si të paligjshme dhe në këtë mënyrë të vendosë për fshirjen e saj nga regjistri.

Në këtë rast jemi përballë faktit ku me një akt nënligjor autorizohet një organ i administratës publike që të ushtrojë ato kompetenca të cilat ushtrohen nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore. Janë pikërisht organet gjyqësore të cilat bëjnë shqyrtimin dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve sipas dispozitave ligjore, dhe më pas mund të vendosin detyrimin e ZVRPP-së që të bëjë fshirjen e një regjistrimi. Këto parregullsi jemi duke i shqyrtuar më në hollësi për të kërkuar eventualisht ndryshimin e tyre nga Qeveria ose do t’i drejtohem Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e tyre si antikushtetuese.

ç) Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

Gjate vitit 2007 pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur 125 ankesa që kanë të bëjnë me pronën, cenimin e kesaj të drejte nga persona fizik si dhe pengesa të ndryshme që mbajtesit e tagreve të pronësive kanë hasur në ushtrimin e

tyre nga Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit te Pronave dhe Zyrat Rajonale te kesaj Agjencie te ngritura ne baze Qarku.

Duhet theksuar fakti se ky eshte nje numer mjaft i madh ankesash ndaj ketij organi dhe qe perbejne rreth tre here me shume se numri i ankesave te paraqitura gjate vitit 2006. Ndërsa 2 ankesa të tjera ishin të mbartura nga viti paraardhës, nftga te cilat njera eshte zgjidhur ne favor te ankuesit, ndersa ankuesi tjetër eshte orientuar qete beje plotesimin e dokumentacionit te tij prane ZRAKKP te Qarkut Tirane sipas kerkesave te Ligjit.

Nga ankesat e paraqitura gjate vitit 2007, janë përfunduar 107 ankesa, nga të cilat 19 janë zgjidhur në favor të ankuesve, 19 kane qene te pabazuara, 25 ankesa kane qene jashte juridiksionit te institucionit te Avokatit te Popullit, 38 ankesa kane qene jashte kompetencave te institucionit pasi ishin ne trajtim e siper nga organe te specializuara per shqyrtimin e rasteve te tilla sic eshte AKKP Tirane apo Gjykatat e Rretheve Gjyqesore prane te cilave ankuesit kishin paraqitur me perpara ankimimiet apo padite e tyre respektive dhe 18 të tjera kanë kaluar për trajtim për vitin 2008.

Objekti i ankesave vazhdojnë të jenë pretendimet për zvarritje në shqyrtimin e kërkesave nga Komisionet për njohjen dhe kthimin fizik të pasurive të paluajtshme, si dhe kundër vendimeve të tyre përfundimtare. Nga verifikimet e bëra rast pas rasti, ka dalë se një pjesë e konsiderueshme e tyre ishin të pabazuara, pasi dokumentacioni i depozituar pranë Komisioneve ka patur mangësi të theksuara, të tilla si mungesa e gen-planeve, mospërcaktimin e saktë të kufinjve për identifikim të pronës së pretenduar, mungesës të vendimeve gjyqësore në rastet e mos pasjes së aktit të pronësisë, e të tjera si këto, që kanë bërë praktikisht të pamundur shqyrtimin e tyre. Nderkohe qe ka patur edhe ankesa te tjera, objekt i te cilave ka qene pretendimi i shtetasve te ndryshem qe te behej njohje dh eme pas kthim/komopesimi i prones se pretenduar nga ana e tyre, ne nje kohe qe ato posedonin vetem nje vendim gjyqesor per vertetimin e faktit juridik te pronesise mbi siperfaqe te caktuara. Edhe keto raste jane konsideruar te pabazuara nga ana jone.

Për të gjitha këto raste, të vlerësuara si të pabazuara, ju është sugjeruar ankuesve të plotësojnë sa më shpejt dokumentacionin e duhur, shoqëruar me kopjen e ligjit të ri dhe sqarimet e duhura për hyrjen në fuqi të tij dhe të kërkesave kryesore proceduriale për realizimin e këtij procesi.

Nga çështjet e shqyrtuara, ato që kishin të bënin me kontestimet për vendimet e K.K.K. të Pronave, duke qënë se janë jashtë juridiksionit tonë, ju është bërë e ditur se duhet bërë kundërshtimi i tyre në rrugë gjyqësore.

Një ankesë tjetër, ajo që i takonte shtetasës R.A. banues në Shkoder, është zgjidhur pozitivisht. Personi në fjalë ankohej për vonesa të ZRAKKP Shkoder në shqyrtimin e kërkesës për njohje dhe kthim prone. Pas hetimit dhe shqyrtimit te ketij rasti nga ana e institucionit tone, ankuesja u orientuar qe te bente plotesimin e dokumentacionit qe mungonte nedosjen e saj, dhe me pas ne pergjgjen e Drejtorit te ZRAKKP Shkoder theksohej fakti se tashme nuk kishte asnjë pengesë ligjore që kjo Zyrë të merrte një vendim për pronën e saj, të pretenduar prej shumë vitesh.

Edhe ankesat e tjera të zgjidhura në favor të ankuesve kanë patur të njëjtën problematike.

Ka patur edhe ankesa të tjera që gjatë shqyrtimit nga ana jonë, kanë rezultuar të pabazuara apo jashtë kompetencave tona institucionale dhe nuk mund të shqyrtoheshim më tej. Këtu vlen të përmendim rastin e shtetasës R.Q. banuese ne qytetin e Korces, e cila kerkonte nderhyrjen einstitucionit te Avokatit te Popullit per kthimin e pronave te vjetra te cilat ajo pretendonte se i kishte trasheguar nga gjyshi i saj. Lidhur me trajtimin e ankesës së saj, ankuesja eshte orientuar qe t' i drejtohet

fillimisht ZRAKKP te Qarkut Korçe, duke dorezuar edhe te gjithë dokumentacionin e duhur ligjor, pasi ZRAKKP eshte organi kompetent per dhenin e vendimeve mbi njohjen dhe kthimin apo kompesimin e nje prone.

Gjithashtu duhet theksuar fakti se gjate shqyrtimit te ketyre ankesave, eshte konstatuar nje zvarritje apo bllokim i procesit te njohjes dhe Kthim/Kompesimit te Prones, si rezultat i moskoordinimit te mire te punes mes Ministrive qe kane ne administrim prona dhe asete te vlefshme te paluajtshme, ne evidentimin dhe kalimin si fond fizik i vecante ne administrim te AKKP-se, duke qene se ato mund te sherbejne ne kompesimin fizik te pronareve qe u eshte njohur dhe kthyer prona me vendime te meparshme te KKKP-ve.

Persa i perket kompesimit financiar te pronareve, nga ana e Qeversise Shqiptare eshte parashikuar nje fond i vecante, i cili i ka kaluar per administrim AKKP, e cila mbi bazen e procedurave te parashikuara ne Vendimin te Keshillit te Ministrave, ka bere shperndarjen e ketij fondi.

Megjithate perzgjedhja e fondit te parashikuar nga Qeveria per kompesimin financiar te ish-pronareve dhe shperndarja e tij, siç konstatohet nga shqyrtimi i ankesave te paraqitura prane institucionit tone dhe qe kane kete objekt, duket se kane krijuar pështjellim të vërtetë, pasi edhe ata shtetas që përfitojnë, marrin kompensim për vetëm 200 metra katrorë të pronës së tyre. Në fakt, në vend ekziston tashmë një kuadër i plotë ligjor lidhur me kthimin dhe kompensimin e pronës së paluajtshme. Madje, është avancuar edhe me hartimin e vleres se tokes, apo përcaktimin e çmimit të tokës bujqesore jo ne te gjithë vendin. Në këto kushte, dhënia e fondeve të tilla “te pamjaftueshme” natyrshëm nuk e zgjidh problemin. Problemi kryesor qendron jo në angazhimin politik, por në një faturë kompensimesh, që llogaritet në miliarda euro, faturë, që asnjë qeveri shqiptare nuk ka as dëshirë dhe as mundësi reale që ta shlyejë. Por, që mbetet kusht kryesor i rrugës drejt Bashkimit European.

Lidhur Marrëdhëniet tona institucionale me Agjencinë e Kthimit e Kompesimit të Pronave dhe Zyrat Rajonale të Kthimit dhe Kompesimit te Pronave, për periudhën që trajtojmë, kanë qënë relativisht të mira. Përgjigjet e kthyerat kanë qënë brënda afateve ligjore dhe të argumentuara në shpjegimet e tyre për çdo rast.

3. Ankesat për pushtetin gjyqësor dhe administratën gjyqësore

Institucioni i Avokatit të Popullit dhe gjykatat janë dy institucionet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndihma e institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është jashtë gjyqësorit, luan një rol të rëndësishëm për rritjen e efektivitetit dhe besimit të publikut tek gjyqësori.

Në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit “Për Avokatin e Popullit” juridiksioni i Avokatit të Popullit në lidhje me gjyqësorin është i tillë, që as prek dhe as rrezikon pavarësinë e gjyqtarëve në dhënien e vendimeve gjyqësore.

Nga praktika disa vjeçare del se ne kemi marrdhënie të mira dhe mirëkuptim me gjyqësorin. Edhe në të ardhmen marrdhëniet tona do vazhdojnë të jenë korrekte në këtë drejtim. Kjo sepse të gjithë jemi të interesuar që të realizohen e të respektohen me përpikmëri të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Avokati i Popullit në punën e tij gjatë verifikimit të ankesave dhe kërkesave ka dhënë ndihmën e duhur në punën e gjykatave duke njoftuar në çdo rast me shkrim Ministrin e Drejtësisë, apo Inspektoriatin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për shkelje të ndryshme proceduriale të kryera nga gjyqtarë të veçantë, si dhe për shkelje të kryera nga administrata gjyqësore.

Avokati i Popullit nga ana e tij ndihmon edhe duke kërkuar që organet e administratës shtetërore të zbatojnë patjetër vendimet gjyqësore në të gjitha rastet kur ato kanë marrë formë të prerë. Në këtë mënyrë ne ndihmojmë që të rritet autoriteti i pushtetit gjyqësor, ndaj degës së ekzekutivit, i cili ka treguar në disa raste, se nënvlerëson fuqinë e vendimeve gjyqësore, duke i bërë në këtë mënyrë një dëm të madh imazhit të shtetit shtetit të së drejtës.

Avokati i Popullit gjatë kësaj periudhe ka patur akses të kufizuar në gjykatë dhe në asnjë rast gjatë veprimtarisë së tij, nuk ka prekur apo cënuar pavarësinë e gjyqësorit.

Kuvendi i Shqipërisë me ligjin Nr.9398 dt.12.05.2005 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ka parashikuar disa të drejta dhe kompetenca të tjera të reja në funksion të veprimtarisë së institucionit tonë. Këto shtesa dhe ndryshime u bënë duke u bazuar në eksperiencën e fituar gjatë këtyre viteve dhe përvojës së mirë të Ombudsmanëve të vendeve të tjera, në mënyrë të veçantë të Ombudsmanit të Polonisë.

Në paragrafin e fundit të nenit 25 të këtij ligji parashikohet se Avokati i Popullit, pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkeljen e të drejtave të njeriut që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë, dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prek pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimeve.

Në këto rrethana me këto ndryshime të ligjit ne si institucion jemi të detyruar për të pranuar për shqyrtim çdo ankesë, apo kërkesë që bëhet ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Por ndryshimi i ligjit nuk zgjidh problemin se cili do të jetë mjeti ligjor i reagimit të Avokatit të Popullit ndaj këtyre vendimeve të formës së prerë. Për zgjidhjen e këtij problemi është e nevojshme që të bëhen disa shtesa dhe plotësime në Kodin e Proçedurës Civile, dhe Kodin e Proçedurës Penale. Ne e kemi ngritur këtë çështje në Kuvend dhe Qeveri, por deri tani nuk ka ndonjë projektligj për këtë qëllim.

Lidhur me këtë çështje mund të shifet edhe Rekomandimi Nr.(2000) 2 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare lidhur me rishqyrtimin ose rihapjen e çështjeve gjyqësore të caktuara në nivel të brendshëm, mbështetur në vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 19 janar 2000.

Në Rekomandim thuhet se Komiteti i Ministrave, në përputhje me parashikimet e nenit 15 b të Statutit të Këshillit të Europës, “Inkurajon palët kontraktuese, në veçanti të shqyrtojnë sistemet e tyre ligjore kombëtare, me synimin e garantimit të ekzistencës së mundësive të mjaftueshme për rishqyrtimin e një çështjeje, përfshi edhe rihapjen e procedimeve, në ato faza ku gjykata konstaton shkelje të Konventës, veçanërisht kur:

i) Pala e dëmtuar vazhdon të vuajë pasojat tepër negative, të cilat janë rezultat i vendimit që ankimohet, të cilat nuk janë korrigjuar në mënyrë të mjaftueshme nga shpërblimi i drejtë dhe nuk mund të ndreqen veçse nëpërmjet rishqyrtimit ose rihapjes dhe

ii) Vendimi i Gjykatës të çon në konkluzionin se:

a) vendimi i brendshëm i ankimuar është në themel në kundërshtim me Konventën ose

b) shkelja e konstatuar është mbështetur në gabime procedurale ose mangësi të tilla të rënda që vënë në dyshim serioz rezultatit e procedurave të brendshme të ankimuaras”. Inplementimi i këtij Rekomandimi duhet të bëhet pjesë e Reformës në Drejtësi, proces që ka filluar nën drejtimin e Kuvendit të Shqipërisë.

Problematikat e ankesave për Gjykatat

Gjatë vitit 2007 ndaj gjykatave kanë ardhur me shkrim për shqyrtim gjithsej 282 ankesa, nga të cilat 182 prej tyre kanë qënë kundra vendimeve gjyqësore dhe si të tilla nga ana jonë janë refuzuar, duke sqaruar faktin se akoma nga Parlamenti nuk janë bërë ndryshimet e nevojshme në kodet përkatëse të procedurave. Në këtë numër nuk përfshihen edhe ankesa të tjera që i ka prituri Sektori i Pritjes së Popullit dhe i ka dhënë ndihmë juridike ankuesve, por kanë qënë jashtë juridiksionit tonë. Por 100 ankesat e tjera, duke i analizuar sipas objektit të tyre, kanë qënë për këto probleme :

Vendin kryesor të ankesave të ardhura gjatë këtij viti ndaj gjykatave e zënë ato për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimeve për çështje të ndryshme si në fushën penale dhe atë civile.

Në disa ankesa ndaj gjykatave është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit për të përfaqësuar palët ndërgjyqëse në shkallët më të larta të gjyqësorit, në mënyrë të veçantë në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë, me arsyetim se ato nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar marrjen e një avokati privat. Legjislacioni ynë e njeh të drejtën e shërbimit ligjor falas, por ky shërbim rezulton të ketë probleme sidomos në rastin e kërkesave për rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë pranë Gjykatës së Lartë për çështje të ndryshme penale.

Për shkak të vshtirësive ekonomike shumë qytetarë nuk kanë mundësi financiare për të siguruar një avokat privat dhe klinikat ligjore që ofrojnë këtë mundësi janë shumë të pakta, për të mos thënë mosekzistente nëpër rrethe të ndryshme të vendit (ka vetëm 2 klinika ligjore falas në Tiranë). Për më tepër legjislacioni penal ka zbrazëti pasi mundësia për të patur një avokat falas të siguruar nga shteti njihet vetëm në shkallë të parë dhe të dytë të gjykimit, dhe jo në gjykimin në Gjykatën e Lartë, duke i mohuar kështu të drejtën e njohur me Kushtetutë të të pandehurit për tu mbrojtur gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj gjykimeve dhe vendimeve gjyqësore të marra në mungesë të palëve, ose të subjekteve përkatëse. Palët mbas vënies në dijeni të këtyre gjykimeve dhe vendimeve të marra janë ankuar tek ne duke kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen tonë për prishjen e këtyre vendimeve nga organet më të larta gjyqësore.

Edhe gjatë këtij viti kanë ardhur në disa raste ankesa për veprime e qëndrime të njëanshme të gjyqtarëve të veçantë gjatë gjykimeve konkrete dhe është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e jonë për përjashtimin e tyre nga gjykimi i çështjes.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë ndaj të cilëve është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor derisa të shqyrtohet rekursi nga Gjykata e Lartë.

Po kështu ka patur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë kur palët kanë zbuluar prova të reja shpresore dhe për këtë është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit për t'ju drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim vendimi.

Në disa raste ankesa kanë ardhur ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë duke pretenduar se nga gjykatat gjatë gjykimit të çështjeve të tyre nuk janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit material e procedural për një proces të rregullt ligjor. Në këto rast është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit që

çështja e tyre të dërgohet për gjykim në Gjykatën Kushtetuese, për të kërkuar që vendimet gjyqësore të deklarohen antikushtetuese.

Edhe gjatë këtij viti, në disa raste, kanë ardhur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatave për të cilat janë ezauruar të gjitha mjetet e ankimit, duke përfshirë edhe ankimin kushtetues dhe kërkohet ndihma jonë që çështja e tyre të dërgohet për gjykim në Gjykatën e Strasburgut.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj vendimeve gjyqësore ku janë marrë masa të rënda dënimi dhe është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë, me qëllim që ndaj tyre të zbatohet Amicus Curie (Miku i gjykatës)

Ankesa kanë ardhur edhe për zvarritje të padrejta nga administrata e gjykatave në drejtim të dërgimit të dosjeve për gjykim nga Gjykatat e Rretheve në Gjykatat e Apelit apo në Gjykatën e Lartë dhe anasjelltas.

Po kështu ankesa kanë ardhur edhe për faktin se, ndonëse kanë përfunduar gjykimet, palëve nuk u jepen kopjet e vendimeve nga administrata gjyqësore.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj gjyqtarëve të veçantë të Gjykatave të Shkallës së Parë apo të Gjykatave të Apelit duke i akuzuar ato për veprime korruptive dhe kërkohet që nga Avokati i Popullit të fillohet procedimi disiplinor si për shkelje të ndryshme në detyrë ashtu dhe për korrupsion.

Nga analiza e ankesave të ardhura ndaj gjykatave vërehet se në përgjithësi ka besim ndaj institucionit tonë dhe arrihet deri aty sa ankuesit të paraqesin edhe dokumente apo fakte të ndryshme për të argumentuar dhe bërë vlerësimet e vendimeve gjyqësore.

Për këto ankesa nga ana jonë në çdo rast janë bërë sqarimet e nevojshme për rrugën ligjore që duhet ndjekur si dhe argumentat kushtetuese dhe ligjore se vendimet gjyqësore nuk mund të ndryshohen nga institucioni ynë, por vetën nga gjykatat më të larta mbi bazën e ankimeve dhe rekurseve të parashikuara në ligj.

Gjatë vitit 2007 për gjithë ankesat e ardhura ndaj gjykatave, në 25 raste ato janë zgjidhur në favor të ankuesave.

a. Ankesat e ardhura ndaj gjykatave të Rretheve Gjyqësore

Nga 282 ankesa të ardhura gjatë vitit 2007, ndaj Gjykatave të Rretheve Gjyqësore kanë qenë 191 ankesa.

Nga verifikimi i këtyre ankesave ka rezultuar se në pjesën më të madhe ankuesit nuk kanë patur të drejtë mbasi gjyqtarët e akuzuar për shkelje kanë bërë “*kujdes*” që nga ana ligjore të mos vërtetohet ndonjë shkelje e dispozitave ligjore.

Ja disa nga rastet e ankesave të ardhura ndaj Gjykatave të Rretheve Gjyqësore gjatë vitit 2007 dhe për të cilat ankuesit janë ndihmuar nga ana jonë:

1. Ankuesja K.K. nga Tirana është ankuar ndaj Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, për zvarritje gjykimi për një çështje civile.

Nga verifikimi rezultoi se kërkesë padia e saj është paraqitur për gjykim në gjykatë me dt.22.11.2006 dhe ka si objekt detyrimin e ZRPP Tiranë, për ta paisur atë me certifikatë pronësie.

Seanca gjyqësore e dt.09.03.2007 është shtyrë me arsyetimin se një antar i trupit gjykues ka qënë me raport mjeksor. Me dt.30.03.2007 çështja është shtyrë me kërkesë të avokatit të saj dhe me dt.04.05.2007 janë dhënë shpjegimet e palëve dhe është shtyrë seanca për tu njohur pala paditëse me provat e palës së paditur.

Me dt.25.05.2007 me kërkesën e palës së paditur janë thirrur 2 persona me cilësinë e personit të tretë. Me dt.15.06.2007 përfaqësuesi i Avokatit të Shtetit ka

paraqitur kërkesë për shtyrje seance dhe njëri prej personave të tretë nuk ka patur dijeni.

Me dt.28.09.2007 nuk formohet trupi gjykues dhe me dt.26.10.2007 përsëri nuk formohet trupi gjykues, pasi njëri antar i trupit gjykues ka qënë i sëmurë me raport mjeksor.Pra gjykimi ka vazhduar rreth një vit dhe nuk kishte përfunduar dhe ndërhyrja jonë bëri që kjo çështje të përfundojë.

2. Ankuesi N.M. nga qyteti i Shkodrës, është ankuar për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore ndaj Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, për gjykimin e një çështje civile.

Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoj se N.M. me cilësinë e Kryetarit të Shoqatës “11 janari 2004” Shkodër ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, një kërkesë padi me dt.26.03.2007 me objekt shpërblim dëmi për vdekjen e familjarëve në tragjedinë e 9 janarit 2004.

Nga verifikimi rezultoi se me vendimin Nr.2868, dt.20.04.2007 të kësaj gjykate është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes për mosparaqitje të palëve.

Ankuesi N.M. ka paraqitur përsëri kërkesë padi të re me të njëjtin objekt me dt.19.07.2007 në këtë gjykatë.

Me dt.15.10.2007 shtyhet seanca gjyqësore për të siguruar pjesmarrjen e paditësit dhe për tu dhënë kohë paditësave të plotësojnë të metat e padisë, të paguajnë vlerën 1% të objektit të padisë, të paraqesin çertifikatat e vdekjeve, listën e personave që do të dëmshpërblehen etj.

Si rezultat i ndërhyrjes së institucionit tonë u bë e mundur plotësimi i këtyre të metave dhe ju paraqit gjykatës kërkesë padi e re.

3. Ankuesja N.M. nga qyteti i Rrogozhinës është ankuar kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, me të cilin është vendosur dërgimi i kërkesë padisë së saj për largim nga puna për kompetencë gjykimi, Seksionit Administrativ të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nga ana jonë ankuesja është sqaruar se kundër vendimit gjyqësor mund të ushtrohet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, ndërsa Seksionet Administrative në gjykata janë caktuar para disa vitesh me dekret të Presidentit të Republikës, me propozim të Ministrisë së Drejtësisë dhe për rrethin e Kavajës është caktuar që këto gjykime të gjykohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

4. Ankuesi Z.K. nga qyteti i Librazhdit është ankuar për zvarritje pa shkaqe të arsyeshme nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, në gjykimin e një çështje penale me të gjykuar B.G. i akuzuar për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, nga ku ka gjetur vdekjen bashkëshortja e ankuesit.

Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se, me dt.08.02.2006 kjo çështje ka ardhur për rigjykim në këtë gjykatë, mbasi është prishur nga shkalla e dytë Gjykata e Apelit Durrës.

Në bazë të detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit Durrës, duhej bërë pyetja e shtetasit maqedonas Z.M. i cili ndodhet jashtë vendit tonë, në Republikën e Maqedonisë.

Për këtë veprim gjyqësor është dërguar letër-porosi nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Republikës të Maqedonisë, për paraqitjen pranë gjykatës në Librazhd të shtetasit maqedonas Z.M.

Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë është kthyer përgjigje se aktet i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë të Maqedonisë, e cila nuk ka kthyer akoma përgjigje. Deri në kthimin e një përgjigje nga Ministria e Drejtësisë së Maqedonase,

kjo çështje mbahet e pezulluar nga gjykata, meqenëse pyetja e këtij dëshmitari është e domosdoshme dhe ka rëndësi për zgjidhjen e çështjes në themel.

5. Ankuesja L.M. nga qyteti i Peqinit ankohet ndaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për zvarritje pa shkaqe ligjore të një çështje civile me objekt zgjidhje martesë dhe lënien e 4 fëmijëve të mitur për rritje dhe edukim si dhe detyrim për pension ushqimor në dobi të fëmijëve.

Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se me vendimin Nr.193 dt.30.01.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është vendosur zgjidhja e martesës midis H.H dhe L.H. dhe lënia e 4 fëmijëve të mitur ankueses për rritje dhe edukim si dhe detyrimi i paditësit për të paguar pension ushqimor në dobi të fëmijëve të mitur.

Kundër këtij vendimi gjyqësor është ankuar në shkallë të dytë paditësi dhe Gjykata e Apelit Durrës, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se dosja civile ka ardhur në këtë gjykatë me dt.08.11.2007. Nga ana jonë ankuesja është sqaruar që ti drejtohet me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke kërkuar prej saj lëshimin e urdhër ekzekutimit, për të vënë në ekzekutim në Zyrën e Përmbarimit Elbasan, vendimin e sipërcituar të gjykatës.

6. Ankuesi R.Q. nga qyteti i Elbasanit është ankuar ndaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për zvarritje pa shkaqe ligjore të një çështje civile.

Kështu nga verifikimi i kësaj ankese ka rezultuar se kjo çështje është hedhur në short me dt.21.02.2007. Seancat gjyqësore janë shtyrë për shkaqe ligjore. Kështu me dt.12.03.2007 seanca është shtyrë për thirrjen e palës së paditur, me dt.23.03.2007 seanca është shtyrë për t'u bërë akti i ekspertimit në datën.14.05.2007 dhe 21.05.2007 është shtyrë mbasi nuk ka ardhur përgjigja nga Banka Popullore.

Me dt.28.05.2007 seanca gjyqësore është shtyrë që palët të japin konkluzionet përfundimtare dhe me dt.04.06.2007 gjykata ka dhënë vendimin përfundimtar. Nga verifikimi i kësaj ankese nga ana e jonë u arrit jo vetëm shpejtimi i këtij gjykimi, por edhe përfundimi i tij.

7. Ankuesi F.Z. nga qyteti i Korçës është ankuar për zvarritje gjykimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Nga verifikimi rezultoi se me dt.01.09.2004 është regjistruar për gjykim në gjykatë kërkesë padia e ankuesit dhe me vendimin Nr.382 dt.25.02.2005 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Korçë, është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes, pasi paditësi ka hequr dorë nga gjykimi i çështjes.

Ankuesi ka paraqitur përsëri kërkesë padi të re dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin Nr.549 dt.20.03.2006, ka vendosur përsëri pushimin e gjykimit pasi paditësi ka hequr dorë nga gjykimi çështjes. Nga verifikimi ynë rezultoi se të dy këto vendime gjyqësore kanë marrë formë të prerë, mbasi ankuesi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit në shkallë të dytë, në Gjykatën e Apelit Korçë.

8. Ankuesi A.M nga qyteti i Vlorës është ankuar për zvarritje gjykimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë pa shkaqe ligjore.

Nga verifikimi rezultoi se kjo çështje është regjistruar për gjykim me dt.23.05.2006, dhe nga gjykata janë zhvilluar gjithsej 15 seanca gjyqësore.

Seancat e dt.10.12.2006 dhe 18.12.2006 janë shtyrë për të kryer ekspertimin e çështjes. Ndërsa seancat gjyqësore të dt.26.03.2007 dhe dt.16.04.2007 janë shtyrë me kërkesën e paditësit seanca e radhës deri në datën që ankuesi paraqiti ankesë pranë nesh, ishte caktuar me dt.07.05.2007.

9. Ankuesi L.Dh. nga Tirana është ankuar se me vendimin Nr.645 dt.06.06.2005 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, është deklaruar fajtor për veprën

penale të shpërdorimit të detyrës dhe në bazë të nenit 248 të KP, ai është dënuar me 100.000 lekë gjobë.

Ky vendim është vënë në ekzekutim në Zyrën e Përmbarrimit Tiranë, e cila nuk e sqaronte atë nëse ai përfitonte apo jo nga ligji me Nr.9678 dt.31.01.2007 “Për dhënie amnistie”.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se me vendim dt.08.02.2007 të përmbarruesit gjyqësor, është vendosur pushimi i ekzekutimit të çështjes ndaj L.Dh, pasi ai ka përfituar në bazë të ligjit Nr.9678 dt.31.01.2007 “ *Për dhënie amnistie* “, sipas të cilit u amnistuan të gjithë personat e dënuar me gjobë.

10. Ankuesi A.M. nga qyteti i Vlorës është ankuar ndaj vendimit Nr.426 dt.06.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i marrë në mungesë ndaj të gjykuarit Sh.M.

Nga përmbajtja e dispozitivit të vendimit gjyqësor rezultonte se kundër atij vendimi i gjykuarit ose mbrojtësi i tij mund të bënin ankim në shkallë të dytë në Gjykatën e Apelit Vlorë. Për të gjykuarin Sh.M. ky afat fillonte nga dita e komunikimit të vendimit sipas procedurave të përcaktuara mbi komunikimin e vendimeve të marra në mungesë nga gjykata.

Nga ana tjetër ankuesi u sqarua se kundër vendimit mund të bëjë ankim edhe mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e të gjykuarit në bazë të nenit 48, pika 3 të Kodit Procedurës Penale, i autorizuar me prokurë të posaçme, qëndrim ky i mbajtur dhe i unifikuar përfundimisht edhe nga Gjykata Kushtetuese, duke garantuar kështu mbrojtjen e të drejtave të individit gjatë procedimit penal.

11. Ankuesja L.Gj. nga qyteti i Vlorës, ankohej për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore në gjykimin e një çështje civile nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se me vendimin Nr.1646 dt.03.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur pushimi i gjykimin të çështjes mbasi ditën dhe orën e gjykimin të saj nuk u paraqit avokati i saj P.M. pa shkaqe të arsyeshme.

Me vendimin Nr.1963 dt.24.11.2003 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur pushimi i gjykimin të çështjes pasi paditësi hoqi dorë vetë nga gjykimi.

Me vendimin Nr.1406 dt.03.09.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur pushimi i gjykimin mbasi paditësi hoqi dorë nga gjykimi. Rezultoi se të tre këto vendime kanë marrë formë të prerë, mbasi ndaj tyre ankuesja nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit në shkallë të dytë, në Gjykatën e Apelit Vlorë. Pra ankesa ishte e pabazuar, por ankuesja u këshillua se ka të drejtë ti drejtohet sërish gjykatës, me kërkesë padi të re.

12. Ankuesja K.S. nga qyteti i Përmetit është ankuar ndaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, për zvarritje pa shkaqe ligjore të një çështje civile me objekt lënien e fëmijës së mitur për rritje dhe edukim dhe detyrimin e pagimit të pensionit ushqimor në dobi të tij.

Nga verifikimi rezultoi se kjo çështje është prishur dhe dërguar për rigjykim nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, dhe do gjykohej nga kjo gjykatë me tjetër trup gjykues. Me ndërhyrjen tonë u arrit jo vetëm shpejtimi i këtij gjykimi, por edhe përfundimi i gjykimin të kësaj çështje.

13. Ankuesja B.S. nga rrethi i Fierit është ankuar kundër vendimit Nr.138 dt.08.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me të cilin është vendosur deklarimi fajtor dhe dënimi i burrit të saj me 3 vjet burgim për veprën penale të kultivimit të bimëve narkotike, duke pretenduar se ky vendim është jo vetëm i padrejtë, por edhe i pa bazuar në ligj.

Në ankesë përveç prishjes së vendimit kërkohet edhe ndihma e institucionit tonë për lirimin e tij para kohe me kusht ose falja e dënimit të mbetur. Nga ana jonë ankuesja u këshillua për procedurat dhe rrugën ligjore të ankimeve ndaj vendimeve gjyqësore dhe u sqarua se lirimi para kohe me kusht është në kompetencë të gjykatës së vendit ku vuan dënimin bashkëshorti i saj sipas parashikimeve të nenit 64 të K.Penal.

Ndërsa për faljen e dënimit të mbetur u këshillua se duhet t'i drejtohet Presidentit të Republikës.

14. Ankuesja N.A. nga qyteti i Sarandës është ankuar kundër vendimit Nr.552 dt.11.04.2006 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Sarandë, me të cilin është vendosur zgjidhja e martesës me bashkëshortin e saj N.H.

Nga përmbajtja e dispozitivit të vendimit gjyqësor rezultonte se ky gjykim është zhvilluar në mungesë të ankueses dhe në të thuhej se kundër tij lejohej ankim dhe për të paditurën që ka qënë në mungesë ky afat fillon nga dita e komunikimit të vendimit.

Kështu që ankuesja u këshillua nga ana jonë se mund t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me kërkesë për rivendosje në afat meqenëse ajo ka qënë jashtë shtetit dhe nuk ka patur asnjë mundësi komunikimi në lidhje me gjykimin e kësaj çështje. Për realizimin e këtyre të drejtave ajo mund të kërkonte ndihmën e një avokati privat.

Në disa ankesa, të afërmit ose familjarët e viktimave janë ankuar për veprime korruptive nga gjyqtarë të veçantë si të gjykatave të rretheve, ashtu edhe për ata të gjykatave të Apelit.

Nga ana jonë, në zbatim të kërkesave të nenit 17/b të ligjit "Për Avokatin e Popullit" ankesat e bëra, së bashku me dokumentat shoqëruese të tyre, i janë dërguar për shqyrtim organit kompetent, Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ose Ministrit të Drejtësisë i cili ka të drejtën e procedimit penal ndaj gjyqtarëve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe ato të Gjykatave të Apelit.

Në përgjithësi në këto ankesa bëhet fjalë për gjyqtarë të veçantë të cilët gjatë kryerjes së detyrës së tyre pretendohet se janë treguar të njëanshëm dhe jo objektiv për raste konkrete, duke dhënë dënime të buta në saj të veprimeve të hapura korruptive.

Po kështu në disa raste të tjera ankuesit, duke qënë të mërzhitur nga tejzgjatja e proceseve gjyqësore nga njëra shkallë e gjyimit tek tjetra nuk binden me përgjigjen e kthyer nga ana e jonë, sidomos me arsyetimin "se vendimet gjyqësore janë jashtë juridiksionit tonë".

Ankuesit nga ana e tyre këmbëngulin se Avokati i Popullit duhet të bëjë patjetër vlerësimin e vendimeve gjyqësore mbasi sipas tyre ato janë hapur të padrejtë dhe të pa mbështetur në ligj. Ato paraqesin tek ne edhe dokumenta apo prova të tjera shkruesore me të cilët këmbëngulin që ne të krijojnë bindje me çdo kusht se ato kanë të drejtë, por kjo e drejtë atyre nuk u jepet nga gjykatat, mbasi sipas tyre ato janë të korruptuara.

Në lidhje me ankesat e ardhura gjatë kësaj periudhe ne kemi bërë të gjitha sqarimet e nevojshme se për vendimet gjyqësore nuk mund të ndërhyhet nga ne derisa të bëhen ndryshimet përkatëse si në Kodin e Procedurës Penale, ashtu edhe në Kodin e Procedurës Civile.

Në lidhje me problemet e zvarritjeve të gjykimeve të ndryshme për çështje penale për mendimin tonë del nevoja e shqyrtimit të disa dispozitave në Kodin e Procedurës Penale, me synim shkurtimin e afateve si të hetimit ashtu edhe të gjyimit të procedimeve.

Në këtë përfundim arrihet sepse me afatet ekzistuese lihet shteg për abuzim nga punonjës të veçantë si të prokurorisë në fazën e hetimit paraprak, ashtu edhe nga gjyqtarët në fazën e gjykimit të procedimeve penale.

Për mendimin tonë, në lidhje me afatet e hetimit dhe të gjykimit, ka vend që të bëhen studime dhe përgjithsime për të parë mundësinë e rishikimit të tyre, duke patur parasysh periudhën e gjatë të miratimit të Kodit të Procedurës Penale, (1995) dhe problemet që kanë dalë gjatë zbatimit të tij në praktikën gjyqësore.

Edhe në drejtim të zvarritjeve në gjykimin e çështjeve civile mendojmë se duke u bazuar edhe në ankesat e ardhura në Institucionin e Avokatit të Popullit, ku vendin kryesor të tyre e zënë zvarritjet pa shkaqe ligjore, ka vend për t'u bërë rishikim dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

Gjithashtu ka vend për të parë mundësinë e rritjes së çështjeve civile që gjykohen me 1 gjyqtar, në raport me çështjet që sot shqyrtohen nga gjykata me 3 gjyqtarë. Për këtë duhet patur parasysh se gjyqtarë të një gjykate shpesh konsumohen në gjykimin e çështjeve, të cilat shpesh kthehen për rigjykim disa herë nga gjykatat më të larta. Kështu gjyqtarët kanë pengesa ligjore për gjykimin e tyre. Ky problem deri tani është zgjidhur duke u komanduar sipas rastit gjyqtarë nga Gjykatat e rretheve të tjera gjyqësore, me vendim të KLD-së, veçse zvarritjet nuk shmangen dhe qytetarët ankohen.

b. Ankesat ndaj Gjykatës së Apelit

Gjatë vitit 2007 ndaj gjykatave të Apelit kanë ardhur gjithsej 40 ankesa. Vendin kryesor të këtyre ankesave (26) e zënë ato me objekt kundërshtim vendimi gjyqësor. Për ato është vendosur refuzimi i tyre mbasi kanë qënë jashtë juridiksionit tonë.

Për 14 raste të tjera ankesat kanë patur si objekt shpejtimin e gjykimit ose është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja jonë për uljen e masave të dënimit të dhëna nga Gjykatat e Shkallës së Parë ose na janë kërkuar ndërhyrje për dhënie kopje vendimi për të ushtruar rekurs brenda afatit ligjor, mbasi ka përfunduar gjykimi dhe nga gjyqtarët nuk janë arsyetuar vendimet, për dhënien e vërtetimeve të ndryshme gjyqësore etj.

1. Ankuesi I.I. nga qyteti i Vlorës është ankuar kundër Vendimit të Gjykatës Apelit Vlorë, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Vlorë, për të gjykuarin Nj.R.

Po kështu ai ankohet edhe kundër Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, me të cilin është vendosur lirimi para kohe me kusht i të gjykuarit Nj.R.

Ankuesi është sqaruar për rrugën ligjore që duhet të ndjekë për ankimimin ndaj vendimeve gjyqësore në gjykatat më të larta, duke patur parasysh se pushteti gjyqësor në Shqipëri është i pavarur dhe se institucioni ynë nuk mund të ndërhyjë për prishjen e vendimeve të gjykatave.

2. Ankuesi N.K. nga qyteti i Korçës, është ankuar për zvarritje pa shkaqe ligjore të një çështje penale nga Gjykata e Apelit Korçë.

Nga verifikimi i kryer në lidhje me këtë ankesë rezultoi se kjo çështja ka shkuar për gjykim në Gjykatën e Apelit Korçë me dt.16.01.2007.

Në seancën gjyqësore të dt.07.03.2007 është vendosur pranimi i kërkesës së ankuesit për përjashtimin e gjyqtarëve E.P. dhe M.M, ndërsa gjyqtari tjetër A.K. ka kërkuar dorëheqje nga ky gjykim mbasi kishte pengesa ligjore, kërkesë e cila është pranuar nga Kryetari i Gjykatës Apelit Korçë, me dt.12.03.2007.

Meqenëse edhe gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate kanë patur pengesa ligjore për gjykimin e çështjes, i është bërë kërkesë Ministrisë së Drejtësisë që të caktohen nëpërmjet KLD-së tre gjyqtarë të tjerë për gjykimin e saj.

Me dt.06.04.2007 janë caktuar gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, të cilët nuk e kanë gjykuar këtë çështje, mbasi ato kanë marrë pjesë më parë edhe në gjykimin e një çështje tjetër me objekt anulimin e vendimit të mosfillimit të çështjes penale ndaj ankuesit N.K.

Mbi këtë bazë, i është bërë kërkesë përsëri Ministrisë së Drejtësisë, për të komanduar gjyqtarë të tjerë. Me vendim të KLD-së janë caktuar tre gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Durrës, të cilët kanë përfunduar gjykimin e kësaj çështje.

3. Ankuesi A.B. nga qyteti i Vlorës, është ankuar kundër vendimit Gjykatës Apelit Vlorë, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilin ai është dënuar me 2 vjet burgim me kusht dhe me 300.000 lekë gjobë, për veprën penale të fallcifikimit të dokumentave zyrtare.

Nga ana jonë janë bërë sqarimet ligjore se kundër vendimit të Gjykatës Apelit, mund të ushtrohet rekurs brenda 30 ditëve, në Gjykatën e Lartë Tiranë, e cila, ka të drejtën e prishjes së vendimit kur janë kushtet ligjore.

4. Ankuesi B.Sh. nga rrethi i Fierit është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Vlorë, për zvarritjen pa shkaqe ligjore të gjykimin të çështjes penale ndaj M.S.dhe S.S të akuzuar për veprën penale të trafikimit të qënieve njerëzore.

Nga verifikimi i bërë kësaj ankese rezultoi se dosja penale e këtyre të akuzuarve ka shkuar për gjykim në atë gjykatë me dt.07.06.2007 dhe gjykimin e çështjes ishte caktuar me dt.28.09.2007.

Meqenëse gjyqtarët e kësaj gjykate kanë patur pengesa ligjore për gjykimin e çështjes i është kërkuar Ministrisë së Drejtësisë, caktimi i një gjyqtari tjetër nga Gjykatat e Apelit me qëllim që ky gjykim të përfundonte sa më shpejt.

5. Ankuesi i A.P. nga burgu i Peqinit është ankuar ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, me të cilin është gjykuar dhe dënuar me 20 vjet burgim për veprën penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të mitur dhe në gjini.

Nga ana jonë u bënë sqarimet e nevojshme për rrugën ligjore të ankimit në gjykatat më të larta duke dhënë këshillë se në bazë të nenit 131 shkronja "f" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ai mund të ankohej në Gjykatën Kushtetuese, duke parashtruar të gjitha shkeljet dhe pretendimet e tij që ai kishte ndaj vendimeve gjyqësore.

Po kështu në bazë të neneve 449 dhe 450 të Kodit Procedurës Penale, ankuesi u sqarua nga ana jonë se mund të drejtohej përsëri Gjykatës së Lartë Tiranë, me kërkesë për rishikimi vendimi.

6. Ankuesi R.D. nga rrethi i Dibrës, është ankuar për zvarritje gjykimi ndaj Gjykatës së Apelit Tiranë, në gjykimin e një çështje civile.

Nga verifikimi i bërë kësaj ankese rezultoi se kjo çështje ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë e rregjistruar me Nr.2805 dhe ndiqte radhën e gjykimin në bazë të rregullave të vendosura për gjykimet në Gjykatën e Apelit.

7. Ankuesi T.K. nga qyteti i Gjirokastrës, ankohej ndaj Gjykatës Apelit Gjirokastrë, për zvarritje pa shkaqe ligjore në gjykimin e një çështje civile.

Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se kjo çështje ndodhej e rregjistruar për gjykim në gjykatë me dt.16.06.2006.

Me dt.06.07.2006 ishte caktuar seanca gjyqësore, por nuk formohej trupi gjykues mbasi gjyqtarët e kësaj gjykate kishin pengesa ligjore dhe për këtë arsye ishte kërkuar që të komandoheshin gjyqtarë të tjerë për gjykimin e saj. Pasi u

caktuan gjyqtarë të tjerë, me dt.02.10.2006 gjykata kishte vendosur thirrjen e ekspertëve.

Me dt.30.10.2006 nuk ishin paraqitur ekspertët. Me dt.14.11.2006 nuk është paraqitur pala M.B mbasi kishte qënë e sëmurë me raport mjeksor. Me dt.18.12.2006 gjykata me vendim të ndërmjetëm ka vendosur për kqyrjen në vend të objektit.

Me dt.22.01.2007 gjykata u ka propozuar palëve zgjidhjen e çështjes me pajtim dhe palët kanë rënë dakord.Me dt.19.02.2007 ankuesi T.K. nuk ka qënë dakord me zgjidhjen me pajtim të kësaj çështje dhe ka kërkuar që të kryhet ekspertimi.

8. Ankuesja N.F. nga qyteti i Shkodrës është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila megjithëse ka përfunduar gjykimin dhe ka shpallur vendimin për zgjidhjen e një çështje konkrete pa shkaqe ligjore, asaj nuk i jepej kopja e vendimit për të ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë brenda afatit ligjor.

Nga verifikimi i kësaj ankese dhe ndërhyrja jonë u bë e mundur dhënia e kopjes së vendimit ankueses në një kohë se më të shpejtë.

9. Ankuesi J.N. nga qyteti i Tiranë ankohej ndaj Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila kishte përfunduar gjykimin e një çështje civile dhe pa shkaqe ligjore, nuk i jepete dhe komunikonte kopjen e vendimit gjyqësor të marrë në mungesë të tij, mbasi ai kishte qënë jashtë shtetit dhe do të ushtronte rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga verifikimi i kryer kësaj ankese u bë komunikimi i vendimit gjyqësor dhe ju dha një kopje e këtij vendimi duke filluar afati i rekursit nga dita e këtij komunikimi.

10. Ankuesi N.Zh. nga qyteti i Sarandës është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila pa shkaqe ligjore nuk i lëshonte vërtetim se çështja e tij e gjykuar në vitin 1994 nuk ishte shqyrtuar në shkallë të dytë nga Gjykata e Apelit Tiranë. Mbasi u bënë verifikimet e nevojshme nga kjo gjykatë u lëshua vërtetimi përkatës me qëllim që ai të kërkonte nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për atë vendim.

Nga ana jonë në çdo rast janë bërë sqarimet e nevojshme ligjore për rrugën që mund të ndjek ankuesi për zgjidhjen e problemit si me kërkesë për gjykim në Gjykatën Kushtetuese, në bazë të nenit 131 germa “f” të Kushtetutës, ashtu edhe me kërkesë për rishikim vendimi në Gjykatën e Lartë, në bazë të nenit 494 të Kodit Proçedurës Civile, duke kërkuar për realizimin e këtyre të drejtave edhe ndihmën e një avokati privat.

c. Ankesat ndaj Gjykatës së Shkallës Parë për Krimet e Rënda

Gjatë vitit 2007 në institucionin tonë kanë ardhur gjithsej 7 ankesa ndaj Gjykatës së Shkallës Parë për Krimet e Rënda.

Në 6 raste ankesat kanë qënë kundra vendimeve gjyqësore dhe nga ana jonë, duke i konsidruar jashtë juridiksionit të institucionit tonë, i kemi refuzuar ato. Në 1 rast ankesa ka qënë për zvarritje gjykimi nga Gjykata e Shkallës Parë për Krimet e Rënda.

1. Ankuesja F.B. ankohet kundra urdhërit të ndalimit të Prokurorit të çështjes në Prokurorinë e Krimeve të Rënda Tiranë, të lëshuar me dt.14.06.2007.

Nga verifikimi i bërë ankesës së tij rezultoi se ai është akuzuar nga organi i Prokurorisë si bashkëpunëtor në veprën penale të trafikut të narkotikëve në bazë të nenit 283/a2 të KP dhe nga ana e jonë u bënë sqarimet e nevojshme. Ankuesi u sqarua gjithashtu mbi rrugën ligjore që mund të ndjekë ndaj vendimit gjyqësor në gjykatat më të larta në shkallët e gjyqësorit

2. Ankuesja Z.Gj. nga rrethi i Tropojës është ankuar për zvarritje pa shkaqe ligjore në gjykimin e çështjes penale ndaj saj nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Nga verifikimi i bërë kësaj ankese rezultoi se ndaj ankueses janë zhvilluar gjithësej 16 seanca gjyqësore të cilat janë shtyrë për mungesë të avokatit mbrojtës, mbasi avokatët e caktuar kryesisht nuk paraqiten në të gjitha seancat e gjykimit.

3. Ankuesi L.T. nga Tirana, ankohej kundër vendimit të Gjykatës Shkallës Parë për Krimet Tiranë.

Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se çështja e tij ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, ku ai vetë ose nëpërmjet avokatit privat, kishte të drejtë të parashtronte gjatë gjykimit të çështjes të gjitha shkeljet dhe pretendimet e tij në lidhje me vendimin gjyqësor.

4. Ankuesi E.C. është ankuar ndaj vendimit Nr.38 dt.22.09.2006 të Gjykatës Shkallës Parë Për Krimet e Rënda Tiranë. Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se kjo çështje ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda dhe ankuesi ose avokati i tij privat pretendimet e tyre mund t'i parashtronin gjatë gjykimit të saj.

5. Ankesa e M.M. nga rrethit i Kukësit, i cili ankohej kundra vendimit nr. 67 dt. 19.12.2003 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Kukës, që kishte vendosur masën e sigurisë duke caktuar burg pa afat.

Ankuesi ka pretenduar se ka kaluar afati i paraburgimit tij.

Por nga verifikimi i ankesës së tij rezultoi se ndaj tij gjykata kishte vendosur pezullimin e afateve për 15 muaj e 6 ditë. Në fakt në burg ankuesi ka qëndruar vetëm 24 muaj. Po kështu ankuesi është sqaruar se për zgjidhjen e këtij problemi ai mund t'i drejtohej me kërkesë gjykatës dhe të kërkonte prej saj shuarjen e masës sigurimit duke parashtruar para saj të gjitha pretendimet e tij. Si përfundim rezultoi se ankesa e ankuesit ishte e padrejtë.

ç. Ankesat ndaj Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda

Gjatë këtij viti në intitucionin tonë ka ardhur vetëm një ankesë ndaj Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

Ankuesi A.O. nga qyteti i Vlorës, ankohej kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për krimet e Rënda Tiranë dhe ka kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen tonë për prishjen e tij.

Po kështu ankuesi pretendonte se vëllezërit e tij, që ndodheshin të arrestuar, nuk kanë trajtim të mirë ushqimor dhe shëndetësor në vendin e vuajtjes së dënimit me burgim.

Në rastin konkret ankuesi është sqaruar se kundër vendimit të Gjykatës Apelit për Krimet e Rënda në bazë të nenit 435 të Kodit Proçedurës Penale, mund të ushtronte rekurs brenda 30 ditëve, në Gjykatën e Lartë.

Në lidhje me kushtet e ushqimit dhe shëndetësore të vëllezërve të tij në burg mbasi problemi u verifikua në vend ankuesi është sqaruar se ato i kanë dhe i gëzojnë kushtet e trajtimit si gjithë të dënuarit e tjerë.

d. Ankesat ndaj Gjykatës së Lartë

Dihet se Gjykata e Lartë nuk ka lidhje vartësie nga Ministria e Drejtësisë. Por ne i kemi radhitur ankesat në këtë kre, për shkak të problemeve që ngrenë shtetasit

për këtë Gjykatë që janë pothuaj të njëjlojta me ato që ngrejne ata edhe për gjykatat më të ulta.

Në vitin 2007 kundër Gjykatës së Lartë kanë ardhur gjithsej 25 ankesa. Nga këto, në 15 raste ankesat kanë qënë kundra vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe nga ana e jonë ato janë refuzuar si të pabazuara.

Nga ana jonë janë bërë të gjitha sqarimet e nevojshme duke orientuar ankuesit që në rast se ato kanë argumenta ligjore se ndaj tyre gjykatat nuk kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor, mund t'i drejtohen me kërkesë për gjykim Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 131 shkronja " f " të Kushtetutës.

Nga 10 ankesat e tjera, në 5 raste ato kanë qënë për shpejtim gjykimi, në 3 raste është kërkuar të shpejtohet kërkesa e tyre për rishikim vendimi, në 1 rast është kërkuar t'i jepet kopja e vendimit dhe në një rast tjetër është kërkuar që të bëhet ndreqje gabimi e vendimit të asaj gjykate.

Ja disa nga rastet e këtyre ankesave sipas objektit të tyre.

1. Ankuesi J.B nga qyteti i Korçës, është ankuar ndaj vendimit Nr.720 dt.29.05.2007 të Gjykatës së Lartë dhe ka kërkuar prishjen e tij mbasi ai është i padrejtë dhe i pabazuar në ligj.

Nga ana jonë ankuesi është sqaruar se vendimet gjyqësore janë jashtë juridiksionit tonë dhe ai, në bazë të nenit 131 shkronja f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka të drejtë ti drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke argumentuar para saj se gjykatat ndaj tij kanë zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor dhe të kërkohet deklarimi i këtij vendimi si antikushtetues. Për realizimin e kësaj të drejte ankuesi u sqarua se mund të konsultohet me avokatin e tij privat i cili do të pregatitë dokumentat e nevojshme dhe do të bën mbrojtjen në gjykatë.

2. Ankuesi L.M. nga qyteti i Sarandës ankohej ndaj vendimit Nr.40 dt.15.12.2006 të Gjykatës së Lartë Tiranë, duke pretenduar se gjykimi dhe dënimi i djalit tij ishte i padrejtë duke u kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e institucionit tonë për prishjen e tij dhe uljen e masës së dënimit të dhënë me burgim nga gjykata.

Nga verifikimi i bërë kësaj ankese rezultoi se ankuesi kishte edhe dy mundësi të tjera për të vepruar për zgjidhjen e këtij problemi dhe konkretisht në bazë të nenit 131 shkronja " f " të Kushtetutës të ankohej në Gjykatën Kushtetuese, për një proces të parregullt gjyqësor, dhe në bazë të nenit 449, 450 të Kodit Proçedurës Penale, mund t'i drejtohet me kërkesë për rishikim vendimi Gjykatës së Lartë, në rast se kishin dalë prova të reja dhe që ato nuk janë administruar më parë nga gjykata.

3. Ankuesja F.A. nga qyteti i Beratit ankohej ndaj një vendimi për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Rrethit Gjyqësor Berat, dhe Gjykata e Apelit Vlorë, marrë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

Nga ana jonë janë bërë sqarimet e nevojshme se këto vendime nuk janë përfundimtare dhe të gjitha pretendimet e saj ajo mund t'i paraqiste vetë ose nëpërmjet avokatit privat në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë.

4. Ankuesja A.K. ankohet ndaj Gjykatës së Lartë për zvarritje pa shkaqe ligjore në gjykimin e çështjes penale ndaj D.Gj. për të cilin kishte vendosur përfundimisht Gjykata Kushtetuese dhe se shtyrja e këtij gjykimi shkaktonte kalimin e afatit të burgimit të tij te afatit të parashikuar nga ligji.

Me anë të një rekomandimi drejtuar Gjykatës së Lartë nga ana jonë u bë prezent problemi dhe u kërkuar shqyrtimi i kësaj çështje me përparësi pa prituri radhën e gjykimit, pasi kalimi i afatit do të shkaktonte shkeljen e të drejtave të njeriut të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa

Europiane e të Drejtave të Njeriut, dhe ligjet e aktet e tjera nënligjore të njohura nga shteti për të burgosurit.

Rekomandimi ynë u pranua dhe u bë i mundur gjykimi në një kohë më të shpejtë i kësaj çështje duke u vendosur përfundimisht lirimi e tij.

5. Ankuesi Q.K. nga qyteti i Tiranës ankohej ndaj Gjykatës së Lartë, se ndonëse kishte kërkuar ti jepet një kopje e vendimit gjyqësor Nr.353 dt.29.10.1945 të Gjykatës Ushtarake në Gjykatën e Lartë, për dënimin e babajt tij, pa shkaqe ligjore, nuk i jepej asnjë përgjigje.

Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se ky vendim nuk ndodhej në Gjykatën e Lartë por në Arkivin e Ministrisë së Brendëshme.

Me ndërhyrjen tonë u bë e mundur marrja e këtij vendimi, i cili ju dorëzua ankuesit, me qëllim për ta përdorur atë sipas nevojave të tij. 6. Ankuesi H.T. nga qyteti i Tiranës është ankuar për zvarritje gjykimi nga Gjykata e Lartë në shqyrtimin e një rekursi kunder vendimeve të Gjykatës Rrethit të Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Apelit Durrës.

Nga verifikimi i bërë kësaj ankese rezultoi se rekursi i tij ishte shqyrtuar në Gjykatën e Lartë me dt.08.01.2007 dhe ishte vendosur mospranimi i rekursit.

Ankuesi u sqarua se çdo shtetas ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës dhe të kërkojë përmbushjen dhe mbrojtjen e të drejtave të tij në të gjitha shkallët e gjyqësorit shqiptar dhe se për shkeljet e pretenduara, ai mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por edhe më tej në Gjykatën Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, dhe se kjo e drejtë nuk mund t'i mohohet askujt.

*
* *
*

Duke patur parasysh problemet që kanë dalë herë pas here për sigurinë e gjyqtarëve, kemi dërguar një rekomandim për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit Nr.9110 dt.24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”. Rekomandimi i është drejtuar Kryeministrit, Ministrit të Drejtësisë dhe për dënimin Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Në nenin 10 të këtij ligji të sipërcituar, parashikohet se brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, pasi të ketë marrë edhe mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duhet të nxjerrë aktet nënligjore të nevojshme lidhur me sigurimin dhe ruajtjen e posaçme të mjediseve të punës, ruajtjen e afërt fizike, mbrojtjen e familjes dhe atë pasurore si dhe të masave të tjera që lidhen me mbrojtjen e posaçme të Gjykatave për Krimet e Rënda, të gjykatave të Apelit për Krimet e Rënda si dhe të gjyqtarëve të tyre.

Duke qënë se afati i parashikuar në ligj ka kaluar dhe nuk janë nxjerrë aktet nënligjore, nga ana e Avokatit të Popullit u dërgua Rekomandimi për nxjerrjen e tyre. Për këtë problem na është kthyer përgjigje nga Qeveria me dt.05.07.2007 ku thuhet se Drejtoria e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, po përgatit aktet e nevojshme, dhe se është drejt përfundimit të këtij procesi. Por realisht deri tani akoma nuk janë nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore nga Qeveria për këtë qëllim, prandaj do të përsëritim rekomandimin.

4. Ankesat për Prokurorinë

Sipas Kushtetutës sonë Prokuroria nuk bën pjesë në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, por për lehtësi studimi e kemi përfshirë pas saj.

Veprimtaria e punës së Avokatit të Popullit, në shqyrtimin e ankesave të shtetasve ndaj organit të Prokurorisë ka konsistuar në zbatimin korrekt dhe objektiv të Kushtetutës, ligjit që normon punën tonë dhe ligjit procedural penal.

Në rastet e konstatimit të shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve në procesin penal, duke bashkëpunuar me Prokurorinë, kemi synuar që ato t'i shërbejnë qëllimit të mirë për përmirësimin e punës së Prokurorisë në drejtim të respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Për vitin 2007 në Institucionin tonë **340** shtetas të ndryshëm kanë paraqitur **169** ankesa apo kërkesa, të cilat kanë patur për objekt veprimtarinë e punës së organit të Prokurorisë. Mënyra e përfundimit të ankesave për vitin 2007 është: **57** ankesa janë zgjidhur në favor ose 33.7 përqind, **39** ankesa kanë qënë jashtë juridiksionit, **63** ankesa jashtë kompetence, dhe **10** ankesa kanë qënë të pabazuara. Për vitin 2008 kanë kaluar për shqyrtim 5 ankesa. Gjatë vitit 2007 janë shqyrtuar dhe 3 ankesa të mbartura nga viti 2006, të cilat kanë përfunduar në këtë mënyrë: 2 ankesa janë zgjidhur në favor dhe 1 ankesë ka qënë jashtë kompetence.

Edhe për vitin 2007 ankesat e shtetasve ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë janë shqyrtuar me përparësi. Për ankesat që kanë qënë brënda kompetencës sonë, Avokati i Popullit ka bërë vlerësimet e rastit dhe ka urdhëruar kryerjen e procesit të hetimit administrativ nëpërmjet realizimit të veprimeve të nevojshme si marrja e deklarimeve të shtetasve të ndryshëm, kqyrja e dokumentave, kryerja e ekspertimeve mjeko-ligjore ose teknike me specialistë të fushave përkatëse, apo duke studjuar dosje hetimore për të cilat Prokuroria kishte vendosur pushimin apo pezullimin e çështjes penale.

Për mjaft ankesa është shkuar në vëndbanimin e ankuesit ose kërkuesit, apo janë kryer veprimet në vënd, duke marrë dhe shpjegimet apo informacionin e nevojshëm në organin e Prokurorisë, ndaj të cilit shtetasi ka bërë ankimin. Vlen për t'u përmëndur fakti se gjatë vitit 2007 Avokati i Popullit ka kryer inspektime me grup ekspertësh në Institucionet e Paraburgimit si në Vlorë, Durrës etj, duke marrë një numur të konsiderueshëm ankesash nga shtetas të ndryshëm që ndodhen në këto institucione. Pra, për vitin 2007 është bërë një vlerësim korrekt i ankesave dhe për rrjedhojë janë kryer hetime të gjithanëshme me ditë të tëra e me grup ekspertësh, dhe është ndjekur ecuria e tyre në vazhdimësi deri në përfundimin e çështjeve penale nga organi i Prokurorisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me preçedencë dhe ankesat e shtetasve apo shoqatave që përfaqësojnë interesa të një grupi të caktuar personash të organizuar në sindikata, fondacione si nga Shoqata e Romëve "Për integrim dhe kundër trafikut të Fëmijëve"; Shoqata e "policëve të vrarë në krye të detyrës"; Kryetari i Shoqatës së Romëve, dega Korçë; Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Shqipërisë F.M etj.

Për vitin 2007 vihet re se, ankesa apo kërkesa në Institucionin e Avokatit të Popullit janë paraqitur dhe nga kryetarë të Komunave në rrethe të ndryshme të vëndit si në Ballagat të Lushnjës, Ksamil të Sarandës etj, të cilat kanë konsistuar në fillimin e hetimeve të procedimeve penale nga Prokuroria.

Institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2007 ka marrë në shqyrtim dhe ankesën e shtetasit kosovar I.T. nga Komuna e Gjakovës, dërguar nga Ombudspersoni i Kosovës. Shtetasi I.T. ngrinte shqetësimin për faktin se avokati

mbrojtës i vëllait të tij A.T. që ndodhej i arrestuar në Institucionin e Paraburgimit Durrës kërkonte një shumë prej 3500 Euro. Mbi këtë ankesë është kryer verifikimi i çështjes në Prokurorinë e rrethit Gjyqësor Durrës nga ku rezultoi se, organi i Prokurorisë kishte kërkuar pranë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës si masë sigurimi “garanci pasurore në masën 400.000 lek”, ndaj të pandehurit A.T. akuzuar për veprat penale të “Falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave apo vizave” dhe “Falsifikim të vulave, stampave apo vizave”, parashikuar nga nenet 189/1 dhe 190/1 të Kodit Penal.

Shtetasit kosovarë kanë paraqitur dhe kërkesa apo ankesa individuale në Institucionin e Avokatit të Popullit. Shtetasi F.D. nga Mitrovica e Kosovës ka kërkuar ndërhyrjen e Zyrës tonë për marrjen e dëmshpërblimit si i përndjekur politik, i dënuar në vitin 1976 me 10 vjet burgim për krimin e “Agjitacionit dhe propagandës”. Pas verifikimit të problemit në Institutin e Integritit të të Përndjekurve Politikë, kërkuesi u sqarua për dokumentat që duhet të plotësonte dhe më pas dërgimin e tyre pranë atij Instituti.

A. Gjatë shqyrtimit të ankesave për vitin 2007, vihet re se objekti i tyre është i njëjtë me objektin e ankesave të paraqitura edhe gjatë vitit 2006. Në mënyrë të grupuar shtetasit ankohen ndaj Prokurorisë:

1. Për zvarritje në hetimin e çështjeve penale

Raste të tilla mund të përmëndim ankesën e shtetasve F.Ç. dhe SH.R. nga Tirana; E. M. nga Saranda; Z. G. nga Fieri; A.P. nga Kavaja; I.S nga Durrësi; Z.M. nga Shkodra etj.

-Në Institucionin e Avokatit të Popullit një numur i konsiderueshëm ankuesish nga rrethe të ndryshme të vendit ngrenë shqetësimin për zvarritje në hetimin e çështjeve penale për krime të rënda si “Vrasje”, “Trafikim të lëndëve narkotike”, “Trafikim të të miturve” apo dhe vepra të tjera penale si “Falsifikim të dokumentave” etj. Kështu në ankesën e tij shtetasi E.M. nga Saranda, ka ngritur shqetësimin për zvarritje të pajustificuara në hetimin e proçedimit penal në ngarkim të babait të tij SH.M, akuzuar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 186/1 të Kodit Penal. Proçedimi penal ka numrin 9 të vitit 2007 dhe hetimet kanë përfunduar pas tetë muajve. Konkretisht më datë 21.09.2007 kur çështja penale është dërguar në gjyq.

- Në ankesën e saj shtetësja Z.G. nga Baçova e Fierit ka ngritur shqetësimin për zvarritje të pajustificuara në hetimin e proçedimit penal në ngarkim të bashkëshortit të saj B. G, akuzuar për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”. Kështu, nga studimi i akteve të proçedimit penal Nr. 350, filluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier qysh më datën 13.07.2005 konstatohet se, fillimisht gjatë muajit korrik janë kryer disa veprime hetimore siç janë proçes verbali dhe vendimi për sekuestrimin e sendeve, prova materiale lënda “canabis sativa”, e vendimi për kryerjen e ekspertimit kimik të tyre. Mandej, është kryer ndonjë veprim i shkëputur në muajin tetor dhe vetëm në muajin dhjetor janë marrë deklarime disa personave, është njoftuar shtetasi B.G. me akuzën kurse akti i ekspertimit kimik në atë organ ka ardhur në muajin gusht 2007. Për periudhën nga data 15 tetor 2006, deri në momentin kur çështja penale është dërguar në gjyq më datën 05.07.2007, është marrë zgjatje afati, në mënyrë krejt formale dhe aspak e përlligjur në respekt të nenit 324 të Kodit të Proçedurës Penale. Për zvarritjen e pajustificuar në hetimin e këtij proçedimi penal është përgatitur rekomandimi drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për marrjen e masave disiplinore ndaj Prokurorit të çështjes dhe vënien në vënd të së

drejtë së shkelur të shtetasit B.G.

- Në ankesën e tyre shtetasit A.Z, K.H dhe A.S. nga Vlora të mitur të datëlindjes 1993, disa muaj mbi moshën e përgjegjësishë penale, kanë ngritur shqetësimin për zvarritje në hetimin e procedimit penal Nr. 601 të filluar më datën 09.07.2007 nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Shtetasit e mësipërm janë akuzuar për veprën penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300/1 të Kodit Penal për arsye se kanë qënë të pranishëm në ngjarjen e datës 07.07.2007 kur shtetasi J.I. ka vrarë me thikë shtetasin M.L. Prokuroria edhe pse ka patur mundësitë për të përfunduar shpejt hetimin e çështjes, më datën 24.10.2007 ka dërguar çështjen në gjyq. E përmëdim këtë rast sepse qëndrimi i të miturve në dhomat e paraburgimit me kushte tejet të vështira, influencon negativisht për gjëndjen shëndetësore dhe psihike të tyre.

Nga studimi dhe analiza e rasteve, kur hetimet e procedimeve penale janë zvarritur në mënyrë të pajustificuar nga organi i Prokurorisë, konstatohet se zvarritjet e tejzgjatura në hetimin e çështjeve penale shpesh nuk kanë qënë justifikuese. Zvarritjet flasin sa për mosplanifikim në kryerjen e veprimeve hetimore të gjithanëshme dhe në vazhdimësi, ashtu dhe për moskontroll të prokurorit që ndjek hetimin ndaj oficerëve të policisë gjyqësore. Shpesh, zvarritjet e hetimeve të procedimeve penale kanë patur si shkak transferimin e çështjeve penale nga një rreth tek tjetri duke shpallur moskompetencën gjatë hetimeve paraprake, kërkesë kjo e parashikuar nga neni 84 i Kodit të Procedurës Penale. Ankesat e shtetasve për zvarritje në hetimin e çështjeve penale kanë qënë dhe ndaj Prokurorisë për Krime të Rënda. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit E.R. nga Gjirokastra; I.S. nga Durrësi etj. Shtetësja E.R. nga Gjirokastra ka ngritur shqetësimin për zvarritje në hetimin e procedimit penal që bën fjalë për veprën penale të “Trafikimit të të miturve” e kryer në bashkëpunim me persona të tjerë, parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal për të cilën Prokuroria e Krimeve të Rënda Tiranë, më datën 10.11.2006, ka filluar procedimin penal Nr.102. Pavarësisht veprimeve hetimore të kryera, organi i Prokurorisë lidhur me këtë rast duhej të kërkonte me insistim pranë autoriteteve të drejtësisë greke kthimin e përgjigjeve të letër porosive të dërguara me qëllim ekzekutimin e tyre dhe përfundimin e hetimit sa më parë.

Konstatojmë se më tepër duhet të vlerësohet momenti i rregjistrimit të veprës penale në rregjistrin penal që disponon organi i Prokurorisë, të pasqyruar në të me vërtetësi dhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale, mbasi nga ky moment fillon afati i hetimit të çështjes penale, parashikuar nga neni 287/1 e Kodit të Procedurës Penale.

Nuk duhet të abuzohet në disa raste duke zgjatur hetimin e çështjes me justifikimin se vepra penale është pa autor, kur në kallëzimin e tyre drejtuar Prokurorisë, shtetasit tregojnë dhe për autorin e veprës penale.

2. Për moskryerje të hetimeve të gjithanëshme dhe objektive

Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasve R.D. nga Golemi i Kavajës; F.S. nga Tirana; P.GJ. nga Kallmeti i Lezhës; LL.A. nga Gjirokastra; H.Z. dhe N.K. nga Korça; H.R. nga Malësia e Madhe dhe A.H. nga Delvina;

Më konkretisht ankesat e tyre kanë konsistuar në mosvënien para përgjegjësishë ligjore të autorit dhe bashkëpunorëve në kryerjen e krimit, në mosnjoftimin e akuzave për të gjitha veprat e kryera nga të pandehurit, në mosnxjerrjen e motiveve që kanë shtyrë autorët në kryerjen e veprës penale, në ndryshimin e kualifikimit të veprës nga një vepër më e rëndë në veprën më të lehtë

në ngarkim të pandehurit, në moskryerjen e ekspertimeve të ndryshme mjeko-ligjore apo tekniko-grafike të nënshkrimit etj. Për rrjedhojë moskryerja e hetimeve të gjithanëshme në disa raste, ka sjellë për pasojë dhe pezullimin e hetimit apo pushimin e çështjes penale.

- Kështu në ankesën e tij shtetasi H.T. nga Lekaj i Kavajës ngre shqetësimin dhe ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethi për arsye se nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në hetimin e proçedimit penal që bën fjalë për “Vrasje në rrethana të tjera cilësore kundër dy ose më shumë personave”. (Ngjarje e ndodhur datë 26.12.2006 ku janë vrarë me armë zjarri djali i tij D.T. dhe shtetasi A.T.). Rezultoi se Prokuroria ka marrë në përgjegjësi penale si autor të mundëshëm të kësaj vrasje shtetasin F.K. dhe pas përfundimit të hetimit ka dërguar çështjen në gjyq. Por Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë bazuar në nenin 377 të Kodit të Proçedurës Penale, i ka kthyer aktet e proçedimit penal organit të Prokurorisë. Prokuroria ka pushuar akuzën në ngarkim të shtetasit të dyshuar si autor i vrasjes, por është duke kryer hetime të mëtejshme.

- Në ankesën e tij shtetasi N.K. nga Korça ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethi e cila nuk ka kryer hetime të gjithanëshme pas shfuqizimit të vendimit të pushimit, nga Prokurori i Përgjithshëm sipas vendimit të datës 30.04.2007. Proçedimi penal i filluar mbi bazën e kallëzimit të ankuesit N.K. bën fjalë për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit R.SH, ish rregjistruer i Zyrës së Rregjistrimit të Pasurisë së Paluajtëshme në Korçë.

- Në ankesën e tij shtetasi H.K. nga Voskopi i Korçës paraqet shqetësimin për moskryerje të hetimeve të gjithanëshme nga Prokuroria e atij rrethi, në proçedimin penal që bën fjalë për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave”, në ngarkim të ish kryeplakut të fshatit Dersnik N.M. Organi i Prokurorisë në mënyrë të njëanëshme ka vendosur pushimin e hetimit për këtë çështje penale, vendim i cili është prishur nga Gjykata e Apelit Korçë. Por përsëri Prokuroria ka pushuar çështjen. Shtetasi H.K është ankuar tek Prokurori i Përgjithshëm, i cili më datën 24.05.2006, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes. Përfundimisht, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë ka pushuar çështjen penale bazuar në nenin 328 Pika 1 gërma “b” të Kodit të Proçedurës Penale me arsyetimin se: “...Nuk ndodhemi para veprës penale të falsifikimit të dokumentave por para një lajthimi në objekt duke ngatëruar personat, se është gabim i pranueshëm njerëzor...”.

- Rast tjetër është dhe ankesa e shtetasit P.GJ. nga Kallmeti i Lezhës i cili ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethi për arsye se, nuk ka kryer hetime të gjithanëshme në proçedimin penal, që bën fjalë për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” ndaj ish drejtuesve të komunës Kallmet. Kështu, organi i Prokurorisë Lezhë pas kallëzimit të bërë nga shtetasi P.GJ. ka vendosur mosfillimin e proçedimit penal. Por pas ankimit të shtetasit kundër këtij vendimi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, më datën 07.02.2007, ka vendosur prishjen e vendimit duke urdhëruar vazhdimin e hetimit. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë më datën 05.07.2007 ka vendosur pushimin e hetimeve të çështjes penale.

- Për vitin 2007, duke ndjekur me shqetësim rastet e ankesave të disa shtetasve për humbjen e jetës së të afërmëve të tyre, si rezultat i punës së pakujdesshme të mjekëve apo personelit tjetër mjekësor, janë grumbulluar të dhëna dhe informacione nga disa Prokurori të rretheve, të cilat kanë hetuar çështjet penale për veprën penale të “Mjekimit të Pakujdesshëm”, me pasojë vdekjen e personit, parashikuar nga neni 96 e Kodit Penal. Me marrjen e të gjitha të dhënave të

nevojshme do të realizohet për vitin 2008 një studim disa vjeçar dhe problemet që do të dalin, mendojmë t'ja dërgojmë Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Shëndetësisë etj.

3. Për shkelje proceduriale në kryerjen e veprimeve hetimore

Këto shkelje kanë konsistuar në ndalimin e paligjshëm të personave, mosnjohim të akuzës në ngarkim të tyre, mbajtje tej afateve të hetimeve paraprake apo dhe ndjekjen penale në një kohë që për të njëjtën akuzë, ka patur proces gjyqësor nga autoritetet e drejtësisë të shteteve të tjera.

- I tillë është rasti i ankesës së shtetasit I.S. nga Durrësi, ndaj të cilit dhe disa personave të tjerë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rregjistruar procedimin penal që më datë 28.01.2001. Baza për fillimin e këtij procedimi penal kanë qënë shkresat e ardhura nga Gjykata e Barit në Itali, e cila në fazën e hetimeve paraprake, kishte marrë vendime arresti për 27 persona midis të cilëve dhe për shtetasin I.S. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka dërguar materialet e procedimit penal Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila nga ana e saj, ka rregjistruar procedimin penal më datë 26.08.2002. Ky procedim penal mbasi është bashkuar me procedimin penal Nr. 59 të vitit 2002, i është transferuar për kompetencë Prokurorisë “Për Krime të Rënda” Tiranë.

Prokuroria “Për Krime të Rënda” Tiranë, më datën 18.11.2004 ka rregjistruar procedimin penal Nr. 294 për veprat penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike”, “Organizim dhe drejtim i organizatës kriminale” dhe “Krijim i bandës së armatosur dhe organizatës kriminale”, të parashikuara nga nenet 283/a, 284/a dhe 333 të Kodit Penal. Më datën 27.04.2006 është bërë dhe rregjistrimi i emrit të shtetasit I.S. në rregjistrin e njoftimit të veprës penale.

Më datën 27.04.2006, me urdhër të Prokurorisë, Policia Gjyqësore ka kryer ndalimin e shtetasit I.S. veprim i cili me të drejtë nga ana e Gjykatës është cilësuar i paligjshëm, mbasi nuk janë respektuar kërkesat e nenit 253 të Kodit të Procedurës Penale. Nga analiza e akteve të administruara në procedimin penal në ngarkim të shtetasit I.S, G.S dhe A.V. pavarësisht veprimeve hetimore të kryera dhe sidomos ato që lidhen me dërgimin e shkresave “letërporosi drejtuar autoriteteve italiane”, organi i Prokurorisë duke mbajtur në burg tej afatit të hetimeve paraprake apo pa i njoftuar akuzën konkrete shtetasit I.S, nuk ka realizuar një proces të rregullt ligjor dhe brënda një afati të arsyeshëm duke cënuar të drejtën kushtetuese që përcaktohet në pikën 3 të nenit 28, pikën 1 të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë si dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Për këto shkelje i kemi rekomanduar Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, marrjen e masave për respektimin e të drejtave proceduriale dhe kushtetuese për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë shtetasi I.S. u lirua nga Dhomat e Paraburgimit.

- Rast tjetër është dhe ankesa e shtetasit K.B. me profesion avokat pranë Dhomës së Avokatisë Vlorë, i cili është ankuar ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për arsye se në procedimin penal të vitit 2005 në ngarkim të shtetasve N.A.dhe D.R, masa e sigurimit ndaj tyre ishte shuar pasi koha e zgjatjes së paraburgimit të vuajtur, ishte më e madhe se masa e dënimit të caktuar. Mbi kërkesën e të pandehurit të tretë A.T nëpërmjet mbrojtësit të tij për shuarjen e masës së sigurimit, Gjykata e pranoi atë dhe për rrjedhojë ai u lirua nga dhomat e paraburgimit. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka ekzekutuar urdhërin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë duke liruar pas disa ditëve nga dhomat e paraburgimit dhe dy të pandehurit e tjerë N.A. dhe D.R. Pas kallëzimit

penal të paraqitur nga avokati mbrojtës K.B. Prokuroria e rrethit gjyqsor Fier ka rregjistruar procedimin penal për veprën penale të “Mosmarrjes së masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme”, në ngarkim të Prokurorit të çështjes D.M.

- Policia Gjyqësore Shkodër ka kryer ndalimin e shtetasit G.J.K, akuzuar për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin Nr. 49 datë 27.02.2007 e ka cilësuar të paligjshëm ndalimin e shtetasit G.J.K, me arsyetimin se jo vetëm që kanë qënë veprimet e paligjshme të dëmtuarit që përbëjnë shkakun e vërtetë të ngjarjes, por dhe është shkelur i neni 253 të Kodit të Procedurës Penale, sepse policia gjyqësore nuk mori urdhërin nga Prokurori për ndalimin e personit.

- Në të njëjtën mënyrë nga ana e policisë gjyqësore është vepruar dhe në rastin e shtetasit H.A. nga Tirana i cili është arrestuar në flagrancë për kryerjen e veprave penale të “Kundërshtimit të punonjësit të policisë” dhe “Prishjes së qetësisë publike”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj Nr.112 datë 03.02.2007 ka cilësuar si të paligjshëm arrestimin në flagrancë me arsyetimin se, nuk ndodhemi në asnjë prej kushteve të parashikuara për gjendjen e flagrancës sipas nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale.

4. Për akuzë të padrejtë apo rëndim të akuzave, në momentin e marrjes në përgjegjësi penale

- Rastet që ankuesit i janë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit për akuzë të padrejtë të ngritur nga organi i Prokurorisë kanë qënë kryesisht ato kur të pandehurit kanë marrë pafajësi nga Gjykata, apo kur Gjykata ka kthyer aktet e çështjes organit të Prokurorisë dhe më pas kjo e fundit, ka vendosur pushimin e hetimit të çështjes penale. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit E.L. nga Lushnja i cili ankohet ndaj Prokurorisë së Apelit Vlorë për faktin se, pas dhënies së pafajësisë të pandehurës M.M. nga Gjykata e Apelit Vlorë, të cilën e kishte kallëzuar në Prokurori për veprën penale të “Ekspertimit të rreme”, Prokurori i seancës ka hequr dorë nga ankimi, ndonëse Prokuroria e Rrethit Vlorë, kërkoi deklarin fajtor dhe dënimin e M.M. me 100.000 lek gjobë.

- Në ankesën e tij shtetasi S.K. nga Hasi, ngre shqetësimin dhe ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, e cila e ka akuzuar padrejtësisht për veprën penale të “Kontrabandës” kryer në bashkëpunim. Ky procedim penal i është transferuar për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila nga ana e saj, ka vendosur pushimin e procedimit penal. Në këto rrethana ankuesi është sqaruar për të drejtën e paraqitjes së kërkesë padisë në Gjykatë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar, parashikuar nga nenet 640 e në vijim të Kodit Civil.

- Rast tjetër është ankesa e shtetasit V.D. nga Fieri ndaj Prokurorisë Për Krime të Rënda Tiranë, për akuzë të padrejtë ndaj djalit të saj V.D, për veprën penale të “Trafikimit të femrave për prostitucion” ndaj bashkëshortes së tij. Ankuesja ka ngritur dhe pretendimin se djali i saj është i sëmurë nga gjëndja shëndetësore dhe për këtë ju rekomandua që dokumentat mjeko-ligjore që vërtetojnë gjëndjen e rëndë shëndetësore t'i paraqesë në organin e Prokurorisë.

- Gjatë shqyrtimit të disa ankesave është konstatuar se, organi i Prokurorisë ka vepruar në mënyrë të nxituar dhe të pabazuar në verifikimin e ngjarjes me të gjithë elementët që përbëjnë veprën penale apo duke mosvlerësuar të dhënat e paraqitura me qëllim për fillimin e hetimit të procedimit penal. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit I.S. nga Durrësi i cili ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethit për arsye se ka akuzuar padrejtësisht R.S. për veprën penale të “Heqjes së paligjshme të

lirisë”. Nga verifikimi i kryer nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës rezultoi se fillimisht ndaj të pandehurit është kërkuar masë sigurimi “Arrest në burg me afat 15 ditor” dhe mandej në përfundim të këtij afati, është kërkuar “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”. Konstatohet se, organi i Prokurorisë nuk ka patur provat e mjaftueshme për akuzën në ngarkim të shtetasit R.S.

Pas studimit të ankesave është konstatuar se ato janë drejtuar në Institucionin tonë menjëherë pas marrjes së vendimit nga Prokuroria. Kështu nga ana e jonë ankuesit janë sqaruar për ndjekjen e rrugës ligjore, për të kundërshtuar vendimin në gjykatë, e drejtë kjo e përcaktuar në nenin 291/2 të Kodit të Procedurës Penale.

5. Për mosnjofitim apo njofitim me vonesë për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit apo përfundimit të çështjes penale, si p.sh ankesat e shtetasve K.G. dhe Q.C. nga Tirana; L.S. nga Korça; P.M. nga Lezha etj.

- Rast ku shkelja është e dukshme është ankesa e shtetasit K.G. nga Tirana i cili qysh më datën 26.03.2007 ka paraqitur pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kallëzimin penal ndaj shtetasit I.J. përfaqësues i subjektit ndërtues “ERRE.GI-Albania” Sh.p.k, për veprat penale të “Falsifikimit të dokumentave” dhe “Mashttrimit”. Organi i Prokurorisë më datën 10.05.2007 ka vendosur mosfillimin e proçedimit penal me arsyetimin se: *“ndodhemi para një marrëdhënie juridiko-civile dhe si e tillë ajo zgjidhet në gjykatë”*. Mandej Prokuroria ka orientuar kallëzuesin K.G se *“ai duhet t’i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që ka me të kallëzuarin”*. Shtetasi K.G. edhe pse mori njofitim me vonesë për vendimin e mosfillimit të proçedimit, menjëherë është drejtuar me ankesë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit. Pas kryerjes së një hetimi të pavarur dhe studimit të akteve të administruara në dosjen hetimore, u konkludua se shtetasi K.G. kishte të drejtë dhe për rrjedhojë vendimi i mosfillimit të proçedimit penal ishte i pabazuar në ligj. Në këto rrethana Avokati i Popullit i paraqiti Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Rekomandim për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të proçedimit penal Nr. 1527 datë 10.05.2007”, i cili u pranua. Pas shfuqizimit të vendimit të mosfillimit të proçedimit penal, Prokuroria urdhëroi rregjistrimin e proçedimit penal për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

- Shtetasi A.O. nga Tirana qysh më datën 30.10.2006 ka paraqitur kallëzim pranë Sektorit të Luftës Kundër Krimit Ekonomik në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, lidhur me ushtrimin e aktivitetit të biznesit të tij privat me liçencë të falsifikuar nga shtetasi A.D. Shtetasi A.O. është ankuar ndaj Prokurorisë për faktin se, ndonëse është marrë në pyetje nga një oficer i policisë gjyqësore, nuk ka dijeni për mënyrën e përfundimit të hetimit të proçedimit penal. Pas verifikimit të kryer nga ana e jonë, shtetasi A.O. u sqarua se çështja penale në ngarkim të shtetasit A.D. akuzuar për veprën penale të “Mospagimit të taksave dhe tatimeve”, parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal është dërguar në gjykatë.

- Për vitin 2007 janë marrë në shqyrtim dhe disa ankesa të shtetasve të cilët i janë drejtuar me kërkesë-ankesa Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm në rastet kur nga Prokuroritë në rrethe është vendosur mosfillimi i proçedimit penal apo pushimi i hetimit të çështjes, por nga ajo Zyrë nuk është kthyer përgjigje ose përgjigja është dërguar me vonesë. Raste të tilla janë ankesat e shtetasve TH.Q. nga Vlora, E.Q. nga Skrapari, GJ.LL. nga Lushnja etj.

Kështu në ankesën e tij shtetasi TH.Q. nga Vlora është ankuar ndaj Prokurorisë së Përgjithshme për arsye se nuk i ka kthyer përgjigje ankesave të tij të datës 10.11.2006, të përsëritur më datën 27.02.2007. Ankuesi TH.Q. i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme mbasi ankohet ndaj Prokurorisë Vlorë për vendimin e

mosfillimit të procedimit penal ndaj shtetasit L.XH, me profesion avokat mbrojtës. Pas verifikimit të ankesës në Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun, shtetasi TH.Q. u sqarua se ankesa e tij ishte rregjistruar në atë Zyrë më datën 01.03.2007 dhe i kishte kaluar për ndjekje e verifikim prokurorit të Drejtorisë së Hetimit.

Konstatohet se nga ana e Prokurorëve të cilët marrin ankesat e shtetasve nuk tregohet kujdes i duhur për verifikimin e tyre dhe kthimin e përgjigjes sa më parë.

6. Për mosvënie në lëvizje apo mosvlerësim të kallëzimit të shtetasve

Në praktikën e punës të organit të Prokurorisë janë konstatuar raste kur personat e marrë në përgjegjësi penale, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e policisë, kanë paraqitur kallëzim penal para punonjësit të Prokurorisë. Kallëzimi jo vetëm nuk është marrë, por dhe nuk është bërë vlerësimi i nevojshëm. Është detyra e Prokurorit që, mbi pretendimin e ankuesit (të pandehurit) apo konstatimet e tij kur dëmtimet janë të dukshme, të marrë kallëzimin duke e vlerësuar atë dhe menjëherë të përpilojë vendimin për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor.

Të ngjashme janë edhe rastet e ankesës të shtetasës Q.C. nga Tirana për mosfillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Ç.S, punonjës policie për veprime të kundraligjshme. Nga verifikimi i kryer në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, u konstatua se letra që ajo i kishte drejtuar atij organi, ishte trajtuar si ankesë. Në këto rrethana shtetësja u sqarua për të drejtën e paraqitjes së kallëzimit penal dhe mënyrës së përpilimit të tij, në përputhje me kërkesat e neneve 281 e 283 të Kodit të Procedurës Penale. Ankesa e shtetasës S.XH. nga Burreli, e cila është ankuar për mosmarrje të kallëzimit penal për vjedhje të një sasive lekësh të shpërblimit që i ishte dhënë kur ishte mësuese, në ngarkim të kryetarit të Komunës dhe ish shefit të financës. Nga verifikimi i kryer në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat, rezultoi se shtetësja S. XH. nuk kishte paraqitur kallëzim me shkrim në atë Institucion. Nga ana jonë ankuesja u sqarua për të paraqitur kallëzimin penal sipas rregullave procedurale dhe se Prokuroria ishte e predispozuar për ndjekjen ligjore dhe korrekte të tij.

7. Për bllokime apo sekuestrime të sendeve prove materiale, për mosdhënie të tyre gjatë fazës së hetimit apo për dhënie të tyre me vonesa

Vihet re se në disa Prokurori të rretheve gjyqësore, në praktikën e hetimit të çështjeve penale kur vendoset sekuestrimi i mjeteve në aksidentet aotomobilistike apo sendeve prova materiale të tjera, ka një tendencë që ato nuk u kthehen personave që ju takon gjatë fazës së hetimit, ose në raste të tjera ato kthehen me vonesë, ndonëse janë kryer veprimet e nevojshme si ekspertime autoteknike, vlerësime etj.

Kjo kërkesë përcaktohet në mënyrë të qartë në Pikën 2 të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, “**Disponimi i provës materiale**” ku thuhet shprehimisht se: “Provat materiale mund t’u kthehen personave që u përkasin edhe para mbarimit të procedimit, kur nuk dëmtohet zgjidhja e çështjes”.

- E tillë është ankesa e shtetasit R.Ç. nga Tirana i cili ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për arsye se, nuk ka kryer veprime të shpejta me qëllim marrjen e mjetit Fuoristradë të tipit “Toyota”, vjedhur në muajin gusht 2006, për të cilën mbasi e ka gjetur vetë në Budva të Malit të Zi, ka bërë dhe kallëzimin penal në organin e Prokurorisë. Edhe pse nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë është rifilluar hetimi i pezulluar dhe mandej është dërguar

letërporosia autoriteteve të drejtësisë malazeze, në pritje të përgjigjes hetimi është pezulluar përsëri, vonesa këto të pajustificuara dhe me pasoja në veprimtarinë e punës dhe familjes së shtetasit R.Ç.

-Në ankesën e tij shtetasi L.J. nga Tirana ngre shqetësimin se nuk i është dhënë motorçikleta e tipit “Honda” vjedhur në muajin tetor të vitit 2006, për të cilën Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë kishte pezulluar hetimin për mosnjohje të autorit. Pas kallëzimit penal për gjetjen e motorçikletës, organi i Prokurorisë ka kryer dhe ekspertimin teknik të numurit të shasisë dhe pas kryerjes së veprimeve të tjera hetimore ka vendosur përsëri pezullimin e hetimit për mosnjohje të autorit për faktin se motori i sjellë nga Italia ka kaluar për shitje blerje në disa persona.

8. Mosmarrje të masave për kryerjen e ekspertimeve të ndryshme si mjeko-ligjor, neuropsihiatrik apo dhe riekspertimeve autoteknike

- Në ankesën e tij shtetasi Z.M. nga Shkodra ka kërkuar ndërhyrjen e Zyrës sonë pranë Prokurorisë së atij rrethi me qëllim kryerjen e ekspertimit neuropsihiatrik të djalit të tij K.M, akuzuar për veprën penale të vrasjes së bashkëshortes, ngjarje e ndodhur datë 08.01.2007. Në përgjigjen e saj Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër sqaron se, nuk është vendosur kryerja e ekspertimit neuropsihiatrik me arsyetimin se “ kryesisht nuk janë konstatuar çrregullime apo simptoma të ndonjë sëmundje psihike...”. Pavarësisht nga sa sipër, ankuesit i është rekomanduar nga ana jonë që këtë kërkesë ta paraqesë gjatë gjykimit të çështjes penale. Ankesa e shtetasit E.T. nga Shkodra i cili ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për arsye se nuk ka kryer gjatë fazës së hetimit paraprak ekspertimin teknik të firmës së tij dhe të personit që ka përdorur dokumentacionin e liçencës së tij.

- Shtetësja SH.R. nga Tirana është ankuar për kryerje të veprimeve jo profesionale nga oficerët e policisë gjyqësore lidhur me ngjarjen automobilistike me pasoja vdekjen e vëllait të saj S.XH. dhe kunatës SH.XH, ndodhur më datën 01.11.2007, ka kërkuar ndërhyrjen e Zyrës sonë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, me qëllim kryerjen e një ekspertimi tjetër me grup ekspertësh, veprim i cili është realizuar nga Prokuroria e atij rrethi, pas rekomandimit tonë.

- Shtetasi M.B.GJ. nga Mirdita, më datën 20.12.2007 ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim kryerjen e një ekspertimi mjeko-ligjor për dëmtimet e shkaktuara më datën 30.06.2007, kur ai është qëlluar për vdekje nga persona të tjerë. Sipas tij ndonëse dëmtimi i tij ka qënë i rëndë, eksperti mjeko-ligjor e ka kategorizuar plagosje të lehtë. Avokati i Popullit duke respektuar kërkesat e gërmës “ ç” të nenit 19 të ligjit të tij organik, ka administruar kartelën mjekësore të pacientit dhe do të kërkojë të kryhet ekspertimi mjeko-ligjor me grup ekspertësh të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Konstatohet se nga ana e Prokurorive në disa raste nuk tregohet kujdesi dhe interesimi i nevojshëm për marrjen e përgjigjeve të akteve të ekspertimeve të ndryshme, si mjeko-ligjore, kimike për lëndët narkotike, kriminalistike etj, duke qëndruar në pritmëri në një kohë që aktet janë përfunduar, por për arsye burokratike nuk u janë dorëzuar atyre.

- Avokati i Popullit ka vlerësuar dhe ndjekur me përparësi dhe rastet e ankesave të shtetasve që kanë pësuar dëmtime fizike apo të shëndetit mendor nga veprime ose mosveprime të punonjësve të policisë, apo mjekët kurues për kohën që ata kanë qënë të arrestuar. Në këto raste jo vetëm janë administruar dokumentat shkresore siç janë kartelat mjekësore etj, por dhe është përpiluar vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, i cili është dërguar Institutit të Mjekësisë Ligjore. Tek ekspertët e këtij Instituti kemi gjetur predispozicionin e nevojshëm për

realizimin e aktit mjeko-ligjor dhe sjelljen e tij në Institucionin tonë brënda afateve të kërkuara. Të tilla janë rastet e ndjekura me Inisiativë nga Avokati i Popullit me të dëmtuar shtetasin I.M. ndaj të cilit është ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e policisë së burgjeve në Institucionin e Paraburgimit Vlorë apo shtetasi K.H. ndaj të cilit është ushtruar dhunë nga punonjësi i policisë kriminale të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë. Për të dy rastet Avokati i Popullit ndërmori një hetim të pavarur me grup ekspertësh dhe në përfundim ka dërguar Rekomandimet përkatëse për Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë për zbatimin korrekt të Ligjit organik “Për Policinë e Shtetit” etj.

9. Ankesa për ngjarje të ndodhura para vitit 2000

Gjatë vitit 2007 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë paraqitur disa ankesa shtetas nga rrethe të ndryshme të vëndit për moszbulimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të vrasjeve të fëmijve apo të afërmëve të tyre, ngjarje të ndodhura kryesisht gjatë vitit 1997. Të tilla janë ankesat e shtetasve M.M. nga Tepelena për moszbulimin e autorit të vrasjes së vajzës së tij Y.C. ngjarje e ndodhur datë 07.05.1997; Shtetasi M.M. po nga Tepelena për moszbulimin e autorit të vrasjes së djalit të tij R.M. ngjarje e ndodhur datë 31.07.1997; Shtetasi F.B. nga Burreli për moszbulimin e autorit të vrasjes së djalit të tij G.B. ngjarje e ndodhur datë 10.11.1997; Shtetasi L.RR. nga Vlora për moszbulimin e autorit të vrasjes së djalit të tij V.RR, ish punonjës policie në Komisariatin e Policisë Vlorë, ngjarje e ndodhur datë 11.05.1997; Shtetasi H.R. nga Malësia e Madhe, për moszbulimin e autorit të vrasjes së djalit të tij V.R, ish punonjës policie në Komisariatin e Policisë Shkodër, ngjarje e ndodhur datë 08.10.1997; Shtetasi D.D. nga Korça për moszbulimin e autorit të vjedhjes me dhunë me pasojë dëmtimin e rëndë dhe të një shume të konsiderueshme të hollash ngjarje e ndodhur datë 01.06.1997 etj.

-Për vitin 2007 janë marrë në shqyrtim dhe një numër ankesash të shtetasve për vepra penale, sidomos për vrasje të ndodhura pas vitit 2000, por që nga ana e Prokurorisë është vendosur pezullimi i hetimit për moszbulim të autorit. Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasit K.M. nga Shkodra për vrasjen e djalit të tij F.M. ngjarje e ndodhur në Selanik të Greqisë datë 13.09.2000; shtetasit GJ.K. për vrasjen e djalit të tij A.K. ngjarje e ndodhur në Bari të Italisë datë 04.12.2003; shtetasit F.M. nga Kolonja për moszbulimin e vrasjes së vajzës së tij M.M, ngjarje e ndodhur datë 10.10.2005.

Konstatohet se për këto çështje, të cilat fillojnë mbi bazën e ngjarjes dhe që jo vetëm janë me rrezikshmëri të madhe shoqërore, por dhe që kanë tronditur komunitetin e më gjërë, ndonëse janë kryer veprimet e para hetimore të domosdoshme, nuk është predispozicioni i duhur për kryerjen e veprimeve të gjithanshme për zbulimin e autorit të veprës penale, si dhe mungon bashkëpunimi mes prokurorisë dhe policisë kriminale. Për rrjedhojë, shpesh hetimet pezullohen dhe materialet e çështjes i dërgohen policisë kriminale. Atje shpesh nuk ka asnjë impenjim për bashkëpunim për ndjekjen në vazhdimësi të çështjes dhe analizën e tyre të herëpashershme. Në këto kushte, ato mbeten pa veprime nga policia kriminale duke mbetur edhe kriminelët pa ndëshkuar.

Nga ana jonë për një pjesë të mirë të këtyre rasteve është bërë verifikimi në vënd, duke u marrë kontakt si me drejtues të Prokurorisë, ashtu dhe me ata të policisë kriminale. Në takimet e kryera kemi orientuar dhe insistuar në kryerjen e shpejtë të veprimeve dhe ndjekjen në vazhdimësi të çështjeve të pezulluara.

- Duke patur parasysh faktin se, Policia Kriminale në bashkëpunim me Prokurorinë kanë rifilluar hetimin për disa ngjarje të rënda kriminale të ndodhura në vitin 1997 si ajo e “Qafë Gjashtës” Sarandë, “Cërrikut etj”, ku janë vrarë efektiva të policisë, mbi shqetësimin e paraqitur nga familjarë dhe të afërm të viktimave të vrarë në atë periudhë, do t’i paraqesim Policisë Kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme rekomandimet tona për ecurinë e mëtejshme të dosjeve të pezulluara me qëllim rifillimin e hetimeve.

10. Kërkesa për ndihmë juridike

- Gjatë shqyrtimit të ankesave apo kërkesave të shtetasve për vitin 2007 konstatohen raste kur prej tyre kërkohet konsulencë juridike për mënyrën e veprimit të mëtejshëm për problemin që ata i shqetëson. Të tilla janë rastet e kërkesave të shtetasit Gj.Ll. nga Lushnja i cili ka kërkuar ndërhyrjen e Zyrës sonë lidhur me vetvarjen e vajzës së tij E.LL, ngjarje e ndodhur në muajin nëntor të vitit 1999 pasi kanë dalë prova të reja të cilat provojnë fajësinë e shtetasit Th.K. ish bashkëshorti i vajzës, person i deklaruar i pafajshëm nga ana e Gjykatës; Ose shtetasi A.Z, aktualisht i dënuar duke vuajtur dënimin me burgim në Burgun e Peqinit, i cili ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me kërkesën për rishikimin e vendimit penal që ka marrë formë të prerë. Nga interesimi në Gjykatën e Lartë rezultoi se kërkesa e tij për rishikimin e vendimit penal ndodhej për shqyrtim në Dhomën e Këshillimit në Gjykatën e Lartë. Për këtë u njoftua ankuesi.

- Në ankesën e tij shtetasi V.Th. nga Ksamili i Sarandës ngre shqetësimin se pas një konflikti pronësie me shtetasin B.D. punonjës policie, bashkëshortja e tij Ç.Th, është rrahur prej bashkëshortes së shtetasit B.D. Për këtë shqetësim ai kishte vënë në dijeni dhe drejtuesit e Komisarariatit të Policisë si dhe kishte kryer ekzaminimin mjeko-ligjor të bashkëshortes, ku sipas konkluzioneve të aktit të ekspertimit mjeko-ligjor dëmtimet hynin në kategorinë e rrahjes. Ankuesi u sqarua nga ana jonë në mënyrë të hollësishme për rrugën ligjore që duhet të ndiqte si **“I dëmtuar akuzues”**, çka do të thotë se ai duhet të paraqiste kërkesë në gjykatë. Shtetasit ju bë e qartë dhe mënyra e përpilimit të kërkesës sipas nenit 60 të Kodit të Proçedurës Penale e cila duhej të depozitohej më pas në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

-Në ankesën e tij shtetasi P.M. nga Lezha ngre shqetësimin për faktin se pas kallëzimit për kanosje bërë ngë shtetasi T.M, me të cilin ka një konflikt pronësie për servitutin e kalimit, Prokuroria ka pushuar çështjen penale bazuar në ligjin “Për Amnistinë e vitit 2007”. Meqënëse nga ana e Përmbauesit Gjyqësor ishte përpiluar proçes verbali i veprimeve përmbaimore gjatë ekzekutimit dhe ankuesi nuk ishte dakort, atëhere ai u sqarua për të drejtën e ankimit në gjykatë për kundërshtimin e veprimeve përmbaimore, parashikuar nga neni 610 i Kodit të Proçedurës Civile.

- Shtetasi A. N. nga Saranda ka kërkuar sqarim juridik lidhur me parashkrimin e ekzekutimit të dënimit, që parashikohet në nenin 68 të Kodit Penal. Shqetësimi i shtetasit A.N. lidhet me autorin e vrasjes së vëllait të tij I.N. nga shtetasi L.M, person i dënuar në mungesë me 15 vjet burgim dhe se kapja e tij është bërë pas 10 vjetësh. Shtetasi A.N. u sqarua në mënyrë të hollësishme me kërkesat që përmenden në nenin 68 të Kodit Penal.

- Shtetësja L.S. nga Fieri është ankuar për faktin se nga ana e nipit të saj A.S. i është marrë padrejtësisht një sipërfaqe toke prej 500 metër katrore, dhe si rrjedhojë e ka të pamundur të drejtën e kalimit nga banesa e saj. Shtetësja L.S. i ka kërkuar konsulencë juridike Institucionit të Avokatit të Popullit për rrugën e

zgjdhjes së problemit të saj. Asaj i është bërë e qartë ndjekja e rrugës ligjore dhe konkretisht si nëpërmjet kallëzimit penal që duhet të paraqesë në Prokurori për veprën penale të “Pushtimit të tokës”, ose për zgjidhjen civilisht të çështjes me anë të kërkesë padisë civile, me objekt servitutit e kalimit që parashikohet në nenin 277 të Kodit Civil.

- Në ankesën e shtetasit L.S. nga Pogradeci ndaj Prokurorisë për arsye se, pas kallëzimit penal për dëmtim të pasurisë, shkaktuar nga komshiu i tij, është sqaruar se vlera e dëmit është nën shumën prej 50.000 lek. Kjo është element i domosdoshëm i veprës penale të “Shkatërrimit të pronës nga pakujdesia”. Në këto rrethana shtetasi L.S. u sqarua nga ana e jonë për të drejtën e paraqitjes së padisë civile në gjykatë, me objekt “Shpërblimin e dëmit”.

Në këto raste shtetasit janë sqaruar nga ne sipas rastit, për të drejtën e parashikuar në nenin 283 të Kodit të Proçedurës Penale për bërjen e kallëzimit penal tek oficeri i policisë gjyqësore apo prokurori, plotësimin e materialeve të kallëzimit sipas kërkesave të parashikuara në ligj, paraqitjen në prokurori të dokumenteve origjinale, të drejtën për rishikimin e vendimit penal që ka marrë formë të prerë dhe dërgimin e saj pranë Gjykatës së Lartë duke respektuar kërkesat e neneve 449-453 të Kodit të Proçedurës Penale, duke dërguar dhe fotokopje të neneve respektive që bëjnë fjalë për këtë institut, dërgimin e formularit me dokumentet e nevojshme për faljen që bën Presidenti i Republikës etj, për dokumentet dhe proçedurat që duhet të ndjekin për rastet kur ankesa i drejtohet Gjykatës së Strasburgut etj.

11. Ankesa për kërkesat e prokurorëve për masat e sigurimit apo të dënimit

- Ka edhe ankesa nga shtetasit për masa të ulta dënimi për autorët e veprave penale ku ata, ose pjestarë të familjes, janë të dëmtuar, si p.sh. ankesa e shtetasit O.Xh. nga Fushë-Kruja për kërkesën për masë dënimi të ulët, 6 muaj burgim, ndaj autorit të veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasojë plagosjen e rëndë të fëmijës së tij të mitur G.Xh; Shtetasi R.Ç. nga Elbasani për masë dënimi të ulët prej 2 muaj burgim, ndaj shtetasit E.K. akuzuar për veprën penale të “Mashtrimit” etj.

- Në raste të tjera ankesat e shtetasve janë drejtuar ndaj organit të Prokurorisë e cila sipas tyre ka kërkuar masë të lartë dënimi me burgim ndaj fëmijve apo të afërmeve të tyre, të akuzuar për vepra penale të ndryshme si p.sh. ankesa e shtetasit I.A. nga Kavaja i cili ankohet ndaj Prokurorisë që ka kërkuar masë të rëndë prej 21 vjet burgim për djalin e tij N.A, akuzuar për veprën penale të “Vrasjes në rrethana cilësuese” kryer ndaj më shumë se dy personave; ankesa e shtetasit J.R. nga Cërriku i Elbasanit për kërkesën e Prokurorit për masë dënimi të lartë prej 6 vjet burgim ndaj djalit të tij L.R. akuzuar për veprat penale të “Vjedhjes së pasurisë” dhe “Mbajtjes pa lejë të armëve luftarake” etj.

- Ka edhe një grup ankesash ku shtetasit ankohen ndaj Prokurorisë për aplikim të masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj fëmijve të tyre, për vepra penale jo me rrezikshmëri të madhe dhe për të cilat organi i akuzës mund të kërkonte masë sigurimi më të butë. E tillë është ankesa e shtetasit P.G. nga Marinza e Fierit e cila ka kërkuar ndërhyrjen e Zyrës sonë për faktin se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, ka vendosur ndaj djalit të saj TH.K. të datëlindjes 15 qershor 1992, masë sigurimi “Arrest në burg” për veprën penale të “Mbajtjes pa lejë të armëve luftarake”, (pistoletë e gjetur ndërsa ai kulloste bagëtitë). Ne kemi argumentuar se në këtë rast organi i Prokurorisë në kërkesën për masë sigurimi nuk ka marrë në konsideratë jo

vetëm rrezikshmërinë e veprës penale, moshën e mitur të autorit, gjëndjen e rëndë ekonomike etj, ankesat e shtetasve A.S. etj nga Vlora të datëlindjes 1993, për të cilët Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka kërkuar masë sigurimi “Arrest në burg” për veprën penale të “Moskallëzimit të krimin”, parashikuar nga neni 300 e Kodit Penal.

Nga ana jonë ankuesit janë sqaruar për mosndërrhyrjen e Avokatit të Popullit në pavarësinë e organeve të drejtësisë, kërkesë kjo e përcaktuar në nenin 145 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe të drejtën që kanë për t’u ankimuar kundër vendimit të gjykatës duke i u drejtuar instancave përkatëse gjyqësore sipas procedurave të parashikuara në ligj. Pavarësisht nga sa sipër, shqetësimi i tyre mbetet një problem që mendojmë se duhet rregulluar për të futur të drejtën e ankimit të viktimës ndaj vendimeve gjyqësore. Pra, të përmirësohet Kodi i Procedurës Penale në drejtim të dhënies së të drejtës që avokati i viktimës të ketë të drejtë të ankohe kundër vendimit të pafajsisë, apo masës së dënimit.

12. Ankesa për hetimet në çështjet e aksidenteve automobilistike

- Për periudhën që analizohet ka patur dhe raste kur, shtetas të ndryshëm ankohen për “mbyllje” të çështjeve për veprën penale të “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasoja të rënda për jetën apo shëndetin e shtetasve. Të tilla janë ankesat e shtetasve Z.M. dhe N.B nga Tirana; L.M. nga Kuçova; A.M. nga Lushnja etj.

- Kështu shtetasi Z.M, nga Tirana ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për kryerjen e hetimeve objektive në procedimin penal që bën fjalë për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasojë vdekjen e vëllait të tij, A.M. Mbi këtë shqetësim është kontaktuar dhe me drejtues të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët kanë qënë të predispozuar në ndjekjen e rrugës ligjore jo vetëm duke përjashtuar nga hetimi prokurorin, pretendim i ngritur prej ankuesit, por dhe duke kryer një ekspertim tjetër autoteknik me grup ekspertësh.

- Shtetësja L.M. nga Kuçova ankohe ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, për arsye se ka kërkuar masë sigurimi “Arrest në shtëpi” për drejtuesin e motorçikletës E.K, autor i veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, me pasojë vdekjen e babait të saj Y.M, ngjarje e ndodhur datë 25.09.2007.

Nga studimi dhe analiza e bërë ankesave të paraqitura në Institucionin tonë arrijmë në përfundimin se, nga ana e Prokurorisë jo gjithmonë bëhet vlerësimi i duhur i këtyre çështjeve, të cilat fillojnë mbi bazën e ngjarjes dhe kërkojnë kryerje të shpejta të veprimeve të para hetimore të papërsëritshme, njohuri profesionale në fushën autoteknike dhe objektivitet. Njëanshmëria, dhënia e konkluzioneve të pasakta dhe të padrejta në aktet e ekspertimit mjeko-ligjor ose autoteknik, moskryerja e veprimeve të gjithanëshme, janë pasoja të vendimeve të pabazuara të ndërmarra nga policia gjyqësore e të miratuara nga Prokuroria. Nga ana tjetër, ato sjellin zvarritje në hetimin e çështjeve penale dhe pasoja të tjera që lidhen me probleme sociale, deri në acarimin e marrëdhënieve ndërmjet autorëve të veprës me familjarët e të dëmtuarëve apo viktimave të shkaktuara nga vepra penale. Veç sa sipër, këto qëndrime ndikojnë negativisht në rritjen e numrit të aksidenteve në shkallë vëndi, i cili për vite me radhë është mjaft shqetësues.

Pikërisht mbi këtë shqetësim qytetar, duke konstatuar se në vitet e fundit aksidentet rrugore janë konsideruar si “vrasësit” kryesorë të shqiptarëve me gati 1 të vdekur dhe 2 të plagosur në ditë, nga ana jonë u realizua “Studimi për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasojë vdekje apo dëmtime në

shëndetin e shtetasve për periudhën 5 vjeçare 2001-2005”. Ky studim i është dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

13. Kërkesa për mbrojtje të dëshmitarëve

- Për vitin 2007 shtetas të ndryshëm, të cilët kanë qënë dëshmitarë kryesorë në çështje të rëndësishme me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, kanë kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit pranë Prokurorisë së Përgjithshme me qëllim marrjen e masave për mbrojtjen e dëshmitarit. Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasve O.L. e dëmtuar nga vepra penale, lidhur me ngjarjen e ndodhur në repartin ushtarak të Bisht Pallës Durrës. Si rezultat i kallëzimit të saj janë çuar në gjyq dhe dënuar disa autorë të veprës penale. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, mbi shqetësimin e të dëmtuarës i dërgoi materialet Prokurorisë së Përgjithshme për zbatimin e Ligjit Nr.9205 datë 15.03.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunorëve të drejtësisë”; ankesa e shtetasit Z.K. nga Saranda si dëshmitar kryesor në zhdukjen e shtetasit kosovar R.K, për të cilin nuk është kthyer përgjigje nga Prokuroria e Përgjithshme; shtetasi I.R. nga Tropoja dëshmitar kryesor në procedimin penal për veprën penale të vjedhjes me armë, ngjarje e ndodhur në muajin nëntor të vitit 2003; shtetasi R.C. nga Shkodra, i cili ka kërkuar ndërhyrjen pranë organeve kompetente me qëllim sigurimin e jetës së tij dhe familjes mbasi kërcënohet nga persona të dënuar në një procedim penal ku ka qënë i pandehur dhe djali i tij A.C. për veprën penale të “vrasjes me paramendim” etj.

B. Nga shqyrtimi i ankesave të ndryshme që janë konsideruar të drejta për shkeljet e konstatuara, Avokati i Popullit i ka paraqitur Prokurorit të Përgjithshëm, apo drejtuesve të Prokurorive në rrethe 10 rekomandime, të cilat janë mirëpritur dhe pranuar. Në mënyrë të grupuar rekomandimet tona drejtuar organit të Prokurorisë, paraqiten si më poshtë:

1. Rekomandim drejtuar Prokurorisë “Për Krime të Rënda” Tiranë, “Për marrjen e masave me qëllim respektimin e dispozitave proceduriale dhe kushtetuese për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor në procedimin penal Nr. 294 në ngarkim të shtetasit I.S. etj”. (Ankesa e shtetasit U.S. nga Durrësi). Rekomandimi është pranuar.

2. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal Nr. 1527 datë 10.05.2007, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. (Ankesa e shtetasit K.G. nga Tirana). Rekomandimi është pranuar. Pas pranimit të shfuqizimit të vendimit të mosfillimit të procedimit penal organi i Prokurorisë ka urdhëruar rregjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 186 e Kodit Penal.

3. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë “Për fillimin e hetimit për veprën penale të “Torturës” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 86 e 25 të Kodit Penal në ngarkim të shtetasve A.SH, M.H, E.M dhe I.J. me detyrë punonjës policie në Institucionin e Paraburgimit Vlorë”. (Me iniciativën e Avokatit të Popullit, pas kryerjes së Inspektimit me grup ekspertësh në Institucionin e Paraburgimit). Rekomandimi është pranuar, por Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka filluar procedimin penal për “Shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal.

4. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Për fillimin e hetimit për veprat penale të “Torturës”, parashikuar nga neni 86 i ndryshuar i Kodit Penal, si dhe atë të “Heqjes së Paligjshme të lirisë” e parashikuar nga neni 110/2 të Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të policisë të

Komisariatit Nr. 5 Tiranë. R.T, B.R, E.D. dhe SH.P". (Ankesa e shtetasve M.LL, N.D, A.K. etj, nga Valiasi i Tiranës). Rekomandimi është pranuar. Organi i Prokurorisë ka dërguar në gjyq të pandehurin R.T. për veprën penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare" ndërsa për personat e tjerë është pushuar akuza.

5. Rekomandimi drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, "Për fillimin e hetimit për veprën penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare", parashikuar nga neni 250 e Kodit Penal në ngarkim të punonjësve të Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë A.G etj". (Ankesa e shtetasit S.LL etj, nga Tirana). Rekomandimi është pranuar.

6. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë "Për fillimin e hetimit për veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Kryerjes së veprimeve arbitrare", parashikuar nga nenet 248 e 250 të Kodit Penal ndaj shefit të rajonit të policisë Rrogozhinë I.M'. (Ankesa e shtetasit S.SH, me detyrë Kryetar i Komunës Gosë në Kavajë). Rekomandimi është pranuar.

7. Rekomandimi drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë "Për fillimin e hetimeve për veprën penale të "Falsifikimit të dokumentave dhe rezultateve të zgjedhjeve", parashikuar nga neni 326 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve A.D, J.SH, D.D, K.P, XH.TH dhe E.K". Rekomandimi është pranuar.

8. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë "Për fillimin e hetimit për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" ndaj kryetarëve të degës së Policisë së Ndërtimit V.G, E.S, A.M, H.GJ, SH.K si dhe ndaj punonjësve të tjerë të këtij organi të ngarkuar me ndjekjen e çështjes së ankuesit K.P". (Ankesa e shtetasit K.P. nga Tirana). Rekomandimi është pranuar.

9. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, "Për fillimin e hetimit për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga neni 248 e Kodit Penal, ndaj shtetasit F.Q. ish kryetar i degës së Policisë së Ndërtimit". (Ankesa e shtetasit P.B. nga Gjirokastra). Rekomandimi është pranuar.

10. Rekomandim drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër "Për fillimin e hetimit të veprave penale të "Shpërdorimit të detyrës" si dhe të "Falsifikimit të akteve të gjëndjes civile", parashikuar përkatësisht nga nenet 248 dhe 191 të Kodit Penal në ngarkim të punonjësit të Zyrës së Gjëndjes Civile, Komuna Tamarë M.K". (Ankesa e shtetasit M.G. nga Torovica e Lezhës). Rekomandimi është pranuar.

Vlen të theksohet fakti se për të gjitha rekomandimet e sipërpërmendura drejtuar Prokurorive në rrethe të ndryshme gjyqësore të vëndit, nga ana e jonë është vënë në dijeni Prokurori i Përgjithshëm, i cili pas shqyrtimit të tyre ka kthyer përgjigje brënda afatit ligjor në Institucionin e Avokatit të Popullit. Nga ana tjetër, në bazë të kompetencave të parashikuara në ligj, shpesh ai ka urdhëruar dhe fillimin e hetimit.

Për vitin 2007, vlen për t'u theksuar fakti se nga ana e Prokurorive në rrethe, ka një vlerësim më të mirë dhe korrekt ndaj rekomandimeve të dërguara nga Avokati i Popullit. Për rrjedhojë të gjitha rekomandimet tona janë pranuar. Por ka edhe raste që ndonjë Prokurori si ajo e Durrësit, nguron të dërgojë informacione apo akte, s'japin për studim dosje penale për të cilat janë pushuar hetimet prej tyre, por për të cilat ka patur ankesa nga shtetasit. Këto prokurorë nuk kanë parasysh ndryshimet e bëra me Ligjin Nr. 9398 datë 12.05.2005 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin Për Avokatin e Popullit", ku janë qartësuar kompetencat tona edhe në marrëdhënie me Prokurorinë dhe sipas të cilave të gjitha kërkesat tona ndaj prokurorive kanë qënë dhe janë të bazuara në ligj. Thelbi është se këta prokurorë nuk dëshirojnë kontrollin mbi punën e tyre.

5. Ministria e Brendshme

Gjatë këtij viti ndaj Ministrisë së Brendshme dhe organeve të pushtetit vendor kanë ardhur gjithsej 758 ankesa, kërkesa apo njoftime. Nga këto 274 kanë qënë ndaj institucionit të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit, ndërsa 484 kanë qënë ndaj organeve të pushtetit vendor si Këshillave të Qarqeve, Prefekturave, Bashkive, Komunave dhe Zyrave të Gjëndjes Civile.

A. Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave dhe kërkesave ndaj organeve të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit ka qënë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet tona kryesore. Kjo jo vetëm për faktin se ky organ i administratës publike përbën strukturën që përfaqëson fuqinë shtrënguese të shtetit, por edhe për vetë specifikën e Policisë Shqiptare, e cila krahas arritjeve pozitive, vazhdon të ketë në radhët e saj elementë të pakulturuar, të papërgatitur profesionalisht, të pa trajnuar me konceptet e shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të Njeriut, të korruptuar etj.

Në institucionin tonë për sektorin e policisë gjatë vitit 2007 kanë ardhur gjithsej 274 ankesa, kërkesa apo njoftime. (Në këtë numër nuk përfshihet numri i ankesave të mbartura nga viti 2006). Nga këto, 109 prej tyre janë bërë nga banorë të Tiranës, ndërsa 165 nga banorë të rretheve të ndryshme të vendit. Kanë përfunduar 242 ankesa si vijon: 83 ose rreth 34 % janë zgjidhur në favor, 48 kanë qënë jashtë juridiksionit, 108 kanë qënë të padrejta, kurse 3 ankues kanë hequr dorë. Janë mbartur për shqyrtim në vitin 2008, 32 ankesa.

Gjatë këtij viti për rastet që kemi vërtetuar shkelje të ligjit, janë bërë 6 rekomandime për fillimin e ndjekjes penale, nga të cilat 5 janë pranuar dhe 1 është në shqyrtim. Janë bërë dhe 4 rekomandime për dhënien e masave disiplinore, të cilat janë pranuar të gjitha. Në bazë të rekomandimeve tona, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Shkodër dhe Kavajë kanë filluar ndjekjen penale ndaj disa punonjësve të Policisë të Komisarariatit të Policisë Nr. 3 dhe 5 në Tiranë, në Kavajë dhe nëpunësve të gjëndjes civile në Shkodër e në Tiranë si dhe janë dhënë masa disiplinore ndaj 10 punonjësve të policisë që kanë bërë shkelje të ligjeve.

Ankesat e trajtuara ndahen sipas problemeve të mëposhtme:

I. Ankesat për keqtrajtim të shtetasve

Këto ankesa janë vlerësuar më tepër sepse kur ato kanë rezultuar të vërteta, kanë qënë shkelje të rënda të nenit 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës”. Njëkohësisht ato janë edhe dhunime të rënda të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në institucionin tonë janë bërë 21 ankesa me 26 persona për keqtrajtime të shtetasve nga Policia e Shtetit. Pas përfundimit mënyra e zgjidhjes së tyre është: 2 ankesa janë vlerësuar të drejta, 14 të pa bazuara dhe 5 kanë qënë jashtë juridiksionit.

Për rastet kur kemi vërtetuar pretendimet e ankuesve për keqtrajtime nga punonjësit e Policisë kemi bërë rekomandime organeve përkatëse. Gjatë vitit 2007 për rastet e keqtrajtimeve, i janë bërë 2 rekomandime organit të Prokurorisë për fillimin e ndjekjes penale ndaj 7 punonjësve të Policisë, të cilat janë pranuar.

Si raste të ankesave për keqtrajtime të shtetasve të vërtetuara mund të përmëndim:

1. Ankesa e shtetasve S. Ll., N. D. dhe A. K., me banim në Tiranë. Ata pretendonin se në orët e vona të natës, ndërmjet datave 16 dhe 17 Janar 2007, ishin në një lokal në afërsi të kryqëzimit të Zogut të Zi, në Tiranë. Në mesnate, në këtë lokal ka shkuar një grup policësh dhe ju ka kërkuar dokumente identifikimi. Ankuesit i kanë paraqitur dokumentet e identifikimit, por policët i kanë shoqëruar në Komisarlatin e Policisë Nr. 3 në Tiranë rreth orës 00.30 të datës 17.01.2006 për verifikim. Në Polici ata janë futur në dhoma sigurimi të mbyllura me dryn dhe gjatë natës janë dërguar në Drejtorinë e Policisë të Qarkut Tiranë, ku ju janë marrë gjurmët e duarve dhe janë fotografuar. Pas kësaj, janë sjellë përsëri në Komisarlatin e Policisë Nr. 3 dhe janë futur në dhomat e sigurimit. Në mëngjez rreth orës 09.00, ata janë marrë një nga një dhe janë çuar në një zyrë në katin e dytë të këtij komisariati, ku janë marrë në pyetje nga disa punonjës Policie, të veshur civilë dhe një me uniformë. Ankuesit pretendonin se gjatë pyetjes nga punonjësit e Policisë janë keqtrajtuar e rrahur duke u goditur me kabëll plastik dhe me shpulla në duar e në pjesë të tjera të trupit. Sipas ankuesve, ata nuk i kanë mësuar emrat e punonjësve të Policisë që i kanë keqtrajtuar, por shprehnin sigurinë se ishin në gjëndje që t'i njihnin ata nëse ju paraqiteshin për njohje. Gjithashtu ata pretendonin, se ishin mbajtur në gjëndje shoqërimi tej afatit ligjor dhe ishin lënë të lirë rreth orës 13.30, duke u mbajtur 3 orë tej afatit maksimal ligjor, ndonëse në libër ishte shënuar sikur janë lënë të lirë në orën 10.30.

Meqënëse nga përfaqësuesit e institucionit tonë u konstatuan shënja dhune në pjesë të ndryshme të trupit të ankuesve, morëm vendim për ekzaminimin mjekoligjor të tyre në Institutin e Mjekësisë Ligjore Tiranë.

Nga kqyrja e librit të regjistrimit të shtetasve të shoqëruar në Komisarlatin e Policisë Nr. 3 Tiranë në datën 17.01.2007, rezultoi se të tre shtetasit e mësipërm ishin shoqëruar në këtë komisarlat nga grupi i gatshëm për qëllim verifikimi nga ora 24.30 deri në orën 10.30 dhe se me ta kishin punuar Specialisti i Policisë Kriminale Elton Alushi dhe Specialisti i Policisë së Zonës Agim Goxhaj. Nga pyetja me procesverbal e të dy punonjësve të Policisë që kishin punuar me ankuesit rezultoi se, shoqërimi i tyre në Polici ishte bërë me urdhër të Elton Alushit meqënëse ata ishin pa dokumente identifikimi, por ai nuk kishte punuar me ata në komisarlat. Ndërsa Agim Goxhaj shpjegoi se kishte punuar me ata në komisarlat duke iu marrë deklaratime me shkrim në një zyrë në katin e parë, meqënëse të shoqëruarit ishin kapur në zonën e tij dhe se nuk kishte dijeni se kush i kishte keqtrajtuar në katin e dytë të komisarlatit. Gjithashtu, nga ana jonë u thirrën dhe u pyetën edhe punonjësit e informacionit pranë këtij komisariati, Engjëll Shkëmbi dhe Luan Dardha. Punonjësi i Policisë Engjëll Shkëmbi deklaroi se me të shoqëruarit kishte punuar Agim Goxhaj dhe se nuk kishte dijeni se cili punonjës tjetër Policie kishte punuar me ta, apo cili i kishte keqtrajtuar ata.

Në përfundim të hetimit të kësaj ankese arritëm në konkluzionin se ankuesit e cituar më sipër, ishin keqtrajtuar nga punonjësit e Policisë të Komisarlatit Nr. 3 Tiranë dhe se ata ishin mbajtur në gjëndje shoqërimi tej afatit ligjor prej 10 orësh. Pretendimet e tyre për keqtrajtim nga punonjësit e Policisë u provuan nga akt dëshmitë mjeko-ligjore, sipas të cilave rezultonte, se në trupin e tyre janë konstatuar dëmtime, të shkaktuara me mjet të fortë mbrejtës, të cilat hyjnë në kategorinë e rrahjes. Gjithashtu, pretendimet e tyre për keqtrajtim dhe mbajtje në gjëndje shoqërimi tej afatit ligjor nga Policia, u provuan edhe nga shpjegimet e dhëna me procesverbal nga dëshmitarët V. D., M. Ll. dhe B. L., të cilët kanë qënë të pranishëm në momentin e daljes së ankuesve nga komisarlati.

Veprimet e punonjësve të Policisë të kryera ndaj ankuesve ishin antiligjore dhe përbënin shkelje të hapur të neni 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 3 të Konventës Europiane të të drejtave të Njeriut, dhe neni 45/2 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”. Me veprimet e tyre, punonjësit e Policisë të Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë kishin konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “kryerjes së veprimeve arbitrare” të parashikuar nga neni 250 të K.Penal. Për këto arsye, i rekomanduam Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjësve të Policisë Agim Goxhaj e të tjerë, që kishin marrë pjesë në veprimet e kryera me ankuesit për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, të parashikuara nga neni 250 i Kodit Penal. Rekomandimi u pranua dhe filloi çështja penale. Mirëpo pas “bërjes së hetimeve”, Prokuroria e pezulloi atë për mosgjetje të autorëve të veprës penale. Ky qëndrim është i paligjshëm, i papërgjegjshëm dhe subjektiv, sepse sikurse kemi përmendur edhe më lart, njëri prej autorëve të kësaj vepre penale të kryer ndaj ankuesve, dihej se cili ishte.

2. Ankesa e shtetasve M. Ll., N. D., A. K., B.L. dhe Xh. D. me banim në Tiranë. Ata pretendonin, se në orët e para të mëngjesit të datës 02.04.2007, në banesat e tyre kanë shkuar disa punonjës policie dhe iu kanë kërkuar që të shkonin me ta në Komisariatin e Policisë Nr. 5 Tiranë. Policia ka bërë kontroll në banesat e tyre pa patur më parë një vendim gjykate dhe në përfundim të kontrollit nuk është përpiluar procesverbali i kontrollit të banesave të tyre. Ankuesit janë mbajtur në ambjentet e Komisarariatit të Policisë Nr. 5 më shumë se 10 orë pa asnjë arsye dhe më pas janë dërguar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, ku janë fotografuar, si dhe ju janë marrë gjurmët e gishtave. Në polici ata janë fyer me fjalë fyese, si dhe janë dhunuar fizikisht. Atyre iu është kërkuar të bënin një deklaratë ku të tregonin se çfarë dinin lidhur me vjedhjen e një automjeti një natë më parë në zonën e banimit të tyre. Për shtetasit M. Ll., A. K. dhe Xh. D., punonjësit e Policisë kishin përpiluar procesverbalin e arrestimit në flagrancë, kopjen e të cilit ankuesit e kishin paraqitur në institucionin tonë. Ankuesit pretendonin, se veprimet e vlerësimit të arrestit në flagrancë nuk janë kryer nga organet e specializuara të Prokurorisë dhe Gjykatës, por vetë Policia i kishte lënë të lirë ata pas disa orësh.

Nga verifikimet e bëra nga ana jonë rezultoi se, në datën 31.03.2007, në orët e vona të natës ishte vjedhur automjeti tip Benz, me targë TR 4199 M, në lagjen “Frutore”, në Kamëz Tiranë, me pronar shtetasin G.D..

Pas konstatimit të vjedhjes së automjetit në mëngjesin e datës 31.03.2007, shtetasi G. D. ka bërë kallzimin në Polici. Mbi këtë bazë në vendngjarje shkoi grupi hetimor, i cili ka kryer veprimet e para hetimore.

Po në këtë datë, rreth orës 05.30, Specialisti i Policisë Kriminale Roland Tabaku, Specialisti i Policisë së Zonës dhe Agjenti i Policisë Kriminale, së bashku me një grup të gatshëm kanë shoqëruar për në Komisariatin e Policisë Nr. 5 Tiranë, pesë shtetas dhe konkretisht M. Ll., A. K., B. L., N. D. dhe Xh. D..

Sipas librit të personave të shoqëruar, të pesë këta shtetas janë shoqëruar në Komisariatin e Policisë Nr. 5 Tiranë. Shtetasi M. Ll. ishte shoqëruar në orën 06.05, datë 31.03.2007, dhe është lënë i lirë në orën 14.00. Shtetasi B. L. ishte shoqëruar në orën 06.05 datë 31.03.2007, dhe është lënë i lirë në orën 16.00. Shtetasi A. K. ishte shoqëruar në orën 07.30 të datës 31.03.2007, dhe është lënë i lirë në orën 14.00. Shtetasi N. D. ishte shoqëruar në orën 06.05 të datës 31.03.2007, dhe është lënë i lirë në orën 16.00. Shtetasi Xh. D. është shoqëruar në orën 06.05 të datës 31.03.2007, dhe është lënë i lirë në orën 14.00. Arsyeja e shoqërimit ka qenë për verifikim dhe punonjësi që kishte bërë shoqërimin ishte Specialisti i Policisë Kriminale Roland

Tabaku. Nga kqyrja e librit të personave të shoqëruar rezultoi se lirimi i tyre ishte bërë me urdhër të Shefit të Komisarariatit.

Në Komisarariatit e Policisë Nr. 5 Tiranë ankuesit M. Ll., A. K., N. D. dhe Xh. D. janë marrë nga Specialistët e Policisë Kriminale Butrint Roshi e Shkëlqim Cakani dhe janë futur në mjediset e sallës së mbledhjes së Policisë dhe aty janë pyetur lidhur me vjedhjen e automjetit tip Benz TR 4199 M, pronë e shtetasit G. D.. Ndërsa shtetasi B. L. është futur në një dhomë izolimi deri në orën 19.00 të asaj dite dhe më pas është dërguar në ambjentin ku ishin të shoqëruar personat e tjerë.

Po atë ditë, të pesë ankuesit janë dërguar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe iu është bërë fotografimi i tyre, si dhe iu janë marrë gjurmët e gishtave (daktiloskopike).

Nga verifikimi i kryer, si edhe kqyrja apo administrimi i dokumenteve të ndryshme rezultoi se:

Shoqërimi i ankuesve ishte i paligjshëm për arsye se, është cënuar neni 27 pika 2, gërma “c” e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë në të cilën thuhet shprehimisht se:

“Liria e personit nuk mund të kufizohet përveçse në rastet e mëposhtme:...

“Kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj”.

Siç u përmend edhe më lart, të shoqëruarve në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë ju janë marrë dhe gjurmët daktiloskopike, veprim i cili është i kundërligjshëm pasi urdhër-shërbimi nr. 1634, datë 13.05.2003, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për fotodaktiloskopimin e personave”, në bazë të të cilit kishin vepruar punonjësit e Policisë, bie ndesh me nenin 353 të Kodit të Procedurës Penale. Më konkretisht, ky urdhër është bazuar në nenin 3, pika 1, gërma “c” dhe nenin 37, pika 1, dhe 4 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999, “Për Policinë e Shtetit”, në të cilët flitet për marrjen e masave për parandalimin dhe zbulimin e krimeve, për marrjen e informacioneve, por duke respektuar garancitë kushtetuese për liritë dhe të drejtat e personit.

Urdhëri bazohet dhe në nenin 295, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale, i cili bën fjalë për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Për rastin konkret, personat M. Ll., A. K., N. D., Xh. D. dhe B. L. ishin të identifikuar dhe nuk ishin në pozitën procedurale të personave ndaj të cileve zhvillohen hetime.

Urdhëri i mësipërm mbështetet në urdhërin Nr. 74 të vitit 1992 dhe Rregulloren e Policisë Shkencore Nr. 1063, datë 18.12.2001, të cilat nuk kanë fuqi ligjore.

Këto veprime vijnë në kundërshtim dhe me nenet 2 dhe 11 të ligjit nr. 8517 datë 22.07.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Nga verifikimet e kryera nga ana jonë u provua plotësisht, se ndaj shtetasve A. K., N. D. dhe Xh. D. ishte ushtruar dhunë fizike, duke u goditur me kabëll plastik, pëllëmbë e grushta në pjesë të ndryshme të trupit nga punonjësit e Policisë së Butrint Roshi, Roland Tabaku, Emri Demalia e Shtjefen Pjetri për të marrë të dhëna për autorët e vjedhjes së automjetit. Këto veprime të dhunëshme, ndëshkuese e çnjerezore janë antiligjore dhe përbëjnë shkelje të hapur të neni 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 3 të Konventës Europiane të të drejtave të Njeriut, si dhe neni 27/2 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Kontrolli i banesave të ankuesve, pa qenë në kushtet e flagrancës dhe pa vendim të organit të Gjykatës, si dhe moslënia e procesverbalit përkatës, ishin bërë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 37 të Kushtetutës së Republikës së

Shqipërisë, nenet 202, 205 dhe 206 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe me nenin 43/2 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Gjithashtu u provua, se ankuesit ishin mbajtur në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor prej 10 orësh. Ky veprim ishte në kundërshtim me nenin 45/2 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Arrestimi në flagrancë për tre ankuesit M. Ll., A. K. dhe Xh. D. përmbante elementët e veprës penale të heqjes së padrejtë të lirisë, e cila parashikohet nga neni 110/2 i K. Penal.

Duke analizuar në tërësi provat e administruara rezultoi, se nga ana e punonjësve të Policisë Butrint Roshi, Roland Tabaku, Emri Demalia dhe Shtjefen Pjetri janë kryer veprime të kundërligjshme, duke konsumuar elementët e veprës penale të “Torturës”, parashikuar nga neni 86, i ndryshuar, i Kodit Penal dhe të “Heqjes së paligjshme të lirisë”, parashikuar nga neni 110/2 i K. Penal.

Për këto arsye, i rekomandua Prokurorise se Rrethit Gjyqësor Tirane fillimin e hetimit ndaj punonjësve të Policisë Butrint Roshi, Roland Tabaku, Emri Demali e Shtjefen Pjetri për veprat penale të “Torturës”, parashikuar nga neni 86, i ndryshuar, i Kodit Penal, si dhe atë të “Heqjes së paligjshme të lirisë”, parashikuar nga neni 110/2 i K. Penal.

Prokuroria e mirëpriti rekomandimin dhe e filloi ndjekjen penale ndaj tyre. Çështja u hetua dhe pas hetimit u dërgua për gjykim për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i K. Penal vetëm shtetasi Roland Tabaku, ndërsa për të tjerët çështja u pushua.

Ne gjykojmë, se qëndrimi i mbajtur nga Prokuroria dhe vlerësimi i bërë prej saj për ndryshimin e akuzës nuk është ligjor dhe objektiv, sepse nga provat e administruara nga ana jonë, të cilat ja dërguam organit të Prokurorisë, provohej plotësisht se punonjësit e Policisë të përmendur më sipër kishin konsumuar elementët e veprës penale të “Torturës”, si dhe atë të “Heqjes së paligjshme të lirisë”. Ankuesve ju ishin shkaktuar vuajtje të rënda fizike nga ana e punonjësve të Policisë me qëllim marrjen prej tyre të informatave dhe pohimeve për kryerjen e një vepre penale, që siç rezultoi në fakt, nuk ishte kryer prej tyre. Në të njëjtën kohë punonjësit e Policisë, me veprimet e tyre të arrestimit të ankuesve në flagrancë pa patur prova dhe të pa mbështetura në ligj, ju kishin hequr në mënyrë të paligjshme lirinë atyre. Edhe pushimi i çështjes për tre punonjës Policie në këtë rast nuk është qëndrim korrekt dhe ligjor, sepse nga ana jonë u provua plotësisht që veprimet e kundërligjshme ndaj ankuesve, të katër punonjësve të Policisë të cituar më sipër, i kishin kryer në bashkëpunim me njëri tjetrin.

II. Ankesat për veprime të tjera të paligjshme apo të parregullta nga Policia

Kanë qënë 104 ankesa për veprime arbitrare të punonjësve të Policisë, nga të cilat 2 për kontrollë të paligjshme banese; 47 për arrestime, ndalime dhe për shoqërimi të paligjshme në Polici; 17 veprime të tjera arbitrare; 38 për mos evidencim apo mos ndjekje të kallzimeve apo të ankesave; dhe 57 për veprime të tjera të kundërligjshme apo të parregullta, si për sende të sekuestruara apo bllokuara nga Policia; për gjoba të padrejta; mospajisje me pasaportë apo bllokime të tyre etj. Nga 104 ankesat e regjistruara në këtë rubrikë, 36 prej tyre janë konsideruar të drejta. Si raste të zgjidhjes pozitive mund të përmëdim:

1. Ankesa e 5 kryetarëve të fshatrave të Komunës Gosë, Kavajë, përkatësisht shtetasit I.S., H.I., N.K., L.Sh. dhe Sh. S. për thirrjen e tyre më datën 08.10.2007, në

Rajonin e Policisë në Rrogozhinë. Shefi i Rajonit të Policisë në Rrogozhinë, Ibrahim Maksuti ju kishte kërkuar atyre që të dorëzonin vulat e kryetarëve të fshatrave, pasi “në të gjithë fshatrat e Komunës Gosë ishin bërë zgjedhje të reja dhe se ishin zgjedhur kryetarë të tjerë në fshatrat e tyre”. Kryetari i Komunës Gosë, në Kavajë z. Sinan Shala na informoi se thirrja në Polici, marrja në pyetje, si dhe mbajtja në ambjentet e Rajonit të Policisë deri në orën 16.30 të asaj dite ishte e paligjshme, pasi në fshatrat e komunës ku ai është Kryetar Komune nuk ishin bërë zgjedhje të reja për kryesitë dhe kryetarët e fshatrave.

Për hetimin e këtij informacioni u dërgua në vend një ekip i Avokatit të Popullit. Nga pyetja e Shefit të Rajonit të Policisë në Rrogozhinë rezultoi, se thirrja e 5 ish kryetarëve të fshatrave të komunës Gose, Kavajë ishte bërë mbi bazën e një urdhëri me shkrim të Komisarariatit të Policisë Kavajë, nga i cili ai varet, sipas të cilit, atij i kërkohej marrja e masave që problemi i kryetarëve të fshatrave (kryepleqve) të zgjidhej në rrugë ligjore. Bashkë me këtë shkresë atij i kishte shkuar edhe një shkresë e N/Prefektit të Kavajës dhe një shkresë e Këshillit të Komunës Gosë, ku kërkohej që të merreshin masa urgjente që vulat e ish kryetarëve të fshatrave të Komunës Gosë, t’u kalonin kryetarëve të rinj të fshatrave të kësaj komune. Në bazë të këtyre shkresave ai, më datën 05.10.2007 ka bërë njoftimin e 5 ish kryetarëve të fshatrave të kësaj komune për t’u paraqitur në Rajonin e Policisë më datën 08.10.2007, ora 10.00. Në këtë datë Kryetari dhe Sekretari i Këshillit të Komunës Gosë, kishin bërë kallzim ndaj ish kryetarëve të fshatrave për veprën penale të “Përvetësimit të titullit apo detyrës shtetërore”, parashikuar nga neni 246 i K. Penal. Të gjithë ish kryetarët e fshatrave ishin paraqitur dhe Shefi i Rajonit të Policisë ju ka bërë me dije kallzimin për mosdorëzimin e vulave dhe ndërkohë i ka pyetur ata me shkrim. Ata kanë dhënë shpjegime dhe kanë ngritur pretendimin se zgjedhjet e kryetarëve të rinj të fshatrave nuk ishin bërë dhe se vulat do t’ja dorëzonin atyre që do të dilnin fitues pas bërjes së zgjedhjeve të rregullta.

Mirëpo Shefi i Rajonit të Policisë Rrogozhinë, në vend që të zbatonte detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 293 të K.Pr.Penale, për të bërë referimin e veprës penale tek prokurori, ka kryer veprime hetimore me personat ndaj të cilëve ishte bërë kallzim pa patur urdhër apo delegim kompetencash nga prokurori. Sqarojmë se kallzimi i bërë bënte fjalë për një kundërvajtje penale dhe se nuk kishim të bënim me një krim me rrezikshmëri të theksuar shoqërore dhe as ishin në kushtet e flagrancës. Gjithashtu nga pyetja e ankuesve dhe verifikimi në vënd rezultoi që Shefi i Rajonit Policisë në Rrogozhinë, në vënd që, pas marrjes në pyetje t’i linte ata të lirë, i ka mbajtur në mënyrë të kundërligjshme në ambjentet e Policisë edhe për disa orë. Kështu p.sh. shtetasit H. I., N. K., I.S. dhe Sh. S. janë mbajtur në polici 6.5 orë nga ora 10.00 deri në orën 16.30, ndërsa shtetasi L. Sh. është mbajtur 8.5 orë, nga ora 10.00 deri në orën 18.30, duke iu cënuar rëndë lirinë personale.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti ne konstatuam se me veprimet e tij të kundërligjshme shtetasi Ibrahim Maksuti, gjatë ushtrimit të funksionit të tij shtetëror, si Shefi i Rajonit të Policisë Rrogozhinë dhe atë të punonjësit të Policisë Gjyqësore, kishte konsumuar elementët e figurës të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, i cili parashikon se: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve ose mosveprimeve në kundërshtim me ligjin që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës nga punonjësi i ngarkuar me funksion shtetëror ose shërbim publik, kur u ka sjellë pasoja të rënda interesave të ligjshëm të shtetasve ose shtetit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet”.

Gjithashtu me veprimet e tij, të kryera në këtë rast, Shefi i Rajonit të Policisë në Rrogozhinë kishte konsumuar edhe elementët e figurës të veprës penale të

“Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i K.Penal, cili parashikon se: “Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhërave arbitrare nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet”.

Për sa më sipër, i rekomandua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë fillimin e hetimeve ndaj Shefit të Rajonit të Policisë Rrogozhinë Ibrahim Maksuti për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal dhe të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i K.Penal. Rekomandimi u mirëprit, është filluar ndjekja penale dhe është në procesin e hetimit.

2. Ankesa e shtetasit N. B., banues në Rrëshen, i cili ankohej se meqënëse ishte me pushime, kishte lënë në shtëpinë e tij vëllain e vet G. B., nipin G. M. dhe dhëndrin P. M.. Më datën 19.07.2007, ora 04.00, në shtëpinë e tij kishin shkuar forca të shumta policore dhe kishin trokitur në derë. Pasi personat e mësipërm kanë hapur derën, policët kanë hyrë menjëherë brenda dhe pa i informuar për shkakun e këtij veprimi, i kanë prangosur të tre ata. Punonjësit e Policisë kanë ushtruar kontroll në banesë pa patur asnjë vendim gjyqësor dhe gjatë kontrollit kanë dëmtuar disa dokumenta të ankuesit. Pas këtyre veprimeve punonjësit e Policisë nuk kanë mbajtur e as lënë ndonjë procesverbal për ushtrimin e kontrollit dhe i kanë shoqëruar të tre personat në Polici. Ata janë mbajtur në Komisariatin e Policisë në Mirditë për 5 orë dhe nuk ju është thënë arsyeja e kontrollit, prangosjes dhe shoqërimit të tyre. Ankuesi pasi është njoftuar për këtë veprim të Policisë, ka ndërprerë pushimet dhe është paraqitur në Polici dhe ka kërkuar takim me Shefin e Komisariatit në Mirditë, por nuk është pritur prej tij.

Në bazë të kërkesës tonë, Komisarati i Policisë Mirditë, midis të tjerave na informoi se për këtë kontroll ka patur urdhër nga Prokuroria për Krimet e Rënda, pasi sipas informacioneve të marra në rrugë sekrete aty fshihej një person shumë i kërkuar N. S., për të cilin ajo Prokurori kishte nxjerrë urdhër ndalimi, pasi akuzohej për disa vepra penale të rënda.

Në kërkesën tonë i kërkuam Policisë edhe shpjegime për shkaqet ligjore të shoqërimit të personave të cituar më sipër, si edhe dokumente që lidheshin me këto veprime të Policisë. Nga verifikimet e bëra rezultoi se punonjësit e Policisë që kishin kryer këto veprime nuk kishin përpiluar dokumentet e nevojshme, fakt që vërtetonte pretendimin e ankuesit se nga ana e Policisë nuk ishte mbajtur procesverbal ose ndonjë dokument tjetër për ushtrimin e kontrollit të banesës së tij.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese arritëm në konkluzionin, që pavarësisht se kontrolli i banesës ishte kryer me qëllimin e kapjes së një personi shumë të kërkuar dhe me urdhër të organit të Prokurorisë, mbas përfundimit të tij duhej të ishte përpiluar raporti përkatës nga punonjësit e Policisë që kryen këtë veprim. Ky veprim, mosmbajtja e dokumentacionit, vjen në kundërshtim me nenin 112, pika 4 e ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, i cili parashikon se: “Në të gjitha rastet e hyrjeve dhe të kontrolleve, sipas këtij neni, punonjësi i Policisë harton një raport, ku përmenden arësyet e hyrjes dhe kryerjes së kontrollit dhe rezultatet e tij. Një kopje e këtij raporti i jepet, sipas kërkesës, personit të interesuar ose personave të autorizuar prej tij”. Në të njëjtën kohë ky qëndrim vjen në kundërshtim edhe me nenin 298 të K.Pr.Penale, i cili parashikon mbajtjen e procesverbalit për veprimet e kryera nga punonjësit e Policisë Gjyqësore në rastet e kontrolleve.

Për këto arsye, i rekomandua Shefit të Komisariatit të Policisë Mirditë, që të analizonte këtë rast dhe të jepte masa disiplinore ndaj punonjësve të Policisë që

kishin marrë pjesë dhe drejtuar veprimet proceduriale gjatë kontrollit të banesës së ankuesit. Gjithashtu i rekomanduam, që masat disiplinore të jepeshin në prezencë të efektivit të Policisë me qëllim që të parandalohen shkelje të tilla në të ardhmen. Rekomandimi u pranua dhe ndaj punonjësve të Policisë Frederik Lleshi, Ndue Gjeta, Pal Lleshi dhe Paulin Përdoda u dhanë masa disiplinore.

3. Ankesa e shtetases B. N., me banim në Tiranë, e cila u ankua se në orën 01.15 të datës 16.04.2007, i kanë hyrë në oborr jo nga dera e jashtëme dhe më pas edhe në shtëpinë private në mënyrë të dhunshme një grup rreth 15 policësh, efektivë të Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë. Veprimi i tyre ka qënë shumë i dhunshëm fizikisht dhe psikologjikisht ndaj saj dhe djalit të saj të mitur. Pasi punonjësit e Policisë kanë hyrë në shtëpi, kanë ushtruar kontroll në ambjentet e saj për kërkimin e F. N., djalit të madh të saj. Ata nuk kanë paraqitur ndonjë vendim gjyqësor për ushtrimin e kontrollit të banesës dhe nuk kanë lënë procesverbal për kontrollin e ushtruar. Sipas saj, shkak i kryerjes së këtij veprimi të Policisë kishte qënë kërkimi i djalit të saj F. N., i cili dyshohej nga Policia si autor i një vjedhjeje të ndodhur në Tiranë. Ankuesja pretendonte, se veprimi i Policisë ishte i kundërligjshëm sepse djali i saj, i cili kërkohet nga Policia nuk ndodhej në Tiranë, por kishte ikur jashtë shtetit që para 4 muajsh.

Në bazë të kërkesës tonë, Komisaritati i Policisë Nr. 4 Tiranë, ndërmjet të tjerave na informoi se më datën 15.04.2007, rreth orës 24.00 ishte kryer vjedhja e një automjeti në rrugën “K. Manastirit”. Pas punës së bërë nga Policia u gjet automjeti i vjedhur, i cili ishte braktisur. Nga dëshmitarët dhe i dëmtuari ishin përcaktuar të dhënat fizike të autorit. Nga të dhënat rreth karakteristikave të autorit, ka rezultuar se ato përputheshin me karakteristikat e djalit të ankueses, të quajtur F. N., i evidentuar nga ana e Policisë si person me precedent kriminal, me tendence vjedhje të automjeteve, i cili edhe ishte dënua një herë për këtë lloj veprë penale. Në këto kushte, bazuar në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 45 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” kanë shkua në banesën e ankueses, e cila ka hapur derën pas 15 minutash trokitje. Asaj i është shpjeguar qëllimi i vajtjes atje, i cili ishte kërkimi i djalit të saj F. N.. Ajo është përgjigjur se ai nuk ishte në shtëpi, por në Greqi dhe ka kërkuar që të takohej me Shefin e Krimeve për shqetësimin që i ka sjellë Policia. Ankuesja është shoqëruar në komisarariat dhe është takuar me Shefin e Krimeve, i cili e ka sqaruar atë për veprimet e Policisë. Pas kësaj, ajo nuk ka patur pretendime dhe ishte kthyer në shtëpi e shoqëruar nga Policia. Në përgjigjen e Policisë theksohej se nuk ishte ushtruar kontroll banese, por vetëm është kërkuar djali i saj.

Informacionin e dhënë nga Policia, ne ja bëmë të njohur ankueses, mirëpo ajo e ka kundërshtuar atë. Sipas saj, punonjësit e Policisë kanë hyrë brenda ambjenteve të shtëpisë duke kërkuar djalin dhe se ajo nuk ka kërkuar të shkojë në Polici, por është shoqëruar me forcë nga punonjësit e Policisë.

Nga pretendimet e ankueses dhe nga përgjigja e Policisë arritëm në konkluzionin se veprimet e punonjësve të Policisë në rastin konkret ishin të kundërligjshme. Neni 27 i Kushtetutës dhe neni 45 i ligjit “Për Policinë e Shtetit” i jep të drejtën punonjësve të Policisë që të kufizojë lirinë e personit dhe të bëjë shoqërimin e tij në Polici, kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale, ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj. Mirëpo në këtë rast, i dyshuar si autor i veprës penale ka qënë djali i ankueses dhe jo ankuesja, e cila është shoqëruar në Polici në kundërshtim me kriteret ligjore. Edhe hyrja e punonjësve të Policisë në banesën e saj është bërë në kundërshtim me

nenin 37 të Kushtetutës, nenet 202 - 206 dhe 298 të K.Pr.Penale, si dhe nenin 43 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Për sa më sipër dhe për të bërë të mundur parandalimin e veprimeve të kundërligjshme të punonjësve të Policisë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, i rekomanduam Shefit të Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë, që të analizonte me objektivitet këtë shkelje ligjore dhe ndaj punonjësve të Policisë që kishin urdhëruar dhe drejtuar kryerjen e veprimeve të kundërligjshme të jepeshin masa disiplinore. Gjithashtu rekomanduam, që kjo shkelje të përgjithësohej dhe masat disiplinore të jepeshin në prezencë të efektivit me qëllim parandalimin e shkeljeve të tilla në të ardhmen. Rekomandimi u pranua dhe ndaj Shefit të Policisë Kriminale z. Gentjan Bajrami dhe Specialistit të Policisë Kriminale z. Eduart Struga u dhanë masa disiplinore.

4. Ankesa e shtetasit Arben H., lindur ne Pukë dhe banues në Kumingatane - Gotenburg, Suedi. Ai na shkruante se ishte emigrant i rregullt në Mbretërinë e Suedisë dhe jetonte e punonte atje. Në datën 06.07.2007, ka hyrë pa asnjë problem në Shqipëri nëpërmjet pikës së kalim-kontrollit kufitar në Rinas. Në Shqipëri qëndroi disa ditë tek të afërmit e tij dhe në datën 18.07.2007, është nisur për t’u kthyer në Suedi, me avionon e linjës “Austria Airlines”, meqënëse të nesërmen i duhej të ishte në punë. Në orën 13.00 ka bërë kontrollin e bagazhit në Aeroportin e Rinasit, por në terminal është ndaluar nga forcat e Komisarariatit të Policisë të Rinasit. Që nga ky çast e deri në ora 22.30 të datës 18.07.2007, është shoqëruar në ambjentet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë. Ai nuk është lejuar të lajmërojë familjen e tij në Shqipëri dhe as bashkëshorten në Suedi, e cila për shkak të vonesës së tij ishte shqetësuar dhe kishte filluar të interesohej deri në organet e Policisë së aeroportit pritës në Suedi. Gjithashtu, ai nuk është lejuar të kontaktojë me ndonjë avokat, edhe pse në ambjentet e dhomës ku ai është marrë në pyetje ishte shkruar me gërma të mëdha, e drejta e çdo personi të ndaluar nga policia për të marrë një avokat. Ankuesi është marrë në pyetje katër herë radhazi, duke i bërë të njëjtat pyetje të cilat ai i konsideronte sugjestionuese, pasi donin t’ a detyronin të pohonte përgjigjet e tyre dhe jo të vërtetën që ai kishte deklaruar. Ata e kanë pyetur jo vetëm për të dhënat të tija, por për të gjithë familjen dhe e kanë detyruar të firmosë disa herë për të parë përputhjen e firmës së tij me atë në pasaportë. Ai është pyetur dhe nga Shefi i Policisë Kriminale të Drejtorisë së Policisë të Qarkut në Tiranë, si dhe katër punonjës Policie të ardhur nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Shkodrës. Gjatë gjithë kohës është marrë në pyetje nga persona të pautorizuar dhe të pidentifikuar, të cilët nuk i konfirmonin se përse ishte shoqëruar. Në orën 22.30, ai është lënë i lirë, pa i komunikuar arsyen përse ishte shoqëruar. Në përfundim është përpiluar vetëm një shkresë gjysëm faqe ku ai ka vendosur firmën dhe nuk i është dhënë kopje e saj edhe pse ai e ka kërkuar. Njëri nga personat me uniformë që e ka takuar në ambjentet e komisarariatit i ka thënë, se bëhej fjalë për një ngatërrësë ngjashmërie, dhe atij i duhej të vuante për shkak të ngjashmërisë së tij me persona të tjerë. Për shkak të veprimeve të Policisë, ankuesi nuk është paraqitur në kohë në vendin e punës në Suedi, duke rrezikuar t’ a humbasë atë. Ai është detyruar të presë një biletë tjetër të kushtueshme pa fajin e tij dhe nuk ishte çdëmtuar financiarisht. Gjithashtu ankuesi pretendonte, se nga këto veprime të paligjshme të Policisë së vendit të tij mori një stres dhe një shqetësim të pajustificueshëm, duke bërë të ndjehet i pasigurt dhe i pa mbrojtur.

Nga verifikimet e bëra si dhe dokumentacioni që administruam në këtë rast rezultoi se:

Në sistemin TIMS (për personat në kërkim) të Policisë Kufitare dhe Migracionit në Komisariatit e Policisë në Rinas rezultonte se shtetasi A.H, i biri i P. dhe i Z., lindur dhe banues në Fushë-Arrëz, Pukë, ishte person i dyshuar për kryerjen e një krimi.

Sipas librit të shoqërimit të shtetasve rezultonte, se shtetasi Arben H. ishte shoqëruar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë për verifikim, në ora 15.15 të datës 18.07.2007 dhe se është lënë i lirë në orën 22.15 të datë 18.07.2007.

Punonjësi i Policisë Entiol Xhelilaj, me detyrë specialist në Zyrën e Analizës dhe Kordinimit në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, sqaroi se shtetasi Arben H. ishte shoqëruar me kërkesë të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër, e cila kishte njoftuar për një shtetas në kërkim, i cili perdorte dy emra, përkatësisht Arben dhe Artan H.. Në datën 17.07.2007, ky shtetas është futur në sistemin TIMS si person i dyshuar, por përveç gjeneraliteteve i mungonte fotografia. Në datën 18.07.2007, në Komisariatit e Policisë Rinas dhe pikërisht në kabinën e daljes së Policisë Kufitare, u konstatua një shtetas me emrin Arben H. që kishte të dhëna të përafërta me shtetasin në kërkim. Dyshimi u shtua se shtetasi ankues Arben H. figuronte me dy pasaporta. Por fotografia e tij ndryshonte në të dy pasaportat, pasi në njërin ishte i qethur shkurt dhe në tjetrën me flokë më të gjatë. Ndërsa fotografia e personit që kërkohet nuk ishte siguruar akoma. Në këto kushte ankuesi u shoqërua derisa të vinin punonjësit e Policisë Shkodër për të bërë identifikimin përfundimtar. Pas ardhjes së punonjësve të Policisë së Shkodrës rezultoi, se shtetasi i shoqëruar me emrin Arben H. nuk ishte shtetasi që kërkohet prej tyre. Në këto kushte ankuesit ju tha shkaku i shoqërimit dhe u la i lirë. Sipas tij, ankuesi nuk kishte kërkuar të komunikonte me ndonjë njeri, nuk kishte kërkuar avokat dhe se kishte firmosur një deklaratë me dëshirën e tij, ku ndër të tjera deklaronte se nuk kishte ndonjë pretendim për shoqërimin e tij në Polici. Ai nuk kishte kërkuar kopje të deklaratës dhe se atij nuk i ishte mbajtur bileta e udhëtimit. Shpjegimet e tij konfirmohen edhe nga pyetja e policëve të tjerë.

Nga verifikimi në Agjensinë e Udhëtimit Ajror të Shoqërisë Austrian-Airlines rezultoi, se ankuesi në datën 18.07.2007, kishte prerë biletë udhëtimi me linjën Austian-Airlines për në Suedi, por nuk kishte udhëtuar atë ditë. Ai kishte udhëtuar me linjën Austian-Airlines për në Suedi në datën 21.07.2007, po me të njëjtën biletë, por me një penaltitet në shumën 50 euro.

Në përfundim të verifikimit të kryer dhe administrimit të dokumenteve të ndryshme rezultoi se, shoqërimi i ankuesit ishte i ligjshëm për arsye se Policia dyshoi për atë si person të kërkuar. Mirëpo koha e mbajtjes së tij në ambientet e Policisë për rreth 9 orë edhe pse ishte brënda afatit ligjor, nuk ishte e justifikuar. Sigurimi i të dhënave të plota për verifikim është detyrë e Policisë së Shtetit. Ky veprim i Policisë ndaj ankuesit, i solli atij si pasojë udhëtimin me dy ditë vonesë, pagimin e penaltitetit prej 50 euro për biletën, 37.000 lek të vjetra për dy ditë akomodimi e ushqim, si dhe rrezikimin për të humbur vëndin e punës. Sipas akteve normative në fuqi këto detyrime i ngarkohen Drejtorisë së Policisë së Qarkut në Tiranë.

Për sa sipër, i rekomanduam Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që të merrte të gjitha masat e nevojshme për të plotësuar me të dhënat e plota dhe të sakta sistemin TIMS, me qëllim eliminimin e rasteve të tilla. Gjithashtu i rekomanduam, kompensimin e dëmit që ju shkaktua ankuesit. Rekomandimi u pranua.

III. Inspektime në dhomat e paraburgimit që administrohen akoma nga Policia e Shtetit

Kalimin e sistemit të paraburgimit nga Ministria e Brendshme në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, Avokati i Popullit e ka konsideruar si arritje pozitive në fushën e mbrojtjes së të drejtave të të paraburgosurve. Megjithëse ky proces filloi në vitin 2003, u bë e mundur që të përfundonte vetëm në muajin Qershor 2007.

Në urdhërin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë me nr. 582/1 Prot., dt. 24.01.2007 dhe Ministrit të Brendshëm me nr. 432 Prot., dt. 23.01.2007, me titull “Për kalimin e plotë të paraburgimit nga Ministria e Brendshme në varësi të Ministrisë së Drejtësisë”, i cili është nxjerrë në bazë e për zbatim të nenit 6/12 të ligjit nr. 8678, dt. 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” dhe VKM nr. 327, dt. 15.05.2003, “Për kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë”, midis të tjerave, në detyrat e Ministrisë së Drejtësisë është përcaktuar, që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të asistojë dhe të marrë masat e nevojshme për të ekzekutuar menjëherë çdo vendim të gjykatës për caktimin e masës së sigurisë arrest në burg. Prandaj në muajin Shtator 2007 u bënë inspektime nga ekipe të Avokatit të Popullit në dhomat e sigurimit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë dhe në disa qarqe të tjera të vendit.

Nga inspektimet konstatuam se kjo detyrë nuk po zbatohet me korrektësi, sepse në dhomat e sigurimit të organeve të Policisë mbaheshin ende të paraburgosur ndaj të cilëve ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”. Në dhomat e sigurimit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë mbaheshin 16 persona të arrestuar, nga të cilët 13 ishin me masë sigurimi arrest në burg të caktuar nga gjykata, ndërsa 3 ishin në pritje të vlerësimit të masës së sigurimit. Në fakt në këtë drejtori ka vetëm 4 dhoma sigurimi me përmasa 1.3 x 2.2 m, në të cilat duhet të mbahet vetëm nga një person në një dhomë. Ndërkohë, siç përmendëm edhe më lart, ishin 16 persona. Nga komunikimi me titullarët e këtij organi u informuam se gjendja në këtë drejtori kishte qënë edhe më e rënduar dhe se para disa ditëve kishin patur 36 persona, 3 prej të cilëve të dënuar nga gjykata. Sipas pretendimit të tyre, kjo gjendje vinte për shkak se Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nuk i pranon të paraburgosurit menjëherë pasi ata arrestohen nga gjykata, me pretendimin se nuk kanë vende të lira në burgje. Për zgjidhjen e këtij problemi ata, përveç komunikimit të vazhdueshëm verbal i kishin bërë edhe disa shkresa Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Edhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, na informoi se ishin në dijeni të këtij shqetësimi dhe se i kanë kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të përmbushte detyrat e saj lidhur me këtë proces. Por problemi akoma nuk kishte gjetur zgjidhje të plotë. Situata të tilla kishte edhe në disa drejtori të tjera të Policisë në qarqe.

Ne gjykojmë se mbajtja e personave të arrestuar në dhomat e sigurimit të organeve të Policisë së Shtetit vjen në kundërshtim me aktet e përmendura më sipër. Në të njëjtën kohë konstatuam, se ky veprim përbënte shkelje të të drejtave të paraburgosurve, për faktin se këto ambjente nuk kanë standartet e kërkuara, kanë kubaturë të vogël, disa janë pa ajrim dhe të ndaluarve ju shkelet e drejta e ajrimit, ka mungesë të kushteve higjeno-sanitare, si dhe personeli i sigurimit të tyre është i patrajtuar në këtë fushë.

Për sa më sipër, i rekomanduam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë, marrjen e masave të nevojshme për dërgimin dhe pranimin e menjëhershëm

të të gjithë të paraburgosurve që ndodheshin në dhomat e sigurimit të organeve të Policisë së Shtetit, në Tiranë dhe kudo ku ndodhen të tillë. Marrjen e masave organizative e teknike me qëllim për të bërë të mundur ekzekutimin e menjëhershëm të çdo vendimi gjyqësor për caktimin e masës së sigurisë arrest në burg, duke i dërguar personat në burgje apo institucionet e caktuara për të paraburgosur, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, por jo në dhomat e sigurisë në varësi të Policisë së Shtetit. Gjithashtu ju bëjmë të ditur se moszbatimi i këtij rekomandimi, që nxirret në zbatim të legjislacionit përkatës, në të ardhmen do të përbënte shkak për të kërkuar marrjen e masave administrative apo penale ndaj personave përgjegjës që do të shkelin të drejtat e të paraburgosurve. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua, por jemi në ndjekje të rasteve të tjera kur vetë organet e Policisë na informojnë për shkelje të kësaj natyre nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

IV. Ankesat ndaj Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, për mos respektimin e të drejtave të punonjësve të tyre në rastet e largimeve nga puna

Në Institucionin tonë gjatë vitit 2007 janë bërë 88 ankesa nga 230 oficerë, policë dhe punonjës të tjerë të strukturave mbështetëse të Ministrisë së Brendshme për largime të padrejta nga puna. Sipas tyre, motivacioni dhe shkaqet ligjore të largimit nga puna nuk kanë qënë të bazuara dhe shpesh herë fiktive, si dhe nuk janë zbatuar kriteret ligjore dhe profesionale.

Si shëmbuj të rasteve të trajtimit të këtij problemi mund të përmëndim:

Ankesat e një numri të konsiderueshëm ish punonjësish të Policisë së Shtetit, të larguar në fund të vitit 2006 dhe gjatë vitit 2007. Sipas tyre, motivacioni i largimit, “për shkak të shkurtimit të funksionit organik” ishte i pavërtetë sepse në fakt nuk janë shkurtuar funksionet ku ata kanë qënë, por në vend të tyre janë emëruar persona të tjerë. Gjithashtu, ata ngrinin edhe problemin se gjatë kryerjes së reformës dhe ndryshimeve strukturore në Policinë e Shtetit, nga strukturat përkatëse emëruese, nuk janë mbajtur parasysh kriteret profesionale, arsimi, aftësitë, vlerësimet e punës dhe mosha, si për ata që janë larguar, ashtu edhe për ata që janë mbajtur e riemëruar në Polici.

Meqënëse nga ish punonjës të Policisë, efektivë të Drejtorisë së Policisë së Qarkut në Vlorë, na erdhën disa ankesa të cilët përfaqësonin rreth 150 punonjës Policie të larguar, për verifikimin e pretendimeve të tyre, një ekip i Avokatit të Popullit në datat 5-7 shkurt 2007 dhe 20-24 mars 2007 shkoi në këtë drejtori dhe në komisaritet në varësi të saj, në Sarandë e në Delvinë.

Nga kqyrja e dokumentacionit, si organigramat dhe dosjet e ankuesve dhe të punonjësve të Policisë për të cilët u informuam se ishin marrë apo mbajtur jashtë kriterëve ligjore e profesionale, rezultoi se:

I. Motivacioni i largimit, “shkurtim të funksionit organik” për dhjetë punonjës Policie të rolit të mesëm nuk ishte i vërtetë, sepse në fakt nuk kishte shkurtim të funksionit organik në strukturën e re organike të kësaj drejtorie. Kështu mund të përmëndim ish punonjësit e Policisë:

1. Sh. H., ish specialist i kërkimit në Komisaratin e Policisë Vlorë. Në momentin e largimit, kishte qënë një funksion dhe ngelej një në organigramën e re. Ky ankues ishte me arsim të lartë, kishte studiuar në Akademinë e Policisë, të cilën e kishte mbaruar më 1987, kishte kryer detyra të ndryshme drejtuese në Polici, i trajnuar disa herë brenda vendit dhe me vleresime pune të mira.

2. A. M., ish specialist i luftës kundër drogës në Drejtorinë e Policisë Vlorë. Në momentin e largimit të tij, kishin qënë pesë funksione dhe ngeleshin pesë në organigramën e re. Ky ankues ishte me arsim të lartë, kishte mbaruar më 1989 Akademinë e Policisë. Kishte kryer detyra të ndryshme drejtuese, me vlerësime pune shumë të mira, shpërblyer disa herë, si dhe trajnuar disa herë brenda dhe jashtë vendit.

3. N. B., ish specialist i Policisë së zonës (qytet) në Komisaratin e Policisë Vlorë. Në momentin e largimit, kishin qënë pesë funksione dhe ngeleshin pesë në organigramën e re. Ky ankues ishte me arsim të lartë. Kishte studiuar Matematikë-Fizikë dhe kishte mbaruar më 1997. Kishte kryer dhe Akademinë e Policisë, mbaruar më 2001. Emëruar në Polici më 1998, kishte punuar në detyra të ndryshme, me vlerësime pune të mira.

4. H. J., ish specialist i Policisë së zonës (qytet) në Komisaratin e Policisë Vlorë. Në momentin e largimit, kishin qënë pesë funksione dhe ngeleshin pesë në organigramën e re. Ky ankues ishte me arsim të lartë Akademia e Policisë, emëruar fillimisht si polic në vitin 1986 dhe pas mbarimit të shkollës së lartë, më 1998 ishte titulluar oficer, kishte kryer detyra të ndryshme, kishte vlerësime pune të mira dhe ishte trajnuar disa herë jashtë dhe brenda vendit.

5. F. M., ish specialist i Policisë së zonës (qytet). Në momentin e largimit në Komisaratin e Policisë Vlorë, kishin qënë pesë funksione dhe ngeleshin pesë në organigramën e re. Ky ankues është me arsim të lartë, ishte emëruar si polic në vitin 1989, kishte mbaruar Akademinë e Policisë në vitin 2001 dhe ishte titulluar oficer, kishte kryer detyra të ndryshme dhe kishte vlerësime pune të mira.

6. M. Q., ish specialist i Policisë së zonës në Rajonin e Policisë të Portit Vlorë. Në momentin e largimit, kishte qënë një funksion dhe ngelej një në organigramën e re. Ky ankues fillimisht e kishte filluar karrierën si polic dhe në vitin 2001 kishte përfunduar arsimin e lartë, Akademinë e Policisë dhe ishte titulluar oficer, kishte vlerësime pune të mira dhe ishte trajnuar disa herë.

7. I. Ll., ish specialist i luftës kundër drogës në Drejtorinë e Policisë Vlorë, për Komisaratin e Policisë Sarandë. Në momentin e largimit të tij, kishin qënë pesë funksione dhe ngeleshin pesë në organigramën e re. Ky ankues ishte me arsim të lartë ekonomik dhe Akademinë e Policisë, kishte punuar në detyra të ndryshme drejtuese, kishte vlerësime pune të mira, ishte shpërblyer disa herë dhe kishte bërë disa trajnime.

8. F. V., ish komandant i PKK Rrips Sarandë. Në momentin e largimit kishte qënë një funksion dhe ngelej një në organigramën e re. Ky ankues është me arsim të lartë ushtarak mbaruar në vitin 1990, kishte punuar në repartet e M.Mbrojtjes deri në vitin 1994 dhe më pas kishte kaluar në M.R.Publik dhe kishte kryer detyra të ndryshme, kishte vlerësime pune të mira dhe kishte kryer disa trajnime policore.

9. A. Ç., ish kontrollor dhe përgjegjës turni në PKK Rrips Sarandë. Në momentin e largimit kishin qënë dy funksione dhe ngelej një në organigramën e re. Sqarojmë se në momentin e ardhjes së organigramës së re, kolegu i tij ishte larguar me kërkesën e vet dhe për rrjedhojë kishte ngelur vetëm ai. Ky ankues është me arsim të lartë ushtarak, mbaruar në vitin 1988 dhe kishte punuar në repartet e M.Mbrojtjes deri në vitin 1993 dhe pas kësaj kishte kaluar në M.R.Publik, kishte kryer detyra të ndryshme, kishte vlerësime pune të mira dhe kishte kryer disa trajnime.

10. L. B., ish kontrollor dhe përgjegjës nëngrupi në Livadhja. Ishin katër funksione në organigramën e vjetër dhe ngelen dy. Sqarojmë se të katër ata që ishin më parë ishin larguar dhe dy të riemëruarit janë sjellë nga vende të tjera pune.

Nga ana jonë u konkludua se 10 ankuesit e mësipërm janë larguar nga puna padrejtësisht dhe se motivi i largimit të tyre ishte fiktiv dhe i pavërtetë.

II. Nga verifikimi i emërimeve dhe riemërimeve të bëra po në Drejtorinë e Policisë së Qarkut në Vlorë konstatoam, se mjaft prej tyre ishin pa arsimin policor, me arsim civil ose ushtarak dhe vetëm disa prej tyre kishin kryer kursin 4 mujor të Policisë, i cili kurrsesi nuk mund të zëvendësojë arsimin e lartë policor. Çuditërisht disa prej këtyre, duke mos patur arsimin, përvojën dhe kualifikimin e duhur ishin emëruar edhe në funksione drejtuese në këtë drejtori. Kështu pasi u studjuan dosjet e personelit mund të përmëndim:

1. E. M., me arsim të lartë ushtarak (ish Shkolla e Bashkuar e Oficerëve), mbaruar në vitin 1980 dhe deri në vitin 1993 kishte punuar në repartet e M.Mbrojtjes. Pas kësaj kishte kaluar në M.R.Publik dhe në vitin 1997 ishte liruar. Më 01.03.2006 ishte riemëruar në Polici në detyrën Shef i Rendit dhe Sigurisë Publike në Komisariatin e Policisë Vlorë. Kishte marrë një masë disiplinore në vitin 2006, nuk ka arsim policor, por vetëm kurse dy-tre ditore.

2. A. Y., me arsim të lartë ushtarak (ish Shkolla e Bashkuar e Oficerëve), mbaruar në vitin 1990, ishte emëruar në Polici në vitin 2006 dhe në dhjetor 2006 riemëruar Shef i Rajonit të Policisë në Portin e Vlorës. Kishte bërë dy kurse trajnimi policore nga një muaj në Poloni dhe në Egjipt gjatë vitit 2006, pas emërimit.

3. A. Z., me arsim të lartë mësuesi, mbaruar në vitin 1993. Në vitin 1994 ishte titulluar oficer dhe ishte emëruar në Komisariatin e Policisë Gjirokastër. Në vitin 1995 kishte filluar Akademinë e Rendit (pa shpëputje nga puna) dhe kishte shlyer vetëm 6 lëndë. Më 04.11.1997, del në lirim për cënim të figurës së ushtarakut. Më 29.09.2006 është ripranuar në Polici dhe emëruar Shef i Rajonit të Policisë Himarë. Nuk ka asnjë kualifikim policor.

4. F. V., me arsim të lartë juridik, mbaruar në vitin 2004. Në vitin 1993 është emëruar polic në Komisariatin e Policisë Vlorë. Në vitin 1997 është liruar si i papërshtatshëm. Më 18.01.2007 është ripranuar në Polici dhe është emëruar në detyrën specialist në seksionin e gjurmimit teknik në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë. Nuk ka asnjë trajnim policor. Sqarojmë se ripranimi i tij në Polici është bërë në kundërshtim me Urdhër-Shërbimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 689/1, dt. 25.10.2006, me lëndë “Dërgohet struktura organike dhe Urdhër-Shërbimi për miratimin e saj”. Sipas këtij urdhëri-shërbimi, nuk duhet të bëhet asnjë propozim për pranim ose ripranim në Polici në plotësimin e funksioneve të lira organike, pa u sistemuar më parë punonjësit që ju shkurtohet vendi i punës. Pra në vënd që të sistemoheshin dhjetra të larguar për shkurtrim të funksionit organik, merren dhe emërohen në Polici persona nga jeta civile dhe pa arsimin përkatës.

5. A. B., me arsim të lartë për gjeologji-miniera, diplomuar si tillë në vitin 1994 dhe përfunduar edhe Fakultetin e Marinës në vitin 2002. Në vitin 1993 është emëruar polic në forcat speciale të RENEA-s. Në vitin 1994 është titulluar oficer dhe është emëruar Shef i Policisë Kriminale në Komisariatin e Policisë Vlorë, ndërsa në vitin 1995 është emëruar Instruktor i Përgatitjes Fizike në Rep. 751 Vlorë. Më 01.09.1997 del në lirim për shkak të mosparaqitjes në detyrë. Më 05.09.2006 është ripranuar në Polici dhe është emëruar në detyrën Shef Seksioni ai dhe Specialist i Policisë Kriminale në Komisariatin e Policisë Vlorë. Gjatë vitit 2006 kishte kryer kursin 4 mujor në Akademinë e Policisë.

6. Sh. M., me arsim të lartë ushtarak (ish Shkolla e Bashkuar e Oficerëve), mbaruar në vitin 1973 dhe kishte punuar në repartet e M.Mbrojtjes deri në vitin 2002. Ai ishte emëruar në Polici me 05.02.2006 në detyrën e Komandantit të PKK në Rajonin e Portit Vlorë. Ndërsa në dhjetor 2006 ishte emëruar Komandant i GOS

(grup operativ i specializuar), në sektorin e Policisë Kufitare. Ky nuk kishte kryer asnjë trajnim policor.

7. R. B., me arsim të lartë, dega anglisht, emëruar në Polici në vitin 2006 në sektorin e mardhënieve me publikun. Meqënëse u shkurtua funksioni i saj, në dhjetor 2006 ishte riemëruar Kontrollore dhe Përgjegjëse turni në PKK në Portin Vlorë. Nuk kishte asnjë trajnim policor.

8. P. M., me arsim të lartë, inxhinjeri minierash, është rimarrë në Polici më 05.05.2006 dhe emëruar Specialist i Policisë Rrugore në Komisaratin e Policisë Vlorë. Nuk kishte kryer asnjë trajnim policor.

9. V. S., me arsim të lartë, dega veterinar, është emëruar në Polici në vitin 2006 dhe gjatë këtij viti ka kryer një kurs 4 mujor në Akademinë e Policisë, ishte emëruar Shef i Luftës Kundër Drogës në Drejtorinë e Policisë Vlorë.

10. I. N., me arsim të lartë dega zooteknikë, emëruar në Polici në vitin 1993. Në vitin 1997 ishte larguar me kërkesën e tij. Rimarrë më 18.02.2006 dhe gjatë këtij viti kishte kryer një kurs 4 mujor në Akademinë e Policisë. Ishte emëruar Shef i Rendit dhe Sigurisë Publike në Drejtorinë e Policisë Vlorë. Në vitin 2007 kishte marrë një masë disiplinore.

11. V. S., me arsim të lartë Akademia e Policisë, mbaruar në vitin 2001. Kishte qënë punonjës Policie dhe në dhjetor 2006 ishte emëruar në detyrën e Specialistit të Policisë Zonës në Komisaratin e Policisë Vlorë, pas largimit të disa të tjerëve të përmendur më sipër. Nga studimi i dosjes së tij rezultoi, se ai ishte ndëshkuar me disa masa disiplinore. Më 29.03.2006 ishte propozuar për t'u emëruar në një detyrë tjetër për punë jo të mirë, më 23.08.2006 është ndëshkuar me masë disiplinore "vërejtje me paralajmërim" për moskryerje të detyrës dhe përsëri në shtator 2006 ishte ndëshkuar me po të njëjtën masë disiplinore "vërejtje me paralajmërim". Megjithë këto masa disiplinore të marra radhë dhe të pashlyera, ai mbahej në Polici dhe riemërohej.

12. A. Gj., me arsim të lartë Akademia e Policisë, riemëruar në dhjetor 2006 në detyrën Komandant i Ruajtjes së Objekteve në Komisaratin e Policisë Vlorë. Nga studimi i dosjes së tij rezultoi, se ai ishte ndëshkuar me disa masa disiplinore si, më 04.05.2006 "vërejtje me paralajmërim" për mungesë korrektesë në kryerjen e detyrës. Më 23.08.2006 "vërejtje me paralajmërim" për mungesë korrektesë në kryerjen e detyrës dhe në shtator 2006 "vërejtje me paralajmërim" për mungesë korrektesë në kryerjen e detyrës. Megjithë këto masa disiplinore të marra radhë dhe pa u shlyer asnjëra, ai mbahej dhe riemërohej në Polici.

13. B. Gj., me arsim të lartë ushtarak, në vitin 2006 ka kryer një kurs katër mujor në Akademinë e Policisë, ishte emëruar në detyrën Komandant Grupi në Repartin e Rendit. Nga studimi i dosjes së tij rezultoi, se ai ishte ndëshkuar me dy masa disiplinore, më 23.08.2006 "vërejtje me paralajmërim" për mungesë korrektesë në kryerjen e detyrës dhe në shtator 2006 "vërejtje me paralajmërim" për mungesë korrektesë në kryerjen e detyrës. Megjithë masat disiplinore të marra radhë dhe pa u shlyer asnjëra, ai mbahej dhe riemërohej në Polici.

14. F. Sh., me arsim të lartë ushtarak, në vitin 2006 ka kryer një kurs katër mujor në Akademinë e Policisë dhe ishte emëruar në detyrën e Specialistit në Policinë e Rendit.

15. L. Gj., ishte emëruar punonjëse Policie në rolin bazë më 15.02.2006. Emërimi i saj ishte bërë jashtë kriterëve ligjore, sepse nuk kishte arsimin policor dhe moshën nën 30 vjeç. Ajo ishte me profesion parukiere dhe me moshë 41 vjeçe në kohën e emërimit???

III. Për dy punonjës Policie konstatuam se ndonëse ishin larguar me kërkesën e tyre, ata pretendonin se shkak për bërjen e kërkesës ishin bërë transferimet në mënyrë të padrejtë. Këtu mund të përmëndim:

1. A. V., ish Shefi i Rendit dhe i Sigurisë Publike në Drejtorinë e Policisë Vlorë, i cili ishte me arsim të lartë ushtarak, Akademia e Forcave Tokësore, mbaruar në vitin 1993 dhe Akademia e Policisë, mbaruar në vitin 1998 në Turqi, kishte kryer disa kurse trajnimi dhe kishte një karrierë të mirë policore, me vlerësime shumë të mira pune. Meqënëse në vitin 2006 ishte transferuar në Komisaratin e Policisë Tropojë dhe në një detyrë të ulët, ai bëri kërkesë për t'u larguar. Në vend të tij është emëruar I. N. me arsim zooteknik e kurs Policie 4 mujor.

2. V. P., ishte me arsim policor dhe kishte punuar 30 vjet në Polici në detyra të ndryshme. Në vitin 2006 ishte transferuar në Komisaratin e Policisë Tropojë në detyrën e Komandantit të Ruajtjes së Objekteve. Pasi punoi për rreth një vit në Tropojë dhe ndërkohë nuk e rikthyen në Sarandë, ai bëri kërkesë për t'u larguar.

IV. Të larguarit nga Policia trajtoheshin me pagesë kalimtare, të cilën e kishin marrë disa muaj me vonesë. Por disa prej tyre nuk ju ishin dhënë dy pagat mujore që në bazë të ligjit duhet t'i kishin marrë menjëherë pas largimit. Për këtë problem mund të përmëndim:

1. F. M., ish efektiv në Komisaratin e Policisë Vlorë.
2. M. B., ish efektiv në Komisaratin e Policisë Vlorë.
3. H. J., ish efektiv në Komisaratin e Policisë Vlorë.
4. N. B., ish efektiv në Komisaratin e Policisë Vlorë.

V. Nga hetimi i ankesave për largimet nga puna në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë në të cilën janë larguar 152 punonjës, si dhe i disa ankesave të ish punonjësve të Policisë në Drejtorinë Qëndrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe në disa Drejtori Qarqesh si, në Fier, Durrës, Kukës etj, kemi konstatuar se largimet nga Policia në fund të vitit 2006 janë kryer në kuadrin e shkurtimeve të numrit të punonjësve të Ministrisë së Brendshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Këto shkurtime janë bërë në bazë dhe në zbatim të VKM Nr. 551, dt. 2.8.2006 "Për caktimin e numrit të punonjësve buxhetore për vitin 2006 në Ministrinë dhe Institucionet Qëndrore". Në vijim të këtij vendimi ka dalë Urdhëri i Ministrit të Brendshëm Nr. 1442, dt. 25.8.2006 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektit të ristrukturimit të Policisë së Shtetit", Urdhër-Shërbimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 689, dt. 25.10.2006 "Për strukturën dhe përbërjen organike të Drejtorisë së Policisë së Qarkut" dhe Urdhër-Shërbimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 689/1, dt. 25.10.2006 me lëndë "Dërgohet struktura organike dhe Urdhër-Shërbimi për miratimin e saj".

Gjatë procesit të propozimeve dhe emërimeve të punonjësve të Policisë, nuk është mbajtur qëndrim korrekt dhe objektiv nga strukturat emëruese përkatëse, sepse largimet dhe rrimërimet e punonjësve të Policisë nuk janë bërë në bazë të kriterëve ligjore dhe profesionale të përcaktura në ligjin "Për Policinë e Shtetit" dhe në Rregulloren e Personelit të Policisë së Shtetit. Ato janë bërë në kundërshtim edhe me vetë Urdhër-Shërbimin Nr. 689/1, dt. 25.10.2006, në të cilin urdhërohet që në propozimet për emërim në detyrë të punonjësve të Policisë të rolit të mesëm dhe të lartë të mbahen parasysh kriteret e mëposhtëme si; vlerësimi i punës, vlerësimi i personalitetit, aftësitë fizike dhe shëndetësore, formimi dhe kualifikimi profesional dhe grada. Kryerja e këtyre veprimeve, në kundërshtim me kriteret ligjore, është bërë shkak për shkeljen e të drejtave të një numri të konsiderueshëm të ish punonjësve të Policisë. Për rastet e konstatuara më sipër nga ana jonë u bënë rekomandime individuale për rikthimin në punë për çdo punonjës Policie të larguar

padrejtësisht. Në të njëjtën kohë duhet të theksojmë, se ky proces i padrejtë ka sjellë si pasojë edhe uljen e nivelit profesional të efektivitetit të Policisë.

Për sa më sipër, i rekomanduam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Ministrit të Brendshëm që, gjatë procesit të reformës në strukturat e Policisë së Shtetit nga strukturat emëruese të mbahet një qëndrim korrekt ligjor e profesional në riemërimet, largimet dhe ngritjen në detyrë të punonjësve të Policisë, duke përzgjedhur ata që janë më të kualifikuarit, me arsimin përkatës e të trajnuar, më të mirët, më të aftët dhe më rezultativët në punë dhe t'i jepej fund praktikës abuzive, të largimit nga Policia të punonjësve me motivacione fiktive, siç është bërë në shumë raste. Rekomanduam që të rishikoheshin emërimet e bëra kohët e fundit në organet e Policisë dhe ata që nuk plotësojnë kriteret ligjore e profesionale të largoheshin nga Policia e Shtetit. Për të larguarit nga Policia të zbatoheshin të gjitha detyrimet ligjore dhe t'iu respektohen të drejtat e tyre ligjore si, dhënia e pagesës kalimtare në kohë dhe dhënia e dy pagave të menjëhershme.

Lidhur me punonjësit e Policisë të larguar nga puna thamë se gjatë vitit 2007 kanë ardhur 88 ankesa, të cilat përfaqësojnë 230 persona. Nga verifikimet e plota që mundëm të bënim për disa prej tyre, arritëm në konkluzionin se, për 26 punonjës Policie, ish drejtues, specialist apo policë, midis të cilëve edhe Kryekomisar, ishin larguar padrejtësisht dhe jashtë kriterëve ligjore. Për këto raste kemi bërë rekomandime individuale për rikthimin e tyre në punë. Mirëpo është e papranueshme që organet e Policisë në qendër dhe ato vendore, megjithatë të gjendur përballë fakteve dhe provave të pakundërshtueshme, nuk rikthyen asnjërin prej tyre.

Ky fenomen, përveç pasojave negative që ju sjell të ndëshkuarëve, duke ju ndërprerë marrëdhëniet e punës, passjellë në të njëjtën kohë edhe humbjen e besimit të publikut ndaj këtyre organeve. Gjithashtu, ai i shkakton edhe një dëm të konsiderueshëm ekonomik buxhetit të shtetit në përgjithësi dhe buxhetit të vetë këtyre organeve në veçanti. Krerëve të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë duhet t'ju tërheqë vëmëndjen fakti, se të larguarit nga Policia për shkak të "reformës", marrin pagesë kalimtare apo pension të parakohshëm. Ndërsa mjaft të tjerë kanë fituar të drejtën e dëmshpërblimit në rrugë gjyqësore për përjashtim apo lirim të padrejtë nga Policia. Kjo shumë është mjaft e konsiderueshme për buxhetin e këtij organi, duke e rënduar padrejtësisht atë. Edhe ky fakt është një tregues real, se largimet e bëra për disa punonjës Policie nuk kanë qënë të motivuara dhe të bazuara në ligj dhe në kriteret profesionale. Shkarkimet apo transferimet nga detyra të drejtuesve të Policisë pa mbushur disa muaj në vëndin e punës, nuk mund të ndikojnë në rritjen e besimit publik ndaj Policisë. Edhe në se ato bëhen të drejta për shkak të shkeljeve ligjore apo të Kodit Etik, përseri ka vënd për kritika, sepse personat e tillë nuk janë studjuar mirë para emërimit në detyrë. Gjithashtu, është edhe një tregues i faktit se emërimet në detyra të punonjësve të Policisë nuk bëhen gjithmonë mbi bazë të kriterëve ligjore, profesionale e morale njëkohësisht, por mbi baza njohjesh personale, përkatësive politike dhe për interesa të ngushta. Ky fenomen ka qënë i ndjeshëm edhe gjatë vitit 2007 sepse numri i punonjësve të Policisë të larguar nga puna për shkak të "reformës" është jo i vogël.

V. Rekomandime për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe shkeljeve të ligjit nga Policia

Në raportet e viteve të fundit, në mënyrë të përsëritur kemi bërë disa rekomandime, për të cilat gjykojmë se respektimi i tyre do të sillte parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe të shkeljeve të ligjit nga Policia.

Megjithëse ato ja kemi dërguar Ministrisë së Brendëshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, konstatojmë se edhe pas këmbënguljes tonë të vazhdueshme, pjesa më e madhe e tyre nuk janë zbatuar. Kështu p.sh. mund të përmëndim:

1. Nuk janë marrë masat e nevojshme që të sigurohet e drejta e vizitës nga një mjek për personat e privuar nga liria, qysh në fillim të privimit të tyre nga liria. Kjo e drejtë duhet gjithashtu të nënkuptojë të drejtën që këta persona kanë për t'u ekzaminuar, nëse ata dëshirojnë, nga një mjek i zgjedhur prej tyre.

Për realizimin e kësaj të drejte gjithashtu duhet që:

- Të gjitha ekzaminimet mjekësore të personave të privuar nga liria e tyre prej Policisë të jenë larg dëgjimit të Policisë dhe vetëm nëse kundërshton mjeku. Për ndonjë rast të veçantë, larg edhe shikimit të punonjësve të Policisë kur ata vizitohen nga mjeku.

- Rezultatet e çdo ekzaminimi, si dhe çdo deklaratë e bërë nga personi i vizituar, duhet të shënohen nga mjeku dhe të jenë në dispozicion të personit të privuar nga liria dhe të avokatit të tij.

2. Personave të privuar nga liria prej Policisë, nuk u dorëzohen formularë ku të pasqyrohen e saktësohen të drejtat e tyre. Këta formularë duhet që të jenë të disponueshëm edhe në gjuhë të huaj. Për më tepër, të interesuarit duhet të ftohen që të firmosin një deklaratë që ata kanë qënë të informuar mbi të drejtat e tyre.

3. Nuk është nxjerë udhëzimi (kod i sjelljes) për marrjen në pyetje nga Policia. Ky kod duhet ndër të tjera të trajtojë aspektet e mëposhtme; t'i tregohet sistematikisht të ndaluarit identiteti i personave të pranishëm gjatë marrjes në pyetje (emri dhe/ose matrikuli); kohëzgjatja e lejuar e një seance pyetjesh; periudhat e pushimit ndërmjet këtyre seanceve dhe pauzat gjatë marrjes në pyetje; vendi apo vendet ku mund të mbahet një seancë e tillë; nëse do t'i kërkohet të ndaluarit të qëndrojnë në këmbë gjatë marrjes në pyetje; dhe që ndalohe marrja në pyetje e personave nën ndikimin e drogës, alkoolit, ilaçeve ose nën një gjëndje tronditjeje. Ky kod duhet gjithashtu të parashikojë që të shënohet sistematikisht momenti i fillimit dhe i përfundimit të çdo marrje në pyetje, identitetin e çdo të pranishmi gjatë çdo seance pyetjeje, si dhe çdo kërkesë të formuluar nga i ndaluarit gjatë kësaj seance. Situata e personave veçanërisht të pambrojtur (për shëmbull, minorenet, personat e prekur nga sëmundje ose mangësi mendore) duhet të bëhen objekt i garancive specifike.

4. Nuk zbatohen të drejtat e mësipërme edhe për personat e mbajtur nga Policia për qëllime administrative. Nga inspektimi i bërë gjatë këtij viti në disa Komisariate të Policisë në shkallë vendi kemi konstatuar se në disa raste "shoqërimi në Polici" përdoret ndaj personave të dyshuar për një vepër penale. Pra shoqërimi përdoret jo për të sqaruar veprime administrative, por me qëllim hetimesh për vepra penale dhe mbas kohës së "shoqërimit" bëhen veprime procedurale të ndalimit ose arrestimit. Po kështu kemi konstatuar disa raste të kryerjes së veprimeve që çojnë në kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave në mënyrë të paligjshme, duke shkelur pikën 2 të nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Të dhëna të tilla mund të përmëndim ato që janë marrë nën efektin e dhunës fizike.

5. Nuk është nxjerë nga autoritetet policore qarkorja që të sqarojë se koha e mbajtjes së personit, për arsye administrative ose gjyqësore duhet të llogaritet brënda afatit kohor të caktuar për paraqitjen e një personi para një gjyqtari, që, sipas nenit 28 të Kushtetutës, është jo më tepër se 48 orë. Nga verifikimi i disa ankesave ka rezultuar se koha e ndalimit ose arrestimit fillon pas asaj të shoqërimit, që në disa raste edhe ajo ka qënë tej afatit ligjor.

6. Titullarët dhe kuadrot drejtues të Policisë nuk ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm në lidhje me librat e regjistrimit dhe të mbajtjes së personave në ambjentet e Policisë, me qëllim që ato të plotësohen saktë e të mos manipulohen për të mbuluar shkeljet e ligjit. Kemi konstatuar disa raste që shënimet në këto regjistra nuk përputhen me kohën e saktë të qëndrimit të tyre në Polici, ndërsa në raste të veçanta ata nuk regjistrohen.

7. Nuk ka ndryshuar koncepti për personat e shoqëruar në Polici, të cilët duhet të mbahen në dhoma shoqërimi dhe jo ndalimi, jo të prangosur ose në dhoma të mbyllura me dryn, siç veprohet në disa raste. Po kështu nuk ka ambiente për të shoqëruarit e mitur dhe femra. Dhomat duhet të jenë me kushte të përshtatshme higjienosanitare dhe të pajisura me karrige e tavolina. Këto mangësi fatëkeqësisht janë të pranishme dhe shumë të dukshme edhe në pjesën më të madhe të Komisariateve të Policisë në Kryeqytet, ku pretendojmë dhe synojmë të kemi një Polici më të kulturuar dhe më të civilizuar.

8. Nuk janë ndryshuar e përmirësuar kushtet e mbajtjes së të ndaluarëve e të arrestuarve në dhomat e paraburgimit në ambjentet e Policisë, me qëllim që:

- të respektohen në mënyrë strikte kriteret e parashikuara lidhur me çështjen e hapësirës minimale për të ndaluarin, si dhe

- të ndahen të rriturit nga minorenët dhe t'i kushtohet këtyre të fundit një vëmendje e veçantë në planin e shëndetit dhe të edukimit.

9. Megjithëse në muajin korrik të këtij viti u bë kalimi i të gjitha dhomave të paraburgimit dhe i personelit të tyre nga varësia e Ministrisë së Brendëshme në atë të Ministrisë së Drejtësisë, kemi konstatuar se ka shumë raste që të paraburgosurit dhe në disa raste edhe të dënuarit mbahen në dhomat e sigurimit të Policisë. Dërgimi i të paraburgosurve në dhomat e paraburgimit që në momentin e vlerësimit të masës së sigurimit në organet gjyqësore, do të krijonte mundësinë për të vënë efektivisht në jetë të gjitha dispozitat e caktuara në “Rregulloren mbi sigurimin dhe trajtimin e të burgosurve”, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.96, datë 09.03.2000.

Ministria e Brendëshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka insistuar vazhdimisht për realizimin e kësaj detyre, por Ministria e Drejtësisë dhe veçanërisht Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka sjellë pengesa.

Përveç zbatimit të rekomandimeve të mësipërme, nga organet e Policisë duhet të punohet më shumë për të zbatuar një nga detyrat kryesore institucionale të saj të përcaktuara në nenin 1 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, atë ... të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut. Për realizimin e kësaj detyrë është e domosdoshme që:

1. T'i jepet një përparësi më e madhe edukimit dhe formimit profesional në vazhdimësi të punonjësve të Policisë të të gjitha roleve dhe gradave. Në këto programe duhet të zërë një vënd të rëndësishëm edukimi i tyre me ndjenjën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Niveli kulturor e profesional, njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut, si dhe aftësia komunikuese të jenë kriteret përcaktuese në rekrutimin, mbajtjen në punë dhe përzgjedhjen në emërimet e ngritjeve në detyrë të punonjësve të policisë të të gjitha roleve.

2. Duhet që autoritetet politike dhe teknike të niveleve më të larta të dalin herë pas here, më shpesh dhe më fort, me mesazhe të qarta që dënojnë rreptë keqtrajtimet nga policia. Ky veprim duhet të përsëritet me intervale të rregullta nga drejtuesit në të gjitha shkallët e Policisë. Kjo në veçanti t'u theksohet punonjësve të Policisë të ngarkuar me marrjen në pyetje të personave të privuar nga liria. Është

mjaft pozitive se këtë mesazh e dha Kryeministri Berisha në fjalën e tij të mbajtur në analizën vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2007. Mesazhi publik, i bërë nga Kryeministri, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve nga punonjësit e Policisë është shumë i rëndësishëm. Mirëpo do të ishte mirë që këtë mesazh t'a bënin herë pas here edhe drejtuesit e Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit.

3. Në të gjitha ambjentet e Policisë të vendosen menjëherë posterat e përgatitura në bashkëpunim me institucionin tonë, të cilat bëjnë fjalë për respektimin e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e dhunës nga punonjësit e Policisë. Ato do të shërbejnë si një kujtesë e vazhdueshme për punonjësit e Policisë dhe do t'i ndihmojë ata në zbatimin me rigorozitet të ligjit. Është konstatuar se edhe ato që janë vënë, janë hequr pa shkak.

4. Bashkëpunimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Institucionin e Avokatit të Popullit, në kuadër të punës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, megjithëse ka qënë i mirë, duhet të rritet e përsoset më tej në të ardhmen.

5. Megjithëse janë hedhur hapa përpara për përmirësimin e policimit në komunitet nevojitet një punë më e madhe nga ana e policisë së shtetit për rritjen e besimit të publikut dhe forcimin e bashkëpunimit të ngushtë të komunitetit me strukturat e policisë nëpërmjet ruajtjes së konfidencialitetit për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve. Programe të ndryshme duhet të hartohen për informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik. Me miratimin e ligjit "Për policinë e shtetit" është planifikuar të krijohet një strukturë për policimin në komunitet në 12 drejtoritë e policive në qarqe të cilat duhet të forcojnë lidhjet dhe besimin me publikun.

VI. Rekomandime dhe propozime në fushën legislative

Gjatë shqyrtimit të disa ankesave të ndryshme ne kemi konstatuar se ka akte normative ligjore e nënligjore për Policinë e Shtetit që janë në fuqi, të cilat binin ndesh ose ishin nxjerrë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe shkelnin të drejtat e qytetarëve dhe të punonjësve të Policisë së Shtetit. Propozimet konkrete janë në Pasqyrat përkatëse në kreun e katërt.

B. Ankesat për organet e pushtetit vendor (Komunat, Bashkite dhe Prefekturat)

Gjate vitit 2007 kemi patur 484 ankesa për organet e mesiperme. Problematika e tyre është e larmishme dhe natyrisht jo e panjohur, pasi është prezantuar edhe në raportet e mëparshme.

a) Ankesat për komunat

Nga 103 ankesa që kemi shqyrtuar për Komunat, 5 prej tyre janë të mbartuara nga viti 2006. Nga këto 17 ankesa janë ende në shqyrtim. Jane përfunduar 86 ankesa, nga të cilat 13 janë zgjidhur në favor të ankuesve, 14 jashtë juridiksionit dhe 41 konsiderohen ankesa të pa bazuara, 15 ankesa janë jashtë kompetences dhe 3 ankesa kanë rezultuar me heqje dore. Objekti i ankesave të paraqitura gjatë këtij viti, ka qënë kryesisht lidhur me konfliktet e pronësisë në procedurat e ndjekura gjatë ndarjes së tokave nga Komisionet e Ndarjes së Tokave, si dhe me probleme të tjera të cilat lidhen me çështje jetike të komunitetit, si

zvarritje procedurash administrative, mungese informimi, apo largime nga puna të pamotivuara, apo ne kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punes.

Problemet ekzistuese të ankesave të evidentuara vit pas viti janë më të dukshme në këto nivele vendore, sepse dhe niveli profesional nuk është në standartet që kërkohen për pushtetin vendor. Gjithashtu dhe struktura e këtyre organeve dhe vete fondet e kufizuara që ata kanë në dispozicion për zgjidhjen e çështjeve në terren, i bënë edhe më të vështira zgjidhjet afat shkurtër dhe afat gjatë. Megjithatë dhe vetëmënxhimi i fondeve të kufizuara që ata kanë, apo iniciativa dhe veteveprimi për menyrat e krijimit të të ardhurave qoftë dhe modeste nga vete komuna, me qëllim që këto t'i përdorin më pas në favor të komunitetit, janë shprehje të mungesës së vizionit për veteqeverisje. Qëndrimet apatike dhe mosvepruese të drejtuesve të këtyre organeve kanë sjelle që dhe vlerësimet dhe qëndrimet e tyre në raport me shkeljet e konstatuara, të mos gjejnë në kohën e duhur zgjidhjen ligjore të domosdoshme. Shpesh nga mos njohja e akteve ligjore dhe nënligjore, komunat jo vetëm që nuk shqyrtojnë dhe nuk zgjidhin probleme, por nuk u kthejnë as përgjigje ankuesve për sa kërkojnë. Sikurse e kemi konstatuar edhe në vitet e tjera, Kodi i Procedurave Administrative, në shumë raste nuk njihet. Por edhe kur njihet ose nuk zbatohet ose keqpërdoret për interesa të caktuara dhe shkaqe të pajustificuara.

Në Institucionin tone ka ardhur një ankesë e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, e cila bente fjale për mosregjistrimin e 501 zgjedhësve në listat paraprake të zgjedhësve në Komunen Paskuqan, Tiranë. Në ankesë shprehet shqetësimi për mohimin e të drejtës kushtetuese të votimit të një mase të konsiderueshme rreth 500 zgjedhës të kësaj njesie të qeverisjes vendore. Për këtë rast Zyra jone i rekomandoi Kryetarit të Komunes Paskuqan Tiranë, Ministrin të Brendshëm dhe çdo strukturë tjetër qendrore që duhej të angazhohej në zgjidhje të këtij problemi, të merrte menjëherë masat e nevojshme për rishikimin dhe plotësimin e listave paraprake të zgjedhësve, për zgjedhjet e 18 Shkurtit 2007.

Sipas subjektit ankues, mbas konstatimit të mosperfshirjes në listat paraprake të zgjedhësve për numrin e personave të sipërcituar, ky subjekt kishte paraqitur kërkesë në Komunen Paskuqan për regjistrimin e tyre. Mirepo kërkesa e tyre nuk ishte marrë në konsideratë nga zyra e protokollit të kësaj komune. Nderkohe, pretendohet se nuk i jepej me shkrim arsyeja e mospranimit të kërkesës së tyre. Gjithashtu subjekti ankues pretendonte se personat e lene jashtë listave paraprake ishin votues të majtë, ndaj dhe Kryetari i Komunes Paskuqan, meqenese rikandidonte kishte urdheruar mosregjistrimin e tyre.

Nga ana jone kjo ankesë u vlerësua maksimalisht dhe për këtë, në dt.31.01.2007, u dërgua në Komunen Paskuqan një ekip prej tre personash të stafit të Avokatit të Popullit. Ata moren takim me përfaqësuesin e subjektit ankues, Shefin e Zyres së Gjendjes Civile pranë kësaj komune, si dhe me kryetarin e Komunes Paskuqan. Përfaqësuesi i subjektit ankues pretendoi se ishin lene jashtë listave paraprake të zgjedhësve jo vetëm numri i personave të paraqitur në ankesë, por nga verifikimet që vazhdonin të beheshin, numri i tyre vinte në rritje dhe se sipas tij, deri në momentin e takimit ishin konstatuar 700 persona dhe 200 familje të peregjistruar. Gjithashtu ai pretendoi, se ishin lene jashtë listave paraprake edhe një numër prej 123 personash, të cilët në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 ishin perfshire në listen perfundimtare të zgjedhësve vetëm në baze të vendimeve gjyqësore individuale perkatëse.

Sipas tij, personat e lene jashtë listes zgjedhore ishin banorë të kësaj komune dhe se gjithashtu, ishin të regjistruar në regjistrin themeltar të shtetasve në Zyrën e Gjendjes Civile të Komunes Paskuqan. Meqenese komuna nuk kishte pranuar

kerkesen per regjistrimin e ketyre zgjedhesve, ai kete kerkese, se bashku me listat e emrave te personave te paregjistruar ia kishte derguar me poste kesaj komune dhe per kete demostroi deftesen postare. Perfaqesuesi i subjektit ankues ngriti edhe shqetesimin tjeter se ne grupet dyshe te punes per njoftimin me shkrim te zgjedhesve, nuk ishin perfshire perfaqesuesit e partise me te madhe opozitare, siç parashikohet nga Kodi Zgjedhor dhe Udhezimi i Ministrit te Brendshem Nr. 130, dt. 18.01.2007 "Per proçedurat e rishikimit te listave paraprake dhe shpallja e listes perfundimtare te zgjedhesve "Per zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dt. 18 Shkurt 2007.

Kryetari i Komunes u shpreh se grupet dyshe te punes i kishte organizuar vetem me perfaqesues te administrates, sepse opozita nuk i kishte derguar propozimet me emrat e perfaqesuesve te saj. Megjithate ai u tregua i gatshem qe te riformonte grupet e punes dhe ne perberje te tyre te perfshiheshin edhe perfaqesuesit e opozites menjehere sapo te dergonin listen me emrat e tyre.

Per te verifikuar pretendimet e subjektit ankues, nese personat e lene jashte listes paraprake ishin apo jo banore te kesaj komune dhe te regjistruar ne regjistrin themeltar te shtetasve, perfaqesuesit tane bene verifikimin ne Zyren e Gjendjes Civile. Nga dy listat e gjata te personave te paregjistruar qe dispononte subjekti ankues, u perzgjodhen nga 10 persona per secilen liste me qellim per te bere nje sondazh ne regjistrin themeltar dhe ne listen kompjuterike te listave paraprake te zgjedhesve.

Nga sondazhi i bere rezultoi se, kishte persona qe ishin banore te kesaj komune dhe te regjistruar ne regjistrin themeltar, por qe nuk ishin te regjistruar ne listat paraprake te zgjedhesve. Gjithashtu rezultoi se, kishte edhe persona qe ne zgjedhjet e vitit 2005 ishin regjistruar me vendim gjyqesor, ndersa ne listat paraprake te zgjedhesve, per zgjedhjet vendore te vitit 2007 nuk ishin te regjistruar. Pas verifikimit te bere ne regjistrin themeltar te shtetasve ne Zyren e Gjendjes Civile dhe ne listat paraprake kompjuterike te zgjedhesve te kesaj komune, perfaqesuesit tane dhe pjesemarresit ne takim, arriten ne konkluzionin se pretendimet e mesiperme te subjektit ankues qendronin. Sqarojme se mosveprimi i mundshem per te pranuar, protokolluar dhe shqyrtuar kerkesen e subjektit ankues per ndryshimin e listave paraprake te zgjedhesve vinte ne kundërshtim me percaktimet e bera ne nenin 57/e, dhe 58/2,3 e 4 te Kodit Zgjedhor te Republikës se Shqipërisë, si dhe me piken 3/e dhe piken 4/c, te Udhezimit te Ministrit te Brendshem Nr. 130, dt. 18.01.2007.

Mosveprimet e mesiperme te kesaj komune, si pjese e organeve te qeverisjes vendore binin ndesh edhe me detyrimet ligjore te percaktuara ne nenin 46 te Kodit te Proçedurave Administrative, persa i perket fillimit te proçedimit administrativ mbi bazen e kerkeses se pales se interesuar. Ne proçesin e ndermjetesimit te ndermarre nga ana jone per zgjidhjen e kesaj çështjeje, nga te gjitha palet pjesemarrese u pranuan konstatimet tona ligjore dhe u ra dakort qe proçesi i kerkuar per ndryshimin e listave paraprake te fillonte menjehere.

Theksojme se mosregjistrimi i zgjedhesve ne listat paraprake te zgjedhesve perbente pengese ligjore per pjesmarren e tyre ne zgjedhjen e organeve te pushtetit vendor qe po organizoheshin, si dhe shkelje te hapur te se drejtes kushtetuese te shtetasve per te zgjedhur, te parashikuar nga neni 45 i Kushtetutes Republikës se Shqipërisë. Gjykojme se respektimi i te drejtes kushtetuese te individit per te zgjedhur, perben themelin e konceptit te shtetit te se drejtes, ndaj dhe angazhimi i shprehur i te gjitha paleve ne ato zgjedhje vendore, per nje proçes te lire e te ndershem zgjedhor duhet te fillonte pikerisht ketu. Nga ana tjeter, respektimi i kesaj te drejte kushtetuese nuk eshte dhe nuk duhet te mbetet çështje deshire, e organeve

te administrates apo forcave politike pa perjashtim. Permbushja e kesaj te drejte ishte nje detyrim ligjor per Komunen Paskuqan si pjese e organeve te pushtetit publik, te cilat ne permbushje te detyrave ligjore duhet te respektojne te drejtat dhe lirate themelore te njeriut, si dhe kontribuojne per realizimin e tyre, ne perputhje me percaktimin e bere ne nenin 15, pika 2 te Kushtetutes tone.

Per te bere te mundur rivendosjen ne vend te se drejtes kushtetuese te shkelur zgjedhesve (banoreve) te Komunes Paskuqan, bazuar ne piken 3 te nenit 63 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, Avokati i Popullit rekomandoi: marrjen e masave te menjehershme per te bere rishikimin dhe ndryshimin e listave paraprake te zgjedhesve, duke regjistruar personat qe rezultojne te paregjistruar, sipas listave te paraqitura nga subjekti ankues.

Ky rekomandim eshte pranuar dhe zgjidhur pozitivisht ne favor te personave, te cilet nuk ishin perfshire ne listat zgjedhore.

2. Ankesen e paraqitur nga Fondacioni Swiss Foundation International, te cilet na informuan per disa probleme qe ishin shfaqur se fundi, ne marredhenie me Komunen Kryevidh, me te cilen keta kane lidhur nje akt marreveshje.

Ne objektin e kesaj ankese, te ciles i eshte bashkengjitur dhe peticioni i 574 banoreve te fshatit Spille dhe Greth te rrethit Kavaje, u informuam per situaten qe eshte krijuar se fundi midis ketij Fondacioni dhe Komunes Kryevidh. Sipas perfaqesuesve te ketij Fondacioni, kundrejt Komunes ishin shlyer te gjitha detyrimet per taksen e ambientit, te tabelës, te truallit dhe te ndertesës, likuidim i cili sipas faturave perkatese daton ne 24.10.2007. Ne momentin qe Fondacioni konsideronte se gjithcka po funksiononte sipas rregullave dypaleshe te vendosura paraprakisht ne aktmarreveshje, ata u informuan se ne daten 7.11.2007 Keshilli i Komunes Kryevidh, do te mblidhej per miratim te projektvendimit "Per lirimin e hapësirave publike te zena nga Fondacioni SFI mbi Aktmarreveshjen e nenshkruar me pare".

Gjendur ne kete suate, menjehere kane vene ne dijeni Institucionin e Avokatit te Popullit, me qellim qe te mundesohej nje mediacion, per te bere te mundur qe te respektohen kushtet e vendosura midis paleve, per te bere te mundur vijimesine e nje procesi te tere shnderrues te Qendres Shendetsore te Komunes, e cila me investimet e Fondacionit ishte kthyer ne nje qender te mirefillte mjekesore diagnostikuese, ne sherbim te ketij komuniteti.

Per nevojat e shqyrtimit te kesaj ankese, kerkuam shpjegime prane Komunes Kryevidh Kavaje dhe bazuar ne mediacionin e zyres tone cdo gje u zgjidh pozitivisht ne dobi te dy paleve kontraktuese dhe sidomos ne dobi te vet komunitetit perfitues nga sherbimet e ketij Fondacioni.

Ankesa e shtetasit M.A., banues ne Hotolisht, lidhur me mosdhenien e lejes per furnizimin me uje te pijshem ne fshat. Aktualisht ishin disa familje ne kete fshat qe nuk furnizoheshin me uje te pijshem, madje ankuesi shprehej se burimin e ujit e kishte 200 m larg, por nuk i jepej leja per lidhjen e furnizimin e baneses se tij me uje te pijshem. Ndaj kerkoj ndihmen e Zyres sone per zgjidhjen e ketij problemi jetik per jetesen e tij dhe te familjeve te tjera ne fshat. Ne pergjigje te nderhyrjes institucionale te Zyres tone u informuam nga Komuna Hotolisht Librazhd, se problemi do te zgjidhej pozitivisht pasi do te merresin te gjitha masat per rregullimin e kesaj gjendje, aspak normale per keta banore te fshatit.

3. Institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur dhe luan aktualisht një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të ish- pronarëve dhe të së drejtës së pronës, si një e drejtë universale e njohur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në aktet ndërkombëtare. Një rol i tillë aktiv nuk do të mungojë edhe në të ardhmen.

Ne kete kuader mund te permendim dhe ankesen e paraqitur nga shtetasi B.C, nga Xhafzotaj Durres lidhur me zënien forcërisht të një rruge që përdorej nga komuniteti i asaj zone si rrugë kalimi.

Konkretisht ankuesi shprehej se rruga e lënë në ngastrën 46/15 për nevojat e komunitetit ishte zënë nga disa persona dhe se nga ana e Komunës nuk janë bërë përpjekjet e duhura për zgjidhjen e problemit. Më tej shtohet se problemën në fjalë e kanë bërë prezent edhe në Prefekturën e Qarkut Durrës, por nuk kishin patur ndonjë reagim që mund të sillte zgjidhjen e problemit dhe shuarjen e kontradiktave të lindura mes banorëve të fshatit.

Per kete ankese ju drejtuam Kryetarit të Komunës Xhafzotaj Durrës.

Në këtë kuadër krahas interesimit maksimal për të gjetur një zgjidhje sa më të shpejtë ligjore për problemin e ngritur nga ankuesi, angazhimi i institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë serioz dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke kontribuar në verifikimin dhe shqyrtimin sa më të shpejtë të kësaj ankese, por jo vetem ne kete rast. Fale nderhyrjes se Zyres tone nga ana e kësaj Komune, pati një angazhim serioz për zgjidhje e problemit në fjalë, duke ndërmarrë një sërë nismash ligjore dhe duke iu ofruar ankuesit disa zgjidhje ligjore me qëllim që të kishte një zgjidhje me mirëkuptim dhe të pranueshme për të gjitha palët.

4. Ankesa 5 ish kryetarëve të fshatrave të Komunës Gosë, Kavajë I.S., H.I., N.K., L.Sh. dhe Sh. S. të cilët pretendonin për një farsë në procesin e zgjedhjes së kryetarëve të rinj të fshatrave, sepse ai nuk ishte kryer në fakt dhe se nga organizatorët ishin bërë falsifikime të dokumentave.

Pas verifikimeve të bëra nga ana jonë rezultoi se, mbledhja e Këshillit të Komunës Gosë e dt.18.05.2007, ku është diskutuar dhe vendosur për zgjedhjet e kryesive dhe kryetarëve të fshatrave, si dhe për formimin e grupeve të punës lidhur me këtë proces ishte e parregullt për arsye se;

a) Nuk është zbatuar procedura për thirrjen e kësaj mbledhjeje siç parashikon neni 31/4 i ligjit nr.8652, dt. 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, sipas të cilit “*Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës*”. Rezultoi se 7 anëtar të Këshillit të Komunës dhe Kryetari i Komunës nuk jane njoftuar për mbajtjen e kësaj mbledhjeje.

b) Këshilli i Komunës, në kapërcim të kompetencave të tij ligjore të përcaktuara në nenin 32 të ligjit nr.8652, dt.31.07.2000, ka vendosur shkarkimin (shfuqizimin, siç pasqyrohet në protokoll) nga detyra të të gjithë kryetarëve (kryepleqve) të fshatrave të komunës dhe dorëzimin e vulave brënda 3 ditëve. Normalisht mandati i tyre do të përfundonte pasi të zgjidheshin kryetarët e rinj dhe pas kësaj bëhej edhe dorëzimi i vulave të tyre.

c) Këshilli i Komunës nuk ka përcaktuar mënyrat dhe rregullat e votimit për këto zgjedhje, siç parashikohet në nenin 45/1 të ligjit nr. 8652, dt. 31.07.2000.

2. Mbledhjet e fshatrave për zgjedhjen e anëtarëve të kryesive të fshatrave nuk ishin bërë dhe se nuk kishte asnjë dokument apo procesverbal që të provonte të kundërtën.

3. Anëtarët e kryesive të fshatrave ishin vetshpallur të zgjedhur duke marrë firmat e një numri shumë minimal banorësh nëpër shtëpi, lokale apo ne rrugë, në disa raste edhe duke i mashtruar. Ndërkohë që neni 45/1 i ligjit nr. 8652, dt. 31.07.2000, kërkon që për zgjedhjen e tyre të bëhen mbledhje në fshatra dhe me pjesmarrje jo më pak se gjysmën e banorëve me të drejtë vote.

4. Kishte disa raste që firmat e banorëve të fshatrave të mbledhura nga anëtarët e kryesive ishin të fallsifikuara, kane firmosur familjarët për njeri tjetrin, si dhe janë marrë firmat e kryefamiljarëve dhe kjo është konsideruar dhënie pëlqimi (votim) nga të gjithë pjestarët e familjes, duke shkelur hapur të drejtën vetjake të votës.

5. Zgjedhja e kryetarëve të fshatrave është bërë në kundërshtim me nenin 45/3 të ligjit nr. 8652, dt. 31.07.2000, sepse nuk janë bërë me votim të fshehtë dhe me kandidatura alternative.

6. Disa anëtarë të kryesive të fshatrave nuk janë banor të fshatrave ku janë zgjedhur, si p.sh. Xh.I., Z.V., N.O., Sh.Sh., M.T. dhe Xh.A..

7. Disa anëtarë të Këshillit të Komunës janë zgjedhur edhe kryetarë të fshatrave, duke krijuar kështu një lloj konflikti interesi dhe duke marrë dy lloj shpërblimesh si anëtarë i këshillit dhe si kryetar i fshatit, në bazë të nenit 29/2 dhe 46/5 të ligjit nr. 8652, dt.31.07.2000.

Vizioni i Avokatit të Popullit është, se zgjedhjet e lira, të drejta dhe të ndershme janë themeli i demokracisë. Nuk ka rëndësi në se institucionet apo autoritetet që zgjidhen janë apo jo të rëndësishme. Prandaj anashkalimi me apo pa dashje i rregullave demokratike në një proces zgjedhor është një lloj i dënueshëm sikurse bëhet për deputetet apo kryetarët e fshatrave.

Për sa më sipër dhe me qëllim për të bërë të mundur realizimin e parimit kushtetues për zgjedhje të lira, të barabarta, të drejtpërdrejta, të përgjithshme dhe periodike, i rekomanduam Këshillit të Komunës Gosë Kavajë që, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, vendimit të Këshillit të Komunës Gosë, nr. 8 dt. 18.05.2007, pasi ai është nxjerrë në kundërshtim me formën e procedurën se kërkuar nga ligji dhe në të njëjtën kohë në kapërcim të kompetencave të tij. Gjithashtu i rekomanduam që të merrte vendim për zhvillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e kryesive dhe të kryetarëve të fshatrave të Komunës Gosë, Kavajë, në përputhje me ligjin, duke eliminuar shkeljet e konstatuara nga ana jonë. Rekomandimin ia dërguam edhe institucioneve më të larta të shtetit. Fillimisht ai u vlerësua dhe u dhanë mesazhe pozitive, mirëpo më pas nuk pati asnjë reagim për t'a pranuar atë.

Gjate verifikimeve të bëra në këtë rast u konstatua edhe se gjatë procesit të zgjedhjes së kryetarëve të fshatrave nga kryesitë, në 3 raste ishin falsifikuar dokumentat, procesverbalet e zgjedhjeve. Në procesverbalet e mbajtura nga grupet e punës për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave janë paraqitur të dhëna të rreme dhe janë fallsifikuar firmat e disa anëtarëve të kryesive. Konkretisht mund të përmendim:

1. Në procesverbalin e mbajtur më dt. 02.06.2007, për zgjedhjen e kryetarit të fshatit Boshrovë-Ballaj, I.Th, figuron që në mbledhje kane marrë pjesë 7 anëtarët e kryesisë (apo siç pasqyrohej në procesverbal, anëtarët e lagjeve) dhe është firmosur prej tyre me përjashtim të kryetarit të fshatit I.Th.. Gjithashtu ai është firmosur edhe nga anëtarët e grupit të punës shtetasve Agron Dema, Jemin Shaba dhe Durim Demiri, të cilët kane organizuar dhe mbikqyrur këtë proces. Mirëpo u provua se anëtari i kryesisë, shtetasi E.D. nuk ka qënë i pranishëm në këtë mbledhje dhe se firma e tij është fallsifikuar.

2. Në procesverbalin e mbajtur më dt. 12.06.2007, për zgjedhjen e kryetarit të fshatit Gosë-Qëndër, A.S., figuron që në mbledhje kane marrë pjesë 7 anëtarët e kryesisë (apo siç pasqyrohej në procesverbal, anëtarët e lagjeve). Ai është firmosur prej tyre dhe anëtarëve të grupit të punës, shtetasve Kudret Pepa dhe Xhevdet Thartori, të cilët kane organizuar dhe mbikqyrur këtë proces. Sqarojme se grupi i punës ka qene i perbere nga 3 persona, por anëtari i tretë shtetasi Sh. S. nuk ka qënë

i pranishëm në mbledhje dhe nuk ka firmosur këtë proces-verbal. Nga provat e mbledhura u provua se anëtarët e kryesisë shtetasit, Xh.A. dhe M.T. nuk kane qënë të pranishëm në këtë mbledhje dhe se firma e tyre është falsifikuar.

3. Në proces-verbalin e mbajtur më dt. 28.05.2007, për zgjedhjen e kryetarit të fshatit Kalush, B.Sh., figuron që në mbledhje kane marrë pjesë 7 anëtarët e kryesisë (apo siç pasqyrohet në procesverbal, anëtarët e lagjeve). Ai është firmosur prej tyre me përjashtim të shtetasit H.H. dhe është firmosur edhe nga anëtarët e grupit të punës shtetasit, Kudret Pepa dhe Esat Krasniqi, të cilët kane organizuar dhe mbikqyrur këtë proces. Sqarojmë se grupi i punës ka qënë i përbërë nga 3 persona, por anëtari tretë, zoti B.Ç. nuk ka qënë i pranishëm në mbledhje dhe nuk ka firmosur këtë proces-verbal. Nga verifikimet e provua se anëtari i kryesisë, shtetasi I.K. nuk ka qënë i pranishëm në këtë mbledhje dhe se firma e tij është fallsifikuar.

Me keto veprime të kundërligjshme të kryera nga anëtarët e grupeve të punës të ngarkuara nga Këshilli i Komunës me detyrën e organizimit dhe mbikqyrjes së zgjedhjeve të anëtarëve të kryesive dhe kryetarëve të fshatrave të Komunës Gosë Kavajë, janë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “Fallsifikimit të dokumentave dhe rezultateve të zgjedhjeve”, parashikuar nga neni 326 i K.Penal, cili parashikon se: *“Paraqitja në dokumentet e zgjedhjeve të të dhënave, rrethanave, shifrave që dihen që janë të pasakta, përpilimi i dokumenteve false ose zëvendësimi i të saktave me të rreme, i bërë nga personat e ngarkuar me përpilimin, vlersimin, nxjerrjen e rezultateve apo ruajtjen e dokumenteve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”*.

Për sa më sipër i rekomandua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë fillimin e hetimeve ndaj shtetasve Agron Dema, Jemin Shaba, Durim Demiri, Kudret Pepa, Xhevdet Thartori dhe Esat Krasniqi për veprën penale të “Fallsifikimit të dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve”, parashikuar nga neni 326 i K.Penal. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

4. Ankesa e shtetasit B.C i cili ka ngritur shqetësimin se nuk ka siguruar prej kohësh një përgjigje zyrtare nga Komuna Proptisht, Pogradec, lidhur me trajtimin ose jo të pasurisë së tij nga Ligji 7501 “Për Tokën”.

Në përgjigje të interesimit tonë, jemi informuar se Komuna Proptisht nuk dispononte asnjë dokument zyrtar që pasuria e B.Ç. të jetë ndarë me Ligjin 7501 “Për Tokën”. Krahas kësaj u sqarua se një mungesë e tillë në dokumentacion, ka sjellë për pasojë vonesa në kthimin e përgjigjes.

Avokati i Popullit duke analizuar rrethanat konkrete të kësaj çështje dhe duke parë veprimet e kryera nga ana e Kryetarit të Komunës Proptisht, Pogradec konstatoi se mosnjohja e individëve brenda procedurave dhe afateve ligjore për kërkesat që kanë paraqitur, është një veprim i padrejtë dhe i pambështetur në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu Avokati i Popullit konstatoi me keqardhje se një procedurë e tillë nuk ishte ndjekur nga ana e Komunës Proptisht konform dispozitës perkatese të Kodit të Procedurës Administrative dhe Ligjit “Për të drejten e informimit me dokumenta zyrtare”. Ndaj dhe korrigjimi i kësaj praktike duhej të kryhej sa më parë për të vënë në pozita të ligjshme marrëdhëniet midis Komunes me personat e interesuar.

Vonesat dhe zvarritjet për të vënë në dijeni shtetasin B.Ç. për një procedurë verifikimi dokumentare në favor të tij, ishin të pajustificueshme për aq kohë sa ato nuk respektonin parimet kryesore të të drejtës për t`u informuar dhe nuk përlligjeshin nga dispozitat ligjore në fuqi.

Ne keto kushte i kujtuam Kryetarit te Komunes detyrimin ligjor qe kishte per t'i dhene nje konfirmim zyrtar ankuesit dhe per t'i vene ne dispozicion personit te interesuar brenda nje afati sa me te shpejte kete informacion. Per sa me lart duke konkluduar ne cenimin e te drejtave dhe interesave te ligjshme te ankuesit, si dhe duke qene te sigurte se vazhdimi i metejsheem i kesaj situatë perbente shkak per mohimin e standarteve minimale ne sherbimet publike qe ofron Komuna Proptisht, Avokati i Popullit rekomandoi dergimin e menjehershem te nje vertetimi zyrtar ne adrese te ankuesit, lidhur me gjendjen dokumentare qe disponon Komuna Proptisht, Pogradec mbi trajtimin ose jo te pasurise se tij nga Ligji Nr.7501 "Per Token". Perfundimisht u zgjidh ankesa e dhenien e dokumentit te kerkuar.

Nga komunat si organe kompetente me afer komunitetit dhe problemeve te shumta te tyre, kerkohet nje angazhim me i madh per zgjidhjen e problemeve te tilla jetesore, per te qene me energjike, si per sigurimin e ujit dhe dritave, te krijimit te kushteve te shkollimit te femijve, te shendetesise dhe te sherbimeve te tjera, te infrastruktures ne pergjithesi, tregues te cilat do te ndikonin ne rritjen e cilesise se jetes se tyre.

Gjatë shqyrtimit të ankesave per Komunat, jo ne pak raste eshte vërejtur se në këto struktura, aktet administrative apo shkallët e ankimit administrativ, nuk njihen ose ndërmerren veprime nga kryetarët e komunave që kapërcejnë kompetencat e tyre. Gjithashtu janë shfaqur dhe zvarritje e neglizhenca në trajtimin e problemeve, mos angazhim për zgjidhjen e fenomeneve, sidomos në zonat rurale. Kjo dhe për faktin se duke qenë të veshur me mandat zgjedhor, Kryetarët e Komunave e konsiderojnë veten të pacënueshëm edhe në rastet kur shkelin ligjin në mënyrë sistematike, me dashje apo për qëllime abuzive. Prandaj mendojme se duhet bere kujdes nga partite politike ne perzgjedhjen e individeve per keto poste.

b. Ankesat për bashkitë

Gjatë vitit 2007 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë mbërritur 342 ankesa kundrejt Bashkive. Gjithashtu jane ndjekur dhe 26 ankesa te mbartura nga viti 2006, pra gjithsej jane shqyrtuar 368 ankesa. Nga këto janë përfunduar 314 dhe janë ende në shqyrtim 54 ankesa. Nga totali i ankesave të përfunduara kanë rezultuar 61 ankesa në favor të ankuesve, 113 prej tyre jashtë juridiksionit, 68 ankesa jashte kompetence dhe 65 ankesa të pa bazuara, 7 raste kane rezultuar me heqje dore. Nga keto 5 ankesa kane perfunduar me perpilimin edhe te rekomandimeve me shkrim. Edhe këtë vit prezantohen probleme dhe fenomene, të cilat nuk janë të panjohura ose të paditura. Shumica e ankesave të mbërritura gjatë këtij viti ashtu si dhe me pare, kane patur në qendër të vëmendjes, çështjen e strehimit si një problem madhor, i prekshëm, jetik, por praktikisht ende i pazgjidhshëm. Numri i familjeve te pastreha eshte i destinuar te rritet. Nese ky numer do te ulet si efekt i projekteve te realizuara, do te rritet si efekt i rritjes demografike dhe krijimit te familjeve te reja. Per kete arsye kontrolli periodik i kerkesave per strehim dhe te familjeve perfituese do te lejoje njohjen dinamike te situates per sa i perket llojit te familjeve ne pritje, te rezultateve te parashikuara dhe atyre te arritura deri tani. Ky kontroll periodik perben bazen e sejcilit program qe duhet te hartohet per kete kategori ne nevojë. Megjithese Bashkia e Tiranës ka hartuar nje program 10 vjeçar per strehimin ne qytetin e Tiranës, kjo eshte e pa mjaftueshme nese nuk do te kete mundesi reale financimi dhe strategji te harmonizuara me programet e qeverise. Megjithate kohet e fundit ka te dhena dhe projekte se kjo çështje po trajtohet me seriozitet.

Zgjidhja pjeserisht e strehimit të familjeve të pastreha nga renia e skemave piramidale, natyrisht është një hap i madh përpara që rrit besimin dhe shpresën në materializimin e politikave të zgjidhjes së këtij problemi. Megjithatë ende ka shumë për të bërë në këtë drejtim. Duke shpresuar se aktet e fundit ligjore dhe nënligjore që kanë dalë nga Qeveria për zgjidhjen e strehimit, si dhe prioriteti i saj në këtë drejtim, do të zgjidhin hap pas hapi këtë problem kombëtar dhe madhor, besojmë se dhe kategoritë e tjera të pastreha do të përfitojnë nga këto politika sociale të shtetit. Megjithatë gjatë trajtimit të këtyre ankesave ka patur pretendime nga ankuesit, që mungon transparenca në përzgjedhjen e kategorive apo në vendimarrjet për zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe sidomos në vendimet që marrin këshillat bashkiake, për të cilat pretendohet se asnjëherë nuk dihen kriteret vlerësuese e radha e trajtimit të shtetasve, probleme të cilat janë prezantuar dhe në raportet e meparshme. Mungon informimi publik për ditën e mbledhjeve, apo dhe rendin e ditës të mbledhjeve të këshillave bashkiake, të cilat duhet të jenë publike dhe të njohura, me qëllim që personat e interesuar të jenë pjesë e kësaj procedure, për të cilët janë direkt të interesuar dhe për të cilat duhet të vihen në dijeni, qoftë dhe se kur praktikisht mund të zgjidhen shqetësimet e tyre. Në këtë drejtim është e nevojshme të rritet transparenca nga organet e pushtetit vendor, për t'i bërë të njohur taksapaguesve dhe zgjedhësve të tyre punën dhe arritjet për zgjidhjen e këtij problemi madhor, si dhe strategjitë përkatëse, pasi shpesh shtetasit nuk informohen në kohë për kuadrin ligjor ekzistues dhe në këtë mënyrë humbasin dhe afatet ligjore për mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshme. Këto organe, duke qenë se ushtrojnë veprimtarinë mbi bazën e parimit të autonomisë dhe vetëqeverisjes, duhet që të rritin bashkëpunimin me komunitetin për tërheqjen e mendimit të tyre, për alternativat dhe kohën e zgjidhjes. Për gjithë kuadrin ligjor që trajton strehimin, shtetasit janë krejtësisht të pa informuar, pasi shpesh nuk dinë se si dhe ku duhet t'i kërkojnë të drejtat e tyre.

Sikurse edhe vitin e kaluar janë konstatuar mjaft raste kur Bashkitë nuk shfrytëzojnë mjetet ligjore për zgjidhjen e ankesave të shtetasve, nuk shfrytëzojnë kompetencat që u jep Ligji Nr.8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore", duke hezitur në nxjerrjen e urdhërave administrative dhe padrejtesisht duke i treguar qytetarëve rrugën gjyqësore. Ndërkohë që sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit të sipërcituar, ato kanë të drejtë të ndër marrin procedime të tilla, duke marrë në shqyrtim dhe vendosur edhe për ankimet administrative.

1. Në ankesën drejtuar institucionit tone, shtetasi V. C. ka shprehur shqetësimin në lidhje me mosdhenien e një informacioni të kërkuar nga ana e Bashkisë Tirane.

Sikunder ankuesi shkruante, bazuar në ligjin "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare", me anë të një kerkese me shkrim të datës 2.04.2007, ka kërkuar nga Bashkia Tirane, dhenien e një informacioni zyrtar. Informacioni i kërkuar në këtë rast, sikurse shprehet kerkuesi, kishte të bënte me dosjen që një subjekti ndertues privat që kishte depozituar pranë kësaj Bashkie për legalizim të shtesave të kryera tej lejes së ndertimit, dokumentacioni i nevojshëm për ankuesin, si person direkt i interesuar pasi është pronar i truallit mbi të cilin kjo firmë ishte duke ndertuar dhe me të cilin ankuesi ka lidhur një kontratë siper marrje.

Megjithatë, kerkuesi shpjegonte se pergjigjet që kishte marrë nga Bashkia kishin qenë gjithmone negative, duke i mohuar të drejtën e disponimit të këtij informacioni dhe prandaj ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për zgjidhjen e kësaj çështje. Bazuar në përmbajtjen e kësaj ankese dhe në vazhdim të shqyrtimit,

te saj nga ana jone jane kerkuar shpjegime ne lidhje me trajtimin e kesaj kerkese per informacion dhe dokumentacion, nga ana e Bashkise.

Ne pergjigjen e dates 27.04.2007 dhe dates 30.05.2007, Bashkia sqaronte se per marrjen e informacionit kerkuesit nuk mund t'i vihej ne dispozicion asnje dokument pasi mosmarreshjet qe ai kishte me subjektin ndertues, duhet t'i zgjidhe jashte Bashkise ne rruge gjyqesore. Ne vazhdim citohej se ne rastin konkret, dokumentacioni i kerkuar nuk bente pjese ne informacionin qe ai mund te merrte ne baze te ligjit Nr.8503 date 30.06.1999 "Per te drejten e informimit me dokumentat zyrtare".

Ne nje kendveshtrim me te gjere te trajtimit te ceshtjes, e drejta e informimit eshte e garantuar ne nenin 23, te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, ku ne piken dy te tij, thuhet shprehimisht:

"Kushdo ka te drejte, ne perputhje me ligjin, te marre informacion per veprimtarine e organeve shteterore, si dhe te personave qe ushtrojne funksione shteterore".

Ne vazhdim te ketij trajtimi, ne nenin 3, te Ligjit Nr.8503 date 30.06.1999 "Per te drejten e informimit per dokumentet zyrtare", percaktohet se: *"Çdo person ka te drejte te kerkoje informacion per dokumentet zyrtare, qe kane te bejne me veprimtarine e organeve shteterore dhe personave qe ushtrojne funksione shteterore, pa qene i detyruar te shpjegoje motivet. Autoriteti publik eshte i detyruar te jape çdo informacion ne lidhje me nje dokument zyrtar, perveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe"*.

Neni 4 i ligjit te sipercituar, jep kuptimin dhe percaktimin se kur mund te kufizohet dhenia e dokumentave zyrtare dhe me konkretisht;

"Nese informacioni i kerkuar per nje dokument zyrtar kufizohet me ligj, autoriteti publik i leshon kerkuesit nje deklarate me shkrim, ne te cilen tregohen arsyet e mosdhenies se informacionit dhe rregullat ne baze te te cilave ai mund ta kerkoje ate.

Nese kufizimi eshte vetem per nje pjese te te dhenave te dokumentit zyrtar, pjesa tjeter nuk i refuzohet kerkuesit".

Referuar rastit konkret, konstatohej se:

Ne perputhje me nenin 7 dhe germen "c", te nenit 9, te Ligjit Nr.8503 date 30.06.1999, te sipercituar, ku thuhet shprehimisht se:

"Kerkuesit i vihet ne dispozicion nje kopje e plote e dokumentit zyrtar, per te cilin kerkohet te informohet",

"Ne perputhje me ligjet, aktet nenligjore dhe rregullat e publikuara prej tij, autoriteti publik parapergatit per shqyrtim apo kopjim, ne pritje te kerkeses nga publiku, dokumente te tilla si:

-kopje te çdo dokumenti zyrtar, i cili i eshte dhene me pare te pakten nje personi, pavaresisht nga formati i tyre dhe qe autoriteti publik, beson se do te jete me interes per persona te tjere".

Rezulton se ankuesi, ka paraqitur ne perputhje me ligjin, kerkese zyrtare per marrje informacioni dhe dokumentacioni.

Ne asnje moment te trajtimit te kesaj ceshtje, nuk evidentohet fakti se dokumentacioni zyrtar i kerkuar, ishte i kufizuar ne dhenie per publikun nga ligji, megjithese pergjigjia mohuese e Bashkise justifikohet duke cituar nenin 51, pika 1 e Kodit te Procedures Administrative: *"Ne informacionin qe jepet nga administrata, tregohet organi administrativ qe zhvillon procedimin, hapat konkrete te ndermarra prej tij, vendimet e marra si dhe çdo informacion tjeter"*, qe ne fakt jo

vetem qe nuk e kufizon kete te drejte, por ne te kundert i jep mundesine kerkuesit te marre çdo informacion qe ai e çmon se lidhet me interesat e tij.

Ne procesin e ndermjetesimit nga ana jone, per zgjidhjen e kesaj çeshtje, rikujtuam perkufizimin tashme te pranuar nga Parlamenti European, ne lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve te administrates publike, sipas te cilit:

“Keqadministrimi ndodh kur nje organ publik, nuk vepron ne perputhje me nje rregull apo princip, i cili eshte i detyrueshem per te”.

Pa dashur te paragjykonim trajtimin e ketij rasti dhe ne perputhje me parimet nderkombetare te funksionimit te administrates publike, gjetem me vend citimin e nenit 22, te Kodit European te Sjelljes se Mire Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

“1. Zyrtari do t’u jape, kur ai ka pergjegjesine per çeshtjen ne fjale, anetareve te publikut, informacionin qe ata kerkojne. Kur i takon atij, zyrtari do te jape keshille se si te fillohet nje procedure administrative brenda fushes se tij te kompetences. Zyrtari do te kujdeset qe informacioni i komunikuar te jete i qarte dhe i kuptueshem.

2. Nese nje kerkese gojore per informacion eshte shume e komplikuar apo shume e gjithanshme per tu trajtuar, zyrtari do te keshilloje personin e interesuar te formulroje kerkesen e tij me shkrim.

3. Nese, per shkak e konfidencialitetit te tij, nje zyrtar mund te mos e jape informacionin e kerkuar, ai apo ajo ne perputhje me nenin 18, te ketij Kodi, do ti tregoje personit te interesuar arsyet se pse ai nuk mund t’ja komunikojte informacionin”.

Duke ju referuar ketyre percaktimeve dhe trajtimin qe i ishte bere kerkeses arrirem ne konkluzionin se kemi te bejme me shkelje te te drejtes se ketij individi, per t’u informuar me dokumentat perkatese zyrtare, te kerkuara prej tij.

Per sa me siper rekomanduam informimin dhe dhenien e dokumentacionit te kerkuar nga ankuesi.V.C. ne baze te kerkeses te cilen ai ka paraqitur prane Bashkise.Ky rekomandim u mireprit dhe u kthye nje pergjigje pozitive ne favor te ankuesit.

Ne kete suate te re, ku niveli i shkeljeve te te drejtave dhe lirive themelore po shihet si barometer per etiketimin dhe standartizimin ne planet integruese, Avokati i Popullit apelon per me shume kujdes dhe profesionalizem ne marredhenie me individet dhe me te drejtat qe ata gezojne karshi organeve te administrates publike qendrore apo vendore.

2. Ankesa e paraqitur nga shtetesja M. U. banore ne qytetin e Tiranes, lidhur me mos veprimin e Policise Bashkiake Tirane, per te hequr pengesat qe vendosin banoret per te parkuar automjetet e tyre.

Ne objektin e kesaj ankese sqarohemi se ne bllokun ku banon ankuesja ne vitin 2005, Bashkia Tirane beri te mundur rregullimin e rrugeve dhe lulishteve perreth pallateve, duke krijuar nje ambient komod, te kulturuar dhe te gjelberuar. Pas ketij rregullimi nje pjese e banoreve filluan te zaptonin pjese siperfaqe, duke i bllokuar hyrjet me hekura apo pengesa te ndryshme me celes me qellim parkimin e automjeteve te tyre, duke u sjelle si pronare te ketyre trojeve.

Pas interesimit te ankueses ne Bashkine Tirane, ajo eshte informuar se te gjitha keto veprime, qe zene siperfaqe te tera perballe pallateve me qellim parkimin e automjeve, jane te kundraligjshme. Per kete suate ankuesja shpjegoi se i eshte drejtuar dhe Policise Bashkiake disa here, e cila sipas saj eshte ne dijeni te ketij problemi, por deri tani asnje veprim nuk eshte kryer duke sjelle jo vetem veshtiresi per banoret e tjere, por demton gjithashtu dhe gjithe punen qe Bashkia Tirane beri, per te rregulluar dhe gjelberuar kete bllok pallatesh.

Per sa me siper ankuesja iu drejtua Avokatit te Popullit dhe kerkoi qe te nderhyhet prane Bashkise, per te bere te mundur marrjen e masave me qellim rregullimin e kesaj gjendje qe eshte krijuar perreth pallateve ne bllokun 50 vjetori ne rrugen "Myslym Shyri".

Institucioni i Avokatit te Popullit, kerkoi nje shpjegim per shkaqet se perse nuk veprohet kundrejt ketyre kundravajtesve, te cilet jo vetem kryejne veprime arbitrare dhe te paligjshme por veshtiresojne jetesen e gjithe banoreve te tjere, duke marre atributet e pronesise qe nuk ju takon si dhe ndikojne ne prishjen e ambientit perreth, i cili sapo eshte rikonstruktuar nga Bashkia Tirane. Pas nderhyrjeve tona institucionale u be e mundur rregullimi i gjendjes qe ishte krijuar nga kundravajtesit dhe zgjidhja e ceshtjes ne favor te ankueses.

3. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit eshte drejtuar nje ankese nga Shoqata "Amaro-Drom". Ne ankesen e tyre ato shprehin shqetesimin e disa familjeve te komunitetit rom te vendosur ne Lagjen 5 Maji, Elbasan te cileve u jane prishur shtepite dhe jetojne ne kushte shume te veshtira.

Ne letren e Drejtorise se Sherbimeve Publike, Bashkia Elbasan, sqarohej se, Keshilli i Rregullimit te Territorit(KRRT) i Bashkise Elbasan ne perputhje me planin rregullues te zones kishte vendosur qe ne zonen ne fjale te ndertohet nje objekti banimi per familjet e pastreha.

Per shqyrtimin e kesaj ceshtje, nje grup ekspertesh nga Institucioni i Avokatit te Popullit bene nje verifikim te fakteve ne Elbasan. Nga verifikimi rezultoi se ne Lagjen 5 Maji ne Elbasan jane prishur 4 shtepi. Keto shtepi, te vendosura ne nje truall publik, ishin ndertuar pa leje, brenda sheshit te ndertimit te nje pallati per te pastrehet. Te kater shtepite e prishura i perkisnin banoreve te komunitetit rom. Pas prishjes se banesave te tyre, familjaret e siperpermendur jetonin ne kushte shume te veshtira, jashte çdo standarti minimal, ne baraka te improvizuara megjithese kishin femije te vegjel.

Nga takimet me perfaqesues te Drejtorise se Urbanistikes prane Bashkise Elbasan dhe dokumentat e shqyrtuara rezultoi se per prishjen e 5 objekteve ne Lagjen 5 Maji, veprimet e ndermarra nga Policia Bashkiake ishin ne perputhje me vendimin e KRRT-se Elbasan nr.5 date 22.05.2006.

Megjithese vendimi i Bashkise se Elbasanit ishte ne perputhje me ligjin per "Urbanistiken", sqaruar se Keshilli i Ministrave me Vendimin nr. 633 date 18.09.2003 ka miratuar "*Strategjine per permiresimin e kushteve te jeteses se minoritetit rom*". Kjo Strategji percakton prioritetet per Qeverine Shqiptare per permiresimin e kushteve te ketij minoriteti.

"Qeveria shqiptare duke pare veshtiresite me te cilat perballet popullsia rome ne Shqiperi, angazhohet politikisht per hartimin e nje strategjie per permiresimin e kushteve te jeteses se pakices rome qe jeton ne Shqiperi permes politikave e programeve konkrete per zbutjen e varferise, perfshirjen e tyre ne jeten publike, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit te tyre etnik etj..."

Lidhur me kete ceshtje Institucioni i Avokatit te Popullit rekomandoi qe te vleresohet me prioritet sistemimi i perkohshem te 4 familjeve rome te cilave u jane prishur shtepite nga Policia Ndertimore e Elbasanit dhe te shikohej mundesia e vendosjes te ketyre familjeve ne listen e personave te pastrehe, te cilet do te perfitojne ne objektin pallat qe do te ndertohet ne Lagjen 5 Maji. Ne kete rast reagimi i Bashkise Elbasanit ka qene pozitiv ne favor te zgjidhjes se ceshtjes se ketij komuniteti.

4. Ankesa e paraqitur nga XH.G, banues ne Tirane, i cili ka shprehur shqetesimin ne lidhje me prishjen e nje objekti (dyqan) te tij, te ndodhur ne rrugen e

Dibres, nga ana e Policise Bashkiake Tirane. Sikunder ai shkruan, dyqani ne fjale ku ai ushtronte profesionin e berberit, ndodhej ne rrugen e Dibres, perballe spitalit nr.1, tek godina e Fakultetit te Mjekesise, Tirane.

Ankuesi shprehej se Bashkia Tirane ka nxjerre urdher per prishje objektesh te ndodhura ne kete rruge dhe ka prishur dyqanin e tij. Ajo ka vepruar duke mos i komunikuar ankuesit asnje vendim perkates. Per shkak se nga ana e zyres se tatimeve i eshte kerkuar vendimi i prishjes se dyqanit, ankuesi shkruan se i eshte drejtuar disa here organit te Policise Bashkiake per dhenien e nje kopje te ketij vendimi, por nuk i eshte dhene asnje i tille.

Me marrjen ne shqyrtim te kesaj ceshtje nga ana jone, i jemi drejtuar parapraakisht organit te Policise Bashkiake per dhenien e shpjegimeve ne lidhje me kete ceshtje. Nga ana e ketij organi u sqaruam se ne kete rast eshte vepruar ne zbatim te nje vendimi te nxjerre nga ana e Drejtorise se Pergjithshme te Infrastruktures ne Bashkine e Tiranës, per rikonstruksionin e rruges se Dibres. Fakti eshte se ne kete shkrese nuk permendej dhe nuk identifikohet asnje e dhene konkrete, ne lidhje me kete vendim, prandaj i jemi drejtuar Drejtorise te Pergjithshme te Infrastruktures per dhenien e shpjegimeve, lidhur me shkresen e Policise Bashkiake Tirane, persa i perket vendimmarrjes perkatese per rikonstruksionin e rruges se Dibres. Njekohesisht, se bashku me pergjigjen, kemi kerkuar te n'a dergohet nje kopje te ketij vendimi.

Ne te gjithë kete ceshtje, morem te mireqene faktin qe ishin zhvilluar ne menyre te plote te gjitha procedurat e duhura ligjore dhe ishin nxjerre aktet e nevojshme administrative, pasi ne te kundert (gje qe nuk rezultonte te pakten nga pergjigja e organit te Policise Bashkiake), ceshtja ne fjale do te ishte shume me serioze ne demin qe mund t'i jete shkaktuar ankuesit.

Ne trajtimin qe i eshte bere kesaj ceshtje, nuk rezultonte te kishim refuzim te kerkeses per dhenie kopje dokumenti zyrtar, pra te se drejtes per informim ndaj ankuesit per aq sa ai ka kerkuar ne kete rast. Ne keto kushte, konstatuam se nga ana e Bashkise dhe Policise Bashkiake eshte shkelur parashikimi i bere ne nenin 53 te Kodit te Procedurave Administrative.

Nga ana tjetër nuk evidentohet fakti qe dokumenti i kerkuar te perbeje dokument, i cili eshte i kufizuar ne dhenie nga ligji.

Pra, nuk kishte ekzistuar dhe nuk ekzistonte asnje pengese per Bashkine, per plotesimin e kerkeses se ankuesit dhe dhenies se nje kopje te dokumentit zyrtar te kerkuar. Praktika e filluar ne kete rast, do te vazhdonte natyrshem me dhenien e nje kopje te vertetuar te dokumentave qe Bashkia mbante per kete ceshtje, te shoqeruara me shkresen percjellese perkatese, drejtuar vete ankuesit.

Per sa me siper, rekomanduam plotesimin sa me te shpejte te kerkeses se paraqitur per dhenien e kopjes te dokumentave te kerkuar, nga ana e XH.G.

Se fundmi, ne pergjigjen e dhene prej Drejtorise se Infrastruktures ne Bashkine Tirane, duke i dhene nje kopje te dokumentacionit ankuesit, zgjidhem pozitivisht kete ceshtje ne favor te ankuesit.

5. Ankesa e paraqitur nga R.H., banues ne qytetin e Vlores. Shtetesja R.H., ka shprehur shqetesimin e saj ne lidhje me kondicionet ne te cilat ka filluar te ndertohet nje objekt, ne baze te lejes se ndertimit nr.7/47 date 19.12.2005 te KRRT-se se Bashkise Vlore.

Sikunder ajo shkruan, kjo leje eshte e paligjshme pasi qe ne momentin e diskutimit te saj, nuk eshte marre parasysh gjendja faktike e sheshit te ndertimit dhe vijes se ndertimit qe kalon ne shtepine e ankueses.

Sikurse ankuesja shprehej, ndertimi ne fjale ka filluar me pare se te zbardhej leja e ndertimit, nderkohe qe kjo çeshtje i ka shkaktuar nje problem shume te madh familjes se saj.

Ne shpjegimet e dhena nga ana e Policise te Ndertimit, dega Vlore per kete çeshtje, sqarohej se nga ana e KRRT-se ne Bashkine Vlore eshte miratuar leje ndertimi per firmen ndertuese. Kjo leje ndertimi eshte ne perputhje te plote me studimin e miratuar nga ana e KRRT-se ne Bashkine Vlore, duke respektuar vijen e ndertimit. Ne keto kushte, ne pergjigje thuhej se objekti i planifikuar per ndertim nga ky subjekt ndertues, eshte rreth 4m larg nga shtepia e ankuesit. Megjithate, ne pergjigje sqarohet se ky nuk perben nje shkak ligjor per pezullim ne kete rast nga ky organ, pasi kerkesat ligjore te ndertuesit jane respektuar nga KRRT-ja. Po keshtu, ne pergjigje citohet se ankuesja duhet t'i drejtohet Bashkise per kompensim, pasi objekti i saj eshte i vendosur ne nje zone qe e kap zgjerimi i rruges. Objekti ne ndertim sipas kesaj pergjigje, nuk mund te spostohet nga vija e ndertimit e parashikuar ne studim per efekt kondicionesh urbanistike. Nderkohe ne pergjigjen e dhene konfirmohej se, subjekti ndertues eshte pezulluar per mosrrethim kantieri dhe per mospostim te linjes se ujrave te bardha, por nese plotesoheshin keto kerkesa do te kryhej ç'pezullimi.

Ne vazhdim, ne pergjigjen e dhene nga ana e Bashkise, sqarohet se me vendimin nr.1 date 23.06.2004 te KRRTRSH-se, eshte miratuar studimi urbanistik i zones Qender, te qytetit te Vlores, ku eshte percaktuar sistemi i ri rrugor, vijat e ndertimit dhe zonimi funksional i territorit. Ne baze te Ligjit "Per urbanistiken", ne pergjigje thuhet qe Bashkia Vlore ka miratuar studime urbanistike, sheshe dhe leje ndertimi per subjektet e interesuara, gjithmone ne zbatim te studimit te miratuar nga KRRTRSH-ja. Edhe objekti 8 kat per te cilin eshte ankuar shtetesja R.H, ne pergjigje konfirmohet se i eshte referuar studimeve te mesiperme, duke respektuar vijen e ndertimit te miratuar.

Banesa e ankueses prej 41.5 m2, sipas pergjigjes, nuk i plotesonte distancat urbane me objektin e ri 8 kate, por ishte jashte vijes se ndertimit dhe perfshihej ne territorin e sistemit te ri rrugor te miratuar, te zones qender dhe do te shpronesohej ne baze te Ligjit "Per shpronesimet per interes publik".

Duke analizuar pergjigjen e mesiperme, si dhe duke iu referuar punimeve tashme ne vazhdim per zbatimin e vendimit te KRRT-se se Bashkise Vlore, gjykua se procedurat e ndjekura ne raport me te drejtat legjitime te ankueses ne cilesine e pronares, ishin kryer jo ne perputhje me parashikimet e Ligjit Nr.8561 date 22.12.1999 "*Per Shpronesimet dhe marrjen ne perdorim te perkohshem te pasurise prone private per interes publik*".

Efektivisht, sipas radhes se ndjekur per te arritur deri tek vendimi perkates i KRRTRSH-se, per zonen Qender, te qytetit Vlore, mbetej problematik mosidentifikimi ne kohe nga ana e Bashkise, i cenimit qe mund t'i behej baneses se ankueses, sikunder edhe cenimi i mundshem i pronesive te tjera te ligjshme. Fillimi i zbatimit te vendimit te KRRTRSH-se, duhej qe te paraprihej nga etapat qe duheshin permbushur deri ne fillimin e punimeve. Se pari, fillohet me ngritjen e komisionit te shpronesimit per raste te veçanta, apo ne bllok per pronesite e ligjshme qe cenohen, me tej vazhdohet me evidentimin e siperfaqeve qe preken nga projekti, me vleren e drejte qe duhet te akordohet ndaj pronareve, me nenshkrimin e marreveshjes me pronaret per shpronesim dhe se fundi, me procedurat e miratimit te fondeve nga Keshilli i Ministrave. Pas realizimit te ketyre fazave, subjektit te interesuar (*ne kete rast Bashkise Vlore*), i lind e drejta te filloje planin zbatues te aplikimit konkret per dhenie leje ndertimi, apo zbatim punimesh, ne perputhje me vendimin e KRRTRSH-

se. Pergjigja e dhene nga ana e Bashkise per kete rast do te thoshte nje procedure e vonuar, pa afate konkrete qe do te zgjaste ne dem te te drejtave te ankueses.

Institucioni yne konkludoi se per sa kohe nuk ishin permbushur kriteret e ligjit te mesiperme ne favor te pronareve legjitim, per aq kohe vendimet per dhenie leje ndertimi, apo punimet dhe veprat me vlere urbane do te konsideroheshin cenim pronesis private, ne kundersizim me legjislacionin ne fuqi.

Te njohesh dhe te trajtosh pronaret sipas te drejtave te tyre, eshte se pari nje detyrim qe buron nga Protokollu I, Neni 1, i Konventes Europiane e te Drejtave te Njeriut ku parashikohet se:

“Çdo person fizik apo juridik ka te drejte per respektimin e pasurise se tij. Askush nuk mund te privohet nga prona e tij, veçse per arsye te dobise publike dhe ne kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e pergjithshme te se drejtes nderkombetare”

Se dyti, eshte nje garanci themelore per rendin kushtetues te parashikuar nga neni 41 dhe 42 ku midis te tjerash thuhet se:

“Neni 41 pika (4)-Shpronisimet ose ato kufizime te se drejtes se prones qe barazohen me shpronisimin, lejohen perkundrejt nje shperblimi te drejte”.

“Neni 42 pika (1)-Liria, prona dhe te drejtat e njohura me kushtetute dhe me ligj nuk mund te cenohen pa nje proces te rregullt ligjor”.

Dhe se treti, eshte nje detyrim ligjor qe buron nga Ligji Nr.8561, datë 22.12.1999 *“Per Shpronisimet dhe marrjen ne perdorim te perkohshem te pasurise prone private per interes publik”* ku midis te tjerash thuhet se:

“Neni 3--Shpronisimi dhe marrja ne perdorim te perkohshem te pasurise prone private realizohet ne perputhje me kushtet dhe procedurat e percaktuara ne kete ligj, duke garantuar transparencen, barazine e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe te drejtave te tyre pasurore”.

Gjykuam se vlerat publike qe perfaqesojne punet e Bashkise Vlore apo edhe vendimet qe jepen nga ana e saj per lejimin e ndertimeve private, duhej te ecnin paralelisht me zbatimin korrekt te ligjit ne mbrotje te te drejtave, lirive dhe interesave te ligjshme te individeve. Çdo perpjekje per te anashkaluar legjislacionin ne fuqi dhe per te cenuar te drejtat e pronesise perbente nje veprim, i cili demtonte forcimin e shtetit te se drejtes.

Duke e konsideruar natyren e kundraligjshme te praktikës se lartpermendur si shkelje te te drejtave dhe interesave te ligjshme te ankueses, rekomanduam trajtimin e menjehershëm dhe fillimin urgjent te procedurave te shpronisimit ndaj ankueses me cilesine e pronares se ligjshme, ne lidhje me pasurine e saj (banese 41.5 m²), e cila cenohej jo vetem nga zbatimi i vendimit te KRRT-se se Bashkise Vlore per dhenie leje ndertimi ne favor te firmes ndertuese, por edhe nga zbatimi i metejshem i vendimit nr.1 date 23.06.2004 i KRRTRSH-se, per miratimin e studimit urbanistik te zones Qender, te qytetit te Vlores. Jemi ne pritje te nje pergjigje zyrtare me shkrim, per sa kemi rekomanduar lidhur me kete ceshtje.

6. Ankesa e shtetasit R.L. nga fshati Lac Puke, i cili prezantoi shqetesimin, lidhur me mos furnizimin me uje te pijshem nga i vetmi burim i fshatit si pike furnizimi.

Lidhur me kete shqetesim jetik, na u shpjegua se qe nga data 1 Prill 2007, fshati Lac me 30-40 familje nuk furnizohet me uje te pishem nga burimi. Ky burim sipas ankuesit ishte i vetmi nga i cili furnizoheshin dhe ne kohe dimri, ai krijonte nje situatë shume te veshtire.

Ky burim iu nenshtroa para pak kohesh nje investimi, por qe nga muaji Prill i vitit 2007, keto familje nuk furnizoheshin me uje te pijshem.

Per nevojat e shqyrtimit te kesaj ceshtje, kerkuam shpjegime prane Bashkise Puke dhe na eshte kthyer dhe nje pergjigje lidhur me kete rast, sipas se ciles angazhimi i strukturave perkatese, ne favor te zgjidhjes se ketij shqetesimi qytetar nuk mungon dhe do te jete prioritet i punes se Bashkise dhe drejtuesve te saj te rinj, me qellim kthimin e normalitetit dhe furnizimin me uje te pijshem te banoreve te kesaj zone.

7. Ankesa e H. T. nga Ura Vajguore Berat, per problemin e prishjes se ambjentit prane shtepise, e cila demtohej nga nje biznes gurorje.

Ne zbatim te kompetencave ligjore i kerkuam Ministrise se Mjedisit, Pyejeve dhe Administrimit te Ujrave si dhe Bashkise se Ures Vajguore, shpjegime mbi kriteret e dhenies se lejes se ndertimit dhe licensimit te nje impianti guri tek zona Guri i Bardhe si dhe nese ishin marre ne konsiderate efektet ne ambjentin perreth ketij impianti.

Nga Bashkia e Ures Vajguore u njoftuam se subjekti perkates po e kryen veprimtarine per shfrytezimin e gurit ne baze te lejeve perkatese.

Ndersa, Ministria e Mjedisit, Pyejeve dhe Administrimit te Ujrave, njoftoi se, ka ndermarre veprime per verifikim te situates se ndotjes se mjedisit dhe demeve te shkaktuara nga impianti ne fjale dhe se subjektit ne fjale, i eshte kerkuar qe te programoje zhvendosjen e linjes se fraksionimit te inerteve larg shtepive te banimit.

Gjithashtu kjo Ministri, cileson se subjekti ne fjale do te monitorohet vazhdimisht per respektimin e rregullave perkatese dhe mos ndotjen e mjedisit.

8. Ankesa e B.H, nga qyteti i Tiranes, i cili si perfaqses i nje grupi banoresh qe banojne ne pallatet 1 Maji, Vila 2 kateshe ne rrugen Komuna e Parisit, si edhe pallatit 6/1 te ndodhur ne rrugen Emin Duraku, kane prezantuar problemin lidhur me disa veprime te pretenduara te paligjshme dhe te parregullta te nje shtetasi, i cili krijonte shqetesime me aktivitetin privat qe po ushtronte ngjitur me banesat e ankuesve.

Pervec sa me siper, na u shpjegua se puna e vazhdueshme gjate gjithë dites se lavazhit, ka prishur qetesine e banoreve nga zhurma e pompave te ujit, gjeneratorëve dhe zhurmat e makinave qe vijne ne menyre permanente. Gjithashtu eshte krijuar nje nivel i larte lageshtire dhe nderkohe eshte krijuar pengese per parkimin e makinave te vete pallatit, pasi ne te duhet te parkohen ato qe vijne per ne lavazh.

Per shqetesimet e mesiperme, ankuesi ka paraqitur ankesa neper te gjithë instancat dhe institucionet, por si Policia Ndertimore ashtu dhe Bashkia Tirane, vetem kane konstatuar paligjishmerine e ketij lavazhi, por nuk kane marre asnje mase per nderprerjen e kesaj paligjishmerie.

Ndodhur me keto kushte, ai iu drejtua Avokatit te Popullit dhe kerkoi nderhyrjen e tij, per te bere te mundur nxitjen e organeve vendore dhe qendrore, per te nderhyre dhe ushtruar kompetencat, te drejtat dhe detyrat qe u ngarkojne ligjet, per te mos i lene vend vetgjqesive qe vijne nga mosveprimet dhe zvarritjet e zgjidhjes se problemeve.

Per nevojat e shqyrtimit te kesaj ankese, kerkuam shpjegime prane Bashkise Tirane, si dhe ne Ministrine e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Me pas, shqyrtimet tona vijuan ne Inspektoriatin Ndertimor Urbanistik te Bashkise Tirane. Gjithashtu per kete ceshtje ezauruam dhe nje takim verbal me Kryeinspektorin e Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik, te Bashkise Tirane, i cili na informoi se per kete rast jane evidentuar shkeljet dhe eshte hartuar proces verbali i konstatimit te kundravajtjes, gati per te vazhduar me procedurat e metejshme deri ne zgjidhjen perfundimtare te problemit, qe shqeteson komunitetin e kesaj zone. Pra

dhe ne kete rast reagimi i organeve vendore ka qene pozitiv ne favor te zgjidhjes se ankuesve.

9. Ankesa e A.L, Kryeplak i Zones Zall-Mnerr i Ri, Kamez, me ane te se ciles eshte parashtruar shqetësimi dhe pretendimi i afro 300 familjeve të kësaj zone që nuk janë pajisur me dokumentacion pronësie.

Konkretisht ankuesi shprehej se kishte 10 vjet që banonte në shtëpitë e ndërtuara nga shteti si pasojë e shpërnguljes së banorëve nga Ujëmbledhësi i Bovillës. Lidhur me këtë ai sqaronte se që nga ajo kohë, këtyre banorëve nuk u është dhënë asnjë vërtetim pronësie për shtëpitë ku ata jetojnë prej vitesh çka përbën një problem për ato.

Më tej ai shtonte se kjo është një e drejtë që buron nga Vendimi nr. 317 datë 19.06.1995 i Këshillit të Ministrave, por deri në ditën e shkreses ai nuk ka konstatuar reagim serioz të organeve kompetente shtetërore të ngarkuara për zbatimin e këtij vendimi.

Lidhur me këtë rast kërkuam shpjegime Kryetarit e Bashkise Kamez. Nga ana e Kryetarit, kemi një përgjigje zyrtare për rastin konkret, në të cilën trajtohet hollësisht problemi i sipershenuar, ku nder te tjera konfirmohet fakti se keta banore jane sqaruar edhe verbalisht nga ana e Kryetarit per problemin e parashtruar.

Sa më sipër banoret u sqaruan lidhur me pretendimet e tyre dhe jane orientuar per rrugen qe duhet te ndiqet ne te ardhmen per zgjidhjen perfundimtare te kesaj çeshtje ne favor te kerkimeve te tyre.

10. Eshte trajtuar dhe zgjidhur pozitivisht dhe ankesa e paraqitur nga G. M., banues ne qytetin e Korçes, i cili ankohet per mosveprim te Bashkise Korçe, qe nuk zbatonte VKM Nr.536 date 1.08.2003, qe i kalon pronat e N G P Drithit Korçe ne inventarin dhe administrimin e kesaj Bashkie, per shkak se ndermarrja eshte pa aktivitet dhe rezulton me nje bilanc negativ.

Si rrjedhoje e kesaj, nuk zbatohet as vendimi gjyqesor Nr.718 date 3.04.2003, sipas te ciles N G P Drithi Korçe i detyrohet ish pronareve te shoqerise Gjeneral Elektrik Korçe shumen prej 14.501.961 leke.

Ankuesi na shpjegon se per sa me siper ka filluar nje proces gjyqesor per shpalljen e falimentimit te N.G.P drithit Korce, sepse i ploteson kushtet per likuidim. Por per shkak se Bashkia nuk figuron si pronare nga mos zbatimi i vendimit te sipercituar te VKM Nr.536 date 1.08.2003, nuk mund te zhvillohet as procesi gjyqesor, duke ju mohuar keshtu nje mjet ligjor dhe mundesi per te rivendosur ne vend te drejtat e pretenduara si te shkelura. Pikerisht ky mosveprim, sipas pretendimit te ankuesit, ka penguar zhvillimin e procesit gjyqesor qe do te shpallte te falimentuar N.G.P.Drithin Korçe dhe do t'u jepte mundesi kreditoreve qe te perfitonin nga shitja e asetëve te kesaj ndermarrje.

Per nevojat e shqyrtimit te kesaj ceshtje, kerkuam shpjegime prane Kryetarit te Bashkise Korçe, i cili na ka derguar dhe pergjigjen lidhur me kete rast, duke na percjelle angazhimin e tij per zgjidhje te kesaj suate, e cila eshte e renduar jo vetem per ankuesin, por edhe per te tretet, ndaj te cileve ka detyrime te pa shlyera nga kjo ndermarrje

Megjithëse ne veprimtarine e organeve te pushtetit vendor, verehen perpjekje per me shume profesionalizem dhe kulture konformë frymes se ndertimit te nje shteti ligjor, ato ende jane larg standarteve qe kerkon koha. Per kete arsye gjithmone kemi menduar dhe gjykojme se ka nevojë për një oponencë konstruktive të vazhdueshme, e cila në rastet konkrete që kemi ndjekur me këto organe, jemi munduar t'ia servirim me profesionalizëm e objektivitet me qellim qe te mesojne

dhe mos perseritin shkeljet qe kane bere. Per sa i perket reformes se decentralizimit, konstatojme se jane bere perparime por nuk eshte arritur akoma rezultati i pritur.

Referuar raportit te Monitorimit te Marreveshjes se Stabilizim Asociimit nga ana e Institutit Agjenda, verehet se per te permbushur angazhimet, lidhur me reformen ne procesin e decentralizimit, te cilat ne kuader te MSA-se rrjedhin kryesisht nga nenet 78 dhe 110, si dhe nga dokumenti i Parlamentit Europian jane parashikuar nje sere masash legjislative, administrative dhe infrastrukturore. Ato synojne zbatimin e reformes se decentralizimit te pushtetit vendor, rritjen e transparences si dhe perfshirjen me te gjere te qytetareve dhe komuniteteve e grupeve te ndryshme shoqerore ne qeverisje, ne perputhje me Karten Europiane te Autonomise Lokale dhe Rajonale.

Ne kete situatë të re, ku niveli i shkeljeve të drejtave dhe lirive themelore po shihet si barometer për etiketimin dhe standartizimin në planet integruese, Avokati i Popullit apelon për me shume kujdes dhe profesionalizem në marrëdhënie me individët dhe me të drejtat që ata gëzojnë kundër organeve të administratës publike qendrore dhe vendore.

c. Ankesat për prefekturat

Gjithsej kemi patur 10 ankesa për prefekturat për këtë vit si dhe 2 të mbartura nga vitit 2006. Nga këto 2 janë zgjidhur në favor të ankuesit, 1 ankese është e pa bazuar, 4 jashtë juridiksionit, 3 ankesa kanë qenë jashtë kompetencës kurse 2 janë në shqyrtim për vitin 2008.

Prefekti është hallkë ndërmjetëse midis pushtetit qendror dhe vendor dhe për këtë arsye misioni i tij është të bashkërendojë punën dhe veprimtarinë me këto institucione. Në këtë këndvështrim nga ankesat e shqyrtuara janë konstatuar raste të zvarritjeve të procedurave administrative, mungesë transparence apo dhe shkelje të së drejtës së informimit, si dhe shkelje të procedurave administrative në rastet e largimeve nga detyra.

1. Veçojmë ankesën e shtetasit B.K, sekretar i Keshillit të Komunes Golem, rrethi Lushnje, lidhur me disa mosveprime të N/prefektit që sipas pretendimit të tij, kanë penguar ecurinë normale të punës të organeve vendore.

Në objektin e kësaj ankese sqarohemi hollësisht për procedurën e ndjekur të mbledhjeve të një pasnjeshme që janë ezauruar, për ngritjen dhe konstituimin e Keshillit të Komunes dhe me pas për perpjekjet për të bërë të mundur konfirmimin e procedurës së ndjekur, nga ana e n/prefektit të rrethit Lushnje.

Lidhur me këtë të fundit ankuesi na sqaronte se, padrejtesisht nga n/prefekti nuk bëhet i mundur konfirmimi i konstituimit të Keshillit të Komunes, duke sjellë një pengesë për mbarevajtjen e gjithë komunitetit.

Për sa me sipër ankuesi kishte kërkuar nderhyrjen e gjithë strukturave përgjegjëse për rregullimin e kësaj gjendje të krijuar dhe së fundi dhe nderhyrjen e Avokatit të Popullit.

Për nevojat e shqyrtimit të kësaj çështje, kërkuam një informacion për shkaqet që përse vendimet e mesipërme nuk konfirmohen nga n/prefekti të rrethit Lushnje.

Në përgjigje të kërkesës tone u informuam se pavaresisht zvarritjeve pa shkak, gjithçka ishte kthyer në normalitet dhe në rrugën e duhur institucionale, informacion të cilin e gjykuam pozitiv në funksion të mirëqeverisjes të çdo hallke dhe strukture qeverisëse.

2. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit ne kete vit na eshte bere prezent shqetesimi i Kryetarit te Komunes Rrajce, lidhur me mos veprimin per te nderhyre ne rregullimin e situates qe ka ardhur si rezultat i keqmenaxhimit te ujit te pijshem ne tunelin Qafe Thane.

Lidhur me kete problem, kryetari i kesaj Komune na shpjegonte gjithë ecurine e kesaj ceshtje dhe deri tek shqetesimi emergjent, qe kishte rrjedhur si shkak i lidhjeve te paligjshme apo deri tek lavazhet e panumerta ne rrugen nacionale, qe kishin shtuar shume rreziqe dhe probleme per mbare komunitetin. Kjo gjendje sipas Kryetarit te Komunes kishte ardhur nga veprimet e pushtetareve lokale, apatia e tyre ne veprime konkrete, te cilet me papergjegjshmeri kishin lejuar lidhje te panumerta, ne tunelin hekurudhor Qafe Thane. Kjo papergjegjshmeri sipas Kryetarit te Komunes, kishte shkuar deri aty sa ishte lejuar nderhyrja ne sifonin e ujit te vaditjes se fshatrave Urake, Kotodesh, Katjel e Rashtan ku fermeret mbjellnin, por nuk korrnin nga mungesa e ujit.

Duke patur parasysh se ne kete tunel kalon rruga hekurudhore, burimi i ujit te pijshem ndotej perdite nga udhetaret, qe hedhnin mbeturina te ndryshme, duke bere qe gjendja te paraqiste nje rrezik evident dhe me shume risqe per jeten dhe shendetin e njerezve.

Per kete qellim Kryetari i Komunes, bente thirrje dhe kerkonte qe me perpjekjet e tij, te bashkoheshin te gjithë strukturat perkatese pergjegjese, per te marre masa per sistemimin e burimit te ujit te pijshem, per ta izoluar me mbulesa cemento dhe materiale te tjera ndertimi ne te gjithë gjatesine e tij.

Gjithashtu ne vijimesi te ketyre masave, kerkohej te realizohej ndertimi i nje kolektori te perbashket per shperndarjen e komanduar te ujit, sipas rregullave hidrike te menaxhuar me ligj si dhe duke mbrojtur kete pasuri ujore, e cila eshte kombetare dhe si e tille kerkon impenjim te gjithsecilit, ndergjegjesim dhe perkushtim ne mbrojtje te jetes se banorve te ketij komuniteti.

Ne mbrojtje te jetes se njerezve dhe per nje administrim me te mire te kesaj pasurie kombetare, Kryetari i Komunes, kerkoi ndihmen e Avokatit te Popullit qe te ndermjetesonte dhe koorrdinonte punen midis organeve vendore dhe qendrore per te bere te mundur angazhimin e strukturave shteterore, ne zgjidhje te ketij shqetesimi

Per sa me siper Institucioni i Avokatit te Popullit, kerkoi nje informacion per situaten qe paraqiste Kryetari i Komunes Rrajce, ne drejtim te administrimit te ujit te pijshem ne Tunelin Qafe Thane, duke kerkuar specifikisht se cilat kane qene veprimet qe kishte ndermarre Prefektura e Qarkut Elbasan, nderkohe qe problemi nuk ishte i panjohur dhe cilat ishin procedurat qe kishte ndjekur Prefektura si ure lidhese e pushtetit vendor me pushtetin qendror.

Lidhur me kete ceshtje na u kthye nje pergjigje nga Prefektura e Qarkut Elbasan, sipas te ciles ekziston nje vullnet dhe angazhim i mire per zgjidhjen e ketij shqetesimi mbarekomunitar ne dobi te jetes dhe shendetit te njerezve. Pra dhe ne kete rast nderhyrja jone institucionale solli rezultate pozitive te pritshme, ne funksion e gjitha te miremenaxhimit dhe bashkerendimit te hallkave te pushtetit vendor dhe atij qendror.

Si perfundim mund te themi se Prefekturat në zbatim të Ligjit Nr.8927 datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, duhet të rrisin rolin e tyre koordinues dhe kontrollues mbi administrimin dhe veprimtarinë e organeve të pushtetit vendor në të gjitha hallkat e tij, si dhe kontrollin e bazueshmërisë ligjore të të gjitha akteve që nxjerrin këto organe, për t’u prerë rrugën veprimeve të kundraligjshme dhe abuzive që në fillim, me qëllim që situata të mos derivojë dhe të sjellë pasoja të pariparueshme sociale dhe ligjore per shtetasit.

dh. Ankesat për Sherbimin e Gjendjes Civile

Edhe gjate ketij viti prane Zyres tone jane trajtuar ankesa te cilat lidhen me sherbimin e Zyrave te Gjendjes Civile. Keshtu jane shqyrtuar 30 ankesa, nga te cilat 22 jane perfunduar dhe 8 jane ende ne shqyrtim. Nga 22 ankesa te perfunduara, 10 jane zgjidhur ne favor te ankuesve, 6 kane qene te pa bazuara, 2 jashte juridiksionit dhe 4 jashte kompetences.

Pjesën më të madhe të ankesave për Zyrat e Gjendjes Civile e zënë ato për te cilat pretendohet mosveprim apo veprime me gabime materiale te bera nga nepunes te gjendjes civile dhe per rrjedhoje mos plotesim te kerkesave te shtetasve per sa ata pretendojne. Ne ndonje rast ankohen edhe per zvarritje te procedurave gjate trajtimit të kerkesave apo per fallsifikim dokumentash.

Pjesa me e madhe e ankesave jane perfunduar, duke i informuar dhe sqaruar ankuesit per rrugen e zgjidhjes qe duhet te ndjekin dhe procedurat paraprake per realizimin e te drejtave te tyre, bazuar ne ligjin Nr.8950 date 10.10.2002 "Per Gjendjen Civile", te ndryshuar.

Me poshte po trajtojme me gjate disa raste te shkeljeve me te renda te bera nga nepunesit e Zyrave te Gjendjes Civile.

1. Ankesen e shtetasit M.G nga fshati Torovice Lezhe.

Ankuesi pretendonte se në ngjarjen tragjike të 9 Janarit 2004, ku humbën jetën (u mbytën) 19 persona ne Vlore, atij i është mbytur djali Gj.G. dhe nusja e djalit E. G. Ankuesi shpjegon se për këtë ngjarje Stacioni Televiziv Top Chanel hapi një numër llogarie ku çdo qytetar mund të kontribuonte në të holla, për të ndihmuar familjet e viktimave.

Nga shuma e të hollave të grumbulluara, ka përfituar 1.200.000 lekë të reja, përkatësisht 600.000 lekë për djalin dhe 600.000 lekë për nusen e djalit. Me tej shpjegonte se, tërheqjen e të hollave e ka bërë në datën 27-28 Janar 2004, në Bankën Kombëtare Tregtare, Dega Shkodër. Tërheqja e të hollave është bërë mbi bazën e disa dokumentave që duheshin dorëzuar pranë kësaj banke, ku nga më kryesoret ishte çertifikata familjare të cilën ankuesi e ka marrë në zyrën e gjendjes civile Tamarë, Malësi e Madhe. Çertifikata ndodhej në praktikën që Banka Kombëtare Tregtare Shkodër ka hapur për këtë problem. Në çertifikatën familjare vërtetohej gjendja familjare me personat perkates te trungut te familjes.

Ankuesi shpjegonte me tej se, nga shuma e të hollave që mori, gjysmën e kesaj shume ja ka dhënë babait të nuses se djalit.

Më vonë doli një Vendim i Qeverisë i cili u jepte familjarëve të viktimave të 9 Janarit nga 2.000.000 lekë të reja për person. Ankuesi kishte dëgjuar se këtë radhë lekët do të jepeshin në Prefekturë. Aty ai informohet se leket për nusen e djalit janë tërhequr nga ëma e saj (nuses), bashkë me punonjësën e gjendjes civile Tamarë, bazuar në çertifikatën që ajo ka paraqitur. Ankuesi na informonte se në këto kushte shkoi në Tamarë dhe takoi punonjësën e gjendjes civile, të cilit i kërkoi përsëri një çertifikatë familjare siç e kishte marrë herën e parë ku të vërtetohej se nusja e djalit ishte në çertifikatën e gjendjes familjare. Por punonjesi i gjendjes civile i shpjegoi se nuk mund ta jepte një çertifikatë të tillë pasi ankuesi nuk e ka bërë celebrimin e djalit me nusen, sepse veprimet ishin bere me laps, për t'i plotësuar më pas.

Ankuesi na informonte se edhe në polici, familjaret e nuses se djalit kanë dashur që të zhduknin praktikën e aplikimit për pasaportë të nuses, me qëllim që të mos kishte asnjë gjurmë që ajo ishte nusja e djalit te ankuesit.

Për të bërë të mundur sqarimin e kësaj ankese nga ana e institucionit tonë është shkuar për të parë dokumentat në vend dhe është marrë takim me punonjës të gjendjes civile Tamarë si dhe janë bërë një sërë verifikimesh.

Nga kqyrja e regjistrimit themeltar të gjendjes civile Tamarë rezultonte se viktimat Gj. G. dhe E. N. kishin bërë lidhje martesore në datën 05.01.2004.

Ndërsa punonjësi i gjendjes civile në deklaratën e tij deklaroi se gjendja civile e E. N. është beqare, pasi nuk e lejon ligji i gjendjes civile të lidhë martesë pa mbushur moshën 18-vjeç. Por ndonëse në gjendjen civile Tamarë rezultonte se E. N. dhe Gj.G. kanë bërë lidhje martesore që në 05.01.2004, po nga ky punonjës i gjendjes civile. Në deklaratën e tij punonjësi i gjendjes civile deklaroi se çdo dokument tjetër që është lëshuar më parë është jashtë normave ligjore.

Çertifikata familjare e familjes së kryefamiljarit të nuses E.N., nr.7/228, datë 22.10.2004, ku rezultoi E. N. me gjendje civile beqare, është shkelje flagrante e punonjësit të gjendjes civile, pasi ai është i detyruar që të japë dokumenta autentike bazuar në regjistrin themeltar të gjendjes civile.

Më tej nga ana e jonë u shkua në Komisaratin e Policisë Malësi e Madhe, për të verifikuar dokumentat me të cilat E.N. kishte aplikuar për pasaportë për jashtë shtetit. Nga verifikimet e bëra rezultoi se, në datën 05.01.2004 (pikërisht në datën që kishte bërë lidhjen martesore) E. G. kishte marrë çertifikatë personale në gjendjen civile Tamarë, të lëshuar nga punonjësi i gjendjes civile dhe në datën 09.01.2004, pikërisht në ditën që është mbytur, i është prodhuar pasaporta për jashtë shtetit me mbiemrin e bashkeshortit të saj.

Nga verifikimi i kryer, si edhe kqyrja apo administrimi i dokumenteve të ndryshme rezultoi se:

Veprimet e punonjësit të Gjendjes Civile ishin antiligjore dhe përbënin shkelje të nenit 191 dhe 248 të Kodit Penal. Në rastin konkret ndodhur para veprës penale të “shpërdorimit të detyrës”, mbi bazën e materialit kallzues të dërguar nga ana e jone Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkoder u rregjistrua procedimi penal nr.489 datë 06.07.2007, në ngarkim të shtetasit M.K. për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Pas veprimeve hetimore të kryera, shtetasi M.K. me detyrë Nepunes i Gjendjes Civile të Komunes Kelmend është marrë në përgjegjësi penale, duke u akuzuar se ka kryer veprën penale të falsifikimit të akteve të gjendjes civile, krim i parashikuar nga neni 191\2 i K.Penal. Me datën 17.09.2007, çështja është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkoder. Aktualisht kjo çështje është në proces gjyqësor.

2. Ankesa e shtetasit E. A., nëpërmjet të cilës shprehte shqetësimin e tij lidhur me mospajisjen nga Zyra e Gjendjes Civile të Prefekturës së Qarkut Tiranë me çertifikatë negative për të ndjerën M. R. Ankuesi na shkruante se çertifikata negative për të ndjerën M. R. nuk i jepej nga nëpunësja e kësaj zyre me pretendimin se e ndjera M. R. rezultoi në aktin e vdekjes së A. R., si e veja e tij në bazë të vendimit nr. 427, datë 5.07.1958 të Gjykatës Popullore Tiranë.

Mirëpo ai sqaronte se kushëriri i tij, i ndjeri A. R. ka vdekur në vitin 1944 dhe në vitin 1945 ishte bërë regjistrimi i aktit të vdekjes së tij në Shqipëri në bazë të një vendimi gjyqësor të Gjykatës Popullore Tiranë. Më pas me vendimin nr. 427, datë 5.07.1958, të Gjykatës Popullore Tiranë ishte bërë korrigjimi i akt-vdekjes së A. R. Në këtë vendim, me të cilin ishte bërë korrigjimi i aktit të vdekjes së A. R., figuron se A. R. ka qenë i martuar me M. R. Ky vendim ishte regjistruar në anën e majtë të fletës së regjistrimit në të cilin pasqyrohet akti i vdekjes së A. R. Ky fakt u konstatua edhe nga përfaqësuesit e institucionit tonë kur bënë kqyrjen e regjistrimit të akteve të vdekjeve në këtë zyrë. Sqarojmë se ky vendim nuk vërteton faktin juridik

të martesës ndërmjet A. R. dhe M. R., por vetëm ka bërë disa korrigjime në aktin e vdekjes së të ndjerit A. R.

Për shkeljen e të drejtës së tij, ankuesi ishte ankuar në rrugë administrative në organet eprore të kësaj zyre deri në Kryeministri, megjithatë problemi nuk ishte zgjidhur.

Zyra e Gjendjes Civile të Prefekturës së Qarkut Tiranë, ktheu përgjigje kerkeses sone për mos dhënien e çertifikatës ankuesit duke përdorur të njëjtin justifikim sikurse i kishte dhene ankuesit.

Gjithashtu ankuesi pretendonte, se nëpunësja e Gjendjes Civile, më datën 31.05.2006, kishte lëshuar një çertifikatë vdekje në emër të shtetasit A. R. Sipas tij, kjo çertifikatë ishte falso, sepse pasqyron një fakt të pa qënë, atë të martesës së shtetasit A. R. me shtetasen M. R. Në qoftëse ky fakt do të ishte i vërtetë, atëhere kjo zyrë do t'i jepte ankuesit çertifikatën e martesës ndërmjet tyre.

Nga çertifikatat që na vuri në dispozicion ankuesi dhe konkretisht, çertifikata e martesës e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Bashkisë Tiranë, më dt. 18.07.06, rezulton se shtetesja M. R. ka qënë e martuar me shtetasin H. B, data e martesës së tyre është 22.01.1954. Sipas kësaj çertifikate, rezulton se shtetesja M. R. ka qënë e çkurorëzuar dhe jo e ve?! Nëse ajo do të kishte qënë e martuar me A. R, pas vdekjes së tij dhe në momentin e lidhjes së martesës me shtetasin H. B, do të ishte e ve dhe se ky fakt do të pasqyrohej në çertifikatën e martesës me këtë të fundit. Edhe në qoftëse ajo ka qënë e martuar me shtetasin A. R. dhe më pas është çkurorëzuar me të, atëhere ajo nuk mund të jetë trashëgimtare ligjore e tij.

Në Rregulloren "Për metodikën e punës së Zyrave të Gjendjes Civile në Bashki e Komuna, në kapitullin i cili bën fjalë për lëshimin e çertifikatave negative thuhet se: "*Çertifikata negative vërteton që një person i caktuar, nuk figuron në ndonjë regjistër apo akt*". Më poshtë nga modeli i çertifikatës negative i përshkruar në këtë rregullore kuptohet qartë se, *çertifikata negative lëshohet nga punonjësja e gjendjes civile të zyrës përkatëse që e lëshon atë, për regjistrin dhe librin e akteve të kësaj zyre*. Kjo do të thotë se, nëse një shtetas i caktuar nuk figuron i regjistruar në regjistrin apo në librat e akteve të një zyre të caktuar, për atë shtetas duhet të lëshohet çertifikatë negative, pavarësisht nëse ai mund të jetë i regjistruar në regjistrin apo librat e akteve të një zyre tjetër. Pra çdo zyrë lëshon dokumente dhe përgjigjet vetëm për regjistrat dhe librat e akteve që ajo disponon dhe brenda kompetecave të saj tokësore.

Në rastin konkret, kur e ndjera M. R, figuron në librin e akteve, në formën e një shënimi në krah të aktit të vdekjes së A. R, nuk kemi të bëjmë me faktin e regjistrimit të saj në regjistër apo libër aktesh.

Qëndrimi i nëpunësës së gjendjes civile ndaj ankuesit, duke mos lëshuar çertifikatën përkatëse në emër të shtetasës M. R. nuk ishte korrekt dhe ligjor, sepse atij i është mohuar e drejta kushtetuese dhe ligjore e informimit dhe e shërbimit nga organet e administratës publike, pjesë e të cilës është edhe zyra e gjendjes civile. Nga mosveprimi i kundërligjshëm i saj ka ardhur si pasojë cënimi i rëndë i veprimtarisë normale dhe i imazhit të institucionit të shërbimit të gjendjes civile dhe në të njëjtën kohë janë shkelur rëndë të drejtat e ankuesve. Për shkak të mosdhënies së çertifikatës negative të martesës së shtetasës M. R. me shtetasin A. R., ankuesi është përjashtuar padrejtësisht nga e drejta ligjore e trashëgimisë së trashëgimlënësit A. R, i cili në kohën e vdekjes ka patur pasuri me vlera të konsiderueshme në Greqi. Sipas dëshmisë mbi të drejtën e trashëgimisë, nr. 65, datë 06.05.1958, të Gjykatës Popullore Tiranë, vërtetohet se trashëgimtare e vetme ligjore e A. R. është e veja e tij M. R. Kjo dëshmi është lëshuar në bazë të një çertifikate me

nr. 696, datë 01.04.1958, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile pranë Këshillit Popullor të Rrethit Tiranë, sipas të cilës rezultoi se M. R. është e veja e A. R. Dokumentet e Zyrës së Gjendjes Civile pranë Këshillit Popullor të Rrethit Tiranë, aktualisht ndodhen në Zyrën e Gjendjes Civile të Prefekturës së Qarkut Tiranë. Mirëpo nga kontrolli i bërë nga nëpunësja e kësaj zyre, me kërkesën e ankuesit dhe të përfaqësuesve të Avokatit të Popullit rezultoi, se dokumentet në bazë të të cilave është lëshuar çertifikata nr. 696, datë 01.04.1958, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile pranë Këshillit Popullor të Rrethit Tiranë nuk ekzistojnë.

Moslëshimi i çertifikatës negative të martesës së M. R. me shtetasin A. R., i heq ankuesit mundësinë ligjore për të kërkuar rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 65, datë 06.05.1958, të Gjykatës Popullore Tiranë, në bazë të të cilit M. R. është bërë trashëgimtare e vetme ligjore e A. R.

Përsa më sipër dhe për të bërë të mundur rivendosjen e të drejtës së mohuar ankuesit, i rekomanduam Zyrës së Gjendjes Civile të Prefekturës së Qarkut Tiranë, që të bënte verifikimet në regjistrin themeltar të gjendjes civile dhe librat e akteve; të lindjes, të martesës dhe të vdekjes lidhur me shtetasin M. R. Nëse shtetësja M. R. figuron e regjistruar në regjistrin themeltar apo në librat e akteve, të lëshonte çertifikatat përkatëse në emër të saj. Nëse shtetësja M. R. nuk figuron e regjistruar në regjistrin themeltar apo në librat e akteve, të lëshonte çertifikatat negative përkatëse në emër të saj. Çertifikatat e lëshuara t'i jepeshin ankuesit. Mirëpo edhe pas rekomandimit tonë, nëpunësja e gjendjes civile nuk reagoi për dhënien e çertifikatave të cituara më sipër. Qëndrimi i nëpunëses së gjendjes civile ndaj ankuesit, duke moslëshuar çertifikatat përkatëse të martesës apo atë negative në lidhje me martesën e shtetasin M. R. me shtetasin A. R. ishte i kundërligjshëm. Ankuesit i është mohuar e drejta kushtetuese dhe ligjore e informimit dhe e shërbimit nga organet e administratës publike, pjesë e të cilës është edhe Zyra e Gjendjes Civile të Prefekturës së Qarkut Tiranë. Këto të drejta janë të parashikuara dhe të garantuara respektivisht nga:

a) Neni 23 i Kushtetutës, i cili sanksionon se:

“1. E drejta e informimit është e garantuar.

2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, ...”.

b) Neni 3 i ligjit nr. 8503, dt. 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i cili përcakton se:

“Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qënë i detyruar që të shpjegojë motivet.

Autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe...”.

c) Neni 56 i ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se:

“Shërbimi i gjendjes civile është institucion shtetëror dhe unik. Ky shërbim, në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore. Ai plotëson, ndryshon dhe mban regjistrat e gjendjes civile, harton aktet e gjendjes civile, sipas përcaktimeve të këtij ligji, kryen shërbime ndaj shtetasve, si dhe publikon dhe jep çertifikatat për përmbajtjen e tyre”.

Me mosveprimet e kundërligjshme, mosdhënien e certifikatave të kërkuara nga ankuesi, shtetësja Valbona Barushi gjate ushtrimin e funksionit të saj shtetëror, ka konsumuar elementët e figurës të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Ndërsa me veprimet e saj të kundërligjshme,

duke lëshuar një certifikatë me të dhëna të rreme, ajo ka konsumuar elementët e figurës të veprës penale të “Falsifikimit të akteve të gjendjes civile”, parashikuar nga neni 191/2 i K.Penal. Për këto arsye i rekomanduam Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, fillimin e hetimeve ndaj nëpunëses së Zyrës së Gjendjes Civile të Prefekturës së Qarkut Tiranë për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal dhe të “Falsifikimit të akteve të gjendjes civile”, parashikuar nga neni 191/2 i K.Penal. Ky rekomandim është bërë kohët e fundit dhe jemi në pritje të shqyrtimit të tij.

3. Gjithashtu mund të permendim ankesën e shtetasve K.K dhe Z.K të cilën shprehin shqetësimin e tyre lidhur me mospajisjen me certifikatë nga ana e Zyres Gjendjes Civile Shkoder, pasi nuk kishin permbushur detyrimin lidhur me pagimin e takses së pastrimit të qytetit.

Nisur nga ankesa e tyre kemi kërkuar të informohemi nga ana e Zyres Gjendjes Civile Shkoder, lidhur me pretendimin e tyre.

Ne pergjigjen e kesaj zyre me date, 08.06.007, informohemi se, ne zbatim te Urdherit te Brendshem Nr.4 date 25.01.2006 te ish Kryetarit Bashkise Shkoder, kjo zyre urdherohej te mos kryente asnje veprim per te gjithë shtetasit prane Zyres se Gjendjes Civile ne Bashkine Shkoder, pa qene te pajisur me kartonin e takses se pastrimit.

Avokati i Popullit ne perputhje me detyrat e tij kushtetuese ne mbrojtje te te drejtave dhe interesave te ligjshme te individeve nga veprimet e parregullta dhe te paligjshme te organeve dhe funksionareve te administrates publike, duke i vleresuar veprimet dhe urdherin administrativ Nr.4 date 25.01.2006 te Kryetarit te Bashkise Shkoder si te marra ne kundërshtim me Kushtetuten dhe aktet ligjore e nenligjore, ne baze te nenit 21/b te ligjit Nr. 8454, dt. 04.02.1999 “ Per Avokatin e Popullit” me ndryshimet e bera, rekomandoi :

-Ne baze te nenit 124 te K.Pr.Administrative revokimin e urdherit administrativ Nr.4 date 25.01.2006 si akt administrativ absolutisht i pavlefshem.

2-Ne baze te nenit 21/2 te ligjit nr. 8454, dt. 04/02/1999 “Per Avokatin e Popullit” me ndryshimet e bera, i beme te ditur pezullimin e ketij akti dhe veprimeve ne zbatim te tij, deri ne shqyrtimin dhe kthimin e pergjigjes brenda 10 diteve, si dhe vazhdimin e kryerjes se detyrave ne sherbim te individeve, nga te gjitha zyrat e Bashkise Shkoder.

Praktika e ndjekur nga zyrat e gjendjes civile te cilat kushtezojne sherbimin e gjendjes civile me vjeljen e taksave vendore, bie ne kundërshtim edhe me nenin 64 te Ligjit Nr.8950 date 10.10.2002 “Per Gjendjen Civile”, i cili percakton detyrat e zyres se gjendjes civile ne Bashki dhe Komuna.

Ne kundërshtim me kete nen, Kryetaret e Njesive te Qeverisjeve Vendore, kane nxjerre “Urdher” per kufizimin e Sherbimit te Gjendjes Civile, edhe pse ky sherbim eshte funksion i deleguar prane ketyre njesive.

Duke kërkuar nje zbatim rigoroz te dispozitave ligjore nga Sherbimi i Gjendjes Civile, Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile” prane Ministrise se Brendshme, pasi u informua per kete shtete, hartoi shkresen Nr.4842 prot date 18.07.2007 dhe e dergoi ate ne çdo zyre te gjendjes civile te Bashkive, Njesive Bashkiake dhe Komunave. Pra ceshtja u zgjidh pozitivisht ne rruge institucionale, por ne praktike pavaresisht rasteve sporadike kemi verejtur se vazhdohet me praktika te tilla te gabuara, te cilet cenojne padrejtesisht te drejtat e ligjshme te shtetasve.

4. Ne kete kontekst veçojme dhe ankesën që kemi ndjekur me Njesinë Bashkiake Nr.3 Tiranë, për nëpunësit e gjendjes civile pranë kesaj Njesie Bashkiake,

te cilët refuzojnë pajisjen me çertifikatë të personave që nuk kanë paguar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore dhe refuzimin e shërbimeve të ofruara nga Njësia Bashkiake.

Për kete, me qëllimin e kryerjes së një analize të plotë dhe të saktë të çështjes, kërkuam shpjegime në të gjitha Njësitë Bashkiake Tirane, lidhur me faktin nëse ka ndodhur kjo situatë në këto njësi dhe në rast se po, mbi cilin ligj është bazuar ky veprim.

Në përgjigje të kërkesës tonë, të gjitha njësitë e sipercituara të qeverisjes vendore argumentuan se vepron në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.5 datë 05.02.2007 “Për caktimin e njësive bashkiake si agjent tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore si dhe për një shtesë në numrin e punonjësve në strukturat organizative”. Megjithatë, vetëm disa prej tyre argumentonin se kanë vendosur si sanksion për mospagimin e këtyre detyrimeve mosdhënien e shërbimeve, të cilat ofrohen prej njësive bashkiake, siç mund të jenë vërtetimet si banor lagjeje, vërtetimet për ndihmë ekonomike etj.

Lidhur me kete çështje, i drejtuam rekomandim Ministrin të Financave dhe Ministrin të Brendshëm, për të realizuar inisiativën legjislative në ndryshim të nenit 34, të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, që do të parashikojë në mënyrë të hollësishme procedurën e ekzekutimit të taksave, kur subjekt janë familjarët dhe jo personat fizikë e juridikë të cilët ushtrojnë një veprimtari të caktuar tregtare si dhe për plotësimin e nenit 35, të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10. 2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” duke parashikuar procedurën që ndiqet në rast mospagimi të tarifave vendore.

Por në analizë të kësaj çështjeje kemi konstatuar gjithashtu se:

Këshilli Bashkiak Tirane në vendimin e tij nr.5 datë 05.02.2007, ka caktuar Njësitet Bashkiake në qytetin e Tiranës si agjent tatimor për mbledhjen e dy taksave, “Taksës mbi ndërtesën” dhe “Taksës së Gjelber” dhe “Tarifës vendore të pastrimit” dhe në të njëjtën kohë parashikon se me këto njësi duhet të përgatiten akt-marrëveshjet përkatëse për kete qëllim.

Nga verifikimet tona rezultoi se nga ana e Bashkisë janë përgatitur draft-kontratat me detyrat dhe të drejtat e Bashkisë së Tiranës dhe çdo Njësie Bashkiake, lidhur me administrimin dhe arketimin e këtyre taksave dhe tarifave vendore.

Por duke qenë se ky proces ende nuk është finalizuar, i ka lënë vend kryerjes së veprimeve të paligjshme nga ana e Njësive Bashkiake në rolin e agjentit tatimor.

Kështu u evidentua se derdhja e taksave dhe tarifave pranë njësive bashkiake vërtetohet me dokumentin “mandat arkëtimi”, i cili nuk ka numrin e serisë.

Sa me sipër arriam në konkluzionin se dokumentimi në kete mënyrë i të ardhurave që vijnë si pasoje e derdhjes së taksave dhe tarifave vendore mund të lërë vënd për abuzime. Ky argument përforcohet në kushtet kur në vendin tonë nga organet e qeverisjes vendore nuk ekziston një sistem i dhënash për taksapaguesit dhe tarifepaguesit.

Për sa me sipër, rekomanduam lidhjen e kontratës midis Bashkisë së Tiranës dhe agjenteve tatimore, ku të parashikohen të drejtat e detyrimit të secilës palë në procesin e mbledhjes dhe të administrimit të taksave dhe tarifave vendore, dokumentimin me të gjithë elementet e sigurisë të mundshme të vërtetimit të derdhjes së detyrimit të taksave dhe tarifave vendore nga subjektet përkatëse dhe krijimin e një sistemi të dhënash pranë organeve të qeverisjes vendore për taksapaguesit dhe tarifepaguesit.

Lidhur me kete rekomandim, kemi marrë përgjigje negative vetëm nga Njësia Bashkiake nr.3.

Sa me siper, duke patur parasysh faktin qe ne menyre formale asnje prej Njesive Bashkiake apo organeve te tjera te qeverisjes vendore ne vend nuk pranojne vendosjen e sanksionit te mosdhenies se certifikatave per mospaguesit e taksave dhe tarifave vendore, jemi ne pritje te nje vleresimi nga strukturat pergjegjese te cilave u jemi drejtuar me rekomandim.

Rastet e paraqitura me lart, jane ndjekur me kembengulje dhe perkushtim dhe ne shumicen e tyre jane zgjidhur kerkesat e shtetasve. Por do te permendnim ketu dhe ceshtjen e ndjekur me iniciative nga Zyra jone dhe qe lidhet me *përmirësimin e Ligjit Nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjëndjen civile”*, te cilen e kemi prezantuar ne raportin e vitit 2006, por edhe ne pjesen e marredhenieve me Kuvendin e Shqiperise.

Behet fjale per problemin e mosregjistrimin te fëmijëve në regjistrat e Gjëndjes Civile, sidomos femijve rome dhe ne pergjigje te rekomandimit tone, na eshte kthyer nje pergjigje me shkrim, sipas te ciles eshte ngritur grupi i punes prane Ministrise se Brendshme me eksperte te OSBE-se dhe po punohet per projektligjin per ndryshimin e Ligjit Nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjëndjen civile”, te ndryshuar.

Marredhëniet institucionale me Ministrinë e Brendshme kanë qënë korrekte. Ky fakt është një tregues pozitiv i mirëkuptimit që ky dikaster dhe organet e tij vartëse kanë ndaj rekomandimeve dhe kritikave tona për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë edhe ato të punonjësve të Policisë të cilat meritojnë më shumë vëmëndje. Nëse nuk do të kujdesemi për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të punonjësve të Policisë, nuk mund të kemi të drejtë morale që t’u kërkojmë prej tyre respektimin e të drejtave të të tjerëve.

*
* *

Në vartësi të Ministrisë së Brendshme ndodhet edhe Departamenti i Administratës Publike. Prandaj në këtë kapitull po japim disa nga problemet e funksionimit të administrates publike që janë evidentuar edhe nga raporti i fundit i Komisionit Europian. Këto mund të përmbliidhen si më poshtë:

Mungesa e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil për rekrutimin dhe largimin nga detyra të nëpunësve civilë; eliminimi i emërimeve në bazë të kontratave në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil; eliminimi i emërimeve politike në administratën publike; fuqizimi i kapaciteteve të Departamentit të Administratës Publike; moszbatimi i vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil dhe gjykatave për nëpunësit civilë; zhvillimi i karrierës së nëpunësve civilë dhe rritja e aftësive të tyre nëpërmjet trajnimit; zhvillimi i teknologjive të informacionit në fushën e government; promovimi i etikës në administratën publike.

Kuptohet se këto mangësi qëndrojnë për të gjitha organet e tjera të administrates publike shqiptare, prandaj raporti i KE nënvizon “Funksionimi i administrates publike bazuar mbi parimet dhe kriteret e përcaktuara nga ligji për shërbimin civil nuk ka shënuar përparim”.

6. Ministria e Mbrojtjes

Per vitin 2007 ndaj strukturave te Ministrisë së Mbrojtjes janë bërë 141 kërkesa e ankesa nga subjekte që janë ushtarakë apo ish ushtarakë. Për vitin 2007 janë përfunduar 66 nga ankesa, nga të cilat 4 raste kanë qënë të mbartura nga viti

2006. Janë në shqyrtim edhe 79 ankesa që kanë ardhur në muajt e fundit të vitit 2007. Këto janë kryesisht ankesa të marra gjate organizimit të ditëve të hapura në repartet ushtarake.

Duke analizuar në tërësinë e tyre ankesat e ardhura në Institucionin tonë për vitin 2007, konstatohet se ato janë bërë kryesisht nga oficerë, nënoficerë, nga punonjës civile, ushtarë, si dhe ushtarakë të dalë në rezervë.

Nga ankesat e përfunduara gjatë vitit 2007, rezulton se 18 ankesa ose 27.3 përqind e tyre kanë gjetur zgjidhje pozitive. Në 4 raste ankesat kanë përfunduar duke bërë rekomandime me shkrim që janë pranuar. Ky është një tregues i kënaqshëm që tregon efikasitetin e punës sonë si dhe bashkëpunimin e frytshëm me Ministrinë e Mbrojtjes. Ndërsa 13 ankesa ose 19.7 % kanë qënë jashtë kompetencës tonë, 24 ose 36.4 % kanë qënë ankesa të pabazuara, në 5 raste ose 7.6 % ankesat kanë qënë jashtë juridiksionit. Në 2 raste ose 3% e ankesave kanë përfunduar me heqje dorë nga ankuesi.

Gjatë vitit 2007 zyra e Avokatit të Popullit ka marrë takim me një numër të madh subjektsh ushtarake, të cilët kanë prezantuar ankesat e tyre. Për ato raste që ata kanë gjykuar, ankesat janë me shkrim.

Në përgjithësi objekti i ankesave të prezantuara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2007 ka qënë si vijon:

1. Ankesa për mobilizim në shërbimin ushtarak në kundërshtim me ligjin.
2. Ankesa për keqtrajtim të ushtarëve apo marinarëve nga ana e komandantëve të tyre.
3. Ankesa për pensionin suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
4. Ankesa për mosdhënie e gradës sipas ligjit.
5. Ankesa lidhur me strehimin e ushtarakëve.
6. Ankesa për mënyrën e trajtimit me ushqim.
7. Ankesa për zbatimin e normave të veshmbathjes.
8. Ankesa për kohën e punës dhe pushimit.
9. Ankesa për trajtimin financiar të ushtarakëve.
10. Ankesa për kompesimin e qirasë së banesave.
11. Ankesa për transportin nga vëndi i punës për personelin ushtarak.
12. Ankesa për mospagesën mujore të studentëve të shkollave ushtarake.
13. Ankesa për mospagesën e pagës për bashkëshortin (en) e ushtarakut pas transferimit.
14. Ankesa për pensionet e ulta të ushtarakëve të dalë në rezervë para vitit 1992.
15. Ankesa për moszbatim të ligjit për daljen e ushtarakëve në rezervë.
16. Ankesa kundër Komisionit të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorëve të Atdheut.

Gjatë muajit Tetor dhe Nëntor të vitit 2007 u organizuan ditët e hapura në disa reparte ku kishte grumbullime të mëdha forcash mbi bazën e programit të punës të hartuar në mbështetje të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, të datës 12 mars 2007 “Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit”, ku parashikohej si objektiv, vazhdimi i organizimit të ditëve të hapura, për të pritur ankesat e ushtarakëve në repartet ushtarake. Organizimi i ditëve të hapura në repartet ushtarake gjatë këtij viti u bë i mundur edhe falë një bashkëpunimi të ngushtë me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Major Luan Hoxha dhe Drejtorinë e Personelit pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Organizimi i ditëve të hapura vërtetoi se

është mënyra më efikase, për të larguar ngurimin e kësaj kategorie individësh për të bërë ankesa apo kërkesa lidhur me probleme të ndryshme, që ata i shqetësojnë.

Gjatë organizimit të ditëve të hapura u takuan me rreth 1500 ushtarë, marinarë, oficerë dhe nënoficerë të Forcave të Armatosura. Gjatë takimeve të marra me këto kategori ushtarakësh, nga grupi i ekspertëve të zyrës sonë, ju bë i qartë qëllimi i ardhjes në këto reparte, si dhe ju shpjeguan detyrat dhe kompetencat e zyrës së Avokatit të Popullit. Nga ana tjetër atyre ju prezantuam edhe arritjet e zyrës sonë në takimet e organizuara më parë në këto reparte. Nga takimet individuale që patëm morëm rreth 90 ankesa dhe kërkesa, një pjesë e të cilave janë përfunduar dhe një pjesë e tyre është në shqyrtim nga ana e zyrës sonë.

Takimet u organizuan pa praninë e eprorëve të oficerëve, ushtarëve apo marinarëve që paraqitën ankesat. Bashkëpunimi midis grupit të ekspertëve të Avokatit të Popullit dhe grupit të dërguar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë bëri të mundur që një numër jo i vogël ankesash të paraqitura në ditët e hapura, në një kohë që problemet kishin një kohë të gjatë pa u zgjidhur, morën zgjidhje brenda një kohe të shkurtër.

Më konkretisht:

1. Për ankesat e ngritura nga disa ushtarakë për trajtim me strehim apo shtesë sipërfaqe banimi. Këto çështje janë parashikuar në ligjin nr. 9210, datë 23.03.2004, "Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe konkretisht në nenet 21, 38, dhe 39 si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij. Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes ky problem vazhdon të zgjidhet nëpërmjet: 1. Rritjes së fondit të dhënies së kredive për strehim nga buxheti i shtetit, i cili deri tani ka qënë i kufizuar. 2. Strehimit të ushtarakëve në ambiente të cilat dalin të lira nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura. 3. Nëpërmjet kompesimit të qerave të banesave sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 30.07.2004, i cili është në process rishikimi dhe në të përfshihen edhe propozimet e fundit për përfshirjen në të edhe të nënoficerëve e ushtarëve profesionistë.

Theksojmë me kënaqësi se ajo që nuk ishte bërë për dy vjet rresht, u realizua brenda dy javëve. Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes pasi i janë bërë prezent shkeljet e të drejtave të ushtarakëve nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm është nxjerrë urdhëri për ngritjen e komisioneve pranë Komandave përkatëse për testimin e tregut të qirave të banesave. Më pas u ngrit Komisioni Qëndror në Ministrinë e Mbrojtjes, u ra dakort me Ministrinë e Financave lidhur me vlerën e qirasë dhe në të njëjtën kohë është miratuar fondi prej 85.000.000 lekë për këtë qëllim. Nga kjo përfitojnë rreth 500 ushtarakë aktiv.

2. Për problemin e trajtimit me ushqim nga ana e Drejtorisë së Logjistikës në Shtabin e Përgjithshëm është ngritur një grup pune, i cili ka përgatitur një projekt vendim për përmirësimin e normave të ushqimit. Ky draft i ka kaluar për miratim Qeverisë. Në mbledhjen e datës 28.01.2008 Qeveria ka vendosur rritjen e normave të ushqimit. Me anën e këtij vendimi i është lënë detyrë Ministrisë së Mbrojtjes të përcaktojë një sërë normash të tjera për ushtarakët në varësi të gradës dhe pozicionit që kanë. Ministrinë të Mbrojtjes i është lënë detyrë të nxjerrë udhëzime për të përcaktuar trajtimin me ushqim të gatuar pa pagesë për oficerët nënoficerët dhe ushtarët profesionistë, në rast të qëndrimit në repart mbi 8 orë për arsye gadishmërie, apo trajnime dhe stërvitje në terren, në lloje të ndryshme operacionesh brenda dhe jashtë vëndit. Në këto raste ushtarakët nuk përfitojnë kompesim të ushqimit në vlerë leku.

3. Për problemin e normave të veshmbathjes në Forcat e Armatosura, nga Drejtoria e Logjistikës është përgatitur një draft për rishikimin e tabelave të normave

të veshmbathjes, të ndara këto sipas specifikimeve. Në këtë draft kanë prioritet ushtarët aktiv, ushtarët profesionistë dhe studentët. Është parashikuar rritja e cilësisë së uniformës dhe kualitetit të saj .

4. Lidhur me ankesat për kohën e punës dhe pushimit, Drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm, për të realizuar pushimet në ditët e shtuna do të bënte ndryshimin e programit stërvitor për vitin 2008, duke kaluar nga katër cikle stërvitore në tre cikle stërvitore, me qëllim që të garantohet pushimi i ushtarakëve.

5. Lidhur me ankesat e studentëve të Universitetit Skënderbej i është propozuar Ministrisë të Mbrojtjes një rritje e pagesës mujore për këtë kategori ushtarakësh.

6. Për ankesat e ekuivalentimit të diplomës pas përfundimit të studimeve në universitetin ushtarak “Skënderbej”. Në politikën e arsimit dhe trajnimit të personelit të Forcave të Armatosura është parashikuar që të gjithë të diplomuarit në këtë universitet, duke filluar jo më vonë se viti 2008 do të marrin diplomë ekuivalente me atë të një universiteti civil. Kjo falë një koordinimi edhe me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Universitetit të Tiranës.

7. Për problemin e pagesës së bashkëshortëve (eve) për ata ushtarakë që janë transferuar, specifike kjo për ankuesit për brigadën e stërvitjes në Bunavi, problemi është zgjidhur mbasi Ministria e Mbrojtjes ka alokuar fondet në degën e Bankës dhe Thesarit në Vlorë në dispozicion të komandës së kësaj brigade në Bunavi.

8. Shtetasi S.T. nga Durrësi ka prezantuar pranë nesh ankesën e tij, pasi djali i tij V.T. ishte thirrur në shërbimin e detyrueshëm ushtarak në kundërshtim me ligjin. Ai është thirrur në shërbimin e detyrueshëm ushtarak në një kohë që ishte duke vazhduar vitin e katert të shkollës së mesme. Për këtë, zyra jonë pas pranimit të ankesës dhe verifikimeve të nevojshme i kërkoi shpjegime Drejtorisë së Personel Organizimit pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Në përfundim u njoftuam se për ushtar V.T. është përgatitur urdhëri për ndërprerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Të kësaj natyre janë edhe 8 ankesa të tjera të cilat u paraqitën gjatë ditëve të hapura dhe që i kemi akoma në shqyrtim.

9. Në Brigadën e Stërvitjes në Bunavi ushtar F.L. u ankua se nga ana e Instruktorëve të Qendrës së Stërvitjes Bunavi ishte keqtrajtuar. Ai pretendonte se Instruktorët në qendrën ku ai stërvitet fyejnë ushtarët, i rrëzojnë nga krevati, përdorin fjalë fyese etj. Për të bërë të mundur zgjidhjen e kësaj ankese, i kërkua shpjegime komandantit të Brigadës së Stërvitjes Bunavi, i cili u përgjigj se nuk ka patur raste të veprimeve që pretendonte ankuesi. Por përpjekjet tona për të zbuluar dhe për të parandaluar ankesa të kësaj natyre vazhdojnë.

10. Ankesat e ushtarakëve apo ish ushtarakëve që ndërpresin karrierën apo e kanë ndërprerë atë kohë më parë në kuadrin e reformës në Forcat e Armatosura qysh nga viti 1992 e në vazhdim, zënë një vënd të konsiderueshëm. Këta persona ankohen se jo vetëm që masa e pensionit të tyre është më e ulët se pensioni i kolegeve të tyre që kanë dalë në pension pas vitit 1993, edhe pse kanë qënë të barazvlefshëm në detyrë, por ata kundërshtojnë edhe iniciativën e Kryeministrit, për të ndryshuar ligjin nr. 9418 datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Kërkesa apo ankesa të kësaj natyre kanë paraqitur jo vetëm individë të caktuar, por edhe shoqata e grupime të tjera ish ushtarakësh. Dihet që kjo çështje vazhdon të mos gjej zgjidhjen e duhur.

11) Ka edhe ankesa të tilla si ajo e ushtarakut T.K i cili është ankuar se jo vetëm është larguar padrejtësisht nga puna, por se i është mohuar edhe e drejta për të marrë me shkrim një vendim të largimit nga puna kurse .E.V ka pretenduar se ka

punuar prej një kohe të gjatë oficer aktiv me gradën kapiten i parë . Në kohën që do të gradohej atë e nxjerrin në rezervë. Pavarësisht se është e drejta e Komisionit të Lartë të Karrierrës, i cili ka autoritetin për vlerësimin e ushtarakut për të përparuar në gradë, ne mendojmë se në përzgjedhjen e efektivit për të nxjerrë në rezervë duhet të ketë më shumë qëndrime objektive e të vlerësohen më tepër edhe të drejtat e ushtarakëve.

12. Numri i përgjithshëm i ankesave të ardhura për vitin 2007, kundër Komisionit të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorit të Atdheut ka qënë 13 ankesa ose rreth 9 (përqind) e numrit të ankesave të regjistruara për vitin 2007. Mënyra e përfundimit të tyre ka qënë: 2 ankesa janë zgjidhur në favor, 1 ankesë kanë qënë jashte kompetence, 7 ankesa të pabazuara, kurse 3 janë në shqyrtim. Objekti i ankesave të paraqitura ka qënë për përfitimin e Statusit të Veteranit, për Statusin e Dëshmorit, apo dhe për përfitime shtesë që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.190, datë 03.05.1995, për veteranët të cilët gjatë luftës kanë qënë në burgjet nazifashiste brënda apo jashtë vëndit.

Qysh në fillim konstatojmë se, Ministria e Mbrojtjes në vite ka bërë vlerësimin e veteranëve duke paraqitur projektet e nevojshme dhe Qeveria ka nxjerrë vendimet përkatëse “Për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të LANÇ-it të popullit shqiptar” etj.

Nga shqyrtimi i disa ankesave për këtë kategori personash, (veteranët e luftës) doli se dokumentat e paraqitura prej tyre pranë Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit, janë paraqitur jashtë afatit ose paraqitja e dokumentave me vonesë është bërë mbi bazën e një vendimi të gjykatës për rivendosjen e afatit.

Lidhur me këtë problem, edhe me ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, doli Vendimi i K.M. nr. 748 datë 11.11.2004 “Për një ndryshim në vendimin nr. 190, datë 03.05.1995 “Për Statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional- Çlirimtare të Popullit Shqiptar , të ndryshuar. Sipas nenit 1 të këtij vendimi, Komisioni Qëndror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional - Çlirimtare dhe stafi i tij teknik, të vazhdojë veprimtarinë e tij edhe për vitin 2004 deri më 31.12.2006, vetëm për personat që e fitojnë këtë status me vendim gjykate të formës së prerë. Siç shihet, detyrohet Komisioni të vazhdojë veprimtarinë e vet vetëm për kërkesat për Statusin e Veteranit të cilat janë njohur me vendim gjykate duke lënë si afat përfundimtar 31 dhjetorin e vitit 2006. Krahas mundësisë që i dha vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave ankuesve lidhur me përfitimin e statusit nëse plotësoheshin kërkesat e parashikuara në aktet ligjore për këtë qëllim, edhe zyra e Avokatit të Popullit u angazhua totalisht në ndihmë të ankuesve, të cilëve ju rekomandoi që të kundërshtonin vendimin administrativ që kishte bërë refuzimin e statusit të tyre. Për këtë, në disa raste ju kemi pergatitur ankuesve draftin e kërkesë padisë për kundërshtim akti. Por nga ana e Veteranëve që pretendonin se ishin të tillë, nuk u bënë përpjekjet e duhura ligjore për të marrë statusin e pretenduar. Tani ata vazhdojnë ta kërkojnë atë, ndonëse me vendim të Këshillit të Ministrave veprimtaria e Komisionit për Statusin e Veteranit është mbyllur që në 30 Korrik 2002.

Gjatë viteve 2004, 2005, 2006, 2007 në zyrën e Avokatit të Popullit kanë prezantuar ankesat e tyre për zvarritje në shqyrtimin e kërkesave të tyre për dhënien e Statusit të Dëshmorit të Atdheut 25 persona. Në disa raste ata edhe i kanë përsëritur ankesat e tyre.

Nga viti në vit janë grumbulluar gjithsej 491 dosje me kërkesa për dhënien e statusit të Dëshmorit të Atdheut, të cilat prisnin mbledhjen e Komisionit përkatës për

të shqyrtuar kërkesat, por ende edhe sot një pjesë e mirë e këtyre ankesave kanë ngelur pa u shqyrtuar nga Komisioni.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 54 datë 31.01.2007, caktonte afatin prej 45 ditësh për shqyrtimin në kohë të kërkesave të shtetasve Shqiptar për shpalljen dëshmor të të afërmëve të tyre rënë gjatë luftës apo në krye të detyrës. Për mosfunksionimin e Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorëve të Atdheut, Zyra jonë i dërgoi Zv/Kryeministrit Z.Gazmend Oketa si kryetar i këtij Komisioni, rekomandimin për shqyrtimin e dosjeve të prapambetura të Komisionit Qëndror të Dëshmorëve të Atdheut, sipas Vendimit të mësipërm “Duke e ndjekur problemin në vazhdimësi, më datë 14.12.2007 verifikuam pranë stafit teknik në Ministrinë e Mbrojtjes se, nga 491 dosje të prapambetura janë marrë në shqyrtim 40 prej tyre dhe janë përgatitur për shqyrtim edhe 70 dosje të tjera për t’i shqyrtuar brenda vitit 2007”. Siç shihet angazhimet e marra kishin ngelur vetëm fjalë. Për këtë më 18 dhjetor 2007 i dërguam Zv. Kryeministrit rekomandimin tjetër për marrjen e masave për përshpejtimin e procedurave të shqyrtimit të kërkesave për Statusin e Dëshmorit të Atdheut. Në përgjigje të rekomandimit tonë, kabineti i Zv. Kryeministrit na informoi për masat e marra për të përfunduar në një kohë sa më të shpejtë shqyrtimin e rasteve të paraqitura.

Me shkresën nr. 114 datë 11.01.2008 kabineti i Zv/Kryeministrit na njofton se: “Komisioni Qëndror i Dëshmorëve të Atdheut mbledhet në mënyrë periodike për shqyrtimin e dosjeve të prapambetura. Mbledhja e fundit e këtij Komisioni u zhvillua në muajin dhjetor 2007, në të cilën u shqyrtuan rreth 70 dosje, gjë e cila e çon numrin e dosjeve të shqyrtuara në 120 nga 491 dosjet e prapambetura. Vet procesi i diskutimit të kërkesave, interpretimit të ligjit për çdo kërkesë është një proces delikat, jo i lehtë, për të cilin çdo antar i Komisionit angazhohet maksimalisht. Komisioni Qëndror ka vendosur organizimin e mbledhjeve çdo 2-3 javë me qëllim përfundimin e shqyrtimit të dosjeve të prapambetura. Shpresojmë që më në fund të marrë zgjidhje ky problem”.

Një prioritet i rëndësishëm i punës së Avokatit të Popullit që nga viti 2000 ka qënë zgjidhja e ankesave të ushtarakëve aktiv në lidhje me trajtimin e tyre financiar, për shkak të natyrës së vështirë të punës apo punës me orar të zgjatur etj. Në raportet e mëparshme Avokati i Popullit ka rekomanduar nevojën e trajtimit financiar më të mirë të ushtarakëve aktiv si dhe çeljen e fondeve për trajtimin financiar edhe të ushtarakëve të dalë në rezervë apo lirim. Me V.K.M-në nr.791, datë 26.11.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.839. datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e ushtarakëve aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë,” janë bërë shtesa në pagë për punë të vështira të ushtarakëve aktiv, shtesa për kushte të veçanta pune dhe shërbimi, shtesa në pagë sipas gradës dhe viteve të shërbimit si dhe shtesa për punë të vështira dhe të dëmshme për shëndetin. Këtë ne e vlerësojmë si një arritje të suksesshme për realizimin e objektivave tona në mbrojtje të të drejtave të ligjshme të njeriut. Duke marrë shkas nga ankesat e grumbulluara në Ditët e Hapura për problemin e trajtimit financiar të ushtarakut të Forcave të Armatosura (paga e pamjaftueshme), veçanërisht për pagat e ulta dhe shtesat mbi pagë për dëmtim shëndeti u bë e mundur që, në zbatim të urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes, nr. 535, datë 23.04.2007, “Për krijimin e grupit të punës për rishikimin e trajtimit me pagë e shtesë mbi pagë të ushtarakëve dhe studimin e pagave të nëpunësve sipas strukturës së pagës së institucioneve në varësi të Ministrisë së linjës” grupi i punës të përgatisë propozimet përkatëse të cilat Ministri i Mbrojtjes i ka dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave.

Është kënaqësi të përsërisim konstatimin tone se Ministria e Mbrojtjes është një nga dikasteret e Administratës sonë Publike ku ne gjithmonë, qysh në fillim të veprimtarisë sonë në vitin 2000, kemi gjetur partnerë të gatshëm për të bashkëpunuar në mënyrë institucionale, me qëllimin e mirë dhe të vetëm për zgjidhjen e drejtë të problemeve dhe shqetësimeve të ushtarakëve.

Bashkëpunimi i mirë me Ministrinë e Mbrojtjes është realizuar në kontaktet direkte me drejtues dhe specialistë të drejtorive përkatëse, të ngarkuara për problemet dhe shqetësimet e ankesave të ushtarakëve dhe të Veteranëve. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe informacionet e dërguara Ministrisë të Mbrojtjes ku parashtrijmë ankesat dhe problemet e pazgjidhura.

Në prioritetet e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit edhe për vitin 2008 do të jetë organizimi i Ditëve të Hapura dhe inspektimeve me grup ekspertësh në reparte të ndryshme, të Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare, me qëllim tërheqjen e ankesave nga ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e Forcave tona të Armatosura si dhe bashkëpunimi më i ngushtë me Drejtoritë e ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes dhe strukturat e tjera ushtarake për zbatimin korrekt të ligjit dhe zgjidhjen e drejtë të ankesave të ushtarakëve apo edhe të punonjësve civilë që punojnë në Forcat tona të Armatosura.

7. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Numri i ankesave të shqyrtuara nga Institucioni ynë lidhur me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSHB) si dhe të institucioneve në varësi të saj, Institutin e Sigurimeve Shoqërore Shtetërore, Shërbimin Social Shtetëror dhe strukturat e tyre në rrethe ka qenë 253. Kurse 31 ankesa kanë qenë për vetë Ministrinë. Nga keto janë përfunduar 29 ankesa. Kanë rezultuar 6 ankesa të pabazuara, 6 jashtë juridiksionit, 8 për kompetencë, 8 të zgjidhura në favor të ankuesve, 1 heqje dore dhe janë në proces shqyrtimi 2 ankesa. Gjithashtu janë shqyrtuar dhe përfunduar 3 ankesa të mbartura nga viti 2006 dhe kanë rezultuar 1 ankese e pabazuar, 1 ankese jashtë kompetencë dhe 1 **ankese e zgjidhur** në favor të ankuesve.

Në vijim po trajtojmë disa nga problematikat e ankesave që janë shqyrtuar:

1. Një grup pensionistësh të fshatit Drenovë paraqitën ankesë ndaj Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në lidhje me diferencat ndërmjet pensioneve para vitit 1993 dhe atyre pas këtij viti. Ankuesit e konsideronin veten të diskriminuar nga diferenca e madhe e përfitimit midis këtyre dy grupeve të mëdha pensionistësh, si një shkelje të të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme dhe të barazisë përpara ligjit.

Pasi kërkua shpjegime shkresore nga kjo Ministri, u informua se pas vitit 1993, kur u miratua dhe filloi zbatimi i ligjit të ri të sigurimeve shoqërore, linden pabarazi në masën e pensioneve për individë që kanë kontribuar në mënyrë të barabartë. Kjo për arsyen e indeksimit të pabarabartë të masës së pensioneve me prioritet pensionet e vogla si dhe të ligjit të ri të pensioneve që ndryshoi edhe menyrat e përlogaritjes së masave të pensioneve dhe të normave të kontributeve. Kjo dukuri bëri që të ngushtohen diferencat midis masës së pensionit maksimal dhe atij minimal. Për të zbutur këtë dallim të diferencës së pensioneve kanë dalë dhe janë zbatuar në vite disa Vendime të Këshillit të Ministrave. Me miratimin dhe zbatimin e Ligjit nr.9588 datë 25.07.2006 ‘‘Për rilogaritjen e pensioneve’’, u realizuan disa

permiresime ligjore. Do te vazhdohet perseri me permiresime ne aktet ligjore dhe nenligjore per te zbutur dhe ngushtuar diferencat ne masat e pensioneve.

2. Federata e Sindikatave te Pensionisteve Kucove kerkonte nga Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta zbatimin e Marreveshjes se Madridit 2002 ne lidhje me Statusin e Pensionisteve. Kjo sindikate kerkonte nga kjo ministri te ndermarre nismat ligjore per hartimin e Statusit te Pensionisteve.

Pas informacionit te kerkuar edhe ne Institutin e Sigurimeve Shoqerore Tirane, na u shpreh angazhimi per dhenien e kontributit te institucionit te tyre ne grupin e punes per pergatitjen e statusit te pensionisteve. Ky angazhim i hap rrugen edhe konkretizimit te shqetesimit te ligjshem te Sindikatave te Pensionisteve, per pajisjen e nje statusi te standarteve nderkombetare ne mbrojtje te te drejtave dhe interesave te antareve te tyre.

3. Nje grup te moshuarish te Azilit Tirane paraqiten kerkesen e tyre per permiresimin e kushteve te jeteses ne ambjentet e ketij Azili si dhe per largimin nga kjo qender rezidenciale te nje te moshuari, R.Sh, i cili paraqiste rrezikshmeri te theksuar shoqerore ne ate kolektiv.

Pasi kerkuam shpjegime shkresore, nga ana e inspektoreve te Sherbimit Social Shteteror u realizua nje takim pune me drejtorin dhe stafin e Shtepise se te Moshuarve Tirane, ku u diskutuan te gjitha ankesat e tyre duke iu shpjeguar te gjitha hapat e ndermarra nga MPCSSHB, per zbatimin e standarteve te miratuara per ofrimin e sherbimeve sociale ne kete institucion. Gjithashtu te moshuarve iu parashtruan arsyet specifike te verberise qe ben te pamundur transferimin e te moshuarit R.SH nga qendra e tyre. Kjo zgjidhje u arrit me konsensusin e te moshuarve dhe me nje angazhim me te madh te stafit te kesaj qendre rezidenciale per te punuar me program te vecante me kete te moshuar.

Fale nderhyrjes sone, u be e mundur zgjidhja e problemit te tyre, duke terhequr vemendjen organeve perkatese ndaj problemeve te te moshuarve.

Pavarësisht mospasjes së ankesave konkrete për kushtet e punës dhe sigurimin teknik, mund të themi se viktimat dhe problemet e bëra publike herë pas here në Mediat e ndryshme, flasin se duhet bërë një punë e madhe nga inspektoriatet e ndryshme në vartësi të kësaj Ministrie për të garantuar shëndetin dhe jetën e punonjësve si në shërbimin publik ashtu edhe në sektorin e punësimit privat.

a. Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Gjatë vitit 2007 pranë Institucionit tonë janë paraqitur 207 ankesa drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe strukturave në varësi të tij. Janë përfunduar 185 ankesa. Nga këto ankesa kanë rezultuar 60 të pabazuara, 39 jashtë juridiksioni, 55 jashtë kompetence, 4 heqje dorë dhe 27 te zgjidhura në favor të ankuesve. Aktualisht në proces shqyrtimi janë 22 ankesa.

Gjithashtu janë shqyrtuar dhe përfunduar 14 ankesa të mbartura nga viti 2006. Nga këto ankesa, kanë rezultuar 7 të pabazuara, 4 jashte kompetence, 1 jashte juridiksioni dhe 2 të zgjidhura në favor të ankuerve.

Konstatojmë se problematika që ngrihet në ankesat e qytetarëve është pothuajse e njëjtë si në vitet e tjera paraardhëse. Konkretisht qytetarët ankohen për masën e përfitimit të pensionit te pleqërisë, mosnjohjen e vjetërsisë në punë, mosdhënien e invaliditetit nga Komisionet përkatëse të Caktimit të Aftësisë për Punë, mospërfitimin e shtesave të pensionit të pleqërisë, zvarritje burokratike nga organet kompetente, për kohën e daljes në pension, mospërfitimin e pensionit familjar, mospërfitimin e pensionit si nënë me shumë fëmijë, sigurimin e

detyrueshëm për personat e vetëpunësuar në bujqesi, derdhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore për pensionistët që zhvillojnë aktivitet privat, për mosperfitim të kompensimit të energjise elektrike etj.

Përgjithësisht nga këto ankesa kemi evidentuar se shpesh herë ankuesit, kryesisht për mosnjohje të Ligjit, nuk kanë konsumuar shkallët e ankimit administrativ në Komisionet e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore si dhe në Komisionin Qëndror të Ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në këto raste ndihma jonë juridike ka qenë e favorshme duke i dhënë mundësinë qytetarit të qartësohet për problemin e tij, pa i hyrë procedurave të zgjatura administrative nëpërmjet komisioneve. Këtë veprim ua kemi orientuar që ta kryejnë në një moment të dytë, në qoftëse nuk mbeten të kënaqur dhe më pas t'i drejtohen komisioneve përkatëse të Apelit.

Gjithashtu nga ana e Institucionit tonë është bërë një punë jo e vogël për informimin e qytetarëve për zhvillimet e herë pas hershme lidhur me përmirësimet në Ligjin “Për Sigurimet Shoqërore” si dhe mbajtjen në kontakt të vazhdueshëm të tyre për fazat e rishikimit të këtij legjislacioni. Kjo sepse është konstatuar fakti se shumë qytetarë kur i drejtohen Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore marrin përgjigje në mënyre verbale dhe jo shkresore, duke mos u qartësuar për kërkesat e tyre.

Në vijim po paraqesim disa çështje të përfunduara gjatë vitit 2007, të cilat kanë rezultuar të zgjidhura pozitivisht:

1. Nga ana e Institucionit tone, pas publikimit në Tv.News 24, me iniciative, është shqyrtuar ankesa mbi mosperfitimin e statusit të invalidit paraplegjik-tetraplegjik të dy vajzave nga Gramshi. Kontaktoam me të atin e vajzave dhe ai ankohej se me miratimin e Ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, ku u hoq kriteri i shkakut për perfitimin e statusit të invalidit paraplegjik-tetraplegjik, vajzat e tij duhet ta perfitonin këtë status.

Nga ndërmjetesimi ynë aktiv me organet kompetente, u arrit që nga ana e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë në Elbasan, të bëhej rivlerësimi i gjendjes mjekësore të të dy vajzave dhe me vendimin e tyre ky Komision vendosi që vajzat të perfitonin Statusin e Invalidit Paraplegjik-Tetraplegjik.

2. Qytetari Xh.F, banues në qytetin e Vlores ankohej ndaj Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlore se pensioni i plotë i pleqërisë nuk i jepej në masën e duhur. Ankuesi shprehte shqetësimin për mënyrën e llogaritjes së pensionit të tij të pleqërisë. Ai kishte një vjetërsi pune prej 42 vitesh. Megjithatë edhe pse për periudhën 3 vjeçare (1984-1987), nuk dispononte dokumentacion, për arsye të djegies së dokumentave, ankuesi pretendonte se masa e tij e pensionit duhet të ishte me e madhe.

Për zgjidhjen e këtij problemi i kërkuam shpjegime shkresore Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Vlore. Nga ana e këtij organi pasi u bënë verifikimet e duhura, rezultoi se pretendimi i ankuesit ishte i drejtë dhe problemi u zgjidh pozitivisht.

Në këtë mënyrë në bazë të ndërmjetësimit tonë u bë e mundur rillogaritja e masës së tij të pensionit dhe qytetarit iu njoh e drejta ligjore e përfitimit të shtesave të pensionit të pleqërisë, duke marrë në konsideratë edhe periudhën e sigurimit nga viti 1984 – 1987.

3. Qytetari B.C me banim në Fushe – Krujë paraqiti ankesë ndaj Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Durrës, me ane të të cilit pretendonte se që nga muaji Shkurt 2007 i ishte ndërprerë pa të drejtë pensioni i invaliditetit.

Pas kërkesave tona për shpjegime, lidhur me pretendimin e ankuesit, ceshtja u zgjidh përfundimisht dhe me Vendim të Komisionit Epror të Caktimit të Aftësisë për Punë, ankuesit iu njoh e drejta e cenuar.

4. Qytetari S.D nga Shkodra ankohej ndaj Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Shkodër se kishte paraqitur vazhdimisht kërkesa për të paguar sigurimet shoqërore vullnetare për një periudhë dy vjeçare. Ankuesi shprehte shqetësimin se për të përfituar pensionin e pleqërisë, i duheshin edhe dy vjet vjetërsi pune, prandaj kerkonte sigurimin vullnetar. Por pretendimi i tij ishte se ai institucion nuk ia jepte këto të drejta.

Pas nderhyrjes së Zyres sonë pranë atij Institucioni, u sqarua ankuesi dhe e njoftuam që se bashku me dokumentacionin e plotësuar të paraqitëj pranë zyrave të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër për të zgjidhur problemin e tij.

5. Qytetari H.K, banues në Gramsh ankohej për zvarritje të lidhjes së pensionit të pleqërisë për gruan e tij R.H. Megjithatë nga Zyra e Gjendjes Civile në Gramsh ishte bërë rregullimi i emrit të saj, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Elbasan i ishte kthyer përgjigje se për të përfituar të drejtën e saj, ankuesja duhet të ndiqte rrugën gjyqësore. Për shqyrtimin e ankesës i kerkuam shpjegime shkresore asaj Drejtorie, mbi arsyet e zvarritjes së këtij problemi.

Pas nderhyrjes së Zyres sone u bë e mundur zgjidhja pozitive e ankesës dhe qytetares R.H iu lidh pensioni i pleqërisë konform legjislacionit në fuqi, pa ndjekur rrugën gjyqësore.

6. Qytetari B.N. me banim në Korçë, paraqiti ankesë ndaj Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë në lidhje me mospërfitimin e pensionit familjar për tre vajzat e tij. Përfitimin e pensionit familjar ankuesi e kërkonte pasi i kishte vdekur bashkëshortja dhe gjatë viteve të fundit të jetës së saj, ajo kishte përfituar pension invaliditeti për shkak të sëmundjes në zemër dhe dosja përkatëse e saj ishte mbyllur pas vdekjes.

Pas vdekjes së bashkëshortes, ai ishte drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Korçë, që fëmijët e tij të përfitonin pensionin familjar, bazuar në Nenin 40 të Ligjit 7703 dt. 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, meqenëse të tre vajzat ishin të mitura. Në ankesën e tij, qytetari sqaronte se e drejta e përfitimit të këtij pensioni i ishte mohuar nga ana e atij institucioni.

Për këtë ankesë kerkuam shpjegime shkresore pranë DRSSH-Korçë dhe u bë e mundur zgjidhja pozitive e ankesës. Sipas shkresës tyre me ndryshimet e bëra në Ligjin nr. 9377 date 21.04.2005, të dy vajzat e mitura nën 18 vjeç përfituan një pension familjar të pjesshëm në masën 50%.

Po kështu duhet të theksojmë faktin se nga trajtimi i mjaft ankesave, të cilat pas shqyrtimit kanë rezultuar të pabazuara, është bërë punë për sqarimin ligjor të problemeve të parashtruara nga ankuesit.

Në bazë të të gjitha evidentimeve, statistikave dhe observimeve të nxjerra si dhe bazuar në rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit që ndikon dhe përçon vizionin e mirëqeverisjes, është arritur në konkluzionin se Qeveria Shqiptare së bashku me institucionet e tjera përkatëse, me gjithë arritjet e deritanishme, duhet të jetë më efektive, më reale dhe më e përgjegjshme në politikën që lidhen me fushën e sigurimeve shoqërore.

Ky konkluzion ka dalë pasi shumica e ankuesve problemin e masës së pensionit që ata përfitojnë, e shohin në këndvështrimin e një diskriminimi që u bëhet atyre nga shteti për punën që ata kanë bërë për vite me radhë. Ata kërkojnë të ketë

edhe një bazë më të mirë për politikën që ndjek shteti në fushën e sigurimeve shoqërore. Megjithatë kohë pas kohe janë bërë përmirësime ligjore në këtë fushë, përsëri vihet re se ka kundërthënënie, evazivitet, diferenca të masës së pensioneve të qytetarëve në kushte të njëjta pune etj. Por këto ndryshime dalin jashtë juridiksionit të veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit.

Konkretisht, në këtë kuadër, duke marrë shkas nga ankesat e qytetarëve, po paraqesim problematikat e mëposhtme:

- *Së pari*, në lidhje me trajtimin e diferencuar të minatorëve.

Shumë ankesa të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntoke, ngrejnë shqetësimin se ka një diferencim të masës së pensionit që marrin. Ata kërkojnë të kenë një status të vacantë si dhe të rriten pensionet aktuale.

Duke i vlerësuar si të drejta shqetësimet e tyre kemi ndërhyrë pranë organeve kompetente. Nga ana e Ministrisë Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta na është konfirmuar fakti se me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9356 datë 17.03.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.8685 datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, u vendos që trajtimi i punonjësve të nëntokës të rritet ose të indeksohen sa herë dhe në masën e rritjes së pensioneve dhe më e rendësishmja është që periudha gjatë të cilave përfitohet ky trajtim të njihet si vjetërsi pune.

Për këtë problem, Ministria e Financave po përgatit projekt-vendimet përkatëse për rritjen e pensioneve dhe të gjitha përfitimeve të tjera, kurse në Kuvend ndodhet projekt-ligji “Për statusin e minatorit”.

-*Së dyti*, për rillogaritjen e pensioneve të pleqërisë për periudhën 01.01.1994 – 31.12.1996, problem të cilën e kemi parashtruar edhe në raportin vjetor 2006.

Sipas Ligjit nr.9588 datë 25.07.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”, në nenin 2 citohet:

“Pensionet e pleqërisë në qytet, që kanë datë fillimi datën 01.01.1994 deri më 31.12.1996, përfshirë edhe këtë datë dhe që vazhdojnë të paguhën pas datës 01.07.2006, rillogariten duke indeksuar pagat, mbi të cilat është llogaritur baza e vlerësuar dhe pagën neto, sipas koeficientëve të indeksimit, të miratuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave...”

Pretendimi i të gjithë ankuesve që kanë fituar të drejtën e daljes në pension pleqërie gjatë vitit 1994, është se akoma nuk kanë përfituar nga ky Ligj, megjithatë në të përcaktohet se përfiton dhe kjo kategori e pensionistëve.

Konkretisht, sipas VKM nr.590 datë 31.08.2006 “Për zbatimin e Ligjit nr.9588 datë 25.07.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”, paragrafi I - Për rillogaritjen e pensioneve të caktuara nga data 01.01.1994 deri me 31.12.1996 përcakton se:

1. Në zbatim të nenit 2 të Ligjit nr.9588 datë 25.07.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”, pensioneve që kanë datë fillimi nga data 01.01.1994 deri me 31.12.1996, përfshirë dhe këtë datë, u indeksohet paga mbi të cilën është llogaritur baza e vlerësuar dhe paga neto, për periudhën nga data 01.01.1994 deri në datën e fillimit të pensionit individual, por në çdo rast brenda periudhës 01.01.1994 deri më 31.12.1996.

2. Indeksimi bëhet sipas procedurave dhe koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar individuale, pas vitit 1994, sipas viteve, përcaktohen në Vendimin nr.400 datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual për llogaritjen fillestare të pensioneve”.

Kështu në VKM nr.400 datë 21.06.2006 përcaktohen koeficientët edhe për vitin 1994. Por sipas pikës 2 efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi janë vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 01.01.2006.

Pra, siç shihet, në aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit të sipërcituar nuk ka konsekuencë ligjore në parashikimet përkatëse të bëra, pasi nuk është e përfshirë kategoria e pensionistëve që kanë përfituar të drejtën e daljes në pension pleqërie gjatë vitit 1994.

- Së treti “Për rillogaritjen e pensioneve të pleqërisë në qytet për periudhën Tetor-Dhjetor 1993”, periudhë e cila nuk ishte përfshirë në Ligjin nr.9588 date 25.07.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”.

Për këtë problem, siç jemi shprehur dhe në raportin vjetor 2006, nga ana e Zyrës sonë u dërgua Rekomandimi Ministrit të Financave, Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si dhe Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për marrjen e një nisme ligjore për plotësimin e Ligjit të sipërcituar, konkretisht të nenit 2, me formulimin: periudha 01.01.1994 – 31.12.1996 të ndryshohet në periudha 01.10.1993 – 31.12.1996.

Sipas shqyrtimit të këtij rekomandimi nga ana e Ministrit të Financave, në përfundim të përgjigjes së dhënë është sqaruar se, me qenë se efektet e llogaritjes së pensioneve të periudhës 1.10.1993 deri 31.12.1993, me kriteret që parashikon Ligji nr.9588 datë 25.07.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve” do të ishin zero, nuk do të ishte nevoja për të ndryshuar ligjin e sipërcituar, duke futur si subjekt pensionet e përfituara gjatë periudhës 1.10.1993 deri 31.12.1993.

Mbi bazën e rekomandimit të paraqitur dhe të përgjigjes që u dërgua nga ana e Ministrit të Financave, kërkuam edhe mendimin e ekspertëve të fushës së sigurimeve shoqërore, duke nxjerrë për këtë qëllim një vendim për akt-ekspertimi. Në përfundim të këtij akt- ekspertimi dhe të pyetjeve të parashtruara nga ana jonë për sqarim, nga ana e ekspertit përkatës, z.Fadil Kepi është nxjerrë konkluzioni se, edhe nëse do të përfshihen për trajtim pensionet e periudhës së sipërcituar në Ligjin “Për rillogaritjen e pensioneve”, kjo gjë nuk do të kishte efekt, pra nuk do të ndikonte në masën e pensionit të pleqërisë për këtë kategori përfituesish.

Në funksion të përmirësimeve të mundshme që mund të rezultojnë pozitive, Zyra jonë është në vazhdimësi të proceseve të rishikimeve dhe analizave të legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore, proces i cili do të pasohet me rekomandimet përkatëse në këtë fushë.

Së fundi, duhet të theksojmë se bashkëpunimi ndërmjet Institucionit tonë me administratën qendrore dhe lokale të Sigurimeve Shoqërore ka qenë rezultativ, duke vërejtur një përgjegjshmëri në rritje të asaj administrate.

b. Sherbimi Social Shtetëror

Ankesa të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit drejtuar Shërbimit Social Shtetëror për vitin 2007 rezultojnë **15**. Nga këto janë përfunduar **11** ankesa, nga të cilat, **5** ankesa në favor të ankuesve, **1** ankese jashtë juridiksioni, **3** ankesa jashtë kompetence, **2** ankese heqje dorë dhe janë akoma në proces shqyrtimi **4** të tjera.

Gjithashtu janë shqyrtuar dhe përfunduar 4 ankesa të mbartura nga viti 2006. Nga këto ankesa, kanë rezultuar 1 e pabazuar, 1 jashtë juridiksioni dhe 2 të zgjidhura në favor të ankueve.

Kryesisht këto ankesa kanë konsistuar në pretendime për masën e përfitimit të ndihmës ekonomike, për ndërprerjen e ndihmës ekonomike, mospërfitim te

pagesës së kujdestarisë, vendosjen e femijeve ne qendra rezidenciale te perkujdesit shoqeror etj.

Në vijimësi po paraqesim disa nga ankesat më tipike të trajtuara në këtë fushë:

1. Qytetari B.H me banim në Durrës, ankohej për mosrritjen e masës së ndihmës ekonomike nga ana e Zyrës së Ndihmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale pranë Bashkisë Sukth - Durres.

Pasi kryem verifikimet e nevojshme pranë kësaj zyre, në bazë të Ligjit nr.7501 dt.01.08.1991, u informuam se qytetari ishte trajtuar me tokë. Duke parë gjëndjen e vështirë të familjes së tij, ga ana e Bashkisë Sukth, që në muajin Qershor ishte trajtuar me ndihmë ekonomike ne masen 2000 lekë në muaj.

Kjo masë e ndihmës ishte përcaktuar në bazë të fondit të miratuar në buxhetin e vitit 2007 dhe numrit të kërkesave nga familjet në gjendje të vështirë ekonomike.

Për vitin 2008 meqënese dhe numri i kërkesave të familjeve në nevojë eshte i madh, kjo bashki ka menduar se fondi për këtë qëllim do të jete në një masë më te madhe, si rrjedhojë dhe masa e ndihmës ekonomike për familjen e tij do të jete më e madhe.

Lidhur me këtë çështje e sqaruam dhe ankuesin.

2. Qytetari Z.B. banues në Komunën Velipojë Shkoder, paraqiti kërkesën e tij lidhur me mundësinë e rifutjes së tij në skemën e ndihmës ekonomike, për perfitimin përsëri të ndihmës ekonomike.

Konkretisht shprehej se kishte qënë përfitues i ndihmës ekonomike për nje periudhë prej 5 vjetësh, deri në muajin Prill të vitit 2006 dhe pretendonte se i ishte ndërprerë kjo ndihmë nga zyra e Ndihmës dhe Përkrahjes Sociale të Komunës së Velipojës në Shkodër.

Pasi morëm në shqyrtim ankesën e bërë nga ky shtetas, e informuam se problemi i tij ishte shqyrtuar në mbledhjen e Këshillit të Komunës, me datën 03.09.200. Ky i fundit kishte marrë vendimin që ai të rifutej përsëri në skemën e ndihmës ekonomike, kundrejt plotësimit të dokumentacionit mbi bazën e Ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”.

3. Qytetari N.R. ankohej për ndërprerje pa te drejte të ndihmës ekonomike nga Njesia Administrative nr.11, Tiranë.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj ankese, i kërkuam informacion Zyrës së Ndihmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale prane kesaj Njesie. Nga ana e tyre u informuam se ky ankues nuk ishte më banor i njesise se tyre, por ishte transferuar me banim ne Njesise Administrative nr.9, Tiranë.

Pas përfundimit të shqyrtimit të kësaj ankese, e sugjeruam qytetarin se duhej të paraqitej pranë Zyrës së Ndihmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale pranë Njesise Administrative nr.9, sëbashku me dokumentacionin përkates për t’u futur në skemën e ndihmës ekonomike.

4. Qytetarja L.D, banuese në fshatin Sheqeras – Korçë, paraqiti një kërkesë për të mundësuar vendosjen e fëmijëve të saj të mitur në një qendër apo institucion shtetëror rezidencial përkujdesjeje.

Ajo është nënë e 5 fëmijëve të mitur (14 vjeç,13 vjeç,7 vjeç, 5 vjeç dhe më e vogla 4 vjeç), e braktisur nga bashkëshorti dhe në kushte mjaft të vështira ekonomike mbijetese, pasi nuk perfiton as ndihmë ekonomike nga shteti. Për t’i ardhur në ndihme sa më shpejt ankueses ne i kërkuam shpjegime shkresore Shërbimit Social Shtetëror. Pas marrjes se shpjegimeve nga ky institucion, ne

informuam shtetasen L.D për dokumentat që duhet të plotësojnë dhe rrugën që duhet të ndiqte për zgjidhjen e problemit të saj.

Ajo që është konstatuar dhe që vazhdimisht i është vënë theksi nga Zyra jonë gjatë trajtimit të ankesave lidhur me shërbimin social, është se vazhdojnë të ekzistojnë mundësitë e pakta të vendit për të siguruar shëndetin dhe mirëqënien e popullsisë, të cilat janë të kompromentuara nga infrastruktura e dobët, lëvizjet e mëdha demografike, mungesat e përkohshme të stabilitetit të brendshëm dhe kapacitetet e dobëta teknike të strukturave përkatëse. Në këtë kontekst vëmë në dukje se ristrukturimi dhe reformimi i shërbimeve sociale duhet të jetë një element prioritar lidhur dhe me uljen e varfërisë.

Në kuadrin e decentralizimit të shërbimit social shtetëror, siç e kemi përmendur edhe në raportin vjetor të vitit 2006, kishin filluar procedurat për kalimin e institucioneve të përkujdesit shoqëror në varësi të pushtetit vendor. Ky proces ka përfunduar duke zbatuar një nga standartet e shërbimeve sociale.

Ministritë përkatëse të fushës së zbatimit të detyrueshëm të politikave në fushën e ndihmës dhe përkujdesit shoqëror, duhet të vazhdojnë punën e nisur për përsosjen e këtyre politikave, të përmirësimit të legjislacionit dhe përshtatjes së tyre me parametrat më të larta të vendeve të përparuara demokratike.

8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve

Gjatë vitit 2007 ka patur 151 ankesa për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe organet e saj në varësi. Nga keto, 43 ankesa kanë qenë për vetë ministrinë, nga të cilat 13 ankesa kanë qenë të pabazuara, 18 ankesa kanë qenë jashtë kompetencës dhe juridiksionit, 6 ankesa janë ende në shqyrtim dhe 6 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve.

Në vijim po paraqesim disa çështje të vlerësuara në mënyrë pozitive dhe njëkohësisht problematikat që kemi hasur gjatë vitit 2007 me këtë ministri që lidhen sidomos me rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve shqiptarë.

1. Me iniciativën e tij, Avokati i Popullit paraqiti një rekomandim pranë MPPTT dhe Kryeministrit, duke kërkuar ndërhyrjen urgjente për eliminimin e një sërë shqetësimesh që shkaktohenin nga mbingarkesa e trafikut në periudhën e verës në aksin rrugor Plepa-Mali i Robit, Kavajë.

Dihet se ky aks (Durrës-Rrogozhinë) është më i ngarkuari në të gjithë vendin për shkak se është e vetmja rrugë që lidh viset veriore me Tiranën e Durrësin dhe me zonën bregdetare jugore të vendit.

Njëkohësisht në pikun e sezonit të plazhit, për të përshkuar segmentin Plepa-Mali i Robit (rreth 6 km) duhen nga 60-90 minuta, për arsye se fluksit të automjeteve me destinacion të largët i shtohen edhe pushuesit ditor të plazheve të Durrësit, Golemit, Divjakës etj.

Avokati i Popullit duke parë se kjo çështje ishte ngritur disa herë në media nga qytetare të ndryshëm, mendoi se ndërhyrja në këtë rast do t'i vinte në ndihmë zgjidhjes së një çështje mjaft të mprehtë që nganjëherë ndikon edhe në rrezikimin e jetës së njerëzve në nevojë urgjente për ndihmë mjeksore.

Për të gjitha këto arsye, ne i sugjeruam MPPTT dhe Qeverisë që të mundësonin me një vendim të veçantë prokurimin pa tender projektimi dhe ndërtimi të këtij segmenti rrugor brenda vitit 2008.

Në përgjigje të rekomandimit të mësipërm Ministri i MPPTT sqaroi se e

vlerësonte si të drejtë shqetesimin e ngritur dhe zgjidhja e kësaj çështje ishte në vëmendje të veçante të Qeverisë.

Për këtë qellim, MPPTT (Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve), njoftoi se kishte filluar përgatitjen e projektit për ndertimin e një By-Passi, që do të lehtësojë dhe permiresojë në mënyrë të ndjeshme qarkullimin e automjeteve në segmentin rrugor të sipërpërmendur.

Krahas kësaj u njoftua gjithashtu se hartimi i projektit të By-Pass-it "Plepa - Kavaje", do të perfundonte brenda vitit 2007 dhe brenda vitit 2008 do të planifikoheshin fondet e nevojshme për ndertimin e tij.

Megjithëse përgjigja ishte e shpejtë dhe ky problem tashmë është futur në rrugën e zgjidhjes, por jo brenda vitit 2008, siç është përgjigja sërish Avokati i Popullit ndjehet skeptik për ndjeshmërinë dhe operativitetin që disponon MPPTT në zgjidhjen e rasteve emergjente rrugore të ngjashme me procedurën të përshpejtuara.

2. Në një inspektim që Zyra e Avokatit të Popullit ndërmori gjatë vitit 2007 në shërbimin e transportit detar të pasagjerëve, pas zjarrit që shpërtheu në një traget, u vunë re disa problematika, lidhur me mënyrën e kontrollit nga ana e Kapitenerisë së Portit të Durrësit të kushteve higjieno-sanitare të trageteve dhe pranimit të ankesave nga udhëtarët për parregullsi të ndryshme.

Nga të dhenat e mbledhura rezultoi se kushtet e trageteve të huaja në përgjithsi që operojnë në linjat shqiptare janë në nivel të dobët, veçanërisht në aspektin e nivelit të shërbimeve dhe kushteve higjieno-sanitare.

Konkretisht shumë emigrante konstatojnë diferencim të madh midis shërbimit udhetar detar që kryhej me destinacion Shqipëri dhe atyre për vende të tjera. Sipas tyre, tragetet përgjithësisht janë tepër të amortizuar, ofrojnë një shërbim hotelier të dobët, sidomos për klasin e dytë dhe të tretë. Cilesia e ushqimit shpesh është e pakënaqshme dhe ishin konstatuar probleme në kushtet higjieno-sanitare të dhomave, çarçafëve e batanijeve.

Krahas kësaj shpesh vërehet se nuk ka një shërbim korrekt transporti, por vihen re vonesa të theksuara në nisjen e mbërritjen e trageteve, vonesa që shkaktonin probleme tek pasagjeret dhe sidomos tek familjarët. Përpos kësaj, çmimet e biletave, sipas tyre janë tepër të larta, krahasuar me çmimet për distanca të njëjta në linjat Greke apo Italiane.

Avokati i Popullit duke patur në konsideratë standartet e BE-se edhe në fushën e transportit detar, kërkoi pranë MPPTT kryerjen e një inspektimi nga ana e saj për të vënë përpara përgjegjësisë çdo person juridik që shfrytëzon këtë veprimtari për të abuzuar në kurriz të shtetasve shqiptarë.

Inspektimi rekomandohej me tematikë për kushtet teknike të trageteve, gjendjen higjieno-sanitare, kushtet e dhomave, sallave të ngrënies, cilesisë së ushqimit, kuzhinave, respektimit të zbatimit të orareve, tarifave për çmimet etj.

Në përgjigje të këtij rekomandimi MPPTT njoftoi se me Urdhërin e Ministrit Nr.137 dt.07.11.2007 "Për kontrollin në anijet e pasagjerëve dhe trageteve që operojnë në linjat ndërkombëtare detare në portet e Republikës së Shqipërisë", strukturat në varësi ushtruan një inspektim të gjerë në shkallë vendi.

Ky inspektim, konsistoi në kontrollin e dokumentacionit teknik të anijeve, standarteve teknike të tyre, si dhe në kontrollin e kushteve dhe nivelit të shërbimeve të anijeve që operojnë në linjat ndërkombëtare detare (tragetet), ndaj udhëtarëve.

Në përfundim të kontrollit, sipas përgjigjes që na ka dërguar ministri i MPPTT rezultoi se "përgjithësisht gjendja paraqitej e pranueshme në drejtim të sigurisë teknike në lundrim dhe të shërbimit ndaj pasagjerëve". Por sipas MPPTT, "gjatë kontrollit u konstatuan dhe të meta, të cilat u vlerësuan si të karakterit dytësor,

të cilat nuk ndikojnë në sigurinë e lundrimit dhe të jetës, si dhe të akomodimit të pasagjerëve, të cilat u pasqyruan dhe në dokumentet përkatëse të kontrollit. Për këto të meta u lanë detyra konkrete për përmirësimin e tyre sa më të shpejtë”. Sidoqoftë, duke njohur situatën në terren, ne nuk kënaqemi me këtë përgjigje.

Avokati i Popullit duke vlerësuar seriozitetin me të cilin u krye inspektimi, nënvizon faktin se kjo veprimtari shtetërore nuk duhet të jetë spontane dhe me kërkesë të organeve të tjera shtetërore. Nga të dhënat tona rezultoi se kapacitetet njerezore të Kryekapitenerise së Porteve të Shqipërisë janë të pakta për të zhvilluar një inspektim të hollësishëm dhe periodik. Ndaj iniciativa dhe burimet njerezore për të ushtruar inspektime duhet të jenë më aktive dhe në kordinim të plotë të gjithë strukturave në varësi me MPPTT-së. Në të ardhmen kjo çështje do të ndiqet me përparësi nga ana jonë, duke i dhënë rëndësinë e nevojshme ushtrimit të inspektimeve, sidomos në periudhat e fluksit të madh të pasagjerëve gjatë sezonit veror.

3) Avokati i Popullit krahas angazhimit të tij për përmirësimin e shërbimit në tragjetet e linjave me Shqipërinë, u fokusua gjatë vitit 2007 edhe në problemet ligjore që nuk lejojnë një nxitje dhe kordinim të nevojshëm midis organev shtetërore në fushën e menaxhimit detar.

Konkretisht në Nenin 401 të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr.9251 dt. 08.07.2004 ishte parashikuar se:

“Brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi, ngarkohen organet përgjegjëse të përgatisin aktet nënligjore si më poshtë:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë miraton aktet nënligjore në zbatim të dispozitave të këtij Kodi, kur këto akte prekin interesat ndërministrorë”.

Aktet që duhet të miratohen janë një pjesë e rëndësishme për të vënë në zbatim dhe bashkërenduar kompetencat që parashikon neni 32 i Kodit Detar, ku midis të tjerash citohen organet dhe detyrat e tyre për sa vijon:

a) Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit:

i) transportin detar të mallrave dhe njerëzve;

ii) portet detare të hapura për qëllime ekonomike;

iii) Regjistrin e Mjeteve Llunduese dhe klasifikimin e tyre;

iv) plotësimin e kushteve për sigurinë e jetës së njerëzve dhe mjeteve llunduese;

v) së bashku me Rojen Bregdetare hetimin e incidenteve detare.

b) Ministria e Financave:

i) zbatimin e legjislacionit fiskal dhe doganor gjatë zhvillimit të veprimtarive detare;

ii) ndalimin e trafikeve të paligjshme të mallrave dhe vlerave monetare e materiale;

iii) së bashku me ministritë e tjera përcaktimin e tarifave për shërbimet dhe sanksionet.

c) Ministria e Rendit:

i) zbatimin e legjislacionit shqiptar për kalimin e kufirit dhe të luftës kundër krimit në portet dhe hapësirën detare shqiptare;

ii) mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë në radat dhe në portet shqiptare;

ç) Ministria e Mbrojtjes:

i) sigurimin hidro-lundrimor të bregdetit shqiptar;

ii) prodhimin e hartave detare hidrografike dhe hidrologjike dhe pajisjen e anijeve që mbajnë flamurin shqiptar me dokumentacionin e nevojshëm lundrimor;

iii) organizimin dhe drejtimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit në hapësirën detare shqiptare;

iv) ushtrimin e kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë në hapësirën detare.

d) Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit:

i) shfrytëzimin e pasurive që peshkohen në hapësirën detare në përputhje me legjislacionin shqiptar;

ii) ndryshimin e sipërfaqes tokësore në vijën bregdetare të zonës abrazive në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes (shërbimi hidrografik) dhe me Akademinë e Shkencave (Instituti Hidrometeorologjik).

dh) Ministria e Turizmit dhe Rregullimit të Territorit:

i) turizmin detar dhe bregdetar në Republikën e Shqipërisë;

ii) ndërtimet publike dhe private në vijën bregdetare dhe atë detare të lidhura me veprimtaritë e turizmit.

e) Ministria e Mjedisit:

i) mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotjet, nga veprimtaritë në zonë, nga anijet dhe bazat tokësore;

ii) konservimin e mjedisit detar.

ë) Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve:

i) sportet e ujit dhe të nënujit që zhvillohen në hapësirën detare.

3. Dikasteret qendrore, në plotësimin e funksioneve të mësipërme, krijojnë struktura të përshtatshme dhe përgatisin aktet nënligjore në përputhje me këtë Kod.

Nisur nga përmbajtja e kësaj dispozite, Avokati i Popullit mendon se kryesisht Ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacioneve, por edhe ministritë e tjera të lartpërmendura duhet të bënin përpjekje të shpejta për hartimin e drafteve nënligjore të vonuara dhe kalimin e tyre sa më parë në Këshillin e Ministrave për miratim.

Kjo masë ju propozua organeve të sipërpërmendura me anë të një rekomandimi me anë të të cilit i jepej një ndihmë edhe shqetësimit të një sërë dikasteresh, të cilat kishin probleme në bashkërendimin dhe kordinimin e punës midis tyre.

Në përgjigjen e kthyer nga këto ministri përgjithësisht sqaroheshin masat e marra dhe aktet që kishin dalë edhe më parë në zbatim të Kodit Detar. Gjithsesi ishin për t'u vlerësuar hapat që po ndërmerre Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave në fushën e ndotjes ujore, duke përgatitur draftet përkatse për miratim.

Nisur nga kjo frymë angazhimi, Avokati i Popullit do të vazhdojë të insistojë edhe në të ardhmen në këtë rekomandim, pasi mendon se ende ka nevojë për akte nënligjore në fushën e menaxhimit detar, për sa kohë që ka një mungesë kordinimi midis pothuajse 10 organeve shtetërore që ndjekin dhe zbatojnë dispozitat të caktuara të Kodit Detar në Republikën e Shqipërisë.

4. Pranë Zyrës së Avokatit të Popullit paraqiti një ankesë një shtetas ish punonjës i DRSHT Laç, i cili pretendoi se pasi kishte dalë në pension në Janar 2007, nuk kishte përfituar 2 paga shpërblim për dalje në pension sipas ligjit.

Për këtë ankuesi shprehej se Drejtoria në Laç kishte dërguar propozimin përkatës për Drejtorinë e Përgjithshme në Tiranë, por ende ky problem nuk kishte marrë zgjidhje.

Avokati i Popullit pasi u njoh me këtë ankesë kreu menjëherë ndërhyrjet e tij pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor si dhe Drejtorisë Rajonale Laç, duke ju rikujtuar dispozitat përkatse të Kodit të Punës.

Në përfundim të kontakteve me këto zyra u arrit që problemi i paraqitur nga ky shtetas të futej për shqyrtim në mbledhjen e rradhës të Këshillit Drejtues të DPSHTRR-se dhe të miratohej, duke zgjidhur ankesën.

5. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit u paraqit një ankesë, në të cilën një shtetas pretendoi se nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor dega Gjirokaster nuk i ishte dhënë dokumentacioni i kërkuar, duke i shkelur në këtë mënyrë e drejta e tij për t'u informuar dhe për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm sipas ligjit.

Avokati i Popullit pasi u njoh me këtë ankesë, si dhe pasi kreu një korrespondencë me DSHTR dega Gjirokaster arriti të bindë drejtuesit e këtij institucioni nëpërmjet dispozitave përkatse ligjore për rëndësinë e respektimit të së drejtës së informimit për individët.

Pas kësaj ndërhyrje me anë të një shkrese të DSHTR dega Gjirokaster jemi vene në dijeni se kjo drejtori e kishte pajisur me dokumentacionin e kërkuar shtetasin në fjalë, duke u justifikuar me disa vonesa të karakterit administrativ.

6. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit një shtetas prezantoi shqetësimin e tij, lidhur me mos dhënie të librezës së plotësuar të punës nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.

Konkretisht ankuesi sqaroi se kishte qenë prej 38 vitesh punonjës në Institutin e Ndërtimit, në pozicionin e kimistit teknolog dhe në datën 29.12.2006 ishte lajmëruar nga Drejtori i këtij Instituti se duhet të nderpriste kontratën e punës, për shkak se kishte mbushur moshën e pensionit.

Për sa me sipër ai kishte filluar një proces gjyqësor, për të rivendosur në vend të drejtën e pretenduar. Por ndërkohë kishte kërkuar pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore që të tërhiqte librezën e punës për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm. Kjo kërkesë atij i ishte refuzuar pa të drejtë disa herë me pretendimin se drejtori nuk ndodhej në institucion.

Referuar sa më lart, Avokati i Popullit ndërhyri menjëherë pranë Institutit të Ndërtimit për të bërë të mundur tërheqjen e librezës së punës, pasi ky ishte një dokument personal dhe nuk mund të pengohej dhënia pa një shkak ligjor. Aq më tepër që në mungesë të drejtorit, funksionet dhe kompetencat e tij vazhdojnë të ushtrohen nga personat e tjerë drejtues dhe kjo nuk përbente justifikim për mosdhënie dokumentacioni.

Pas kësaj ndërhyrje kemi marrë njoftim se ankuesi e kishte marrë librezën dhe me këtë rast ankesa u konsiderua e zgjidhur.

Në një vështrim përfundimtar të veprimtarisë së kësaj ministrie mund të përmendim punën e mirë që është bërë gjatë këtij viti për shpronësimin për interes publik ndaj shtetasve. Nisur nga numri i pakët i ankesave për këtë problem dhe nga njoftime të tjera në Media gjatë vitit, kemi arritur në përfundimin se është rritur ndjeshëm përgjegjësia ligjore ndaj procedurave të shpronësimit, çka është një element pozitiv në respektimin e të drejtës së pronësisë.

Ndërkohë referuar gjendjes së infrastrukturës dhe aksesit rrugor, vërejmë se krahas punimeve në volume të mëdha nuk janë mbajtur në konsideratë masat me karakter mbrojtës ndaj jetës dhe shëndetit të udhëtarëve. Konkretisht në disa akse rrugore shtetas të ndryshëm vazhdojnë të plagosen dhe humbin jetën për shkak të mungesës së sinjalistikës. Problem mbetet mungesa e investimeve për mbikalime, çka në shumë raste ka shkaktuar aksidente të rënda.

Një çështje tjetër mbetet gjendja e rënduar e shërbimit hekurudhor. Megjithatë gjatë vitit 2006 Avokati i Popullit inspektoi në të gjithë vendin dhe la detyra për përmirësimin e kushteve të këtij shërbimi, përsëri nuk është vënë re

ndonjë ndryshim i konsiderueshëm. Jemi vënë në dijeni se po bëhen përpjekje për rehabilitimin e shërbimit të transportit hekurudhor në linjën Tiranë-Durrës-Rinas, por deri tani kjo është vetëm në fazën e një projekti.

Duke mbajtur në vëmendje këtë problematikë komplekse të këtij dikasteri, në interes të qytetarëve Avokati i Popullit do të vazhdojë edhe në të ardhmen të ndjekë me përgjegjësi këtë veprimtari për të dhënë kontributin e tij në përmirësimin e shërbimeve publike që i ofrohen individit nga MPPTT dhe strukturat e saj vartëse.

a) Ankesat për Policinë e Ndertimit (Inspektoriatet Ndertimore e Urbanistike)

Nenshkrimi i Marreveshjes së Stabilizimit Asociimit ndërmjet vendit tonë dhe vendeve të Bashkimit Europian, në 12 qershor 2006, ka shtruar si një nga perparësitë kryesore adoptimin e legjislacionit të brendshëm, në përputhje me direktivat dhe standartet e legjislacionit të BE-së, në të gjitha fushat e përfshira në këtë marreveshje.

Një nga këto fusha është ajo e urbanistikës, ku një vend kryesor zënë ndertimet pa leje dhe legalizimi i tyre.

Legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndertimeve pa leje, janë kryefjala e përpjekjeve dhe angazhimit konkret për t'i dhënë fund kaosit urban që ka mbizotëruar në gjithë këtë periudhë në vend. Është e natyrshme që levizja në drejtimin e duhur edhe në këtë fushë, duhet të fillonte me adoptimin e një legjislacioni të ri.

Miratimi nga ana e Kuvendit të Shqipërisë dhe hyrja në fuqi e Ligjit nr.9482 datë 16.02.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje", krijoi bazën e duhur për ndërmarrjen dhe realizimin e një procesi shumë kompleks dhe gjithëpërfshirës, që ka çuar në krijimin e institucioneve të reja specifike për mbarevajtjen e tij. Por nga ana tjetër, ka shërbyer edhe si një shtytje për realizimin e kuadrit të decentralizimit të pushtetit vendor.

Dhenia e një roli aktiv organeve të pushtetit vendor në procedurat e legalizimit, ka ndikuar në rritjen e autonomisë së tyre në kuadër të zbatimit dhe respektimit të parimit të autonomisë, ndërkohe që parashikimi dhe zbatimi i procedurave të thjeshta administrative për legalizimin, ka kontribuar në rritjen e efikasitetit të kësaj administrate që po luan një rol themelor në këtë proces.

Keto zhvillime janë një përgjigje pozitive ndaj shqetësimeve të ngritura kohë pas kohe në rekomandimet dhe propozimet tona, për ndryshimin dhe përmirësimin e legjislacionit në fushën e urbanistikës, si dhe të rikonceptimit dhe ristrukturimit të organeve të ngarkuara me mbikqyrjen dhe zbatimin e ligjshmerisë në ndertime.

Jemi të ndergjegjeshëm se rekomandimet dhe propozimet tona kanë qenë një kërkesë llogjike e politikave sociale dhe ligjore në vend, sikurse vlerësojmë faktin që, kontributi ynë është konsideruar pashmangshmerisht dhe tashmë është pjesë domethënëse e gjithë përpjekjeve për vendosjen e shtetit të së drejtës në Shqipëri.

Specifika që vërehet në kuadrin e ri ligjor të miratuar gjatë vitit 2007, në fushën e urbanistikës dhe asaj të ndertimeve pa leje në veçanti, është se, theksi po vihet gjithnjë e më shumë në decentralizimin dhe autonominë e pushtetit vendor dhe marrjes persiper nga ana e këtij të fundit të përgjegjesive konkrete dhe reale në këtë fushë.

Në rekomandimet tona të mëparshme kemi theksuar se hapat e ndërmarrja deri në atë kohë në procesin e decentralizimit, e kanë vendosur në një marrëdhënie dualizmi pushtetin qendror me atë vendor në disa kompetenca të përcaktuara në

“Ligjin per Urbanistiken”, prandaj shtrohej nevoja e pershtatjes se ketij ligji me Karten Europiane per Autonomie Vendore.

Ne kuader te Kartes Europiane te Autonomie Vendore, te ratifikuar me Ligjin nr.8548, date 11.11.1999, mbetet primar parimi qe sanksionon ky akt, sipas te cilit kompetencat qe u besohen organeve lokale duhet te jene te plota dhe mund te diskutohen apo te kufizohen nga nje autoritet tjeter, qendror apo rajonal, vetem brenda ligjit. Eshte kuptimplote fakti se me autonomie lokale si koncept, Karta Europiane e Autonomie Vendore kupton te drejten dhe aftesine efektive te bashkesive lokale per te rregulluar e drejtuar, brenda ligjit, nen pergjegjesine e tyre nje pjese te mire te ceshtjeve publike, perfshire ketu infrastrukturen urbane.

Edhe ne Kushtetuten tone, autonomie vendore i kushtohet nje vemendje e vecante ne nenin 13 te saj, ku thuhet shprehimisht se:

“Qeverisja vendore ne Republikën e Shqipërisë ngrihet ne baze te parimit te decentralizimit te pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit te autonomie vendore”.

Konkretizimi i ketij parimi kushtetues, eshte bere tashme me futjen ne fuqi te Ligjit nr.8652 date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Ne germen a/I, te pikes 4 te nenit 72 te ketij ligji, percaktohet shprehimisht se:

“Duke filluar nga 1 Janari 2001, komunat dhe bashkite jane teresisht pergjegjese per kryerjen e funksioneve te veta te meposhtme:

Ne fushen e infrastruktures dhe sherbimeve publike:

- ndertimin, rehabilitimin dhe mirembajtjen e rrugeve me karakter vendor, te trotuareve dhe shesheve publike”.

Por kemi qene te ndergjegjshem se per aq sa eshte arritur, nuk ka qene e mjaftueshme. Ky shqetesim i yni eshte shprehur jo vetem ne rekomandimet tona drejtuar institucioneve ne vend, por edhe ne takime me personalitete perfaqesues te organizmave nderkombetare qe monitorojne ecurine e zhvillimeve ne vendin tone. Ne takimin e zhvilluar ne daten 17.01.2006 ne zyren e Avokatit te Popullit me Presidentin e Kongresit te Autoriteteve Lokale & Rajonale te Keshillit te Europes, z. Giovanni Di Stasi, jane nenvizuar qarte tre momente:

1. Shkrirja e KRRT-se ekzistuese dhe formimi i nje KRRT-je te re, sipas parimeve te autonomie vendore.

2. Shkaterimi i objekteve qe jane ne kompetence te organeve te pushtetit vendor nuk mund te behej nga ana e Policise te Ndertimit, pasi ky ishte nje veprim qe binte ne kundërshtim me parashikimet e Kartes Europiane te Autonomie Vendore.

3. Krijimi dhe funksionimi i organit te Policise te Ndertimit, ne baze te Ligjit nr.8408 date 25.09.1998 “Per Policine e Ndertimit”, binte ndesh me keto parashikime, ndaj edhe kompetencat per te dhene leje ndertimi e me pas per te prishur, jane kompetenca qe i duhen dhene nje organi ne perputhje me kete Karte.

Keto konkluzione kane qene thelbi i rekomandimeve qe ne kemi derguar prej kohesh, per permiresimin e infrastruktures ligjore dhe te aktivitetit te organeve kompetente, ne fushen e urbanistikes dhe te ndertimeve pa leje.

Dy jane ligjet e miratuara gjate vitit 2007, te cilet reflektojne keto konkluzione dhe kerkesa primare te adoptimit te legjislacionit tone ne kete fushë, Ligji nr.9743 date 28.05.2007 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr.8405 date 17.09.1998 “Per urbanistiken”, i ndryshuar” dhe Ligji nr.9780 date 16.07.2007 “Per inspektimin e ndertimit”.

Ne Ligjin nr.9743 date 28.05.2007 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr.8405 date 17.09.1998 “Per urbanistiken”, i ndryshuar”, gjejme tashme te

parashikuar ngritjen e KRRT-se se Bashkise te Tiranes, si nje organ vendimmarres ne fushen e urbanistikes me nje perberje dhe funksion qe e perfshin ate ne grupimin e organeve lokale me kompetenca te plota ne fushen e urbanistikes. Megjithate, gjykojme se edhe ky parashikim nuk jep tablone e plote te rregullimit ligjor qe nevojitet ne kete fushe, pasi KRRT-ja ne fjale nuk perfaqeson dhe as nuk mund te perfaqesoje teresine e KRRT-ve ekzistuese ne te gjithe njesite vendore.

Pavaresisht ketij rregullimi, gjykojme se eshte i domosdoshem rishikimi i gjithe kuadrit ligjor ne fuqi ne fushen e urbanistikes dhe per me teper, miratimi dhe hyrja ne fuqi e nje ligji te ri per urbanistiken qe do te perfshije dhe pasqyroje standartet e kerkuara europiane edhe ne kete fushe.

Ligji nr.9780 date 16.07.2007 "Per inspektimin e ndertimit", pa dyshim perben nje nder hapat e pare serioz drejt realizmit te aftesise efektive te bashkesive lokale per te rregulluar e drejtuar, brenda ligjit dhe nen pergjegjesine e tyre nje pjese te mire te ceshtjeve publike.

Krijohet per here te pare organi i inspektoriatit ndertimor e urbanistik ne njesite e qeverisjes vendore, me varesi direkte nga organet perfaqesuese te qeverisjes vendore dhe i qellimuar per kontrollin dhe zbatimin e ligjshmerise, si dhe te standarteve teknike ne fushen e ndertimit dhe te urbanistikes.

Megjithate, gjykojme se pavaresisht konceptimit standartizues qe jepet ne kete ligj per krijimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik, mbeten ende momente te paqarta te cilat, do te evidentohen gjate praktikës se zbatimit te ligjit.

Mbetet jo i qarte, per aq sa parashikohet ne ligj, raporti ndermjet Inspektoriateve Ndertimore e Urbanistike te Bashkive, Komunave apo te Qarqeve, me Inspektoriatin Ndertimor e Urbanistik Kombetar. Ky raport eshte shume i diskutueshem sidomos kur shtrohet ceshtja nese Inspektoriatin Ndertimor e Urbanistik Kombetar do te konsiderohet apo jo, si hallke hierarkike e ankimit administrativ per teresine e vendimeve qe mund te merren nga Inspektoriatet Ndertimore e Urbanistike te Bashkive, Komunave apo te Qarqeve.

Faza tranzitore e parashikuar ne ligj per kalimin nga organi i Policise te Ndertimit si nje organ i centralizuar, ne Inspektoriat Ndertimor e Urbanistik, ka krijuar nje problem sa praktik aq edhe thelbesor per veprimtarine normale te Inspektoriateve Ndertimore e Urbanistike, tashme te ngritura.

Edhe pse ka kaluar afati ligjor i percaktuar ne nenin 18/1 te ligjit, per ngritjen e inspektoriateve ndertimore e urbanistike, ende sot e kesaj dite nuk mund te gjeshe nje informacion te plote dhe te sakte per te gjithe Inspektoriatet Ndertimore e Urbanistike, te krijuara ne rang Bashkie, Komune apo Qarku. Kete informacion nuk e gjen as edhe ne Inspektoriatin Ndertimor e Urbanistik Kombetar. Ky fakt mund te duket teknik dhe i nje rendesie te pallogaritshme. Por nuk eshte keshtu, pasi ai krijon probleme te njohjes dhe orientimit tek keto organe te qytetareve dhe subjekteve te interesuara, si dhe krijon probleme te komunikimit institucional ndermjet vete organeve te administrates publike, gje qe sjell pasoja rast pas rasti.

Mospereaktimi i nje afati per transferimin e praktikave dokumentare administrative qe kane qene ne shqyrtim e ndjekje nga Policia e Ndertimit, prej Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik Kombetar, tek inspektoriatet ndertimore e urbanistike ne nivel bashkie, komune e qarku, ka krijuar probleme qe lidhen me funksionimin normal te ketyre organeve, fakt ky qe evidentohet ne komunikimin tone te perditeshem me to.

Gjate gjithe veprimtarise tone institucionale jemi kujdesur dhe nuk kemi nguruar te japim rekomandime per mirefunksionimin e mireadministrimin e

organeve te administrates publike, gje qe pa dyshim do t'a kishim bere edhe gjate procesit te diskutimit te projektligjit per inspektimin ndertimor, ne te cilin nuk jemi ftuar per dhenie mendimi.

Jo vetem per kete ligj, por edhe per ndryshimin qe ka pesuar se fundmi ligji "Per urbanistiken", gjykojme se per ato mangesi qe verehen ne permbajtjen e tij, mund te ishin bere permiresimet e duhura gjate diskutimit te projektligjit perkates, duke ftuar me teper aktore dhe faktore qe ndikojne ne mireberjen e legjislacionit, perfshire ketu Avokatin e Popullit.

Ecuria e zbatimit te Ligjit "Per legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje", ka njohur nje lloj vazhdimesie dhe qendrueshmerie, por duhet cilesuar se procesi po ecen me hapa relativisht te ngadalte. Kjo duket ne radhe te pare, ne shtyrjen qe i eshte bere afatit te vetedeklarimit te ndertimeve te paligjshme nga ana e poseduesve te tyre dhe ne radhe te dyte, ne numrin e objekteve apo zonave qe jane legalizuar deri tani.

Megjithate, ende nuk dihet me saktesi se kur do te perfundoje ky proces. Nga ana tjeter, per zonat qe jane legalizuar apo jane drejt perfundimit te kesaj procedure, mbetet realizimi i shpejte i dy hapave te tjere qe jane urbanizimi dhe integrimi i tyre.

Çeshtjet e shqyrtuara nga ana jone gjate ketij viti kane evidentuar gjithashtu se, ne rastet e ndertimeve pa leje, per te cilat paraprakisht eshte plotesuar formulari i legalizimit, jane pezulluar ekzekutimet e vendimeve te marra nga organi i Policisë të Ndërtimit, deri ne marrjen e një vendimi përfundimtar nga ana e organit të ngarkuar me ligj për shqyrtimin e mundësisë së legalizimit.

Ne fakt ky qendrim qe mbahet nga ana e inspektoriateve ndertimore e urbanistike, nuk eshte korrekt me parashikimet e bera ne germat "a" dhe "b", te nenit 131, te Kodit te Proçedurave Administrative. Ne kete nen parashikohet se, aktet administrative (ne kete rast vendimet e nxjerra paraprakisht nga ana e organit te Policise te Ndertimit), nuk mund te ekzekutohen, se pari, kur efekti i tyre eshte pezulluar, apo se dyti, kur kunder tyre eshte bere nje ankim me efekt pezullues. Plotesimi dhe paraqitja ne organin perkates kompetent i formularit te deklarimit te ndertimit te kundraligjshem dhe rrjedhimisht fillimi i proçedimit administrativ rast pas rasti, nuk perbejne dhe nuk cilesohen ne kushtet e parashikuara ne germat "a" dhe "b", te nenit 131 te Kodit te Proçedurave Administrative. Pra, paraqitja e formularit te vetedeklarimit nuk eshte nje shkak ligjor i parashikuar ne Kodin e Proçedurave Administrative, per pezullimin e ekzekutimit te ketyre vendimeve.

Praktika qe po ndiqet ne keto raste, mund te kete efekt pozitiv ne aspektin social vetem per ata individe apo subjekte qe kane ngritur ndertime pa leje. Por nga ana tjeter ne aspektin ligjor, konstatohet nje problem qe nuk mund te lihet ne heshtje dhe qe ka te beje me mosharmonizimin e parashikimeve te Ligjit "Per legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje", me legjislacionin tjeter ne fuqi. Ky eshte nje tjeter konstatim qe evidenton nje praktike e cila, nuk duhet lene thjesht ne diskrecionin e organeve specifike, por qe duhet rregulluar me parashikimet perkatese ligjore ne nje kohe sa me te shpejte.

Gjatë vitit 2007, për problematikën e ndertimeve pa leje që lidhet me veprimtarinë e organit të Policisë të Ndërtimit, te transformuar ne Inspektoriate Ndertimore e Urbanistike, ne perputhje me parashikimet e Ligjit nr.9780 date 16.07.2007 "Per inspektimin e ndertimit", rezulton të jenë shqyrtuar 106 ankesa, nga te cilat rezultojne 74 ankesa te reja dhe 32 ankesa te mbartura.

Nga ankesat e shqyrtuara deri në fund të vitit 2007, rezultojnë të përfunduara 83 ankesa dhe jane ende në shqyrtim 23 ankesa.

Përsa i përket çështjeve të përfunduara, ka rezultuar se janë zgjidhur në favor 14 ankesa, jashtë juridiksionit dhe kompetencës kanë qene 54 ankesa, ndërsa për 15 prej tyre jemi në kushtet e pabazueshmerise se ankeses ose braktisjes së procedimit administrativ të filluar me kerkese nga vetë ankuesit. Pra jemi në kushtet e heqjes dore të ankuesve nga ndjekja e mëtejshme e çështjeve prej nesh.

Trajtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me ndertimet pa leje në vitin 2007, shfaq një veçori që lidhet me fazën tranzitore në të cilën kaloi organi i Policisë të Ndertimit, me hyrjen në fuqi të Ligjit “Për inspektimin e ndertimit”.

Per shkak të kesaj gjendjeje, në fillimin e vitit 2007 u vu re një gjendje apatie dhe neglizhence pothuajse e plote e organit të Policisë të Ndertimit, me pasoje mbartjen e problemeve që kanë të bëjnë me ndertimet pa leje dhe shtimin e tyre për arsye të mosveprimit.

Rekomandimet që i janë drejtuar Policisë të Ndertimit dhe me pas Inspektoriateve Ndertimore e Urbanistike, si pasoje e konstatimit të veprime të parregullta ose të paligjshme të kryera në shkelje të drejtave të lirive të ligjshme të shtetasve, janë 8.

Problematika e shfaqur në vitin 2007 në veçanti për punën e organit të Policisë të Ndertimit, të transformuar, konstaton se:

- Ka patur një mungesë të theksuar dhe neglizhencë krejtësisht të pajustificuar të Policisë të Ndertimit, por edhe të një sere Inspektoriateve Ndertimore e Urbanistike pas ngritjes së tyre, në dhenien e përgjigjeve apo informacioneve, pas kërkesave të dërguara për këto qëllime nga ana e institucionit të shtetit. Kjo gjë shpeshherë është shoqëruar paraprakisht nga një mungesë transparence ndaj personave të interesuar, apo edhe publikut në përgjithësi. Mungesa e informacionit të kërkuar, është bërë shkak për kohezgjatjen e shqyrtimit të ankesave nga ana e tyre.

- Një pjesë e mirë e rekomandimeve tona kanë mbetur pa përgjigje, duke ngritur detyrën që t’ja përsërisim ato, të gjitha strukturave formale të parashikuara në ligj, gjatë transformimit të organit të Policisë të Ndertimit.

- Vihet re një praktikë kontradiktore në trajtimin e rasteve të konstatimit të ndertimeve pa leje nga njëra anë dhe të ekzekutimit të vendimeve që tashmë janë marrë nga ana e organit të Policisë të Ndertimit ndaj këtyre ndertimeve. Në rastin e parë, mbahet qëndrimi që për ndertimet pa leje për të cilat është bërë vetedeklarimi me qëllim legalizimi, duhet pezulluar procedura e vendimmarrjes (neni 23/1 i Kodit të Procedurave Administrative), deri në daljen e vendimit për legalizimin e tyre ose jo nga ana e organit përkatës kompetent. Në rastin e dytë, në kundërshtim me parashikimet e bëra në germet “a” dhe “b”, të nenit 131 të Kodit të Procedurave Administrative, pezullohet procedura e ekzekutimit të një vendimi të marrë dhe që është në fuqi, pa asnjë shkak të perligjur.

- Legjislacioni në fuqi për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje, shpesh shihet si kusht mosveprimi për çështje të ndertimeve pa leje, që i paraqiten inspektoriateve ndertimore e urbanistike. Nuk ka asnjë justifikim ligjor nëse arsyeja për mosveprim shihet tek fakti se, për ndertimin pa leje është bërë vetedeklarimi për legalizim, nderkohe që mund të jemi në kushtet e nenit 33 të Ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje”, apo në rastet kur behen shtesa pa leje, apo kur vazhdojnë punimet e ndertimit në objektet pa leje të vetedeklaruara tashmë nga subjektet e interesuara, pas datës së përcaktuar si limit maksimal ligjor për vetedeklarim. Mosveprimi behet edhe me i dukshëm kur kemi të bëjmë me ndertime të ngritura rishtazi pa leje ndertimi.

- Është ende herët të flitet për mireduksionim ose jo të inspektoriateve ndertimore e urbanistike përkatëse, për shkak të kohës së shkurtër të funksionimit të

tyre. Megjithate, nisur nga nje praktike e pasur analizuere dhe rekomanduese qe kemi zhvilluar ne punen tone me organin e Policise te Ndertimit, gjykojme se konkluzionet dhe rekomandimet e shumta qe jane nxjerre kohe pas kohe, do te jene te vlefshme jo vetem per te konstatuar shkeljet e mundshme qe do te kryhen nga ana e ketyre inspektoriateve ne punen e tyre te perditeshme, por ne te njejten kohe do t'i sherbejne atyre si tregues per mireadministrimin e kompetencave dhe funksioneve te tyre specifike ligjore. Nje rendesi e veçante i eshte kushtuar nxitjes se iniciatives se vete organit, per ndreqjen e vlefshmerise se akteve administrative dhe procedurave ne nxjerrjen e tyre.

Çeshtjet e shqyrtuara gjate vitit 2007, kane pasur si problematike te tyre kryesore mosveprimin e organit te Policise te Ndertimit dhe me pas, te Inspektoriateve Ndertimore e Urbanistike, per ekzekutimin e vendimeve per prishje te nxjerra nga ana e Policise te Ndertimit. Pezullimin e punimeve ne ndertimet qe rezultojne me shkelje ne zbatim, apo sanksionim me vendim per ndertimet e kundraligjshme.

Keto raste kane te bejne me shkelje te distancave apo kondicioneve urbanistike gjate zbatimit te projektit te miratuar ne lejet perkatese te ndertimit, apo edhe per ndertime te cilat jane teresisht te kundraligjshme. Gjate shqyrtimit te ketyre rasteve nga ana jone, duke marre disa prej tyre si shembuj konkret, ka rezultuar qe:

1. Ne letren drejtuar Avokatit te Popullit, shtetasi V.Ç banor ne komunen e Lukoves, Sarande, ka paraqitur nje ankese ne lidhje me mosveprimin e ish organit te Policise te Ndertimit, dega Vlore, i transformuar perkatesisht ne Inspektoriat Ndertimor e Urbanistik te Komunes Lukove, per ekzekutimin e nje vendimi per prishjen e nje ndertimi te kundraligjshem.

Sikunder ai shprehej, Policia e Ndertimit, dega Vlore me ane te vendimit nr.142 date 13.05.2003, kishte vendosur prishjen e nje ndertimi te kunderligjshem te shtetasis Ç.L. Megjithate, edhe pas konfirmimeve te shumta per veprim te ish organit te Policise te Ndertimit, nuk ishte vepruar per kete rast, gjendje e cila ka vazhduar me ngritjen dhe funksionimin e Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik te Komunes Lukove. Ne keto rrethana, ankuesi ka kerkuar nderhyrjen e Avokatit te Popullit per zgjidhjen e kesaj çeshtje.

Per shqyrtimin e kesaj çeshtje ne kohen e paraqitjes se saj nga ana e ankuesit, i jemi drejtuar me kerkese per dhenie shpjegimesh Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik Kombetar, dega Sarande, si dhe Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik Kombetar.

Ne shpjegimet e dhena nga ana e kesaj dege jemi informuar se, i eshte kthyer pergjigje ish Drejtorise se Policise te Ndertimit, per mosekzekutimin e vendimit nr.142 date 13.05.2003, pasi shtetasi Ç.L ka paraqitur ne kete kohe prane deges se Vlores, dokumentacionin e meposhtem;

- vendimin nr.1 date 16.07.2003 per dhenie leje dhe shesh ndertimi,
- vendimin nr.1 date 18.08.2003 per shesh ndertimi,
- leje ndertimi nr.2 date 7.10.2003,
- konfirmimi i pageses ne banke me date 15.10.2003,
- dokumentacion i privatizimit te objektit ekzistues.

Ne keto kushte, nga ana e Policise te Ndertimit, dega Vlore, eshte sqaruar se, per shkak te mosdorezimit ne kohe te dokumentacionit ne fjale (i cili me pas ka rezultuar i plote), shtetasi Ç.L do te penalizohej ne baze te nenit 9, te Ligjit nr.8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit".

Per shkak te disponimit te dokumentacionit te plote nga ana e shtetasis Ç.L, ne pergjigje shprehej se behej i pamundur ekzekutimi i vendimit nr.142 date

13.05.2003, perfundim, i cili n'a eshte konfirmuar edhe nga ana e Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik Kombetar.

Shprehja e perdorur konkretisht ne kete pergjigje, "behet i pamundur ekzekutimi i vendimit nr.142 date 13.05.2003", eshte nje konkluzion ligjerisht i pabazuar. Ne nenin 131, te Kodit te Proçedurave Administrative, parashikohet shprehimisht se:

"1. Aktet qe nuk mund te ekzekutohen jane:

- a) ato akte efekti i te cilave eshte pezulluar;
- b) ato akte kunder te cilave eshte bere nje ankim me efekt pezullues;
- c) ato akte te cilat hyjne ne fuqi vetem pasi te miratohen nga nje organ administrativ i ndryshem nga ai qe i ka nxjerre".

Siç evidentohet, ekzekutimi i vendimit nr. 142 date 13.05.2003, nuk eshte ne keto kushte te parashikuara prej Kodit te Proçedurave Administrative, ndaj edhe nuk mund te pretendohet se ky vendim nuk mund te ekzekutohet.

Çeshtja duhet te trajtohet nga nje tjetër kendveshtrim ligjor, qe ka te beje me vlefshmerine e aktit administrativ, ne kushtet kur menjehere pasi ai eshte nxjerre dhe ka hyre ne fuqi, jane paraqitur rrethana e fakte te reja, te cilat godasin themelin dhe vlefshmerine e aktit administrativ.

Keto rrethana e fakte te reja, kane te bejne me dokumentacionin tekniko-ligjor te paraqitur prej shtetasit Ç.L, fakt i cili eshte pasqyruar ne veprimet e metejshme te ndermarra ne kete çeshtje prej Policise te Ndertimit, dega Vlore, me nxjerrjen e aktit administrativ per caktimin e denimit me gjobe per kundervajtjen administrative te kryer, ne baze te parashikimeve te Ligjit nr.8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit".

Pavaresisht ketij veprimi, kemi konstatuar se nderhyrja ligjore e kryer nga ana e Policise te Ndertimit, dega Vlore, nuk ka qene e plote dhe korrekte, pasi nuk eshte mundur te eliminohen pasojat qe mund te sjelle nje akt administrativ ende ne fuqi (vendimi nr. 142 date 13.05.2003), i cili shfaqet dhe aktualisht cilesohet ne kushtet e pavlefshmerise.

Thelbi qendron ne faktin se, eshte nxjerre nje vendim per prishje objekti te kundraligjshem (pra, per nje objekt i cili ligjerisht eshte ngritur pa leje ndertimi), nderkohe qe objekti rezulton te jete me leje ndertimi, menjehere sapo kundervajtesi i supozuar ka paraqitur dokumentacionin ligjor per kete qellim.

Ne keto rrethana, kemi dale ne perfundimin se vendimi nr.142 date 13.05.2003 eshte nje vendim relativisht i pavlefshem, ne perputhje me parashikimet e bera ne paragrafin e pare te nenit 118, te Kodit te Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht qe:

"1. Aktet administrative do te quhen relativisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, kur ato jane nxjerre ne kundertshtim me ligjin, por megjithate nuk jane absolutisht te pavlefshme".

Menjehere pas paraqitjes se dokumentacionit tekniko-ligjor nga ana e z.Lagji, permbajtja e vendimit nr.142 date 13.05.2003, nuk perputhet me qellimin e ligjit, pasi qellimi i ligjit nuk drejton veprimtarine e organit kompetent tek prishja e ndertimeve me leje ndertimi, por tek ato ndertime qe, sipas nenit 45, te Ligjit nr.8405 date 17.09.1998 "Per urbanistiken", i ndryshuar, ngrihen ne kundertshtim me kete percaktim ligjor.

Ndaj ketij akti administrativ, rezulton se nuk eshte ndjekur rruga e ankimit administrativ prej personit qe ka nje interes te drejteperdrejte, nderkohe qe vete organi qe e ka nxjerre ate e ka lene ne fuqi edhe pse e ka quajtur çeshtjen te zgjidhur, duke mos e zbatuar kete akt administrativ, por duke nxjerre nje akt tjetër qe vendos

nje denim administrativ, bazuar ne nje legjislacion tjeter. Rruga qe duhej ndjekur ishte ajo e shfuqizimit ne rast ankimi administrativ ndaj ketij akti, prej ish Drejtorise se Policise te Ndertimit.

Megjithate, meqenese nuk ishte ezauruar pjesa e ankimit administrativ, kemi konstatuar se mbetej ende nje mundesi ligjore pas hyrjes ne fuqi te Ligjit nr.9780 date 16.07.2007 "Per inspektimin e ndertimit", e cila ka te beje me revokimin e ketij akti administrativ, tashme prej vete Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik, te Komunes Lukove.

Kemi theksuar se, ne perputhje me parashikimet e nenit 119, te Kodit te Procedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht qe:

"Per sa kohe qe akti administrativ relativisht i pavlefshem nuk eshte bere objekt i ankimit administrativ ose gjyqesor brenda afateve te percaktuara nga ky Kod, ose nuk eshte revokuar/shfuqizuar nga organi administrativ kompetent, ai prodhon efektet e nje akti administrativ te vlefshem/te rregullt", vendimi nr.142 date 13.05.2003, prodhonte ende efektet e nje akti administrativ te vlefshem.

Ne keto rrethana i kemi rekomanduar Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik, te Komunes Lukove, ne cilesine e organit qe ka te drejten e nxjerrjes se akteve administrative (sikurse ne kete rast), te ndermarre ne çdo kohe te pershtatshme me nismen e tij, ushtrimin e kompetences ligjore te revokimit te vendimit nr.142 date 13.05.2003. Çeshtja eshte ende ne shqyrtim, ne pritje te qendrimit ndaj rekomandimit tone.

2. Ne letren drejtuar Avokatit te Popullit shtetesja A.Zh, banore ne qytetin e Tepelenes, ka shprehur shqetesimin e saj ne lidhje me mosekzekutimin nga ana e organit te Policise te Ndertimit, dega Gjirokaster, te nje vendimi per prishje objekti te kundraligjshem. Sikunder ajo shkruante, ne qytetin e Tepelenes ka ne pronesi nje objekt librari, ne anen jugore te se ciles qe ne vitin 1997, eshte ngritur nje ndertim pa leje nga ana e shtetases E.R.

Ankuesja shprehej se ka kerkuar prej organit te sipercituar prishjen e ketij objekti, nderkohe qe eshte sqaruar nga ky i fundit se, Policia e Ndertimit mund te vepronte ne kete rast vetem mbi bazen e nje vendimi perkates te KRRT-se se Qarkut Gjirokaster. Megjithate, ankuesja shkruante se edhe pse ky vendim ishte marre tashme nga ana e KRRT-se se Qarkut Gjirokaster (nr.82/1 date 28.07.2006), ai ende nuk po ekzekutohej, duke kerkuar nderhyrjen e Avokatit te Popullit per zgjidhjen e kesaj çeshtje.

Me marrjen ne shqyrtim, jane kerkuar shpjegime lidhur me trajtimin e kesaj çeshtje, nga ana e Policise te Ndertimit, dega Gjirokaster, si dhe prej Keshillit te Rregullimit te Territorit, te Qarkut Gjirokaster.

Ne pergjigjen qe Policia e Ndertimit, dega Gjirokaster ka dhene per kete çeshtje, konfirmohej fakti se nisur nga permbajtja e vendimit nr.82/1 date 28.07.2006, kjo e fundit i ishte drejtuar KRRT-se se Qarkut Gjirokaster me shkresen nr.77/1 date 16.11.2006 (Kerkese per rishikim), pasi kishte pasaktesi ne formulimin e ketij vendimi, gje qe veshtiresonte ekzekutimin e tij. Qe nga kjo kohe deri ne dhenien e pergjigjes nga ana e Policise te Ndertimit, dega Gjirokaster, thuhej se nuk ishte derguar ndonje pergjigje, nderkohe qe kjo dege ishte ne pritje te vendimmarrjes nga ana e organit te sipercituar per kete çeshtje.

Keshilli i Rregullimit te Territorit, te Qarkut Gjirokaster, ne pergjigjen e tij konfirmonte se, vendimi ne lidhje me kete çeshtje ishte marre qe ne daten 28.07.2006 (vendimi nr.82/1 date 28.07.2006), ku ishte vendosur prishja e objektit

(verande), te ngritur prej shtetases E.R. Pra, ky vendim ishte i qarte dhe nuk linte vend per paqartesi.

Ajo çfare binte ne sy ne kete praktike te ndjekur nga ana e ish organit te Policise te Ndertimit, sot i transformuar ne Inspektoriat Ndertimor e Urbanistik i Bashkise Tepelene, ishte se ne menyre te dukshme kishte mosveprim dhe anashkalim te pergjegjesive dhe detyrimeve qe Ligji nr.8408 date 25.09.1998 “Per Policine e Ndertimit”, (tashme i shfuqizuar), i ngarkonte ketij organi.

Pavaresisht konstatimit dhe marrjes se vendimit per kunderligjshmerine e ndertimit te sipercituar, nuk ishte ndjekur procedura perkatese e detyrueshme ne perputhje me parashikimet ligjore. Ky konkluzion dilte jo vetem nga parashikimet e bera ne Ligjin nr.8405 date 17.09.1998 “Per urbanistiken”, por gjente mbeshtetje edhe ne parashikimin e bere ne nenin 5, te Ligjit nr.8408 date 25.09.1998 “Per Policine e Ndertimit” (i shfuqizuar), ku thuhej shprehimisht qe:

“Policia e Ndertimit, ne zbatim te kushteve te Ligjit nr.8405 date 17.09.1998 “Per urbanistiken” dhe te Ligjit nr.8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, kontrollon dhe merr masat e duhura per pezullimin e punimeve, prishjen e ndertimit te kunderligjshem, si dhe jep denimin me gjobe”.

Nxirrej perfundimi se kundervajtja administrative (ndertimi i kunderligjshem i kryer) vazhdonte te ekzistonte, ndaj ishte i nevojshem veprimi konkret per ekzekutimin e vendimit nr.82/1 date 28.07.2006 te KRRT-se se Qarkut Gjirokaster, sipas procedures qe tashme percakton Ligji nr.9780 date 16.07.2007 “Per Inspektimin e Ndertimit”, i cili ka shfuqizuar Ligjin nr.8408 date 25.09.1998 “Per Policine e Ndertimit”.

Ndertimi i kundraligjshem i konstatuar ne kete çeshtje, jo vetem qe kishte cenuar pronesine e ligjshme te ankuseses, por perbente shkak per vazhdimin e kesaj gjendje per arsye te mosveprimit korrekt ligjor, nga ana e ish organit te Policise te Ndertimit, sot i transformuar ne Inspektoriat Ndertimor e Urbanistik, te Bashkise Tepelene.

Ne baze te kompetencave dhe detyrave qe Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik te Bashkise Tepelene, i percaktohen ne nenin 4, te Ligjit nr.9780 date 16.07.2007 “Per Inspektimin e Ndertimit”, ku thuhet shprehimisht se:

“Prane çdo bashkie/komune ngrihet inspektoriat ndertimor e urbanistik, i cili, nepermjet kryeinspektorit e inspektoreve, ushtron pergjegjesine e kontrollit dhe zbatimit te ligjshmerise e te standarteve teknike ne fushen e ndertimit dhe urbanistikes dhe ato te parashikuara shprehimisht ne ligje te tjera, brenda territorit administrativ te Bashkise/komunes”, kemi rekomanduar, ekzekutimin ne nje kohe sa me te shpejte te mundshme te vendimit nr.82/1 date 28.07.2006 te KRRT-se, se Qarkut Gjirokaster.

Ne pergjigjen e dhene per kete rekomandim nga ana e Bashkise Tepelene, jemi vene ne dijeni te faktit se kjo bashki nuk ka ngritur nje inspektoriat ndertimor e urbanistik te vetin, sipas parashikimeve te Ligjit nr.9780 date 16.07.2007 “Per Inspektimin e Ndertimit”, por i ka deleguar keto pergjegjesi dhe detyra tek Qarku Gjirokaster.

Ne keto rrethana, i kemi drejtuar nje rekomandim te njejte Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik, te Qarkut Gjirokaster. Çeshtja eshte ne shqyrtim nga ana jone, ne pritje te pergjigjes ndaj ketij rekomandimi.

3. Ne letren drejtuar Avokatit te Popullit, shtetasi L.P banor ne qytetin e Korçes, ka shprehur shqetesimin e tij ne lidhje me mosveprimin e organit te Policise

te Ndertimit, i transformuar perkatesisht ne Inspektoriat Ndertimor Urbanistik Kombetar te Bashkise Korçe, ndaj nje ndertimi te kundraligjshem.

Sikunder ai shkruante, fqinja e tij shtetesja M.P, kishte kryer nje ndertim te kundraligjshem, fakt per te cilin ai i ishte drejtuar per nderhyrje rajonit nr.3, te Bashkise Korçe. Pas verifikimit qe iu be çeshtjes me ane te nje komisioni, ankuesi shkruante se, ishte konstatuar qe ndertimi i ngritur nga ana e M.P, ishte ne kundershtrim me ligjin.

Mbi bazen e ketij konstatimi, me ane te shkreses nr.137 date 5.06.2006 te Bashkise Korçe, ishte njoftuar Policia e Ndertimit dega Korçe dhe i ishte kerkuar nderhyrje per zbatim ligjshmerie ne kete rast, por siç shprehej ankuesi ne letren e tij, nuk ishte ndermarre asnje veprim. Ne keto kushte, ai ka kerkuar nderhyrjen e Avokatit te Popullit per zbatimin e procedurave ligjore ndaj ketij ndertimi te kundraligjshem.

Me marrjen ne shqyrtim te kesaj çeshtje nga ana jone, jane kerkuar shpjegime per trajtimin e saj dhe shkaqet e mosveprimit prej Deges se Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik Kombetar, Korçe (organi kompetent, per fazen tranzitore te parashikuar nga Ligji nr.9780 date 16.07.2007 “Per inspektimin e ndertimit”).

Ne pergjigjen dhe shpjegimet e dhena sqarohej se, dega e Policise te Ndertimit, Korçe, (e transformuar ne ate kohe ne dege te Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik Kombetar), pas njoftimit per ndertim pa leje nga ana e Bashkise Korçe dhe ne baze te proces-verbalit te konstatimit te kundervajtjes nr.23 date 22.06.2006, ka nxjerre akt pezullimin e punimeve me nr.20 date 26.06.2006 dhe me pas, ka nxjerre vendimin nr.48 date 14.07.2006 per prishje objekti.

Ne lidhje me kete vendim jepej konfirmimi se, do te ekzekutohej ne aksionin me te afert te ketij inspektoriati. Nderkohe kemi orientuar ankuesin qe, nese nuk do te kishte veprim brenda nje afati dy mujor nga data e kthimit te pergjigje tone per kete ankese, te n’a ridrejtohej per te mundesuar nderhyrjen tone te metejshme per zgjidhjen perfundimtare te kesaj çeshtje.

Me anen e nje letre te perseritur, ankuesi ka kerkuar nderhyrjen e metejshme Avokatit te Popullit per zgjidhjen perfundimtare te çeshtjes, pasi sikurse ai shkruante, nuk ishte ndermarre asnje mase per ekzekutimin e vendimit per prishjen e objektit te kundraligjshem, te shtetases M.P.

Duke analizuar trajtimin e çeshtjes ne teresi, kemi evidentuar mosveprim dhe anashkalim te pergjegjesive dhe detyrimeve, qe Ligji nr.8408 date 25.09.1998 “Per Policine e Ndertimit”, (tashme i shfuqizuar), i ngarkonte ketij organi.

Pavaresisht konstatimit dhe marrjes se vendimit per kunderligjshmerine e ndertimit te sipercituar, nuk ishte ndjekur procedura perkatese e detyrueshme ne perputhje me parashikimet ligjore. Ky konkluzion dilte jo vetem nga parashikimet e bera ne Ligjin nr.8405 date 17.09.1998 “Per urbanistiken”, por gjente mbeshetje edhe ne parashikimin e bere ne nenin 5, te Ligjit nr.8408 date 25.09.1998 “Per Policine e Ndertimit”, ku thuhej shprehimisht qe:

“Policia e Ndertimit, ne zbatim te kushteve te Ligjit nr.8405 date 17.09.1998 “Per urbanistiken” dhe te Ligjit nr.8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, kontrollon dhe merr masat e duhura per pezullimin e punimeve, prishjen e ndertimit te kunderligjshem, si dhe jep denimin me gjobe”.

Per pasoje, kundervajtja administrative (ndertimi i kunderligjshem i kryer) vazhdonte te ekzistonte, ndaj ishte i nevojshem veprimi konkret per ekzekutimin e vendimit nr.48 date 14.07.2006, sipas parashikimeve te Ligjit nr.9780 date

16.07.2007 “Per Inspektimin e Ndertimit”, i cili ka shfuqizuar Ligjin nr.8408 date 25.09.1998 “Per Policine e Ndertimit”.

Kemi nenvizuar gjithashtu se, kjo menyre trajtimi e çeshtjes nuk respektonte nje nga parimet kryesore te veprimtarise se administrates publike, te sanksionuar ne nje sere aktesh normative nderkombetare, por edhe ne Kushtetuten tone, qe lidhet me konceptin e procesit te rregullt ligjor.

Bazuar ne kompetencat qe Inspektoriati Ndertimor e Urbanistik te Bashkise Korçe, i jepen ne Ligjin nr.9780 date 16.07.2007 “Per Inspektimin e Ndertimit”, i kemi rekomanduar ketij te fundit, ekzekutimin ne nje kohe sa me te shpejte te mundshme te vendimit nr.48 date 14.07.2006 te Policise te Ndertimit, dega Korçe.

Ne pergjigjen e dhene per kete rekomandim, Inspektoriati Ndertimor e Urbanistik, i Bashkise Korçe, me ane te shkreses nr.64/8 date 21.11.2007, pranonte konstatimet dhe rekomandimin e drejtuar nga ana jone, duke shprehur angazhimin per zgjidhjen perfundimtare te shpejte te çeshtjes. Shqyrtimi i kesaj çeshtje eshte mbyllur, duke e konsideruar ate te zgjidhur pozitivisht, ne kushtet qe ankuesi nuk ka bere ndonje ankese tjeter, pasi u njoftua per kete pergjigje.

4. Ne letren drejtuar Avokatit te Popullit, shtetasi H.B, banues ne qytetin e Permetit, ka shprehur shqetesimin e tij ne lidhje me mosveprimin e organit te Policise te Ndertimit, dega Gjirokaster, per sa i perket nje ndertimi te paligjshem qe po ngrihej ngjitur me apartamentin ku ai banon.

Sikunder ai shkruante, shtetasi K.K kishte filluar nje ndertim pa leje ngjitur me apartamentin e tij, ndertim i cili ishte ngritur vetem si karabina. Per kete fakt, ankuesi shkruante se ishte ankuar ne nje sere institucionesh dhe ne organin e sipercituar (tashme i transformuar ne Inspektoriat Ndertimor e Urbanistik te Bashkise Permet), por megjithese ndertimi ishte pezulluar, ende nuk i ishte dhene nje zgjidhje perfundimtare kesaj çeshtje. Ne keto kushte, ankuesi ka kerkuar nderhyrjen e Avokatit te Popullit per zgjidhjen e saj.

Me pranimin dhe marrjen ne shqyrtim te çeshtjes, jane kerkuar shpjegime lidhur me trajtimin e saj, prej Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik Kombetar, dega Gjirokaster, si dhe prej Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik Kombetar.

Ne pergjigjen dhe shpjegimet e dhena nga Inspektoriati Ndertimor e Urbanistik Kombetar, dega Gjirokaster, konfirmohej fakti se nga ana e shtetasis K.K ishte prishur garazhi i ndertuar me vendimin nr.169 date 9.10.1998 te Keshillit te Rrethit Permet, qe ndodhej ne pjesen veriore te baneses se ankuesit.

Me konstatimin e kundervajtjes per prishjen e garazhit dhe rikonstruksionin e tij, ishin mbajtur procedurat perkatese ligjore duke nxjerre; PVKK nr.13 date 28.07.2006 dhe aktin e pezullimit nr.23 date 28.07.2006. Nderkohe ne pergjigje pohohej se, kundervajttesi e kishte respektuar kete akt dhe nuk kishte kryer punime te metejshme, deri ne plotesimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe pajisjen me leje ndertimi. Po ne kete pergjigje, thuhej se ne vazhdim te procedurave, meqenese shtetasi K.K dispononte dokumenta per ndertimin e garazhit qe ne vitin 1998 dhe nuk kishte aplikuar ne KRRT-ne e Bashkise Permet per rikonstruksionin e garazhit, i ishte kerkuar Bashkise Permet per t’u shprehur ne lidhje me kete objekt.

Nga ky trajtim dhe praktike e ndjekur prej organit te Policise te Ndertimit, sot i transformuar ne Inspektoriat Ndertimor e Urbanistik te Bashkise Permet, konstatohej dukshem mosveprim dhe anashkalim i pergjegjesive dhe detyrimeve te percaktuara ne Ligjin nr.8408 date 25.09.1998 “Per Policine e Ndertimit”.

Ne perputhje me parashikimin e nenit 45, te Ligjit nr.8405 date 17.09.1998 “Per Urbanistiken”, i ndryshuar, ndertimi i kryer nga K.K ishte nje ndertim i kundraligjshem, pasi ne te shprehet qe;

“Çdo person fizik me juridik, vendas ose i huaj qe te ndertoje ne territorin e Republikes se Shqiperise duhet te pajiset me leje ndertimi. Ky eshte dokumentacioni i vetem ligjor mbi bazen e te cilit lejohet ndertimi. Leja e ndertimi i jepet personit juridik te licensuar”.

Pavaresisht konstatimit per kunderligjshmerine e ndertimit te sipercituar, procedura e ndjekur ishte e manget dhe jo ne perputhje me parashikimet ligjore te bera, qofte ne Ligjin nr.8405 date 17.09.1998 “Per urbanistiken”, qofte ne nenin 5, te Ligjit nr.8408 date 25.09.1998 “Per Policine e Ndertimit” , ku thuhej shprehimisht qe:

“Policia e Ndertimit, ne zbatim te kushteve te Ligjit nr.8405 date 17.09.1998 “Per urbanistiken” dhe te Ligjit nr.8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, kontrollon dhe merr masat e duhura per pezullimin e punimeve, prishjen e ndertimit te kunderligjshem, si dhe jep denimin me gjobe”.

Per me teper, kemi konkluduar se procedura qe eshte ndjekur nuk duhej te ishte mjaftuar me aq sa eshte konfirmuar zyrtarisht ne shkresen e Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik Kombetar, dega Gjirokaster, pasi siç rezultonte dhe ne reference te parashikimeve te bera ne Kodin e Proçedurave Administrative, vendimi i pezullimit eshte nje vendim i ndermjetem ne nje proçedim administrativ tashme te filluar dhe qe duhej te perfundonte me nje vendim perfundimtar, ne perputhje me kompetencat ligjore te ketij organi. Proçedura e detyrueshme ligjore, percaktonte jo vetem marrjen e mases se pezullimit ndaj ndertimit te kunderligjshem, por edhe qe brenda afateve ligjore te percaktuara ne Ligjin nr.7697 date 7.04.1993 “Per kundervajtjet administrative” (neni 14), te merrej vendimi perfundimtar per çeshtjen. Kjo proçedure nuk ishte ndjekur plotesisht ne kete rast.

Per pasoje, akti i pezullimit nr.23 date 28.07.2006, kishte humbur prej kohesh fuqine e tij juridike si akt administrativ i nxjerre nga ana e Policise te Ndertimit, dega Gjirokaster, ne perputhje me parashikimet e bera ne nenin 14, te Ligjit “Per kundervajtjet administrative”.

Perfundimisht konstatohej qe kundervajtja administrative (ndertimi i kunderligjshem i kryer) vazhdonte te ekzistojte, ndaj ishte i nevojshem fillimi i nje proçedure te re, duke konstatuar ndoshta edhe punime te reja te kunderligjshme ne po te njejtin ndertim, sipas rruges dhe proçedures qe tashme percaktonte Ligji nr.9780 date 16.07.2007 “Per Inspektimin e Ndertimit”.

Sa me siper, i kemi rekomanduar Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik Kombetar, dega Gjirokaster, rifillimin sa me te shpejte te proçedures ligjore ndaj ndertimit te kundraligjshem te shtetasit K. K. dhe nxjerrjes se vendimeve perkatese per kete rast, ne perputhje me parashikimet e bera ne ligjin perkates. Çeshtja eshte ne shqyrtim nga ana jone, ne pritje te pergjigjes ndaj ketij rekomandimi.

5. Ne letren drejtuar Avokatit te Popullit shtetasi A.Sh, nga qyteti i Tiranës, ka shprehur shqetesimin ne lidhje me moszbatimin e disa vendimeve te marra nga ana e KRRT-se ne Bashkine Durres, si dhe nga ana e KRRTRSH-se, per prishjen e disa ndertimeve pa leje ne nje prone te ligjshme te tij, prej organit te Policise te Ndertimit, dega Durres, i transformuar perkatesisht ne Inspektoriat Ndertimor e Urbanistik, te Bashkise Durres.

Sikunder ai shkruante, me ane te vendimit nr.919 date 22.06.1995, i eshte kthyer nga ana e Komisionit perkates te Kthimit dhe Kompensimit te Pronave ish Pronareve, nje siperfaqe trualli e lire e ndodhur ne lagjen 13, Plazh, Durres, prone te cilen e ka regjistruar ne ate kohe ne hipoteke. Me vendimin nr.6 date 27.06.1996, te

KRRT-se ne Bashkine Durres, ne kete truall eshte miratuar leje per shesh ndertimi, ne perputhje me studimin urbanistik te zones te miratuar nga ana e KRRTRSH-se.

Pavaresisht kesaj, ankuesi shkruante se per shkak te ngjarjeve te vitit 1997 dhe ne vitet ne vijim, ne kete truall filluan te ngrihen ndertime pa leje, per te cilat ai ishte drejtuar prej kohesh institucioneve dhe organeve kompetente per marrjen e masave ndaj tyre.

Si pasoje e mosveprimit nga ana e organeve kompetente, ne kete truall jane ngritur 6 ndertime pa leje ne periudha kohore te ndryshme. Per prishjen e ketyre ndertimeve, ankuesi shkruante se KRRT-ja ne Bashkine Durres kishte marre fillimisht nje vendim ne daten 30.01.1998, vendim i cili nuk u zbatua nga ana e organit te Policise te Ndertimit.

Ne vazhdim, KRRT-ja ne Bashkine Durres mori nje vendim tjeter me nr.5 date 25.04.2002, vendim i cili perseri nuk u zbatua. E njejta gje ndodhi sipas ankuesit edhe me vendimin nr.9 date 15.03.2005 te marre nga ana e KRRTRSH-se, i cili perseri kishte mbetur i pazbatuar prej organit te Policise te Ndertimit.

Jo vetem qe dega e Policise te Ndertimit, Durres, nuk kishte vepruar, por ankuesi shkruante se ajo nuk kishte marre parasysh as urdherin e dhene nga ana e ish titullarit te organit te Policise te Ndertimit, me shkresen date 16.05.2006, per ekzekutimin e ketyre vendimeve. Ne keto kushte, ankuesi ka kerkuar nderhyrjen e Avokatit te Popullit per zgjidhjen perfundimtare te kesaj ceshtje.

Me marrjen ne shqyrtim te kesaj ceshtje nga ana jone, jane kerkuar shpjegime te metejshtme lidhur me trajtimin e saj, nga ana e ish organit te Policise te Ndertimit dhe deget e krijuara gjate transformimit te tij, deri ne ngritjen e Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik te Bashkise Durres.

Megjithese jane kaluar te gjitha afatet kohore brenda te cilave duhej te ishte dhene nje pergjigje dhe pas kerkesave te perseritura per kete qellim, nuk eshte dhene informacioni i kerkuar. Ky fakt, evidentonte nje shkelje te perseritur te detyrimit ligjor te organit ne fjale per dhenien e shpjegimeve te kerkuara nga ana e Institucionit tone, por realisht n'a krijonte nje pozite te veshtire me vete ankuesin, ne lidhje me ankesen qe ai kishte paraqitur tek ne per shqyrtim.

Inaktiviteti ne ekzekutimin e vendimeve, eshte konstatuar si shkak per vazhdimin e gjendjes se shkeljes se te drejtave qe ankuesit i rrjedhin nga pronesia e tij e ligjshme, dhe si nje tregues negativ ne permbushjen e detyrime qe percaktohen prej Ligjit nr.9780 date 16.07.2007 "Per inspektimin e Ndertimit".

Evidentohej se kishim te benim me mosveprim te plote, per ekzekutimin e vendimeve qe kishte nxjerre KRRT-ja ne Bashkine Durres, si dhe KRRTRSH-ja, ne zbatim te Ligjit Nr.8408 date 25.09.1998 "Per Policine e Ndertimit", por tashme edhe te Ligjit nr.9780 date 16.07.2007 "Per inspektimin e Ndertimit".

Detyrimi per mbrojtjen e prones dhe te drejtave qe rrjedhin prej saj, sikurse edhe ne kete ceshtje, eshte sanksionuar shprehimisht edhe ne paragrafin e pare te nenit 1, te protokollit 1, te Konventes Europiane per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe Lirive Themelore, ku citohet se:

"Çdo person fizik ose juridik ka te drejte per respektimin e pasurise se tij. Askush nuk mund te privohet nga prona e tij, veçse per arsye te dobise publike dhe ne kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e pergjithshme te se drejtes nderkombetare".

Per sa me siper, i kemi rekomanduar Inspektoriatit Ndertimor e Urbanistik te Bashkise Durres, ekzekutimin ne nje kohe sa me te shpejte te vendimeve te KRRT-se ne Bashkine Durres, perkatesisht te vendimit te dates 30.01.1998, si dhe te vendimit nr.5 date 25.04.2002, si dhe ekzekutimin ne te njejtat kushte, te vendimit te

KRRTRSH-se per kete çeshtje, me nr.9 date 15.03.2005. Çeshtja eshte ne shqyrtim nga ana jone, ne pritje te pergjigjes ndaj ketij rekomandimi.

b) Ankesat per Ujesjelles Kanalizimet

Gjatë vitit 2007, janë shqyrtuar 20 ankesa, që kanë patur të bëjnë me Ndërmarrjet e Ujësjiellës dhe Kanalizimeve. Nga këto 5 ankesa janë zgjidhur në favor, 3 janë ende në shqyrtim, 8 kane qenë të pabazuara dhe 11 ankesa kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencave.

Në vijim po trajtojmë ankesat e zgjidhura pozitivisht:

1. Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nivelin dhe cilësinë e shërbimeve publike që ofrohen nga Ujësjiellës-Kanalizime sha Tiranë. Kjo veprimtari është parë e lidhur ngushtë, jo vetëm me nevojën e rritjes së standarteve të shërbimit të furnizimit me ujë të konsumatorit, por dhe me qëllimin e ligjshëm për të ofruar një model të pranueshëm të mirëadministrimit të kësaj shoqërie, për respektimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve.

Nisur nga një ankesë e paraqitur nga nje shtetas, Avokati i Popullit konstatoi se Ujësjiellës-Kanalizime sha Tiranë, mbante në përdorim të paligjshëm për nevojat e saj një pjesë të sipërfaqes së një apartamenti, i cili ishte pronë e këtij ankuesi.

Nga të dhënat dhe verifikimet e kryera rezultoi e provuar se ky ankues kishte në pronësi një apartament në Rrugën “Ali Demi”. Kjo pronë figuronte e rregjistruar në emër të tij, në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë me sipërfaqe banimi 51.9 m². Nga këqyrja në vend e këtij objekti, u konstatua se pjesa kryesore e tij ishte përshtatur në ambjent shërbimi “Bar”, ndërsa pjesa tjetër ishte e ndarë me mur dhe shfrytëzohej si ambjent i veçantë nga dy punonjëse te UK sha Tiranë për arkëtimin e shumave të konsumit të ujit nga banorët e zonës.

Pronari i apartamentit në fjalë, njëkohësisht edhe ankuesi, shpjegoi se me blerjen e kësaj prone në vitin 2003 nga ana e tij ishte vënë në dijeni edhe UK sha, por nga ana e kësaj ndërmarrje nuk ishte bërë asnjë veprim për lidhjen e një kontrate të rregullt qiraje.

Ndodhur përpara këtij fakti, Avokati i Popullit paraqiti një rekomandim prane UK sha Tiranë, duke kërkuar që të merreshin masat urgjente për të ligjësuar posedimin e tyre mbi një pjesë të sipërfaqes në pronësi të ankuesit.

Në mbështetje të kësaj kërkesë UK sha Tiranë ju bënë të njohura një sërë detyrimesh kushtetuese dhe ligjore për të kryer një veprim të tillë dhe ju tërhoq vëmendja për vonesat në veprimet në favor të pronarit të ligjshëm.

Në përgjigjen e Drejtorit të UK sha Tiranë, u bë njohur fakti se menjëherë ishte thirrur pronari i apartamentit dhe kishin filluar procedurat e plotësimit të dokumentacionit ligjor për lidhjen e kontratës së qirasë. Pra u zgjidh çështja pa qenë nevoja që palët t'i drejtoheshin gjykatës.

Megjithëse kjo çështje u zgjidh pozitivisht, ajo tregoi se sa inaktive janë këto struktura për të vënë me iniciativën e tyre në pozita të ligjshme veprimtarinë që ushtrojnë.

2. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit u paraqit një ankesë me anë të së cilës një shtetas pretendoi se UK sha Tiranë nuk kishte kryer ndreqjen e difektit te linjes së ujit që furnizonte pallatin e tij.

Nisur nga rrethanat e çështjes dhe pretendimet e prezantuara, u ndërhy menjëherë pranë UK sha Tiranë për të sqaruar shkaqet e vonesave dhe afatin brenda te cilit do te bëhej e mundur ndreqja e këtij difekti.

Me anë të përgjigjes të Drejtorit të UK sha Tiranë jemi vënë në dijeni se problemi i ngritur ishte marrë në konsideratë si i drejtë dhe ishin marrë masat konkrete për zgjidhjen e tij. Por sipas tyre shkak i vonesave ishin bërë vendosja e paautorizuar e pompave të ujit me anë të të cilave ishte ulur ndjeshëm furnizimi me ujë i rrjetit të pallatit.

Duke mirëkuptuar kërkesat e banorëve, UK sha Tiranë njoftoi gjithashtu se kishte vendosur që të kryente një ndërhyrje të re në rrjet për të shtuar prurjet e ujit për banorët. Për këtë qëllim ishte hartuar edhe një projekt specifik nga ana e UK sha Tiranë, i cili sipas drejtorit të kësaj ndërmarrje pritej të vihej në zbatim shumë shpejt.

3. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit një shtetas paraqiti një ankesë në të cilën pretendoi se Ujesjelles sha Permet nuk furnizonte normalisht me ujë zonën e tij të banimit, ashtu si zonat e tjera pranë këtij qyteti, por ndiqte disa orare më të kufizuara, duke i mohuar sipas tij barazinë në shërbimet jetike komunitare.

Pasi u njohëm me këtë ankesë, si dhe pasi kryem ndërhyrjet e duhura me UK sha Permet u arrit që kjo ndërmarrje të bënte një marreveshjeve me kryepleqte e zonave përreth Qytetit të Permetit, në të cilën u ra dakort për sasine mesatare të furnizimit me ujë, sipas kërkesave të banorëve.

Pas kësaj jemi njoftuar se zona ku banonte ankuesi është furnizuar normalisht me 300 litra uje në ditë për banor, çka, sipas UK sha Permet, ishte një sasi e kenaqshme për të plotësuar nevojat e banorëve.

4. Në ankesën e tij një shtetas pretendoi se faturuesja e zones së UK sha Tiranë në bashkepunim me disa lokale poshte pallatit të tij kishte manipuluar matësit (sahatet) në mënyrë të tillë që këto subjekte të paguanin më pak dhe në dëm të banorëve të tjerë të ndërtesës. Avokati i Popullit pasi u njoh me këtë akuzë të rëndë në ngarkim të një punonjësi të UK sha Tiranë, kërkoi pranë kësaj të fundit që të ngrihej menjëherë një grup pune për verifikimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive të mundshme në rast shkelje.

Nga pergjigja e paraqitur nga kjo ndermarrje, jemi vënë në dijeni se ishte ngritur një grup pune, i cili pasi kishte kryer kontroll në pallatin e ankuesit, kishte konstatuar se gjendja e matesit të tij ishte në përputhje me shumen e faturuar dhe se pretendimi i tij se rrjeti kishte lidhje të jashtme nga pallati nuk u vërtetua. Ndërsa lidhur me disa faturime të tjera aforfe të konstatuara gjatë këtij kontrolli, UK sha Tiranë njoftoi se ndaj kësaj punonjëse ishte marrë masa e largimit nga puna.

5. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, një grup banorësh në Tiranë paraqitën një ankesë, në të cilën shprehën shqetësimin se megjithëse kishin lidhur kontrata me UK sha, kishin rreth 12 muaj që nuk furnizoheshin me uje te pijshem.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me këtë ankesë, kërkoi të informohej hollësisht nga ana e UK sha, lidhur me rrethanat e problemit që ngrinin banorët, me masat administrative apo teknike që ishin marre për të furnizuar ata me uje te pijshem dhe pengesat që ishin hasur ne kete kuader. Perveç kesaj u kerkuan afate konkrete brenda te cilave do te behej i mundur ky investim.

Me ane te pergjigjes se paraqitur nga Drejtori i Pergjithshem i UK sha jemi njohur se mungesa e ujit kishte ardhur si pasoje e parregullsive qe kishin shoqeruar lejen e ndertimit te pallatit, lidhur me oponencen e ujesjelles-kanalizimeve.

Si rrjedhim UK sha kishte hartuar një tjetër projekt për furnizimin me uje te pijshem, të pallatit të ankuesve i cili u vu në zbatim dhe aktualisht ka permiresuar ndjeshem furnizimin e banorëve.

Pergjithësisht ne konstatojmë se shërbimi i ujësjellës kanalizimeve ka patur problematika sporadike gjatë vitit 2007. Por duke i përgjithësuar ato, konstatojmë se çështjet që duhet të merren në konsideratë nga administrata shtetërore janë si vijon:

1. UK sha ende nuk po përmbush funksionin e saj kryesor për furnizimin e rregullt me ujë të qytetarëve. Në këtë rast mendojmë se duhet marrë shëmbull nga disa qytete të mëdha si Korça apo Pogradeci, ku furnizimi me ujë është i pandërprerë, për shkak të disa investimeve serioze me donatorë të huaj

2. UK sha nuk ka ende kapacitetet e nevojshme financiare dhe teknike për të garantuar cilësinë e ujit të pijshëm. Kjo ka ardhur si pasojë e mungesës së fondeve të mjaftueshme për të kryer ndërhyrje në rrjetet e amortizuara dhe për të ndryshuar pajisje të tjera teknike që ndikojnë në rrjetin e ujit të pijshëm.

3. UK sha ende nuk po përmirëson shërbimin kontraktor ndaj klientëve të saj, duke e lënë mardhenien e furnizimit shpesh pa kontratë dhe pa faturim të rregullt.

4. UK sha vepron pa program të rregullt për prishjen e linjave të paligjshme të ujësjellësve dhe në shumë raste nisat vetëm kur ka ankesa nga banorë të rajoneve urbane, të cilët nuk kanë ujë për shkak të një ndërhyrje të paligjshme në rrjetin e tyre.

Ne mendojmë se këto të meta të punës së UK sha duhet të riparohen sa më shpejt vetëm nëpërmjet rrugës së privatizimit ose dhënies me kontratë konçesioni, praktikë kjo e fundit, e cila nisur nga eksperiencia e suksesshme në disa qytete, është model që duhet ndjekur edhe për zona të tjera të vendit.

Avokati i Popullit në kuadrin e kalimit të këtij shërbimi pranë organeve vendore, do të përpiket që të shqyrtojë me seriozitet kërkesat dhe ankesat për përmirësimin e këtij shërbimi, pasi uji i pijshëm, shërbimi dhe cilësia e tij, janë gjithmonë një e drejtë elementare për çdo shtetas dhe një detyrim i pashmangshëm publik.

c. Ankesa për shërbimet e telefonisë

Avokati i Popullit ka qenë një ndër institucionet e para që ka shprehur publikisht shqetësimin për tarifën e larta të telefonave celularë në Shqipëri. Madje ai ka insistuar se këto tarifa vendosen dhe aplikohen nga operatorët privatë në mënyrë të pakontrolluar nga organet shtetërore përgjegjëse.

Kjo situatë mendojmë se vazhdon edhe sot, paçka masave të marra kohët e fundit nga Qeveria Shqiptare. Ne konstatojmë me keqardhje se ende tarifën celulare veprojnë në kushtet e një tregu të paliberalizuar, ku konsumatori përballë përpara një duopoli të fuqishëm, i cilësuar kështu edhe nga Raporti Hetimor i Kuvendit të Shqipërisë Nentor 2006.

Ashtu siç jeni në dijeni, Institucioni i Avokatit të Popullit hetoi në mënyrë të pavarur këtë çështje dhe shërbeu si bashkëpunëtor i ngushtë i komisionit të atëhershëm parlamentar me synimin e vetëm që ky problem të vinte në lëvizje organet kompetente shtetërore dhe t'i jepte zgjidhje ligjore situatës së krijuar.

Gjithashtu në rekomandimet dhe komunikimet me organet më të larta shtetërore, ne kemi kërkuar vazhdimisht përgjegjësi konkrete për mosveprime administrative, të cilat kishin lënë shteg për vakum ligjor në kontrollin e tarifave, duke privilegjuar në mënyrë flagrante operatorët celularë.

Avokati i Popullit ka deklaruar më shumë se një herë në këto 7 vjet se Enti Rregullator i Telekomunikacioneve nuk ka luajtur rolin e tij për të mbrojtur interesat e konsumatorit dhe për të vënë nën kontroll operatorët privatë të telefonisë celulare.

Për këtë arsye që nga viti 2003 e në vijim vazhdimisht kemi kërkuar që nga ana e ERT-së, të hartohet dokumenti final i Metodologjisë së Caktimit të Tarifave për tu miratuar më pas në Këshillin e Ministrave. Por vonesat e pajustificuara të këtij

organi, kanë bërë që ky shqetësim të brente edhe Qeverinë Shqiptare, e cila se fundi propozoi masa drastike, tashmë të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

Avokati i Popullit ka mendimin e tij të palëkundur se shkarkimi i Bordit të ERT-së nuk zgjidhi problemin e ngutshëm të konsumatorëve shqiptarë. Por me masat e marra u rrit vetëm përgjegjshmëria publike e organeve tona në përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Për të zgjidhur çështjen e parë dhe më kryesore për të gjithë ne, mendojmë se ajo kërkon një angazhim dhe veprime konkrete në disa aspekte.

Konkretisht, ne mendojmë se si hap i parë drejt uljes dhe normalizimit të tarifave është hapja e tregut konkurrues nëpërmjet vënies në funksionim në vitin 2008 të operatorit të tretë celular “Eagle Mobile”, e pas tij edhe ndonjë tjetër. Avokati i Popullit konstaton se ka tre vjet që shteti shqiptar paguan taksën e licencës për këtë kompani, e cila është vënë në funksionim në mars 2008, ndaj dhe kjo situatë duhet zgjidhur sa më shpejt.

Së dyti, në mënyrë të përshpejtuar duhet vepruar jo vetëm në miratimin sa më parë nga Kuvendi të Ligjit të ri “Për komunikimet elektronike”, por dhe të miratimit dhe vënies në zbatim nga ana e Këshillit të Ministrave të metodologjisë së caktimit të tarifave. Tashmë Qeveria, pas datës 8 shkurt 2008 nuk mund të justifikohet se ERT-ja nuk ka paraqitur Metodologjinë e Tarifave.

Së treti, ka ardhur koha që kompanitë prezente të telefonive celulare në vend të japin llogari për veprimtarinë e tyre të deritanishme, lidhur me abuzimet që janë konstatuar në Raportin Hetimor të Kuvendit Nëntor 2006.

Avokati i Popullit konstaton me keqardhje se raporti në nëntor 2006 perfunditmar i Komisionit Hetimor i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë nuk është vënë ende në zbatim. Në pikën e fundit të rekomandimeve ky Komision i propozonte Kuvendit që kopje e raportit t’i dërgohej organit të Prokurorisë për hetime.

Por nga interesimi ynë pranë këtij organi është vërtetuar se pranë Prokurorisë Shqiptare nuk është paraqitur një dokument i tillë???

Ky fakt shumë tronditës nuk përkon me rëndësinë me të cilën duhet të trajtoheshin problemet e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit në Shqipëri nga organi ligjvënës dhe aparati administrativ në shërbim të tij.

Avokati i Popullit mendon se askush në Republikën e Shqipërisë nuk duhet t’i fshihet kontrollit dhe përgjegjësisë ligjore. Ndaj dhe është rasti që Kuvendi duhet të vërë në lëvizje organet kompetente për të hetuar dhe zbardhur deri në fund veprimtarinë abuzuese të telefonisë celulare në vendin tonë.

Ne nuk pajtohemi asnjëherë me fakte tashmë të njohura, sipas të cilave operatorët e telefonisë së lëvizshme Vodafon dhe AMC vazhdojnë të aplikojnë normat më të larta të fitimit në tregun evropian e më gjërë.

Për t’i dhënë fund kësaj vjedhje në kurriz të konsumatorit shqiptar, ndjehet e nevojshme që masat e mësipërme të gjejnë një zgjidhje sa më të shpejtë.

Avokati i Popullit ka qenë dhe do të ngelet këmbëngulës në këtë çështje, pasi beson se është në anën e drejtë të saj, në respekt të ligjit dhe në mbrojtje të të drejtave të konsumatorit.

Qëllimi ynë kryesor do të vijojë të jetë që masat e marra me karakter ligjor të pasohen nga veprime konkrete në terren, të cilat do ta bëjnë mëse real vizionin e Qeverisë Shqiptare për liberalizimin e tregut të telefonisë në vend.

9. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës

Për vitin 2007 janë trajtuar gjithsej 73 ankesa për vetë Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe organet në vartësi të saj, nga të cilat 2 prej tyre pas shqyrtimit kanë rezultuar të pabazuara, 22 kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencave, 2 janë zgjidhur në mënyrë pozitive dhe 2 ankesa janë ende në shqyrtim. Së bashku me numrin e çështjeve të ndjekura me organet në varesi të METE-s janë trajtuar gjithsej 98 ankesa.

Në vijim po paraqesim ankesat e zgjidhura pozitivisht, duke nxjerrë në pah edhe problematikat kryesore me të cilat është përballur puna e Avokatit të Popullit me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe strukturat administrative në varësi të saj.

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit një shtetas me anë të ankesës së tij, pretendoi se Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE) kishte zvarritur pa shkaqe ligjore miratimin e plotë të kërkesës së subjektit që ai përfaqësonte për shfrytëzimin konçesionar të formës BOO (ndërtim, zotërim, shfytëzim) të HEC-it Egnatia, Komuna Hotolisht, Librazhd.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të paraqitur rezultoi se në mbështetje të Ligjit Nr.7973, datë 26.7.1995 “Për Konçesionet dhe Pjesëmarrjen e Sektorit Privat në Shërbimet Publike dhe Infrastrukturë” subjekti “Remi sh.p.k”, kishte dorëzuar me dt.01.03.2005 të gjithë dokumentacionin për marrjen me konçesion të HEC-it Egnatia, Librazhd. Madje nga ana e ish Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës i ishin kërkuar disa dokumenta shtesë për përgatitjen e plotë të dosjes për miratim.

Nga të dhënat e tjera konstatohet se shoqëria e mësipërme kishte kërkuar ndërtimin e HEC-it Egnatia, për arsye se toka nëpër të cilën ishte ideuar dhe skicuar për shfrytëzim kjo vepër, ishte pronë e tyre. Fillimisht subjekti kishte kryer studimin e fizibilitetit, planin e biznesit dhe oponencat e tjera teknike. Më tej me një vendim të Këshillit të Komunës Hotolisht është miratuar leja e ndërtimit për objektin kryesor të HEC-it. Gjithashtu nga ana e Këshillit Kombëtar të Ujit ishte miratuar kërkesa për përdorimin e rezervës ujore për prodhim hidroenergjie. Të gjitha këto veprime së bashku me përgatitjen e stafit punonjës dhe investimeve fillestare për veprën, kishin patur një faturë shpenzimi të konsiderueshme për këtë subjekt.

Nga relacionet e përbashkëta për këtë projekt, përgatitur nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, rezultonte se Shoqëria “Remi” sh.p.k, kishte patur epërsi në përzgjedhje, pasi kishte qenë e vetmja në zonën e Librazhdit që kishte përmbushur kriteret për kryerjen e një investimi të “madh”, në rreth 2.5 Milion Euro. Ky investim do të mundësonte, sipas tyre, një prodhim energjie 25 milion kwh në vit dhe do të ishte një projekt mjaft i dobishëm për mbulimin me energji elektrike të nevojave të zonës së Librazhdit.

Në vijim të këtij relacioni, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, kishte paraqitur pranë Këshillit të Ministrave për miratim me dt.16.12.2005 Projekt-Vendimin “Për fillimin e procedurës së dhënies me konçesion, të formës BOO si propozim i pakërkuar, për ndërtimin e HEC-it “Egnatia” Komuna Hotolisht, në rrethin e Librazhdit”.

Me tej, me anë të një shkresë ish Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave kishte njoftuar procedurialisht, midis të tjerash, METE-n se projekt-vendimi i mësipërm për HEC-in “Egnatia” ishte miratuar.

Pas kësaj në Janar 2006 dhe në vazhdim, Shoqëria "Remi" sh.p.k kishte qenë në pritje për kryerjen e procedurave të mëtejshme ligjore, të cilat do të mundësonin në vijim miratimin dhe lidhjen përfundimtare të marreveshjes konçesionare.

Por në kontaktet me METE-n subjekti ishte njohur me faktin se kjo ministri kishte vendosur për mosvazhdimin e trajtimit të mëtejshëm të praktikës konçesionare, me arsyetimin se "kërkesa e Shoqërisë "Remi" sh.p.k do të rishqyrtohej sërish pasi të rishikohej kuadri ligjor për konçesionet".

Ky qëndrim i METE-s kishte hasur në kundërshtime dhe protesta të shumta të subjektit, lidhur me padrejtesinë që po i bëhej në dëm të biznesit të tij të ligjshëm. Ai ishte shprehur midis të tjerash se procedura e miratimit dhe lidhjes së marrëveshjes konçesionare duhet të ishte përfunduar me Ligjin Nr. 7973, datë 26.7.1995 "Për Konçesionet dhe Pjesëmarrjen e Sektorit Privat në Shërbimet Publike dhe Infrastrukturë" si akt në fuqi që rregullonte deri në atë kohë mardheniet në fushën e konçesioneve, me të cilin u trajtua fillimisht edhe praktika e këtij subjekti.

Avokati i Popullit, pasi verifikoi nëpërmjet METE-s procedurat e ndjekura për këtë çështje, arriti në përfundimin se mënyra me anë të së cilës ishte trajtuar Shoqëria "Remi" sh.p.k gjatë gjithë kësaj procedure, përbënte një zvarritje burokratike të pashpjegueshme në kundërshtim me të drejtat dhe interesat e ligjshme ekonomike të këtij subjekti.

Praktika për dhënien në konçesion të HEC-it Egnatia rezultoi se ishte pezulluar në mënyrë të padrejtë për më shumë se 1 vit, megjithëse kishte ekzistuar kuadri ligjor përkatës dhe kriteret e tjera tekniko-administrative.

Pezullimi që METE i bëri kësaj praktike anashkaloi në mënyrë të dyshimtë miratimin në Këshillin e Ministrave të hapjes së këtyre procedurave. Madje ky pezullim nuk ishte shoqëruar me një akt administrativ konkret.

Gjithashtu referuar listës së subjekteve të tjera konçesionare të miratuara me parë, Avokati i Popullit u shpreh se refuzimi i vazhdimit të procedurave dhe rivendosja në afat me ligjin e ri në mënyrë jo të barabartë shprehte një trajtim diskriminues ndaj subjektit të mësipërm.

Të gjitha arsyet dhe argumentat e mësipërme u bënë pjesë e një rekomandimi që ju dërgua METE-s ku ndër të tjera shprehej habia se si në kushtet e një krize energjitike dhe nevojës së ngutshme për rritje të investimeve në prodhimin e hidroenergjisë, ishte vepruar në një mënyrë të tillë.

Krahas kësaj u kërkuar miratimi i shpejtë i projektit konçesionar dhe krijimi i lehtësirave ligjore ndaj subjektit të mësipërm, për të rifituar kohën e humbur dhe shmangur dëmet e mëtejshme financiare. Një kopje e këtij rekomandimi ju drejtua edhe Kryeministrit të Shqipërisë me qëllimin për ta njohur atë me trajtimin e që ju bëhej investitorëve vendas në fushën aq shumë të rëndësishme, siç është ajo e energjistikës.

Në përgjigje të interesimit dhe ndërhyrjeve tona për këtë çështje Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjistikës Z. Genc Ruli ka sqaruar se në zbatim të Ligjit Nr.9663, date 18.12.2006 "Për koncesionet" dhe te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.27, date 19.01.2007 "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve" , me VKM nr.126, date 14.03.2007 ishte miratuar fillimi i procedurës për ndërtimin me koncesion të formës "BOT" të hidrocentralit "Egnatia", projekti i te cilit ishte propozuar nga shoqeria "Remi" shpk.

Gjithashtu METE kishte publikuar ftesen per oferte për pjesëmarrjen në këtë procedure, të cilën në përfundim e fitoi Shoqëria "Remi sh.p.k".

Avokati i Popullit megjithëse mundësoi sadopak me ndërhyrjen e tij për zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi, i ka konsideruar zvarritjet e procedurave

administrative një dukuri mjaft negative dhe të papranueshme të punës së kësaj ministrie, duke shkaktuar në terren jo pak dëme për investitorët privatë.

2. Nisur nga disa njoftime të bëra publike nëpërmjet medias, Institucioni i Avokati të Popullit filloi me iniciativën e tij hetimin e faktit se pranë Ish-Kombinatit të Tekstileve Berat, aktualisht “Tekstile sha” qëndronin të vendosura disa kompresorë me përmbajtje amoniaku, të cilat për vetë specifikat e tyre përbënin rrezik të madh për jetën dhe shëndetin e banorëve përreth.

Nga të dhënat e grumbullura si rezultat i kqyrjes në vend të këtyre kompresorëve, si dhe nga korrespondenca me përfaqesues të Inspektoratit Qëndror Teknik dhe Drejtorit të “Tekstile sha” Berat, rezultoi se:

Në një nga objektet e Shoqërisë “Tekstile sha” Berat ekzistonte një repart i quajtur “Freskore”, i cili në lartësinë 9 metra përmbante 6 kompresorë amonjaku (NH₃) nën presion me kapacitet 16 m³ secili dhe presion 2-2.5 atm. Këta kompresorë ishin jashtë përdorimit dhe gjendja e tyre kishte mbetur e tillë që prej 20 vjetësh. Në pamje të parë kompresorët nuk paraqisnin rrjedhje apo çlirim të dukshëm të amonjakut në mjedis, por ky rrezik ishte mjaft i lartë për shkak të mungesës me vite të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së tyre.

Gjatë vizitës së përfaqësuesve të Avokatit të Popullit në objektin “Freskore” nuk u gjet roje për ruajtjen e kompresorëve. Objekti “Freskore” nuk kishte dritare dhe ngjante me shumë me një ngrehinë që ndikohej maksimalisht nga faktorët e jashtëm atmosferik.

Sipas specialisteve të shëndetit publik të kontaktuar nga ana jonë, në rast derdhje apo çlirimi në mjedis të amonjakut, kjo lëndë shkakton ndikime të drejtpërdrejta në sistemin nervor qëndror të njeriut, duke sjellë çrregullime të ndryshme në aparatën e frymëmarrjes, deri në paralizimin e tij të plotë.

Nisur nga të gjitha konstatimet e mësipërme, Avokati i Popullit i kërkoi fillimisht Shoqërisë Tekstile sha të vinte në ruajtje këtë objekt dhe me tej të mundësonte zhvendosjen e lëndës së rrezikshme. Por në prononcimin e tyre është bërë i njohur fakti se kjo shoqëri ishte në procedurat e falimentit dhe nuk dispononte fonde për të zhvendosur apo degazuar kompresorët e amonjakut.

Për këtë çështje ata kishin prezantuar kërkesat e tyre të vazhdueshme në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, por nuk kishin marrë mbështetje financiare nga ky organ.

Nga të dhënat e administruara për veprimtarinë e Ish Inspektoratit të Pajisjeve nën Presion, aktualisht Inspektorati Qendror Teknik, rezultoi se Zyra Rajonale në Fier kishte dijeni për këtë situatë dhe kishte kryer madje edhe inspektimet në objekt. Por këto veprime nuk kishin vijuar aspak me ndonjë masë të mëtejshme për të eliminuar pasojat negative që mund të sillte amortizimi i mëtejshëm i depozitave të amonjakut.

Si konkluzion i mos marrjes së masave parandaluese nga organet kompetente, Avokati i Popullit paraqiti një rekomandim pranë METE-s dhe IQT-së ku i kërkoi që të merreshin masat e duhura për sigurimin e objektit, dhe më tej për degazimin e lëndës së depozituar.

Në përgjigje të këtij rekomandimi IQT-ja njoftoi se kishte marrë masat për eliminimin e rrezikshmerisë që mbartnin pajisjet me mjedis amonjaku te sistemit ftohes ne "Tekstile sha" Berat. Por sipas tyre keto masa kishin konsistuar në sigurimin e mbikqyrjes teknike dhe ruajtjes se vazhdueshme, duke përjashtuar në mënyrë kategorike amortizimin e mundshëm të pajisjeve për shkak të disa specifikave teknike te tyre.

Konkretisht në bashkëpunim me Tekstile sha u vendos një roje me kohë të plotë dhe u morën masa për rrethimin e objektit. Krahas kësaj nga Agjensia Rajonale e Mjedisit Berat u mundësua pajisja me leje mjedisore për objektin në fjalë, ç`ka përbente një detyrim ligjor të pazbatuar deri në kohën e ngritjes së këtij problemi.

Së fundi, Tekstile sha në bazë të detyrave të lëna nga IQT-ja, ka propozuar shitjen e kësaj lënde konform procedurave ligjore. Por në këtë kuadër ajo ka nënvizuar rëndësinë që firmat private të kenë mundësi teknike për degazimin dhe transportimin e këtij malli sipas standarteve të kërkuara.

Avokati i Popullit megjithëse i vlerësoi masat e marra në drejtim të eliminimit të rreziqeve për popullatën, ka vërejtur me rezervë indiferencën e strukturave të METE-s për t`i dhënë zgjidhje përfundimtare të këtij problemi me anë të lëvrimit të fondeve përkatse.

Për shkak të rëndësisë që paraqet kjo çështje, zyra jonë do të vijojë të mbikqyrë zbatimin e procedurave për zgjidhjen e këtij problemi. Në të kundërt ajo do të ndërhyjë fuqimisht pranë Qeverisë Shqiptare që t`i jepet fund situatës brenda të cilës mund të këtë ende rreziqe të mundshme për jetën dhe shëndetin e një popullate të gjerë pranë qytetit të Beratit.

Në problematika të tjera të konstatuara nga ana jonë për punën e METE-s pa dyshim nje vend të veçantë zë edhe rasti i abuzimit të kompetencave të saj për propozimet për kontrata konçesionare.

Konkretisht, gjatë vitit 2006, Avokati i Popullit trajtoi një ankesë, në të cilën disa investitorë pretendonin se liria e sipërmarrjes private në fushën e prodhimit të energjise elektrike ishte cënuar së tepërmi nga një kontrate konçesioni e lidhur midis Ish Ministrise së Industrisë dhe Energjitikes, Ministrisë së Ekonomise dhe Shoqërisë italiane “Essegei s.r.l”. Sipas tyre, detyrimet e kësaj kontrate nuk ishin përmbushur nga kjo shoqëri, duke lënë në mëshirë të fatit 25 HEC-e vendore prej gati 4 vjetësh.

Avokati i Popullit pasi u njoh me pretendimet e ankuesve, mblodhi dhe analizoi në tërësi aktet ligjore për dhënie në konçesion të 25 HEC-eve vendore në favor të shoqërisë italiane, administroi dokumentacionet teknike, financiare dhe tatimore të veprimtarisë së kësaj shoqërie si dhe aktet e kontrollit përkatës të ushtruara gjatë vitit 2005 dhe 2006 nga Ish Ministria e Industrisë dhe Energjitikës, Ish Ministria e Ekonomise dhe nga Ministria aktuale e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikes të përmbledhura në termat e kontratës konçesionare si Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA).

Nga analiza e të dhenave të mblledhura, rezultoi se kjo kompani, pas miratimit të kontratës së mësipërme të konçesionit në Tetor 2002 kishte abuzuar me veprimtarinë investuese konçesionare, duke lënë pas dore dhe jashtë funksionimit një sërë HEC-esh të vogla vendore, madje duke figuruar debitorë në organet tatimore.

Sipas Programit të Kontrollit “Mbi Zbatimin e Marreveshjeve të Konçesionit për HEC-et Vendore” miratuar nga ish Ministri i Ekonomise me Nr.2934 dt.09.05.2005 dhe ish Ministri i Industrisë dhe Energjitikës me Nr.2260 dt.06.05.2005, grupi i përbashkët i ngritur për këtë qëllim kishte konstatuar midis të tjerash se:

“Për të gjithë periudhën e konçesionit deri në Qershor 2005, kjo kompani, kishte investuar vlera të vogla financiare në 105 000 USD ose rreth 3% të investimit të përgjithshëm dhe nuk kishte rehabilituar asnjë hidrocentral të vetëm. Nuk kishte likujduar vlerën prej 1.154 USD të investuar nga shoqëritë nën-kontraktore vendase për investimet e kryra në 11 hidrocentrale dhe nuk kishte respektuar derdhjen e

kontributeve të sigurimeve shoqerore për një pjese të madhe të punonjësve të HEC-eve për vitet 2003 dhe 2004”.

Ndersa sipas Urdherit Nr.105 dt.08.02.2006 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës Z.Genc Ruli “Për ngritjen e grupit te punes për kontrollin e zbatimit të marrevshjeve konçesionare për hidrocentralet” grupi i punës ngritur për këtë qëllim kishte konstatuar sipas Akt Kontrollit të datës.27.02.2006 midis të tjerash se:

“Shoqëria italiane nuk ka realizuar investimet sipas kontrates konçesionare, investime të cilat janë kryer deri në fund të 2005 në masën 14% dhe kanë një diference të porealizuar në shumën prej 3.9 Milion USD, gjë që bie ndesh me kontratën e konçesionit. HEC-et administrohen tërësisht nga disa shoqeri shqiptare që kanë lidhur kontrata të diskutueshme nën konçesionare me shoqerinë italiane, duke kryer dhe investime në objekte në shumën 1.5 Milion USD”.

Avokati i Popullit në vijim të këtij hetimi kërkoi pasqyrën zyrtare të prodhimit vjetor të enegjisë elektrike për 25 HEC-et e vogla të marra në konçesion nga kompania e mësipërme për vitin 2005, nga ku konstatoi se 11 prej tyre rezultoni me prodhim vjetor zero, ndërsa pjesa tjetër kishte prodhim brenda kapaciteteve tradicionale me pajisjet e vjetra.

Referuar sa me lart, nga ana jonë u denoncuan me anë të një rekomandimi shkeljet e konstatuara dhe apatia e METE-s për të zbatuar penalitetet në këto raste.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, Ministri i METE-s Z. Genc Ruli deklaroi se në përfundim të verifikimeve për këtë çështje, OSHA ishte duke përgatitur projekt-vendimin përkatës me kerkesen per prishjen e kontrates konçesionare me shoqerine italiane, i cili do t'i kalonte për miratim brenda Muajit shkurt 2007 Këshillit të Ministrave.

Avokati i Popullit konstatoi me keqardhje se në fillim të vitit 2007 shoqërisë italiane, jo vetëm nuk ju komunikuan masat ndëshkimore për shkeljet e kryera, por ju krijuan lehtësira të reja me anë të një Vendimi të Këshillit të Ministrave për të marrë në konçesion vepra të reja hidroenergjitike.

Megjithëse kjo çështje pati një kontestim publik nga specialistë të fushës dhe organe të shtypit, nga ana e METE-s dhe Këshillit të Ministrave nuk u reflektuan akuzat e ngritura me të drejtë për këtë shoqëri.

Ky mosveprim të bën të besosh se kjo çështje është e mbuluar nga një tis abuzimi dhe afere korruptive në dëm të interesave të publikut dhe shtetit shqiptar. Gjithsesi zyra jonë do të vijojë të monitorojë dhe denoncojë publikisht ato kontrata të pazbatuara në fushën konçesionare energjitike, ku interesat e konsumatorit janë nëpërkëmbur hapur.

Gjithashtu një tjetër problem i vërejtur së fundi nga ana jonë është propozimi i METE-s për të transferuar pranë KESH sha kompetencat e Policisë Elektrike tashme të suprimuar si organ.

Konkretisht Avokati i Popullit është vënë në dijeni se METE propozoi ndryshimet e reja të ligjit Nr.9072 dt.22.05.2003 “Për sektorin e enegjisë elektrike”, në të cilat krahas të tjerash entit shpërndarës KESH sha i kanë kaluar një sërë kompetencash për konstatimin e kundravajtjeve administrative dhe vendosjes së gjobave ndaj shkelësve në rrjetin elektrik.

Pra KESH sha aktualisht pas miratimit në Kuvend të këtyre ndryshimeve ka marrë të gjitha kompetencat e Policisë Elektrike për shkak të suprimimit të këtij institucioni shtetëror.

Në këtë kuadër zyra jonë, nisur nga ekskluziviteti që i jep Ligji Nr.7697 dt. 7.04.1993 “Për kundravajtjet administrative” i ndryshuar, organeve të administratës

shtetërore qëndrore ose vendore, për të konstatuar kundravajtje administrative dhe vendosur gjoba, mendon se një veprim i tillë është i paligjshëm pasi i atribuon kompetenca ligjore një strukture pranë një shoqërie tregtare.

Në bindjen tonë KESH sha apo çdo ent tjetër furnizues që mund të marrë këtë cilësi pas proceseve të privatizimit të këtij sektori, për shumë elemente ligjore të organizimit dhe funksionimit është larg të qenit organ i administratës publike.

Aktualisht kjo çështje vijon të ndiqet nga zyra jonë dhe shumë shpejt pas një analize të argumentave dhe fakteve që do na serviren nga METE, do të përcaktojmë rrugët me anë të të cilave do të bëjmë të mundur korrigjimin ligjor të kësaj praktike.

a. Ankesat për Korporatën Elektroenergjitike (KESH) Sh.A.

Gjatë vitit 2007 Avokati i Popullit ka trajtuar 70 ankesa kundër KESH-sha, nga të cilat, 15 ankesa janë zgjidhur pozitivisht, 28 prej tyre kanë rezultuar të pabazuara, 22 kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencave dhe 5 ankesa janë ende në shqyrtim. Në vijim do të prezantojmë disa nga çështjet të cilat kanë rezultuar pozitive, si dhe problematikën që ka hasur Avokati i Popullit gjatë shqyrtimit të ankesave për shërbimin që ofron KESH sha ndaj konsumatorëve:

1. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, Avokati i Popullit është përpjekur që fenomenet e korrupsionit dhe abuzimit nga nëpunës të administratës, të marrin përgjigjen e merituar nga forca e ligjit.

Pranë zyrës tonë dy punonjës të Drejtorisë së Shpërndarjes KESH sha Tiranë, u paraqitën për të denoncuar disa raste flagrante shkeljesh dhe abuzimesh nga kolegët e tyre.

Motivi i këtij denoncimi ishin presionet e shumta të ushtruara ndaj tyre nga drejtues të KESH sha, për kryerjen e veprimeve në shkelje të ligjit me qëllimin e mbulimit të abuzimeve ekonomike-financiare të shoqërisë KESH sha.

Pasi u njohem fillimisht me pretendimet e tyre dhe me tej me dokumentacionet që ata paraqiten, si dhe pasi kryem një verifikim të shpejtë rezultoi se:

a-Gjatë muajve të parë të vitit 2007 nga ana e drejtuesve të Filialit të Shitjes së KESH sha, Sektori Fshat Tiranë, ishte kërkuar që i gjithë dokumentacioni i faturave të prapambetura 1996-2002 të kartelizohet (rregjistrohet si debi klienti) në mënyrë të menjëhershme dhe të përgjithshme. Këto fatura kishin qenë të pa kartelizuara që nga viti 2002 dhe arkëtarët nuk kishin bërë mbylljet dhe inventarizimin e tyre.

Këto fatura ishin dokumentacion i prapambetur, i cili nuk kishte qenë i hedhur në sistemin kompjuterik të instaluar në një periudhë të mëvonshme pas vitit 2002. Mos bërja e këtij inventari nga ana e arkëtarëve dhe mos urdhërimi i mbylljeve të bilancit nga ana e drejtuesve të KESH sha, kishte sjellë si pasojë që të shkeleshin një sërë dispozitash ligjore. Avokati i Popullit konstatoi se shuma që përmbanin të gjitha faturat e paarkëtuara dhe të painventarizuara shkonte në 527.384.835 lekë të reja (vetëm për sektorin fshat në KESH sha). Mos rakordimi dhe inventarizimi i tyre prej kaq kohësh, kishte qenë shkak që shumë nga këto dokumenta të asgjësoheshin apo humbnin, duke mbuluar një sërë manipulimesh financiare me shumat e lekëve të rregjistruara.

b- Një tjetër shkelje e denoncuar ishte aplikimi dhe vjelja e tarifave për lidhjet e reja të energjisë elektrike tek abonentet e rinj. Konkretisht, sipas sqarimeve të ankuesve, KESH sha sipas një tarife në shumën mesatare prej 20.000 lekë, kryente lidhjen e linjave të reja elektrike tek klientet e rinj, duke hartuar më parë raportin

teknik. Lekët për këto lidhje duhej të arkëtoheshin në Drejtorinë e Shpërndarjes së KESH sha pranë Stacionit të Trenit, Tiranë.

Gjatë vitit 2006 vetëm për zonën e fshatit janë kryer 3500 lidhje të reja (klientë të rinj) të kompjuterizuar. Shuma që duhet të ishte vjele nga ky shërbim shkonte në rreth 7 miliard lekë të vjetra. Këto shuma lekësh në kompjuter kategorizohen si "EKSTRA" ndërkohë që nuk rezultojnë të vjelura. Ky denoncim mund të vërtetohet sipas nëpunësve, duke kontrolluar kompjuterin dhe arkën përkatëse për të parë rakordimin.

c-Një tjetër shkelje e denoncuar ishte abuzimi me kabinat elektrike që ndertoreshin në shërbim të firmave private, pallateve të reja etj. Inxhinierët e KESH sha pasi marrin porosinë, tërheqin nga magazinat e KESH sha transformatorët, kabllot, shtyllat elektrike dhe kryejnë punimet në rrjet. Pas përfundimit të punimeve, banorët derdhen privatisht pranë këtyre punonjësve shuma parash për të përballuar këtë investim, ndërkohë që kabina është investim i KESH sha dhe klientet nuk kanë asnjë detyrim financiar për të kryer një veprim të tillë.

Ankuesit pretenduan se me anë të një inventarizimi të magazinës, arkëtimit të lekëve në KESH sha dhe kontrollit në kompjuter për lidhjet e reja, mund të provohej shumë lehtë ky veprim abuziv.

ç-Denoncimi tjetër i këtyre nëpunësve kishte lidhje me abuzimet në kamat vonesa. Këto kamata për fatura të papaguara jashtë sistemit kompjuterik duhet të rregjistrohen në një libër të veçantë pagesash. Në Sektorin Fshat rezultoi gjithsej 2500 klientë biznese, nga të cilët rreth 100 prej tyre janë lavatriçe inertesh që harxhojnë shumë energji. Kur këtyre firmave ju duhej të paguanin faturat e prapambetura, disa prej tyre për të eliminuar pagimin edhe të kamatës 0.5 % në ditë, paraqiten tek llogaritarja, presin një mandat pagese (mandat pagese me likujdim pjesor) në të cilën paguajnë vetëm detyrimin e faturës, pa përfshirë kamat vonesën.

Kjo kamatë, sipas sqarimeve të nëpunësve, nuk vilet asnjëherë. Kjo ndodhte sipas tyre duke shmangur paraqitjen e klientit tek arka me faturën përkatëse. Kjo arkë nga ana e saj nuk viltë kamat vonesën, por me ndihmën e llogaritares shënonte shlyerjet e detyrimeve në librin përkatës pa llogaritur kamat vonesat.

d-Shkelja tjetër e denoncuar nga këta punonjës ishte abuzimi që kryen KESH sha gjatë ndryshimit të emrit të klientit. Kjo procedurë ka një tarifë prej 300 lekësh, e cila vilet nga KESH sha. Sipas ankuesve, në Prill të vitit 2006 janë ndruar 46 emra klientësh, duke paguar në arkë me mandat nga 300 lekë secili. Megjithatë në shumë raste është vërtetuar se arkëtimi i shumave ka ndodhur vërtet, në disa raste të tjera mungon vërtetimi i likujdimit të debive para ndërrimit të emrit si dokument, i cili sigurohet nga KESH sha. Në shume raste ky dokument nuk ekzistonte në praktikën e ndryshimit të emrit të klientit, duke fshehur shumë detyrime të mëparshme që ky individ mund të kishte patur ndaj shoqërisë.

dh-Shkelja e fundit e denoncuar ishte planizimi i provuar që kryhej për të minimizuar nga KESH sha humbjet teknike. Konkretisht përgjegjësit e zonave përkundrejt një grafiku plani në shuma lekësh të përlllogaritur më parë, kryenin korrigjimet në shiritat (librat e lexuesve të sahatëve) për të rakorduar me planin e tyre. Më pas, sipas këtyre korrigjimeve shefi i sportelit i jepte ngarkesën financiare llogaritares përkatëse. Ky faturim bëhej fiktiv dhe rriste shumën e konsumuar, por të pa arkëtuar, në dukje sikur kjo energji humb nga rrjeti pra llogaritet si humbje teknike. Ndërkohë që ajo ju ngarkohej debitorëve të përhershëm të KESH sha si energji e pa paguar.

Një shembull që u dha në këtë rast nga ankuesit ishte faturimi i 200 familjeve të Zonës së Bathores me 4800 kw në muaj secila (shifër fikse) ose në rreth 40.320

lekë në muajin Dhjetor 2006. Ky lloj faturimi bëhej sipas tyre me qëllimin për të ulur humbjen teknike, duke kryer nje manipulim zërash me anë të mashtrimit në dëm të konsumatorëve familjarë.

Pas verifikimit dhe mbledhjes së provave për akuzat e ngritura, Avokati i Popullit duke mos qenë organ i specializuar në fushën e kontrollit ekonomiko-financiar të organeve, vendosi të kalojë për kompetencë këtë çështje pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke kërkuar prej këtij organi nisjen e kontrollit ndaj strukturave të KESH sha Tiranë dhe nxjerrjen e përgjegjësive ndaj personave përgjegjës.

Pas një kontrolli tematik që u ushtrua në përmbushje të kërkesës tonë, nga ana e KLSH-së u njoftua zbulimi i mjaft shkeljeve të bëra prezente.

Në përfundim të këtij kontrolli, krahas detyrave të lëna për kthimin e shumave të lekëve të paarkëtuara nga punonjësit përkatës, KLSH-ja kishte propozuar marrjen e masave disiplinore për largim nga puna, vërejtje me paralajmërim dhe ulje në detyrë për personat si vijon:

-Drejtori i Zonës së Shpërndarjes Tiranë dhe dy punonjës së Degës Ekonomike KESH sha (largim nga puna) ;

-7 punonjës së Degëve të Shitjes KESH sha Tiranë (ulje në detyrë dhe pagimin e dëmit të shkaktuar);

-3 punonjës së Degës së Kontabilitetit KESH sha Tiranë (vërejtje me paralajmërim dhe pagimin e dëmit të shkaktuar);

-3 Arkëtare të Degës së Shitjes Fshat (vërejtje me paralajmërim dhe pagimin e dëmit të shkaktuar);

-10 Përgjegjësive të Zonave të KESH sha Tiranë (vlerësimin e shkeljeve dhe marrjen e masave përkatse);

-8 Faturistëve të Zonës KESH sha Fshat Tiranë (vlerësimin e shkeljeve dhe marrjen e masave përkatse);

-4 inxhinierëve të lidhjeve të reja KESH sha Tiranë (vlerësimin e shkeljeve dhe marrjen e masave përkatse);

-2 punonjësve të Auditit të KESH sha (vlerësimin e shkeljeve dhe marrjen e masave përkatse);

-13 ish drejtues dhe punonjës të tjerë të KESH sha Tiranë (vjelje të dëmit të shkaktuar);

Me zbardhjen e këtij raporti, Avokati i Popullit nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit të organeve të kontrollit të jashtëm në evidentimin e shkeljeve nga ana e drejtuesve dhe punonjësve të KESH sha. Fakti që këto shkelje në shumicën e tyre u vërtetuan, tregon për nivelin e lartë të abuzimeve që janë kryer nga punonjës të kësaj kompanie. Në këtë kuadër ne do të vijojmë edhe në të ardhmen të denoncojmë shkelje për punën e KESH sha në rast se do të vijmë në dijeni për shpërdorime të mundshme.

2. Avokati i Popullit ka patur vazhdimisht si objektiv të punës së tij përmirësimin e standarteve të shërbimeve publike që i ofrohen individëve. Si pjesë integrale e këtij misioni, kanë qenë edhe përpjekjet për t'i vendosur këto shërbime në formën më të pranueshme, konform legjislacionit në fuqi.

Në Vendimin e tij Nr. 62 dt.03.10.2006 "Për përcaktimin e kohëzgjatjes së periudhës tranzitore dhe të sasisë të faturimit për klientët familjarë që nuk janë të pajisur me matës të energjisë elektrike", Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike në mbështetje të Nenit 52 pika 3 të Ligjit Nr.9072 dt.22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" (i ndryshuar), kishte vendosur shtyrjen e afatit të aplikimit të faturimit afrofe nga ana e KESH sha, deri me dt.31 Mars 2007.

Në përfundim të këtij afati, Avokati i Popullit është interesuar pranë Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE) për ecurinë e këtij procesi, nisur nga interesi i tij i ligjshëm për të ndikuar në përshpejtimin e vendosjes së matësave në rang vendi për të gjithë konsumatorët.

Nga verifikimi i ushtruar, rezultoi se KESH sha jo vetëm nuk kishte vendosur matësat, por nuk kishte paraqitur pranë ERE-s edhe propozimet përkatse për shtyrjen e afatit të faturimit afrofe.

Një mosveprim i tillë i konstatuar nga ana jonë, kishte sjellë për pasojë që faturimi afrofe i KESH sha, duke filluar nga 1 Prilli 2007 të mos ishte i autorizuar nga ligji apo nga organet kompetente vendimarrëse, çka do të thoshte se kjo veprimtari e KESH sha, po kryhej në një mënyrë të paligjshme dhe abuzive.

Duke mos e pranuar këtë gjendje dhe duke e denoncuar atë si shkak për shkelje të detyrimeve ligjore dhe kontraktore me klientët e KESH sha, Avokati i Popullit kërkoi që brenda një kohe sa më të shkurtër kjo kompani të përcillte pranë ERE-s propozimet përkatse për të vënë në pozita të ligjshme veprimtarinë e saj në raport me të drejtat dhe interesat e ligjshme të konsumatorëve.

Në kuadër të korigjimit sa më parë të kësaj gjendje paligjshmërie, Avokati i Popullit i propozoi ERE-s edhe ndëshkimin e KESH sha me penalitete sipas ligjit.

Në përgjigjen e paraqitur nga ana e ERE-s u njoftua se nga ana e këtij organi ishte vendosur shtyrja e re e afatit të vendosjes së matësave për KESH sha deri më 31.12.2007. Krahas kësaj për shkak të vonësave në kryerjen e procedurave KESH sha ishte ndëshkuar me gjobë.

3. Avokati i Popullit kishte shprehur interesimin e tij që në vitin 2004 për çështjen e rrezikut që vinte si rezultat i ekzistencës së linjës 110 kv që përshkon Bulevardin “Zogu I” Tiranë.

Në përgjigjen e paraqitur në atë kohë nga Ish Drejtori i Operatorit të Sistemit të Transmetimit KESH sha, sqarohet se në kohën e ndërtimit të kësaj linje dhe nënstationit 110/20 kv që ajo furnizon, ka patur një nevojë emergjente për energji elektrike, e cila u zgjidh në menyrën më të shpejtë të mundshme. Për këtë qëllim, nisur nga urgjenca e madhe për ndërtimin e kësaj linje, nuk u pa e arsyeshme të analizoheshin teknikisht shumë faktorë që mund të ndikonin përreth saj.

Për pasojë kjo linjë u quajt provizore deri në ndërtimin e një nënstationi definitiv. Gjithsesi nga ana e KESH sha ky objekt nuk paraqiste një rrezik të shtuar për qytetarët, por ai do të zhvendosej shumë shpejt për arsye estetike urbane, si dhe për faktin e ekzistencës jo normale të një nënstationi elektrik në qendër të Tiranës.

Në ndihmë të realizimit të këtij projekti, KESH sha në vitin 2005 njoftoi se ishte në fazën e përpilimit të dokumentacionit për të ndryshuar trasenë e linjës nëntokësore dhe caktimin e një nënstationi definitiv 110kv me financim të Qeverisë Italiane.

Avokati i Popullit duke parë se edhe pas dy vjetësh situata vijoi të mbetej e pandryshuar, prezantoi sërish shqetësimin e tij shumëplanësh për këtë linjë, i cili fokusohet tërësisht në impaktet e mundshme negative që ajo mund të shkaktonte në format si vijon:

a. Prania e shtyllave të larta dhe kablove elektrik në shtrirje të konsiderueshme në një zonë tejet të dendur me popullsi urbane, siç është Bulevardi “Zogu I” krijon një imazh aspak estetik të urbanistikës së tij. Është e vërtetë që edhe në vendet e perëndimit ekzistojnë kablo të tillë në ndihmë të transportit urban, por ato nuk lidhen ndërmjet tyre me shtylla të larta, por me elemente të tjerë praktikë që krijojnë mundësinë e mos cënimit të arkitekturës së objekteve përreth apo planit urbanistik të zonës.

b. Mungesa e mirëmbajtjes brenda parametrave teknik të konstruksionit të shtyllave dhe kabllove elektrik përbën një rrezik për këputjen apo rënien e tyre në rast ndikimi të fuqishëm nga kushtet e veçanta atmosferike. Në këtë mënyrë rrezikshmëria ndaj banorëve dhe kalimtarëve është më e lartë, pasi kjo rrugë ka një lëvizje të shtuar mjetesh motorike dhe kalimtarësh.

c. Megjithëse linja është prezantuar brenda standarteve të sigurisë teknike, kjo nuk përjashton mundësinë që ajo të çenohet qoftë edhe nga aksidentet rrugore (që nuk kanë qenë të rralla në atë rrugë), gjë që mund të shkaktojë jo pak dëme materiale dhe njerëzore.

Avokati i Popullit duke parë vonesat në marrjen e masave për eliminimin e një rreziku të mundshëm nga kjo linjë, kërkoi nga ana e KESH sha fillimin e procedurave për zhvendosjen e menjëhershme të linjës 110 kv dhe caktimin e një afati konkret për realizimin e kësaj detyre.

Në përgjigje të rekomandimit tonë, KESH sha sqaroi se kishte planifikuar ndertimin e një nenstacioni definitiv në Tiranë, me financim nga qeveria Italiane, i cili eliminonte linjen ajrore të nenstacionit provizor. KESH sha dhe OST ishin duke realizuar këtë projekt final, por vonesat kishin ardhur për shkak të procedurave të zgjatura nga Qeveria Italiane për lëvrimin e fondeve dhe vonesave në dhënien e lejes së sheshit të ndertimit nga Bashkia e Tiranës.

Edhe pas këtij prononcimi, Avokati i Popullit do të vijojë të ndjekë vazhdimin e këtyre procedurave, deri në realizimin e tyre të plotë, sepse linja vazhdon siç ka qenë në mes të qytetit të Tiranës por i rëndësishëm në këtë rast është sensibilizimi i këtij problemi dhe fillimi i hapave për eliminimin e tij.

4. Pranë Avokatit të Popullit u paraqit ankesa e disa banorëve të Fshatit Zemblak Korçë, të cilët pretenduan se që nga viti 2002 nuk ishin shpronësuar, si pasojë e ndërtimit të linjës 110 kv Zemblak-Korçë.

Nga të dhënat e administruara nga ana jonë rezultoi se, KESH sha gjatë vitit 2002 kishte kryer ndërtimin e linjës 110 kv Zemblak Korçë, duke zënë një pjesë të konsiderueshme të tokave bujqësore të rreth 70 familjeve me anë të shtyllave dhe nënstacionit përkatës.

Për këtë qëllim, nga ana e përfaqësuesve të familjeve pronare ishin paraqitur disa herë letra dhe kërkesa për nxitjen e procesit të shpronësimit në organet më të larta shtetërore. Por megjithë korrespondencën e gjatë të këtyre të fundit, ato nuk kishin mundur të zgjidhnin përfundimisht këtë problem.

Avokati i Popullit nisur nga kjo procedurë e stërgjatur dhe e papërcaktuar në afate, krijoi bindjen se mos koordinimi i veprimeve administrative dhe mungesa e respektimit të dispozitave të Ligjit Nr.8561 dt.22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të perkohshëm të pasurisë private për interes publik” ishin shkaqet kryesore për këtë zvarritje në cënim të hapur të të drejtave dhe interesave të ligjshme të pronarëve.

Si rrjedhim i shqyrtimit dhe verifikimit të kësaj çështje nga ana jonë, rezultoi se KESH sha megjithëse kishte rreth 1 vit që i ishte paraqitur dosja e plotë e shpronësimeve të zonës Zemblak-Korçë, nuk kishte disponuar ende me projekt-aktet përkatëse për t’i kaluar në METE.

Referuar këtij përfundimi, Avokati i Popullit paraqiti një rekomandim pranë KESH sha dhe METE-s ku kërkoi përfundimin e menjëhershëm të procedurave të shpronësimit.

Në përgjigjen e paraqitur për këtë problem nga KESH sha është njoftuar se kjo kompani i është drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për fillimin e procedurave ligjore për shpronësimin në fjale, duke e shoqëruar këtë

kerkese me dosjen perkatese.

Pas kësaj jemi vene ne dijeni se ishte ngritur komisioni i shpronësimit, i drejtuar nga zëvendesministri i Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes dhe ishte ne perfundim procedura e propozimit për miratim të shpronësimit në Këshillin e Ministrave, nga ministri.

Edhe pse kjo çështje konkludoi me zgjidhje pozitive, sërish në këtë rast u konstatuan parregullsi dhe zvarritje të pajustificueshme në dëm të interesave të pronarëve. Kjo çështje nxorri në pah edhe një herë dëmin e madh që i shkaktohet shtetit dhe shoqërisë shqiptare nga ndërrimi i shpeshtë i punonjësve dhe drejtuesve të korporatës dhe METE-s, ndërrim i cili shkakton amulli dhe zvarritje të punëve administrative.

5. Avokati i Popullit ka qenë shpesh herë i detyruar të ndërhyjë në kufizimet e energjise elektrike të shkaktuara nga KESH sha sa herë që ato nuk kanë janë shoqëruar nga një shkak dhe procedurë korrekte ligjore.

Çdo person ne kushtet e kufizimeve te energjise peson nje çoroditje te aktiviteteve te tij jetesore, ndaj dhe percaktimi dhe njohja me nje grafik nderprerjesh do te ulte te pakten ndjeshem faktorin surprize dhe me kete rast edhe kostot e konsiderueshme ekonomike qe passjell ajo.

Ky fenomen behet me i ndjeshem dhe merr nje peshe specifike kur flitet sidomos per veprimtarine tregtare prodhuese, te sherbimeve apo furnizimin me uje.

Ne keto kushte i kemi gjykuar te drejta parashikimet ligjore dhe kontraktore, lidhur me njoftimet e operatorit furnizues ne sistemin e shperndarjes se energjise, ne rast kufizimesh te energjise.

Konkretisht ne baze te pikes 3.10.4 (Nderprerjet e Furnizimit me Energji Elektrike) te Kodit te Funkcionimit te Shperndarjes se Energjise Elektrike, miratuar me Vendimin Nr.39 dt.30.08.2005 te Entit Rregullator te Energjise Elektrike, Kompania e Shperndarjes (KESH sha) eshte e detyruar te njoftoje konsumatorët ne raste te kufizimeve per ulje te gjenerimit, duke percaktuar madje dhe nje planifikim te programuar te tyre.

Gjithashtu, ne baze te pikave 9.2 dhe 8.2 te Kontratave te Furnizimit me Energji Elektrike per Klientin e Kategorise Familjar dhe Jo Familjar, miratuar me Vendimet Nr.40 dt.31.08.2005 dhe 41 dt.31.08.2005 te Entit Rregullator te Energjise Elektrike, KESH sha eshte e detyruar te njoftoje 24 ore perpara te gjithe konsumatorët per nderprerjen e energjise si pasoje e shterimit te mundesive gjeneruese.

Avokati i Popullit nenvizoi me këtë rast faktin se individët apo subjektet e ndryshëm nuk mund te vijnë në dijeni rastesisht apo nga mediat se ne Shqiperi kane filluar te aplikohen kufizime të energjisë.

Referuar sa me lart dhenia e ketij njoftimi i takonte ligjerisht dhe zyrtarisht Kompanise KESH sha, nen nje kontekst te plote korrektese ndaj publikut.

Për të gjitha këto arsye Avokati i Popullit i paraqiti një rekomandim Drejtorit të Përgjithshëm të KESH sha ku i kërkoi marrjen e masave për shpalljen e menjëhershme në publik të grafikut të kufizimeve të energjise elektrike ndaj klienteve familjarë dhe jofamiljare.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, KESH sha njoftoi se kishte kryer veprimet përkatse me mediat për të publikuar oraret e kufizimeve brenda një kohe shumë të shkurtër.

Në këtë rast zyra jonë krahas vlerësimit që bëri për shpejtësinë e këtij veprimi, vuri në dukje mungesën e një praktike të konsoliduar dhe paraprake për të njoftuar konsumatorët për ndërprerjet e energjisë elektrike.

6. Avokati i Popullit nga të dhënat dhe verifikimet e bëra nga ana e tij, por dhe nëpërmjet ankesave të paraqitura kishte nxjerrë përfundimin se disa zona rurale në vend marrin energji elektrike me cilësi të dobët (140-160 V).

Kjo cilësi nuk ishte në përputhje me kontratën e furnizimit me KESH sha dhe nuk ju kishte mundësuar banorëve të këtyre zonave kryerjen e një aktiviteti normal jetësor.

Konkretisht, për shkak të një neglizhence dhe mos impenjimi për të ndjekur nga afër shërbimin e furnizimit me energji elektrike të zonave rurale përreth Tiranës, sidomos në Komunitat Prezë, Ndroq, Petrelë etj, ishte shkaktuar një pakënaqsi tek banorët dhe një paralizim i përmbushjes së nevojave të tyre me burime të pranueshme të energjisë elektrike.

Në shtëpitë dhe objektet e tjera tregtare të këtyre zonave, kishte jo vetëm mungesë të madhe të energjisë në formën e kufizimeve, por dhe një nivel mjaft të dobët voltazhi në krahasim me zona të tjera urbane, çka nuk realizonte për mbajtjen në punë të pajisjeve elektroshtëpiake dhe për ndriçimin optimal në kohën e darkës.

Kjo kishte sjellë për pasojë që fëmijët të studjonin me mjete ndriçimi aspak të përshtatshme dhe gatimi apo nevoja të tjera për energji, si në familje, ashtu dhe për bizneset e këtyre zonave, të zëvendësoheshin me mjete aspak të pranueshme dhe të leverdisshme.

Avokati i Popullit bazuar në Ligjin Nr. 9072 dt.22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”(i ndryshuar), në Ligjin Nr. 9135 dt.11.09.2003 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, si dhe në vështrim të Kodit të Fuksionimit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (Pika 2 Qëllimi) miratuar nga ERE me Vendimin Nr.39 dt.30.08.2005, u shpreh se praktika e ndjekur në këto zona krahas aspekteve dhe vështirësive teknike, mbetej një diskriminim dhe shkelje e hapur e të drejtave të konsumatorit.

Malli “*energji elektrike*” krahas debatit për çmimin e tij, duhet të shikohet i lidhur ngushtë me cilësinë me të cilën ai shërbehet. Blerja e këtij malli dhe furnizimi i tij, nënkuptonte sipas Kodit Civil (Kontrata e Furnizimit) një mall cilësor, pa vese dhe të meta, i blerë në kushtet e mirëbesimit të plotë. Kjo do të thotë se enti furnizues ishte i detyruar të zbatonte kontratat e lidhura sipas cilësisë së mallit të parashikuar në përmbajtjen e tyre (220 V +/- 10-15%).

Për këtë qëllim, Avokati i Popullit i paraqiti KESH sha dhe ERE-s një rekomandim ku kërkoi që të merreshin masat e duhura për përmirësimin e cilësisë së energjisë elektrike për zonat rurale duke e përgjithësuar këtë dukuri në të gjithë vendin.

Në përgjigjen e paraqitur nga ERE u bë e njohur se nga ana e tyre kjo çështje ishte parë me shumë seriozitet dhe ishte caktuar që brenda një kohe të shkurtër do t'i kërkohet një seancë dëgjimore KESH sha për të evidentuar shkaqet e këtij niveli kaq të dobët shërbimi.

Nga ana e saj, KESH sha njoftoi se ishte në një fazë remonti dhe instalimi të disa linjave të reja në këto zona. Këto do të rrisnin cilësinë e energjisë sipas parametrave të kërkuara. Ky prononcim do të kihet parasysh në vijim të punës së tij nga ana e Avokatit të Popullit për të parë nëse një shërbim i tillë ka shkaqe objektive apo tolerohet si penalitet kolektiv ndaj zonave rurale.

Gjithsesi zyra jonë do të paraqesë shumë shpejt në seancën dëgjimore për këtë çështje rezervat dhe mendimet konkrete.

7. Avokati i Popullit pas një ankesë të disa banorëve për faturime të parregullta në zonën e tyre kreu një verifikim të plotë të pretendimeve të tyre nga ku rezultuan shkelje të detyrës së futurueses së KESH sha.

Pas disa takimesh dhe ndërhyrjesh me drejtues te kësaj kompanie u bë e mundur korrigjimi i faturave dhe pushimi nga puna i faturueses së zonës.

Kjo praktikë ka ndodhur edhe në vitet e kaluara, pasi në marrëveshje me drejtues të KESH sha, është vendosur që në rast se ka ankesa të përsëritura për faturim të parregullt do të konsiderohej mundësia për masa disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës.

8. Zyra jonë u njoh me shqetësimin e ngritur nga një ankues për shërbime të parregullta të kryera nga KESH sha Korçe gjate faturimit të objektit të tij.

Konkretisht në kete rast figuronin detyrime të papaguara edhe nga klienti, por drejtues të KESH sha nuk kishin marrë masat për lidhjen e një marrëveshjeje për likuidimin me afat të detyrimeve.

Avokati i Popullit kerkoi menjehere kryerjen e një veprimi të tillë nga KESH sha Korçë me qëllimin për të sqaruar dhe lehtësuar pozitën e klientit të saj.

Ne pergjigje të këtij interesimi zyra jonë u njoftua për zgjidhjen perfunditmare të këtij problemi me ane te pagesave te kryera ne kuader të nënshkrimit dhe zbatimit të një marrëveshje dy palëshe.

9. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit dy shtetas me banim në Qytetin e Klosit paraqitën ankesën e tyre, në të cilën pretenduan se Kompania KESH sha aplikonte ndërprerje të energjise elektrike në mënyre të paplanifikuar dhe të pa shpallur me grafike të caktuar.

Zyra jonë nisur edhe nga ankesa të tjera, paraqiti nje kërkesë pranë degës së KESH sha Klos ku u kerkua që të shpallej dhe të zbatohet menjëherë një grafik lokal i ndërprerjes së programuar të energjisë elektrike.

Pas kësaj ndërhyrje jemi njohur nga KESH sha Klos se ishin marrë të gjitha masat për publikimin dhe respektimin e orareve të kufizimit me energji.

10. Në ankesën e paraqitur pranë Avokatit të Popullit nga një grup banorësh të Zonës së Valbonës në Tropojë behej fjale per nderprerjen e padrejte te energjise elektrike, si pasojë e dëmtimit të linjës elektrike.

Për këtë çështje u thirr fillimisht Drejtori i Shperndarjes se KESH sha, te cilit ju komunikua kjo ankese dhe u bene sqarimet e nevojshme për marrjen e masave të menjëhershme për rivënien në punë të saj.

Krahas kesaj, per te bere nje sensibilizim akoma me te madh u komunikua edhe me organet e medias te cilat bene pasqyrimet e tyre perkatse.

Pas disa procedurave teknike të përsëritura, të kryera nga firma e punimeve në këtë linjë, u arrit që zona e Valbonës të furnizohej sërish me energji elektrike në kushte normale.

Në këtë rast, Avokati i Popullit mbajti në konsideratë jo vetëm ofrimin e ndihmës së disa zonave të largëta të vendit, por dhe nxitjes nëpërmjet këtyre masave të ardhjes së vizitorëve vendas dhe të huaj, të cilët janë shtuar shumë vitet e fundit në viset veriore.

11. Pranë Institucionit te Avokatit te Popullit disa banorë të një zone në Tiranë paraqitën një ankesë ku akuzuan KESH sha per diskriminim në furnizimin me energji elektrike.

Me ane të ndërhyrjes së zyrës tonë ju kërkuam Zonës se Shperndarjes Elektrike KESH sh.a Tirane që të sqaronte shkaqet e kufizimeve të furnizimit me energji elektrike ne pallatin ku banonin këta ankues.

Në përgjigjen e kthyer nga Divizioni i Shpërndarjes Tirane KESH sha, u sqaruar se nuk kishte funksionuar linja e tensionit mesem qe furnizonte pallatin në fjalë. Në këto kushte u mundësua rregullimi i saj dhe më tej heqja e kufizimeve energjitike. Megjithëse kjo ankesë u zgjidh pozitivisht, punonjësve të KESH sha ju

la si detyrë që në raste të tjera të njoftojnë paraprakisht banorët për raste avarish që krijojnë probleme në furnizimin me energji.

12. Disa banorë të një pallati paraqitën disa ankesa pranë Avokatit të Popullit duke pretenduar se KESH sha kishte ndërprerë në mënyrë të padrejtë furnizimin me energji elektrike.

Në përgjigjen e kthyer nga Divizioni i Shperndarjes Tirane, si rezultat i interesimit tonë institucional, jemi sqaruar se nga verifikimet e ushtruara nga grupi i kontrollit te KESH sha, kishte rezultuar se subjekti që ishte pronar i pallatit merrte energji elektrike në mënyrë të paligjshme në një kabinë tjetër. Kjo bëhej pa dijeninë e banorëve dhe gjatë konstatimit të shkeljes u bë ndërprerja e linjës së energjisë për të gjithë banorët.

Më tej nga KESH sha kishte bërë kallezim penal per administratorin e subjektit, ndersa për të gjithë banoret e tjerë të pallatit ishtë bërë rilidhja elektrike nga kabina përkatse.

Megjithëse kjo çështje u zgjidh në mënyre pozitive për banorët e pallatit, veprimi i kryer fillimisht nga ana e KESH sha ishte një ndëshkim kolektiv i papranueshëm që u denoncua nga ana jonë, por që gjeti një korrigjim të shpejtë.

13. Prane Institucionit të Avokatit të Popullit një grup banorësh të rrethinave të Tiranës paraqitën një ankesë ndaj KESH sha, në të cilën pretenduan se kjo kompani nuk i furnizonte ata në mënyrë të rregullt me energji elektrike.

Pas kësaj zyra jonë i ka kërkuar Zonës së Shperndarjes Elektrike Tirane, qe te bënte verifikimet perkatese në terren dhe të mundësonte një zgjidhje sa më të shpejtë në favor të tyre.

Në përgjigje të këtij interesimi Zona e Shperndarjes Elektrike KESH sha Tirane njoftoi se kishte bërë verifikimet e duhura dhe për pasojë kishte marrë masat për eliminimin e disa problemeve kryesore.

Konkretisht ajo kishte ndërhyrë në rrjetin e shperndarjes ne fshatin Mezes dhe kohet e fundit kishte bërë të mundur që kjo linjë të futej në procesin e miratimit për një projekt të ri rehabilitimi.

Ndërkohë KESH sha në bashkëpunim me banoret kishin organizuar veprimet per te lidhur kontratat e reja definitive, veprim që shoqerohej edhe me vendosjen e matesit perkates.

Nëpërmjet këtyre masave, KESH sha Tiranë pohoi se ishte arritur një përmirësim i furnizimit me energji elektrike të këtyre zonave dhe po punonte për normalizimin edhe të atyre subjekteve që kishin figuruar si debitorë në të kaluarën.

Në vijim po parashtrojmë shkurtimisht disa problematika të përgjithësuara të vëna re në problematikën e KESH sha për vitin 2007.

Konkretisht, KESH sha gjatë vitit 2007 propozoi rritjen e tarifave të energjisë në masën 20%. Në seancat dëgjimore që ERE organizoi për këtë qëllim Avokati i Popullit paraqiti një qëndrim të qartë mospajtures me këto propozime. Konkretisht, ashtu si edhe herë të tjera ne argumentuam se niveli i shërbimeve që ofron KESH sha dhe problematika që ajo shfaq në disa momente të administrimit të saj, janë shumë të dëmshme dhe ndikojnë direkt në krizën ekonomiko-financiare që ajo përpiqet ta shmangë vetëm me rritjen e tarifave.

Fenomeni me kryesor që dëmton ndjeshëm performancën e saj në publik mbetet ende premtimi i pambajtur për instalimin e matësave dhe me këtë rast moseeliminimi i faturimit afrofe.

ERE në fund të vitit 2007, duke parë këtë detyrë të porealizuar nga KESH sha, kreu shtyrjen e afateve për vendosjen e matësave deri më 31 Djetoj 2008. Kjo

tregon edhe një herë mungesë e seriozitetit të kësaj kompanie për të përmbushur në kohë një detyrim ligjor që nga viti 2004.

Për atë kohë sa do të vazhdojë faturimi afrofe në arkëtimin e të ardhurave të KESH sha, kjo kompani do të vijojë të mos jetë e besueshme për konsumatorin dhe do të kontestohet vazhdimisht.

Këto dhe të tjera probleme që kanë shoqëruar KESH sha gjatë vitit 2007, i janë bërë prezente në rekomandime të veçanta Kuvendit të Shqipërisë dhe Kryeministrit pasi çështja e energjisë është një problem kombëtar që nuk mund të lakohet thjesht në kuadrin e veprimtarisë së një shoqërie tregtare të zakonshme.

Ne vërejmë gjithashtu se në kushtet e tanishme, kur vendi është përballur me rritjen e çmimeve, nuk ka sesi të pranohet që konsumatori të mbajë me shpenzimet e tij edhe koston e keqmenaxhimit të KESH sha. Kjo ishte arsyeja kryesore mbi të cilën u kërkua që ERE të mos pranojë propozimet e reja të KESH sha për rritjen e tarifave të energjisë në masën mesatare 20%.

Kjo rritje sipas Avokatit të Popullit, krijon një tjetër problem social dhe fut në një krizë akoma dhe më të madhe mjaft familje me të ardhura të vogla dhe pa përkrahje. Kjo pasi nga të dhënat tona të bëra prezente nga qytetarë të ndryshëm, është identifikuar fakti se kompesimi i energjisë për shkak të nivelit të tij të ulët dhe kriterëve të vendosura, nuk arriti t'i vinte në ndihmë realisht atyre, por ngeli në shumë raste i pazbatuar. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit ndërhyri që edhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.565 dt.09.08.2006 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike" të botohej në fletore zyrtare, për t'i dhënë përmbajtjes së këtij akti transparencë dhe fuqi ligjore.

Në përfundim, ne jemi të bindur se me futjen në procedurat e privatizimit të disa prej sektoreve të kësaj kompanie, do të eliminohen shume probleme të akumuluar. Por Avokati i Popullit në këtë proces i cili pritet të përmbushet brenda vitit 2008 do të synojë të ndërhyjë pranë organeve kompetente shtetërore, që të rritin gamën e kontrollit ndaj enteve private që do të përfitojnë nga privatizimi. Kjo do të mundësonte korrigjimin e menjëhershëm të praktikave të dëmshme ndaj konsumatorëve dhe mosrënien sërish në të njëjtin nivel keqadministrimi që po hasim edhe sot nga drejtimi shtetëror i KESH sha.

10. Ministria e Financave

Numri i ankesave, kërkesave dhe njoftimeve drejtuar Avokatit të Popullit nga shtetas dhe persona juridikë për shkeljen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre nga administrata financiare, ku përfshihen Ministria e Financave, organet doganore, tatim-taksat, INSIG Sh.a. dhe Agjensia e Trajtimit të Kredive është 29. Nga ky numër, 27 ankesa kane perfunduar dhe rezultojne te mbyllura, nderkohe qe 2 jane ende te hapura kanë kaluar për shqyrtim të mëtejshëm për vitin 2008. Nga problemet e prezantuar nga individë të ndryshëm pranë Zyrës tonë, 16 ankesa i janë adresuar Ministrisë së Financave si institucion, 4 Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe degëve në varësi të saj, 5 i janë adresuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, 1 ankesë për INSIG Sh.a. dhe 3 ankesa i janë adresuar Agjencisë së Trajtimit të Kredive. Krahas këtyre ankesave gjatë vitit 2007 janë përfunduar edhe 14 ankesa të mbartura nga viti 2006, nga të cilat 1 ka qenë e pabazuar, 1 ka qenë jashtë juridiksionit, 2 kanë qenë jashtë kompetence, 2 ankesa janë zgjidhur në favor, dhe nga 8 ankesa të trajtuara me rekomandim 5 prej tyre kanë rezultuar të zgjidhura pozitivisht, ndërkohë që 3 nuk janë pranuar.

Për vete Ministrinë e Financave, kemi pasur gjithsej 16 ankesa. Nga këto 3 kanë qenë të pabazuara, 6 kanë rezultuar jashtë juridiksionit të Institucionit të Avokatit të Popullit, 1 ankesë është konsideruar me mungesë kompetence, 1 ankesë është zgjidhur në favor që në fazën e parë të verifikimit, 2 kanë hequr dorë dhe 3 ankesa janë zgjidhur në favor pas paraqitjes së rekomandimeve përkatëse nga Avokati i Popullit.

Në lidhje me ankesat e drejtuara këtij institucioni, do të trajtojmë disa prej tyre, të cilat paraqesin problematika të rëndësishme dhe janë zgjidhur në mënyrë pozitive.

1. Institucioni i Avokatit të Popullit duke marrë shkas nga një ankesë e paraqitur në vitin 2006 dhe që për shkak të problematikës së ngritur në të ka vijuar të shqyrtohet në vijim dhe gjatë vitit 2007, ka ndërmarrë iniciativën ligjore t'i rekomandojë autoritetit përgjegjës, parashikimin dhe hartimin e akteve nënligjore lidhur me rregullimin e veprimtarisë së atyre shoqërive që nuk mbulojnë falas transportin e automjeteve të aksidentuara në vëndin e ngjarjes.

Konkretisht, një person ka ngritur shqetësimin për mungesë të shërbimit transportues nga kompania e sigurimit për makinën e tij të aksidentuar brenda qytetit të Tiranës, në kushtet kur vetë ai nuk dispononte mjete financiare për të përballuar këtë shpenzim në momentin kur ndodhi aksidenti dhe transportuesi nuk kryente shërbimin pa parapagim.

Nisur nga kjo ankesë, kemi kërkuar fillimisht shpjegime pranë ish-Autoritetit të Mbikqyrjes së Sigurimeve (AMS) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, lidhur me praktikën ligjore që ndiqet në këto raste, për transportimin e mjeteve të aksidentuara.

Në përgjigjen e dërguar nga ish Kryetarja e AMS-se Znj.Ermela Guxholli me anë të shkresës Nr.571/1 Prot dt.19.06.2006, është sqaruar se në këto raste kompania e sigurimit është e detyruar të mbulojë shpenzimet e transportit ose të paguajë të gjitha faturat që janë parapaguar nga i siguruari.

Në përgjigjen e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën Nr.2322/1 dt.23.06.2006, është sqaruar se çështja e transportit të mjeteve të dëmtuara në rast aksidenti vijonte të mbetej një shqetësim për shërbimet rrugore të policisë, pasi në shumë raste këto mjete largoheshin me vonesë, duke shkaktuar bllokim të trafikut. Për më tepër, sipas Policisë së Shtetit, shpenzimet në çdo rast paguheshin nga personi i siguruar dhe prezenca e kompanisë siguroese me mjetet e saj për të ofruar këtë shërbim, nuk vërehej në asnjë rast. Në këto kushte, drejtuesit e Policisë së Shtetit kishin kërkuar ndihmën tonë që ky problem që hasej shpesh në rrugët e vendit, të gjente një zgjidhje sa më të shpejtë.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me këto dy opinione zyrtare, për shkak të ristrukturimit që pësoi Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, mendoi se me fillimin e punës së AMF-së kjo çështje duhej ngritur për zgjidhje.

Si rrjedhim, krahas prezantimit të çështjes së lartpërmendur, kërkuam që përpara se të jepnim konkluzionet tona për këtë problematikë, ti bënim të njohur AMF-së fenomenin në këndvështrimin e shqetësimeve të padrejta që i shkaktoheshin individëve, mjetet e të cilëve dëmtohen në rast aksidenti.

Konkretisht, nëse një drejtues mjete motorik përfshihej në një aksident rrugor brenda zonës urbane të qyteteve, në të cilën mjete i tij pësonte dëmtime që kërkonin ndihmë teknike të specializuar, ai ishte i detyruar të paguante në vendngjarje mjetet private të rastit që mund të kryenin transportin e makinës së tij. Shpenzimet e këtij transporti me automjete të posaçme "karrotrec", në zonat urbane varjonin nga 5000-

10.000 lekë, ndërsa për zona të tjera ndërrbane apo në rrugë nacionale vlera trefishohej apo katërfishohej.

Për mendimin tonë, këto pagesa ishin tepër të larta dhe vetëm pajisja e kompanive të sigurimit me mjete të tilla mund të rregullonte këtë problem.

Në shumë raste, personi i përfshirë në aksident nuk kishte me vete vlera të konsiderueshme në të holla për të përballuar një shpenzim të tillë, madje në disa raste të transportit në distanca të largëta, kjo pamundësi bëhej akoma më e madhe në raport me të ardhurat e tij mujore. Duke ngelur një shqetësim në të dy rastet, shpesh kjo pamundësi financiare për t'ju përgjigjur mjeteve të transportit privat dhe nevojës për zhvendosjen e objektit të siguruar nga vendngjarja, kishte bërë që mjeti i dëmtuar të bllokonte trafikun për kohë të gjatë dhe të vinte në pozita të vështira personin e siguruar në gjetjen e mënyrave të mundshme për zgjidhjen e situatës së krijuar.

Në këto ngjarje të bënte përshtypje se, asistenca e kompanive të sigurimit të mjetit të dëmtuar, ishte inekzistente dhe shfaqej në rolin e saj pasiv. Shpesh herë ky rol luhej vetëm në drejtim të mbulimit të shpenzimeve të parapaguara nga i siguruari (kur vërtetohej me dokumente). Ndërsa në raste të tjera kur transporti bëhej me mjete të rastit, personi nuk rimburohej për shpenzimet e kryera. Ky qëndrim ishte për shkak të kuptimit të gabuar që i jepej dispozitave ligjore dhe kontraktore në fuqi, në lidhje me përballimin e dëmeve që vinin si shkak i aksidentimit të mjeteve motorike.

Nga studimi që bëmë për këto raste, pamë se shumë vende të zhvilluara perëndimore e kishin të zgjidhur këtë problem nëpërmjet një numri gadishmërie, me të cilin pajisen me lidhjen e kontratës së sigurimit nga shoqëria. Në këtë numër shërbimi, ofrohej transporti i menjëhershëm dhe riparimi i mjetit, pasi të ishin kryer veprimet e policisë rrugore. Çështja e fajit në aksident mbetej një element, i cili me shqyrtimin dhe vendimin që jepte komisioni apo gjykata përkatëse, mundësohej rimbursimi apo shkëmbimi i shpenzimeve për dëmin midis kompanive të sigurimit që kanë lidhur kontratë me mjetet e përfshira në ngjarje. Ky model, sipas mendimit tone krijonte mjaft lehtësira për drejtuesit e mjeteve dhe i shmangte ata nga pozita aspak të këndshme që ju krijoheshin në rrugë.

Nëse aksidenti përbën në vetvete një traumë të rëndë psikike dhe fizike për drejtuesit e mjeteve, kjo traumë nuk duhet shoqëruar me shqetësime të tjera, për të cilat i siguruari paguan rregullisht. Në këtë aspekt, Avokati i Popullit mendoi se AMF mund të vendoste standarte të reja, duke përmirësuar kështu nivelin e shërbimit të kompanive të sigurimit me një model të pranueshëm për të gjithë.

Përkufizimi që parashikon neni 3 i Ligjit Nr.9267 dt.29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetsimit në sigurime dhe risigurime” në lidhje me sigurimin, e nënkupton këtë shërbim një element bazë të transferimit të një rreziku të mundshëm dhe të shmangjes nga një humbje financiare të të siguruarit. Gjithashtu në Dekretin Nr 295 dt.15.09.1992 (i ndryshuar) “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Mbajtësve të Mjeteve Motorike për Përgjegjësinë ndaj Personave të Tretë” nuk parashikohet në mënyrë eksplicite mbulimi i shpenzimeve të transportit në rast aksidenti, por nënkuptohet që shërbimi i transportit është i përfshirë në faturën e dëmit dhe duhet trajtuar në formën e tij më të përshtatshme.

Në këto kushte çmuam se kishte ardhur koha që nocionit të mbulimi të dëmit, t'i jepet një kuptim i ri praktik dhe operativ nga ana e AMF-së, duke zbatuar kompetencat e saj që i njej neni 14 i Ligjit nr.9752 dt.03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare”.

Kjo iniciative duhej të konsistonte në riformatimin e kontratave të sigurimit të detyrueshëm të automjeteve, ku transporti i mjeteve të dëmtuara të parashikohej si shërbim i detyrueshëm nga kompanitë e sigurimeve apo nga persona të kontraktuar për këtë shërbim për llogari të tyre. Vetëm në këtë mënyrë do të bëhej e mundur zgjidhja e shqetësimit të qytetarëve dhe rritja e standarteve të shërbimeve që iu ofroheshin.

Duke e konsideruar edhe një herë vazhdimin e kësaj situate, si shkak që cënonte pozitat e ligjshme të të siguruarve dhe dëmtonte interesat e tyre ekonomike, Avokati i Popullit, i rekomandoi Kryetares se AMF-së: 1. Përcaktimin si të detyrueshme të klauzolës së mëposhtme në kontratat e sigurimit dhe implemtimin e saj praktik në interes të të drejtave dhe interesave të ligjshme të konsumatorit si vijon: *“Siguruesi siguron transportin e mjetit të dëmtuar nga vendi i aksidentit, deri në ofiçinën apo vendparkimin përkatës. Siguruesi mund të lejojë persona të tretë të kryjnë këtë shërbim, duke bërë pagesën përkatëse. Në asnjë rast pagesa e këtij shërbimi nuk mund t`i kërkohet si parapagim personit të siguar”*. 2. Përmirësimin e shërbimeve dhe vendosjen e standarteve të reja ndaj kompanive të sigurimit që duhet të mbulojnë transportin e mjeteve motorike në rast aksidenti.

Ne pergjigjen e saj, Kryetarja e AMF-së Znj. Elisabeta Gjoni duke shprehur konsideratën për rekomandimet e paraqitura nga Avokati i Popullit, informoi se sigurimi i detyrueshem për pergjegjesite ndaj personave të trete në rastet e aksidenteve automobilistike, rregullohej me Dekret Nr.295, date 15.9.1992 "Për sigurimin e detyrueshem të mbajtesve të mjeteve motorike për pergjegjesine ndaj personave të trete". Por ashtu sikurse e kishte konstatuar edhe zyra e Avokatit të Popullit, në këtë ligj ashtu si edhe në aktet nenligjore të dala në zbatim të tij, nuk parashikohej mbulimi i shpenzimeve të transportit në rast aksidenti.

Deri në amendimet e ligjit të sipërpermendur, ku mund të parashikohen dispozita me specifike dhe detyruese lidhur me mbulimin e shpenzimeve të transportit, mbetet të perfshihen parashikime të tilla në aktet nenligjore të hartuara nga Autoriteti. Aktualisht ky i fundit ndodhet në procesin e draftimit të një akti nenligjor mbi trajtimin e dëmeve, në të cilin trajtoheshin procedura për mbulimin dhe llogaritjen e shpenzimeve në rastin e transportimit të mjetit të demtuar me karrotrec.

Aktualisht, ky rregull është futur tashmë si pjesë përbërëse në rregulloren e përgjithëshme tip, e cila është miratuar nga AMF-ja, për veprimtarinë e subjekteve të mësipërme.

2. Në vijim të iniciativës së ndërmarrë më sipër nga zyra e Avokatit të Popullit, pamë të domosdoshme që ankesat për parregullsi apo shkelje të mundshme në drejtim të Tregut të sigurimeve në vendin tonë, kanë pasur nevojën e rregullimit të kësaj fushe me një legjislacion të ri dhe bashkëkohor.

Ligji Nr.9267 dt.29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetsimit në sigurime dhe risigurime” ishte pa dyshim ligji bazë që ka gjetur veprim në fushën e sigurimeve dhe si i tillë, respektimi dhe implementimi i tij i plotë, kishte një rëndësi të veçantë.

Një çështje që zgjoi vëmendjen tonë gjatë shqyrtimit të këtyre ankesave, ishin kundërshtitë e individëve ndaj vlerësimit të dëmit në rast aksidenti apo ngjarje tjetër për objekte apo subjekte të siguar. Megjithatë kjo çështje është objekt shqyrtimi dhe ka zgjidhje edhe nëpërmjet organeve gjyqësore, vëmendja jonë u fokusua në legjitimitimin dhe kriteret ligjore të ushtrimit të veprimtarisë nga ana e ekspertëve të vlerësimit të dëmeve.

Në një vështrim të përgjithshëm të Ligjit Nr. 9267 dt.29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, vërehet se veprimtaria e ekspertëve të vlerësimit të dëmit, liçensohet dhe mbikqyret nga Agjencia e Mbikqyrjes Financiare (AMF). Nga studimi i akteve nënligjore në fushën e sigurimeve dhe kontakti që patëm me ekspertë të zyrës juridike pranë AMF-se, u vumë në dijeni se detyrimi që buron nga dispozita e lartpërmendur për caktimin e kriterëve liçensuese me anë të një vendimi të veçantë të Këshillit të Ministrave, nuk ishte vënë ende në zbatim.

Në këto kushte, Avokati i Popullit kërkoi që AMF-ja të hartojë dhe paraqesë për miratim pranë Këshillit të Ministrave draftin përkatës. Veprimi i diktuar nga ana jonë, gjente mbështetje të plotë në dispozitën ligjore të mësipërme dhe përbënte një detyrë funksionale të AMF-se, për rregullimin e atyre aspekteve të ligjit mbi sigurimet, të cilat nuk kishin gjetur ende zbatim në praktikë.

Duke i qëndruar besnik parimeve të paanshmërisë dhe luajalitetit në respektimin e ligjit, kishim bindjen se, plotësimi i legjislacionit në këtë aspekt, do të sillte shmangien e veprimtarisë së vlerësimit të dëmit nga raste të shpeshta abuzimi, njëanshmërie dhe mundësie për korrupsion. Gjithashtu, vënia e këtij aktiviteti në pozita mbikqyrje dhe kontrolli shtetëror me anë të liçensimit, do të rriste akoma më shumë seriozitetin e këtij profesioni, duke minimizuar kundërshtitë apo konfliktet gjyqësore për veprimet e papergjegjshme të tyre, të cilat kishin kosto të konsiderueshme.

Duke e konsideruar edhe një herë këtë çështje, si mosveprim i cili mohonte në thelb të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve për të përfituar shërbime të liçensuara dhe të kontrolluara në fushën e sigurimeve, konform legjislacionit në fuqi, Avokati i Popullit, i rekomandoi Agjencisë së Mbikqyrjes Financiare hartimin dhe paraqitjen për miratim pranë Këshillit të Ministrave të projekt-vendimit mbi kriteret liçensuese të ekspertëve të dëmeve, si detyrim që buron nga Neni 89 i Ligjit Nr.9267 dt.29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

Ne pergjigje te rekomandimit tonë, Drejtoresha e AMF-së Znj. Elisabeta Gjoni lidhur me hartimin e aktit nën ligjor dhe paraqitjen për miratim pranë Këshillit të Ministrave të “Për kriteret dhe kushtet për dhënien dhe tërheqjen e licencës së vlerësuesve të dëmeve”, na informoi se Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare aktualisht është në procesin e hartimit të këtij akti nënligjor. Për këtë qëllim ishte ngritur një grup pune në përbërje të të cilit kishte përfaqësues nga shoqëritë e sigurimit, Byroja Shqiptare e Sigurimit, Shoqata e vlerësuesve të dëmeve dhe një avokat që merrej kryesisht me trajtimin e ankesave për dëmshpërblim.

Aktualisht, pas interesimit tonë rezultoi se kjo çështje pret të miratohet shumë shpejt nga ana e Këshillit të Ministrave.

a) Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve dhe Degët në varësi të saj

Për organin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve më vete, kemi pasur gjithsej 2 ankesa. Nga këto 1 është konsideruar jashtë juridiksionit, ndërkohë që 1 ankesë është zgjidhur në favor pas paraqitjes së rekomandimit përkatës nga Avokati i Popullit.

Për degët e organeve tatimore në rrethe kemi pasur gjithashtu 2 ankesa, të cilat vazhdojnë te trajtohen nga ekspertet e zyrës së Avokatit të Popullit.

Më hollësisht paraqitet rasti i trajtuar me rekomandim dhe që është pranuar:

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit paraqiti ankesën e tij një shtetas me banim në Tiranë, i cili duke qenë i punësuar më parë me detyrën e nëpunësit të Degës së Tatimeve Tiranë, sqaronte se me anë të një akti administrativ, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e kishte larguar atë nga detyra. Vendimi i mësipërm, me ankesë të qytetarit ishte bërë objekt shqyrtimi nga Komisioni i Shërbimit Civil, i cili në përfundim, në bazë të Vendimit të tij Nr.154 dt.07.03.2006 kishte vendosur anulimin e aktit administrativ të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, si akt absolutisht i pavlefshëm i nxjerre në kundërshtim me formën dhe përmbajtjen e ligjit, kthimin në vendin e mëparshëm të punës të qytetarit dhe detyrimin e kësaj drejtorie për t'i paguar atij pagën e kohës së qëndrimit pa punë.

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve pasi kishte marrë dijeni për vendimin e mësipërm të KSHC-së, kishte depozituar në Gjykatën e Apelit Tiranë kërkesën me objekt kundërshtimit të vendimit të lartpërmendur të Komisionit të Shërbimit Civil. Me Vendimin Nr.101 dt.11.09.2006, Gjykata e Apelit Tiranë kishte vendosur rrëzimin e kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil. Me kërkesë të ankuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë kishte lëshuar edhe Urdherin e Ekzekutimit Nr.1481 dt.27.11.2006, i cili detyronte zbatimin e detyrueshëm të vendimit të KSHC-së. Në vijim ankuesi sqaronte se kishte kërkuar nga Drejtoria e Personelit të Tatimeve t'i vihej në ekzekutim vendimi i lartpërmendur, por kjo kërkesë nuk ishte marrë në konsideratë.

Në këto kushte, ankuesi i ishte drejtuar Shërbimit Përmbartimor Tiranë, i cili nga ana e tij ishte shprehur se po vijonte përpjekjet për të zgjidhur këtë praktikë, dhe më konkretisht i ishte drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën e tyre më të fundit të depozituar me Nr.3637 Prot dt.02.04.2007, dhe kërkonin zbatimin e menjëhershëm të vendimeve të mësipërme, në të kundërt do të aplikoheshin masat përkatëse ndëshkuese. Ndodhur në këto rrethana, Avokati i Popullit me qëllimin e përmbushjes së funksioneve të tij kushtetuese e ligjore në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit konstatoi se neglizhenca për të zbatuar vendimin e mësipërm të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë, e ngarkonte Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me përgjegjësi ligjore dhe një qëndrim i tillë mund të çmohet si mosveprim i paligjshëm i këtij organi. Duke i rikujtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve se qëndrimi i mbajtur prej saj ishte në kundërshtim me nenin 142/3 të Kushtetutës së Shqipërisë, i rekomanduam rivënien në vend të të drejtave të mohuara ndaj ankuesit, duke vënë në zbatim Vendimin Nr.154 dt.07.03.2006 të Komisionit të Shërbimit Civil dhe Vendimin Nr.101 dt.11.09.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe marrjen e masave për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës të ankuesit, duke përmbushur të gjitha veprimet e duhura administrative dhe financiare në favor të tij.

Në përgjigje të rekomandimit të Zyrës së Avokatit të Popullit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve u informuam se për këtë çështje ishin marrë të gjitha masat e duhura administrative dhe financiare për të përmbushur me përpikmëri dispozitivin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

b) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Degët në varësi të saj

Për këtë organ së bashku me degët e rretheve kemi patur gjithsej 5 ankesa. Ankesat në fushën doganore, kryesisht prezantojnë si objekt të tyre kundërshtime të urdhërave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për lirime nga detyra të punonjësve. Ankuesit disponojnë vendime të Komisionit të Shërbimit Civil dhe

vendime të formës së prerë të Gjykatës së Apelit për rikthim në vendin e mëparshëm të punës, por ato nuk janë zbatuar. Me konkretisht, paraqitet rasti i mëposhtëm:

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit prezantoi ankesën e tij qytetari B. K. me banim në Durres, i cili kishte qenë i punësuar me detyrën e doganierit pranë Degës së Doganës Durrës. Ai sqaronte se me anë të aktit administrativ Nr. 786/3 Prot dt.25.02.2005 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganës ishte larguar nga detyra me motivacionin e shkeljeve të rënda korruptive gjatë kryerjes së detyrës.

Vendimi i mësipërm, me ankesë të të interesuarit u bë objekt shqyrtimi nga Komisioni i Shërbimit Civil, i cili në përfundim, në bazë të Vendimit të tij Nr.79 dt.20.04.2005 kishte vendosur anulimin e aktit administrativ të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave si akt absolutisht i pavlefshëm i nxjerre në kundërshtim me formën dhe përmbajtjen e ligjit, kthimin në vendin e mëparshëm të punës të ankuesit dhe detyrimin e kësaj drejtorie për t'i paguar atij pagën e kohës së qëndrimit pa punë.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pasi kishte marrë dijeni për vendimin e mësipërm të KSHC-së, kishte depozituar në Gjykatën e Apelit Tirane kërkesën me objekt kundërshtimin e vendimit të lartpërmendur të Komisionit të Shërbimit Civil. Me vendimin Nr.138 dt.16.12.2005 Gjykata e Apelit Tirane vendosi rrezimin e kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe lenien në fuqi të vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil.

Me kërkesë të qytetarit B.K., Gjykata e Apelit Tirane leshoi edhe Urdherin e Ekzekutimit Nr.22 dt.24.03.2006, i cili detyronte zbatimin e detyrueshëm të vendimit të KSHC-së. Pas kësaj ankuesi kishte kërkuar në vazhdimësi nga Drejtoria e Personelit të Doganave t'i vihej në ekzekutim vendimi i lartpërmendur, por kjo kërkesë nuk ishte marrë në konsideratë.

Në këto kushte, ankuesi ka qenë i detyruar t'i drejtohej Shërbimit Permbarimor Tirane, i cili nga ana e tij ishte shprehur se po vijonte perpjekjet për të zgjidhur deri në fund këtë çështje, por kishte hasur pengesa për shkak të ristrukturimit të këtij organi.

Në këto rrethana, Avokati i Popullit me qëllim përmbushjen e funksioneve të tij kushtetuese e ligjore në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit konstatoi neglizhencë për të zbatuar vendimin e mësipërm të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i rekomandoi Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave rivënien në vend të të drejtave të mohuara ndaj qytetarit B.K, duke vënë në zbatim Vendimin Nr.79 dt.20.04.2005 të Komisionit të Shërbimit Civil dhe Vendimin Nr.138 të Gjykatës së Apelit Tirane, si dhe marrjen e masave për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës të tij.

Në përgjigjen e ardhur nga ky organ, jemi vënë në dijeni se kjo çështje vijon të trajtohet nga ana e Gjykatës së Lartë.

Por ky qëndrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është i paligjshëm sepse vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë dhe duhet të ekzekutohet. Ankimi në Gjykatën e Lartë, nëqoftëse kjo Gjykatë nuk nxjerr vendim pezullimi të vecantë për ekzekutim, nuk mund të pengojë ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit.

11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Gjate vitit 2007, arsimit dhe shkencës, dy nga deget kryesore të veprimtarisë së administratës, janë përballur me sfidat të cilat kanë derivuar kryesisht nga

zbatimi i Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit. Në këtë kontekst, ngritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe trajnimit profesional, arritja e objektivave të Deklaratës së Bolonjës për sistemin e arsimit të lartë, garantimi i mosdiskriminimit në baza të gjinise, ngjyres, origjinës etnike ose fese në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit, si dhe rritja e nivelit të strukturave dhe veprimtarive arsimore dhe trajnuese, janë disa nga drejtimet kryesore të zhvillimeve përkrahur në këtë fushë. Në këtë kuadër, rezultojnë se janë ndërmarrë një sërë reformash, implementimi i të cilave ka patur impaktin konkret në komunitetin e mësuesve apo të diplomuarve në këtë profesion, si dhe të nxënësve dhe pjesës tjetër të komunitetit që indirekt është bërë pjesë aktive ose jo e këtij procesi.

Duke vlerësuar programin e qeverisë për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit, projektet afatshkurta dhe afatmesme në këtë fushë, do të evidentojmë disa nga shqetësimet me të cilat Institucioni i Avokati të Popullit është ndeshur. Këto kanë ardhur si pas ankesave të subjekteve pranë Institucionit tone, dhe pas studimit të legjislativës në fuqi.

Kështu, gjatë vitit 2007 ka patur 96 ankesa apo kërkesa të ardhura ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve në vartësi të saj. Janë në fazën e shqyrtimit pranë Zyrës sonë 20 ankesa. Në favor me ndërmjetësim janë zgjidhur 27 ankesa apo kërkesa, kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencës 17 ankesa, të pabazuara 26 ankesa, ndërsa për 3 çështje rekomandimi dërguar organit përkatës është refuzuar, një rekomandim është pranuar dhe për 2 ankesa subjektet kanë hequr dorë nga trajtimi i tyre.

Nga viti 2006 janë mbartur për shqyrtim 13 ankesa, nga të cilat 2 janë zgjidhur në favor me ndërmjetësim, 4 jashtë juridiksionit dhe kompetencës, 2 të pabazuara, 2 rekomandime janë refuzuar, një është pranuar dhe për 2 ankesa subjektet kanë hequr dorë për trajtimin e tyre.

Një numër jo i vogël ankesash kanë patur si objekt problematika që lidhen me marrëdhënien e punësimit në sektorin e arsimit, duke filluar që nga problemi i pagesës, shpërblimeve, trajtimeve të veçanta apo edhe i largimeve nga puna të mësuesve.

Gjatë trajtimit të këtyre ankesave janë evidentuar një sërë problemesh si në drejtim të menyrës së rregullimit ligjor të marrëdhënieve të punës së personelit mesimdhënës në sistemin parauniversitar, ashtu dhe në drejtim të moszbatimit të drejtë të këtij kuadri ligjor nga ana e organeve përgjegjëse.

Konkretisht ndër aktet normative kryesore të cilat rregullojnë problematiken e organizimit dhe të funksionimit të arsimit parauniversitar në vendin tone janë, Ligji Nr.7952, datë 21.6.1995 "*Per sistemin arsimor parauniversitar*" i ndryshuar, dispozitat normative të miratuara nga Ministri i Arsimit dhe që kanë hyrë në fuqi në vitin shkollor 2002-2003, V.K.M. Nr. 707, datë 16.10.2003 "*Per riorganizimin e drejtorive arsimore të rrethëve në drejtori arsimore rajonale dhe në zyra arsimore*", si dhe Udhezimi Nr. 29 datë 18.09.2006 i Ministrisë të Arsimit "*Per emerimet dhe levizjet e personelit mesimor dhe drejtues në arsimin parauniversitar*". Në drejtim të menyrës së rregullimit të marrëdhënieve të punës të personelit mesimor të sistemit parauniversitar, një rëndësi të posaçme merr Kontrata Kolektive e nënshkruar me datë 04.07.2006 midis Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikates së Pavarur të Arsimit.

Në veshtrim të Kushtetutës, evidentojmë dhe njëherë një shqetësimin të bërë prezent dhe në Raportet vjetore të dy viteve të kaluara. Kështu kemi evidentuar se Dispozitat Normative të arsimit Parauniversitare nuk janë miratuar me urdher apo udhëzim të Ministrisë të Arsimit. Ato janë firmosur nga Ministri, duke u dërguar për

zbatim me shkresë zyrtare nga Sekretari i Pergjithshem. Referuar nenit 102, pika 4, te Kushtetutes, ne zbatim te kompetencave te tij Ministri nxjerr urdhra dhe udhezime. Ne keto kushte, rregullimi sipas kushtetutes i kesaj çështjeje nuk eshte bere nga Ministri i Arsimit dhe Shkences.

Ne baze te parashikimeve te Kushtetutes dhe Ligjit “Per Avokatin e Popullit”, i kemi rekomanduar Ministrin te Arsimit dhe Shkences, terheqjen dhe ballafaqimin e mendimeve te grupeve te interesit, ne menyre qe akti perfundimtar, pra Dispozitat e reja Normative qe do te miratoheshin, te ishin jo vetem ne perputhje me ligjet, por dhe me kushtet e reja te cilat jane bere prezente.

Pavaresisht se qendrimi i Ministrise se Arsimit per kete çështje ka qene i njejte me konstatimin tone, çështja paraqitet delikate. Kjo pasi eshte e veshtire te percaktohet drejt hierarkia e normave te cilat duhet te zbatohen organet kompetente per situata te ndryshme qe kane te bejne me organizmin e sistemit te arsimit parauniversitar, si ne drejtimin administrative, apo dhe ne permbajtje te tij.

Nje pjese e rendesishme e Strategjise Kombetare te Arsimit 2004-2015 është edhe rritja e cilesise se mesimdhenies. Kjo do te realizohet nepermjet procesit te kurrikules per trajnimin e mesuesve, skemes motivuese te punesimit te bazuara ne meritat, shqyrtimit te modeleve te reja dhe alternative te trajnimit te mesuesve etj . Por terheqja dhe mbajtja ne pune e mesuesve cilësorë kërkon aplikimin e skemave te reja te motivimit, te cilat bazohen ne performancë/meritë dhe jo thjesht ne stazhin e punës.

Sistemi arsimor parauniversitar rregullohet me nje Ligj i cili ka dale para miratimit te Kushtetutes, qe lidhur me personelin mesimor, ne nenin 14 te tij parashikon nder te tjera se:

“Në institucionet shkollore dhe parashkollore publike mesuesi është figura qendrore shkencore e pedagogjike.....

Kërkesat bazë për pergatitjen iniciale dhe kualifikimin e mesuesve percaktohen nga Ministria e Arsimit”.

Ne rast se me “kerkesa qe lidhen me pergatitjen iniciale”, do te kuptojme kushtet qe duhet te permbushen nje mesues per t’u punesuar si i tille ne arsimin parauniversitar , atehere keto te fundit duhet te miratohen me nje akt te Ministrin te Arsimit. Ne aktet te cilat jane miratuar pas ligjit rezulton qe Dispozitat Normative ne nenet 46 dhe 55 te tyre, te referojne tek “Kontrata Kolektive” e cila duhet te parashikojne masat disiplinore dhe tek Kodi i Punes persa i perket levizjeve ne pune te mesuesve . Pra as ligji dhe as Dispozitat Normative, nuk parashikojne kerkesa qe lidhen me pergatitjen iniciale te mesuesve. Nderkohe ka ekzistuar Udhezimi Nr.10 date 16.06.1993 “Per emerimet dhe levizjet e kuadrit arsimor” perputhshmeria e te cilit me ligjin dhe me Dispozitat Normative ka qene e diskutueshme ne momentin e miratimit te tyre.

Kjo situatë ka vazhduar deri ne momentin e nenshkrimimit te “Kontrates Kolektive” te siperpermendur. Pasi ajo ka parashikuar nje sere çështjesh te rendesishme qe nuk kane gjetur rregullim ne asnje prej akteve ligjore apo nenligjore te nxjerra deri ne momentin e hyrjes ne fuqi te saj. Ne kete kontrate jane percaktuar kriteret me kryesore te punonjesve qe mund te punesohen ne arsim, disa nga shkaqet e arsyeshme per zgjidhjen e marredhenieve te punes ne arsim, si reforma ne arsim, pakesimi i numrit te nxenesve, nje specifikim rastesh jo shterues, proceduren e largimit nga puna, proceduren e marrjes ne pune, rastet e ndryshimeve te vendit te punes nga ana e punedhenesit etj.

Megjithate baza ligjore qe rregullon problematiken e mesiperme perseri eshte e paplote pasi hierarkia e akteve sipas Kushtetutes tone kerkon qe Ministri i Arsimit,

bazur ne Ligj ta rregulloje specifikisht kete çeshtje, pasi jo pak here organet jane ndodhur ne dilemen qe do te zbatojne Dispozitat Normative apo Kontraten Kolektive.

Nisur nga kjo situatë Ministri i Arsimit ka nxjerre Udhezimin nr.29 date 18.09.2006 “Per emerimet e levizjet e personelit mesimor dhe drejtues ne arsimin parauniversitar”, i cili nder te tjera eshte mbeshtetur ne Kontraten Kolektive. Duke ju referuar dhe njehere hierarkise se normave, arrijme ne konkluzionin se orientimi ne aktet nenligjore qe rregullojne çeshtjet qe kane te bejne me maredheniet e punes se personelit mesimor te sistemit arsimor parauniversitar, te çon ne konkluzionin se jemi para perdorimit te nje llogjike jo kushtetuese.

Udhezimi i Ministrimit duhet te dale ne baze e per zbatim te nje ligji i cili duhet te specifikojë kriteret kryesore dhe detajimi me pas te behet me akt nenligjor. Ne kete situatë, fuqia e ligjit i jepet jo vetem ligjit “Per Sistemin Arsimor Parauniversitar” dhe Dispozitave Normative, por dhe Kontrates Kolektive e cila nuk eshte nje akt normativ. Ligji, Dispozitat normative si dhe Udhezimi duhet t’i paraprijne nenshkrimin te Kontrates Kolektive, e cila sipas Dispozitave Normative, legjitimohet te rregulloje vetem çeshtjen e masave disiplinore. Persa i perket kriterëve qe duhet te permbushë nje person qe te punesohet si mesues ne arsimin parauniversitar, procedurat se marrjes ne pune, keto jane çeshtje qe duhet te gjejne nje specifikim te posaçem ligjor apo dhe nenligjor, per te minimizuar ne maksimum rastet e shkeljeve dhe shfaqjes se subjektivizmit ne vendimmarrje.

Nga trajtimi i ankesave te cilat kane patur per objekt mosstemimin ne pune si mesues ne sistemin parauniversitar kemi konstatuar se procedura e emerimit te tyre nuk kalon nepermjet nje procesi konkurimi te bazuar ne meritat, procedure kjo e parashkuar ne Kontraten Kolektive dhe ne Udhezimin nr.19 date 18.09.2006 te Ministrimit te Arsimit. Megjithë kundërshtite e konstatuara me siper, duke e marre si pozitiv faktin e parashikimit te nje procedure konkurimi per nje vend te lire pune, kjo e fundit nuk evidentohet te jete kryer ne asnje prej Drejtorive Arsimore Rajonale apo Zyrrave Arsimore, te cilave ju eshte kerkuar ta konfirmojne zyrtarisht kete.

Duke vleresuar reformen qe ky organ po ben ne drejtim te rritjes se cilesise se mesimdhënies jemi te mendimit se duhet te gjendet rruga e duhur ligjore per ta realizuar ate. Ky konstatim eshte i njejte me konkluzionet e Strategjise Kombetare per Arsimin Parauniversitar 2004-2015. Ne kete dokument, me synimin e rritjes se cilesise se mesimdhënies, permendet nevoja për të zhvilluar procesin e regjistrimit dhe akreditimit të mësuesve, si dhe zbatimin e procedurave për monitorim të vazhdueshëm.

Regjistrimi i mësuesve do të shërbejë si parakusht për të zënë një vend pune si mësues. Ne kete akt theksohet me force se procedura e aplikimit për vend pune, e miratimit dhe e zgjidhjes së konflikteve duhet të hartohet dhe miratohet formalisht nga qeveria dhe MASH. Kjo duhet të realizohet së bashku me reformën e programeve të trajnimit të mësuesve.

Nga ankesat e trajtuara përmendim:

1. Prane Institucionit tone kane paraqitur nje ankese dy pedagoge te Universitetit Bujqesor te Tiranes, shtetasit A.N dhe F.G.

Objekt i ankeses se tyre ka qene largimi i padrejte nga puna si pedagoge te universitetit.

Gjate shqyrtimit te ankeses se paraqitur nga ana e A.N ka rezultuar se ai eshte larguar nga puna me Vendimin nr. 14 date 24.05.2007, te Rektorit te Universitetit Bujqesor te Tiranës. Ky vendim, ishte bazuar ne:

1. Perpjekjen e A.N per te falsifikuar nje dokument per ta perdorur per qellim perfitimi te titullit pedagogjik shkencor Profesor i Asociuar.
2. Gjate gjithë kohës te punës nga anketimet e zhvilluara me studentet ka rezultuar mjaft problematik ne lidhje me etiken universitare te maredhenieve me studentet
3. Ne mbledhjen e dates 14.06.2005, Keshilli i Fakultetit i ka hequr te drejten si firme e pare ne komisionet e provimit te lendes si pasoje e rezultateve te sondazheve te kryera;
4. Vendimi Nr. 50 date 10.05.2007 i Keshillit te Fakultetit, i cili i ka propozuar Rektorit qe per te gjithë ata persona qe rezultojne te perfolur ne te gjitha anketimet e kryera me studentet ne Universitetin Bujqesor te Tiranës, te merren masat me ekstreme.

Duke analizuar vendimin e mesiperme arrihem ne keto konkluzione;

a. Vendimi Nr. 14 date 24.05.2007 i Rektorit te Universitetit Bujqesor te Tiranës, eshte nxjerre se pari nga organi kompetent. Referuar nenit 31 te Statutit te Universitetit, “Rektori jep dhe miraton masat disiplinore per punonjesit deri ne largimin e tyre nga puna, kur shkelen nenet e Statutit, te Rregulloreve funksionale te Universitetit apo dispozitat ligjore te Kodit te Punes”.

Ne rastin konkret ne vendim eshte permendur shkelja e nenit 72, pika h te Rregullores se Studimeve Universitare ku parashikohet se: Detyrat e stafit akademik dhe atij ndihmes mesimor:

Te respektoje gjate gjithë veprimtarise se tyre parimet e etikes qytetare, duke shfaqur nje figure morale te papajtueshme me veset e keqija. Figura e pedagogut duhet te sherbeje per studentet si shembull i ndershmerise, largpamjes etj. Pedagogu mban pergjegjesi per shkeljen e rregullave te shkolles. Shkelja e rregullave te shkolles konsiderohen te gjitha veprimet e kryera nga ana e pedagogut qe cenojne personalitetin e studenteve apo te punonjesve te tjere te universitetit, normat etiko morale te mjedisit universitar apo shoqerise. Ndaj pedagogut qe kryen veprime te tilla, do te merren keto masa disionore:

Verejtje me shkrim, paralajmerim per perjashtim nga puna, perjashtim nga puna”.

Per kete ankese arrihem ne konkluzionin se referuar Statutit dhe Rregullores se Universitetit Bujqesor, propozimi i bere nga ana e Keshillit te Fakultetit per largim nga puna nuk ishte nje vendim detyrues per Rektorin per te marre vendimin perfundimtar, por duhet te konsiderohej nje akt i cili do te sherbeje per fillimin e nje procedimi administrativ. Ky procedim do te provoje nese faktet e rezultuara nga sondazhi jane te verteta, ne menyre qe me pas Rektori te argumentoje vendimin e largimit.

Edhe me pare Institucioni yne ne shqyrtimin e ankeses se shtetases D.S. i ka drejtuar Universitetit Bujqesor nje Rekomandim ku theksohet se: “...Ne asnje menyre, rezultatet e sondazhit nuk mund te perdoren si prova qe vertetojne mitmarrjen e nje apo disa pedagogeve. Rezultatet e sondazheve kane nje karakter te thelle subjektiv e cila vjen si pasoje e pakenaqesise apo preferencave te studenteve te ndryshem perballe nje apo disa pedagogeve. Nese ka patur me te vertete te dhena per mitmarrje ndaj pedagogeve te cituar ne sondazh, ne rast se nuk mund te provonit ne rruge administrative ekzistencen e shkeljeve, ju duhet te kishit bere denoncimin perkates prane organit te prokurorise per ndjekjen e metejshtme te kesaj ceshtje mjaft te rendesishme” .

Pra referuar dokumentacionit qe na eshte vene ne dispozicion, nuk rezulton qe nga ana e strukturave perkatese vendimmarrese te jete bere nje hetim administrativ per provueshmerine e shkeljeve te konstatuara nga sondazhet.

b. Lidhur me argumentin tjetër, se ankuesi është “perpjekur për të fallsifikuar nje dokument”, dhe si pasoje ky i fundit ka konsumuar elementet e vepres penale të parashikuar nga neni 186/1 të Kodit Penal., evidentojme se ky konstatim ka qene ne nivelin administrativ. Kjo, pasi nuk rezulton asnje vendim gjyqësor i cili të ketë provuar konsumimin e kesaj vepre penale nga ana e ankuesit. Nese ekzistojne elementet e kesaj vepre penale Rektori duhet t’i drejtohej organit të Prokurorisë duke i parashtruar të gjithë pretendimet perkatese.

c. Lidhur me pretendimin tjetër të parashtruar në pergjigjen drejtuar Institucionit tone se meqenese A.N. nuk pranoi të rinovojë kontratën e punes me punedhënesin pasi kishte mbaruar afati 5 vjecar i kontrates, Universiteti Bujqësor i Tiranës nuk kishte asnje detyrim kontraktual me ta, nuk qendron. Pasi po t’i referohemi nenit 149 të Kodit të Punes ku parashikohet se:

“Kontrata me afat të caktuar perfundon në fund të kohës së parashikuar në kontratë. Kur mbas perfundimit të afatit të caktuar kontrata zgjatet në heshtje të ketij afati, ajo konsiderohet si kontratë me afat të pacaktuar”, argumenti i mesiperm nuk qendron. Maredhenia e punes në këtë rast rregullohet me dispozitat e Kodit të Punes të cilat duhet të respektohen për çdo vendimarrje në rast të tilla.

Duke qene se *vendimi Nr. 14 date 24.05.2000*, është nje akt administrativ kemi konstatuar gjithashtu se procesi administrativ nga ana e Rektorit është zhvilluar në termat e nje procesi të rregullt ligjor.

Referuar nenit 42 të Kushtetutes ku parashikohet se :

“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetute dhe me ligj nuk mund të cenohen pa nje proces të rregullt ligjor” si dhe të jurisprudences së Gjykatës Kushtetuese ka rezultuar se procesi ligjor është nje detyrueshmeri jo vetëm për procesin gjyqësor, por dhe atë administrativ.

Duke qene se në rastin konkret kemi qene para zhvillimit të nje procesi administrativ dhe objekt i ketij procesi ka qene diskutimi rreth rezultateve të sondazheve të studenteve, duhet të zbatoheshin konkretisht nenet 47 dhe 93 të Kodit të Proçedurave Administrative të cilet perkatesisht parashikojne se :

“Fillimi i procesit me nismën e administratës duhet t’u behet i ditur atyre personave të drejtat dhe interesat e ligjshëm të të cileve mund të preken si rezultat i veprimeve të ndëmarra gjatë procesit , kur këta persona mund të identifikohen...”,

“Pas perfundimit të procesit hetimor, palët e interesuara kanë të drejtë të shprehën përpara marrjes së vendimit perfundimtar”,

Sa me sipër degjimi i paleve në nje proces administrativ, është nje detyrim kushtetues dhe ligjor, që në rastin konkret nuk është respektuar.

Në këto kushte, duke i konsideruar aktet e mesipërme në kundërshtim me Kushtetuten dhe me Kodin e Proçedurave Administrative, referuar nenit 121 të Kodit të Proçedurave Administrative i jemi drejtuar me Rekomandim Rektorit të Universitetit Bujqësor ku i kemi shpjeguar se para ketij organi ekziston detyrimi ligjor për të revokuar Vendimin Nr. 14 date 24.05.2007.

Në pergjigje të Rekomandimit, jemi informuar se tashmë ceshtja është bere objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe ky organ është në pritje të vendimit perfundimtar që do të marrë gjykata..

2. Shtetesja Z. M. në ankesën e saj parashtronte se kishte mbaruar studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Dega Matematike,

ne vitin 2001. Por pavaresisht se i ishte drejtuar zyres Arsimore Pogradec per t'u sistemuar ne pune si mesuese, i ishte mohuar kjo e drejte.

Ne keto kushte ajo ju drejtua Institucionit tone ku parashtrroi se verbalisht autoritetet zyrtare te Zyres Arsimore Pogradec i kishin konfirmuar se arsyeja e mosistemimit ka qene mbajtja e shamise nga ana e saj si shprehje e besimit te saj fetar mysliman.

Bazuar ne ankesen e paraqitur ju drejtuam me kerkese per shpjegime Zyres Arsimore duke i kerkuar informacion lidhur me faktin se cilat ishin kriteret qe kjo zyre kishte shpallur per sistemimin ne pune te stafit pedagogjik dhe cilat ishin rezultatet e testimit perfundimtar.

Por pavaresisht shkreses se derguar, dhe detyrimit Kushtetues e ligjore qe qendron para ketij organi te administrates publike, nuk morem nje pergjigje zyrtare. Por nga komunikimi verbal me kete Instiutucion rezultoi se ankuesja ishte sistemuar ne pune.

Por ne vazhdim Institucioni yne eshte investuar pasi nga ana e Pergjegjeses se Zyres Arsimore, ne menyre verbale, ankueses ju vendos si kusht qe, ne rast se kerkon te punoje si mesuese duhet te heqe shamine gjate zhvillimit te procesit mesimor.

Ne keto kushte Zyres Arsimore Pogradec ju drejtuam me Rekomandim duke argumentuar .:

Ne nenin 10 te Kushtetutes parashihet se shteti eshte asnjanes ne ceshtjet e besimit e te ndergjegjes dhe garanton lirine e shprehjes se tyre ne jeten publike. Edhe ne nenin 24 te Kushtetutes percaktohet se secili eshte i lire te zgjedhe, ose te ndryshoje fene, ose bindjet, si dhe t'i shfaqe ato individualisht ose kolektivisht, ne publik ose ne jeten private, nepermjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes se riteve.

Ne morine e Akteve Nderkombetare, mund te permendet neni 18 i Deklarates Universale te Drejtave te Njeriut ku thuhet se: "Çdo njeri ka te drejten e lirise se mendimit, te ndergjegjes dhe te fese, kjo e drejte nenkupton lirine per te ndryshuar fene ose bindjet, vetem per vetem apo bashkarisht si ne publik ashtu edhe privatisht, nepermjet arsimimit, praktikave, kultit dhe kryerjes se riteve", neni 9 i Konventes Europiane per te Drejtat e Njeriut, Konventen per Luften kunder diskriminimit ne Fushen e Arsimimit, neni 26 te Konventes Nderkombetare per te drejtat Civile dhe Politike etj.

Liria e besimit dhe e ndergjegjes dhe liria e shprehjes se tyre ne jeten publike, jane liri individuale te garantuara nga Kushtetuta e Republikes se Shqiperise. Si te tilla, kufizimi i tyre mund te behet vetem me ligj per nje interes publik, ose per mbrojtjen e te drejtave te tjereve (neni 17/1 i Kushtetutes). Per me teper, kufizimi qe mund te behet ne keto raste, nuk mund te cenoje thelbin e lirive dhe ne asnje rast nuk mund te tejkaloje kufizimet e parashikuara ne Konventen Europiane per te Drejtat e Njeriut (neni 17/2 i Kushtetutes).

Pikepyetja qe u ngrit per diskutim ne kete ceshtje eshte se, a mundet qe nje organ administrative te kufizojë liri te garantuara me Kushtetute? Pergjigja eshte prerazi Jo. Nga ana tjeter ne kete ceshtje kemi mbajtur parasysh parimin e pergjithshem te se drejtes se ajo qe nuk pengohet shprehimisht me ligj, lejohet.

Pra duke e konsideruar si shkelje qendrimin e pergjegjeses se Zyres Arsimore Pogradec ndaj ankueses Z.M. per te hequr shamine gjate procesit mesimor, perfundimisht i kemi rekomanduar te mos pengojë ankuesen te ushtrroje profesionin e saj si mesuese duke mbajtur shaminë e kokës, si një shprehje e besimit te saj fetar.

Rezulton qe pavaresisht se ka kaluar nje kohe e gjate nga dergimi i Rekomandimit ende nuk kemi nje pergjigje zyrtare nga ana e Zyres Arsimore Pogradec. Per kete ceshtje kemi infomuar dhe Ministrine e Arsimit dhe Shkences sepse ne raste te tilla ne lidhje me mbajtjen e shamise ne koke ka patur edhe nxenese ne shkollat e mesme apo ne universitet. Por per fat te keq kjo Ministri vazhdon te mbaje nje qendrim te papergjegjshem, per te mos shprehur asnje qendrim zyrtar per keto lloj ankesash.

Rekomandimet e Institucionit tone kane qene ne koherence dhe me permbajtjen e Marreveshjes se Stabilizim Asocimit ne te cilen parashikohet se, nje nga detyrimet e shtetit tone eshte garantimi i aksesit në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Shqipëri. Kjo do te realizohet duke eliminuar rastet e diskriminimit në bazë të gjinisë, ngjyrës, origjinës etnike ose fesë, bazuar ne Kushtetuten tone dhe Aktet e pranuar Nderkombetare.

3. Shtetasi A.B. eshte ankuar per mosrealizim te nje konkursi te drejte dhe te hapur per pozicionin e punes "jurist" prane Zyres Arsimore Devoll.

Ai ne ankese parashtroi se ne kete zyre ekzistonte ky vend pune. Por ne te ishte emeruar nje person i cili nuk kishte arsimin perkates por ishte arsimuar ne Fakultetin Ekonomik.

Ne pergjigje te kerkeses tone , nga kjo Zyre, u informuam se per vendin e punes "jurist" i mbetur vakant prej dy muajsh, qe nga data 03.11.2006, ka patur vetem nje kerkese, ajo e ekonomistit te kesaj zyre, me diplome Ekonomist i Pergjithshem.

Pra, sipas pretendimeve rezultonte se duke qene se prane kesaj zyre u paraqit vetem nje kerkese, u be emerimi i nje personi me arsim te larte "Ekonomist", me te cilin u hartua Kontrata e punes per vendin e punes "Jurist" e cila i shtrinte efektet e saj deri ne daten 05.11.2008.

Ne analize perfundimtare konstatuam se:

Zyra Arsimore Devoll, eshte nje institucion i cili eshte organizuar ne baze te V.K.M Nr. 707, date 16.10.2003 "Per riorganizimin e drejtorive arsimore te rretheve ne drejtori arsimore rajonale dhe ne zyra arsimore

Ne baze te ketij akti nenligjor, konkretisht ne baze te pikes 10 parashikohet se:

"Drejtuesi i zyres arsimore emerohet apo largohet nga detyra, nga drejtori i drejtorise arsimore rajonale, qe ka ne varesi zyren, ndersa nepunesit (pergjegjes sektori, specialist) te ketyre drejtorive e zyrave nga drejtuesit perkates. Emerimi i tyre behet sipas procedurave te percaktuara ne ligjin nr.8549, date 11.11.1999, "Statusi i nepunesit civil". Kur zyra arsimore eshte pjese perberese e drejtorise arsimore rajonale, atehere drejtues perkates te jete drejtuesi i kesaj drejtorie". Ne keto kushte per vendin e punes "Jurist" kjo Zyre duhet te ndiqnte te gjithe proceduren e detajuar sipas parashikimeve te bera ne Ligjin nr.8549, date 11.11.1999, "Statusi i nepunesit civil".

Nga analiza e dispozitave te mesiperme ka rezultuar se kjo Zyre duhet te shpallte vendin vakant, te realizonte perzgjedhjen e dosjeve sipas kriterëve te shpalluar, por ne asnje menyre nuk mund te zhvillonte konkursin pa marre pjese ne te pakten 4 persona, kerkese kjo e ligjit ne fjale. Nga studimi i vendimit te mesiperme te Keshillit te Ministrave, kemi arritur ne konkluzionin se maredheniet punes se personelit te zyrave rregullohen me Kodin e Punes por procedura e marrjes ne pune duhet te jete e ajo e parashikuar ne ligjin "Per statusin e nenpunesit civil".

Ne keto kushte, duke qene se ne kete vendimmarrje jane shkelur procedurat e parashikuara ne ligj, akti qe eshte nxjerre rezulton te jete absolutisht i pavlefshem, ne baze te nenit 116 pika c te Kodit te Proçedurave Administrative.

Ky akt nuk mund te prodhoje asnje pasoje juridike. Rrjedhimisht dhe çdo akt tjetër i cili ka ardhur si pasoje e aktit te emerimit, konkretisht kontrata e punes e cila mban date 05.07.2007, rezulton nul.

Sa me siper, duke e konsideruar si te paligjshme vendimmarrjen pergjegjesit te Zyres Arsimore Devoll, kemi rekomanduar konstatimin si absolutisht te pavlefshem te aktit te emerimit ne detyren "Jurist" prane zyres arsimore Devoll dhe rifillimin e proçedurave te emerimit ne kete vend pune te personave te cilet te plotesojne kriteret e ketij vendi pune duke respektuar legjislacionin ne fuqi.

Ne pergjigje te ketij Rekomandimi nga Zyra Arsimore Devoll jemi informuar se kjo e fundit ka organizuar nje proces konkurimi, bazuar ne legjislacionin ne fuqi, per vendin e punes jurist ne kete zyre duke punesuar ne te nje person me diplome "Jurist".

4. Institucionit tone i eshte drejtuar shtetasi K.M. pedagog i jashtem i Fakultetit te Shkencave te Natyres prane Universitetit te Tiranes.

Ai ne ankese shpreh shqetesimin lidhur me mospagimin e honorareve te cilat i takojne si rezultat i realizimit te mbrojtjes se temave per marrjen e titullit "Doktor i shkencave"

Problemi i dyte i shtruar nga ankuesi, ka te beje me moszbatimin e Udhezimit nr.34, dt. 27.10.1999 "Per shperblimin e punonjesve ne zbatim te VKM nr.199, date 22.4.1999", te nxjerre nga Ministri i Arsimit dhe Shkences dhe Ministri i Financave, ne germen "f" te te cilit parashikohej shperblimi sipas emertesave, per punonjesit qe nuk jane efektive ne shkollat e larta por qe jane bashkepunetore ne veprimtarine e tyre, shperblim te cilin ankuesi nuk e kishte marre per rreth 2 vjet.

Duke i vleresuar si plotesisht te drejta dhe te bazuara ne legjislacionin tone pretendimet e ankuesit, u realizua nje proces ndermjetesimi aktiv me drejtuesit e deleguar te Fakultetit te Shkencave te Natyres dhe Drejtorine se Personelit ne Rektoratin e Universitetit te Tiranes. Ky komunikim çoi ne zgjidhjen pozitive te kesaj ankese duke marre ankuesi shperblimin qe i takonte per punen e kryer sipas akteve ne fuqi.

Prane Institucionit tone ka patur ankesa në të cilat është pretenduar zvarritje e proçedurave për ekuivalentimin e diplomave të individeve të cilët kanë mbaruar studimet jashtë vendit, diskriminim dhe shkelje të ligjeve dhe akteve nënligjore në procedurën e largimit nga puna te stafit akademik nga ana e organeve drejtuese të fakulteteve etj. Gjate shqyrtimit te rasteve ku eshte pretenduar zvarritje ne procedurat per ekuivalentimin e diplomave nga ana e Ministrise se Arsimit kemi konstatuar se ndryshimi i bazes ligjore per kete proces ka qene shkak i mosfunksionimit te strukturave perkatese per nje periudhe kohe te caktuar.

Perfundimisht konstatojme se komunikimi zyrtar me Ministrine e Arsimit si dhe me Institucionet ne varesi te saj ne disa raste ka qene jo ne perputhje me parashikimet ligjore persa i perket kthimit te pergjigjes brenda afatit ligjore. Ne disa raste keto vonesa jane bere pengese ne trajtimin ne kohen e duhur te ankesave.

12. Ministria e Shëndetësisë

Gjatë vitit 2007 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet në vartësi të saj janë shqyrtuar gjithsej 37 ankesa. Kanë qenë të mbartura gjithashtu dhe 8 raste

nga viti 2006. Janë përfunduar 34 ankesa, 13 janë zgjidhur në favor, 10 kanë rezultuar të pabazuara dhe 2 kanë qënë jashtë juridiksionit, 3 jashtë kompetence, 5 raste janë zgjidhur me rekomandim. Janë mbartur 6 ankesa për shqyrtim në vitin 2007.

Problematika e çështjeve që kanë të bëjnë me këtë ministri ka qënë kryesisht lidhur me vendimet për largimet nga detyra, transferime, tarifa prej 100-lekësh që paguhet për çdo recete me ilaçe të rimbursueshme, mosrimbursim të ilaçeve, kërkesa Ministrisë së Shëndetësisë për t'u kuruar jashtë shtetit, trajtimi i të sëmurëve me probleme të shëndetit mendor etj.

Në vijim të përpjekjeve tona institucionale, edhe kete vit kemi ndërmarrë nisma për evidentimin dhe vënien në dukje të të metave që ofrojnë shërbimet shëndetësore, si kusht parësor për të mënjeluar dukuritë negative dhe për të rritur me performanca serioze cilësinë e shërbimeve që ofrohen në qendrat tona spitalore. Kësaj nisme i erdhi në ndihmë edhe miratimi i ndryshimeve të reja që ju bënë në Kuvend Ligjit Nr.8454 dt.4.02.1999 "*Per Avokatin e Popullit*", të cilat sanksionuan të drejtën e Avokatit të Popullit për të kryer inspektime edhe në institucionet publike shëndetësore, veçanërisht në spitalet psikiatrike, duke i dhënë veprimtarisë tonë hapësira të reja për të përmbushur sa më mirë misionin kushtetues, në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve.

1. Avokati i Popullit e ka konsideruar shërbimin shëndetësor një ndër objektivat primare të punës së tij, pasi cilësia e shëndetit dhe e mbrojtjes së tij është një nga të drejtat më elementare që duhet të garantojë Shteti Shqiptar në dobi të të gjithë individëve që kanë nevojë për të.

Në këtë kuadër, Institucioni i Avokatit të Popullit krahas veprimtarisë së tij në disa aspekte të caktuara të kësaj fushe, ka kryer në Shkurt të vitit 2006 një inspektim në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit.

Nga gjendja e konstatuar në atë kohë, si dhe referuar legjislacionit për shëndetin mendor, rezultoi se shërbimi shëndetësor që ofrohej në këtë specialitet kishte të meta si në menaxhimin mjekësor dhe ekonomik, ashtu dhe në zbatimin e ligjit.

Në këto kushte nga ana jonë ju është paraqitur autoriteteve prkatese një rekomandim i veçantë për këtë çështje. Nga pergjigjet e prezantuara pranë Zyrës së Avokatit të Popullit u vërejt dukshëm një angazhim i veçantë i Ministrisë së Shëndetësisë për të marrë masat e duhura në përmirësimin e situatës së konstatuar.

Megjithëse rekomandimi i paraqitur në vitin 2006 arriti të ngacmojë vëmendjen e organeve kompetente dhe u shoqërua me masa konkrete, Avokati i Popullit nisur nga eksperiencia e tij mbi problemet në këtë fushë, vendosi që të ushtrojë sërish një inspektim mbi të gjithë objektet spitalore që mbulojnë shërbimin e psikiatrisë.

Inisiativa për të kryer sërish këtë inspektim, ishte shprehje e një interesimi të veçantë që kemi për të drejtat e pacientëve dhe kushtet që ata duhet të gëzojnë. Por dhe për të ndikuar deri në fund dhe me efektivitet për korrigjimin dhe rehabilitimin e nje seri dukurish negative që vihen re ende në këtë shërbim. Gjithashtu ne besojmë se brenda shërbimit shëndetësor, qendrat psikiatrike mbeten "*Thembra e Akilit*" pasi përmbajnë një problematikë të theksuar dhe komplekse që pengon zhvillimin e një modeli të ri dhe bashkëkohor shëndetësor.

Avokati i Popullit në ushtrimin e këtij inspektimi kërkoi të kishte partner edhe perfaqesuesit e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, por ndihma e tyre nuk i kaloi caqet e disa këshillave dhe sugjerimeve të pakta për objektet dhe mënyrën e kontrollit.

A. Në vijim, institucioneve perkatese, i parashtruam ne menyre të detajuar rezultatet e inspektimit tonë, duke ju përmbajtur një rradhe të dhënash, sipas kërkesave të Ligjit Nr.8092 dt.21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor”.

I. Spitali Psikiatrik Elbasan

1) Numri i pacienteve gjithsej 302 nga të cilët 113 pacientë akut dhe 189 pacientë kronik. Kapaciteti i mundshëm i shtrimit është 310 pacientë. Situata paraqitet e mbipopulluar, pasi spitali po i nënshtrohet një rikonstruksioni dhe shumë dhoma ishin jashtë funksioni.

2) Numri i personelit mjeksor ishte në kuotën e 190 personave, nga të cilët 6 mjekë. Nga keta 1 mjek kishte specialitetin psikiatër, tre të tjerë kishin kryer një kurs 1 vjeçar specialiteti, ndërsa dy të tjerë ishin me eksperiencë të ekuivalentuar si specialiste të kësaj fushe.

Në spital ofronin shërbimin e tyre 49 infermiere, 35 kujdestar dhe pjesa tjetër prej 100 personash ishin staf ndihmës administrativ, mirëmbajtje dhe pastrimi.

3) Në zbatim të nenit 28 të Ligjit. Nr.8092 dt.21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor” rezultoi se numri për shtrimet e detyruara që ishin kërkuar në gjykatë gjatë vitit 2007 ishte 18 raste. Por drejtuesit e spitalit nuk kishin kërkuar revokimin e ndonjë mase të shtrimit të detyrueshëm ndaj pacientëve që ndiheshin të përmirësuar.

4. Nga kontrolli u konstatua se numri i personave të abandonuar që nuk kanë kujdestarë nuk ishte i evidentuar nga personeli mjekesor dhe nuk figuronte si e dhënë e veçantë në kartelën e të sëmurit. Për rrjedhojë në asnjë rast drejtuesit e spitalit nuk kishin kërkuar në gjykatë heqjen etributeve të kujdestarit.

5. Kuota ushqimore dietike ditore për pacientet e Spitalit Psikiatrik të Elbasanit ishte e miratuar me një Urdhër të Ministrisë të Shëndetësisë Nr.28 dt.09.02.1998 në shumën 257 lekë/ditë. Kjo normë sipas drejtuesve të spitalit ishte e vjetër dhe nuk i përmbahej nivelit të ri të çmimeve të tregut ushqimor.

6. Kushtet higjieno-sanitare të ambjentëve paraqiteshin të pranueshme dhe ishte vënë dorë në përmirësimin e tyre.

Gjithashtu paraqitet problem mungesa e artikujve të veçantë të higjienës personale të pacienteve femra.

7. Kushtet e gatimit dhe ngrënies ishin përmirësuar ndjeshëm. Dhomat paraqiteshin në kushte normale, por mbetej problem mungesa e dollapeve dhe komodinave.. Në asnjë rast spitali nuk ishte furnizuar me normativën e 6 kompleteve vjetore për veshjet e të sëmurëve.

8. Mjekimi i të sëmurëve shoqërohej me mungesa në ilaçe, të cilat vinin si pasojë e vonësive në kryerjen e shpejtë të procedurave të blerjes së medikamenteve nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Në çdo rast mjekët ankoheshin se nuk furnizoheshin me ilaçet e duhura që kanë efekt të mirë mbi pacientët, por shpesh kishin marrë medikamente që nuk i përshtateshin skemes së tyre të mjekimit. Furnizimi i Janarit të vitit 2007 për ilaçe ishte kryer në Korrik 2007. Mjeket shpesh herë detyroheshin të blejnë me të ardhurat e tyre ilaçe për të sëmurët, për shkak të rrezikut që paraqet për shëndetin e këtyre të fundit mungesa e medikamenteve në raste të veçanta.

Shërbimi stomatologjik ofrohej vetëm për rastet e heqjes së dhëmbëve, pasi për mjekimin e tyre nuk kishte medikamente të tjera të mjaftueshme.

9. Nga kontrolli rezultoi se në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit ishte e punësuar me kohë të plotë një punonjese sociale dhe një psikologe. Numri i tyre ishte i pamjaftueshëm referuar numrit të përgjithshëm të të sëmurëve. Megjithatë drejtuesit

e spitalit kishin kërkuar shtesë organike, ky propozim nuk ishte marre ende në konsideratë.

10. Lidhur me detyrimin ligjor për perfshirjen e të semurve me ç'rregullime mendore në veprimtari punësuese brenda institucionit psikiatrik nga verifikimi yne u konstatua se Spitali Psikiatrik i Elbasanit ofronte në dukje dy mundësi për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor. Së pari, brenda ambjentëve të tij ekzistonte një ambjent për poçeri balte dhe në afërsi të tij ishte ndertuar një serë për mbjellje dhe rritje të ndryshme të bimësisë.

11. Numri i personave të deinstitutionalizuar që nuk kishin nevojë për mjekim gjatë vitit 2007 ishte mjaft i vogël. 10 pacientë ishin të vendosur në një qendër komunitare në Qytetin e Elbasanit, ndërsa planifikohej edhe hapja e një qendre tjetër në Cërrik.

12. Në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit kishin ndodhur brenda vitit 2007, pesë raste të vdekjeve të papritura, të cilat ishin marre në analize të veçante edhe nga ekspertë të dërguar nga Ministria e Shëndetësisë. Këto vdekje sipas versionit zyrtar mjeko-ligjor kishin si shkak ndalimin e funksionit jetësor të zemrës, por për shkak të kundërshtimit të familjarëve nuk ishte kryer autopsi në asnjë rast.

13. Në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit nuk ishin rregjistruar raste të denoncimit të dhunës, përveçse midis pacientëve.

Gjate inspektimit personeli drejtues ngriti një sërë problemesh të cilat ishin:

a. Mos trajtimi i diferencuar i stafit mjeksor me paga, shpërblime dhe moshë pensioni më të ulët për shkak të vështirësisë së punës që ata kryejnë.

b. Mos gjetja e mënyrave të reja për të motivuar mjekët të ardhshëm për të kryer detyrën e psikiatrit, e cila mendohet se do të çojë në një degradim të plotë të këtij shërbimi.

c. Shqetësimi se Spitali Psikiatrik po kthehet në një azil, ku shumica e të shtruarve nuk marrin mjekim, por strehohen vetëm se kanë prapambetje mendore dhe familja nuk i pranon ti rimarre. Numri i tyre varion në 170 vetë. Strategjia për të deinstitutionalizuar këta individë nuk po zbatohet.

II. Spitali Psikiatrik Vlorë

1. Numri i pacientëve gjithsej 215, nga të cilët 70 pacientë akut dhe 145 pacientë kronik. Kapaciteti i mundshëm i shtrimit ishte 240 pacientë.

2. Numri i personelit mjeksor ishte në kuotën e 153 personave, nga të cilët 8 mjekë, 42 infermierë, 27 kujdestar dhe pjesa tjetër ishin staf ndihmes administrativ, mirëmbajtje dhe pastrimi.

3. Numri i rasteve të kërkuara nga Spitali Psikiatrik Vlorë për miratim mase të shtrimit të detyruar në gjykatë ishte gjashtë. Në këtë numër nuk ishin perfshirë persona të tjerë të cilët megjithëse ekzistonin në kushte të tilla, nuk kishin vendime të gjykatës. Në asnjë rast drejtuesit e spitalit nuk kishin kërkuar revokimin e masës së shtrimit të detyrueshem ndaj pacientëve që vleresonin se ishin përmirësuar.

4. Numri i personave të abandonuar që nuk kane kujdestarë ishte i evidentuar nga personeli mjeksor në numrin e përafërt të 40 personave, por kjo e dhënë nuk figuronte në kartelën e të sëmurit si një kërkesë e veçantë informacioni e detyrueshme nga ligji. Në asnjë rast drejtuesit e spitalit nuk kishin kërkuar në gjykatë heqjen etributeve të kujdestarit.

5. Kuotat ushqimore dietike ditore për pacientet e Spitalit Psikiatrik të Vlorës ishte, sipas drejtuesve të spitalit, në kuota minimale por të pranueshme në shumën prej 270 leke në ditë për pacient.

6. Kushtet higjieno-sanitare të ambjenteve paraqiteshin të pranueshme dhe ishte vënë dorë në përmirësimin e tyre. Nuk kishte sistem qëndror ngrohje-ftohje. Gjendja e tualeteve ishte e përmirësuar por nuk kishte standarte të krenaqshme higjene dhe pastertie. Gjithsesi ngelej problem çështja e normativave të dusheve dhe tualeteve për numër pacientësh.

7. Kushtet e gatimit dhe ngrënies ishin të pranueshme. Në çdo pavion ishin krijuar ambjente të veçanta ngrënie. Guzhina ishte në kushte të mira. Dhomat paraqiteshin në kondicione jo normale të mbipopulluara (15m² sip/5krevate) si dhe kishte lagështirë të dukshme. Mbetej problem mungesa e dollapeve, komodinave, ndriçimit dhe shtretërit ishin mjaft të dëmtuar. Mbulesat dhe shtrojet e krevateve nuk ishin të mjaftueshëm dhe shpesh here kishte mungesa.

8. Mjekimi i të sëmurëve shoqërohej me mungesa në ilaçe, të cilat vinin si pasojë e vonësive në kryerjen e shpejtë të procedurave të blerjes së medikamenteve nga ana e Ministrisë së Shëndësisë. Në çdo rast mjeket ankoheshin se nuk furnizoheshin me ilaçet e duhura që kanë efekt të mirë mbi pacientet, por shpesh kishin marrë medikamente që nuk i përshtateshin skemës së tyre të mjekimit. Rast për tu përmendur ka qenë kërkesa e tyre për një medikament të quajtur “parkopan” në eliminimin e efekteve anësore të ilaçeve të tjera, i cili ka qenë në listën e ilaçeve që rimbushen nga skema, por që kishte gjëndje.

Sherbimi stomatologjik ofrohej vetëm për rastet e heqjes së dhëmbëve, pasi për mjekimin e tyre nuk kishte medikamente të mjaftueshme kurimi.

9. Në Spitalin Psikiatrik të Vlorës ishin punësuar me kohë të plotë dy punonjëse sociale dhe dy psikologë. Numri i tyre ishte i pamjaftueshëm referuar numrit të përgjithshëm të të sëmurëve.

10. Nga kontrolli rezultoi se Spitali Psikiatrik i Vlorës nuk ofronte asnjë mundësi për përmbushjen e detyrimit ligjor për ri-integrim. Brenda ambjenteve të tij nuk ekzistonte ndonjë mjedis tjetër për t'u marrë me punë artizanale, sport apo veprimtari të tjera rehabilitimi.

11. Spitali Psikiatrik Vlore nuk kishte deinstitutionalizuar asnjë paciente, por sipas mjekëve ishin në pritje dhe të gatshëm të largoheshin një numër prej 16 pacientësh.

12. Në Spitalin Psikiatrik të Vlorës nuk kishin ndodhur brenda vitit 2007 raste të vdekjeve të papritura ose të ushtrimit të dhunës. Ndërkohë që ekzistonte një komision konsultativ i psikiatrisë që shqyrtonte rastet e mundshme të dhunës dhe merrte masa ndaj personelit.

13. Në Spitalin Psikiatrik të Vlorës nuk disponoheshin mjete shtrënguese çmobilizimi për të sëmurët, si këmisha force, krevate fiksuese etj. Në shume raste mungesa e tyre ishte bërë burim rreziku i shtuar për pacientët e tjerë dhe vetë personelin mjeksor.

14. Spitali Psikiatrik i Vlores nuk ishte vizituar nga të dërguar të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2007. Në asnjë rast nuk ishin kryer inspektime të detajuara, dhe nuk ishin lënë detyra konkrete për kushtet dhe masat e tjera në dobi të pacientëve.

15. Si komente të tjera që morëm nga vete personeli drejtues dhe stafi ndihmes gjatë këtij inspektimi ishin:

a. Raporti i numrit të mjekëve, personelit ndihmës dhe pacienteve ishte shume i zhdrejtë.

b. Personeli mjeksor ndihej i rrezikuar nga sjellja e pacienteve në kriza akute, sepse nuk dispononin mjete mbrojtëse efikase.

c. Shqetësimin se Spitali Psikiatrik po kthehet në një azil ku shumica e të shtruarve nuk merrnin mjekim, por strehoheshin vetëm se kanë prapambetje mendore dhe familja nuk pranonte t'i rimerrte.

d. Niveli arsimor i kujdestarëve është shumë i ulët dhe ndikon negativisht në trajtimin e të sëmurëve.

III. Spitali Psikiatrik Shkodër

1. Numri i pacientëve gjithsej 70, nga të cilët 20 pacientë akut dhe 50 paciente kronik. Kapaciteti i mundshëm i shtrimit ishte 80 vende.

2. Numri i personelit mjekësor ishte në kuotën e rreth 30 personave, nga të cilët 3 mjekë, 10 infermiere, 10 kujdestar dhe pjesa tjetër ishin staf ndihmes administrativ, mirembajtje dhe pastrimi.

3. Nga inspektimi rezultoi se Spitali Psikiatrik Shkodër në asnjë rast nuk kishte kërkuar në gjykatë miratimin e masës së shtrimit të detyruar.

4. Nga kontrolli u konstatua se numri i personave të abandonuar që nuk kishin kujdestarë ishte i evidentuar nga personeli mjekësor në rreth 80% të pacienteve, por kjo e dhënë nuk figuronte në kartelën e të sëmurit. Në asnjë rast drejtuesit e spitalit nuk kishin kërkuar në gjykatë heqjen e atributëve të kujdestarit.

5. Kuotat ushqimore dietike ditore për pacientët e Spitalit Psikiatrik të Shkodrës ishte sipas drejtuesve të spitalit në kuota minimale. Gjithsesi referuar çmimeve të tregut nga ana e tyre ndihej e nevojshme që ajo të ngrihej sa më shpejt pasi ishte e pamjaftueshme.

6. Kushtet higjieno-sanitare të ambjentëve paraqiteshin të papranueshme dhe nuk ishte vënë dorë në përmirësimin e tyre. Nuk kishte sistem qëndror ngrohje-ftohje. Gjendja e tualeteve ishte e dobët. Ngelej problem çështja e dusheve pasi ato nuk mund të mbulonin asnjëherë nevojat e pacienteve.

Gjithashtu paraqitej problem mungesa e artikujve të veçantë të higjienës personale të pacienteve femra.

7. Kushtet e gatimit dhe ngrënies nuk ishin normale. Në çdo dhomë ishin krijuar ambjente të veçanta ngrënie, krahas një mence që ekzistonte në çdo pavion, por gjendja e tyre ishte mjaft e keqe. Dhomat paraqiteshin në kushte jo normale dhe mbetej problem mungesa e dollapeve, komodinave, ndriçimit dhe shtretërimit ishin mjaft të dëmtuar. Mbulesat dhe shtrojet e krevateve nuk ishin të mjaftueshme dhe shpesh herë kishte mungesa. Përgjithësisht godina e këtij shërbimi paraqitej tepër e amortizuar dhe e dëmtuar.

8. Mjekimi i të sëmurëve shoqërohej me mungesa në ilaçe, të cilat vinin si pasojë e vonësive në kryerjen e procedurave të blerjes së medikamenteve nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Në çdo rast mjekët ankoheshin se nuk furnizoheshin me ilaçet e duhura që kanë efekt të mirë mbi pacientet, por shpesh kishin marrë medikamente që nuk i përshtaten mjekimit.

Shërbimi stomatologjik ofrohej vetëm për rastet e heqjes së dhëmbëve, pasi për mjekimin e tyre nuk kishte medikamente të mjaftueshme.

9. Në Spitalin Psikiatrik të Shkodrës nuk kishte të punësuar me kohe të plotë apo të pjesshëm ndonjë punonjës social apo psikolog.

10. Nga verifikimi i bërë u konstatua se Spitali Psikiatrik i Shkodrës nuk ofronte asnjë mundësi për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor. Brenda ambjentëve të tij ekzistonte një mjedis për t'u marrë me punë artizanale dhe veprimtari të tjera rehabilitimi, por ai nuk ishte i mjaftueshëm dhe nuk vihej në shfrytëzim.

11. Spitali Psikiatrik Shkodër nuk kishte deinstitutionalizuar asnjë pacient dhe nuk ishte krijuar në asnjë rast mundësia dhe kushtet për të realizuar diçka të tillë.

12. Në Spitalin Psikiatrik të Shkodrës kishte ndodhur vetëm një rast vdekje e papritur brenda vitit 2007 për të cilën me insistim të mjekëve ishte bërë autopsi, nga ku rezultoi se pacientja kishte vdekur nga shkaqe natyrale.

13. Në Spitalin Psikiatrik të Shkodrës nuk ishin rregjistruar raste të denoncimit të dhunës. Spitali nuk dispononte mjete shtrënguese çmobilizimi për të sëmuret si kemisha force, krevate fiksuese, por vetëm një dhomë izolimi në kushte aspak të pranueshme dhe tepër të rrezikshme. Në disa raste hyrja në dhomën e izolimit ishte shoqëruar me plagosje të personelit mjekësor për shkak të mungesës së masave të sigurisë brenda këtyre ambjentëve.

14. Spitali Psikiatrik i Shkodrës nuk ishte vizituar nga të dërguar të Ministrisë së Shëndetësisë. Në asnjë rast nuk ishin kryer inspektime të detajuara, dhe nuk ishin lënë detyra konkrete për kushtet dhe masat e tjera në dobi të pacientëve.

15. Si komente të tjera që morëm nga vetë personeli drejtues dhe stafi ndihmës gjatë këtij inspektimi ishin:

a. Spitali Psikiatrik ka nevojë që të ndihmohet për të nxjerrë jashtë ambienteve të tij rreth 80% të pacientëve që rrinë në kushte azili dhe që nuk marrin mjekim.

b. Personeli mjekësor duhet të ndihmohet me organikë shtesë pasi numri aktual i punonjësve për pacientë ishte tepër i ulët. (3 infermierë në turn/40 të sëmurë).

c. Duhet vënë dorë me investime, pasi kushtet ishin shumë të papranueshme për të mjekuar dhe rehabilituar të sëmurë mendore.

B. Problematikat e ngritura organeve qendrore, përgjegjëse për rregullimin e gjendjes

Problematika e trajtuar me lart në shumë aspekte paraqitet e njëjtë për spitalet e inspektuara. Kjo do të thotë se në tërësinë e tij shëndeti mendor po përballet me vështirësi të mëdha që në shumë raste i faturohen neglizhencës së organeve shtetërore kompetente.

1. Funkcioni kryesor i Spitaleve Psikiatrike dhe i shërbimit mjekësor ndihmës është rehabilitimi dhe përmirësimi i gjendjes së të sëmurit mendor. Ky është edhe qëllimi që jepet si kusht parësor për zbatim në Ligjin “Për Shëndetin Mendor”. Nga të dhënat dhe gjendja e konstatuar në të tre objektet e inspektuara, rezultoi se kushtet dhe trajtimi i të sëmurëve jo vetëm që lë shumë për të dëshiruar dhe nuk premtan përmirësimin e shëndetit të tyre, por në shume raste ai ndikon në përkeqsimin e tij.

2. Ligji Nr.8092 dt.21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor” vazhdon të mbetet një akt i pazbatueshëm në shumë dispozita të tij nga personeli mjekësor. Krahas trajnimit dhe direktivave të vazhdueshëm që Ministria e Shëndetësisë duhet të japë për zbatimin e tij, detyrë e rëndësishme mbetet ndryshimi, amendimi dhe nxjerrja e akteve të reja nënligjore për implementimin e tij praktik. Megjithëse Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me OBSH-në kreu gjatë vitit 2006 një workshop për këtë qëllim, rezultatet e tij nuk janë marrë ende në konsideratë për zhvillime të mëtejshme.

3. Një mungesë në kuadër të akteve nënligjore mbetet rregullorja e re për kushtet e trajtimit të të sëmurëve mendore, ku të parashikohen normativat e reja të siperfaqeve për metër katror të hospitalimit të tyre, dushe dhe tualete për frymë, raport mjek/infermier/kujdestar-pacient etj, cilësia dhe sasia kalorike e ushqimit,

norma të reja për veshje dhe shtroje, përlllogaritje e re e kostos së të sëmurit, diferencimi i shpenzimeve për nevojat e pacienteve femra etj.

4. Kërkimi i miratimit të masave të shtrimit të detyruar në gjykatë dhe heqja e të drejtës së kujdestarise mbeten dy momente të paqarta dhe të pazbatuara siç duhet nga personeli mjeksor. Avokati i Popullit mendon se këto masa duhet të jenë pjesë e një procesi të dhënash dhe procedurash të parashikuara në rregulloret përkatse, pasi nga praktika rezulton se personeli mjeksor është i paqartë në zbatimin e tyre. Në asnjë rast shtrimi i detyruar nuk duhet të kryhet vetëm për personat me rrezikshmëri, por për të gjithë ata pacientë që nuk pranojnë vendimin për shtrim. Nuk duhet harruar kjo procedurë ligjore dhe duhet zbatuar me përpikmeri, sepse në të kundërt personelit mjeksor i duhet të perballtet me akuzën për veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë etj.

5. Kuotat ushqimore të të sëmurëve vijnë në mbeten në nivele minimale dhe nuk janë rishikuar në përputhje me çmimet e reja të tregut ushqimor. Për këtë qëllim kjo çështje duhet analizuar dhe zgjidhur sa më shpejt për të përmiresuar ushqimin dhe llojshmerinë e tij në dobi të pacienteve.

6. Përveç ndërhyrjeve me investime që po kryeshin në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit, në dy spitalet e tjera gjendja e përgjithshme e ambjenteve dhe kushteve të brendshme ishte shumë e amortizuar. Lavanderia, guzhina, mencent, dhomat e shtrimit, krevatet etj ishin të vjetëruar dhe tejet të demtuar. Avokati i Popullit është koshient për koston financiare që ka përmiresimi i këtyre kushteve, por të pakten kjo situatë duhet evidentuar dhe planifikuar në planet e ardhshme të investimeve buxhetore ose me anë të donatoreve vendas dhe të huaj.

7. Mjekimi dhe ilaçet për të sëmuret kishin mangësi të dukshme si në cilësi, larmi ashtu dhe në furnizim. Mjekët në mjaft raste u ankuan se procedurat e tejzgjatura të tenderimit dhe blerjes së ilaçeve nga Ministria e Shëndetësisë kanë shkaktuar probleme serioze në shëndetin dhe trajtimin me mjekim të të sëmurëve. Krahas kësaj në mjaft raste të tjera porositet për ilaçe specifike nuk merren në konsideratë, megjithëse ato janë më të lira dhe kanë efekt më të mirë se sa ato që vijnë nga furnizimi. Në këto kushte lind nevoja që procedurat e blerjes së ilaçeve të gjejnë formë të shpejta nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, aq më shumë kur flitet për medikamente të caktuara specifike, mungesa e të cilave çon në degradim të pashmangshëm të shëndetit të të sëmurëve mendore. Kjo gjendje duhet përmirësuar edhe në shërbimin stomatologjik të këtyre spitaleve, duke i furnizuar ato me medikamente mjekimi dhe jo vetëm me mjete për heqjen e dhëmbëve.

8. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta ende nuk ka filluar të koordinojë siç duhet punën për vënien në zbatim të detyrimeve ligjore për caktimin në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të punonjësve social. Gjithashtu spitalet kanë mungesa të theksuara edhe në specialitetin e psikologut.

Gjithsesi Avokati i Popullit nuk është në dijeni të ndonjë strategjie në fushën e shëndetit mendor për të përthithur staf të ri mjeksor dhe të kualifikuar në këtë fushë, nisur nga nevojat që ka shërbimi psikiatrik dhe interesi i ulet që tregohet nga mjekët e rinj për punësimin në këtë shërbim.

9. Megjithëse ka një platformë kombëtare për mënyrën e deinstitutionalizimit të të sëmurëve, Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Spitalet Psikiatrike nuk janë përpjekur seriozisht për të arritur një objektiv të tillë. Spitalet Psikiatrike në shumicën e tyre, shfrytëzohen në masën 70% për shërbimin azil dhe hotelerik. Kjo pasi familjarët apo kujdestarët nuk pranojnë të rimarrin në shtëpi personat tashmë të abandonuar. Gjithashtu numri i vendosur në qendrat komunitare vijon të mbetet në shifra të ulta në raport me nevojat e të sëmurëve.

10. Ambjentet e ushtrimit të veprimtarive çlodhëse, argëtuese, sportive, rehabilituese nëpërmjet punës etj, janë inekzistente ose janë të pranishëm vetëm për efekte optike të përmbushjes së standarteve të kërkuara, por që faktikisht janë të pashfrytëzueshme. Në këto ambjente nga inspektimi i kryer rezultoi se nuk kishte të përfshirë në trajtim asnjë pacient dhe nuk ishin marrë masat minimale për blerje mjetesh ndihmëse për vënien në funksionim të tyre. Në këto kushte Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me spitalet respektive duhet të krijojne një fond të veçantë për krijimin e kushteve të reja me efektivitet të plotë.

11. Rastet e vdekjeve të papitura dhe dhunës në këto spitale nuk janë parë në kuadrin e një standartizimi për trajtimin e tyre ligjor. Përveçse ekziston Urdhëri i Mjekut është e nevojshme që në çdo Spital Psikiatrik të jetë i ngritur një komision keshillimor që të marrë në analize dhe të japë verdiktet e tij për rastet e dhunës. Në shtimin e këtyre rasteve Avokati i Popullit mendon se mund të ndikojë edhe niveli i ulet arsimor dhe profesional i kujdestarëve ndaj dhe Ministrisë së Shëndetësisë i del si detyrë rishikimi i termave ekzistues për pranimin në këtë detyrë.

Nga inspektimi rezultoi se personeli mjeksor ishte mjaft i rrezikuar nga pacientet pasi nuk ekzitonin mjete efikase mjeksore dhe teknike për çmobilizimin e tyre në rast krizash akute psikike.

Krahas kësaj për çdo vdekje të papitur nuk duhet hezituuar nga ana e mjekëve të kryhet autopsia dhe çdo ngjarje e tillë nuk mund të kalojë vetëm me një analizë me inspektorët e Ministrisë së Shëndetësisë.

Në këtë kuadër Avokati i Popullit mendon se duhet të vihen në zbatim edhe dispozitat e Ligjit Nr. 7830, datë 15.6.1994 “ *Për Autopsitë*”, i cili në rastet e vdekjeve brenda ambienteve spitalore kërkon vendimin e shefit të klinikes për kryerjen e autopsisë edhe pse mund të hasen kundërshtime nga familjarët.

12. Avokati i Popullit vëren se megjithë interesimin e Ministrisë së Shëndetësisë për këtë shërbim konstatohen vizita të pakta dhe në asnjë rast inspektime të mirëfillta të saj. Kjo është justifikuar deri diku me informacionin që shkembetet midis ministrisë dhe spitaleve për qëllime të ndryshme, por që gjithsesi kjo praktike pune ngelet larg nevojës së një kontrolli sistematik dhe të plotë në kushte terreni.

13. Një çështje tjetër, e cila kërkon një trajtim më vete, mbetet trajtimi i diferencuar i personelit mjeksor të shërbimit të psikiatrisë. Duke parë kushtet e vështira, problematikën e pacientëve dhe intensitetin e lartë të punës që zhvillohet me ta, vlen që kjo kategori mjekesh dhe stafi mjeksor të trajtohet në mënyrë të veçantë si nga paga, orët e punës, shpërblimet, mosha e daljes në pension etj.

Avokati i Popullit gjykon se ndërmarrja e një iniciativë të tillë do të rriste edhe interesin e mjekëve të rinj për të ofruar kontributin e tyre në këtë shërbim, pa të cilin ky i fundit do të pësojë një degradim të shpejtë në të ardhmen.

Kryerja e inspektivëve nuk ka për qëllim të nxjerrë vetëm të metat dhe mangësitë e këtij shërbimi, por dhe t'i paraprije me këshilla dhe sugjerime një plani afatshkurtër dhe afatmesëm ndërhyrje në Spitalet Psikiatrike.

Institucioni i Avokatit të Popullit mendon se kushtet aktuale dhe problematika e konstatuar vazhdojnë të rëndojnë mbi të drejtat dhe interesat e ligjshme të pacientëve të sëmurë, duke mos ju dhënë atyre shpresë për një trajtim më të mirë dhe për një rehabilitim të shpejtë.

Lënia pas dore e një situatë të tillë do të çojë në një tjetër gjendje akoma më të rëndë nga e cila nuk do të dilet thjesht me projekte sporadike. Shëndeti mendor në Shqipëri duhet rimodeluar dhe përshtatur konform nevojave të reja që në plan të parë të tyre nuk lejojnë degradim të mëtejshëm të pacientit, rishoqërizojnë atë në

komunitet, e mjekojnë atë me ilaçe dhe skema bashkëkohore dhe i japin atij mundësinë të ndihet si çdo njeri tjetër.

Për sa më sipër, i jemi drejtuar Ministrit të Shëndetësisë Zotit Nard Ndoka, dhe Ministrit të Punëve Çështjeve Sociale dhe hanseve të arabarta me rekomandime për marrjen e masave ligjore, organizative dhe buxhetore për përmirësimin e shërbimit shëndetësor psikiatrik në shkallë vendi, duke e standartizuar atë me kushte të pranueshme dhe ligjore. Gjithashtu për këto probleme të konstatuara, nga ana jonë është vënë në dijeni dhe Kryeministri, Zoti Sali Berisha.

C. Në vazhdim të inspektimeve të realizuara gjatë vitit 2007 është kryer dhe inspektimi në Spitalin e Burgut, pranë Qendrës Spitalore “Nënë Tereza” Tiranë. Gjatë këtij inspektimi është konstatuar si vijon:

Te sëmurët mendorë vijojnë të mbahen në Spitalin e Burgut Tiranë në kundërshtim me dispozitat ligjore që parashikon Ligji Nr.8092 dt.21.03.1996, “Për Shëndetin Mendor” dhe Ligji Nr. 8331 dt. 21.04.1998, “Për Ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore me Mjekim të Detyruar”.

Konkretisht në Nenin 45 të ligjit Nr. 8331 dt. 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore me Mjekim të Detyruar”, thuhet se: “Masa mjeksore me mjekim të detyruar ekzekutohet në Institucionin mjeksor të specializuar sipas percaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë mbi kërkesën e Prokurorit”.

Ndërsa në Nenin 42 të ligjit Nr.8092 dt. 03.02.1996, “Për Shëndetin Mendor”, është parashikuar midis të tjerash se:

“Masat e sigurimit për personat e përmendur në nenin 41 merren nga organet e ngarkuara për ruajtjen e tyre, sipas Rregullores së miratuar nga Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shëndetësisë”.

Avokati i Popullit e ka ngritur disa herë problemin e mos zbatimit të dispozitave të mësipërme ligjore, të cilat vazhdojnë të shkatëjnë mbajtjen pa të drejtë të të sëmurëve mendorë në Spitalin e Burgut, ndërkohë që ata duhet të përfitonin prej kohësh një shërbim të specializuar mjeksor pranë Spitaleve Civile.

Problemi i mësipërm ngelet shkelja më e rëndë e kryer ndaj kësaj kategorie personash.

Pavarësisht kësaj, në situatën aktuale kemi vëzhguar nga afër kushtet dhe trajtimin e këtyre personave, dhe prezantojmë të dhënat e mbledhura si vijon:

1. Numri i pacienteve të shtruar me mjekim të detyruar ishte 77, ndërkohë që 10 të dënuar me burg mjekoheshin për sëmundje mendore të shfaqura gjatë vuajtjes së dënimit. Krahas tyre kishte të shtruar edhe 51 persona për sëmundje të tjera, por që në disa raste kishte prej tyre që kishin shfaqur çrregullime mendore. Situata, sipas vetë stafit mjeksor paraqitej e mbipopulluar dhe nuk kishte vende të tjera për të mundësuar shtrime të reja. Stafi mjeksor përbëhej nga 6 mjek, 16 infermierë, 1 punonjës social dhe 1 psikolog. Nga këta vetëm një mjek rezultonte të ishte i specializuar si psikiatër.

2. Në nenin 2 të Ligjit. Nr.8092 dt.21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor” parashikohet se: “Mbrojtja e shëndetit mendor realizohet nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor dhe të një mjedisi social të pershtatshëm për të sëmurët mendore, si dhe nepermjet ndjekjes së një politike parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor”.

Kushtet higjieno-sanitare të ambjenteve paraqiteshin përgjithësisht të pranueshme. Gjendja e tualeteve ishte në kushte jo të mira, pasi kishte probleme të lagështirës dhe aksesoreve të vjetëruar. Ngelej problem çështja e kapaciteteve të vogla të dusheve dhe tualeteve për numër pacientësh. (Raporti 30 vetë /1 dush/1

tualet). Gjatë inspektimit u konstatua se uji ishte i garantuar, por ai nuk vihej në përdorim në mënyrë të mjaftueshme për shkak të mos funksionimit të disa prej pajisjeve hidraulike.

Kushtet e gatimit dhe ngrënies ishin të sistemuara nëpër dhoma dhe nuk kishte ambjent të përbashkët ngrënie. Dhomat paraqiteshin në kushte jo normale populimi. Nëpër korridore sistemi elektrik i ndriçimit ishte i dëmtuar, çka mund të shkaktonte në ndonjë rast mundësinë e vetvrasjes nga pacientët. Mbetej problem mungesa e dollapeve, komodinave dhe shtrojeve të krevateve. Ne asnjë rast spitali nuk ishte furnizuar me normativat vjetore për veshjet e të sëmurëve. Në shumë raste pacientët furnizoheshin me veshje nga familjarët e tyre dhe në disa raste nga vetë pjestarët e stafit mjeksor.

3. Mjekimi i të sëmurëve shoqërohej me mungesa në ilaçe, të cilat vinin si pasojë e vonësive në kryerjen e shpejtë të procedurave të blerjes së medikamenteve nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Në çdo rast mjekët ankoheshin se nuk furnizoheshin në kohë me ilaçet e duhura që kanë efekt të mirë mbi pacientët.

Shërbimi stomatologjik nuk ofrohej në spital dhe nuk ishte i parashikuar në organikë një mjek i veçantë për këtë qëllim. Mjekimi i dhëmbëve nuk kryhej, por të sëmurit i orfohej asistencë stomatologjike nga qendra të tjera mjeksore vetëm në rastet e heqjes së tyre.

4. Në nenin 8 të Ligjit. Nr.8092 dt.21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor” është parashikuar se: “Në të gjitha institucionet psikiatrike, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale cakton punonjes sociale, te cilet mbikqyrin trajtimin e pacienteve nga pikepamja sociale dhe mbrojtjes se te drejtave te tyre”.

Nga kontrolli rezultoi se në Spitalin e Burgut Tiranë ishte e punësuar me kohë të plotë një punonjëse sociale dhe një psikologe. Numri i tyre ishte i pamjaftueshëm referuar numrit të përgjithshëm të të sëmurëve. Pavarësisht kësaj nga inspektimi rezultoi se puna e tyre nuk ishte e evidentuar në kartela të veçanta që të mundësonte ndjekjen dinamike të zhvillimit psikosocial të të sëmurit.

5. Nga kontrolli u konstatua se numri i personave të abandonuar që nuk kishin kujdestarë nuk ishte i evidentuar nga personeli mjeksor dhe nuk figuronte si e dhënë e veçantë në kartelën e të sëmurit. Për rrjedhojë në asnjë rast drejtuesit e Spitalit të Burgut nuk kishin kërkuar në gjykatë heqjen e attributeve të kujdestarit.

6. Në nenin 14 të Ligjit. Nr.8092 dt.21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor” midis të tjerash është parashikuar se: “Perfshirja e të sëmurëve me çrregullime mendore në veprimtari punësuese brenda institucionit psikiatrik ka karakter vullnetar, mjekues dhe rehabilitues, si dhe lehtëson riintegrimin e pacienteve në jetën e shoqërisë”.

Nga verifikimi ynë u konstatua se Spitali i Burgut Tiranë nuk ofronte mundësi të pranueshme për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor. Brenda ambjenteve të tij ekzistonte vetëm një dhomë argëtimi me dy tavolina për lojra “Tavlle dhe Shahu” dhe një televizor. Aktivitete të tjera fizike, sportive dhe rehabilituese nuk ofroheshin.

7. Në Spitalin Burgut Tiranë nuk ishin rregjistruar raste të denoncimit të dhunës, përveçse midis pacientëve. Në disa aspekte të veçanta kjo dhune ishte e vështirë të verifikohet për shkak të papërgjegjshmërisë së pacienteve dhe vetëdëmtimeve që ata i shkaktonin trupit. Spitali nuk dispononte mjete shtrënguese çmobilizimi për të sëmurët si këmisha force, krevate fiksues etj. Në shumë raste mungesa e tyre ishte bërë burim rreziku i shtuar për pacientë të tjerë dhe vete personelin mjeksor.

8. Spitali i Burgut Tirane nuk ishte vizituar nga të dërguar apo inspektorë të Ministrisë së Shëndetësisë. Nga komente të tjera që morëm nga vetë personeli drejtues dhe stafi ndihmës gjatë këtij inspektimi mund të përmendim mos trajtimin e diferencuar të stafit mjeksor me paga, shpërblime dhe moshë pensioni më të ulët për shkak të vështirësisë së punës që ata kryejnë. Krahas kësaj një problem ngelej trajtimi i të sëmurëve kronikë mendorë, shumica e të cilëve nuk kishin nevojë për mjekim, por strehoheshin vetëm se institucionet e vuajtjes së dënimit nuk pranojnë t'i rimarrin.

Sipas të dhënave rezulton se Spitali i Burgut Tiranë ka vetëm funksion kurues me ilaçe dhe jo diagnostikues ndaj pacientëve.

Ky spital ka veçoritë e një burgu të mirëfilltë dhe nuk përmbush standartet minimale si shërbim spitalor. Në këtë spital nuk ka dhomë reanimacioni, radiografie etj. Në të gjitha rastet e vizitave, të sëmurët me shoqërim të mjekut të burgut transferohen pranë shërbimeve të tjera spitalore civile. Në këto raste mjekët e shërbimeve hezitojnë për të vizituar këta të sëmurë, duke i denigruar ata me qëndrimin e tyre dhe duke i lënë për një kohë të gjatë në pritje.

Në disa raste vetëm me ndërhyrjen e mjekëve të Spitalit të Burgut është bërë e mundur trajtimi i tyre i shpejtë dhe korrekt. Për këtë problem, megjithëse ka patur një marrëveshje të veçantë midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë për trajtimin e të sëmurëve të dënuar, në praktikë janë denoncuar jo pak shkelje të trajtimit poshtërues të tyre nga stafet mjeksore spitalore.

Lidhur me sa me sipër, ne kemi rekomanduar se krahas masave disiplinore që duhet të merren nga Ministria e Shëndetësisë dhe Urdhëri i Mjekut për denoncime të kësaj natyre, ndihet e nevojshme që marrëveshja e mësipërme të rishikohet dhe ripërtërihet në frymën e një bashkëpunimi më efikas për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve të dënuar.

Si perfundim Avokati i Popullit konstatoi se kushtet aktuale dhe problematika e konstatuar vazhdojnë të rëndojnë mbi të drejtat dhe interesat e ligjshme të këtyre pacientëve, duke mos ju dhënë atyre shpresë për një trajtim të barabartë mjeksor dhe efikas.

Për sa më sipër, i jemi drejtuar Ministrit të Shëndetësisë, Ministrit të Drejtësisë, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve Drejtorit të Spitalit të Burgut me rekomandim për marrjen e masave për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të të dënuarve të sëmurë mendorë në Spitalin e Burgut Tiranë si dhe kryerjen e një analize të gjithanshme, duke shfrytëzuar të dhënat e paraqitura në këtë rekomandim për të përmirësuar sa më parë ato aspekte që kanë nevojë emergjente për ndërhyrje.

Gjithashtu për këto probleme të konstatuara, nga ana jonë është vënë në dijeni dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Ne pergjigje te ketij Rekomandimi ka reaguar Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve, e cila pavaresisht se e shikon zgjidhjen perfundimtare te problemeve te konstatuara me sipër ne ndertimin e nje spitali te posacem per te semuret me mjekim te detyruar, na ka informuar se ka marre nje sere masash ne permiresimin e situates se konstatuar me sipër. Permiresimet kane qene ne drejtim te kushteve higjeno-sanitare, ne trajtimin e te semureve me medikamente, te diagnostikimit te tyre, dhe te trajtimit stomatologjik. Ne te njejten kohe jemi informuar se tashme emerimi i nje juristi pikerisht ne Qendren Spitalore te Burgjeve do te beje te mundur eliminimin e mosveprimeve te konstatuara gjate inspektimit.

D. Gjate vitit 2006 Institucionit të Avokatit të Popullit ka trajtuar një sere ankesash nga grupe individësh, kryesisht pensionistë, të cilët kanë shfaqur pakënaqësi, duke kundërshtuar pagesën që kryejnë pranë farmacive, ku u duhet të tërheqin barna me rimbursim.

Avokati i Popullit pasi analizoi në tërësi kuadrin ligjor të fushës së sigurimit shëndetësor, konkludoi se praktika financiare që ishte ndjekur mbi pacientët e siguruar ishte në kundërshtim me të drejtat dhe interesat e tyre ekonomike. Për sa më sipër dolem me rekomandim drejtuar Kryeministrit Zotit Sali Berisha, Ministrit të Financave Zotit Ridvan Bode, dhe Ministrit të Shëndetësisë Zotit Maksim Cikuli, duke argumentuar se:

“Konkretisht administrata shëndetësore që merret me kujdesin ndaj pacientëve, vizitat e tyre dhe dhënien e mjekimit me anë të recetave përkatëse, kryen me këtë rast një shërbim publik, i cili është falas. Ky shërbim sipas skemës së sigurimit shëndetësor mbulohet pjesërisht nga kontributi i të sigurve dhe pjesërisht nga kontributi i shtetit. Në këtë rast pagesa e një tarife për recetën e rimbursueshme e vë pacientin sigurve në pozita aspak favorizuese, pasi atij përveç kontributit që derdh për sigurimet shëndetësore, i duhet të paguajë sërish për recetën që i lëshohet nga mjeku. Nga kjo rrjedhimisht konstatohet se pacientit të sigurve i duhet të paguajë dy herë për të njëjtin shërbim, pavarësisht nga shuma e vogel.

Pavarësisht se kostoja e recetës së rimbursueshme është një çeshtje sigurie dhe kërkonte administrimin sa më efektiv të sigurimit dhe kujdesit shëndetësor, kemi konstatuar se nuk është reale dhe nuk justifikohet aspak me elementët shtesë që i janë vendosur asaj. Megjithatë ajo nuk mund t'i faturohet pacientit të sigurve për atë kohë sa kjo tarifë nuk shkon në përfitim të tij, por në të ardhurat e administratës shtetërore.

Referuar sa më lart, Avokati i Popullit, duke përcjellë me këtë rast shqetësimin e drejtë të pensionistëve, si shtresa më e prekur, e cila përfiton të ardhura të pakta, ka përcaktuar qëndrimin e tij zyrtar, sipas të cilit tarifa e parashikuar për recetat e rimbursueshme duhet shfuqizuar.

Në përgjigje të interesimit dhe nderhyrjeve tona të vazhdueshme për çështjen e mësipërme, kjo tashme rezulton e zgjidhur, pasi me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.727 date 30.10.2007, është vendosur të përjashtohen nga pagesa e kësaj tarife të sigurve, që me ligj ose akt nënligjor të veçantë, përfitojnë mjekim me barna falas. Kjo zgjidhje për mendimin tonë rezulton e pjeseshme pasi qellimi i Rekomandimit tonë ka qenë heqja e tarifës së recetës së rimbursueshme për të gjitha subjektet dhe jo për një pjesë të tyre.

13. Ministria e Puneve të Jashtme

Gjate vitit 2007 ka patur dhe janë shqyrtuar 28 ankesa dhe kërkesa për Ministrinë e Puneve të Jashtme, Ambasadat dhe Konsullatat e Republikës së Shqipërisë.

Duke i analizuar, ka rezultuar se 8 ankesa kanë qenë jashtë juridiksionit të Zyres së Avokatit të Popullit, 12 ankesa janë dërguar për kompetencë Drejtorisë Konsullore të Ministrisë së Puneve të Jashtme dhe Ambasadave, 2 ankesa kanë rezultuar të pabazuara, 3 ankesa janë zgjidhur në favor të kërkuarit dhe 2 ankesa janë ende në shqyrtim.

Disa prej ankesave, kane te bejne me pretendime te ndryshme te qytetareve shqiptare kunder perfaqesive diplomatike te vendeve te huaja te akredituara ne Shqiperi, prandaj ato cilesohen jashte juridiksionit tone.

Ne perfundim te shqyrtimit te ankesave, duke patur parasysh specifiken e tyre, ankuesve u eshte dhene ndihmesa dhe konsulenca e nevojshme ligjore dhe ne raste te tjera praktikate i jane kaluar per kompetence Drejtorise Konsullore te Ministrise se Puneve te Jashtme.

Nder ankesat e mara ne shqyrtim nga Zyra e Avokatit te Popullit, permendim:

1. Ankesen e shtetasit N.B nga qyteti i Durresit, i cili gjate sekuestrimit te anijes greke (Orestes) ne Itali me vendim gjyqesor te autoriteteve kompetente, u detyrua te mbetet per nje kohe te gjate ne ruajtje te anijes. Ky qendrim ne anije i shkaktoi shtetasit ne fjale, demtime serioze shendetesore (semundje veshkash). Ishte nje rast ky i bere publik edhe ne mediat Italiane.

Interesimi efektiv i Zyres se Avokatit te Popullit dhe bashkepunimi me strukturat e Ministrise se Puneve te Jashtme te Republikes se Shqiperise, beri te mundur kurimin e shtetasit te permendur ne Itali. Gjithashtu atij ju dha konsulence ligjore per te kerkuar kompensim ne vlere monetare per demin e shkaktuar, por perseri ai eshte ankuar kunder Konsullates Shqiptare ne Bari per ndihme te pamjaftueshme.

2. Ankesen e paraqitur nga shtetesja P.M, qe lidhej me pengesat e nxjerra per te marre nje dokument nga Drejtoria e Arkiv-Dokumentacionit te Ministrise se Puneve te Jashtme, ku dokumentohej se burri i saj ishte vrare ne tentative per te kaluar kufirin e Shtetit Kroat.

Institucioni yne, duke bashkepunuar me Drejtorine e Arkiv-Dokumentacionit te Ministrise se Puneve te Jashtme, e zgjidhi kete problem dhe i vuri ne dispozicion ankueses dokumentin per t'a perdorur per nevojat e saj.

3. Ankesen e shtetasit R.D, qe lidhej me zvarritjen e procedurave te kthimit te trupit te nipit te tij te vrare ne Spanje. Nepermjet bashkepunimit efektiv me Ministrine e Puneve te Jashtme, u realizua pershpejtimi i ardhjes se trupit prane familjes.

4. Ankesen e 6 ish punonjesve te Ambasades se Republikes se Shqiperise ne Beograd, te cilet u larguan nga ambasada per shkak te fillimit te bombardimeve dhe nderprerjes se marredhenieve diplomatike midis dy vendeve ne daten 5 prill 1999.

Urdheri i drejtuesve te MPJ-se te asaj kohe per largimin e personelit nga ambasada jone ne Beograd u be me vonese. Per rrjedhoje, duke pare perkeqesimin e situates, ata (personeli i ambasades) u detyruan te largohen pa marre sendet e paisjet e tyre personale. Dihet tashme zyrtarisht, se me vone ambasada jone ne Beograd u sulmua dhe u demtua, cka i shkaktoi te 6 punonjesve nje dem prej 8 milion lekesh.

Megjithese ky rast eshte trajtuar ne vazhdimesi nga ana jone, madje eshte evidentuar edhe ne raportet vjetore te viteve te kaluara, problemi ende nuk ka gjetur zgjidhje. Megjithese te gjithe titullaret e Ministrise se Puneve te Jashtme, e kane pranuar detyrimin per te shperblyer te demtuarit, perseri ceshtja nuk ka marre zgjidhje. Per mendimin tone, mbeshtetur edhe ne shqyrtimin e te gjitha praktikave dokumentare te administruara, problemi qendron tek juristet e kesaj ministrie, te cilet nuk kane gjetur rrugezgjidhjet ligjore dhe konkretisht formulimin e nje projektvendimi per Qeverine, per akordimin e shumes prej 8 milion lekesh nga fondi rezerve i saj. Eshte nje veprim, i cili motivohet nga ana ligjore dhe konkretisht nga kerkesat e Kodit Civil.

5- Avokati i Popullit ka ndjekur me shqetësim edhe rastet kur shtetasit shqiptarë kanë kërkuar nderhyrjen e tij për shkelje të drejtave të tyre nga autoritetet e drejtësisë jashtë vendit. I tillë është rasti i shtetasit Gj.K. nga Mirdita, i cili ka kërkuar nderhyrjen për zbardhjen e ngjarjes që lidhet me vrasjen e djalit të tij A.K. në Bari të Italisë. Nga ana jone u kryen të gjitha verifikimet e nevojshme në Drejtorinë Konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, nga ku u sqarua se sipas përgjigjes së autoriteteve të policisë italiane, ngjarja me pasoje vdekjen e djalit të tij ishte aksidentale.

Praktika e deritanishme tregon se shumica e ankesave të prezantuara pranë nesh kanë të bëjnë me pengesat që hasin shtetasit shqiptarë jashtë vendit por edhe në Shqipëri, nga autoritetet zyrtare të vendeve të tjera, si dhe përfaqësive të tyre diplomatike në Shqipëri, lidhur me legalizimin e dokumentave, dhenien e vizave për qëllime të ndryshme etj.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe përfaqësitë e saj jashtë ushtrijne funksionet e tyre në përputhje me Konventën e Vjenës për “Marredhëniet Diplomatike”, Ligjin “Për Sherbimin e Jashtëm” dhe akte të tjera. Megjithatë, në këndvështrimin tone, mbështetur në detyrimin ligjor që ka Shteti Shqiptar në mbrojtje të interesave të Republikës së Shqipërisë dhe shtetasve ose personave juridike të saj, brenda kufijve të lejuar nga e drejta nderkombetare, Ministria e Punëve të Jashtme dhe përfaqësitë tona diplomatike e konsullore jashtë vendit, kanë mundësi dhe hapësira të bëjnë me shumë për t’i ardhur në ndihmë shtetasve shqiptarë.

Zyra e Avokatit të Popullit, nëpërmjet trajtimit të ankesave të prezantuara pranë saj, me rekomandimet dhe nderhyrjet përkatëse, ka synuar të ndikojë për një veprimtari ligjore dhe sa më efikase jo vetëm të strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Shqipëri, por dhe të misioneve të saj diplomatike e konsullore që veprojnë jashtë.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka synuar dhe ndikuar nëpërmjet rekomandimeve të tij për të terhequr vëmendjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme për plotësimin me personelin e domosdoshëm të konsullatave pranë Ambasadave, sidomos në Greqi, Itali, Gjermani, Angli etj, ku është evident një emigracion i konsiderueshëm shtetasish shqiptarë, në funksion të rritjes së cilesisë dhe kryerjes në kohë të shërbimeve konsullore.

Nga ana tjetër, është arritur në përfundimin se, bëhet i domosdoshëm angazhimi gjithmone e më i madh i misioneve diplomatike e konsullore të Shqipërisë, sidomos në vendet ku ndeshet përqendrimi më i madh i emigracionit, në mbrojtje të interesave ligjore të shtetasve shqiptarë që punojnë dhe jetojnë jashtë.

Institucioni ynë i ka kushtuar një vëmendje të veçantë dhe bashkëpunimit me institucionin e Ombudsmanit të vendeve ku kemi përqendrim më të madh të emigracionit shqiptar, me qëllim mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të shtetasve shqiptarë në ato vende. Është vendi të evidentohet bashkëpunimi tepër i efektiv ndërmjet institucionit të Avokatit të Popullit me Ombudsmanin Grek. Falë këtij bashkëpunimi është bërë e mundur nxitja konstruktive dhe përsheptimi i bisedimeve mes Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë dhe asaj të Greqisë, lidhur me evidentimin e nevojave dhe lehtësimin e problemeve të emigrantëve shqiptarë, të cilët punojnë dhe jetojnë në Greqi.

Në zbatim të funksioneve kushtetuese e ligjore të Institucionit të Avokatit të Popullit, bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme për përgatitjen e raporteve në zbatim të Konventave në të cilat vendi ynë ka aderuar, ka rezultuar i suksesshëm.

Vlen te permendet ketu kontributi per hartimin e Raportit qe Shteti Shqiptar duhet te paraqesë pranë Keshillit te Europes, lidhur me 5 Rekomandimet të Këshillit të Evropës, botuar në Fletoren Zyrtare Extra Korrik 2007.

Konkretisht Zyra e Avokatit të Popullit ka paraqitur rekomandimet perkatese per:

- Publikimin dhe shperndarjen e tekstit te Konventes Europiane per te Drejtat e Njeriut dhe te jurisprudences se Gjykates Europiane per te Drejtat e Njeriut.

Rendesia qe paraqesin aktet nderkombetare te ratifikuara nga vendi yne, ne raport me te drejten e brendeshme, reflektohet ne nenin 122 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise. Prandaj ne kemi vite qe ngrejme problemin e mos botimit ne Fletoren Zyrtare te rreth 80 Konventave dhe Akteve te tjera nderkombetare ne te cilat ka aderuar Shteti Shqiptar. Kjo ben qe si agjensite e zbatimit te ligjit si policia, gjykatat, prokororet, noteret, avokatet, por edhe shtetasit te mos i njohin ato.

-Per kontrollin e pajtuesmerise se projektligjeve, akteve ligjore egzistuese dhe praktikes administrative, me standartet e percaktuara ne Konventen Europiane per te Drejtat e Njeriut.

Duke ju referuar pervojes se disa vendeve, ku Institucionet Kombetare te te drejtave te njeriut jane perfshire aktivisht ne procesin legjislativ, institucioni yne propozon verifikimin sistematik te perputhshmerise se pinstitucioni projektligjeve me Konventen Evropiane te te Drejtave te Njeriut, marrjen e mendimit te specializuar nga ana e Zyres sone, etj.

- Per rishqyrtimin ose rihapjen e ceshtjeve gjyqesore ne nivel te brendshem, mbeshetur ne Vendimet e Gjykates Evropiane te te Drejtave te Njeriut.

Kuvendi i Shqipërisë me ligjin Nr.9398 dt.12.05.2005 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ka parashikuar disa të drejta dhe kompetenca të tjera të reja në funksion të veprimtarisë së kesaj Zyre. Në paragrafin e fundit të nenit 25 të këtij ligji parashikohet se: “Avokati i Popullit, pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkeljen e të drejtave të njeriut që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë, dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prek pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimeve”. Siç kemi shpjeguar edhe ne pjese te tjera te Raportit ky ndryshim i ligjit ngelet i pazbatuar.

Gjithashtu kontribut është dhene per hartimin e raportit te 2-te periodik te Komitetit Kunder Tortures (CAT), ne kuader te angazhimeve dhe detyrimeve te Shqiperise qe rrjedhin nga Konventa e OKB-se “Kunder Tortures dhe Trajtimeve ose Ndeshkimeve te tjera Çnjerezore dhe Degraduese” dhe ai lidhur me ecurine e zbatimit te rekomandimeve te Komisionit European kunder Racizmit dhe Intolerances (ECRI), ne drejtim te “Strategjise per permiresimin e kushteve te jeteses se komunitetit rom” etj. Persa i perket Protokollit Opsional kunder Tortures kemi shpjeguar se prane Avokatit te Popullit do te funksionoje Mekanizmi Kombetar per parandalimin e Tortures.

14. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Gjatë vitit 2007 për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit janë regjistruar gjithsej 15 ankesa, nga të cilat 8 ankesa kanë qenë jashtë kompetencave dhe juridiksionit, 4 të pabazuara dhe 3 ankesa janë zgjidhur në favor të shtetasve.

Kryesisht ankesat e paraqitura kanë patur për objekt problemet e administrimit të tokave bujqësore, mungesën e një informacioni të detajuar për mënyrën e subvencioneve për veprimitarinë fermere, mos ekzekutimet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë si dhe largimet nga puna veçanërisht gjatë mbylljes së Institutit të Perim-Patateve.

Megjithë larminë e problematikave që kanë shoqëruar trajtimin e ankesave në këtë fushë, nga ana jonë nuk është arritur të ndërhyhet në të gjitha rastet, pasi në disa prej tyre është ndjekur rruga gjyqësore nga vetë ankuesit.

Gjithsesi, në vijim po paraqesim shkurtimisht ankesat e zgjidhura pozitivisht

1. Shtetasi F.D. banues në Tiranë, ngriti pranë Avokatit të Popullit problemin e mosdhenies së informacionit, lidhur me një pasuri për të cilën ai kishte pretendimet e tij, megjithatë ai kishte ndjekur të gjitha procedurat ligjore duke paraqitur kërkesat me shkrim pranë MBUMK si dhe duke paguar tarifat për shërbimin e kërkuara nga ana e tij.

Në këtë mënyrë ankuesi pretendonte për shkelje të të drejtës së tij për informim, si një e drejtë e parashikuar dhe sanksionuar shprehimisht në ligjin organik dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pas fillimit të shqyrtimit të kësaj ankese dhe ndjekjes së procedurës ligjore për verifikimin brenda një afati të arsyeshëm të pretendimeve të ngritura nga ankuesi, u arrit në identifikimin e kërkesës dhe prones për të cilën kërkohej informacion nga ankuesi, duke i mundësuar atij kështu përmbushjen e të drejtës së tij për informim.

2. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit një shtetas paraqiti një ankesë ku prezantoi shqetësimin e tij ndaj Drejtorisë së Ujësjellës-Kanalizimeve Kavajë, për mosndërhyrje në pastrimin e kanalit kullues që shkaktonte probleme të mëdha ndotje dhe përmbetje për fermën e tij që ndodhej shumë afër.

Pas pranimit të ankesës, Avokati i Popullit kreu disa ndërhyrje të vazhdueshme pranë Bordit të Kullimit Kavajë, lidhur me verifikimin e pretendimeve të shfaqura nga ankuesi dhe me mundësinë e zgjidhjes së problemit të ngritur.

Nga ana e Drejtorit të këtij Bordi na u konfirmua përfundimisht fakti se për vitin 2008 ishte planifikuar fondi për pastrimin e këtij kanali për një gjatësi dhe kubaturë të konsiderueshme.

Me këtë rast nga ana e këtij organi u sigurua se ndërhyrja që do të kryhej në këtë vepër mundësonte eliminimin e plotë të shqetësimeve të ngritura me të drejtë nga ana e ankuesit.

3. Një ankese ka qene e mbartur nga viti 2006 për shqyrtim të metejshëm gjatë vitit 2007. Konkretisht bëhej fjalë për shtetasin Y.G. me banim në Pogradec, i cili ankohej ndaj MBUMK për neglizhencën në ekzekutimin e një vendimi gjyqësor. Konkretisht ai shprehet se në tetor 2005 është larguar nga detyra e tij si Drejtor i Bordit të Kullimit në Pogradec dhe se për këtë, ka pretenduar shkelje të të drejtave të tij duke iu drejtuar më pas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatës së Apelit në Korçë. Gjykatat i kanë dhënë atij të drejtë, duke vendosur që shtetasi Y.G. duhet të përfitonte 10 paga mujore.

Më tej ai shton se nga ana e Zyrës së Përmbarrimit Tiranë, ishin kryer të gjitha procedurat përkatëse ligjore për të mundësuar ekzekutimin e këtyre vendimeve gjyqësore. Procedura ishte refuzuar nga MBUMK me pretendimin se kishin paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Ky justifikim ishte në kundërshtim të plotë me ligjin, qëndrim i cili mbështetej edhe nga Zyra e Përmbarrimit Tiranë, që e konsideronte këtë pretendim të Drejtorisë Juridike të MBUMK si të pabazuar. Zyra e Përmbarrimit kishte ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ekzekutimin e plotë të këtij vendimi, duke aplikuar sanksionin e gjobës ndaj Sekretarit të

Përgjithshëm të MBUMK, pasi kishte kaluar afati për ekzekutim vullnetar dhe akoma nuk ishte përmbushur detyrimi ndaj palës kreditore.

Në këto kushte, në zbatim të funksioneve tona kushtetuese dhe në ushtrim të kompetencave të njohura me ligj institucionit të Avokatit të Popullit, i jemi drejtuar me rekomandim përkatës Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për ekzekutim sa më të shpejtë të vendimit gjyqësor në favor të shtetasit Y.G.

Nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit u vume në dijeni të faktit se tashmë nga ana e kësaj Ministrie ishte miratuar autorizimi përkatës për likuidimin financiar të ankuesit.

4. Në një çështje tjetër, lidhur me mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga ana e MBUMK për rimarrjen në punë të një ish nëpunëses në rolin e specialistes në Sektorin e Informacionit, Promocionit dhe Medias. Qëndrimi i mbajtur nga zyrtarë të kësaj ministrie, lidhur me këtë rast është kritikuar ashpër nga ana e Avokatit të Popullit.

Kjo çështje aktualisht po ndiqet nga Shërbimi Përmbartimor, por kjo nuk na ka penguar që të denoncojmë në këtë rast një fenomen të dëmshëm të shërbimit publik të administratës, i cili cënon rëndë parimin e shtetit të së drejtës.

Kjo çështje bëhet prezente në këtë raport për të treguar se mosveprime të tilla të nëpunësve të lartë të administratës shtetërore duhet të mos përsëriten për t'i dhënë një imazh të ri përgjegjshmërisë për zbatimin e ligjit.

Avokati i Popullit jo vetëm në të kaluarën por edhe në të ardhmen nuk do të lejojë që dukuri të tilla të zënë vend në veprimtarinë e institucioneve publike, por do t'i evidentojë ato duke kërkuar edhe masa ekstreme për nëpunësit përgjegjës.

Një çështje tjetër që parashikojmë në të ardhmen të përqëndrojmë në punën tonë me MBUMK është edhe monitorimi për vënien në zbatim të plotë të ligjit të ri për ushqimin.

Ky ligj, me prerogativat që i jep organeve të strukturuar pranë MBUMK, merr përsipër të garantojë një cilësi dhe kontroll të lartë mbi ushqimet në vendin tonë.

Në këto kushte objektivi ynë kryesor do të jëtë që kjo veprimtari të gjejë një përjasje sa më të madhe me nevojat e ngutshme që ka sot konsumatori shqiptar në këtë fushë.

Ankesa për çështje të Ligjit “Për Tokën”

Ankesat që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën” dhe kontestimet e ish pronarëve të tokave bujqësore për këtë Ligj janë 3. Këto ankesa kanë të përbashkët faktin, se ankuesit pretendojnë se nuk janë pajisur plotësisht apo pjesërisht me tokë bujqësore sipas normave për frymë, bazuar në Ligjin e mësipërm “Për Tokën”.

Megjithatë objekti i ankesave të familjeve bujqësore adresuar institucionit tonë mbetet i njëjtë: mosdhënia apo mosplotesimi me tokë bujqësore në pronësi i subjekteve që përfitojnë nga Ligji nr.7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën” dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij. Edhe shkaqet mbeten të njëjta: mos funksionimi i komisioneve të tokave në shumë fshatra, megjithëse ekzistojnë formalisht, mungesa e vullnetit të tyre për të trajtuar familjet e mbetura pa tokë për shkaqe të ndryshme, mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë me të cilat janë detyruar komisionet e tokës në fshat apo komunë për trajtimin e gjyqfituesve sipas legjislacionit për tokën. Por problemi më shqetësues mbetet mungesa e vënies së

fondit të tokës bujqësore të lirë në dispozicion të komisioneve të tokave për t'u ndarë familjeve bujqësore që për shkaqe të ndryshme, kryesisht për krijimin e mbivendosjeve të parcelave nga puna e papërgjegjshme e disa komisioneve në fshatra dhe komuna, ka krijuar një kategori të veçantë subjektësh përfituese pa tokë. Një rast ilustrues ishte edhe ai i paraqitur pranë Institucionit të Avokatit të Popullit me anë të së cilës, një shtetas shprehu shqetësimin në lidhje me parregullësi të konstatuara gjatë procesit të ndarjes së tokës në Bashkinë Himarë.

Konkretisht ai sqaroi se rreth 65 familje, ish- anëtare të kooperativës bujqësore në Himarë nuk kishin përfituar asnjë metër tokë bujqësore në mbështetje të Ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 "Për Tokën".

Lidhur me këtë problem, Avokati i Popullit ndërmori një hetim të veçantë, nga ku rezultoi se pretendimet e ngritura ishin të drejta.

Pas ndërhyrjeve dhe kontakteve të vazhdueshme për këtë problem u bë e mundur që nëpërmjet Komisionit Qeveritar të Tokës të kërkohej nga Komisioni i Tokës në Bashkinë Himarë si dhe në Komisionin e Tokës pranë Këshillit të Qarkut Vlorë, shqyrtimi i kërkesës për trajtimin me tokë të 65 familjeve, verifikimi i ligjshmërisë së vendimeve të mëparshme si dhe marrja e vendimeve përkatëse për zgjidhjen ligjore të problemit të parashtruar.

Pas kësaj, jemi interesuar pranë Komisionit të Ndarjes së Tokës në Bashkinë Himarë duke kërkuar që të njiheshim me trajtimin e kësaj ankese nga ana e tyre dhe nëse kishte filluar procedura e shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve sipas kërkesave të Komisionit Qeveritar të Tokës.

Me anë të një përgjigje zyrtare Bashkia Himarë ka konfirmuar faktin se, Komisioni i Ndarjes së Tokës i fshatit Pilur në proces-verbalin e ndarjes së tokës ka vendosur që 65 familjet që nuk u trajtuan me tokë bujqësore në Himarë, do të merrnin tokë në Pilur.

Në qëndrimin e mbajtur në këtë rast nga organet kompetente që administrojnë tokën bujqëro, Avokati i Popullit vlerësoi seriozitetin e tyre në trajtimin e kësaj çështje. Gjithësesi nga të dhëna të tjera të paraqitura nga ankesa apo peticione të shtetasve të ndryshëm, problemi i ndarjes së tokës bujqësore mbetet ende një çështje e mprehtë, veçanërisht për zonat e bregdetit në jug të vendit.

Ka patur edhe ankesa me të njëjtin objekt, të cilat i janë derguar për kompetencë për verifikim dhe shqyrtim të metejshëm Drejtorise së Menaxhimit të Tokës dhe Ujrave pranë Ministrise së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nga e cila jemi informuar lidhur me menyren e trajtimit dhe zgjidhjen ligjore që u është dhënë rasteve konkrete.

15. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave

Gjatë vitit 2007 janë trajtuar 12 ankesa për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave kryesisht për problematikën e ndotjes së mjedisit. Nga këto, 4 ankesa kanë qenë jashtë kompetencave dhe juridiksionit, 2 ankesa kanë qenë të papabazuara dhe 6 ankesa janë zgjidhur në favor të individëve.

Problemet e mjedisit për vitin 2007 janë konsideruar nga Avokati i Popullit si mjaft prioritare për vetë rëndësinë që ato paraqesin për cilësinë e jetës dhe shëndetit të shtetasve. Objektivi kryesor i punës tonë në këtë drejtim ka qenë përmbushja e standarteve të sanksionuara në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe zbatimi korrekt i legjislacionit në fushën e mjedisit.

Këto përpjekje të Avokatit të Popullit janë bashkërenduar shpesh herë me iniciativat e organizatave jo-fitimprurëse që punojnë për çështjet mjedisore, prej të cilave kemi marrë periodikisht të dhëna për gjendjen dhe problematikat e mjedisit në vend.

Në vijim po trajtojmë shkurtimisht çështjet e zgjidhura pozitivisht për këtë fushë:

1. Nisur nga disa informacione për një rast shqetësues të ndotjes pranë sheshit “Avni Rustemi” Tiranë, Avokati i Popullit ndërmori një procedurë hetimore me nismën e tij, nga ku rezultoi se gjatë ushtrimit të aktivitetit privat të tregtimit të nënprodukteve të mishit, procesi i pjekjes së tyre në zgarë me qymyr shoqërohej me çlirimin e tymrave në sasira të konsiderueshme për zonën përreth.

Kjo veprimtari, sipas dëshmimeve të banorëve dhe pronarëve të dyqaneve në këtë zonë, ishte mjaft shqetësuese pasi rëndonte ajrin në mënyrë të theksuar, duke çliruar gazra (dioksid karboni) dhe erëra të tjera të rënda.

Nga verifikimet tona rezultoi gjithashtu se ky problem ekzistonte prej kohësh dhe ishte prezantuar edhe pranë strukturave të Inspektoratit Mjedisor, por sipas banorëve ato nuk kishin vepruar për pezullimin e aktivitetit apo marrjen e masave për eliminimin e ndotjeve mjedisore.

Në përfundim të hetimeve, Avokati i Popullit paraqiti një rekomandim pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU) dhe Inspektoratit të Mjedisit, ku kërkoi marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e problemeve mjedisore në Sheshin “Avni Rustemi” Tiranë.

Duke marrë shkas nga kjo problematikë, si dhe duke patur si objektiv përgjithësimin dhe parandalimin e këtij fenomeni në shkallë vendi (veçanërisht gjatë sezonit turistik), u kërkua që të ndërmerrej një fushatë kontrolli dhe verifikimi nga Agjensitë Rajonale Mjedisore në disa qytete të vendit ku ishin vërejtur dukuri të tilla.

Përpos kësaj, referuar nenit 69 pika 2/a të Ligjit nr.8934 date 05.09.2002 “Per Mbrojtjen e Mjedisit” ku përcaktohet midis të tjerash se inspektorati i mjedisit realizon zbatimin e ligjshmerisë për mbrojtjen e mjedisit në nivel vendor, u kërkua që ndaj të gjithë subjekteve që do të rezultonin pa leje mjedisore të merrej masa e pezullimit të aktivitetit, deri në përmirësimin e gjendjes mjedisore dhe pajisjes me dokumentacionin ligjor që mundëson një monitorim të plotë të aktivitetit të tyre ndotës.

Nga përgjigjet e paraqitura për këtë çështje, është bërë e njohur që me urdhër të Zv. Ministrit të MMPAU të ngarkohen ARM-të në qytetet Tiranë, Durrës, Shkodër, Sarandë dhe Vlorë që të kryenin kontrole dhe të merrnin masa për eliminimin e ndotjes.

Njëkohësisht, nga përgjigjet e ardhura pas inspektimeve të kryera nga ARM-të e mësipërme, Avokati i Popullit konstatoi se gjatë veprimeve të tyre në terren ishin marrë masa për pezullimin e veprimtarisë tregtare, veçanërisht në zonat bregdetare turistike, lënies së detyrave për ndryshimin e kushteve dhe lëndëve për gatim, vendosjes së gjobave, mbylljen e veprimtarisë me kushtin për pajisjen me leje mjedisore etj.

Këto masa u konsideruan mjaft pozitive nga ana jonë për përmirësimin e situatës ndotëse brenda zonave urbane dhe një iniciativë e tillë do të vijojë në të ardhmen, duke përfshirë brenda saj edhe strukturat përgjegjëse për mjedisin pranë organeve të qeverisjes vendore.

2. Pranë Avokatit të Popullit u paraqit ankesa e një grupi banorësh të disa pallateve në Rrugën e Durrësit, Tiranë, të cilët pretenduan se Inspektorati i Mjedisit

nuk kishte marrë asnjë masë për të eliminuar zhurmat e mëdha që shkaktoheshin sidomos gjatë natës nga aktiviteti i një subjekti tregtar.

Avokati i Popullit për të mundësuar sqarimin e plotë të rrethanave për këtë çështje dhe ndërhyrjen për zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi, kërkoi nga ana e Inspektoratit të Mjedisit që të merreshin masat për inspektimin dhe eliminimin e ndotjeve të mundshme akustike në këtë zonë.

Nga verifikimi që kreu Inspektorati i Mjedisit për këtë çështje rezultoi se aktiviteti tregtar nuk dispononte lejen mjedisore dhe autorizimin për veprimtari (Non-Stop) edhe gjatë natës. Në këto kushte ishte marrë masa e pezullimit të veprimtarisë së subjektit, si kusht për plotësimin e të gjitha kriterëve ligjore që kërkon një aktivitet i tillë me ndotje të lartë akustike.

Ky rast u vlerësua si i suksesshëm falë një bashkëpunimi të efektshëm me ARM-në Tiranë për të parandaluar raste flagrante që çënojnë interesat e banorëve në komunitet. Në vijim jemi në dijeni se edhe Bashkia e Tiranës po punon fort për parandalimin e ndotjes akustike nga baret dhe klubet sidomos për eliminimin e zhurmave pas mesnate.

3. Avokatit të Popullit ju paraqit një ankese, me të cilën një qytetar nga Tirana pretendoi se instalimi i disa tubave të shkarkimit nga ana e një firme private i kishte krijuar jo pak probleme me cilesinë e ajrit pranë banesës së tij dhe të banorëve të tjerë .

Avokati i Popullit pasi u njoh me kete ankesë, paraqiti menjëherë një kërkesë pranë Inspektoratit të Mjedisit që kjo çështje të verifikohet dhe t'i jepej zgjidhje imediate.

Nga të dhënat në përgjigjen e ardhur nga ana e këtij inspektorati u bë e ditur se ishin marrë masat e kontrollit dhe ishin identifikuar shkeljet përkatëse.

Në vijim të ndjekjes së këtij problemi, subjektit privat i ishte lënë detyrë të paraqiste dokumentacionin përkatës pranë inspektoratit brenda një afati të caktuar dhe pas kalimit të këtij afati, atij i është pezulluar veprimtaria deri në plotësimin e detyrave të lëna për përmirësimin e situatës mjedisore.

Ndodhur përpara gadishmërise dhe veprimeve të shpejta të Inspektoratit të Mjedisit, Avokati i Popullit mendon se ndërhyrja e tij në rastin konkret ja arriti qëllimit në ndihmë të zgjidhjes së kërkesave të ligjshme të shtetasve.

4. Në ankesën e tij një shtetas pretendoi për mosdhënie të disa dokumentave zyrtare të kërkuar pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave në zbatim të Ligjit nr. 8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare".

Këto dokumenta sipas verifikimeve paraprake rezultuan se nuk kishin pengesa ligjore për refuzim të kërkesës, por përbënin të dhëna plotësisht të lejueshme për publikim dhe njohje nga ana e publikut.

Duke pretenduar për mosrespektim të dispozitave të ligjit të mësipërm nga ana e strukturave në varësi të MMPAU-t, Avokati i Popullit kërkoi menjëherë shpjegime për shkaqet e refuzimit për informacion dhe kritikoi njëkohësisht afatet brenda të cilave ishte ndjekur kjo procedurë.

Në kuadër të kësaj ndërhyrje u arrit që MMPAU, pas një shqyrtimi paraprak të kësaj çështje të mundësonte vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në adresë të ankuesit, duke kërkuar fillimisht dokumentacionin bazë për identifikimin sa më konkret të atyre parcelave pyjore, për të cilat ai kishte pretendime se çënoheshin nga një projekt i kësaj ministrie.

Në këtë çështje, Avokati i Popullit krahas ndihmës së dhënë në favor të ankuesit, i bëri të njohur organeve të MMPAU-t rëndësinë për zbatimin sa më korrekt të procedurave dhe afateve për dhënie të informacionit ndaj publikut.

5. Në ankesën e tij një shtetas shprehu shqetësimin e tij, lidhur me mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe të vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil, në të cilën ishte vendosur detyrimi i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave për të bërë kompesimin e tij me pagën e 2 javëve kalendarike leje të zakonshme të padhënë.

Avokati i Popullit pasi u njoh me këtë ankesë kreu ndërhyrjet e tij pranë MMPAU dhe insistoi disa herë që Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse pranë kësaj ministrie, të zbatonte ligjin në favor të të drejtave të ankuesit, duke respektuar njëkohësisht vendimet gjyqësore të formes së prerë.

Në përgjigjen përfundimtare të paraqitur, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse pranë MMPAU sqaroi se ishin kryer të gjitha procedurat e nevojshme ligjore, për likuidimin e pagesës së dy javëve kalendarike të lejes së padhënë në favor të ankuesit, duke e justifikuar këtë vonesë me zgjatjen e disa procedurave financiare për transferimin e fondeve për këtë qëllim.

6. Në Institucionin e Avokatit të Popullit disa banorë të Pallatit “Mig Mar” Tiranë, paraqitën një ankesë, e cila kishte të bënte me shqetësime të përsëritura që ju krijonte aktiviteti i ushtruar pranë mjedisëve të pallatit të tyre një subjekt i tregtimit të peshkut.

Konkretisht ata kanë pretenduar se edhe pas detyrave të lëna nga Inspektorati i Mjedisit Tiranë dhe ndërhyrjeve të disa organeve të tjera, zhurma e frigoriferëve, aspiratorëve dhe veçanërisht era e peshkut bëhej shpesh herë tepër shqetësuese.

Ankesa e mësipërme ishte paraqitur edhe më parë pranë Avokatit të Popullit dhe ajo ka rezultuar e bazuar. Por nga pretendimet e banorëve vihej re se masat e marra në terren nga Inspektorati i Mjedisit nuk kishin qenë efektive për të shmangur plotësisht ndotjen mjedisore dhe akustike të kësaj zone.

Në bazë të këtij shqetësimi, Avokati i Popullit kreu disa ndërhyrje pranë Kryeinspektorit të Inspektoriatit të Mjedisit, Agjencisë Rajonale të Mjedisit si dhe Drejtorisë së Shëndetit Publik Tiranë, duke kërkuar marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e problemeve mjedisore dhe akustike që kishin sjellë shqetësime për banorët.

Megjithëse shumë shpejt këto institucione ndërmorrën në vend një verifikim për këtë çështje, sërish nuk u dha një zgjidhje afatgjatë, pasi sipas specialistëve të mjedisit ekzistonte ende një vakum ligjor në lidhje me nivelet e zhurmave për të definuar në një ndotje akustike.

Ky vakum ligjor u ngrit si problem edhe nga ana e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave nëpërmjet një shkrese të tyre, ku krahas niveleve të zhurmave nuk ishin të qarta dhe një sërë kompetencash midis organeve për përballimin e situatave të tilla.

Në përfundim të shkresës theksohej edhe një herë gadishmëria për të vijuar kontrollin mbi subjektin tregtar dhe fakti se kjo ministri kishte në dorë përgatitjen e një pakete ligjore që i jepte zgjidhje përfundimtare problemeve të hasura në punën e tyre.

Nga interesimi që institucioni i Avokatit të Popullit tregoi në vijim për këtë çështje u konstatua se ajo mori zgjidhje në Kuvendin e Shqipërisë me anë të miratimit që ju bë Ligjit Nr. 9774 dt.12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.

Pavarësisht miratimit të këtij ligji, shpesh herë vihet re se strukturat e Inspektoratit të Mjedisit hezitojnë të kryejnë detyrën e tyre kur bëhet fjalë për subjekte të fuqishme tregtare. Ky hezitim të bën të dyshosh se në punën e tyre ka abuzim me detyrën, paragjykimet, trajtime të diferencuara ndaj shkelësve etj.

Dukuri të tilla janë vënë re edhe gjatë trajtimit të çështjes së mësipërme, ndaj dhe janë kundërshtuar nga ne, si veprime që dëmtojnë rëndë imazhin e mirëqeverisjes dhe të të drejtave të individëve.

Një sfidë tjetër e rëndësishme në kuadër të çështjeve mjedisore mbetet jo vetëm performanca e strukturave të MMPAU-t por edhe zbatimi i legjislacionit, veçanërisht i Ligjit Nr. 9774 dt.12.07.2007” Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.

Nga ana jonë do të vijohet të kihet një interesim i veçantë që ky ligj të gjejë zbatim në shumë problematika komunitare urbane, pasi ai përmban një volum të madh kompetencash që e bëjnë shumë efektive veprimtarinë mbrojtëse mjedisore.

Përveç këtyre objektivave, Avokati i Popullit do të ketë në qendër të vëmendjes edhe çështje të tjera që do t'i ndjekë me iniciativë atëherë kur ai do të vërejë se ka cënime flagrante nga ndotje të ndryshme në dëm të interesave të individëve.

Në këtë kuadër na duhet të sqarojmë edhe qëndrimin tonë të mbajtur për dy probleme tepër të mprehta që shoqëruan çështjet mjedisore gjatë vitit 2007.

Së pari, lidhur me projektimin dhe zbatimin e veprës energjitime “Petrolifera” në Vlorë, Avokati i Popullit shprehu një interesim paraprak për t'u njohur me kërkesat qytetare dhe me argumentat e tyre kundër ndërtimit të saj. Por dëshira e tyre për ta zgjidhur këtë çështje me referendum vendor bëri që kjo çështje të mos ndiqej më tej nga ana jonë. Gjithsesi në këtë rast u mbajt në konsideratë edhe praktika ndërkombëtare e Ombudsmanëve, të cilët ndërhyjnë në këto raste vetëm nëse konstatojnë shkelje të procedurave ligjore në hartimin e projekteve të tilla ose nëse vërejnë se ka pasoja të drejtpërdrejta ndotje nga veprimtaria e tyre.

Ky qëndrim disi më i avancuar u mbajt edhe në rastin e miratimit të lejes për ndërtimin e fabrikave të çimentos në zonën e Krujës. Në këtë rast Avokati i Popullit kreu një hetim pranë MMPAU-t dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës duke kërkuar të njëjët me procedurat ligjore të ndjekura në këtë rast.

Në përgjigje të shkresave të dërguara nga ana jonë këto dy ministri sollën një dokumentacion të plotë për këtë çështje, duke dhënë garanci jo vetëm për rregullsinë e këtij procesi, por dhe për mënyrën me anë të së cilës do të bëhej e mundur mbrojtja e mjedisit dhe ripyllëzimi i tërë zonës përreth fabrikës. Megjithatë këto çështje do të vazhdojnë të ndiqen nëse do të realizohen ose jo angazhimet e mara për mbrojtjen e mjedisit.

Avokati i Popullit duke qenë i bindur që ky proces është vetëm në fazën fillestare të zbatimit të tij, beson se në të ardhmen ai do të ndërmarrë një monitorim të plotë për respektimin e legjislacionit dhe kontratave në fuqi me qëllimin e qartë për të mbrojtur të drejtat mjedisore të banorëve të kësaj zone dhe të cilësitë e ekosistemit edhe më gjerë.

16. Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve

Per Ministrine e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve, per vitin 2007 kane ardhur 7 ankesa. Jane perfunduar 6 ankesa, ku 3 jane zgjidhur ne favor, 2 te papazuara, 1 jashte kompetence dhe 1 ne shqyrtim.

Problematika e ankesave qe ka te beje me kete ministri eshte kryesisht per probleme te marredhenieve te punes, vendimeve per perfshirjen e banesave si monument kulture, per ekzekutim te vendimeve gjyqesore e mbrojtjen e se drejtes se autorit.

Nga ankesat qe jane shqyrtuar permendim nje ankese te ligjshme qe eshte ngritur nga shtetesja A.LL. nga Tirana, ndaj Institutit te Monumenteve te Kultures. Ankuesja sqaron se pas kthimit ne pune nga leja lindjes, vendi i punes i ishte zene. Me nderhyrjen e Institucionit tone dhe shqyrtimin e dokumentacionit dhe me pas te interpertimit juridik, u be kalimi ankueses ne vendin e meparshem te punes.

Ankesa e shtetasit I.R. nga Tirana, i cili pretendonte se institucioni TOB-it nuk i jepete honoraret per koncertet e zhvilluara. Me nderhyrjen e Institucionit tone prane drejtorise se TOB-it, nga ana e ketij te fundit u krye pagesa ne favor te ankuesit.

Po keshtu do te veqonim ankesen e Y.P. nga Korça, i cili kontestonte vendimin e perfshirjes se baneses tij si monument kulture, bazuar ne ligjin Nr.9048, date 7.4.2003 “ Per trashgimine kulturore”. Ne ligj parashikohet se vlera objektit si monument kulture shpallet me vendim te organeve kompetente dhe vleresohet nga specialistet perkates, por marrja e miratimit nga pronaret nuk eshte e parashikuar. Ndaj ne pergjigjen qe i dhame e sqaruam ankuesin per kete vakum ligjor.

Ne shqyrtim nga zyra jone eshte ankesa e shtetasit A.P nga Tirana, i cili ka paraqitur shqetesimin e tij lidhur me mosfunksionimin e instrumentave te krijuar per mbrojtjen e te drejtes se autorit, i cili nuk po gezon frutet e punes tij siç ndodh ne vendet fqinje, por perkundrazi veprimtaria saj eshte jashte funksionit mbrojtjes te se drejtave te autorit.

Ankuesi shpjegon se gjobat e vendosura nga ana e organeve perkatese shteterore ne rastin e evidentimit te shkeljes te drejtes se autorit, vilen dhe merren nga shteti, nderkohe qe autori ndaj te cilit eshte kryer kjo shkelje, nuk perfiton asgje. Ne kete kendveshtrim ankuesi pretendon se gjobat e vena ne rast shkelje te se drejtes se autorit, duhet t'i perfitoje autori dhe jo shteti, problem i cili ka te beje me rregullimin ligjor qe do te sjelle dhe respektimin korrekt te se drejtes se autorit.

Kjo ceshtje eshte ende ne shqyrtim nga ana jone.

17. Ankesat për Administratën e Sherbimit Informativ Shtetëror

Gjate vitit 2007 ne Institucionit e Avokatit te Popullit kane ardhur 5 ankesa kunder veprimeve apo mosveprimeve te Sherbimit Informativ Shteteror (SH.I.SH), nga punonjes te ketij sherbimi per largime nga puna.

Per shkak te natyres se sherbimeve ankesat dhe kerkesat jane pare me perparesi dhe kujdes te posaçem, duke i verifikuar dhe kerkuar pergjigje nga administrata e Sherbimit Informativ Shteteror. Si rrjedhoje pas shqyrtimit dhe verifikimit te tyre, ka rezultuar se keto ankesa kane gene te pabazuara, se largimet nga detyra jane bere per shkak te reformimit dhe ristrukturimit te Sherbimit Informativ Shteteror.

Si baze ligjore per largimin nga puna si punonjes te Sherbimit Informativ Shteteror eshte perdorur pika “d” e nenit 45 te ligjit nr.9347, date 17.3.2005 “Per Statusin e Punonjesit te Sherbimit Informativ Shteteror”. Kjo me synim qe keta persona te vazhdonin te trajtoheshin nga ana financiare me pension te parakohshem dhe pagese kalimtare.

Ne pergjigjet zyrtare te Sherbimit Informativ Shteteror per ankesat, del se reformimi eshte bere mbi bazen e Urdherit te Kryeministrit dhe Urdherit te Titullarit te Institucionit.. Eshte e drejte ligjore e Drejtorit te Institucionit qe te beje emerime, levizje ne detyre apo dhe largime nga detyra, ne baze te legjislacionit te fuqi.

Nder ankesat e ardhura po permendim ankesen e shtetasit H.F. nga Korça, i cili pretendonte se i kane larguar djalin nga detyra pa te drejte, si dhe nuk ka perfituar te drejtat qe i takojne me ligj.

Pas verifikimive zyrtare u vertetua se djali i ankuesit kishte paraqitur vete ankese per te shkeputur marredheniet me sherbimin dhe te trajtohej me pagese kalimtare dhe si rezultat ankesa e ketij shtetasi u konsiderua e pabazuar.

Mund te themi se bashkepunimi institucional me Sherbimin Informativ Shteteror ka qene dhe vazhdon te mbetet korrekt, sepse administrata e tij dergon gjithmone shpjegimet e duhura brenda afateve te caktuara.

18. Veprimtaria e Nenseksionit te te Drejtave te Femijeve

Avokati i Popullit ka synuar te jape nje kontribut te vecante ne luften per mbrojtjen e te drejtave te femijeve, si me ane te trajtimit te ankesave individuale, ashtu dhe te hetimit me iniciativen e tij te rasteve te bera publike, si dhe te shqyrtimit te legjislacionit dhe dhenies se rekomandimeve per ndryshime apo permiresime te nevojshme.

Ne kete kuader vijoi edhe per vitin 2007 dhe bashkepunimi i Zyres sone me Save the Children per projektin “**Fuqizimi Institucional i Nenseksionit per te Drejtat e Femijeve ne Shqiperi**” me mbeshtetjen financiare te SIDA-s (Agjensia Suedeze per Zhvillim dhe Bashkepunim Nderkombetar). Jane zhvilluar shume aktivite per mbrojtjen e te drejtave te femijeve ne perputhje me Konventen e OKB “Per te drejtat e femijeve”, instrumentat e tjere nderkombetare, ligjet dhe aktet nenligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Gjithashtu projekti perfshinte rritje te ndergjegjesimit te opinionit publik per misionin dhe rolin e Nenseksionit per te drejtat e femijeve, ndertim kapacitetesh, asistence teknike, mbeshtetje infrastrukture, forcim institucional, pune kerkimore, nderhyrje direkte ne rast shkeljesh te te drejteve te femijeve, etj.

Veprimtaria e Nenseksionit gjate vitit 2007, u zhvillua e suksesshme ne perputhje me objektivat e vendosura ne projekt.

Ne drejtim te sigurimit te kapaciteteve profesionale dhe kompetencave per te mbrojtur te drejtat e femijeve ne Shqiperi, gjate vitit 2007 u realizuan objektivat si me poshte:

U nenshkrua amendimi i marreveshjes dypaleshe ndermjet Institucionit te Avokatit te Popullit dhe Save the Children per funksionimin e projektit per vitin 2007, pas vleresimit te raportit vjetor te 2006. Nje nga ndryshimet e pasqyruara ne kete marreveshje ishte ndryshimi i statusit te eksperteve rajonale ne ndihmeskomisionere.

Gjate ketij viti jane trajtuar 136 raste ankesash apo kerkesash me objekt shkeljen e te drejtave te femijeve. Nga keto 20 raste kane qene te mbartura nga viti 2006. Numri i femijeve perftues direkt nga ndihma dhene nepermjet trajtimit te rasteve ka qene 657 femije. Kjo pasi disa prej ankesave, kerkesave apo dhe rasteve te shqyrtuara me iniciative preknin te drejtat e nje numri te konsiderueshem femijesh.

Organizimi i diteve te hapura. Institucioni i Avokatit te Popullit ka zhvilluar ditet e hapura ne te gjitha bashkite e Shqiperise ne periudhen Prill–Maj dhe Shtator 2007 dhe ne Korçe dhe Shkoder ato jane asistuar edhe nga ndihmeskomisioneret e zyrave rajonale.

Trajtimi i rasteve qe prekin nje numer te madh femijesh. Gjate ketij viti jane trajtuar 8 raste te cilat synojne permiresimin e te drejtave te nje numri te madh femijesh. Keto raste kryesisht kane te bejne me permiresimin e kushteve te arsimit parashkollor, femijet e ngujuar nga gjakmarrja, apo probleme te kushteve te strehimit etj.

Identifikimi dhe monitorimi e qendrave rezidenciale per femijet. Ne muajin prill dhe maj jane identifikuar qendrat rezidenciale per femijet qe operojne ne te gjitha vendin si dhe eshte pergatitur plani per monitorimin e ketyre qendrave. Nga Zyra e Shkodres jane monitoruar 4 qendra rezidenciale per femije, ndersa nga Zyra e Korçes 1 qender.

Vendosja e bashkepunimit me institucionet shtetore lokale. Takime me perfaqesues te pushtetit vendor jane organizuar nga Zyrat Rajonale Zyra Rajonale e Korçes ka zhvilluar takime me N/kryetarin e Bashkise Pogradec, Kryetarin e Bashkise Devoll dhe perfaqesues te Bashkise Korçe per te vendosur bashkepunim institucional.

Trajtimi multidisiplinar i rasteve per femijet. NDF Tirane ka bashkepunuar me Qendren e Sherbimeve dhe Praktikave Ligjore te Integruara ne dy raste per te bere nje vleresim psiko-social femijeve.

Trajnimi i partnereve lokale OJF per te punuar me Ombudsmanin dhe perspektiva e tij. Ne workshopin 2 ditor te organizuar nga Barn Ombudsmani Suedez, ne Shqiperi u trajnuan edhe 20 partnere lokale dhe kombetare te NDF-se.

Workshopi per rishkrimin ne menyre feminore te objektivave te NDF-se dhe axhendes per trajnimin e femijeve. Ne datat 18-20 Korrik u zhvillua workshopi mbi rishkrimin ne menyre feminore te objektivave te NDF-se dhe hartimit te nje axhende per trajnimet e femijeve te shkollave. Ne kete aktivitet 16 femije te grupit "Zeri 16+" Elbasan te grupmoshes 14-18 vjeç, punuan intensivisht qe te rishkruanin ne nje gjuhe te kuptueshme nga femijet, rolin dhe çfare ofron NDF-ja. Gjithashtu nje qellim tjeter ishte edhe hartimi i nje axhende nga femijet per femijet mbi trajnimet qe do te zhvilloje NDF-ja ne shkollat e Tiranës. Femijet dhane mendime mbi sloganin qe mund te perdore NDF-ja gjate takimeve.

Gjate vitit 2007, eshte punuar per nje koordinim te permiresuar dhe proaktiv mes NDF-se dhe agjensive shtetore si dhe organizmave te ndryshme qe mbrojne te drejtat e femijeve, per nje ambjent me pergjegjes mbi politikat si dhe per nderhyrje te qendrueshme te Qeverise per te drejtat e femijeve.

Pergatitja e rekomandimeve per permiresimet e kuadrit ligjor per te drejtat e femijeve: Gjate vitit 2007 jane pergatitur dhe derguar Parlamentit te Shqiperise disa rekomandime per permiresim legjislativ. Me konkretisht:

- a. per permiresimin e ligjit "Per gjendjen civile", qe synon te permiresoje procedurat e regjistrimit te femijeve;
- b. Rekomandim per permiresimin e ligjit "Per Policine e Shtetit" qe synonte ne permiresimin e procedurave per respektimin e te drejtave te femijeve ne konflikt me ligjin;
- c. Rekomandim mbi projektligjin "Per disa shtesa ne Kodin Penal" ku rekomandohej qe dispozitat e propozuara per ndalimin e dhunes fizike e psikologjike, ndalimi i shfrytezimit te femijeve etj, te beheshin ne frymen e Konventes "Per te Drejtat e Femijeve" dhe Protokolleve Shtese.

Nga keto deri tani vetem nje rekomandim eshte pranuar dhe jane pasqyruar te gjitha sugjerimet tona. Behet fjale per ligjin "Per Policine e Shtetit". Gjithashtu, Ministria e Drejtesise do te beje nje studim te perputhshmerise te dispozitave shtese te Kodit Penal dhe KDF-se. Po keshtu, eshte pranuar ne parim rekomandimi "Per disa ndryshime ne Ligjin "Per Gjendjen Civile", dhe Ministria e Brendshme eshte ne proces vleresimi. Per kete eshte ngritur nje grup pune prane Drejtorise se Pergjithshme te Gjendjes Civile, ne perberje te cilit jane dhe 2 eksperte te OSBE.

NDF Tirane ishte pjese e grupit te punes per organizimin e konferences kombetare dy ditore mbi "Mbrojtjen e Femijeve, te Rinjve dhe Familjes", Shtator 2007. Konferenca u organizua nga Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta dhe UNICEF, nga ku dolen rekomandime konkrete mbi permiresimet ne fushat e ndryshme per funksionimin e ketij sistemi.

Nenseksioni raportoi prane Sekretariatit Kombetar Teknik per Femijet (SKTF) mbi masat e marra nga NDF per zbatimin e Planit Kombetar te Veprimit te Strategjise Kombetare per Femijet. Institucioni mbajti raportin mbi masat e marra nga NDF per zbatimin e Planit Kombetar te Veprimit te Strategjise Kombetare per Femijet ne Konferencen Kombetare per Femijet e zhvilluar ne 13 Korrik 2007.

NDF ka qene prezent ne mediat kombetare dhe lokale. Gjate 2007 NDF ka qene e ftuar per te diskutuar ne TV "News 24", "Vizion +". Po keshtu jane publikuar artikuj ne gazeten e perditshme kombetare "Standart" si dhe jane publikuar komunikata e Zyres se Shkodres ne web sitin e ATSH.

Eshte pergatitur dhe eshte transmetuar spoti publicitar per NDF. Gjate muajit prill dhe maj eshte punuar se bashku me agjencine e kontraktuar "Ashley and Holmes" per pergatitjen e dy spoteve publicitare informuese per NDF-ne. Njeri prej spoteve synonte informimin e femijeve dhe tjetri ate te te rriturve, me te drejtat e femijeve. Keto dy spote jane transmetuar nga data 15 Maj-15 Qershor si dhe ne Shtator 2007 ne mediat kryesore kombetare dhe lokale. Si rezultat i transmetimit te spotit televiziv, ka patur nje rritje te ndjeshme te numrit te ankesave.

Zyra Rajonale e Shkodres, ka moderuar, ne Prill 2007 takimin nderinstitucional me teme "Drejtesia e te miturve ne Shqiperi, reflektime mbi gjendjen aktuale dhe te ardhmen dhe sfida e integritimit evropian".

Ne korrik 2007 Zyra Rajonale e Shkodres referoi dhe mori pjese ne Tryezen Nderinstitucionale te nivelit te larte Shqiperi-BE me teme: "Vendosja e raporteve institucionale Rajon-BE ne funksion te zhvillimit demokratik dhe prespektives europiane". Nje takim i tille u organizua nga Bashkia Shkoder, Zyra Rajonale e Avokatit te Popullit ne Shkoder, "Regione Toscana" e Konsullata Italiane ne Shkoder, dhe ngriti ne nivel rajonal çeshtjet e te drejtave te femijeve ne kontekstin e integritimit europian.

Zyra Rajonale e Korçes ne Nentor 2007 organizoi tryezen e Rrumbullaket me teme "Qeverisja lokale dhe qendrore ne kuader te decentralizimit te sherbimeve sociale per nje realizim te te drejtave te femijeve ne Qarkun e Korçes, dhe atyre te minoriteteve ne veçanti (politikat per mbrojtjen dhe garantimin e tyre)". Ne kete takim me pjesemarrës nga Bashkia Korçe, Qarku, Drejtoria e Pergjithshme e Policise dhe gjyqtare, u diskutuan problemet qe dalin nga procesi i decentralizimit te sherbimeve sociale.

Stafi i Zyres Rajonale te Korçes, ka organizuar nje takim me femijet e shkollave te mesme, ku eshte diskutuar mbi te drejtat e femijeve dhe rolin e Avokatit te Popullit ne mbrojtje te ketyre te drejtave.

Tryeza e dyte e rumbullaket mbi “Studimi mbi perputhshmerine e legjislacionit shqiptar me Konventen Per te drejtat e Femijeve”. NDF se bashku me Qendren e Sherbimeve dhe Praktikave Ligjore te Integruara, organizuan tryezen e rumbullaket me rastin e perfundimit te studimit. Ky studim synon te permbledhe ne nje dokument te gjithe legjislacionin shqiptar per femijet dhe praktikat perkatese ne gjykate dhe organet administrative. Nje pjese kryesore e studimit jane gjetjet dhe rekomandimet per permiresimet legjislative per te drejtat e femijeve.

NDF-ja eshte bere me vizibel si rezultat e diteve te hapura, spoteve publicitare dhe pjesemarrjes ne takimet ne media.

Çeshtjet konkrete te trajtuara nga Nenseksioni si dhe nga gjithe Institucioni i Avokatit te Popullit gjate vitit 2007, qe kane lidhje me te drejtat e femijeve.

Me qellim qe te stimuloje nje reflektim dhe veprimtari sa me te madhe ne drejtim te mbrojtjes se femijeve, Avokati i Popullit ka trajtuar me perparesi rastet e abuzimit, keqtrajtimit dhe shkeljes se te drejtave te femijeve, qe ne fillim te ushtrimit te aktivitetit te tij ne fushen e mbrojtjes se te drejtave te njeriut.

Gjate vitit 2007, Zyra e Avokatit te Popullit duke perfshire dhe Nenseksionin per te Drejtat e Femijeve, ka shqyrtuar gjithsej 136 raste ankesash qe kane patur lidhje me te drejtat e femijeve. Pra ka patur nje rritje prej 280% me shume se rastet e trajtuara ne 2006. Nga keto 27 raste jane ndjekur kryesisht nga Institucioni i Avokatit te Popullit, 95 kane qene ankesa dhe 27 kerkesa drejtuar institucionit. Jane ne shqyrtim 26 prej tyre, 28 kane rezultuar jashte juridiksionit apo kompetences se Avokatit te Popullit, 33 ankesa apo kerkesa te pabazuara, 43 ankesa te zgjidhura ne menyre pozitive, 8 ankesa jane konkluduar me rekomandime te pranuar nga organet e administrates, si dhe rezulton 1 ankese per te cilen eshte bere rekomandim, por qe nuk eshte pranuar nga organi te cilit i jemi drejtuar, kurse 1 rekomandim tjeteter eshte ende pa pergjigje.

Megjithese ka patur nje rritje te konsiderueshme te numrit te rasteve te trajtuara, vazhdojne qe numri me i madh i ankesave per femijet te vijne nga prinderit ose te afermit e tyre.

Rastet e trajtuara gjate 2007 kane qene te fushave te ndryshme, por kryesisht objekti i ketyre ankesave ne pergjithesi ka qene i lidhur me trajtimin e veçante te femijeve, me permiresimin e kushteve ne shkolla dhe trajtimin e nxenesve, mosdhenien e ndihmes ekonomike nga Bashkia dhe perfitimin e statusit te jetimit, mosekzekutimin e vendimeve gjyqesore per detyrimin ushqimor te prinderve, vendosjen e femijeve jetime ne qendra rezidenciale, permiresimin e kushteve te strehimit, shkeljen e te drejtave te femijeve nga organet e administratave te shteteve te huaja, mosregjistrimin e femijeve, dhe moszbatimin e procedurave ligjore per rastet e femijeve ne konflikt me ligjin, etj. Numri me i madh i ankesave ka patur te beje me mosekzekutimin e vendimeve te Gjykates dhe vihet re nje renie e ankesave per keqtrajtim ne komisariate. Pozitiv mbetet fakti i rritjes se numrit te femijeve perftues nga projekti ne 657, si rezultat e trajtimit te rasteve me iniciative qe perfshijne nje numer te madh femijesh.

Konkretisht po paraqesim disa raste, 5 prej te cilave jane perfunduar me rekomandim nga Zyra jone:

1. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit ka paraqitur ankesen e saj qytetarja T.C., ne te cilen shprehte shqetesimin e saj per mosekzekutimin e vendimit gjyqesor te formes se prere, ku ishte vendosur detyrimi i ish-bashkeshortit per te paguar detyrimin ushqimor per kujdesin e mirerritjen e femijes se tyre. Pasi morem shpjegime nga Zyra e Sherbimit Permbarimor Tirane, i rekomanduam ketij te fundit

marrjen e masave te nevojshme per venien ne ekzekutim te vendimit perkates gjyqesor, konform nenit 606 te K.Pr.Civile dhe 320 te K.Penal. Po keshtu ne rekomandimin derguar kesaj zyre, theksuam se ne rast se do te vazhdonte gjendja e paligjshmerise, do te nxirrej pergjegjesia e nepunesit pergjegjes dhe do te kerkohej marrja e masave disiplinore prane organit epror. Kjo meqenese ishte bere dy here lajmerimi per ekzekutim vullnetar dhe nuk ishte dhene asnje rezultat ne favor te pales kerkuese, pavaresisht parashikimeve te bera ne Kodin e Procedures Civile dhe Kodin Penal.

Ne perfundim, problemi mori zgjidhje, pasi nga ana e Përmbartuesit Gjyqësor u kryen të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për ekzekutimin përfundimtar të këtij vendimi.

2. Zyra Rajonale e Avokatit te Popullit Korçe ndermori me iniciative trajtimin e problemit te dy femijeve te mitur vellezer R.Z dhe V.Z, perkatesisht 15 dhe 13 vjeç, te cilet jetonin te dy vetem tek ish-Magazinat, prapa Ndermarrjes Gjeologjike Korçe, pasi nena e tyre kishte vdekur. Prinderit e ketyre dy femijeve nuk kishin bere martese ligjore. Ne momentin e regjistrimit te femijeve ne Zyren e Gjendjes Civile, nena e tyre ishte vene nje atesi fiktive dhe femijet ekzistonin ne trungun familjar te nenes se tyre. Femijet pretendonin se babai i tyre biologjik eshte shtetasi M. R., i cili kishte bashkejetuar me ata vitet e fundit, dhe aktualisht vuante denimin me burgim per vepren penale te vjedhjes. Femijet nuk perfitonin asnje ndihme ekonomike dhe mbeshtetje nga institucionet vendore dhe per te jetuar mblidhnin hekurishte dhe i shisnin. Keta dy femije, megjithese te mitur, jetonin vetem pa nje kujdestar ligjor qe te kujdesej per ta. Gjithashtu megjithese ishin ne moshe qe duhet te frekuentonin shkollen, asnjeri nuk ishte i regjistruar.

Per kete arsye ne punuam ne disa drejtime:

-Zyra Rajonale e Korçes kontaktoi organizaten jofitimprurese lokale “Ndhme per femijet”(NDF) per te mundesuar perfshirjen e ketyre femijeve ne programin e tyre. Si rrjedhoje e kesaj u mundesua qe V.Z te perfitoje ndihme materiale dhe te regjistrohet ne klasat speciale te programit “Shansi i dyte”.

-Duke marre ne konsiderate faktin qe te dy femijet jetonin vetem, iu dergua rekomandim Bashkise se Korçes, qe te marre masa per vendosjen e ketyre femijeve nen kujdestari ligjore ose institucion rezidencial. Legjislacioni i brendshem shqiptar reflekton mjaft mire detyrimin e shtetit per tu kujdesur per femijet te cilet jetojne vetem. Kjo fryme del shume qarte ne Kodin e Familjes, ku ne te gjitha dispozitat qe i referohen femijeve, ato konsiderohen qe jane nen kujdesin e prinderve ose nen nje kujdestari ligjore. Bashkia Korçe ka marre informacion per rastin ne fjale dhe ka bere perpjekje per te vendosur femijet ne institucion rezidencial, por femijet nuk kane dashur. Pas marrjes se rekomandimit tone, Bashkia ka kontaktuar dy here me femijet per te biseduar ne lidhje me sistemimin e tyre. Po kete vit, pasi ka vuajtur denimin eshte liruar nga burgju edhe babai biologjik i femijeve dhe Bashkia po ndihmon qe femijet te vendosen nen kujdestarine e babait te tyre, shtetasit M. R.

3. Ne nje nga artikujt e gazetes se perditshme “Gazeta shqiptare” ngrihej shqetesimi mbi shkollat e mbipopulluara e konkretisht ne shkollen cikli i ulet Kala Berat, shkollen 9 vjeçare Mashterkor Mirdite dhe shkollat Koplík. Sipas artikullit, mungesa e klasave veshtiresonte organizimin e mesimit ne disa turne. Megjithese Bashkia e Koplíkut kishte akorduar nje fond te mjaftueshem per ndertimin e 6 klasave, kjo nuk i plotesonte nevojat aktuale qe jane per ndertimin e 11 klasave te reja ne shkollen 9-vjeçare dhe 9 klasa ne ate te mesme.

Institucioni i Avokatit të Popullit nisi me iniciativë shqyrtimin e problemeve të paraqitura në këtë artikull. Prandaj i kerkuam shpjegime Ministrise se Arsimit dhe Shkences nisur nga fakti se e drejta per arsimim dhe kushte te pershtatshme per edukim, eshte deklaruar se perben nje prioritet per kete Ministri. Ne kerkuam qe te shikohej me prioritet financimi i investimeve të shkollave në Komunat ose Bashkitë me nivel të ulët të ardhurash, duke i dhënë prioritet atyre që kanë kohë që nuk janë rikonstruktuar, si dhe per nje vleresim te situates se infrastruktures se shkollave ne shkalle kombetare. Ne pergjigjen e marre nga MASH u sqaruam se bazuar ne rekomandimin tone, jane marre masa per te financuar rikonstrukcionin e shkolles 9-vjeçare Mashterkor, ndersa dy shkollat e tjera nuk kane sjelle dokumentacion te plote ne perputhje me kerkesat e parashikuara ne Aneksin nr.3, te Ligjit 9645 date 27.11.2006 “Per buxhetin e shtetit 2007”.

4. Duke marre shkas nga disa ankesa te disa prindërve se punonjesja e shërbimit R.R e shkollës “Emin Duraku”, Tirane ushtronte dhunë psikologjike ndaj fëmijëve-nxenes te kesaj shkolle, Zyra jone kreu nje hetim mbi kete rast. Per te bere verifikimet perkatese mbi kete pretendim, eksperte te Institucionit tone dhe dy psikologe moren takim me Drejtoreshen e shkolles.

U zhvillua nje bisede me nje grup me 6 femije te klases II dhe 3 klases III te cilet u perzgjodhen ne menyre rastesore. Nga biseda me femijet dukej qarte se shqetesimi i ngritur nga prinderit ishte i vertete dhe se ne sjelljen e kesaj punonjeseje kishte elemente te dukshem te dhunes psikologjike. Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve ka theksuar se në zbatim të Nenit 28 dhe 29 të KDF-së “shkollat duhet të jenë miqësore ndaj fëmijëve në kuptimin më të gjerë dhe se koncepti i “shkollës” nuk duhet të limitohet vetëm tek mësuesit dhe drejtuesit e saj, por duhet të jetë më gjithëpërfshirës në drejtim të të gjithë personelit të saj”.

Kuadri yne ligjor për arsimin parauniversitar mundohet që të krijojë një ambjent pa dhunë në shkolla për fëmijët duke ndaluar rreptësisht ushtrimin e dhunës fizike dhe psikologjike në të. Kështu Neni 36 i “Dispozitave normative për arsimin parauniversitar” thekson se: “Individualiteti dhe dinjiteti njerëzor i fëmijës parashkollor dhe i nxënësit respektohet, ai mbrohet nga dhuna fizike e psikologjike, diskriminimi e veçimi. Në kopësht dhe në shkollë janë kategorikisht të ndaluara ndëshkimet fizike apo trajtimet poshtëruese e denigruese të fëmijëve”.

Po kështu, edhe fushata e ndërmarrë nga MASH për t’i thënë “Stop dhunës ndaj fëmijëve në shkollë” është shumë gjithëpërfshirëse dhe mundohet që të japë një koncept sa më të gjerë të konceptit të ambjenteve miqësore dhe të sigurta të fëmijëve në shkolla dhe detyrimin për ndalimin e dhunës ndaj fëmijëve në to.

Nga interpretimi i bërë “Dispozitave Normative” dhe “Qarkores për marrjen e masave për përmirësimin e punës edukative në shkollë” si dhe udhëzimeve të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve, del qartë se detyrimi për të mos ushtruar dhunë psikologjike bie jo vetëm ndaj stafit pedagogjik, por tek i gjithë personeli i shkollës, përfshirë këtu edhe punonjësit e shërbimit. Prandaj i rekomanduam Ministrin të Arsimit dhe Shkences, Drejtorise Arsimore Tirane si dhe Drejtorise se kesaj shkolle qe:

-Te marre masa ndaj kesaj punonjeseje, e cila kishte ushtruar ne menyre te hapur dhe rregullisht dhune psikologjike ndaj te gjithe femijeve te shkolles.

-Te marre masa qe trajnimet informuese ne zbatim te “Qarkores per marrjen e masave per përmirësimin e punes edukative ne shkolle” te shtrihen edhe ne personelin tjetër te shkolles, ne menyre qe te sigurohej nje ambjent i sigurt dhe pa dhune ndaj femijeve ne shkolla.

Si perfundim, Drejtoria e Shkolles vendosi t'i jape verejtje punonjeses R.R, vendim qe u mbeshtet edhe nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit Tirane.

5. Gjatë inspektimit të kryer në Institucionin e Paraburgimit Vlorë, ka paraqitur ankesë dhe i paraburgosuri A.L, me moshë 17 vjeç. Ankesa e tij konsistonte në faktin se, në moshën 12 vjeç, ai i është nënshtruar një operacioni kirurgjikal tek të dy sytë në Rusi dhe aktualisht kishte shqetësime të cilat vështirësoheshin në kushtet e paraburgimit. Ai u ankua ndaj Drejtorisë së Institucionit të Paraburgimit Vlorë për arsye se, nga momenti i arrestimit (kishte 2 muaj deri ne ditën qe u krye inspektimi), nga ana e personelit mjekësor nuk i ishte dhënë asnjë lloj ndihme mjekësore.

Gjëndja shëndetësore e tij ishte përkeqësuar. Nga ana tjetër, në Institucionin e Paraburgimit Vlorë ndonëse në organikë ishte caktuar mjek, aktualisht deri në momentin inspektimit këtë detyrë e krynte ndihmësmjeku i cili mjaftohej me dhënien e ndonjë medikamenti që dispononte personave që ishin të sëmurë, por pa bërë asnjë përpjekje për dërgimin e tyre tek mjeku specialist për vizita ambulatorë.

E drejta për kujdes shëndetësor nga shteti është një e drejtë kushtetuese, e cila për rastin konkret, meqënëse i paraburgosuri ishte i mitur, merr një rëndësi të veçantë.

Në Ligjin Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” i ndryshuar dhe konkretisht në nenin 29 i cili bën fjalë për Shërbimin Shëndetësor percaktohet se: “Administrata e Institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve”.

Në kushtet e paraqitura, ishte e domosdoshme që i paraburgosuri A.L. duhej t'i nënshtrohej një ekzaminimi nga mjeku specialist okulist. Ky i fundit në bashkëpunim dhe me mjekun ligjor, duke parë gjendjen aktuale të sëmundjes dhe kushtet e dhomave të paraburgimit duhej të sqaronte nëse kushtet ne te cilat ndodhej i paraburgosuri, bëjnë të pamundur trajtimin mjekësor të tij apo nevojitej trajtim në kushte spitalore.

Prandaj, i rekomandua Drejtorisë së Institucionit të Paraburgimit Vlorë marrjen e masave të menjëhershme me qëllim trajtimin mjekësor të paraburgosurit të mitur. Ky rekomandim u mireprit dhe kemi marre përgjigje si nga Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve, ashtu dhe nga Institucioni i Paraburgimit Vlore, qe femija po vijon te ndiqet nga mjeku specialist, dhe do ta kurojne ne kliniken e specializuar okulistike.

6. Prane Institucionit te Avokatit te Popullit eshte drejtuar nje ankese nga Qendra e Sherbimeve dhe Praktikave Ligjore te Integruara Tirane per disa shkelje proceduriale te kryera nga nje punonjes i Komisarariatit te Policise nr.1 Tirane. Kjo pasi me daten 5 Prill 2007, Grupi i Gatshem prane Komisarariatit te Policise nr.1 Tirane ka shoqeruar te miturin L. Xh. te datelindjes 1992 ne dhomat e ketij komisaritati. Nena e femijes i ka kerkuar Qendres ne fjale qe t'i jape ndihme ligjore djalit te saj. Ne ankesen e saj, Qendra shpreh shqetesimin, se Oficeri i Policise Gjyqesore N.B, nuk ka lejuar qe avokati te takoje te miturin, duke penguar zbatimin e te drejtave te njeriut te parashikuara ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise si dhe te konventave nderkombetare ku shteti yne eshte pale. Institucioni i Avokatit te Popullit e ka trajtuar dhe referuar me prioritete edhe me pare kete ceshtje tek autoritetet perkatese. Ne vijim te trajtimit te rastit konkret, i rekomandua Shefit te Komisarariatit te Policise nr.1 Tirane marrjen e masave per te zbatuar ne te ardhmen te drejtat e personave te shoqeruar si dhe i derguam shkresen perkatese Drejtorit te Drejtorise se Pergjithshme te Policise se Shtetit per lejimin e avokateve qe te hyjne

ne ambientet e policise per tu takuar me klientet e tyre qe ne momentet e para te shoqerimit, ndalimit apo arrestimit.

Ne pergjigjen e rekomandimit u sqaruar se “u moren masa per te zbatuar ne te ardhmen te drejtat e personave te shoqeruar si dhe garantimin e te drejtave te tyre per tu mbrojtur me avokat”.

7. Me interes eshte te veçojme ankesen e ndjekur me iniciative nga Zyra jone, per permiresimin e kushteve te Kopshtit te Femijeve Nr.3 ne Qytetin e Burrelit. Krahas masave te tjera, ne monitorojme ne vijmesi njoftimet nga organet te ndryshme publike dhe te medias me qellimin qe t`ju gjendemi sa me prane problemeve dhe ankesave te femijeve.

Ne vijim te kesaj veprimtarie, me dt.21.10.2007 u njohem me nje kronike te Televizionit KLAN, e cila ngrinte shqetesimin per kushtet e papranueshme te Kopshtit te Femijeve Nr.3 Burrel.

Menjehere nga ana e Institucionit te Avokatit te Popullit u organizua nje inspektim prane ketij objekti, ku u konstatuan mjaft mangesi dhe kushte te papranueshme, te cilat çdo dite rrezikonin seriozisht jeten dhe shendetin e femijeve. Kopshti Nr.3 i ndodhur ne Lagjen “Drita”, Qyteti i Burrelit është ndërtuar para 30 vjetësh dhe është një ndërtesë 1 katëshe e përbërë nga 4 dhoma, dhe një guzhinë, korridor dhe banjo. Ndërtesa nga inspektimi i kryer rezultoi tejet e amortizuar. Tarraca e saj prej betoni kishte mungesa te dukshme te hidroizolimit dhe per pasoje nepermjet saj rridhnin shira brenda objektit ne vende te veçanta. Si rrjedhim edhe shume pjese murale te brendshme ishin me suva te demtuar nga lageshtira teper e madhe. Mbas vitit 1997 në këtë kopsht ishte bërë një meremetim i pjesshëm, por gjendja aktuale kishte demtuar edhe pjesen e rikonstruktuar rishtaz, duke e kthyer ate ne nje investim te padobishem.

Kopshti kishte nje kapacitet për 30 fëmijë, ndërsa në fakt ne momentin e inspektimit rezultuan 60 fëmijë, pra dyfishi i kapacitetit. Kushtet e jashtme ishin pa rrethim, pa kënd sportiv, pa lulishte dhe perpara godines kishte nje pellg te madh me ujra te ndotura si pasoje e problemeve ne kanalizimet nentokesore qe nuk ishte nderhyre prej kohesh. Ngrohja e ketyre femijeve behej me korrent dhe ne mungese te tij me gaz te siguruar nga prinderit e femijeve. Ne ambientet e gatimit kishte nje sobe te vjeter drush qe ishte nxjerre jashte përdorimi. Aktualisht ishte në përdorim një fernellë me gaz, e cila perdorej ne kushte aspak te sigurta per femijet. Në guzhinë nuk kishte dollap enësh dhe mjete te tjera ndihmese me qellim pregatitjen dhe servirjen e ushqimit ndaj femijeve. Lavanteria ishte jashtë përdorimi dhe ne kopesht nuk kishte depozitë uji. Femijet flinin ne krevate te improvizuara nga arka druri dhe mbuloheshin me batanije leshi të përdorura qe prej 30 vjetësh. Shpesh femijet ankoheshin per pranine e minjve ne ambientet e tyre, gje qe nuk konfirmohej nga edukatoret.

Ne kontakt me drejtuesen e ketij kopshti rezultoi se ky objekt varet nga Bashkia Burrel dhe fondet per meremetimin dhe permiresimin e sherbimit te tyre miratohen dhe levrohen nga Këshilli i Bashkisë. Ndersa Drejtoria Arsimore e rrethit merrej vetem me emerimin e personelit të ketij shërbimi.

Nga dokumentacioni i kontrolluar rezultoi se ky kopsht ishte kontrolluar disa herë nga Drejtoria e Shëndetit Publik Burrel dhe për shkeljet e konstatuara ishin lënë akt kontrole me shkrim per permiresimin e kushteve.

Nga te dhenat e mesiperme, Avokati i Popullit ka dale ne perfundimin se Kopshti Nr.3 Burrel eshte i pabanueshem dhe i rrezikshem per jeten dhe shendetin e femijeve. Ne keto kushte nga ana jone u shtrua si nevoje evakuimi i menjehershem i 60 femijeve qe strehoheshin ne kete godine dhe sistemimi i tyre ne kopshtet e tjera te

qytetit. Keshilli Bashkiak i Bashkise Burrel me iniciative te tij duhej te merrte dhe te shqyrtonte jashte rendit te dites miratimin e nje fondi emergjence per permiresimin e ketij kopshti per ta sjelle ate brenda kushteve te pranueshme.

Avokati i Popullit gjate ketij inspektimi evidentoi neglizhencen e Drejtorise se Shendetit Publik ne rreth per te marre masa deri ne mbylljen e objektit. Pajtimi me situaten ne te cilen jetonin keta femije tregon papergjegjshmeri te larte nga ana e tyre gjate ushtrimit te funksioneve shteterore.

Kushtet dhe gjendja e amortizuar dhe mbi te gjitha mbajtja hapur e nje godine te tille per strehim femijesh te moshes 3-6 vjeç eshte nje problem qe duhet te ishte zgjidhur me kohe dhe jo te lihej ne meshire te pritjes per fonde ne afate te tejzgjatura.

Organet e pushtetit vendor i kane te gjitha mundesite (ashtu si ka ndodhur edhe per kopshtet e tjera te qytetit te Burrelit) per te siguruar ne shume menyra fonde te veçanta emergjence apo baze materiale per permiresimin e kushteve per femijet.

Kjo apati nuk duhej te vijonte dhe te rendonte mbi jeten dhe shendetin e femijeve, por ajo duhej zgjidhur sa me shpejt per te parandaluar konsequenca te padeshirueshme per jeten dhe shendetin e tyre.

Nga kjo pergjegjesi nuk perjashtuam edhe Drejtorine e Arsimit ne Rreth, e cila nuk duhej te pajtohej me nje mjedis te tille pune per punonjesit e saj, por duhej te mendonte nepermjet bashkepunimit dhe koordinimit te veprimeve me Bashkine Burrel per nje zgjidhje emergjente te kesaj situate. Me neglizhencen e saj, kjo drejtori ka lejuar qe kopshti i femijeve te kthehet ne nje mjedis mjeran hotelerik ditor, i cili kishte humbur qellimin didaktik dhe edukues ndaj femijeve. Kjo u vu re nga mungesa e mjeteve dhe bazes materiale qe mundesonin misionin edukues dhe didaktik te kopshtit.

Avokati i Popullit paraqiti nje rekomandim si nje shqetesim jo vetem ne rolin e nje funksionari publik, por dhe ne ate te nje prindi te prekur nga nje trajtim mesjetar qe ju behet femijeve tane.

Në përfundim, duke e parë se vazhdimi i mëtejshem i kësaj situatë në mungesë të veprimeve konkrete ligjore përbën shkak për cënimin e të drejtave të ligjshme të femijeve, i rekomanduam Kryetarit të Bashkise Burrel marrjen e masave të menjehershme për permiresimin e kushteve të Kopshtit të Femijeve Nr.3 në Qytetin e Burrelit.

-Mbylljen e perkohshme te Kopshtit Nr.3 dhe sistemimin e femijeve ne kopshtet e tjera te qytetit, deri ne permiresimin e kushteve.

-Mbajtjen e nje mbledhje jashte rradhe te Keshillit Bashkiak Burrel per te analizuar situaten ne kete kopsht dhe per te marre vendimet e duhura per rehabilitimin e tij. Ky rekomandim eshte ende ne shqyrtim e siper nga zyra jone, ne pritje te nje vleresimi pozitiv qe do t'i behet kesaj ceshtje, sa e rendesishme aq dhe ligjore.

Si përfundim, mund të themi se Avokati i Popullit është i angazhuar seriozisht të japë një kontribut me rëndësi të veçantë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të femijeve. Kjo duke rritur ndergjegjesimin e individëve të komunitetit dhe të administratës publike në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë reciproke në mbrojtjen e garantimit të të drejtave të femijeve.

Ne kemi planifikuar qe ne mbyllje te projektit 3 vjeçar, ne Qershor 2008 t'i paraqesim Kuvendit te Shqiperise nje Raport te veçante dhe Rekomandimet perkatese per ngritjen e nje strukture te veçante per mbrojtjen e te drejtave te femijeve, qofte brenda Institucionit te Avokatit te Popullit, qofte jashte tij, si institucion i pavarur, i krijuar me ligj te posaçem.

K R E U I V

1. E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legjislative

Në nenin 24 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit” parashikohet e drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legjislative. Në këtë dispozitë përcaktohet se: “Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:

a. t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;

b. t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.

c. të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla”.

Qysh nga fillimi i veprimtarisë në qershor të vitit 2000 deri në fund të vitit 2007, institucioni ynë e ka përdorur shpesh herë këtë të drejtë, kur ka konstatuar gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave apo njoftimeve se janë kushtet e mësipërme për të bërë rekomandime për përmirësimin e legjislacionit. Është e qartë se nga ndryshimi i një ligji apo akti nënligjor me karakter normativ (jo individual, për një person të caktuar) rregullisht përfiton jo vetëm personi i caktuar që ankohet, por përfitojnë të gjithë personat që kanë të bëjnë me marrëdhëniet që rregullon ligji apo akti nënligjor i nxjerrë, ndryshuar apo përmirësuar me rekomandim të Avokatit të Popullit. Që këtë del rëndësia e madhe e përdorimit të këtij mjeti pune nga Avokati i Popullit.

Siç del nga Pasqyra nr.1, gjatë periudhës 2000-2006 janë bërë 41 rekomandime drejtuar organeve që kanë të drejtën ligjvënëse (deputetëve të Kuvendit, Kryeministrit dhe anëtarëve të Qeverisë) që të bëjnë ata propozime për ndryshime apo përmirësime të ligjeve. Për vitin 2007 janë bërë 4 të tilla. Nga 45 rekomandime janë pranuar 37 që kanë rezultuar me 26 ndryshime apo përmirësime të ligjeve; 11 janë në fazën e projektit për miratim në Kuvend apo ne Qeveri; 5 janë refuzuar dhe 3 janë pa përgjigje zyrtare.

Në Pasqyrën nr.2 janë pasqyruar rekomandimet për ndryshime apo plotësime të akteve nënligjore normative që ka në kompetencë të nxjerrë Këshilli i Ministrave (Qeveria) për periudhën 2000-2007. Nga 36 rekomandime (3 janë bërë në vitin 2007) janë pranuar 33, që kanë rezultuar 22 me ndryshime, përmirësime apo nxjerrje të akteve nënligjore nga Qeveria; 11 janë në fazën e projektit; 2 janë refuzuar dhe 1 është pa përgjigje zyrtare.

Kurse në Pasqyrën nr.3 janë pasqyruar rekomandimet për ndryshime apo plotësime të akteve nënligjore normative në kompetencë të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore. Nga 40 rekomandime (9 janë bërë në vitin 2007)

janë pranuar 34, nga të cilët për 25 janë bërë ndryshimet apo përmirësimet; 9 janë në fazën e projektit; 4 janë refuzuar, kurse 2 janë pa përgjigje.

Në përfundim, nga 121 rekomandime, propozime apo kërkesa me karakter legjislativ janë pranuar deri tani gjithsej 104 prej tyre, ose rreth 85%. Mund të themi se rezultatet janë të kënaqshme, sepse nga 104 të pranuar, për 73 prej këtyre rekomandimeve janë bërë ndryshimet apo përmirësimet e ligjeve apo akteve nënligjore. Kurse 21 rekomandimet e tjera janë në proces realizimi. Për lehtësi studimi gjithë rekomandimet e bëra dhe ndryshimet e realizuara gjatë vitit 2007 janë shënuar me gërma të zeza.

*Evidenca e rekomandimeve per plotësim apo ndryshime te ligjeve te Kuvendit te Shqipërisë
Per periudhen 2000-2007*

<i>Nr</i>	<i>Ankuesi</i>	<i>Permbajtja e rekomandimit</i>	<i>Kujt i drejtohet</i>	<i>Data e dergimit</i>	<i>Përfundimi</i>
1	Ankesa e 70 ish ushtarakëve të larguar nga detyra.	Rekomandim: “Për një ndryshim në Ligjin Nr. 8087 datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve në F.A. të Republikës së Shqipërisë e konkretisht nenit 19/1 për ndryshimin e termit “braktisje në detyrë”.	Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes në Kuvend, i cili mori iniciativën legjislative.	16.03.2001	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 8948 datë 03.10.2002, i cili bëri ndryshimet në nenin 19/1, sipas rekomandimit të Avokatit të Popullit.
2	Ankesa e shtetasit K.D.	Rekomandim: “Për iniciimin e nxjerrjes së një ligji për rregullimin e simboleve fetare në shkollat publike”	Kryeministrit. Ministrit të Arsimit dhe Shkencës	26.04.2001	Ministri i Arsimit ka pranuar që të nxjerrë një udhëzim për të rregulluar këtë problem, por deri tani nuk është nxjerrë.
3	Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit	Rekomandim: “Ndryshimi i Ligjit Nr.8435 datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me taksën për rregjistrimin vjetor të automjeteve dhe taksën për aks	Ministresë së Transporteve, Ministresë së Financave, Drejtoresë së Përgjithshme të Transportit Rrugor.	20.07.2001	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 8840 datë 11.11.2001 që rriti përqindjen e D.P.T. Rrugor si agjent tatimor në 20 përqind, duke ndryshuar nenin 4 të ligjit.
4	Ankesa të ish pronarëve	Rekomandim: “Propozohen ndryshime në Ligjin nr. 7665 datë 21.01.1993 “Për zhvi-	Komisionit të Ligjeve, ekonomisë e financave në	12.10.2001	Rekomandimi është pranuar. Shfuqizuar me nenin 30 të

		llimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, për shfuqizimin e neneve 7/ç dhe 13 të tij.	Kuvend. Ministrit të Turizmit e Rregullim Territorit		Ligjit Nr. 9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin e kompesimin e pronës”.
5	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin Nr. 8097 datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.	Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale. Komisionit parlamentar të çështjeve kushtetuese dhe ligjeve.	14.12.2001 Përsëritur në datën 06.03.2003	Rekomandimi është pranuar në parim, por nuk është miratuar në ndryshimet që i janë bërë ligjit.
6	Ankesa të shtetasit J.L.	Rekomandim: “ Për ndryshimin e nenit 6, pika 2 të Ligjit Nr. 8360 datë 10.06.1998 “Për kriteret dhe mënyrat e shpërndarjes të pasurive të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjërë”.	Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve e Çështjeve Sociale. Komisionit Parlamentar për Punën dhe Çështjet Sociale	14.12.2001	Pa përgjigje.
7	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “ Dërgohen propozime për marrjen e nismës ligjvënëse lidhur me përmirësimet e ndryshime të akteve ligjore e nënligjore për përfundimin e procesit të rivlerësimit e rishpërndarjes së pasurisë së ish kooperativave bujqësore si dhe, ndryshime në Ligjin Nr. 8435 datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”	Ministrit të Bujqësisë. Ministrit të Financave. Kryeministrit.	26.12.2001	Pa përgjigje.
8	Ankesa nga	Rekomandim: “Për rregullimin ligjor të punës	Ministrit të	2001	Rekomandimi është pranuar dhe rregulluar me nenin 31 të Ligjit “Për statusin e ushta-

	ushtarakët	jashtë orarit dhe shërbimit 24 orësh”.	Mbrojtjes		rakut” dhe mbi këtë bazë dhe me rregullore të Ministrisë së Mbrojtjes.
9	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për përgatitjen e Ligjit “Për zhdëmtimin e personave të dëmtuar”, në zbatim të nenit 44 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.	Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë	24.12.2001	Rekomandimi është pranuar pjesërisht. Doli Ligji Nr. 9381 datë 28.04.2005 “Për kompesimin e burgimit të padrejtë”.
10	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “ Për zbatimin e nenit 10 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare dhe miratimin e tyre në Kuvendin e Shqipërisë”.	Dërguar të gjithë Kryeministrave.	16.01.2002 Përsëritur në 09.12.2005	Rekomandimi është pranuar pjesërisht. Është lidhur marrëveshja vetëm me Komunitetin katolik nëpërmjet Ligjit Nr. 8902 datë 23.05.2002.
11	Ankesa nga Shoqata e të Verbërve	Rekomandim: “Për domosdoshmërinë e ndryshimit të Ligjit Nr. 8098 datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”.	Zv/Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve e Çështjeve Sociale	02.04.2002	Rekomandimi është pranuar në parim. <i>Eshte miratuar strategjia kombëtare për personat me aftësi të kufizuara, me ane te VKM nr. 8 dt.7.01.2005 “Strategjia Kombetare per personat me aftesi te kufizuar”.</i>
12	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për bërjen e disa ndryshimeve në Ligjin Nr. 8388 datë 05.08.1998 “Për grumbullimin e armëve dhe municioneve luftarake”	Kryeministrit. Kryetarit të Kuvendit.	16.04.2002	Rekomandimi është pranuar pjesërisht. Kuvendi zgjati afatin e veprimit të Ligjit, duke miratuar Ligjin Nr. 9018 datë 06.03.2003 “Për mbledhjen e armëve, të municioneve dhe materialeve

					të tjera luftarake”
13	Banorë të komuniteteve në Tiranë, Durrës dhe Librazhd	Rekomandim: “Për përgatitjen sa më shpejt të projekteve për plotësimin e legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të ambientit nga rrezatimet jo jonizuese të telefonisë celulare”.	Ministrit të Mjedisit. Ministrit të Shëndetësisë. Ministrit të Drejtësisë.	13.05.2002 Përsëritur në dt. 27.10.2004	Është kthyer përgjigje nga Ministritë. <i>Po përgatitet nje draft i ri nga Instituti i Fizikes Berthamore, por akoma nuk eshte paraqitur në Qeveri.</i>
14	Ankesa e shtetasit B.I.	Rekomandim: “Për një plotësim në Ligjin Nr. 7710 datë 18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, lidhur me parashikimin e procedurës së ankimit administrativ kundër vendimeve të seksioneve përkatëse të Bashkive apo Komunave”.	Zv/ Kryeministrit dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta	09.05.2002	Rekomandim është pranuar dhe zgjidhur me nenin 25 të Ligjit Nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”.
15	Ankesa e shtetasit Th.K	Rekomandim: “Për ndryshimin e e ligjit Nr. 7889 datë 14.02.1994 “ <i>Për statusin e invalidit</i> ” për përfitimin e një shtese mujore mbi pensionin e invaliditetit, për të gjithë të aksidentuarit gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak”.	Zv.Kryeministrit Ministrit të Mbrojtjes	12.06.2002	Rekomandimi është pranuar dhe problemi është zgjidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 9418 datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
16	Konferenca Kombëtare Dhjetor 2001	Rekomandim: “ Mbi masat që duhen marrë për zbatimin e Rekomandimeve të Konferencës Kombëtare “ <i>Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës</i> ”, që të krijohet një organizëm shtetëror për të kontrolluar gjakmarrjen etj.	Kryeministrit, disa ministrave	10.09.2002	Rekomandimi u pranua. Doli Ligji Nr. 9389 datë 04.05.2005 “Për Këshillin Koordinativ për luftën kundër gjakmarrjes”
	Me iniciativën	Rekomandim: “Për marrjen e masave për të realizuar ndryshimin e Ligjit Nr. 5840 datë	Kryeministrit.		Rekomandimi u pranua. Neni 57/7 i Ligjit nr.8950

17	e Avokatit të Popullit	20.02.1979 “Për rregjistrimin e akteve të gjëndjes civile”, me qëllim çrregjistrimin e personave të vdekur nga listat e zgjedhësve”.	Kryetarit të Kuvendit	11.09.2002	datë 10.10.2002 i lejon zyrat e gjëndjes civile të zgjidhin problemin duke ju drejtuar vetë gjykatës.
18	Ankesa të ish pronarëve	Rekomandim: “Të përshpejtohet procesi legjislativ në bazë të nenit 181 të Kushtetutës për miratimin e akteve nënligjore që rregullojnë problemet e pronësisë, mosdhënien e titullit “ <i>person i stimuluar në fushën e turizmit</i> ”, ndalimin e tjetërsimit të pronës shtetërore të rregjistruar dhe bllokimin e privatizimit apo të dhënies me qera të objekteve shtetërore dhe trojeve të tyre”	Kryetarit të Kuvendit. Komisioneve Parlamentare dhe Qeverisë.	19.09.2002	Rekomandimi është pranuar. Doli Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë Nr. 9 datë 03.10.2002, e cila i kërkoi Qeverisë dhe organeve të qeverisjes vendore që deri në hartimin e projektligjit të ri “Për kthimin e Kompesimin e pronave” të ndërpritet tjetërsimi dhe dhënia me qera e pronave shtetërore.
19	Ankesat e ish pronarëve	Rekomandim: “Për masat që duhen marrë në zbatim të neneve 41/1 dhe 181/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë”, me qëllim rregullimin e drejtë dhe përfundimtar të çështjes së pronave.	Kryeministrit. Kryetarit të Kuvendit.	19.09.2002	Rekomandimi u pranua. Dolën ligjet Nr. datë 29.07.2004, Nr. 9388 datë 04.05.2006 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”.
20	Ankesat e ish pronarëve	Rekomandohet të merret në konsideratë Vendimi nr.26 datë 24.04.2001 i Gjykatës Kushtetuese në projektligjin “Për kthimin dhe kompensimin e ish pronarëve”	Kryetarit të Kuvendit. Komisioneve parlamentare në Kuvend	28.10.2002	Rekomandimi u pranua. Neni 8/2 i ligjit nr.9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës ish pronarëve”
21	Me iniciativën e Avokatit të	Rekomandim: Për plotësimin e Ligjit Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe	Komisionit të Ligjeve dhe të Drejt-	25.11.2002	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 9071 datë 22.05.2003 Për një ndryshim

	Popullit.	<i>trajtimin e të dënuarve me burgim</i> ".	tave të Njeriut në Kuvend, i cili mori iniciativën legislative.		në Ligjin Nr. 8328 datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajnimin e të dënuarve me burgim"
22	Njoftimi i zotit Pjetër Arbnori	Rekomandim: "Për përmirësimin e nenit 4 të Ligjit Nr. 8292 datë 25.02.1998 <i>"Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë"</i> , sepse nuk lejohet hetimi i policëve që bëjnë pjesë në këto forca, kur akuzohen për vepra penale.	Komisionit të Ligjeve dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvend, i cili mori iniciativën legislative dhe e paraqiti në Kuvend.	26.11.2002 Përsëritur në 2006	Nuk u miratua projektligji në seancë parlamentare. Është ribërë propozimi, drejtuar Komisionit të Ligjeve dhe Sigurisë Kombëtare si dhe në projektligjin "Për Policinë e Shtetit". <i>Me ligjin nr.9748 date 4.06.2007 "Per Policine e Shtetit", neni 4 eshte lene ne fuqi.</i>
23	Me iniciativën e Avokatit të Popullit.	Rekomandim: "Për plotësimin e Ligjit Nr. 8609 datë 08.05.2000 <i>"Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë"</i> për t'u mundësuar gjithë të dënuarve që të votojnë në zgjedhjet për pushtetin vendor.	Komisionit Bipartizan në Kuvend.	13.02.2003 Përsëritur në datën 20.10.2006	<i>Kerkesa ju drejtua Gjykatës Kushtetuese me dt.23.02.2007, e cila me vendimin e saj nr.40 dt.16.11.2007 e rrezoi kete kerkesë.</i>
24	Ankesa e shtetasit S.H.	Rekomandim: "Për zbatimin dhe përmirësimin e legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore", ku është propozuar "Ndryshimi i nenit 59 të Ligjit Nr. 7703 datë 11.03.1993 <i>"Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"</i> .	Kryeministrit. Ministrit të Punës e Çështjeve Sociale. Komisionit Parlamentar të Punës e Çështjeve Sociale.	23.09.2003.	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 977 datë 21.04.2005 "Për disa ndryshime e shtesa në Ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar, neni 18.
					Rekomandimi është pranuar.

25	Ankesa nga shtetas dhe shoqata	Rekomandim: “ Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8087 datë 13.03.1996 “ <i>Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Shtetëror</i> ”.	Kryeministrit	19.11.2003	Zgjidhur me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 9418 datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të F.A. të Republikës të Shqipërisë”. Neni 14 pika 6 e tij.
26	Një numer i madh të dënuarish që vuajnë dënimet në burgje.	Rekomandim: “ Propozohet ndryshimi në Ligjin nr. 7941 datë 31.01.1995 për hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 7895 datë 27.01.1995 “ <i>Për Kodin Penal në Republikën e Shqipërisë</i> ”.	Komisionit të të Drejtave të Njeriut në Kuvend. Një grup deputetësh morën inisiativë legislative.	20.11.2003 Përsëritur në datën 08.03.2006	Ne seancen plenare te dates 14.06.2007, Parlamenti ka diskutuar ndryshimet e rekomanduara, te cilat nuk u miratuan.
27	Ankesa e ish gjeneralit Y. D.	Rekomandim: “Bërja e një statusi të veçantë për ushtarakët madhorë duke u nisur nga rasti i ish gjeneralit Y.D”.	Ministrit të Mbrojtjes	24.03.2004	U muar parasysh në ndryshimet e Ligjit Nr. 9171, datë 22.01.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në FA të R. Shqipërisë dhe konkretisht Pika 2 e nenit 22 ku thuhet: “Statusi i gjeneralëve pas daljes së tyre në rezervë/lirim rregullohet me VKM. Doli VKM Nr. 542 datë 12.08.2004 “Për statusin e ushtarakut me gradë madhore në FA pas daljes në lirim”.
28	Ankesa të ndryshme	Rekomandim: “Për plotësimin e nenit 28 të Ligjit “ <i>Për Statusin e Ushtarakut</i> ”.	Ministrisë së Mbrojtjes	03.11.2004	Rekomandimi u pranua si i drejtë dhe Ministria e

					Mbrojtjes ka hartuar draftin.
29	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “ Propozime për përmirësimin e Kodit Zgjedhor”, me qëllim që numurimi i votave në çdo zonë elektorale të bëhet nga tre gjyqtarë.	Bashkëkryetarëve të Komisionit Parlamentar për Reformën Zgjedhore	22.11.2004	Rekomandimi nuk është pranuar.
30	Ankesa e shtetasit D.M.	Rekomandim: “Për plotësimin e nenit 40 të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 “ <i>Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë</i> ”, me qëllim përfundimin e pensionit familjar pas vdekjes së bashkëshortit, nga bashkëshortja ose bashkëshorti student nën moshën 25 vjeç	Komisionit të Ligjeve në Kuvend. Institutit të Sigurimeve Shoqër-re.	28.01.2005 16.03.2005	Rekomandimi nuk është pranuar.
31	Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë	Rekomandim: “Propozim për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9209 datë 22.03.2004 “ <i>Për legalizimin e shtesave në ndërtim</i> ” për të thjeshtuar procedurat e legalizimeve dhe për të ulur masën e gjobave.	Kryeministrit. Komisionit parlamentar të Ligjeve, e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregëtisë e Mjedisit.	16.03.2005 Përsëritur më datën 16.09.2005	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr.9482 datë 16.02.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejë”, ku është përfshirë edhe rekomandimi i Avokatit të Popullit.
32	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për disa shtesa e ndryshime të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, plotësuar më ligjin nr. 8600 datë 10.04.2000 “ <i>Për Avokatin e Popullit</i> ”.	Kryetarit të Kuvendit. Mori iniciativë një grup deputetësh	01.04.2005	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 9398 datë 12.05.2005.
33	Shoqata Uniteti Kombëtar	Rekomandim: “Për zhbllokimin e situatës së krijuar nga mosfutja në përdorim e letrave me vlerë dhe bonove të privatizimit”	Kryeministrit. Ministrit të Financave. Ministrit të Ekonomisë dhe	12.10.2005.	Rekomandimi u pranua. Doli ligji Nr.9516 datë 18.04.2006

			Energjistikës.		
34	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Propozim për një ndryshim në Ligjin Nr.8436 datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për të caktuar afate për qëndrimin në detyrë të kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të gjykatave.	Kryetares së Kuvendit. Kryetarit të Komisionit për çështjet ligjore Kryeministrit	08.11.2005	Rekomandimi është pranuar. Eshte perfshire në ligjin “Për disa ndryshime në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” që është miratur më datën 18.02.2008.
35	Grup Shoqatash	Rekomandim: “Për ndërmarrjen e iniciativës ligjore për parashikimin ligjor të termit “Taksë e drejtpërdrejtë” në Ligjin nr. 8977 datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” si dhe në Ligjin nr. 8982 datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendor”, për cilësimin ligjor të llojeve të “taksave vendore të drejtpërdrejta” për efekt të përjashtimit të veteranëve të luftës, invalidëve dhe të të verbërve”.	Ministrit të Financave, Ministrit të Brendëshëm, Komisionit të Financës dhe Buxhetit në Kuvend.	23.11.2005	Rekomandimi u pranua në parim, por nuk është përfshirë deri tani në ligjet e miratuara.
36	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për ndryshimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së nenit 86 të Kodit Penal, për veprën penale të “torturës”.	Ministrit të Drejtësisë.	16.12.2005	Rekomandimi u pranua. Me Ligjin nr.9686 dt.26.02.2007 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.7895 dt.27.1.1995 “Kodi Penal”, i ndryshuar, u be ndryshimi i nenit 86 te Kodit Penal, sipas rekomandimit tone.
					Rekomandimi u pranua në parim. Megjithate në draft projektligjin për urbanisti-

37	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “ Për marrjen e iniciativës për rregullimin ligjor të ndërtimeve të objekteve fetare”.	Kryeministrit Ministrit të Punëve Publike etj	28.12.2005	<i>kën qe eshte ne proces hartimi nga Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve, nuk eshte parashikuar konkretisht ky rregullim deri tani.</i>
38	Ankesa nga Shoqata joqeveritare	Rekomandim: “Për ndryshimin dhe përmirësimin e Ligjit Nr. 8950 datë 10.10.2002 “Për Gjëndjen Civile” ndryshuar më Ligjin Nr. 9029 datë 13.03.2003 dhe Ligjin nr. 9229 datë 29.04.2004” për regjistrimin e fëmijëve të paregjistruar.	Ministrit të Brendshëm. Kryeministrit.	12.07.2006	<i>Aktualisht nga Ministria e Brendshme eshte ngritur nje grup pune prane Drejtorise se Pergjithshme te Gjendjes Civile. Po punohet per ndryshimin e ligjit duke marre ne konsiderate edhe propozimet tona.</i>
39	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: Për projektligjin “Për pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”.	Kryetarit të Komisionit të Çështjeve Ligjore. Grupeve Parlamentare	13.07.2006	<i>Nuk u pranua nga Qeveria dhe Kuvendi. Pas ankimimit ne Gjykatën Kushtetuese, me vendimin e saj nr.19 date 3.05.2007 eshte vendosur shfuqizimi i disa neneve të Ligjit nr.9584 date 17.07.2006 “Për pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj” sipas kërkesës tonë.</i>

40	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: Për plotësimin e Ligjit Nr. 9087 datë 19.06.2003 “ <i>Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, për të rregulluar tre çështje: votimi i të burgosurve në zgjedhjet lokale, ndalimi i pjesëmarrjes së fëmijve në fushatat elektorale dhe zgjedhja e zëvendës kryetarit të komunës apo bashkisë direkt nga populli, njëjloj si kryetarët.</i> ”	Bashkëkryetarëve të Komisionit Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Kryetarit të Komisionit të Çështjeve Ligjore.	20.10.2006	Për të burgosurit shif pikën 23 të kësaj pasqyre. Për dy propozimet e tjera nuk ka përgjigje zyrtare..
41	Koalicioni për barazi gjinore	Rekomandim: “ Për parashikimin në <i>Kodin Zgjedhor</i> të kuotave jo më pak se 30% për pjesëmarrjen e grave në politikë”.	Bashkëkryetarëve të Komisionit për Reformën Zgjedhore.	25.10.2006	<i>Rekomandimi është pranuar. Është përfshirë në projektligjin “Për barazinë gjinore” që është në Kuvend për miratim.</i>
42	<i>Ankesa e shtetasit O.Xh.</i>	<i>Rekomandim për plotësimin në Ligjin nr.9588 datë 25.07.2006 “Per rrillogaritjen e pensioneve”, i cili do të mundesoje trajtimin e kategorise se pensionistëve te periudhes Tetor-Dhjetor 1993, qe është perjashtuar per trajtim nga ky ligj</i>	<i>Ministrit të Financave. Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta</i>	<i>8.01.2007</i>	<i>Rekomandimi u pranua në parim nga Ministria e Financave. Por pas një eksperte konkrete për rrillogaritjen e mundshme për efekt të ndryshimit të ligjit, ka rezultuar se nuk do të kishte ndonjë efekt në rritjen e pensionit për pensionistet që mund të përfitonin nga rekomandimi.</i>
43	<i>Me iniciativë të Avokatit të Popullit</i>	<i>Rekomandim për ndermarrjen e iniciativës për shfuqizimin e dispozitave të Kodit Penal Ushtarak që përmbajnë denimin me vdekje</i>	<i>Kryetares së Kuvendit.</i>	<i>19.02.2007</i>	<i>Rekomandimi është pranuar. Kuvendi miratoi Ligjin nr.9722 dt. 30.04.2007 me</i>

		<i>në kohë ne gjendje lufte apo situate te jashtezakonshme, ne zbatim te protokollit 13 te Konventes Europiane per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe Lirive Themelore.</i>	<i>Kryeministrin. Ministrin te Drejtesise.</i>		<i>ane te te cilit shfuqizoi ne Kodin Penal Ushtarak te gjitha denimet me vdekje.</i>
44	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandim per pergatitjen e ligjit per ngritjen e nje autoriteti mbikqyres te pavarur, pergjegjes per mbrojtjen e te dhenave personale ne Shqiperi.</i>	<i>Kryeministrin. Ministrin te Drejtesise.</i>	<i>03.04.2007</i>	<i>Rekomandimi eshte pranuar. Keshilli i Ministrave i propozoi per miratim Kuvendit ne muajin Shkurt 2008, projektligjin “Per mbrojtjen e te dhenave personale”, ku parashikohet ngritja e institucionit te Komisionerit per mbrojtjen e te dhenave personale.</i>
45	<i>Me ankese te disa shtetasve</i>	<i>Rekomandohet nisma ligjore per perfshirjen e rreth 400 familjeve te zones se Berdeneshit Sarande brenda territorit administrative te nje njesie vendore</i>	<i>Kryeministrin. Ministrin te Brendshem.</i>	<i>20.11.2007</i>	<i>Rekomandimi eshte pranuar. Ministri i Brendshem ka urdheruar ngritjen e nje grupi pune per studimin e zones dhe dhenien e mendimeve per zgjidhjen ligjore te problemit.</i>

**Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime në aktet nënligjore të
Këshillit të Ministrave per periudhen 2000-2007**

Nr	Ankuesi	Permbajtja e rekomandimit	Kujt i drejtohet	Data e dergimit	Përfundimi
1	Ankesa e shtetasit M.Sh. etj.	Rekomandim: “Propozohet shtyrja e afatit të veprimit të V.K.M. Nr. 585 datë 11.12.1997 “Për evidentimin e familjeve që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale”, si dhe plotësimi i listave të kreditorëve.	Kryeministrit	16.06.2000	Rekomandimi u pranua në parim. Por pa nxjerrë V.K.M. u plotësuan listat e kreditorëve në njësitë e qeverisjes vendore.
2	Shtetasti A.R. ish pronar trualli	Të shfuqizohet si antikushtetuese shkronja “c” e pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive që veprojnë në sektorët strategjikë” si dhe pikës 4 të V.K.M. nr.438, datë 14.08.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare” për çmimin e truallit që i është kthyer ish pronarëve	Gjykatës Kushtetuese	15.11.2000	Kërkesa u pranua. Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.26, datë 24.04.2001 vendosi: 1. Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 1, shkronja ‘c’ të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive që veprojnë në sektorët jostrategjikë”. 2. Pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.438 datë 14.08.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare”.

3	Ankesa te shtetasve	Rekomandim: “Për pagesën nga Agjensia Kombëtare e Privatizimit për taksën e rregjistrimit të pasurive të paluajtëshme që ju ka shitur personave fizikë ose personave privatë”.	Kryeministrit Ministrit të Financave Agjensisë Kombëtare të Privatizimit	11.05.2001	<i>Rekomandimi u pranua. Doli VKM Nr. 386 datë 31.05.2001”Për pagesën e taksës së kalimit të pronësisë nga privatizimi i pronës shtetërore”.</i>
4	Shoqatat e “Dëshmorëve të Atdheut”, dega Fier dhe Krujë	Rekomandim: “Për nxjerrjen e disa akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit Nr. 8607 datë 27.04.2000 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”.	Kryeministrit	08.10.2001	Rekomandimi është pranuar. Doli VKM Nr. 151 datë 25.04.2002 “Për statusin Dëshmor i Atdheut”.
5	Ankesa të shoqatave të ish pronarëve	Rekomandimi që të nxirren Vendimet e Qeverisë në përputhje me vendimin nr.26 datë 24.04.2001 të Gjykatës Kushtetuese	Ministrit të Ekonomisë	24.10.2001	Rekomandimi u pranua. Me VKM nr.119 datë 27.02.2003 u riformulua gërma “c” e pikës 1 të VKM nr.119 datë 18.03.2000, sipas Vendimit nr.26, datë 24.04.2001 të Gjykatës Kushtetuese
6	Ankesa e një numuri të madh të dënuarish që vuajnë dënimin në burgje	Rekomandim: “Për plotësimin e kërkesave të Ligjit Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, për kriteret e shpërblimit të punës së të dënuarve.	Kryeministrit Ministrit të Drejtësisë	13.05.2002	Pranuar në parim. <i>Eshte pergatitur nje projektvendim, qe nuk është miratuar ende nga ana e Keshillit te Ministrave</i>
7	Ankesa e shtetasit A.M.	Rekomandim: “Për shfuqizimin e pikës 1 të VKM nr.24.10.2001 dhe urdhërit të Ministrit të Arsimit “Për kuotat shtesë të Shkollave të Larta”, që krijonte diferencim për kandidatët për studentë në shkollat e larta	Kryeministrit. Ministrit të Arsimit	04.07..2002	Rekomandimi është pranuar. Doli VKM Nr. 362 datë 18.07.2002

8	Disa familjare te punonjsve te policise, te vrare ne krye te detyres	Rekomadim: “Per permiresimin e V.K.M. Nr. 552 date 27.11.1999 “ <i>Per trajtimin ekonomik e financiar te familjareve te punonjesve te policise te vrare e plagosur per shkak te detyres</i> ”.	Keshillit te Ministrave. Ministrit Rendit Publik	06.12.2002 Perseritur disa here dhe heren e fundit date 19.09.2006	Rekomandimi është pranuar. <i>Eshte bere projektvendimi dhe eshte derguar për miratim në Qeveri dy here. Eshte kthyer për t’u ripunuar per shkak te kostos financiare.</i>
9	Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë	Kërkesë: Të shfuqizohet si antikushtetues Vendimi nr.441 datë 26.09.2002 i Këshillit të Ministrave “Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve”	Gjykatës Kushtetuese	13.12.2002	Pranuar. Para shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese, Qeveria nxori Vendimin nr.19 datë 10.01.2003 “Për disa ndryshime në vendimin nr.441 datë 26.09.2002
10	Ankesa e shtetasit Q.H.	Rekomandim: “Për të deklaruar (konstatuar) pavlefshmërinë absolute të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 226 datë 20.08.2002 “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike”.	Kryeministrit	27.05.2003	Rekomandimi u pranua. Kryeministri me urdhërin Nr. 157 datë 12.11.2003 revokoi urdhërin Nr. 226 datë 20.08.2002.
11	Ankesa e shtetasit Q.H	Rekomandim: “ Për ndryshimin e VKM Nr. 64 datë 02.02.2001 “ <i>Për inkuadrimin e gradave ushtarake, në gradat e Policisë së Shtetit dhe për caktimin e funksioneve organike që do të ushtrohen sipas tyre</i> ”.	Këshillit të Ministrave, Ministrit të Rendit Publik	29.05.2003	Rekomandimi nuk u pranua. Por pati efektet e tij pozitive. Eshtë bërë i mundur korigjimi i shumë rasteve të dhënies së gradave në mënyrë të padrejtë.
12	Ankesa e shtetasit S.H.	Rekomandim: “Për përmirësimin e udhëzimit Nr. 1 datë 24.12.2002 “Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni”. Zbatimi me akt nënligjor i parashikimeve të nenit 61 Pika 1 të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në R.Shqipërisë”, dhe udhëzimit Nr. 1 datë 24.12.2002 “Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt	Kryeministrit etj.	23.09.2003	Rekomandimi është pranuar. Në zbatim të këtij rekomandimi doli VKM Nr. 357 datë 01.06.2004 e VKM Nr. 374 datë 31.05.2005 “Për për-caktimin e koefiçie-ntëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual për llogaritjen fillestare të

		pensioni”.			pensioneve”.
13	Ankesa e shtetasit Xh.K dhe i një numuri të madh të veteraneve nga i gjithë vëndi.	Rekomandim: “Për ndërmarjen e inisiativës për hartimin e projektvendimit për caktimin e një afati të ri për paraqitjen e dokumenteve para Komisionit Qëndror të <i>Statusit të Veteranit</i> , me qëllim njohjen e statusit të veteranit”.	Ministrit të Mbrojtjes	26.11.2003	Është pranuar dhe për këtë ka dalë VKM Nr.748 datë 11.11.2004, i cili zgjati afatin deri më 31.12.2006. Afati është zgjatur edhe për vitin 2007.
14	Ankesa e shtetasit G.D.	Rekomandim: “Mbi hartimin e një projektvendimi për trajtimin e detyrimeve ndaj shtetit, ndaj sigurimeve shoqërore dhe të tretëve që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes së konçesionit të formës BOT për uzinën e ferrokromit Elbasan dhe për minierat e kromit Prrenjas e Pojskë, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike e Privatizimit dhe Shoqërisë italiane Darfo SPA”.	Këshillit të Ministrave.	2003	Pranuar. Janë bërë ndryshime në ligj që falin detyrimet e papaguara ndaj Sigurimeve Shoqërore
15	Ankesa e Infosoft System” Sh.a.	Rekomandim: “Për revokimin e paragrafit që parashikon formularin e “Autorizimit të Prodhuesit” në kapitullin e tretë të Udhëzimit të K.M. Nr. 1 datë 01.01.1996 “Për Prokurimin Publik” ndryshuar me VKM Nr.3 datë 10.07.2003 “Për disa ndryshime të VKM. Nr. 1 datë 01.01.1996 “Për Prokurorimin Publik”.	Kryeministrit	13.12.2003	Rekomandimi është pranuar nga ana e Agjensisë së Prokurimit Publik. <i>Ne dokumentet standarte per blerjen e mallrave, te miratuara ne perputhje me Ligjin nr.9643 date 20.11.2006 “Per prokurimin Publik”, eshte hequr ky formular.</i>
16	Ankesa e shtetasit N.GJ.	Rekomandim: “Për përfshirjen në listën e subjekteve që përfitojnë pension suplementar të nënpunësve të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të Avokatit të Popullit”.	Kryeministrit. Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.	08.07.2004.	Rekomandimi u pranua. <i>Shtesat përkatëse te kerkuara jane pasqyruar ne VKM nr.467 date 23.06.2005 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr.382 date</i>

					<i>20.05.1996 “Per zbatimin e ligjit nr.8097 date 21.03.1996 “Per pensionet shtetere suplementare te personave, qe kryejne funksione kushtetuese dhe te punonjesve te shtetit”, te ndryshuar”.</i>
17	Ankesa të punonjësve të policisë së burgjeve	Rekomandim:“Për përshpejtimin e procedurave për miratimin e VKM për trajtimin e të gjitha strukturave të Policisë së Burgjeve sipas nenit 12 të Ligjit Nr. 8321 datë 02.04.1998 “Për Policinë e Burgjeve”.	Ministrit të Drejtësisë	22.12.2004	Rekomandimi u pranua. Ministria e Drejtësisë ka çuar në K.M, dy projekt vendime që janë miratuar.
18	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për marrjen e të gjitha masave në bashkëpunim dhe me institucionet e tjera qendrore, për dhënien e tokës bujqësore në pronësi në bazë të Ligjit Nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” subjekteve që ende nuk kishin marrë ose nuk janë plotësuar me tokë në pronësi”.	Ministrit të Bujqësisë. Kryeministrit	09.03.2005	Rekomandimi u pranua. Ka dalë VKM Nr.291 datë 06.05.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 230 datë 22.07.1991 “Për krijimin e Komisionit të Tokave” në fshatra të cilat shqyrtojnë mosmarrëveshjet dhe konfliktet brënda fshatit, që kanë lindur në vijimësi të procesit të ndarjes së tokës dhe që në kohën e shqyrtimit nuk kanë marrë zgjidhje ligjore”.
19	Ankesa e shtetasit B.K.	Rekomandim: “Për përshpejtimin e procedurave lidhur me funksionimin e Komisionit Shtetëror Trepalësh, si dhe për nxjerrjen e akteve nënligjore për ish të përndjekurit politikë”.	Kryeministrit.	24.03.2005 Përsëritur në datën 02.11.2005	Rekomandimi nuk ka përgjigje.

20	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për rritjen e transparencës dhe zbatimin e Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” duke përgatitur një Rregullore tip”.	Kryeministrit.	12.10.2005	Në parim u pranua. Më konkretisht shif nr.38 tek Pasqyra nr.3
21	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për përgatitjen e akteve të reja nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 9380 datë 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera të lidhura me të”.	Ministrit të Financave Ministrit Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve.	18.10.2005	Rekomandimi u pranua. <i>Ne zbatim te Ligjit nr.9380 date 28.04.2005 “Per te drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te”, ka dale VKM nr.343 date 6.06.2007 “Per miratimin e tarifave te sherbimit qe ofron zyra shqiptare per te drejtat e autorit”.</i>
22	Ankesa e shtetasit A.K.	Rekomandim: “Për përgatitjen e akteve të reja nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 9267 datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigu-rimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.	Ministrit të Financave. Këshillit të Ministrave Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve.	18.11.2005	Rekomandimi u pranua. Është përgatitur projektvendimi “Për kriteret e liçencimit të dëmeve në sigurime”.
23	Ankesa të shumta	Rekomandim: “Për situatën e çmimeve të operatorëve të telefonisë së lëvizshme dhe propozimi për miratimin sa më parë të Metodologjisë së caktimit të tarifave nga ERT”.	Entit Rregullator të Telekomunikacionit	25.11.2005	Rekomandimi është pranuar. Aktualisht projekti i Metodologjisë i ka kaluar për miratim Këshillit të Ministrave.
24	Ankesa e shtetasit P. S. etj.	Rekomandim: “Kërkohej përsheptimi i procedurave për ndryshimin e VKM Nr. 146 datë 26.02.1998 “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”.	Ministrit të Arsimit. Financave dhe Punëve	2005	Rekomandimi është pranuar. VKM nr.146 date 26.02.1998, është ndryshuar me hyrjen në fuqi te VKM nr.166 date

			Publike.		7.02.2007.
25	Me inisiativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.9389, datë 04.05.2005 <i>“Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues të Gjakmarrjes”</i> ”	Kryeministrit.	02.02.2006 Përsëritur 2007	Rekomandimi është pranuar, por deri tani nuk janë nxjerrë aktet nënligjore.
26	Ankesa të shtetasve dhe organizatave joqeveritare të të drejtave të njeriut	Kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të 1. V.K.M. nr.43, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës publike”. 2. V.K.M. nr.44, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike”. 3. V.K.M. nr.48, datë 27.01.2006 “Për disa shtesa në vendimin nr.205 datë 13.04.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”	Gjykatës Kushtetuese	09.02.2006	Pranuar. Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.20 datë 11.07.2006 vendosi shfuqizimin e tre vendimeve të Qeverisë.
27.	Ankesa nga shtetas të ndryshëm	Rekomandim për përgatitjen e projektvendimit të Qeverisë për zbatimin e neneve 8, 9, 10 dhe 11 të ligjit nr.8661, datë 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”	Kryeministrit Ministrit të Brendshëm	03.03.2006	Rekomandimi është pranuar. <i>Eshtë përgatitur projekt vendimi dhe është dërguar për miratim në Qeveri dy here dhe është kthyer për t’u ripunuar për shkak të kostos financiare. Në këtë projektvendim janë përfshirë edhe ndryshimet e VKM nr.552 dt. 27.11.1999 “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjareve të punonjësve të policisë të vrarë e plagosur për shkak të detyrës”, të propozuara</i>

					<i>nga ana jone.</i>
28	Shoqata e Talasemikëve të Shqipërisë.	Rekomandim: “ Për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 8032 datë 16.01.1995 “Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollit të gjakute produkteve të tij dhe transplantimeve”.	Ministrit të Shëndetësisë.	13.03.2006	Rekomandimi është pranuar, është miratuar strategjia për gjak të sigurtë.
29	Ankesa të shtetasve	Rekomandim për hartimin dhe paraqitjen për miratim të projekt vendimit të Qeverisë, për vënien në zbatim të nenit 51 të ligjit nr.9135 datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorit”.	Ministrit të Ekonomisë	20.03.2006	Rekomandimi është pranuar. <i>Eshte miratuar nga Kuvendi dhe ka hyre ne fuqi ligji nr.9683 dt.28.01.2008 “Per ushqimin”, pjese e te cilit eshte edhe mbi-kqyrja e tregut.</i>
30	Ankesa nga shtetas të ndryshëm	Rekomandim: “Per aktet nënligjore te Ligjit Nr. 9232 date 13.05.2004 “Per programet sociale per strehimin e banoreve te zonave urbane”.	Ministrit te Puneve Publike, Transportit e Telekomunikacioneve	29.03.2006	Rekomandimi u pranua.
31	Me iniciativën e Avokatit të Popullit.	Rekomandim: “ Për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.9110, datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Për Krime të Rënda”.	Kryeministrit. Ministrit të Drejtësisë	24.05.2006	Rekomandimi u pranua. <i>Ne date 5.03.2007, eshte kthyer pergjigje se Drejtoria e Kodifikimit ne Ministrine e Drejtësisë po përgatit kuadrin e nevojshëm ligjor per kete problem.</i>
32	Ankesa nga ushtarakët	Rekomandim për plotësimin e kërkesave të nenit 39 të Ligjit nr.9210 datë 23.03.2004 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” për kriteret e përfitimit nga ushtarakët të së drejtës së parablerjes për	Ministrit të Mbrojtjes	30.05.2006	Ministria e Mbrojtjes e pranoi rekomandimin, por nuk janë dakort ministritë e tjera. <i>Rekomandimi do te dergohet perseri duke kerkuar qe ndryshimi ne ligj te hyje ne fuqi pas per-</i>

		objektet ushtarake të dala të lira.			<i>fundimit te procesit te kthimit dhe kompensimit te pronave.</i>
33	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për shfuqizimin e Pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 87, datë 15.02.2006 “Për administrimin dhe mbulimin e shpenzimeve të recetave me rimbursim”	Kryeministrit. Ministrit të Financave, Ministrit të Shëndetësisë	21.12.2006	<i>Rekomandimi është pranuar pjesërisht, tarifa e recetes është hequr vetëm për një kategori të caktuar personash, me VKM nr.727 dt.30.10.2007.</i>
34	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet hartimi dhe paraqitja per miratim prane Keshillit te Ministrave te projektvendimit mbi kriteret licensuese te eksperteve te demeve, si detyrim qe buron nga neni 89 i Ligjit nr.9267 dt.29.07.2004 “Per veprimtarine e sigurimit, te risigurimit dhe ndermjetesimit ne sigurime dhe risigurime”</i>	<i>Kryeministrit. Kryetares se Agjencise se Mbikqyrjes Financiare.</i>	13.03.2007	<i>Rekomandimi u pranua. Ne muajin Dhjetor 2007 projektvendimi eshte depozituar prane Keshillit te Ministrave dhe pritet te miratohet.</i>
35	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet marrja e masave te menjehereshme per botimin ne Fletoren Zyrtare te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.565 dt. 9.08.2006 “Per mbrojtjen e shtresave ne nevojë nga rritja e çmimit te energjise elektrike”.</i>	<i>Kryeministrit. Ministrit te Financave. Ministrit te Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta</i>	17.07.2007	<i>Rekomandimi eshte pranuar. VKM nr.565 dt.9.08.2006 u botua ne Fletoren Zyrtare Nr.Ekstra 25, faqe 3, Viti 2007.</i>
36	<i>Me iniciative te Avokatit te</i>	<i>Rekomandohet plotesimi i kerkesave te nenit 401 te Kodit Detar te Republikes se Shqiperise, per</i>	<i>Ministrit te Puneve Publike, Transporteve dhe Telekomunik</i>	31.07.2007	<i>Rekomandimi eshte pranuar ne parim. Nga ana e Ministrise se</i>

	<i>Popullit</i>	<i>hartimin dhe kalimin per miratim ne Keshillin e Ministrave te disa vendimeve te veçanta me karakter nderministerial.</i>	<i>acionit. Ministrit te Financave. Ministrit te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave.</i>		<i>Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave po hartohen drafte ne lidhje me ndotjen ne hapesiren detare.</i>
--	-----------------	---	--	--	--

Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime për aktet nënligjore të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore për periudhën 2000-2007

Nr	Ankuesi	Permbajtja e rekomandimit	Kujt i drejtohet	Data e dergimit	Përfundimi
1	Subjekte private të qytetit të Korçës	Rekomandim: “Për shfuqizimin e Pikës 4 të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 362 datë 18.08.2000 “Mbi zbatimin e detyrave për dhënien e lejës higjeno-sanitare”.	Ministrit të Shëndetësisë	27.09.2000	Rekomandimi u pranua.
2	Ankesat e një numri të konsiderueshëm qytetarësh.	Rekomandim: “ Për masat që duhen marrë për zbatimin e Ligjit Nr. 8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, me qëllim që çdo autoritet publik të nxjerrë rregullore.	Kryeministrit. Çdo ministri edhe institucioni qendror, çdo organi të pushtetit vendor	09.11.2000 Përsëritur datë 24.01.2002	Rekomandimi është pranuar pothuajse nga të gjitha ministratë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor.
3	Shtetasi R. R. në emër të 49 familjeve nga Tirana.	Rekomandim: “ Mbi problemin e 49 familjeve të shpronësuara nga Ujëmbledhësi i Bovillës me qëllim që projektvendimi i paraqitur të dërgohet sa më parë për shqyrtim në Këshillin e Ministrave”.	Ministrit të Punëve Publike	27.09.2000	Kthyer përgjigje pozitive më datën 19.02.2001. Por megjithatë problemi nuk është zgjidhur me ndonjë akt nënligjor, por me vendime gjyqate
4	Ankesa të studentëve pasuniversitarë	Rekomandim për rivendosjen e së drejtës së shkelur në lidhje me tarifat e regjistrimit për specializim pasuniversitar	Ministrit të Arsimit	12.01.2001	Pranuar. Ministri i Arsimit u përgjigj se do të ndryshojë Udhëzimin

					përkatës
5	Ankesa të shtetasve	Rekomandim për ndryshimin në Udhëzimin nr.39 datë 31.03.1999 të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë	Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë	15.02.2001	Rekomandimi u pranua
6	Ankesa nga ushtarakët	Rekomandim: “Për një ndryshim në VKM Nr. 379 datë 26.06.1995 “Për privatizimin e objekteve që dalin të lira nga ristrukturimi”	Ministrit të Mbrojtjes	13.04.2001	Pranuar dhe kanë dalë VKM Nr. 524 datë 30.07.2004 dhe VKM Nr. 452 datë 09.07.2004 “Për marrje kredi me interes”.
7	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për nxjerrjen e një udhëzimi të përbashkët, për mbajtjen e proces verbaleve të kallëzimit përsonave të keqtrajtuar nga policia jashtë shtetit”.	Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Rendit Publik	03.07.2001	Rekomandimi u pranua. Doli Udhëzimi i Përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm dhe i Ministrit të Rendit Publik Nr. 2037 dhe 1210 datë 23.07.2001
8	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “ Për marrjen e masave dhe nxjerrjen e udhëzimeve që përcakton V.K.M. Nr. 335 datë 20.06.1998 “Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit”.	Ministrit të Drejtësisë. Ministrit të Financave	19.11.2001	Rekomandimi është pranuar nga Ministria e Financave, por nuk është vepruar nga Ministria e Drejtësisë
9	Ankesa të të dënuarve	Rekomandim: “ Për plotësimin e kërkesave të Ligjit Nr. 8092 datë 03.02.1996 “Për shëndetin mendor”, për të nxjerrë rregulloren “Për masat e sigurimit të personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjekësore të mjekimit të detyruar”.	Ministrit të Shëndetësisë Ministrit të Drejtësisë	13.05.2002	Rekomandimi është pranuar. U krijua Instituti për kurimin e të dënuarve me trauma psikike e përdoruesve të drogës në Krujë.
		Rekomandim: “Për krijimin e kushteve për funksionimin e Komisionit Mbikqyrës të Ekzekutimit të	Kryeministrit Ministrit të		Rekomandimi është pranuar. Është ngritur, por

10	Ankesa të të dënuarve	Vendimeve me Burgim, sipas kreut të tretë të Ligjit Nr. 8331 datë 21.04.1994 <i>“Për ekzekutimin e vendimeve penale”</i> .	Drejtësisë,	11.11.2002	nuk funksionon në vazhdimësi. Komisioni Mbikqyrës.
11	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: <i>“Për rritjen e objektivitetit të ekspertimeve mjeko-ligjore, në rastet e vdekjeve të shtetasve kur dyshohet se janë dhunuar nga punonjës policie apo nëpunës të shtetit”</i> .	Instituti të Mjekësisë Ligjore.	16.01.2003	Rekomandimi u pranua. Doli Udhëzimi Nr. 22 datë 27.01.2003, i cili udhëzon kryerjen e ekspertimit me grup ekspertësh ku njëri duhet të jetë patjetër nga Instituti i Mjekësisë–Ligjore.
12	Ankesa e policit Q.H.	Rekomandim: <i>“ Për përmirësimin e Urdhërit Nr. 1661 datë 08.04.2002 “Për komunikimin me media”</i> .	Ministrit të Rendit Publik	28.05.2003	Rekomandimi u pranua në parim, por nuk u ndryshua
13	Pas një inspektimi në Spitalin psikiatrik Tiranë	Rekomandim për zbatimin e nenit 23 të ligjit nr.8092 datë 03.02.1996 <i>“Për shëndetin mendor”</i> në spitalin psikiatrik Tiranë për të nxjerrë një rregullore për komisionin që për ligj masat e kufizimit fizik	Ministrit të Shëndetësisë	13.06.2003 Përsëritur 2007	Rekomandimi pa përgjigje
14	Ankesa të punonjësve të policisë	Rekomandim: <i>“ Për ndryshimin e urdhërit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 1484 datë 18.06.2001, pika 14 dhe urdhër shërbimit Nr. 1172 datë 04.04.2003 të Drejtorit të Policisë së Shtetit pika 8, duke zgjatur afatin e pranimit të ankesave të punonjësve të policisë për gradat deri më 31.12.2004”</i> .	Ministrit të Rendit Publik	16.12.2003	Rekomandimi u pranua më datën 20.01.2004.
15	Ankesa të shtetasve.	Rekomandim: <i>“ Të rishikohen për ulje tarifat e shitjes së energjisë elektrike të miratura me vendimin e E.R.E Nr. 22 datë 30.12.2003”</i> .	Entit Rregullator të Energjisë	12.02.2004	Rekomandimi u pranua. U ulën pjesërisht tarifat e energjisë elektrike.

16	Ankesa e shtetasit A.T.	Rekomandim: “Për revokimin e Urdhërit Nr. 191 datë 22.04.2002 dhe për mospërfshirjen në përbërje të Komisionit Qëndror të Përmirësimit Racor (KQPR-së) të antarëve të subjekteve të tjera konkurrese”	Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit	12.10.2004	Rekomandimi u pranua. Revokuar me Urdhërin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit Nr. 223 datë 12.05.2005
17	Me iniciativë të Avokatit të Popullit (Pas inspektimit në dhomat e paraburgimit Berat)	Rekomandim: “Për shfuqizimin e rregullore “Për sigurimin dhe trajtimin e të paraburgosurve” miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Nr. 1075/2 datë 15.09.1999 dhe urdhërimin për zbatimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Sistemit të Paraburgimit”, miratuar me urdhër të Ministrit të Dretjesisë Nr. 3750/2 datë 23.07.2003”	Ministrit të Drejtësisë dhe të Rendit Publik	29.03.2005	Rekomandimi u pranua. Kthyer përgjigje se është përgatitur drafti i rregullore ku janë marrë në konsideratë të gjitha vërejtjet e Avokatit të Popullit
18	Ankesa e shtetasit B.V.	Rekomandim: “Për shfuqizimin e një pjese të Urdhërit Nr. 110 datë 20.04.2004 të Ministrit të Industrisë dhe Energjitikës “Mbi miratimin e strukturës së Policisë Elektrike”	Ministrit të Industrisë dhe Energjitikës. Për dijeni Kryeministrit.	31.03.2005	Nuk është kthyer përgjigje zyrtare.
19	Ankesa e shtetasit L.D.	Rekomandim: “Për bërjen e ndryshimeve në rregulloren e Institutit të Policisë Shkencore, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 751 datë 16.01.2003, duke parashikuar që në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të rënda në ambjentet e policisë ose jashtë saj, por që kanë si autorë të dyshuar punonjës policie, në kqyrjen e vëndit të ngjarjes dhe në kryerjen e veprimeve ekzaminuese të marrin pjesë dhe ekspertë privatë të specialiteteve përkatëse”.	Ministrit të Rendit Publik	30.05.2005	Rekomandimi u pranua në parim. Datë 16.02.2006 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit sugjeron që t’i drejtohem Prokurorit të Përgjithshëm.

20	Ankesa e shtetasit L.D. Pas vetvrasjes së shtetasit A. D. në Komisarjatin e Policisë Nr. 4 Tiranë.	Rekomandim: “Për shfuqizimin e udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 168 datë 20.10.1993 “Për rregullat e shoqërimit të shtetasve në Komisarjate, Reparte, Posta të Policisë dhe Zyra të tjera të tyre” si dhe për përgatitjen, miratimin dhe vënien në zbatim të Rregullores së re të shoqërimit të shtetasve në zyrat e policisë	Ministrit të Rendit Publik	28.06.2005	Rekomandimi u pranua. Me urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 1749 datë 29.07.2005, u bë shfuqizimi i urdhërit të mësipërm dhe u miratua Rregullorja e Policisë së Shtetit.
21	Ankesa e shtetasit A. B.	Rekomandim: “Kërkohej shfuqizimi i nenit 10 paragrafi i tretë i Rregullores së Fakultetit Histori Filologji të Universitetit të Tiranës”	Fakultetit Histori Filologji. Rektorit të Universitetit të Tiranës.	30.06.2005	Rekomandimi u pranua. Është shfuqizuar paragrafi i tretë i nenit 10 të Rregullores.
22	Ankesa e të dënuarve Z.F. dhe Gj.R. në Burgun e Burrelit.	Rekomandim: “Për rregullimin çështjes së uljes së dënimit për të dënuarit që punojnë në burgje dhe marrja e masave për korrigjimin e pasojave të aktit të nxjerrë nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 3223 datë 08.10.2004, dërguar Prokurorive në rrethe”.	Ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm	22.09.2005	Rekomandimi nuk u pranua nga Prokurori i Përgjithshëm. dhe Ministri i Drejtësisë.
23	Me iniciativën e Avokatit të Popullit. Vetvrasja e shtetasit A.B. në Komisarjatin e Policisë Nr. 3, Tiranë.	Rekomandim: “Për ndryshimin dhe përmirësimin e Kreut XII-të “shoqërimi i personave” të Rregullores së Shërbimeve të Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 1749 datë 29.07.2005, si dhe për hartimin e Metodikës së njoftimit të akuzës dhe marrjes në	Ministrit të Brëndshëm.	22.12.2005	Rekomandimi u pranua në parim pjesërisht, në pikat e propozuara me shkresën e datës 20.02.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. <i>Meqenese kjo rregullore ishte nxjerre ne baze e per zbatim te</i>

		pyetje të personave që dyshohen si autorë të veprave penale, ose që kanë dijeni për rrethana të hetimit”.			<i>ligjit nr.8553 dt. 25.11.1999 “Per Policine e Shtetit”, i cili eshte shfuqizuar me ligjin nr.9749 dt.4.06.2007 “Per Policine e shtetit”, ne kuadrin e implemtimit te MSA po per-gatitet “Manuali i proce-durave te punonjesve te Policise te Shtetit”.</i>
24	Ankesa e shtetases L. G. etj.	Rekomandim: “Për dispozitat e reja normative që do të miratohen, për një mbrojtje sa më të mirë si të të drejtave të personelit që kujdeset për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të drejtave të vetë fëmijve”.	Ministrit të Arsimit.	17.01.2006	Rekomandimi u pranua në parim. Është në proces rishikimi i dispozitave normative.
25	Ankesa e shtetases E.S.	Rekomandim: “Per shpejtimin e punes per har-timin e marreveshjes shqiptaro–greke, per perfi-timin e sigurimeve shoqerore nga shtetasit e te dy vendeve”	Ministrit te Pu-nes e Çeshtjeve Sociale Ministrit te Pu-neve te Jashtme Drejtorit te ISSH	15.02.2006	Ka përgjigje zyrtare nga Ministri i Punës. Po punohet në këtë drejtim.
26	Me iniciativen e Avokatit te Popullit	Rekomandim: “Per pershejtimin e proçedurave per nxjerrjen e akteve nenligjore ne zbatim te Ligjit Nr. 9381 date 28.04.2005 “Per kompesimin per burgim te padrejte”.	Ministrit te Financave Ministrit te Drejtesise	27.03.2006	Rekomandimi u pranua dhe eshte perpiluar udhezimi i perbashket.
27	Ankesa të shtetasve dhe organizatave joqeveritare	Rekomandim për mospranimin e propozimit të KESH sha për rritjen e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë	Entit Rregullator të Energjisë	03.04.2006	E.R.E. me vendimin nr.27 datë 20.04.2006 nuk pranoi rritjen e

					çmimeve
28	Me iniciativen e Avokatit te Popullit	Rekomandim: “Per permiresimin e akteve nenligjore te perbashketa per kqyrjen e vendit te ngjarjes ne ambjentet e Komisariateve te Policise, paraburgimit dhe ne burgje”.	Ministrit te Brendshem Prokurorit te Pergjithshem	07.04.2006	Rekomandimi u pranua.
29	Ankesa të të dënuarve	Rekomandim: “Per konstatimin si akt administrativ absolutisht te pavlefshem te Urdherit te Drejtorit te Pergjithshem te Burgjeve Nr. 1522 te vitit 2006 “Per organizimin dhe kryerjen e takimeve speciale”.	Ministrit te Drejtesise Kryeministrit	20.04.2006	Rekomandimi u pranua pjesërisht.
30	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Per rishikimin e Udhezimit Nr. 6291 date 17.08.2005 “Per Evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve noteriale si dhe per organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”.	Ministrit te Drejtesise Dhomes Kombetare te Noterise	12.05.2006	Rekomandimi u pranua pjesërisht
31	Me iniciativen e Avokatit te Popullit.	Rekomandim: “Per krijimin e kushteve te nevojshme Per funksionimin e Komisionit te Sherbimit Alternativ”.	Ministrit te Punes e Çeshtjeve Sociale. Ministrit te Mbrojtjes	26.09.2006	Rekomandimi u pranua. Janë krijuar kushtet
32	Ankesa të Mjekëve	Rekomandim: “Per hartimin dhe nxjerrjen e rregullores Per funksionimin e Qendres Spitalore Universitare “Nene Tereza” Tirane.	Ministrit te Shendetesise, Ministrit te Arsimit	13.10.2006	Rekomandimi u pranua. Hartimi i rregullores eshte ne fazen perfundimtare, draft-teksti i rregullores i eshte shprendare per mendim drej-

					<i>torive te QSUT “Nene Tereza”.</i>
33	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet permiresimi i sherbimeve dhe vendosja e tarifave te reja ndaj kompanive te sigurimit per mbulimin e transportit te mjeteve motorike ne rast aksidenti</i>	<i>Agjencise se Mbikqyrjes Financiare</i>	21.03.2007	<i>Rekomandimi eshte pranuar. Eshte miratuar nje vendim i AMF-se per menyren e trajtimit te demeve nga aksidentet ku jane pasqyruar disa detyrime te reja qe duhet te respektojne kompanite private ne fushen e sigurimeve.</i>
34	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet marrja e masave per te vendosur ne pozita te ligjshme veprimtarine e KESH sh.a, ne kuader te permiresimit te menyres se matjes se konsumit te energjise elektrike, sepse ka përfunduar afati i aplokimit të faturimit afrofe.</i>	<i>Entit Rregullator te Energjise. KESH sh.a</i>	20.04.2007	<i>Rekomandimi eshte pranuar. Eshte nxjerre vendim per te shtyre afatin e vendosjes se mate-save. Ndersa per zbatimin e faturimit afrofe pa vendim te ERE, KESH sh.a i eshte vendosur gjobe.</i>
35	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit dhe ne bashkepunim me USAID dhe ISPL</i>	<i>Rekomandohet miratimi i rregullores tip “Per shqyrtimin e ankimeve administrative (RTAA)”</i>	<i>Gjithe organeve te Administrates Publike.</i>	5.06.2007	<i>Rekomandimi eshte pranuar dhe pjesa me e madhe e organeve te administrates publike, e ka miratuar kete draft te propozuar nga ne si rregullore te brendshme.</i>

36	<i>Me ankese te Dhomes se Tregtise se Tregtise se Bajram Currit.</i>	<i>Rekomandohet marrja e masave per lejimin e transportit te mallrave nepermjet doganes ne piken kufitare te Qafe Morines, Tropoje, si veprim qe nxit zhvillimin ekonomik dhe lehteson shkembimet tregtare te banoreve te zones.</i>	<i>Kryeminsitrit Ministrit te Financave</i>	29.06.2007	<i>Rekomandimi eshte pranuar. Ne baze te VKM nr.19 dt.19.01.2007, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave emeroi punonjesit e sherbimit doganor ne Qafe Morine.</i>
37	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet marrja e masave per shpalljen e menjehershme ne publik te grafikut te kufizimeve te energjise elektrike ndaj klienteve familjare dhe jofamiljare</i>	<i>ERE KESH sh.a</i>	13.07.2007	<i>Rekomandimi eshte pranuar. KESH sh.a ka kryer publikimin e te gjitha orareve te kufizimeve me ane te njoftimeve te vecanta.</i>
38	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit dhe ne bashkepunim me USAID dhe ISPL</i>	<i>Rekomandohet miratimi i rregullores tip "Per te drejten e informimit"</i>	<i>Gjithe organeve te Administrates Publike.</i>	16.07.2007	<i>Rekomandimi eshte pranuar dhe pjesa me e madhe e organeve te administrates publike, e ka miratuar kete draft te propozuar nga ne si rregullore te brendshme.</i>
39	<i>Ankesa e shtetasit H.P</i>	<i>Rekomandohet eliminimi i parregullsive te aktit administrativ, Rregullore "Per kriteret mjekesore per vleresimin e personave me aftesi te kufizuar", miratuar me urdherin e perbashket te Ministrit te Shendetesise dhe Ministrit te Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, nr.276 date 8.02.2007.</i>	<i>Ministrit te Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta Ministrit te Shendetesise</i>	26.07.2007	<i>Rekomandimi nuk eshte pranuar.</i>

40	<i>Me ankese te nje shtetasi</i>	<i>Rekomandohet marrja e masave te menjehershme per rikthimin ne pozita ligjore te gjendjes se krijuar nga levizja e kuadrit ne sektorin e auditit</i>	<i>Drejtorise se Pergjithshme te Rezervave te Shtetit</i>	30.10.2007	<i>Rekomandimi eshte pranuar. Drejtorise se Pergjithshme te Rezervave te Shtetit, ka nxjerre urdherin per rregullimin e organikes se stafit te auditit te brendshem.</i>
----	----------------------------------	--	---	------------	--

2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit ("ex officio")

Sipas nenit 13 të Ligjit nr.8454, dt.4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005, Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit.

Në rastet kur Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur apo i paaftë mendërisht apo me aftësi të kufizuara ose për mbrojtjen e të drejtave të një numri të madh të individëve.

Në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjërë, të cilët mund të preken nga procedimi administrativ, Avokati i Popullit ka të drejtë të fillojë një procedim administrativ dhe të marrë pjesë në të, në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative.

Këto ndryshime kanë hyrë në fuqi me 1 Korrik 2005.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar totali i çështjeve të filluara me iniciativë gjatë vitit 2006 dhe 2007.

	2006	2007
- Ankesa të drejta ose zgjidhur në favor	22	15
- Jashtë kompetence ose juriksionit	3	2
- Të refuzuara për shkak se nuk u bënë ankesa individuale sipas ligjit, ose gjatë shqyrtimit u tërhoqën, ose në përfundim doli se ankesa ishte e padrejtë apo e pavërtetë	2	2
- Në shqyrtim	8	7
Totali	35	26

ANEKSE

1. Letra falenderimi nga qytetarët dhe vlerësime të institucioneve

Letra falenderimi nga qytetarët

Avokatit të Popullit

1.

Ju njoftoj se falë sensibilitetit në trajtimin e çështjes nga ana juaj, problemi im është zgjidhur në favorin tim. Kjo më bën t`ju uroj dhe falenderoj nga zemra që më jeni gjendur pranë dhe keni marrë pjesë në shqetësimin tim si nënë që më në fund jam e qetë në shtëpinë time bashkë me vajzat.

Ju uroj suksese me punën tuaj, në këtë mision fisnik për të mirën e njerëzve.

26.03.2007

Me respekt
Elvira Mitrushi

Avokatit të Popullit

2.

Po ju drejtohem ju për t`ju falenderuar si drejtues i këtij institucioni që me sinqeritet, devotshmëri dhe ndershmëri mundoheni të zgjidhni hallet dhe problemet e qytetarëve kur ata kanë të drejtë.

Gjithashtu falenderojmë shumë juristin e institucionit tuaj, Z.Fredi Paskali që me shumë durim e punë të pa lodhur arriti te zgjidhë problemin tonë (heqjen e masës së pezullimit mbi pronën tonë) që organet përkatëse padrejtësisht e refuzonin.

15.05.2007

Me respekt
Shirin Morina

Avokatit të Popullit

3.

Ju falenderoj unë babai i dy vajzave invalide nga Gramshi, Aishe dhe Sidorela Pëllumbi. Ankesa që unë bëra për përfitimin e statusit të invalidëve paraplegjik gjeti rrugëzgjidhje të plotë. Të dyja vajzat janë pajisur me statusin e invaliditetit. Për këtë ju falenderoj dhe ju përgëzoj për punën që bëtë për ndjekjen dhe zbatimin e ligjshmërisë.

05.07.2007

Me nderime e respekt
Ason Pëllumbi

Avokatit të Popullit

4.

Në datën 05.10.2007, kam paraqitur ankesë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit me anë të së cilës kam kërkuar ndërhyrjen tuaj pranë Institucionit ku unë punoj për rikthimin tim në vendin e mëparshëm të punës si audit, pasi ish drejtuesi i Institucionit Z.Ahmet Omi pa asnjë shkak dhe pa respektuar ligjin Për Auditin, më kishte kaluar në një detyrë të një niveli më të ulët.

Rekomanimet e dërguara nga ana juaj me shkresën nr K3/A 109-2 Prot, datë 30.10.2007, për çështjen e ngritur në ankesë, u vlerësuan nga titullari i Institucionit të Drejtorisë së Rezervave të Shtetit z.Hysen Arapi, i cili më riktheu në vendin e punës si audit. Një falenderim të vecantë për punonjësin tuaj juristin Ervin Karamuçë, i cili mori çështjen në shqyrtim dhe me etikën e tij profesionale bëri të mundur që nëpërmjet argumentave të më rivihejshin në vend të drejtat që më ishin cënuar.

15.11.2007

Me respekt
Arjan Abazi

Vlerësime nga institucionet:

1. Lidhshipi shqiptar '07 i ka dhënë Çmimin për komponentin “Qeverisje” Institucionit të Avokatit të Popullit me këtë motivacion:

Institucioni i “Avokatit të Popullit”, është afirmuar tashmë si një domosdoshmëri e shoqërisë shqiptare, për mbrojtjen e interesave të qytetarëve, subjekteve private dhe institucioneve të pavarura, dhe mbi të gjitha për konsolidimin e demokracisë. “Avokati i Popullit” ka diktuar drejt zgjidhjes mjaft raste të relatimit të çështjeve problematike që i janë adresuar, duke ndikuar vendim-marrjen apo korrigjimin e tyre nga institucionet publike, përmes akteve të ndryshme administrative dhe juridike.

Drejtor Ekzekutiv
Dritan Shutina

2. Falenderim për bashkëpunimin e deritanishëm

I nderuar Zoti Dobjani,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin institucional të deritanishëm, me rastin e largimit nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, më lejoni t'ju shpreh mirënjohjen time të sinqertë.

E vlerësoj këtë bashkëpunim, si një kontribut të përbashkët për forcimin e shtetit ligjor dhe të institucioneve të tij, sigurimin e rendit e të qetësisë publike, konsolidimin e institucionit të Policisë së Shtetit në shërbim të komunitetit dhe për garantimin e zbatimit të ligjit.

Dëshiroj që ky bashkëpunim të vazhdojë me intensitet akoma më të lartë edhe me Zotin Ahmet Prençi, i cili është emeruar në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Me konsideratën më të lartë

Drejtori i Përgjithshëm
Bajram Ibraj

MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2007

Nr	ORGANI	DATA	RUBRIKA	PASQYRIMI
1	Klan, TVA	07.01.2007	AP kerkon heqjen e tarifes 100 lekeshe per recetat	Prononcim, E. Dobjani
2	Vizion+	10.10.2007	AP - rekomandim Kryeministrit per krizen ne KESH	Prononcim A. Lazebeu
3	Klan, TVA	11.01.2007	AP kerkon plotesimin e ligjit per llogaritjen e pensioneve	Prononcim, E. Dobjani
4	Top Channel, Alsat	11.01.2007	AP kerkon masa per pergjegjesit e krizes ne KESH	Prononcim A. Lazebeu
5	Klan, TVA	15.01.2007	AP kerkon heqjen e tarifes 100-lekeshe per ilaçet	Prononcim E. Dobjani
6	News 24	21.01.2007	AP ne analizen vjetore te Policise se Shtetit	Njoftim
7	TVA	21.01.2007	AP denon dhunen e policise	Njoftim
8	Klan, TVA	23.01.2007	AP denon perdorimin e femijeve ne fushata elektorale	Prononcim, E. Dobjani
9	Top Channel	05.02.2007	AP kerkon mosperjashtimin e votuesve nga listat	Prononcim, E. Dobjani
10	TV Koha, Klan	10.02.2007	AP per denimin me vdekje	Prononcim, E. Karamuça
11	News 24	15.02.2007	AP kerkon te drejten e votes per te burgosurit	Njoftim
12	TVA	19.02.2007	AP: Ja perse nuk votuan te burgosurit	Prononcim, S. Haluci
13	OraNews	23.02.2007	AP: Te burgosurit duhet te kishin votuar	Prononcim, A. Lazebeu
14	Top Channel	28.02.2007	AP mbi denimin me vdekje	Emision, S. Haluci
15	News 24	02.03.2007	AP per Ligjin "Per gjendjen civile"	Emision, S. Nushi
16	Top Channel, Klan, TVSH, TVA, News 24, TV Koha etj	07.03.2007	AP raporton para Komisionit Parlamentar te Ligeve	Njoftim
17	TVA, Top News	15.03.2007	AP kerkon heqjen e denimit me vdekje nga Kodi Penal edhe per gjendje lufte	Prononcim. E. Karamuca
18	ALSAT	16.03.2007	AP dhe problematika e Raportit Vjetor ne "Dita fillon ne Alsat"	Interviste. E. Dobjani

19	News 24	15.03.2007	Me zemer te hapur	Emision, H. Hysa
20	News 24	20.03.2007	Zemerhapur me ankuesin	Emision, H. Hysa
21	Ora news	22.03.2007	Heqja e denimit me vdekje nga Kodi Penal Ushtarak	Prononcim, E. Dobjani
22	Top Channel	29.03.2007	AP dhe Ligji per Trajtimin e Vrasjeve per Gjakmarrje	Emisioni Top Show, A. Lazebeu
23	ALSAT	02.04.2007	AP inspekton burgun e Tepelenes	Prononcim, S. Haluci
24	Vizion +	03.04.2007	AP dhe Ligji per Hipotekat	Emision, E. Pirani
25	News 24	03.04.2007	AP dhe regjistrimet e femijeve shqiptare qe lindin jashte shtetit	Emision, S. Nushi
26	News 24	04.04.2007	AP per çeshtje te pronave dhe privatizimit	Emision, H. Hysa
27	News 24	05.04.2007	AP per vendimet gjyqsore per çeshtje te pronesise	Emision, H. Hysa
28	Ora news	13.04.2007	AP dhe abuzimet ne KESH	Prononcim. E. Karamuca
29	Top Channel	18.04.2007	AP denoncon dhunen ne burgje	Prononcim. S. Haluci
30	TVA	20.04.2007	AP per dhunen ne burgjet shqiptare	Prononcim. S. Haluci
31	TV Skutari, TV Kopliku, TV Lezha	23.04.2007	AP pret ankesa ne Veri	Prononcim , G.Lleshi
32	Vizion +	24.04.2007	AP per dhunen ne familje	Emision. E.Kalaja
33	Onufri TV	24.04.2007	AP zbret ne Berat per dite te hapur	Interviste. A. Lazebeu
34	Top Channel, TV Dardan	24.04.2007	AP ne qytetin e Elbasanit	Prononcim J. Dhrami
35	Radio Tirana	26.04.2007	AP dhe bashkatdhetaret	Emision, A. Lazebeu
36	Zeri i Amerikes	05.05.2007	Perfaqesues te AP-se ne Washington	Interviste. A. Lazebeu, A. Jaupi
37	News 24	07.05.2007	AP per te drejtat e femijeve	Emision. F. Paskali
38	TVSH, TV Saranda	08.05.2007	AP pret ankuesit ne Sarande	Prononcim, G. Lleshi
39	TV2A	08.05.2007	AP ne Bashkine e Kavajes	Prononcim, A. Jaupi

40	Top Channel, TV Gjirokastra, BBC	09.05.2007	Grupi i AP-se ne Gjirokaster	Prononcim, E. Karamuça
41	TV Klaudiana	10.05.2007	AP ne Bashkine e Peqinit dhe Rrogozhines	Prononcim, A. Lazebeu
42	Radion Tirana	15.05.2007	AP bashkebisedon me bashkatdhetaret	Emision, E. Karamuca
43	TV Lushnje, TV Fier	22.05.2007	AP ne rrethin e Lushjes dhe Fierit	Prononcim, R. Poda
44	TV Puka, TV Kukesi, TV Bajram Curri	22.05.2007	AP ne Puke, Kukes, Tropoje	Prononcim, G. Lleshi
45	Radio Tirana	25.05.2007	AP dhe problematikat e tij	Emision, E. Karamuça
46	Alsat Kosove	02.06.2007	AP ne tryezen e rrumbullaket te Ombudsmaneve rajonale ne Kosove	Prononcim, A. Lazebeu
47	Vizion +, Koha TV	05.06.2007	AP kunder dhunes policore greke	Prononcim, A. Lazebeu
48	TVA	10.06.2007	AP kunder dhunes ne burgje	Prononcim, S. Haluca
49	News 24, Klan	02. 07.2007	AP per largimet nga policia e shtetit	Prononcim, S. Nushi
50	Top Channel, TVA, TVSH	26.07.2007	Konference Kombetare "Drejt nje Shqiperie pa torture"	Prononcim, S. Haluci
51	TVSH	29.07.2007	AP dhe te drejtat e shqiptareve ne Greqi	Prononcim, E. Dobjani
52	TVSH	15.08.2007	AP per gjendjen ne spitalet psikiatrike	Prononcim, E. Dobjani
53	UFO TV	06.09.2007	AP ne ndjekje te rekomandimeve te tij	Interviste, E. Dobjani
54	Alsat	13.09.2007	AP per kartat e identitetit	Prononcim, A. Lazebeu
55	News 24	13.09.2007	AP dhe keqtrajtimit nga policia	Emision, H. Hysa
56	Vizion +	13.09.2007	AP per simbolet e kartes se identitetit	Prononcim, A. Lazebeu
57	News 24	14.09.2007	AP dhe rasti "Kllogjri"	Emision, H. Hysa
58	Alsat	17.09.2007	AP kerkon ngritjen e Mekanizmit Kombetar per Parandalimin e Tortures	Prononcim, A. Lazebeu

59	Top Channel, News 24, Vizion +, TVSH	24.09.2007	AP shperndan librin per te drejtat e te burgosurve ne burgjet shqiptare	Njoftim
60	Vizion +	04.10.2007	AP per zbatimin e vendimeve gjyqsore te formes se prere	Prononcim, A.Lazebeu
61	Ora news, News 24	08.10.2007	AP takohet me delegacionin e Parlamentit Evropjan	Njoftim
62	2A Televizion	10.10.2007	AP ne Gosë dhe Lekaj per ankesat e qytetareve	Prononcim, A. Lazebeu
63	Ora News	17.10.2007	AP per dhunen ndaj femijeve	Interviste, A.Lazebeu
64	Mediasat	17.10.2007	AP dhe problematikat e tij	Emision, E. Dobjani
65	Vizion+	17.10.2007	AP per frekuencat televizive	Prononcim, E.Dobjani
66	Shijak TV	17.10.2007	AP dhe mbipopullimi i burgjeve	Prononcim, A. Lazebeu
67	Alsat TV	21.10.2007	AP ne Jug kerkon mberritjen e valeve televizive kombetare	Prononcim, S. Haluci
68	Top Channel	29.10.2007	AP takon Komisionerin per te Drejtat e Njeriut ne Keshillin e Evropes	Njoftim
69	Vizion +	29.10.2007	Dobjani bisedon me Thomas Hammarberg	Njoftim
70	News 24, Ora News	29.10.2007	Dobjani-Hammerberg bisedojne per te drejtat e njeriut	Njoftim
71	Vizion +	30.10.2007	AP ne tyreze te rumbullaket per te drejtat e femijeve	Prononcim, E. Dobjani
72	Klan	05.11.2007	AP rekomandon masa per gjendjen ne kopshtin e femijeve ne Burrel	Njoftim
73	TVSH, Klan, News 24, Ora News etj	05.11.2007	Kuvendi zgjedh komisioneret e AP-se	Njoftim
74	News 24	06.11.2007	Te merren masa per rehabilitimin e kopshteve te femijeve	Prononcim, A. Lazebeu
75	News 24	12.11.2007	AP dhe vrasja e te miturit ne Peshkopi	Emision, H. Hysa
76	Top Channel, News 24, Vizion +, TVSH	20.11.2007	AP:"Nuk eshte e justifikuar rritja e çmimit te energjise"	Prononcim, E. Karamuçça
77	Ora News	05.12.2007	AP dhe spitalet psikiatrike	Prononcim, E. Dobjani

78	Ora News	06.12.2007	AP ne ndjekje te problematikes se dites	Interviste, E. Dobjani
79	Vizion+, Top Channel, News 24, TVSH, Alsat, Ora News	07.12.2007	Ambasadori Amerikan takon Avokatin e Popullit	Njoftim
80	Vizion +	13.12.2007	AP per reformen ne drejtesi	Prononcim A. Lazebeu
81	Top Channel	14.12.2007	AP vleresohet nga Organizata Co Plan me çmimin e vitit per ndikimin ne mireqeverisje	Njoftim
82	Vizion +	17.12.2007	AP dhe antikorrupsioni	Emisioni LOGOS, A. Lazebeu
83	TVSH	26.12.2007	AP dhe zbatimi i vendimeve te Gjykates se Strasburgut	Interviste, E. Dobjani
84	TV Koha	28.12.2007	AP dhe problemet e ndjekura gjate 2007	Interviste, E. Dobjani

**GAZETAT - SHTYPI I SHKRUAR
PER VITIN 2007**

NR	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
1	12.01.2007	Albania	AP: KESH te analizoje keqmenaxhimin e punes	Njoftim
2	12.01.2007	Koha Jone	Kreret e KESH-it te japin doreheqje	Prononcim, E. Dobjani
3	20.01.2007	Panorama	AP: Policia te mos i rrahe te denuarit me tub plastik	Prononcim
4	20.01.2007	Gazeta ABC	AP:Rritet dhuna ne polici	Artikull
5	20.01.2007	SOT	AP fshikullon policine per abuzime	Njoftim
6	20.01.2007	Shqip	AP: "Nuk po rrespektohen gradat ne Polici"	Prononcim
7	20.01.2007	Tirana Observer	AP per policet e pushuar padrejtesisht	Prononcim
8	24.01.2007	ATSH	AP pret Ambasadorin e Spanjes	Njoftim
9	20.01.2007	Shqip	AP: Qeveria injoron vendimet e Permbarimit	Prononcim
10	26.01.2007	Standard	Hipotekat, dyndje ankesash tek AP	Artikull
11	31.01.2007	Standard	AP: "Ndaloni dhunen ne burgje"	Artikull
12	31.01.2007	Shekulli	AP konstaton dhune ne burgun e Rrogozhines	Artikull
13	31.01.2007	Korrieri	Dhuna ne burg, reagon AP	Artikull
14	16.02.2007	KORRIERI	Të burgosurit, 3700 nuk mund të votojnë	Artikull
15	16.02.2007	KOHA JONE	Avokati i Popullit: Në listat e votuesve mungojnë 4 mijë të burgosur	Artikull
16	16.02.2007	PANORAMA	Dobjani: Votime edhe në burgje	Njoftim
17	16.02.2007	ALBANIA	Avokati i Popullit: "Të burgosurit nuk janë futur në listat e votimit"	Artikull
18	16.02.2007	STANDARD	Avokati i Popullit: Të burgosurve u është hequr e drejta e votës	Artikull
19	18.02.2007	TIRANA OBSERVER	Avokati i Popullit jep alarmin për parregullsitë e zgjedhjeve	Artikull
20	18.02.2007	SHEKULLI	Avokati i Popullit: 3700 të burgosur të privuar nga votimi	Intervistë
21	19.02.2007	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit: Të dënuarit privohen nga vota	Artikull
22	19.02.2007	PANORAMA	Dobjani kërkoi votime në burgje	Njoftim

23	23.02.2007	STANDARD	Avokati i Popullit: Të shfuqizohet dënimi me vdekje në Kodin Ushtarak	Artikull
24	23.02.2007	KORRIERI	Surpriza, dënimi me vdekje ende i ligjshëm në Shqipëri	Prononcim
25	24.02.2007	SHEKULLI	Avokati i Popullit: Kuvendi të bëhet me 100 deputetë	Artikull
26	24.02.2007	METROPOL	Avokati i Popullit: Të liruarit nga puna për nepotizëm të rikthehen	Artikull
27	28.02.2007	TIRANA OBSERVER	AP rekomandon heqjen e denimit me vdekje nga Kodi Penal Ushtarak	Artikull
28	03.03.2007	Revista KLAN	AP dhe vendimet e Gjykatave	Interviste, A. Lazebeu
29	31.03.2007	Revista KLAN	AP dhe çështja "Agia Varvara"	Interviste. A. Lazebeu
30	05.03.2007	PANORAMA	Gjykatat dhe AP ende nuk kanë zëvendësuar anëtarët që u kanë mbaruar mandati	Artikull
31	06.03.2007	STANDARD	AP - një portë me shumë për të drejtat e njeriut	Artikull
32	06.03.2007	Republika	AP denon episodin e videos nacionaliste me ushtarët grekë	Prononcim, E. Dobjani
33	06.03.2007	Albania	AP: Incidenti me ushtarët grekë të trajtohet me qetësi	Prononcim, E. Dobjani
34	06.03.2007	Korrieri	AP: Numerimi i votave të bëhet me skaner elektronik	Artikull
35	06.03.2007	RD	AP: Prokuroria dhe Gjykatat zvarrisin çështjet	Prononcim, E. Dobjani
36	07.03.2007	Ballkan	Rekomandimet e AP-se në Raportin e Departamentit të Shtetit	Artikull
37	14.03.2007	Shekulli	AP: Ministria bllokoi projektin për HEC-et	Artikull
38	16.03.2007	Ballkan	AP: Shqipëria ende nuk ka zbatuar konventat evropjane për dënimin me vdekje	Njoftim
39	17.03.2007	Shqip	AP paralajmëron Ministrinë e Drejtësisë për dënimin me vdekje	Artikull
40	18.03.2007	Tirana Observer	AP rekomandon miratimin e HEC-it të Hotolishtit	Artikull
41	24.03.2007	Panorama	Gjykata Kushtetuese pranon kërkesën e AP-se për strukturën dhe pagat	Artikull
42	24.03.2007	Panorama	AP: "Projekti i hipotekave ka përmbajtje antikushtetuese"	Njoftim

43	24.03.2007	Koha Jone	AP: Si te ndryshoje ligji per regjistrimin e pasurive	Artikull
44	24.03.2007	Zeri i Popullit	AP rekomandon masa ndaj firmes se HEC-eve	Artikull
45	24.03.2007	Shqip	AP per firmen fituese te HEC-eve	Artikull
46	26.03.2007	Ballkan	AP dhe problemet e policise	Artikull
47	28.03.2007	Ballkan	Raporti i AP-se dhe problemet e prones	Artikull
48	01.04.2007	Ballkan	Neper faqet e Raportit Vjetor te AP-se	Artikull
49	13.04.2007	Standard	AP paraqet rastet korruptive ne KESH	Artikull
50	13.04.2007	Shqip	Dobjani: 6 rastet korruptive ne Keshin e Tiranës	Artikull
51	16.04.2007	Ballkan	AP: Shqiperia shkel konventat evropjane per denimin kapital	Prononci.m E. Dobjani
52	18.04.2007	Korrieri	AP denoncon rastet e personave te mbajtur ne spitalet e burgjeve	Artikull
53	18.04.2007	Shqip	AP per dhunen ne burgje: "Ka munguar vullneti i te gjitha qeverive".	Artikull
54	19.04.2007	Koha Jone	AP: "Sjellje çnjerezore ne burgjet e Lezhës dhe Burrelit"	Artikull
55	19.04.2007	Panorama	Spektori i krimit ekonomik heton skandalin e zbuluar nga AP per abuzimet ne KESH	Artikull
56	20.04.2007	Ballkan	AP: Ne 2006 u shtua dhuna nga policia e burgjeve	Artikull
57	22.04.2007	MAPO	Denoncimi i specialisteve te KESH-it tek AP	Artikull
58	23.04.2007	Gazeta Shqiptare	Ndotja e mjedisit me amoniak alarmon AP-ne	Artikull
59	25.04.2007	SOT	Zyra e AP-se zbret ne Berat	Njoftim
60	25.04.2007	Albania	AP ne Korçe merr ankesa per gjyqtaret dhe Bashkine	Njoftim
61	25.04.2007	Standard	Ne hetim dy shefa policie me Rekomandim te AP-se	Artikull
62	25.04.2007	Zeri i Popullit	AP ne Korçe merr 100 ankesa ne nje dite	Njoftim
63	04.05.2007	Standard	Kushtetuesja rrezon qeverine per pagat e institucioneve te pavarura	Artikull
64	04.05.2007	Shekulli	Nuk ndryshojne pagat e institucioneve te pavarura	Artikull
65	04.05.2007	Panorama	Pagat e AP-se, Kushtetuesja rrezon qeverine	Njoftim

66	04.05.2007	Shqip	AP jep opinion per ligjin per arsimin e larte	Njoftim
67	06.05.2007	Standard	AP: Nga 1 Prilli, faturat aforfe jane te paligjshme	Njoftim
68	06.05.2007	Shekulli	AP: Afrofeja eshte e paligjshme	Njoftim
69	06.05.2007	Korrieri	AP: Vendosni matesat e energjise	Artikull
70	08.05.2007	Standard	Dobjani: Te denuarit me burgim nuk i kontrollon njeri	Artikull
71	09.05.2007	Sot	Sarande, lume ankesash tek Avokati i Popullit	Njoftim
72	09.05.2007	Metropol	Avokati i Popullit raport per shkarkimet ne forcat e rendit: Policet e shkarkuar te marrin dy paga njeheresh si dhe nje vit garanci	Njoftim
73	11.05.2007	Telegraf	Avokati i Popullit, takime me banoret	Njoftim
74	11.05.2007	Republika	Avokati i Popullit denoncon zyrat e regjistrimit te pronave	Njoftim
75	12.05.2007	Shekulli	Elbasan, 50 ankesa ne dite per Avokatin e Popullit	Njoftim
76	12.05.2007	Sot	Lazarat, bie interesi i banoreve ndaj Avokatit te Popullit	Njoftim
77	12.05.2007	Korrieri	Avokati i Popullit denoncon levizjet jashte kriterëve ne radhet e uniformave blu, te cilat ulin efikasitetin e Policise se Shtetit	Artikull
78	13.05.2007	Korrieri	Avokati i Popullit ankohet tek Kryeministri: Burgje vdekjepruresë	Artikull
79	15.05.2007	Panorama	Dobjani: Ligji duhet rishikuar	Njoftim
80	15.05.2007	Korrieri	Dobjani: Verejtje Rusmalit	Artikull
81	15.05.2007	Standard	Avokati i Popullit: "Te ngrihet Gjykata e te Miturve"	Njoftim
82	15.05.2007	Panorama	Raport i ashper i Dobjanit: Shkarkimet jane abuzive. "Ne polici ikin te trajnuarit, vijne individe pa arsim"	Artikull
83	18.05.2007	Sot	QSHKE paraqet situaten e ankesave tek Avokati i Populli, 32% me teper se '04. Shteti i mbytur ne korrupsion dhe burokraci	Artikull
84	22.05.2007	Koha Jone	Hipotekat, te perfshira ne abuzime- Prononcim - A.Lazebeu	Prononcim
85	23.05.2007	Panorama	Durres, Avokati i Popullit ne inspektim	Njoftim

86	24.05.2007	Sot	Komisioni i Ligjeve miraton pa debate tre propozimet. Miratohen ne Komisionin e Ligjeve Komisioneret e Avokatit te Popullit	Artikull
87	25.05.2007	Tirana Observer	Reforma ne polici, çdo dite ankesa te Avokati i Popullit	Artikull
88	29.05.2007	Gazeta Shqiptare	Aforfeja na kushton 25 mln dollare Dobjani:ERE lejoi shkeljen e re te Kushtetutes	Artikull
89	01.06.2007	Standard	AP: "Te zhvendoset linja 110 kv nga bulevardi "Zogu i Pare"	Artikull
90	19.06.2007	Albania	A.P.: Te pafuqishem per mbrojtjen e emigranteve	Artikull
91	22.06.2007	Panorama	"Shkarkimet ne polici, te paligjshme" Per here te dyte, Avokati i Popullit kerkese Nishanit e Prençit	Artikull
92	22.06.2007	Ballkan	Ja letra qe nxorri nga qelia, te akuzuarin e procesit "Kokaina" Dobjani, Kondit: "Lironi sa me shpejt Din Gjonajn"	Artikull
93	30.06.2007	Panorama	"Shkrihet" Antikrimi i Organizuar A.P.: Shkurtime ne polici prekin edhe stafin operacional te RENEAS	Artikull
94	30.06.2007	Metropol	Sqarimi i Avokatit te Popullit "S'kam asnje lidhje me te arrestuarin si trafikant"	Njoftim
95	04.07.2007	Albania	Dobjani dergon te Nishani listen e policeve qe u hoqen padrejtesisht	Artikull
96	05.07.2007	Koha Jone	Rrahja e Kir Hajdarit, ndalohe inspektori. Denoncimi tek Avokati i Popullit. Nen hetim 10 police te komisariatit	Artikull
97	07.07.2007	Tirana Observer	Emri i fundit konsensual quhet Ermir Dobjani	Njoftim
98	07.07.2007	Shqip	Dobjani: Dhuna greke? Vetem maja e ajsbergut	Interviste
99	14.07.2007	Gazeta Shqiptare	Avokati i Popullit: KESH te shpalle listen e kufizimeve	Njoftim
100	14.07.2007	Tirana Observer	Avokati i Popullit: "491 persona, ne pritje te Statusit "Deshmore te Atdheut"	Artikull
101	17.07.2007	Koha Jone	A.P.: "Krahu i Kirion Hajdarit nuk u thye ne furgon"	Njoftim

102	18.07.2007	Metropol	Avokati i Popullit rekomandon vendosjen e grafikeve per energjine	Njoftim
103	18.07.2007	Panorama	A.P.: "Alarmi, po ikin specialistet nga policia"	Njoftim
104	23.07.2007	Panorama	A.P.: Mashtrimi me kompesimin e dritave	Artikull
105	24.07.2007	Koha Jone	A.P.: "Kompesoni shtresat ne nevojte per çmimin e energjise"	Artikull
106	27.05.2007	Gazeta Shqiptare	Dobjani: "Jo dhunimit te grave dhe femijeve"	Njoftim
107	27.07.2007	Zeri i Popullit	A.P.: "Drejt nje Shqiperie pa torture. Institucionet bashkepunim"	Njoftim
108	27.07.2007	Standard	A.P.: Ende forma torture ne komisariate	Artikull
109	29.07.2007	Albania	Dobjani, leter Rusmajlit: Merr ne pune zyrtaret qe fituan gjyqet!	Artikull
110	29.07.2007	Tirana Observer	A.P.: Eksperti mjeko-ligjor kerkon kthim ne pune	Artikull
111	01.08.2007	Tirana Observer	AP kerkon demshperblim per diplomatet e demtuar ne Beograd gjate luftes	Artikull
112	02.08.2007	Panorama	Psikiatrite ndikojne keq ne shendetin e te semureve	Njoftim
113	02.08.2007	Panorama	AP kerkon inspektimin e linjave te trageteve	Njoftim
114	02.08.2007	Panorama	AP kerkon dublimin e rruges se Plazhit	Njoftim
115	06.08.2007	Korrieri	Shteti shkel te drejtat e te semureve mendore	Artikull
116	06.08.2007	Telegraf	Ja problemet e spitaleve psikiatrike	Artikull
117	08.08.2007	Telegraf	AP i rekomandon Qeverise permiresimin e spitaleve psikiatrike	Artikull
118	08.08.2007	Albania	Dobjani leter Oldashit per inspektimin e trageteve	Artikull
119	09.08.2007	Albania	AP per spitalet psikiatrike	Artikull
120	05.09.2007	Tirana Observer	AP, asnje pergjigje per spitalet	Prononcim
121	13.09.2007	Agon	AP kerkon pergjegjesine per Komitetin Kombetar te Parandalimit te Tortures	Njoftim
122	13.09.2007	Korrieri	AP per simbolet e kartave te identitetit	Njoftim
123	13.09.2007	Koha Jone	AP kerkon shpjegime per simbolet e kartes se identitetit	Njoftim
124	19.09.2007	Koha Jone	I denuari i perjetshem Z. Ç. kerkon ndihmen e Avokatit te Popullit	Njoftim

125	19.09.2007	Gazeta Shqiptare	AP i kthen pergjigje te denuarit te perjetshem	Njoftim
126	20.09.2007	Gazeta Shqiptare	Te arrestuarit VIP rrefejne kushtet e paraburgimit tek Avokati i Popullit	Prononcim, E. Dobjani
127	21.09.2007	Koha Jone	Te miturit e Korçes ankohen tek AP	Artikull
128	22.09.2007	Koha Jone	AP kerkon verifikim per kercenimet ndaj te denuarit te perjetshem Z. Ç	Artikull
129	23.09.2007	Telegraf	AP kerkon pergjegjesine per ngritjen e nje strukture kunder tortures dhe traumes	Njoftim
130	25.09.2007	Korrieri	AP kerkon prej dy vjetesh ngritjen e Komisionit per Gjakmarrjen	Njoftim
131	25.09.2007	Albania	AP kerkon miratimin ne Kuvend te projektligjit per personat me aftesi te kufizuara	Artikull
132	25.09.2007	Standard	AP kerkon qe gjyqtaret te japin edhe denime alternative	Prononcim, E. Dobjani
133	25.09.2007	Panorama	AP prezanton ne burgun 325 librin per te burgosurit	Njoftim
134	26.09.2007	Telegraf	Perfaqesuesi i AP-se ne Konferencen per zbatimin e Konventes Evropjane	Njoftim
135	30.09.2007	Ballkan	AP kerkon ndryshim ligji per regjistrimin e shtetasve	Artikull
136	05.10.2007	Shqip	AP informon Departamentin e Shtetit	Njoftim
137	08.10.2007	Panorama	Raporti i AP-se per keqtrajtimin e te rinjve tek Blloku	Artikull
138	09.10.2007	Gazeta Shqiptare	Dobjani takon Doris Pack per te drejtat e njeriut	Njoftim
139	09.10.2007	Ballkan	Dobjani-Pack: "I nevojshem bashkepunimi me autoritetet shteterore"	Njoftim
140	09.10.2007	Koha Jone	Dobjani bisedon me Doris Pack	Njoftim
141	09.10.2007	RD	AP pret delegacionin e Parlamentit Evropjan	Njoftim
142	09.10.2007	Republika	Takimi Dobjani-Pack per te drejtat e njeriut	Njoftim
143	09.10.2007	Panorama	Dobjani takon delegacionin e PE-se	Njoftim
144	10.10.2007	Shqip	AP informon KE-ne dhe SHBA-ne per te drejtat e njeriut ne Shqiperi	Artikull

145	12.10.2007	Albania	Pergjigje AP-se per te burgosurin e perjetshem Z.Ç	Artikull
146	12.10.2007	Korrieri	AP kerkon zbatimin e ligjit per dhomat e paraburgimit	Artikull
147	13.10.2007	Panorama	AP: "Burgjet nuk pranojne te arrestuarit"	Artikull
148	15.10.2007	Ballkan	Policia dhe Prokuroria, fajtores per aksidentet	Artikull
149	16.10.2007	Sot	Ankesat per pronat sjellin AP-ne ne Sarande	Njoftim
150	16.10.2007	Dajti	AP ne mes te popullit per ankesat	Njoftim
151	18.10.2007	Korrieri	AP: Heqja e antenave - gabim	Prononcim, E. Dobjani
152	20.10.2007	Klan	AP tenton krijimin e Mekanizmit Kombetar Kunder Tortures	Interviste, A. Lazebeu
153	24.10.2007	Shqip	AP me delegacionin e Bundestagut Gjerman: Kujdes me azilkerkuesit homoseksuale	Njoftim
154	26.10.2007	Albania	AP: "Shkelje, ne qelite e policise ka ende te denuar me vendim gjykate"	Artikull
155	31.10.2007	Koha Jone	AP: "Nuk ka vende ne burgje per te transferuarit e mundshem"	Artikull
156	31.10.2007	Koha Jone	Dobjani: "Problem te drejtat e njeriut dhe korrupsioni"	Prononcim, E. Dobjani
157	31.10.2007	Koha Jone	AP: "Situata ne transportin urban duhet pare ne kompleks"	Prononcim, A. Lazebeu
158	31.10.2007	Ballkan	Qeveria heq tarifen e recetes per te siguruarit, me rekomandim te AP-se	Njoftim
159	31.10.2007	Ballkan	Dobjani KE-se: Probleme me zbatimin e te drejtave	Njoftim
160	31.10.2007	Republika	AP-KE: "Probleme me te drejtat e njeriut dhe korrupsionin"	Njoftim
161	31.10.2007	Zeri i Popullit	Dobjani pranon para KE-se: "Kemi probleme me te drejtat e njeriut"	Njoftim
162	31.10.2007	Standard	AP ne tryeze per perafirmimin e legjislacionit te femijeve	Njoftim
163	01.11.2007	Panorama	AP: "Mbipopullimi ne burgje, mbi 1000 veta mbi kapacitetin"	Njoftim
164	05.11.2007	Telegraf	AP: "Si te eliminojme torturat ne dhomat e paraburgimit"	Artikull
165	06.11.2007	Ballkan	AP-Ambasadori gjerman: "Shqiperia, arritje ne lirine e mediave".	Njoftim

166	06.11.2007	Republika	Dobjani-Bortchardt: "Shtyrja e reformes zgjedhore mund te komprometoje procesin"	Njoftim
167	06.11.2007	Albania	AP takon Ambasadorin e Gjermanise	Njoftim
168	06.11.2007	Tirana Observer	Dobjani: "Anetaret e Gjykatave, me mandat te perhershem"	Artikull
169	06.11.2007	Agon	AP ne takim me Ambasadorin gjerman, mbron qeverine dhe akuzon mediat	Artikull
170	21.11.2007	Republika	AP kritikon rritjen e çmimit te energjise	Artikull
171	22.11.2007	Standard	AP paraqet kerkesen per me shume fonde ne Parlament	Njoftim
172	07.12.2007	Shqip	AP zbulon fallsifikimet me dokumentet e viktimave te 9 Janarit	Prononcim. A. Pilo
173	08.12.2007	Agon	Ambasadori Amerikan vlereson rolin e AP-se	Njoftim
174	08.12.2007	Sot	Dobjani i raporton Ambasadorit Amerikan për zbatimin e te drejtave te njeriut	Njoftim
175	08.12.2007	Standard	Vleresohet roli i Avokatit te Popullit	Njoftim
176	08.12.2007	Republika	Dobjani-Withers: Ne fokus, mbrojtja e te drejtave te njeriut	Njoftim
177	08.12.2007	Albania	Ambasadori Amerikan vlereson rolin e Avokatit te Popullit	Njoftim
178	08.12.2007	Koha Jone	AP denoncon torturen ne paraburgimin e Vlores	Artikull
179	14.12.2007	Tirana Observer	Organizata Co Plan shpall AP-ne si njeriu i vitit per 2007	Njoftim
180	14.12.2007	Albania	AP dergon ne Prokurori kater gardiane	Artikull
181	19.12.2007	Albania	Dobjani: "Te ndryshohet ligji per pensionin shtese te policeve".	Artikull
182	21.12.2007	Albania	Dobjani: "Ne spitalin e burgut ka kushte skandaloze".	Artikull
183	29.12.2007	Tirana Observer	AP: "Të ndryshojë ligji për sigurimet shoqërore suplementare të policëve"	Artikull

STATISTIKE PERMBLEDHESE E MBULIMIT MEDIATIK 2007

MEDIA E SHKRUAR

a)


Artikuj	Prononcime	Njoftime	Intervista	Konferenca shtypi	Gjithsej
91	18	69	5	0	183

MEDIA ELEKTRONIKE


b)

Njoftime	Prononcime	Intervista	Emisione	Konferenca shtypi	Gjithsej
13	44	8	19	0	84

Ankesa, kërkesa dhe njoftime të trajtuara nga zyra e AP gjatë vitit 2007
Totali 4233




**Ankesa dhe kërkesa të paraqitura verbalisht pranë
Zyrës së Pritjes së Popullit gjate vitit 2007
Totali 2037**




- Ankesa verbale të regjistruara në sekretari për shqyrtim, pasi u bënë me shkrim
- Ankesa dhe kërkesa verbale, të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë, në zbatim të nenit 17/a dhe 17/b të ligjit.

Ankesa me shkrim te trajtuara gjate vitit 2007
Totali 3018




- Numri i ankesave të regjistruara gjatë vitit 2007
- Numri i ankesave të mbartura nga viti 2006


**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të përfunduara gjatë vitit 2007,
pavarësisht nëse kanë qenë brenda ose jashtë juridiksionit
Totali 2567**



**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave që kanë qenë brenda
juridiksionit gjatë vitit 2007
Totali 1412**




Gjendja e ankesave të marra në shqyrtim gjatë vitit 2007
Totali 2992



■ Ankesa të përfunduara gjatë vitit 2007


■ Ankesa që vazhdojnë të jenë në shqyrtim në vitin 2008

**Krahasimi i ankesave të ardhura për vitet 2000 - 2007,
(përfshirë edhe ato që ju është dhënë përgjigje menjëherë)
Totali 26125**




Ankesa te ardhura ne vite

Shperndarja e ankesave te regjistruara gjate vitit 2007 sipas institucioneve Totali 2792 raste



MEDIA E SHKRUAR PER VITIN 2007



MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2007

